

# 3 MAJTA.

Mendimi Politik / Profile Biografike



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

FRIEDRICH  
EBERT   
STIFTUNG





# E MAJTA

Mendimi Politik / Profile Biografike

## **Botues**

-Friedrich-Ebert-Stiftung

Zyra e Tiranës

Rr. "Kajo Karafili" Nd-14, Hyrja 2, Kati 1, Kutia Postare 1418, Tiranë, Shqipëri

- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Rruga "Ibrahim Rugova", nr. 11, Tiranë, Shqipëri

## **Autorë**

Prof. Dr. Ana Lalaj

Dr. Dorian Koçi

Dr. Edon Qesari

Prof. Dr. Hamit Kaba

Dr. Ilir Kalemaj

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi

Ndihmuan në përgatitjen e këtij botimi:

Ardita Repishti - Drejtoreshë e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, AIDSSH

Jonida Smaja - Koordinatore Programi, Friedrich-Ebert-Stiftung

## **Design**

Grid Cartels

## **Shtëpia Botuese**

Gent Grafik

Kërkimet shkencore dhe analizat e ndërmarra për këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert. Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

# Përmbajtje

6P

Parathënie

10H

Hyrje

26



Sejfulla Malëshova

86



Musine Kokalari

72



Tajar Zavalani

52



Konstandin Çekrezi

104



Isuf Luzaj

118



Skënder Luarasi

140



Petro Marko

200



Xhavid Qesja

180



Isuf Keçi

162



Zef Mala

# Parathënie



**Gentjana  
Sula**

## **Mendimi politik i së majtës shqiptare**

E majta shqiptare jomonolite, me dinamikat e zhvillimit të saj në rrafshin kombëtar dhe europian, me zgjedhjet dhe vendimet për marrjen e mbajtjen e pushtetit në përfundim dhe pas Luftës së Dytë Botërore, ka qenë prej kohësh sfidë për t'u trajtuar.

Gjysmëshekulli komunist që e fshiu mendimin ndryshe, që e retushoi të shkuarën dhe emrat e përveçëm që patën ndikim në vend, u kujdes të vetëparaqitej me dorë të fortë, si e majtë e unifikuar që në fillime, e gjithëpranuar nga populli, e cila e mbajti pushtetin për popullin.

Gjendja e Shqipërisë në fillimvitet '90, e bunkerizuar anekënd, e izoluar nga e gjithë bota, e varfër deri në asht, e kolektivizuar, shpronësuar, me burgjet plot të dënuar politikë, me kampe internimi dhe vende të punës së detyruar nga veriu në jug e po ashtu, emigrimi masiv i mijëra shqiptarëve që e kërkuan jashtë vendit të ardhmen e tyre, tregon qartë se e majta komuniste shqiptare nuk e kishte kaq të gjerë bazën e trumbetuar.

*“Ti e sheh se tek ne fshihet e vërteta”, i thoshte Xhavid Qesja personit që e përndiqte. “... Edhe ty ka plot gjëra që nuk të duken të drejta, por ti nuk flet... Njeriu duhet të flasë, të jetë principlial, të ketë guxim”.*

Sejfulla Malëshova, Konstandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Keçi, Skënder Luarasi, Xhavit Qesja, Isuf Luzaj, Petro Marko, Zef Malaj e të tjerë janë personalitete që u frymëzuan nga aspiratat për drejtësi shoqërore dhe punuan për ta ngritur e formësuar të majtën në vend.

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe kalimi i pushtetit në duart e Partisë Komuniste ishte vendimtar për fatin e tyre e shumë të tjerëve, që u përndoqën, dënuan, ekzekutuan dhe anatemuan me breza. Kjo opozitë brenda së majtës, thujse e panjohur për shoqërinë e sotme shqiptare, të mbingarkuar nga narrativa e së shkuarës, frymëzoi këtë projekt, hapi i parë i studimit të së majtës në Shqipëri, përtej veprimtarisë së PKSH/PPSH.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Fondacioni Friedrich Ebert në Tiranë u bënë bashkë në një projekt serioz dhe sfidues që ndriçon këtë aspekt të historisë sonë të afërt, të lënë në hije për një pjesë të madhe të shoqërisë shqiptare. Dhjetë intelektualë të mirënjohur, filozofë, gazetarë, mendimtarë e përkthyes, shkrimtarë e njohës shumë të mirë të dinamikave në vend e jashtë tij u morën në studim nga një ekip i nivelit të lartë akademik.

4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare profileve të përzgjedhura, duke riskuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX.

Emrat e shqyrtuar në këtë vëllim të parë dhe profilet që i ofrohen lexuesit janë një përpjekje për të sjellë idetë dhe mendimet e atyre që u përpoqën të themelonin një të majtë evropiane, e cila do të vijojë me fazat e tjera. Po ashtu, ky botim është një ftesë për reflektim dhe mundësi që të rinjtë të njihen me individë me identitet politik të qartë, të përcaktuar dhe të dallueshëm, që janë pjesë e trashëgimisë historike të Shqipërisë.

## **Gentjana Sula**

Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

# Parathënie



**Stine  
Klapper**

*I dashur lexues,*

Po të japim në dorë këtë botim që të bën të mendosh. Ai portretizon dhjetë personalitete, disa më të njohur se të tjerët, por që të gjithë me diçka të përbashkët: ata ishin mendimtarë dhe aktorë politikë të majtë dhe, në mënyra të ndryshme, kundërshtarë të regjimit komunist. Leximi i historive të tyre jetësore na bën të kuptojmë shumë mësimë të rëndësishme që vlejnë edhe sot po aq sa në periudhën e errët historike kur jetuan personat e portretizuar. Do të doja të ndaja dy prej këtyre mësimëve:

1. Ideologjitë janë fluide. Kjo vlen si për bindjet ideologjike personale, ashtu edhe për interpretimet e tyre më të gjera. Mendimi politik i majtë u zhvillua gjatë shekullit të kaluar dhe vazhdon të zhvillohet. Ai është tejet pluralist e vjen në një pafundësi formash të ndryshme, si në përkufizime, ashtu edhe në praktikë. Idetë dhe materializimi i tyre e marrin formën prej kontekstit, ndërsa u përgjigjen zhvillimeve historike, shoqërore dhe ekonomike. Të besosh se ka një të vërtetë të vetme, një përkufizim absolut dhe një përgjigje të duhur përfundimtare për kompleksitetin e shoqërisë, shtetit dhe ekonomisë, nuk është vetëm e gabuar, por edhe e rrezikshme. Ky është një perceptim që është keqpërdorur në mënyrë dramatike, veçanërisht gjatë shekullit XX në Shqipëri. Nëse ndalohen diskutimet dhe kritikrat, nëse i pritret rruga ndryshimit dhe korrigjimit të kursit politik, nëse pushteti monopolizohet, nëse ideologjia instrumentalizohet, mund të përfundojmë në regjime të frikshme, regjime që, faktikisht, janë e kundërta e asaj që ëndërruan pionierët e mendimit të majtë politik. Kjo nuk nënkupton se ideologjitë e idetë politike janë të rrezikshme në vetvete. Përkundrazi, ne jetojmë në një botë së cilës i mungojnë këto ide, këto vizione e këto diskutime programore politike. Shumëçka sille rreth politikës së pushtetit e mendjengushtësisë teknokrate, duke dalë mbi ligjërimin dhe bindjet. Na duhet angazhim e diskutim rreth ideologjive politike, rreth kompleksitetit e dobisë së tyre si busull për orientimin e vendimmarrjes politike që mundëson përparimin dhe një shoqëri më demokratike, të drejtë dhe të barabartë, jo si një e vërtetë e vetme dhe absolute.

Kthimi i vështrimit nga personalitetet e portretizuara në këtë libër mund të ushqejë me informacion debatet politike aktuale mbi normat, vlerat dhe orientimet. Disa prej personaliteteve mund të konsiderohen madje si pionierë të mendimit socialdemokrat në Shqipëri. Njohja me jetët, idetë dhe bindjet e tyre do të pasurojë diskutimin e sotëm mbi përgjigjet sociale e demokrate, si



dhe emancipuese e ndërkombëtare ndaj shumë sfidave me të cilat përballen shoqëritë tona.

2. Struktura ka rëndësi, por individët mbajnë përgjegjësi – ata kanë përgjegjësinë për të vepruar a reagu. Historia shqiptare mori një kthesë të tmerrshme gjatë regjimit të Hoxhës. Megjithatë, jo të gjithë e ndoqën pas. Individët pranuan të merrnin përgjegjësi personale për një kauzë më të madhe, për bashkëqytetarët e tyre. Ata qëndruan, shpesh, duke e paguar shtrenjtë. Ne duam t'i nderojmë e të respektojmë kurajën e tyre. Në të njëjtën kohë, duam të tregojmë se ata jo gjithmonë ndoqën rrugën e drejtë heroike. Gjërat vështirë të jenë bardhezi. Njerëzit luftojnë jo vetëm me shtypjen e jashtme, por edhe me vetë identitetin e tyre. Disa luftuan si partizanë antifashistë dhe mbështetën ideologjinë majtiste të një elite të re politike dhe besuan në objektivin fisnik të barazisë, vetëm për kuptuar më vonë se po kjo ideologji u përdor për të shtypur shumicën e për ta grumbulluar të gjithë pushtetin në duart e një pakice. Ky është një ndërgjegjësim që mund të shkatërrojë thelbin e identitetit personal të njeriut. Jo të gjithë nxorën përfundimet e duhura. Këtë mund ta shihni nga rrugët e ndryshme që zgjedhën të përshkonin individët e portretizuar. Ata luftuan me bindjet dhe veprimet e tyre dhe janë vetë personalitete komplekse. Megjithatë, ata janë prova që dëshmon pse përgjegjësia individuale është e mundur dhe thelbësore.

Veçanërisht, ata tregojnë se kishte edhe opozitë nga e majta, e cila besonte te vlerat themelore të lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit, duke protestuar kundër keqpërdorimit dhe zvetënimit të rrënjëve të tyre. Regjimi komunist mund ta quante veten i majtë, por punonte kundër gjithçkaje themelore që përfaqëson ideologjia e majtë.

Dëshirojmë të falënderojmë autorët për studimin e shkëlqyer dhe Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për bashkëpunimin. Kjo është një punë me vlerë të jashtëzakonshme dhe jemi të bindur se ky botim do të shërbejë si pikënisje për shumë diskutime e studime të mëtejshme.

## **Stine Klapper**

Drejtuese e Friedrich-Ebert-Stiftung,  
Zyra e Tiranës

# Hyrje

NGA ILIR KALEMAJ

**E** majta në përgjithësi, ka disa korniza ideologjike të cilat i kanë rezistuar kohës qysh prej Komunës së Parisit dhe Revolucionit Francez. Një prej tyre është arritja e barazisë ekonomike nëpërmjet mekanizmave të rishpërndarjes, ndonëse këtu ka nuanca të forta mbi çfarë lloj të majte flasim. E majta marksiste është për eliminimin e diferencimeve sociale nëpërmjet mekanizmit “të luftës së klasave” për të mbërritur te faza finale, tek ajo që Karl Marksi e quan “shteti politik pasrevolucionar”.<sup>1</sup> Pikëpamjet e Marksit u kritikuan qysh herët nga anarkisti rus Mikael Bakunin, sipas të cilit, pikëpamjet e Marksit do të çonin në mënyrë të paevitueshme drejt një “socializmi shkencor” që do të krijonte, jo vetëm një hierarki të re, por edhe një monopol pushteti.<sup>2</sup> Teza e Bakuninit u zbrërthye më pas nga majtistë të hershëm, si: Leon Trocki, Georg Lukacs apo Milovan Djilas, të cilët theksonin se lufta e përhershme e klasave do të krijonte vetvetiu një klasë të re. Kjo ndodhi fill pas revolucionit bolshevik dhe konsolidimit të paradigmes së re të marksizëm-leninizmit për rolin avantgardë apo edukues të partisë-shtet mbi masat. Tipare të tjera të së majtës janë ato që theksojnë elementë të tillë ideologjikë si drejtësia sociale. E majta vetëpërkruhet si progresiste dhe është në thelb internacionaliste. Eliminimi i barrierave sociale dhe ekonomike është një tjetër tipar identifikues i së majtës moderne dhe synimi është arritja e barazisë së të ardhurave ose, së paku, zvogëlimi i hendekut mes të pasurve dhe të varfërve në shoqëri. E majta socialdemokrate e synon këtë përmes mekanizmit të zgjerimit të shtresës së mesme dhe përmes mekanizmave të taksimit progresiv dhe politikave të tjera fiskale, që synojnë konsolidimin e financave të pjesës më vulnerabël të shoqërisë, si grupet e marginalizuara, punëtorët, minoritetet, etj. Nga ana tjetër, “hegemoniteti kulturor” gramshian, me anë të të cilit shpjegohet se si elitat kontrollojnë qendrat e mendimit dhe, për rrjedhojë, shoqëria reflekton ideologjinë sunduese është njëherazi kritikë, por edhe formulë se si e majta e shekullit XX e mandej mund të vijë në pushtet, jo domosdoshmërisht nëpërmjet revolucionit marksist apo përmbysjeve me dhunë. Natyrisht, e majta moderne dhe pasmoderne socialiste dhe socialdemokrate operon brenda sistemit të liberaldemokracisë si formë sistemi politik dhe

1. Thomas Sowell. 1963. “Karl Marx and the Freedom of the Individual.” *Ethics*, Vol. 72, No. 2, ff. 119-125.

2. Ulli Diemer. Bakunin vs. Marx. Downloaded from: <https://libcom.org/library/bakunin-vs-marx>

ka përqaftuar ekonominë sociale të tregut, si një ndër varietetet e kapitalizmit dhe si forma më e mirë e korrektimit të disbalancave shoqërore, ekonomike, gjinore, etj. Kjo natyrisht e ka diferencuar nga sistemet socialiste që ndoqën rrugën sovjetike sipas modelit të revolucionit bolshevik dhe që shpesh u imponuan dhunshëm nga marshimi gjeopolitik i Ushtrisë së Kuqe.

Për shqiptarët, të cilët jetuan për 47 vjet nën një regjim totalitar të majtë të tipit stalinist, është e natyrshme që historia e së majtës në Shqipëri, shpesh të bashkëlidhet me historinë e grupeve komuniste të krijuara në vitet '30, ose me historinë e PKSH/PPSH-së. Në të vërtetë, historia e së majtës shqiptare shkon më herët në histori dhe e tejkalon të majtën komuniste.

Në një vend të vogël dhe me probleme të thella sociale si Shqipëria, nuk është rastësi që konceptet e së majtës, qoftë asaj socialdemokrate, qoftë asaj komuniste, zunë vend që me krijimin e shtetit. Në fillim të viteve '20, në faqet e shtypit dhe në diskutimet në qarqet intelektuale qarkullonin mjaft nga parimet themelore të së majtës, të tilla si: barazia sociale, rishpërndarja e pasurisë kombëtare, veçanërisht rregullimi i pronësisë së tokës, etj. Me Lëvizjen e Qershorit, konceptet e së majtës liberale u përmbledhën së bashku në një program qeverisës, i cili, duhet pranuar, kishte doza utopie dhe radikalizmi për gjendjen politike dhe shoqërore të Shqipërisë së asaj kohe.

Pavarësisht rrymës së mendimit të majtë (socialdemokratë, anarkistë, komunistë, etj.) që i përkisnin këto shkrime e diskutime në vitet '30, ndihet qartë një rritje e përkrahjes së tyre, veçanërisht nga një pjesë e elitave të reja intelektuale, sidomos nga një masë e madhe e të rinjve të shkollave. Të gjithë i bashkonte qëllimi i përbashkët: gjetja e një alternative politike që do ta shkëpuste vendin nga trashëgimia osmane dhe do t'i jepte mundësi të ecte drejt zhvillimit dhe prosperitetit ekonomik, politik e shoqëror. Një pjesë e shihnin përkrahjen e mendimeve të socialdemokracisë si rrugën më të mirë për europianizimin e vendit. Të tjerë përkrahën komunizmin si një mënyrë për të shprehur pakënaqësinë ndaj autoritarizmit të Mbretit Zog dhe politikës së tij proitaliane. Kishte të tjerë, të cilët si më pragmatistë, panë te përqaftimi i mendimit të majtë një mundësi më shumë për shkollim dhe prosperitet individual.

Lufta e Dytë Botërore ridimensionoi pozicionin e së majtës në Shqipëri. Krijimi i PKSH, adaptimi prej saj i modelit stalinist, diktimi i modelit jugosllav, energjia për të drejtuar dhe dominuar lëvizjen e rezistencës antifashiste i dha asaj legjitimitetin për të kërkuar pushtetin e pasluftës, por edhe i hapi rrugën eliminimit të grupimeve të tjera të së majtës. Rivalët brenda së majtës komuniste, si: Niko Xoxi, Anastas Lula, Llazar Fundo, Mustafa Gjinishi, u eliminuan fizikisht që gjatë Luftës së Dytë Botërore. Komunistë të tjerë, si ata të Grupit Zjarri, iu bashkëngjitën në shumicë Ballit Kombëtar. Disa u vranë gjatë luftës, në përpjekje me armikun, ose në luftë kundër forcave partizane. Të tjerët u konsideruan “armiqtë e popullit” dhe iu nënshtruan ndjekjeve e persekutimeve që iu rezervuan kësaj kategorie. Lufta e mendimeve të ndryshme brenda së majtës komuniste nuk u mbyll gjatë viteve të luftës. Komunistë jostalinistë, si Sejfulla Malëshova, Isuf Keçi, Skënder Luarasi, Petro Marko e shumë të tjerë, me kalimin e kohës, vuajtën në mënyra të ndryshme faktin se nuk arritën t'i përshtateshin vijës politike të PKSH/PPSH-së. E majta socialdemokrate ishte ajo që u godit më shumë dhe në vazhdimësi gjatë regjimit komunist. Pjesa më e madhe e socialdemokratëve shqiptarë: Gjergj Kokoshi, Selaudin Toto, Shefqet Beja, Salim Kokalari, Skënder Muço, etj., iu bashkuan lëvizjes së rezistencës antifashiste. Të tjerë, si Musine Kokalari e Arshi Pipa, zhvilluan një aktivitet interesant në ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për luftën kundër fashizmit. Pas përfundimit të luftës, as angazhimi në rezistencën kundër pushtuesve, as profili i tyre i spikatur intelektual nuk i shpëtoi nga persekutimi komunist. “Faji i tyre” ishte se donin Shqipëri të përparuar, demokraci liberale. Ata kundërshtuan vendosjen e një regjimi diktatorial në Shqipëri dhe këtë e paguan me jetë, ose me persekutim të gjatë në burgje e kampe internimi. Gjyqet e zhvilluara kundër organizatës së Bashkimit Demokratik, të ashtuquajturit “Grupi i Deputetëve”, etj., janë vetëm disa shembuj që tregojnë për persekutimin e së majtës socialdemokrate dhe jostaliniste gjatë viteve të “diktaturës së proletariatit”.

Natyrish, edhe në këtë periudhë, e majta shqiptare nuk filloi e mbaroi me Enver Hoxhën dhe regjimin e tij komunist të instaluar fill pas çlirimit, që zgjati deri në fund të 1990-s. Në përpjekje për të dhënë një kontribut në debatin mbi mendimin politik të së majtës në Shqipëri, në këtë vëllim janë përzgjedhur 10 profile personazhesh që iu përkasin rrymave të ndryshme të mendimit politik të së majtës. Përzgjedhja e personazheve është bërë në përputhje me kriteret e mëposhtme: Personazhet duhet të kenë shfaqur hapur identitetin e tyre politik të majtë. Ata duhet të kenë mbajtur qëndrimi publike pro së majtës dhe/ose të kenë qenë pjesë e grupimeve politike të majta; në mënyrë që të kuptohen evolucioni apo/dhe metamorfoza e mendimit politik të së majtës, personazhet e përzgjedhur e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre politik në tri periudha historike: në periudhën midis dy luftërave, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë viteve të “diktaturës së proletariatit”; përzgjedhja e profileve ka mbajtur parasysh të gjitha rrymat e mendimit politik të së majtës, si atë komuniste, marksiste apo leniniste, ashtu edhe anarkistët, socialdemokratët, etj.

Në këtë vëllim janë përjashtuar përfaqësuesit e së majtës komuniste, e cila ndihmoi në instalimin e diktaturës së proletariatit dhe është përgjegjëse për represionin ndaj shqiptarëve (edhe në rastin kur ata vetë janë dënuar nga i njëjti regjim që kontribuan të instalohesh). Duke qenë se brenda kësaj të majte u zhvillua një tipologji e veçantë: titistët, stalinistët, hrushovianët, etj., ajo do të analizohet me kujdes në një projekt të mëvonshëm.

Kjo lloj tipologjie do të ndihmojë plotësimin e një narrative historike, e cila do të synojë:

1. Skicimin e historikut të mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në korrelacion me mendimin politik botëror të së majtës.
2. Dhënien e një panorame, në mënyrë të kuptohen më mirë rrymat e mendimit politik të së majtës, që qarkulluan në Shqipëri përgjatë shekullit XX.
3. Përcaktimin e rrymave ideologjike të së majtës që fituan më shumë popullaritet në Shqipërinë e viteve '20-'30.
4. Evidentimin e sfidave me të cilat përballej mendimi politik i së majtës në periudhën midis dy luftërave dhe vështirësitë e saj për t'u organizuar në formacione politike.
5. Analizimin e arsyeve dhe rrethanave historike/politike dhe ekonomike që lejuan konsolidimin e së majtës komuniste leniniste në Shqipëri.
6. T'i japë mundësi brezit të ri të shqiptarëve të mësojë më shumë për fatin e individëve që kishin një identitet të qartë politik të majtë, por nuk pranonin qasjen e propozuar nga krerët e “diktaturës së proletariatit në Shqipëri”.
7. Të evidentojë faktin se e majta e sotme në Shqipëri ka si pjesë të trashëgimisë së saj historike, jo vetëm luftën antifashiste, por edhe idetë e mendimit të Selaudin Totos, Musine Kokalarit, Gjergj Kokoshit e shumë të majtëve të tjerë, të cilët u përpoqën të themelonin një të majtë europiane.

---

## Marksizmi si doktrinë filozofike dhe rrymë politike e së majtës

---

Që nga fillimi i saj, lëvizja e klasës punëtore socialiste (dhe më vonë komuniste) kishte, të paktën në teori, aspirata globale që shpreheshin me sloganin “Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!”, e cila ishte deviza kryesore e Manifestit Komunist. Ky ndërkombëtarizëm u vu në praktikë fillimisht nga Internacionalja e Parë, e njohur zyrtarisht si Shoqata Ndërkombëtare e Punonjësve, nën udhëheqjen e Karl Marksit (1864–’76); mandej nga Internacionalja e Dytë ose Socialiste (1889–1914);<sup>3</sup> dhe më pas ajo e Tretë, Internacionalja Komuniste (Kominterni), e formuar më 1919, e cila u shpërbë zyrtarisht më 1943. Nga këto, Kominterni ishte më i fokusuari në aspektin ndërkombëtar të përhapjes së doktrinës komuniste.<sup>4</sup>

Periudha mes dy Luftërave Botërore, që pasoi materializimin e Republikave Socialiste të Bashkimit Sovjetik dhe sukcesi politik i regjimit bolshevik, ishte më intensivja në përhapjen e ideve të së majtës marksiste. Disa autorë së fundmi, i kanë kritikuar pikëpamjet sempliste që theksonin se drejtuesit e Kominternit shpresonin të krijonin një organizatë hierarkike, në të cilën urdhrat e Moskës do të viheshin me shpejtësi në praktikë nga vendet që kishin ngritur struktura të partive komuniste. Këta autorë theksojnë shkallë të lartë të autonomisë që kishin këto parti dhe celula gjatë dy luftërave botërore.<sup>5</sup> Pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme për këtë periudhë, duhet pasur parasysh se disa faktorë kishin impakt paralel. Së pari, pas instalimit të socializmit shtetëror në Bashkimin Sovjetik, përhapja e tij në sa më shumë vende u konceptua edhe si mekanizëm gjeopolitik për t’i pasur këto shtete nën influencën e Moskës. Së dyti, divergjencat e forta brenda Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik pas vdekjes së Leninit, ardhja në pushtet e Stalinit dhe azili i detyruar e më pas, dëbimi i Troçkit. Më pas, eliminimi i udhëheqësve të tjerë të Politbyrosë Sovjetike përcaktoi edhe vijën ideologjike të kësaj partie, që do të ishte në duart e bolshevikëve, nën Stalinin. Së treti, impakti i drejtpërdrejtë që kishte Moska përmes Kominternit apo universiteteve dhe qendrave të trajnimit marksist-leninist në Bashkimin Sovjetik, mbi kuadrin e ri në vende të ndryshme europiane.

Në rastin e Shqipërisë, fillimisht impakti i kësaj rryme të së majtës ka qenë i drejtpërdrejtë, kryesisht përmes grupit të shqiptarëve që studionin në Bashkimin Sovjetik, të tillë si: Tajar Zavalani, Sejfulla Malëshova, Selim Shpuza, Halim Xhelo, etj. Në periudhën midis dy luftërave, këta dhe të tjerë, si në emigracionin politik shqiptar, ashtu edhe brenda Shqipërisë politike, zhvilluan një aktivitet të gjerë propagandistik e politik për përhapjen e ideologjisë të së majtës marksiste-leniniste. Mandej, veçanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore e në vitet që pasuan, ndikimi ishte indirekt, pasi ishte Partia Komuniste e Jugosllavisë, e drejtuar nga Josip Broz Titoja, që ndihmoi në krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, në drejtimin dhe organizimin e hershëm të saj.

---

3. Për Internacionalen e Parë dhe të Dytë, shih: Henryk Katz. 1992. *The emancipation of labor: a history of the First International*, New York: Greenwood Press; James Joll. 1974. *The Second International, 1889–1914*. London: Routledge

4. Shih: Kevin McDermott and Jeremy Agnew. 1997. *The Comintern: a history of international communism from Lenin to Stalin*. New York: St Martin’s Press.

5. Joachim K Haberlen. 2012. “Between global aspirations and local realities: the global dimensions of interwar communism” *Journal of Global History*, Vol. 7, Issue 03, November, f. 422.

---

## Trockizmi si rrymë alternative ndaj stalinizmit

---

Çfarë ishte trockizmi në emër të të cilit u persekutuan jo vetëm kundërshtarët e J.V. Stalinit në BRSS, por edhe të E. Hoxhës në Shqipëri? Leon Trocki, një komunist rus me origjinë hebraike, qysh herët i kishte parë me lente kritike tezat e V. I. Leninit për «centralizmin demokratik» dhe «diktaturën e proletariatit». Ai kishte parashikuar që nëse Lenini dhe mbështetësit e tij do të ishin të suksesshëm, këto teza do të çonin përfundimisht në diktaturën e partisë mbi proletariatin, të Komitetit Qendror të partisë mbi vetë partinë, dhe përfundimisht, të një njeriu mbi Komitetin Qendror. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi me Stalinin<sup>6</sup>. Në vijimësi me Trockin, por duke e zgjeruar aparatën e kritikës ndaj luftës së klasave dhe diktaturës së proletariatit si dy koncepte qendrore të marksizëm-leninizmit, ishin edhe komunistët të tillë, si hungarezi Georg Lukács, serbi Milovan Djilas dhe të tjerë, të cilët, qysh në krye të herës vunë re se kishte kundërvënien logjike të forta në tezat leniniste.

Duke krahasuar teorinë me zhvillimet empirike, ata panë, ndër të tjera, se lufta e klasave nuk çoi në një shoqëri pa klasa, sikundër predikonte në krye të herës Marksi apo Engelsi, por në fakt u krijua një “klasë” e re, ajo e partisë-shtet, funksionarët e së cilës gëzonin privilegjet e vetme në shoqëri. Por në ndryshim nga Trocki, i cili nuk arriti të shihnte “mundësinë e një klase të re udhëheqëse”<sup>7</sup>, Djilas-i, qysh herët në librin e tij “*Klasa e Re: një analizë e sistemit komunist*”<sup>8</sup>, vuri re se kjo klasë e re ishte shumë më pak meritokratike se sa borgjezia që evoluoi natyrshëm si derivat i Revolucionit Industrial, falë aftësisë, talentit, shpikjeve apo përpjekjeve sipërmarrëse dhe intelektuale. Pra, ndryshe nga borgjezia, të cilën klasa e re e komunistëve e kritikonte edhe në format e saj “të buta”, si mikroborgjezia apo fshatarësia me mjete prodhimi, (të ashtuquajturit kulakë), klasa e re e komunistëve që kishte konsoliduar pushtetin pas Revolucionit Bolshevik të Tetorit, kishte arritur dominimin shoqëror, në kuptimin edhe të pushtetit politik e ekonomik, falë arrvizimit dhe jo aftësive. Këto ide të Djilas-it dhe të tjerëve, reformatorë të së majtës komuniste, natyrisht binin ndesh me dogmën e stalinizmit që argumentonte se revolucioni bolshevik dhe reformat sociale të mëpasme të regjimeve komuniste do të çonin vetvetiu në zhdukjen e çdo klase qeverisëse si të tillë.<sup>9</sup>

Sikundër na kujton filozofi politik Leszek Kolakowski, zor se ka ndonjë aspekt të marksizmit që nuk e ndan (më dysh) mendimin e studiuesve dhe kritikëve.<sup>10</sup> Kështu ka qenë qysh në krye të herës, pasi vetë Marksi nuk ishte thjesht sociolog, ekonomist apo filozof, por edhe veprimtar politik i dorës së parë, duke bërë që shpesh idetë e tij të frymëzonin polemika që vijnë sot e gjithë ditën. Marksi që gjithashtu frymëzues i Revolucionit Bolshevik që erdhi nën petkun e marksizëm-leninizmit, pra me modifikimet përkatëse që i bëri Lenini, që ishte edhe vetë, sa ideolog, aq edhe udhëheqës politik i doktrinë së Marksit, për ta përshtatur me një vend (Rusinë cariste) që nuk kishte as borgjezi, as klasë punëtore të mirëfilltë dhe që dominohej kryesisht nga fshatarësia e varfër dhe pa tokë.<sup>11</sup>

---

6. Robert. J. Alexander. 1992. *International Trotskyism: 1929-1985: A Documented Analysis of the Movement*. Duke University Press. f. 11.

7. Robert. J. Alexander. 1992. *International Trotskyism: 1929-1985: A Documented Analysis of the Movement*. Duke University Press. f. 11.

8. Milovan Đilas (1983) [1957]. *The New Class: An Analysis of the Communist System* (paperback ed.). San Diego: Harcourt Brace Jovanovich.

9. Erik van Ree. 2002. *The Political Thought of Joseph Stalin: A Study in Twentieth Century Revolutionary Patriotism* (hardcover) (1st ed.). Routledge. F. 138.

10. Leszek Kolakowski. 1978. *Main Currents of Marxism: Its Rise, Growth and Dissolution*. Vol. 1. Oxford: Clarendon Press.

11. Marksi vetë e nënçmonte këtë kategori të cilën e quante lumpenproletariat, pra pa ndërgjegje klasore dhe kësisoj e paaftë për t'i prirë ndonjë revolucioni. Gjë që solli nga Lenini konceptin e partisë-avantgardë, në rolin formues dhe udhëheqës së masave.

---

## Socialdemokracia si alternativë ndaj së majtës marksiste

---

E majta moderne, veçanërisht në vendet e Europës Perëndimore, evoluoi natyrshëm drejt një sistemi që pranonte premizat fillestare të kapitalizmit dhe liberaldemokracisë. Pra, krejt e ndryshme nga tradita bolshevike, që çoi në ekstremet e saj, si Bashkimi Sovjetik nën Stalinin, edhe Shqipërinë e Enver Hoxhës, drejt një forme totalitare regjimi politik. Socialdemokracia perëndimore bazohet në konceptet e drejtësisë sociale, ekonomisë sociale të tregut, politikave shtetërore rregullatore, rishpërndarjes dhe subvencioneve përmes politikave nxitëse fiskale, etj., duke korrigjuar kështu disa nga eksceset e kapitalizmit “*laissez-faire*” që është karakteristikë kryesore e vendeve si SHBA dhe Britania e Madhe.

Parimet bazë të socialdemokracisë bazohen në drejtësinë sociale dhe konceptet e rishpërndarjes së pasurisë përmes taksimit progresiv. Historikisht, nëse i referohemi për shembull një prej partive më të vjetra socialdemokrate në botë, asaj daneze, të themeluar qysh në 1876, koncepti bazë që theksohet është ai i “socializmit demokratik”, besimit në “demokraci” dhe “barazi shoqërore”,<sup>12</sup> koncepte që sot i gjen edhe te lidhshipi aktual i laburistëve anglezë ose demokrati i njohur Bernie Sanders në SHBA.

Koncepti i drejtësisë shoqërore në shekullin XX është elaboruar veçanërisht nga John Rawls, përmes një eksperimenti të famshëm të tij dhe bazohet në dy premisa kryesore: «Çdo person duhet të ketë të drejta të barabarta të pajtueshme me një skemë të ngjashme lirish për të gjithë.» Si dhe «pabarazitë sociale dhe ekonomike duhet të rregullohen në mënyrë që të dyja t’i shërbejnë“ a) avantazhit më të madh për më pak të privilegjuarit; b) të gjitha zyrat dhe privilegjet të jenë të hapura për garim nga të gjithë, sipas parimit të shanseve të barabarta”.<sup>13</sup>

Po ashtu, solidariteti është koncept mjaft i rëndësishëm për të majtën socialdemokrate. Ndonëse më pak i rëndësishëm se drejtësia dhe liria, qoftë në pikëpamje të filozofisë politike, qoftë në atë të ideologjisë së aplikuar, solidariteti është koncept që gjen shprehje jo vetëm retorike, por edhe empirike në politika të tilla publike, si për shembull skemat e sigurimeve shoqërore, etj.<sup>14</sup> Këto parime, sa historike, aq edhe aktuale, kanë gjetur reflektim të plotë edhe në artikullimin socialdemokrat shqiptar nga fillesat modeste të tij dhe në vazhdim, në vitet ‘30 e mandej me krijimin jetëshkurtër të Partisë Socialdemokrate të Musine Kokalarit, Isuf Luzajt e të tjerëve. Por edhe në konceptin socialdemokratik të periudhës paskomuniste.

---

12. Social Democratic Principles. SOCIALDEMOKRATIET. Marrë nga: <https://www.socialdemokratiet.dk/da/partiet/in-english-the-social-democratic-party/social-democratic-principles/>

13. John Rawls. 1979. *A Theory of Justice*, revised edition, Harvard University Press. ff. 81 & 336.

14. Shih për më gjerë: Thomas Kastning. 2013. *Freedom, Solidarity, Justice: Basics on Social-Democracy*. Friedrich Ebert Stiftung.

---

## E majta historike në Shqipëri: Rrymat politike të mendimit

---

E majta në Shqipëri, ashtu sikundër zhvillimet paralele në botë përgjatë shekullit XX, ka qenë pluraliste dhe jo monolite. Karakteristika që ngjashëm i bashkëndan edhe e djathta shqiptare. Nëse flasim për këtë të fundit si e djathtë konservatore dhe e djathtë liberale, apo në kontekstin historik, e djathtë monarkiste/legaliste apo e djathtë republikane, ashtu edhe për të majtën gjen variacione të njëjta, që ngjallin njëkohësisht interes studimor, por edhe polemikë. Në rastin e Shqipërisë, qysh herët u shquan të paktën pesë kategori të së majtës:

E majta romantike: individë me qasje ideologjike të majtë që ushtruan veprimtarinë e tyre deri në fillim të Luftës së Parë Botërore. Siç i quan Kristo Frashëri: “ata nuk e njihnin thelbin as të doktrinës komuniste, madje as të platformës socialdemokrate, por vetëm anën humane, të cilën e propagandonin militantët socialistë europianë”.<sup>15</sup> Po të kërkonim zanafillën e tyre do të shkonim pas në kohë deri te Sami Frashëri<sup>16</sup>, i cili, në prizmin e vëzhgimit të sotëm mundet lehtësisht të përfshihet te të majtët socialdemokratë ose të socializmi jomarksist. Në këtë grup mund të guxojmë të fusim edhe Stavro Vinjaun, i cili ishte, ndër të tjera, edhe anëtar i Partisë Socialiste Itالية; Dhimitër Fallon që, sipas Kristo Frashërit, i cili iu referohet kujtimeve të Sotir Vullkanit, ishte themeluesi i së parës celulë komuniste në Korçë në prill të 1928-s<sup>17</sup>; dhe ndoshta arqeo-marksistët, apo ata të lidhur ngushtësisht me Partinë Komuniste të Greqisë, që kërkonin një rikthim te tezat origjinale të Marksit.

E majta utopike (komuniste) e cila në literaturën teorike identifikohet fillimisht me autorë si Saint Simon apo Robert Owen, që inspiroi Marksit dhe Engelsin ndër të tjerë, shpesh përshkruhet si njëfarë vizioni për një shoqëri ideale imagjinare ose futuriste, dhe veçon solidaritetin shoqëror apo të mirën e përbashkët si arsyt kryesore për ta lëvizur shoqërinë në një drejtim të tillë. Në Shqipëri, gjithnjë në funksion të ndërtimit të tipologjive ndihmuese, mund të themi se kjo lloj e majte kishte përfaqësues tipikë Qemal Stafën, Sejfulla Malëshovën, Zef Malën, Halim Xhelon, Ali Kelmendin e të tjerë. Veprimtarë kryesorë të kësaj kategorie të së majtës u shquan veçanërisht gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ose edhe më parë, dhe pjesa më e madhe e tyre nuk jetoi të shihte të instaluar diktaturën e proletariatit, të drejtuar nga Partia Komuniste. Kjo nuk e përjashton fanatizmin e tyre ideologjik me indoktrinim të fortë marksist-leninist dhe ndonjëherë sektar të vijës së ashpër, sikundër rastet e H. Xhelos apo A. Kelmendit, por ndarja e papritur nga jeta, përpara se idetë e tyre të materializoheshin në regjimin e ri, mungesa e përgjegjësive konkrete shtetërore, si dhe indoktrinimi i ngurtë, por edhe idealist, i mbrujtur nga lentet utopike me të cilat parashihnin të ardhmen pas çlirimit, mendojmë se i fut në këtë kategori. E majta trockiste, e cila u frymëzua kryesisht nga kundërvënja ideologjike dhe veprimtaria politike e L. Trockit, por që është vështirë të përcaktohet si grupim me kufij të qartë, pasi si në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në Shqipëri, “trockizmi” u përdor shpesh si mjet goditjeje ndaj kundërshtarëve politikë, të cilët, shpeshherë ose nuk i njihnin fare idetë dhe kundërvëniet e Trockit, ose nuk pranonin të vetidentifikoheshin si të tillë. Gjithsesi, pavarësisht kësaj, në rastin e Shqipërisë, mund të thuhet se një nga veprimtarët më të shquar të së majtës historike në periudhën mes dy luftërave dhe shpesh i etiketuar si trockist ishte L Lazar (Zai) Fundo, i cili ishte, ndër të tjera, edhe anëtar i hershëm i Kominternit dhe Federatës Komuniste Ballkanike.

---

15. Kristo Frashëri. 2006. *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së (1878-1941)*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, f.17.

16. K. Frashëri, *Historia ...*, f. 11.

17. K. Frashëri, *Historia ...*, f. 65-66.



E majta socialiste, ku shquajnë Gjergj Kokoshi, i pari Ministër i Arsimit (korrik 1944–janar 1945) dhe Suad Asllani, të dy të dënuar nga gjyqi politik më 1946. Veçori e kësaj kategorie ishin idetë socialiste, që ruanin një distancë të shëndoshë ideologjike nga leninizmi, si mbivendosje e marksizmit tradicional. Ata ishin, ndër të tjera, kundërshtarë veçanërisht të ashpër të vijës staliniste, tipare të së cilës po instaloheshin me shpejtësi në Shqipërinë e pas-Luftës së Dytë Botërore. Duke konstatuar qysh herët dhe mandej, duke u ballafaquar me instalimin me shpejtësi të regjimit të ri totalitar, duke mbrojtur tezat e një të majte socialiste, këta ishin ndër aktivistët që mund të futen në këtë lloj kategorie të së majtës historike. Nga ana tjetër, mungojnë burimet dokumentare për të argumentuar në mënyrë bindëse nëse edhe anëtarët kryesorë të Grupit të Deputetëve, si për shembull Shefqet Beja, mund të klasifikohen në këtë grup, apo jo. Ky i fundit, pavarësisht se u zgjodh deputet i Frontit Demokratik, qysh herët iu kundërvu reformave ekonomike dhe politike të E. Hoxhës, dhe për këtë arsye u gjykua e u dënua me varje nga regjimi.<sup>18</sup> Pra, mund të themi se nuk ka ndonjë të dhënë të besueshme që në tërësi, Grupi i Deputetëve të ketë pasur ndonjë linjë të vetën të spikatur ideologjike brenda së majtës.<sup>19</sup> Më tepër kanë qenë nacionalistë dhe demokratë që iu kundërvunë asaj që ata e shihnin si mbytyje në embrion të çdo lloj tentative për demokratizim të jetës së vendit dhe dorëzim i sovranitetit (për shembull te jugosllavët), ende pa u çliruar mirë nga nazi-fashistët.

E majta socialdemokrate, ku përfshihen Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Muço, etj.. Ky grupim ishte një hap më tej në rezistencën ndaj komunizmit, jo vetëm në mënyrën staliniste se si po implementohej në Shqipërinë e pasluftës, por edhe si ideologji marksiste-leniniste. Me ideologë të spikatur, të mirëshkolluar në Perëndim, ky grupim ndante idetë bazë të së majtës progresive, të tilla si drejtësia sociale, rishpërndarja e të ardhurave, luftimi i pabarazive shoqërore, por edhe liberalizmi politik, ku shquhet nevoja për sistemin pluralist politik, një ekonomi të bazuar në pronësi private, etj.

E majta nacionaliste, ku mund të veçojmë Tajar Zavalanin, Kostë Çekrezin, Fan Nolin, Skënder Luarasin, etj. Karakteristikë e këtij grupimi, pavarësisht nuancave të tyre apo shpesh edhe kundërvënieve personale, ishte veprimtaria politike në Shqipërinë mes dy luftërave botërore, por kryesisht ajo në mërgim, në periudhën e mëpasme. Këta veprimtarë të shquar të diasporës shqiptare bashkonin idetë e një programi ekonomik të majtë me idetë kombëtariste të një Shqipërie të bashkuar me Kosovën dhe viset e tjera amtare. Disa nga veprat e tyre të shkruara kanë qenë gur themeli i kësaj veprimtarie, që bashkonte idetë e majta me ato kombëtariste për prosperitet të kombit, qartazi parë në këndvështrimin patriotik dhe progresiv. Duhet theksuar që kjo është tipologji e përgjithshme për efekte studimore, pasi ka pasur shumë individë që lehtësisht mund të klasifikohen në më shumë se një grup, fjala vjen, veprimtarë të Ballit Kombëtar, si: Hysni Lepenica, Skënder Muço, Isuf Luzaj e shumë të tjerë.<sup>20</sup> Gjithsesi, secila prej këtyre kategorive, të cilat shpesh dhe iu mbivendosën njëra-tjetrës në periudha të caktuara historike, si ajo e Luftës Antifashiste, ka tiparet e veta dhe ngjyrimet ideologjike përkatëse, ndonëse në shumicën e rasteve nuk kemi të bëjmë me mendim të elaboruar dhe sofistikuar politik. Gjithashtu, jo në çdo rast kemi konkretizim të përpjekjeve për krijim formacionesh të mirëfillta politike apo parti të strukturuar, siç ndodhi më 1941 me Partinë Komuniste apo me përpjekjet për të krijuar për herë të parë Partinë Socialdemokrate (1943).

18. Romeo Gurakuqi. 2018. *Shqipëria dhe tokat e lirume (1939-1946)*. Durrës: Jozef. ff. 1193–1195.

19. Shefqet Beja ishte ndër të paktët që deklaronte hapur se ishte kundër instalimit të regjimit monokratik në Shqipëri dhe shprehte preferencën për modelin e demokracive perëndimore bashkë me Riza Danin dhe katërmëdhjetë deputetët e tjerë që u dënuan me vdekje dhe tetë të tjerëve që u dënuan me burgime të zgjatura. Shih: Shefqet Beja: Jam Armik i pushtetit të sotëm në Shqipëri. Marrë nga: <https://www.radiandradi.com/jam-armik-i-pushtetit-te-sotem-ne-shqiperi-shefqet-beja/> 11 Tetor 2019.

20. Balli Kombëtar në programin e tij kishte qartësisht program të majtë ekonomik jo-komunist. Në parametra analitike mund të thuhet se ishte shumë i ngjashëm me një program social-demokrat. Per shembull pika 4 e këtij programi lexon: “Ne po luftojmë për një Shqipëri me një balancë të sigurtë ekonomike dhe sociale në mënyrë që mos të ketë më shfrytëzues dhe të shfrytëzuar... nuk do të ketë bujq pa tokë të mjaftueshme dhe nuk do të ketë më punëtorë me jakë të bardhë apo blu pa shtëpi e siguri...” Ose pika 6 ku thuhet shprehimisht se: “Ne po luftojmë për një Shqipëri, në të cilën të gjitha kontributet do të vlerësohen në mënyrë të drejtë, pavarësisht moshës, fesë apo besimit”. Marrë nga *Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar*, 1942. Programi me dhjetë pika i Organizatës Kombëtare “Balli Kombëtar”.

---

## Organizimet politike të së majtës në Shqipërinë e para dhe përgjatë Luftës së Dytë Botërore

---

Në periudhën mes dy luftërave botërore, krahas zhvillimeve të ndryshme politike që reflektonin, si situatën socio-ekonomike të brendshme, ashtu edhe presionet e jashtme, kemi me fillimin e aktivitetit të celulave komuniste, të cilat nisën të jepnin shkëndijat e para, jo vetëm të reflektimit të revolucionit bolshevik në Bashkimin Sovjetik, por edhe rrymat e para ideologjiko-politike, si trockizmi, që u quajtën nga Stalini, qysh pas vdekjes së Leninit, si deviacione të marksizëm-leninizmit. Duke marrë parasysh se thuajse gjithë aktiviteti fillestar i celulave që operonin në Shqipëri në vitet '30 ishte nxitur direkt apo indirekt nga diaspora që kishte përqafuar këto ide, pavarësisht primitivitetit të celulave që ishin përqendruar kryesisht në Korçë, Elbasan, Tiranë e Shkodër, mund t'i konsiderojmë si farat e para të kultivimit apo ngjizjes së një lëvizjeje komuniste shqiptare. Natyrisht, siç e theksuam, fillesat qenë në emigracion, ku vlen të veçohet KONARE-ja në Vjenë, me rolin e spikatur të Fan Nolit, Lame Borshit, Konstandin Boshnjakut e të tjerëve, Shoqëria "Bashkimi" me aktivitet brenda dhe jashtë vendit dhe pararendëse e lëvizjes komuniste, të rinjtë shqiptarë që studionin në Bashkimin Sovjetik, si Zai Fundo, Tajar Zavalani, Halim Xhelo e të tjerë. Si dhe roli i spikatur në agjitacion e propagandë, por edhe në formësimin e celulave të para komuniste në Korçë nga Ali Kelmendi, Koço Tashko, Miha Lako, etj., të cilët ishin në mënyrë konsekuente më afër vijës së Kominternit, edhe pas spastrimit stalinist të Buharinit dhe linjës së tij në krye të Kominternit. Është interesante të përmendim disa të dhëna që na dalin nga këqyrja e Buletinit të Organizatës Komuniste të Shqipërisë në 1938-n, ku ndër të tjera lexojmë se lëvizja komuniste në Shqipëri ka kohë që lëvront, por nuk ka dalë nga nevojat e brendshme, se kushtet socio-ekonomike nuk e favorizojnë aspak, por nga ata proletarë dhe intelektualë që kanë jetuar dhe punuar në vendet e përparuar. Tekstualisht, në këtë buletin që reflekton pikëpamjet e grupit të Shkodrës, shkruhet se: "Tue mos pasë klasa të diferencueme, tue mos pasë proletariat dhe borgjezi në kuptimin e fjalës, ne sot nuk kemi luftë klase të vërtetë dhe prandaj nuk jemi në kondita të marrim në dorë flamurin e revolucionit".<sup>21</sup>

Një ndër grupet më aktive ishte Grupi i të Rinjve, i krijuar më 1941 dhe që kryesohej nga Anastas Lula dhe Sadik Premtja. Ky grup, ndër të tjera, shprehej se në Shqipëri nuk kishte proletariat dhe për këtë arsye, në këto kushte ishte e pamundur ngjizja e Partisë Komuniste<sup>22</sup>. Sipas Grupit Komunist të të Rinjve nga Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar, 1942, komunizmi ishte doktrinë e ardhur nga jashtë në vendin tonë, që nuk reflektonte gjendjen socio-ekonomike të shoqërisë. Kryesisht, ata që bënin pjesë në këtë grup ishin studentë dhe tek-tuk, ndonjë intelektual. Shqipëria, duke qenë se nuk kishte industri dhe bazohej kryesisht te fshatarësia me ose pa tokë, nuk mund të kishte as punëtori dhe, për rrjedhojë, as proletariat me ndërgjegje klasore, çka do të ishte parakusht për një revolucion marksist. Platforma e këtij grupi mbështetej kryesisht në përkthimin e librave dhe në idenë e ngritjes të sa më tepër grupeve të studimit, si mënyrë për të depërtuar te masat. Pas krijimit të PKS-sh-së, Grupi Komunist i të Rinjve u pa që në fillim me dyshim nga emisarët jugosllavë pranë PKS-sh-së si grup me prirje trockiste dhe u vu qysh në krye të herës në shënjestër të spastrimeve staliniste brenda saj<sup>23</sup>. Më

---

21. Për një Parti Komuniste. Fondi: *Bulletin i Organizatës Komuniste të Shqipërisë, (Buletin Jeshil)*. Nr. 1. Dhjetor 1938, f.1-4.

22. Kastriot Dervishi. 2016. *Lëvizja Komuniste në Vitet 1924-1944 dhe Formimi i PKS-sh-së*. Tiranë: Shtëpia Botuese 55. F. 187.

23. Pas krijimit të PKS-sh theksi iu vu organizimit, centralizimit dhe forcimit ideologjik të partisë së sapokrijuar. Në dy mbledhjet e rëndësishme të PKS-sh, siç ishte ajo e prillit dhe e qershorit 1942, thelbi i diskutimeve ishte konsolidimi i brendshëm i PKS-sh, lufta kundër grupeve komuniste, të cilat nuk u bashkuan me të, siç ishte p.sh. grupi komunist i Zjarrit dhe lufta kundër tendencave grupiste brenda PKS-sh, duke vënë theksin te tendencat fraksioniste të grupit komunist të të Rinjve dhe veçanërisht për drejtuesit e saj, Anastas Lulo dhe Sadik Premtja. Si gjatë LIIB, ashtu edhe pas saj, të gjithë anëtarët e këtij grupi shiheshin me dyshim nga drejtuesit e lartë të PKS-sh-së, të cilat arritën të eliminonin fizikisht drejtuesin e grupin Anastas Lulo. Drejtuesi tjetër i grupit, Sadik Premtja falë mbështetjes që kishte në krahinën e Vlorës, arriti t'i shpëtonte ekzekutimit, por pas LIIB u detyrua të emigronte jashtë vendit dhe të kalonte gjithë jetën e tij në emigracion në Francë.

vonë, në kujtimet e tij, një nga eksponentët më të spikatur të këtij grupi, Sadik Premtja, shkruante ndër të tjera se Grupi i Korçës nuk kishte as bazat më elementare të marksizmit, duke përdorur edhe sarkazëm të ashpër ndaj disa prej eksponentëve të tij, si Enver Hoxhës apo Koço Tashkos.<sup>24</sup>

---

## E majta jostaliniste në kushtet e një regjimi totalitar

---

Është e vështirë të flasësh për mendimin politik të së majtës në kushtet e një regjimi totalitar stalinist, i cili, në kuadër të procesit të unifikimit ideologjik, luftoi pa mëshirë çdo individ apo grupim që guxonte të shfaqte tendenca të së majtës jostaliniste. Persekutimi i së majtës jostaliniste, i filluar që gjatë rezistencës antifashiste (dënimi i Anastas Lulës, Sadik Premtes, vrasja misterioze e Mustafa Gjinishit, pushkatimi i Lllazar Fundos e shumë të tjerëve), vijoi me ashpërsi pas çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit e huaj. Nën maskën e dënimit të kolaboracionizmit u dënuan nga Gjyqi Special disa nga individët që ishin investuar në mendimin politik të së majtës shqiptare, siç ishte p.sh. Kolë Tromara. Prokurori i çështjes ishte Bedri Spahiu, një ushtarak pa formim juristi, i cili kaloi vetë rreth 30 vjet në burgjet e regjimit. Ai ishte ndër të paktit që pati kurajën të bënte një “mea culpa” pas rënies së totalitarizmit komunist në Shqipëri. Kryetari i trupit gjykues ishte Koçi Xoxe, një punëtor i cili, pasi shërbeu për 5 vjet si ministër i Brendshëm, u pushkatua më 1949 si agjent i jugosllavëve.

Kronologjikisht, grupi i dytë i së majtës jostaliniste, i dënuar pas vendosjes së regjimit komunist është ai socialdemokrat, pjesë e Bashkimit Demokratik Shqiptar, së bashku me monarkistët dhe grupin e rezistencës. Midis datave 10–23 janar 1946, organet e Mbrojtjes së Popullit, paraardhësit të Sigurimit të Shtetit, arrestuan 37 vetë të Bashkimit Demokratik Shqiptar, duke përfshirë edhe socialdemokratët, Musine Kokalarin, Suad Asllanin, Gjergj Kokoshin, etj. Bashkimi Demokratik Shqiptar ishte një organizatë që kërkonte të krijonte opozitë legale kundër PKS-së dhe Frontit Demokratik, duke u përpjekur të ndalonin zgjedhjet monopartiake për Asamblenë Kushtetuese, që ishin planifikuar të mbaheshin më 2 dhjetor 1945 e të përfshinin në procesin zgjedhor edhe kandidatë jashtë Frontit Demokratik. Në një memorandum që iu paraqit edhe misionëve të SHBA-së dhe Britanisë së Madhe, pasqyrohej qartë ndikimi i filozofisë të së majtës socialdemokrate. Pasi kritikoheshin politikatat totalitare të ndjekura nga Qeveria e Përkohshme e Enver Hoxhës gjatë një viti e gjysmë që kishte marrë pushtetin<sup>25</sup>, memorandum i shprehej qartë se anëtarët e organizatës nuk ishin “armiqtë e komunizmit. Edhe sikur të mos ekzistonte komunizmi, – shpreheshin ata në memorandum, – do të qe e dobishme ta krijonim si një fuqi shtytëse drejt përparimit social. Por, nga ana tjetër, ne jemi kundërshtarët e tij politikë, deri sa ai shkel liritë politike dhe ngre një qeveri despotike në vend të asaj demokratike”<sup>26</sup>. Gjithashtu, në programin e BDSH theksohet qartë se organizata mbronte liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, ashtu siç kërkonte promovimin e të drejtave politike e sociale. Politika sociale e programit tregon qartazi prijet drejt së majtës. Sipas programit, organizata ishte për “Përmirësimin material dhe moral të kushteve të jetës së klasës punëtore. Pjesëmarrjen e plotë e punëtorëve dhe fshatarëve në jetën politike. Lëniën e lirë e organizatave të punëtorëve dhe pjesëmarrjen e tyre në vendosjen e kushteve të punës.

---

24. Sadik Premtja: Përgatitjet për themelimin e PKS-së. *Kujtime*, 25 janar 1950. Ruhen në dorëshkrim nga bija e tij në Vlorë. Marrë nga: Kristo Frashëri. 2006. *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKS-së (1878-1941)*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë. F. 415.

25. Enriketa Pandlejmoni, “Gjergj Kokoshi dhe kontributi i tij politik në një atmosferë atipike politike në Shqipërinë e pasluftës”. Marre nga: <https://dosjet.gov.al/gjergj-kokoshi/>

26. Po aty.

Demokratizimin e institucioneve. Rivendosjen e identitetit familjar”. Në politikën ekonomike, ndërsa mbronte të drejtën e pronës private dhe sipërmarrjes së lirë, organizata nxiste kontrollin e shtetit mbi industrinë vitale, ndërmarrjen e një reforme agrare, kujdesin e shtetit për strehimin e fshatarësisë dhe krijimin e kooperativave bujqësore<sup>27</sup>.

Ndonëse një pjesë e anëtarëve të Bashkimit Demokratik kishin qenë pjesë e Frontit Nacionalçlirimtar, pjesëmarrës në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, madje dhe ishin emëruar në poste drejtuese në qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit, si për shembull rasti i Gjergj Kokoshit, i cili ishte ministër i Arsimit (korrik 1943-janar 1944), gjatë gjyqit të zhvilluar në muajt qershor-korrik 1946 u konsideruan si “armiqtë e popullit” dhe morën dënime të ashpra.

Goditja e radhës për të majtën jostaliniste ishte ashtuquajtura Grupi i Deputetëve. Këta ishin personalitete me kontribut të spikatur përgjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe pas saj. Deputetët ishin me bindje qartësisht të majta, por nuk ishin komunistë.<sup>28</sup> Ndër ta mund të veçojmë Shefqet Bejën, Kolë Kuqalin, Sheh Ibrahim Karbunarën, Irfan Majunin, Enver Sazanin e figura të tjera intelektuale dhe me peshë politike. Disa prej tyre kishin aktivitet të gjatë politik, që i paraprinte pushtimit nazifashist, si Riza Dani, Selaudin Toto apo Konstandin Boshnjaku. Ky i fundit kishte qenë qysh herët themelues dhe sekretar i KONARE-s, bashkëpunëtor i hershëm i Nolit dhe figurave të tjera eminente të së majtës në Shqipëri dhe diasporë.

Ata përfaqësonin një kërcënim për monopolin e pushtetit politik dhe ekonomik të PKSH-së, kështu që u gjykua të hiqeshin qafe qysh në fillimet e konsolidimit të pushtetit të ri të “diktaturës së proletariatit”. Ndërsa Beja në shkrimet e tij në gazetën “Bashkimi” kundërshtonte monopolin e Partisë Komuniste dhe shihte me shpresë Frontin Demokratik si një organizatë ombrellë që përfshinte shumicën e shqiptarëve dhe, për rrjedhojë, një farë pluralizmi ideor të majtë, Konstandin Boshnjaku që në atë kohë ishte edhe Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë, ishte në favor të inkurajimit të sipërmarrjes private si një motor për zhvillimin e vendit, krahas pronës publike.<sup>29</sup> Pra, qysh në fillimet e instalimit të pushtetit monokratik në Shqipëri, u pa e qartë që regjimi i ri komunist do të ndiqte një vijë të ashpër bolshevike dhe sektare, jo vetëm ndaj atyre që i konsideronte kolaboracionistë, jo vetëm ndaj nacionalistëve, por edhe ndaj opozitës së majtë parlamentare, duke shuar qysh në krye të herës çdo lloj zëri apo vetëdije opozitare dhe nuancë opoence.

Goditja e së majtës jostaliniste vijoi kohë pas kohe dhe përfshiu shumë veprimtarë apo mendimtarë të së majtës. Një pjesë e saj kishte karakterin e luftës për pushtet, e cila zhvillohej nga Enver Hoxha kundër të gjithë elementëve që bëheshin të rrezikshëm për pushtetin e tij, karakteristikë që duhet të trajtohet gjerësisht në një dimension të veçantë. Por goditja drejtohej më së shumti ndaj të gjithë atyre që shfaqnin qëndrime të ndryshme ndaj politika staliniste, e adaptuar nga totalitarizmi shqiptar. Në morinë e goditjeve ndaj kësaj kategorie të së majtës mund të veçohen përndjekjet ndaj anëtarëve të ish-grupeve komuniste të Shkodrës dhe të të Rinjve, anëtarëve të partive komuniste europiane, etj.

Goditjen më të fuqishme dhe afatgjatë e pësuan ata komunistë që përfaquan platformën e “socializmit me fytyrë njeriu”, si derivat e stalinizmit të Enver Hoxhës. Sa për ta ilustruar, po sjellim dy shembuj kuptimplotë: Konferencën e Tiranës dhe Grupin e të Rinjve.

---

27. Po aty.

28. Hamit Kaba & Sonila Boçi. 2017. “Dossier/ Historia Tragjike e Grupit të Deputetëve”. *Gazeta Tema*. 12 Tetor. Marrë nga: <http://www.gazetatema.net/2017/10/12/dossier-historia-tragjike-e-grupit-te-deputete%CC%88ve/>

29. Po aty.

Konferenca e Tiranës. Viti 1956 ka në thelbin e vet përpjekjet për demokratizimin e partive komuniste. Rekordet kryesore të këtij viti janë tezat e Kongresit XX të PK të BS, të cilat, udhëheqësit e rinj sovjetikë kishin filluar t'i përpunonin menjëherë pas vdekjes së Stalinit, në mars 1953<sup>30</sup>. Në këto teza bëhej fjalë për reduktimin e dhunës masive nga qeveritë komuniste, përmirësimin e kushteve ekonomike të popullsisë, marrëdhënie më të afërta me Jugosllavinë e së fundi, në Kongresin XX të PKBS, në shkurt 1956, u arrit deri në demaskimin e krimeve të Stalinit e kësisoj, në çmontimin e figurës së tij si udhëheqës i BS dhe i lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Megjithëse Enver Hoxha dhe Byroja Politike e PPSH-së, ashtu si udhëheqjet e vendeve të tjera komuniste, ishin vënë në dijeni për tezat e “Kursit të Ri”, në Shqipëri nuk flitej për krimet e Stalinit dhe afrimi me Jugosllavinë kishte ngecur. Shqetësimi për më shumë demokraci në PPSH, ishte bërë përherë e më i ndjeshëm te të gjithë komunistët e Tiranës. Hendeku midis njerëzve të thjeshtë dhe drejtuesve të lartë, të cilët gëzonin privilegje në paga, në nevojat për ushqime, në mallrat e konsumit, në shërbimin shëndetësor, etj., vazhdonte të thellohej. Një numër i konsiderueshëm i komunistëve të Tiranës, intelektualë, punëtorë, nëpunës me detyra të rëndësishme në administratën e kohës, menduan se ishte koha të vihej dorë në këto plagë dhe Partia e tyre të merrte përgjegjësi.

Ata ishin njerëz idealistë, besonin te Partia e tyre, besonin te sistemi dhe mundësitë për ndryshim brenda sistemit. Pikërisht kjo ishte drama e tyre. Menduan se Konferenca e PPSH-së për Tiranën (14-19 prill 1956) ishte një çast i përshtatshëm, pasi mendonin se organizata e PPSH-së së kryeqytetit, me peshë të madhe përfaqësuese, do të kishte jehonë në të gjitha organizatat e tjera të vendit<sup>31</sup>. 300 pyetje iu drejtuan presidiumit nga salla e konferencës. Ato nuk kishin të bënin me raportin rutinë të sekretares së parë të qytetit, por me keqdrejtimin, varfërinë, me privilegjet dhe familjaritetin, me propagandën mashtruese, rehabilitimin e figurave të dënuara politikisht, etj. Në këtë rrjedhë qenë dhe diskutimet<sup>32</sup>.

Problemet që u ngritën ishin shqetësuese, jo thjesht për Komitetin e PPSH-së së Tiranës, por për të gjithë Shqipërinë. Natyrshëm, përgjegjësia në diskutime kalonte tek udhëheqja e PPSH, si forca drejtuese e shtetit shqiptar. Prandaj kjo e fundit i konsideroi diskutimet në konferencë si një revoltë e organizuar, pjesëmarrësit e së cilës nesër do të dilnin me një platformë të rrezikshme me pikëpamje antiparti dhe antimarksiste për të përmbytur pushtetin komunist në vend. Madje, këta delegatë do të vinin në Kongresin III të PPSH-së, i cili do të mbahej në maj të po atij viti, ku do të mbanin qëndrim “kundër vijës së drejtë të PPSH”.

Kësisoj, Konferenca e Partisë e Tiranës ka dy pamje, që janë të ndërthurura në një segment kohor tepër të kufizuar, i cili zgjati vetëm disa orë: një shpërthim idealizmi, herë-herë edhe revoltë e përmbajtur e njerëzve që kishin besim për ndryshime brenda sistemit dhe nga ana tjetër, frika ekstreme që kupola kishte nga populli i vet dhe nga baza e Partisë, prandaj organizoi me shpejtësi mbyjtjen e vetë kritikës për problemet që ekzistonin. Madje, brenda disa orëve, të njëjtët njerëz në konferencë u kthyen nga mbështetës entuziastë të zërave kritikë, në linçues të tyre.

Menjëherë pas konferencës, brenda një jave, u organizuan mbledhje rrufe të 243 organizatave të partisë, ku 2000 komunistë dënuan veprimtarinë “armiqësore” të kritikëve të konferencës dhe të atyre që i mbështetën. Me dhjetëra komunistë u përjashtuan nga Partia dhe morën vërejtje në Kartën e Partisë. Në Shqipëri, siç pohon studiuesja Ana Lalaj, pranvera e 1956-s kishte qenë e rrejshme<sup>33</sup>. Akoma më tej,

30. Në vendet komuniste, këto teza u quajtën “Kursi i RI”, ndërsa në Perëndim e më gjerë në literaturën historike dhe në opinionin publik u quajtën “Kursi i destalinizimit”.

31. Ana Lalaj, *Pranvera e rrejshme e '56*, Tiranë: Infobotues, 2015, f. 40-50.

32. Po aty.

33. Po aty.

kur në të gjithë Bllokun komunist ishin pezulluar pushkatimet, në Tiranë, në nëntor 1956 u pushkatuan tre komunistë, mes tyre edhe një grua. Ndërsa pas prishjes me BS, pas vitit 1960, u këput çdo lidhje me destalinizimin dhe, ndaj kritikëve të Konferencës së Tiranës filluan burgimet e internimet.

Konferenca e Partisë e Tiranës mbahet mend për trajtimin transparent të problemeve, por edhe për dhunën politike që u përdor gjatë dhe pas saj. Guximtarëve të '56-s dhe familjarëve të tyre iu desh të kalonin një kalvar të vështirë shumëvjeçar. Por ata mbetën ashtu siç janë fiksuar në memorien e kohës, racionalë, të fortë dhe dinjitozë për të reformuar Partinë e tyre<sup>34</sup>.

Grupi i të rinjve<sup>35</sup> i viteve '70, me pikëpamje sovjetike, përbëhej kryesisht nga Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, gazetarë në Radio Tirana, Robert Vullkani, nëpunës, Trifon Xhagjika, oficer ushtarak kapiten, Thoma Rafaeli, oficer ushtarak major, Franko Sara, inxhinier hidrologjik, dhe Stavri Rafaeli, tenor dhe skenograf në Teatrin e Operas në Tiranë. Ky grup ishte kundër shkëputjes nga Blloku Lindor dhe për zbutjen e sistemit diktatorial. Në fillim të aktivitetit, grupi kishte më shumë kërkesa mbi jetën kulturore, por më vonë mori drejtim politik. Në një trakt të shpërndarë në Tiranë në 28 prill 1962, ata kërkonin lirinë e të burgosurve politikë. Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho shkruanin letra ku dënonin kursin stalinist të Enver Hoxhës, letra që ia dërguan Ambasadës Sovjetike në Tiranë. Teksti i letrave u publikua në Kongresin XXII të Partisë Komuniste Sovjetike në Moskë, në vitin 1962. Që nga ky moment filluan kërkimet për zbulimin e grupit. Trifon Xhagjika shkruante poezi me përmbajtje politike. Një poezi e tij u shpërnda si trakt në Tiranë. Në gjyq lexoi poezinë “Atdheu është lakuriq”. Një pjesë e grupit u arrestua në tentativë arratisje pranë liqenit të Pogradecit, ndërsa të tjerët u arrestuan një muaj më vonë. Trifon Xhagjika dhe Thoma Rafaeli, si ushtarakë morën dënimin kapital me pushkatim. Ndërsa Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho me 25 vjet heqje lirie, Robert Vullkani me 20 vjet heqje lirie, Stavri Rafaeli dhe Franko Sara me 15 vjet heqje lirie. Në vitin 1979, Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezhoja, nga burgu i dërguan një letër Komitetit Qendror, ku kërkonin shkarkimin e Enver Hoxhës dhe hapjen e vendit me botën. Kjo letër u bë shkak për t'i akuzuar për ngritjen e një organizate politike për rrëzimin e pushtetit popullor dhe marrjen e dënimit me vdekje, pushkatim. Stavri Rafaeli u lirua në vitin 1978, pas kryerjes së dënimit. Robert Vullkani doli nga burgu në vitin 1991.


---

34. Po aty, f. 86-111.

35. Për informacionin mbi grupin e të rinjve falenderojmë bashkëpunimin me znj. Lorena Xhagjika, e cila solli informacion shumë të vlefshëm për veprimtarinë e këtij grupi.

## Bibliografia

- Alexander, Robert. J. 1992. *International Trotskyism: 1929-1985: A Documented Analysis of the Movement*. Duke University Press.
- Beja, Shefqet. 2019. Jam Armik i pushtetit të sotëm në Shqipëri. Marrë nga: <https://www.radiandradi.com/jam-armik-i-pushtetit-te-sotem-ne-shqiperi-shefqet-beja/> 11 Tetor 2019.
- Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar, 1942. Programi me dhjetë pika i Organizatës Kombëtare “Balli Kombëtar”. Dervishi, Kastriot. 2016. *Lëvizja Komuniste në Vitet 1924-1944 dhe Formimi i PKSH-së*. Tiranë: Shtëpia Botuese 55.
- Diemer, Ulli. Bakunin vs. Marx. Downloaded from: <https://libcom.org/library/bakunin-vs-marx> Aksesuar më 20 Prill 2020.
- Đilas, Milovan. 1983. [1957]. *The New Class: An Analysis of the Communist System* (paperback ed.). San Diego: Harcourt Brace Jovanovich.
- Gurakuqi, Romeo. 2018. Shqipëria dhe tokat e lirueme (1939-1946). Durrës: Jozef. ff. 1193–1195.
- Kaba, Hamit & Sonila Boci. 2017. “Dossier/ Historia Tragjike e Grupit të Deputetëve”. *Gazeta Tema*. 12 Tetor. Marrë nga: <http://www.gazetatema.net/2017/10/12/dossier-historia-tragjike-e-grupit-tedeputete%CC%88ve/>
- Frashëri, Kristo. 2006. *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së (1878-1941)*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Haberlen, Joachim K. 2012. “Between global aspirations and local realities: the global dimensions of interwar communism,” *Journal of Global History*, Vol. 7, Issue 03, November, pp 415 – 437.
- Kastning, Thomas. 2013. *Freedom, Solidarity, Justice: Basics on Social-Democracy*. Friedrich Ebert Stiftung.
- Katz, Henryk. 1992. *The emancipation of labor: a history of the First International*, New York: Greenwood Press.
- Kolakowski, Leszek. 1978. *Main Currents of Marxism: Its Rise, Growth and Dissolution*. Vol. 1 & 3. Oxford: Clarendon Press.
- Joll, James. 1974. *The Second International, 1889–1914*. London: Routledge.
- Lalaj, Ana. 2015. *Pranvera e rrejtshme e '56*, Tiranë: Infobotues.
- McDermott, Kevin and Jeremy Agnew. 1997. *The Comintern: a history of international communism from Lenin to Stalin*. New York: St Martin's Press.
- Pandelejmoni, Enriketa. “Gjergj Kokoshi dhe kontributi i tij politik në një atmosferë atipike politike në Shqipërinë e pasluftës”. Marrë nga: <https://dosjet.gov.al/gjergj-kokoshi/>
- Për një Parti Komuniste. Fondi: *Bulletin i Organizatës Komuniste të Shqipërisë*, (Buletin Jeshil). Nr. 1. Dhjetor 1938, ff.1-4.
- Premte, Sadik. 2006. *Përgatitjet për themelimin e PKSH-së*. Kujtime, 25 janar 1950. Ruhen në dorëshkrim nga bija e tij në Vlorë. Marrë nga: Kristo Frashëri. 2006. *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së (1878-1941)*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Sowell, Thomas. *Etic Principles*. SOCIALDEMOKRATIET. Marrë nga: <https://www.socialdemokratiet.dk/da/partiet/in-english-the-social-democratic-party/social-democratic-principles/>
- Zhila, Lenina & Vlado Popovski. 2015. *Marrëdhëniet Sovjetike-shqiptare, vitet '20 dhe '30 të shek. XX*. Shkup. (Përkthyes Resul Shabani).
- van Ree, Erik. 2002. *The Political Thought of Joseph Stalin: A Study in Twentieth Century Revolutionary Patriotism* (hardcover) (1st ed.). Routledge.







# **Profile Biografike**

Sejfulla  
Malëshova

1

# Midis ëndrrës dhe zhgënjimit

Më 2 mars 1900, në Limar, një nga tri lagjet e Malëshovës, Tasim dhe Pashako Hoxha sollën në jetë një djalë që ia vunë emrin Sejfulla. Më tej, rruga që ndoqi është pak a shumë e njohur, mësimet e mesme në kolegjin e Shën Adrianit, në Kalabri, prej nga dolën mjaft shqiptarë me emër në historinë e shekullit XX.

**NGA ANA LALAJ**

*Se zhduken perëndi e perandorë,  
po kënga e poetit s'perëndon.*

*Lame Kodra, 1955*

Në tribunat politike të fillim viteve '90, kur komunistët ishin në ethet e reformimit, ndodhi që opozita e sapoardhur t'u kujtonte atyre se e kishin një model të socialdemokracisë dhe se në vend të portretit të Hoxhës, rrëzuar e pa rrëzuar, mund të vinin atë të Sejfulla Malëshovës. Një sugjerim i sinqertë, po të mbajmë parasysh gjestin e demokratëve pasi erdhën në pushtet, teksa një shkolle në Përmet i dhanë emrin e Malëshovës dhe më shumë se aq, presidenti i zgjedhur prej tyre e nderoi me Urdhrin e Flamurit të Klasit I, ndër të tjera, me motivacionin “për shpirt demokrat e përparimtar”.<sup>36</sup> Në të kundërtën, në tridhjetë vjet, socialistët nuk e kanë përmendur asnjëherë e asgjëkund Malëshovën. Edhe një bust i tij, vendosur në një shesh të qytetit të Fierit, u shkull së andejmi sapo erdhi kryebashkiaku i radhës, edhe ai socialist.

Është e lexueshme qasja politike e demokratëve. Duke e identifikuar Malëshovën si kundërshtarin e parë dhe të vetëm të Enver Hoxhës brenda udhëheqjes së Partisë Komuniste menjëherë pas luftës, mendoj se në një kohë kur fjalori politik i ditës qe mbushur me mlllef antikomunist, ata dhanë një mesazh qetësues, sipas të cilit njihnin dallimet edhe midis drejtuesve komunistë e jo më midis komunistëve të thjeshtë. Por nuk është e qartë heshtja e socialistëve. Është për shkak se ata nuk gjejnë ndonjë lidhje ideologjike me këtë figurë historike? Është për shkak të sëmundjes së tyre endemike të

36. Dekret nr. 960, datë 25.11.1994 i Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

shpërfilljes së rrënjëve nga vijnë? Apo një hile e rëndomtë e kohëve moderne, për t'iu shmangur kokëçarjeve që mund të sjellë çfarëdo reference historiografike programore dhe që i kanë kthyer partitë, më e pakta, në instrumente pragmatiste.

Po kush ishte Sejfulla Malëshova? Një emigrant politik që mori arratinë kur Ahmet Zogu u kthye në pushtet në dhjetor 1924. Një pasionant në letërsi, por që studioi në një akademi politike - ushtarake. Anëtar i Partisë Komuniste (bolshevike), por dhe në krye të grupit të parë komunist të shqiptarëve, grupit të Moskës, më 1925. Personi ndërlidhës midis Kominternit dhe të dërguarve në Shqipëri për të formuar në këtë vend një parti komuniste. Profesori i filozofisë i cili, më 1943, iu bashkua shtabit të luftës në Shqipëri, duke marrë atje përgjegjësi politike. Autori më potent i programit politik dhe ekonomik të pasluftës, përplasia me Enver Hoxhën dhe... Historianë komunistë dhe jokomunistë, por që janë marrë me komunizmin, kanë plot jetëshkrime të ngjashme për persona historikë të ngjashëm. Megjithatë, çdo klishe “militantiste” nuk ndihmon për të kuptuar Malëshovën e vërtetë. Përtej saj, vlerësimi për këtë individ historik më duket se do mbajtur në disa linja të holla, të ndërmjetme, po që në rastin e Malëshovës bëhen përcaktuese të personalitetit të tij. Që këtej, besoj se marrin përgjigje edhe pyetje të këtilla: Kush ishte Sejfulla Malëshova dhe çfarë përfaqëson ai? Ishte një bolshevik i bindur apo një i majtë i moderuar, ndoshta socialdemokrat, sipas një versioni në qarkullim. Më në fund, ishte ai viktimë e luftës për pushtet apo kurban i ideve të veta?

---

## Idetë si proces formimi

---

Më 2 mars 1900 në Limar, njëra nga tri lagjet e Malëshovës, Tasim dhe Pashako Hoxha sollën në jetë një djalë që ia vunë emrin Sejfulla. Kur erdhi në moshën e shkollës, i ati e mori në Vlorë, ku punonte doganier.<sup>37</sup> I njëjti burim thotë se mësimet e para i bëri në turqisht. Më tej, rruga që ndoqi është pak a shumë e njohur, mësimet e mesme në kolegjin e Shën Adrianit, në Kalabri, prej nga dolën mjaft shqiptarë me emër në historinë e shekullit XX; student për mjekësi në Romë dhe ndërprerja e studimeve. I kësaj kohe duhet të jetë edhe ndërrimi i mbiemrit nga Hoxha në Malëshova, veprim që, ndoshta nën shembullin e tij, e bënë më 1935 plot malëshovitë të tjerë, emigruar në SHBA.<sup>38</sup> Fillim vitet '20 janë karakteristike për Evropën politike, e cila vinte pas një lufte botërore dhe ku ishin shpërbërë perandori e kishin lindur shtete të reja kombëtare. Në Rusi qe vendosur bolshevizmi, varianti më ekstrem i komunizmit të Marksit. Më 1919, Internacionalja e Tretë Komuniste kishte orientuar partitë komuniste, të viheshin në ballë të turmave proletare e të revolucioneve bolshevike në vendet e tyre për të përmbysur borgjezinë, me frymëzim Revolucionin e Tetorit. Idetë e majta duket se po hynin edhe në Shqipëri, edhe pse në këtë vend nuk kishte as parti komuniste e as parti të tjera të majta. Në rrethet intelektuale u prit me simpati denoncimi që Lenini u bëri marrëveshjeve të Rosisë cariste, prej nga nxori në shesh edhe Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915 për copëtimin e Shqipërisë. Po ashtu protestat e socialistëve në Itali për të mos dërguar trupa në Shqipëri, u erdhën në ndihmë luftëtarëve të Vlorës në fitoren historike të 1920-ës. Në këto rrethana, më 1922, Lazar Fundo, që kishte studiuar në Paris për sociologji, u përpoq të krijonte një parti socialiste në Korçë, por nuk ia doli. Atëherë ai u bashkua me Avni Rustemin dhe po atë vit, ishte ndër themeluesit e Shoqërisë “Bashkimi”.

---

37. Niko Tyto, Për Sejfulla Malëshovën, Tiranë: Botimet Kumti, 2003, f. 5.

38. Po aty, f. 3.



Sejfulla Malëshova ishte një bolshevik i bindur apo një i majtë i moderuar, ndoshta socialdemokrat, sipas një versioni në qarkullim. (në foto)

Depërtimi i mendimit politik të majtë në Shqipëri u shoqërua edhe me veprimin politik që erdhi duke u rritur. Midis veprimtarëve politikë bën pjesë edhe Sejfulla Malëshova, sado që të dhënat për vitet e tij të rinisë janë të pakta. Sa që student thuhet se krijoi një shoqëri, “Shpresa e Atdheut”, nxori revistën me të njëjtin emër si dhe publikoi krijimet e para poetike nën emrin Lame Kodra.<sup>39</sup> Në këto kohë dalldisjesh politike në Italinë e kapur nga fashizmi, Malëshovës autoritetet i ndërprejnë bursën për mjekësi në Romë pasi, sipas tyre, ai u konsiderua “element subversiv” dhe “revolucionar”. Kjo e dhënë është marrë nga një raport për Zyrën e Informacionit të Luftës (OWI) në Shtetet e Bashkuara, dhjetor 1944, i cili përmban dhe një biografi për Malëshovën, që e ka shkruar Ymer Dishnica. Sipas atij raporti, Malëshova ka ardhur në Tiranë më 1922 dhe ka edituar gazetën “Xhoka”, që e nxirrte një grup demokratësh të rreshtuar kundër bejlerëve.<sup>40</sup> E njëjta gjë kishte ngjarë edhe me Avni Rustemin, student për pedagogji në Romë, i cili i kishte ndërprerë studimet për t’u marrë me veprimtari revolucionare. Në dhjetor 1923 ai që zgjedhur deputet. Malëshova, si plot të tjerë, iu bashkua “djemve të Bashkimit”, ku Avniu ishte kryetar.

Në të dy dhjetëvjeçarët ’20-’30, viti 1924 është më i spikatur i jo vetëm për nga dendësia e veprimeve politike, por edhe vit një për të majtën shqiptare, një rast ku janë bërë bashkë të mirat dhe dobësitë e kësaj të majte që po hynte në Shqipëri, edhe vrulli edhe thyerja, edhe përparimi edhe regresi, edhe pjekuria, po dhe naiviteti. Ai vit e gjeti Malëshovën në Tiranë. Fill pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1923, janari kishte hyrë me përplasje politike. Opozita e kishte zgjeruar mbështetjen dhe këmbëngulte në dorëheqjen e Ahmet Zogut si kryeministër, duke sjellë si arsye keqqeverisjen dhe autoritarizmin e tij. Zogu rezistoi sa mundi, po në shkurt kundërshtarët i bënë atentat brenda në parlament. Dyshimet ranë mbi Avni Rustemin si nxitësi kryesor për atentatin, por midis të ndaluarve për t’u marrë në hetime ishte

39. Ndrichim Kulla, Antologji e mendimit shqiptar (1870-1945), Tiranë: Botimet Plejad, 2003, f. 882.

40. The National Archives, HS 5/4, “Report on Trip to Tirana,” Albania, by Maurice Rosenberg, agjent i Zyrës së Informacionit të Luftës të SHBA (OWI - U.S. War Department, Office of War Information, Research Division).

edhe Sejfulla Malëshova, i cili vëzhgohej nga policia.<sup>41</sup> Ahmet Zogu dha dorëheqjen. Më shumë se për të qetësuar gjendjen, duket se kjo ishte një lëvizje taktike për t'u kthyer më i fortë në një çast të dytë. Por zgjedhja e Shefqet Vërlacit si kryeministër nuk e qetësoi aspak opozitën<sup>42</sup>. Ai shihej si përfaqësuesi më tipik i klasës feudale, kur programi i opozitës ishte fund e krye kundër kësaj klase. Për më tepër, Vërlaci ishte njeriu më i afërt i Ahmet Zogut, vjehëri i tij. Ai ishte një mbulesë e mirë edhe për grupet mercenare, që njerëzit e Zogut t'i përdornin sapo të shfaqej nevoja.

Ngjarjet e prill – majit ecën shpejt. Në prill u vra Avni Rustemi. Nuk dihet nëse pati ose jo dorë Ahmet Zogu në këtë vrasje. Ajo që dihet është se opozita e shfrytëzoi ngjarjen për një lëvizje popullore, e cila nuk u qetësua as me thirrjen në kabinetin qeveritar të dy a tre ministrave nga opozita dhe as me ikjen e Vërlacit, në fund të majit. Në qershor kryengritja mori më shumë përmasa. Ajo filloi nga Kruma, ku Bajram Curri me forcat e tij u drejtua Tiranës. Vazhdoi me Vlorën dhe të tjerët. Më 10 qershor u zu Tirana, e cila u mor nga krengritësit pa rezistencë. Ahmet Zogu kaloi kufirin në Homesh të Dibrës dhe prej andej u prit në Beograd. Kjo ngjarje në historiografinë komuniste ka hyrë me termin *Revolucioni Demokratiko Borgjez* i qershorit. Sot opinionet janë të ndara, nëse ishte ose jo *revolucion*, për më tepër ishte ose jo *demokratik*, apo thjesht e vetëm një *grusht shteti* ku u përdor forca për të rrëzuar një qeveri të ligjshme, të sapodalë nga zgjedhjet. Mund të diskutohet gjatë, dhe me të drejtë, nëse ishte ose jo e ligjshme dhuna që u përdor për të rrëzuar një qeveri dhe sjellë një tjetër, por fakt është se qeveria e re me Fan Nolin kryeministër erdhi me një program për një shtet modern, program me të cilin “do të krenohej çdo demokrat perëndimor”.<sup>43</sup> Megjithatë qeverisja e Nolit ishte një dështim. Ajo nuk arriti të zbatonte asnjë nga reformat e premtuara dhe për këtë arsye e humbi shpejt mbështetjen e brendshme. Ashtu si për arsye po aq komplekse nuk arriti të merrte kurrfarë mbështetjeje nga jashtë. Kryengritësit që erdhën me pompë në qershor, ikën kokulur në dhjetor, sapo Zogu u kthye në Tiranë, shoqëruar nga forcat mercenare dhe forca të tjera nga Jugosllavia. Të shumtët prej të ikurve, në krye Noli, Gurakuqi etj., kapërcyen detin dhe u shpërndanë nëpër Evropë. Midis të ikurve ishte edhe Sejfulla Malëshova, të cilin Noli e kishte emëruar sekretar të përgjithshëm në qeverinë e tij.

Qershori i '24-ës gjithsesi shënoi një tronditje në jetën shqiptare. Ai që në qershor u quajt revolucion, në dhjetor u pasua me “kundërrevolucion”. Demokracia që erdhi me rrugë jo legale në qershor, dha shkas për rikthimin legal të një regjimi arbitrar, në dhjetor. Brenda vendit u asgjësuan alternativat, por ato u grupuan dhe u kompaktësuan, së paku për një kohë, jashtë vendit. Përfaqësues të mërgatës politike të dhjetorit 1924, të majtë e të djathtë, nga Fan Noli e deri te Lazar Fundo e Mustafa Kruja më 25 mars 1925 formuan një organizatë që e quajtën KONARE (Komiteti Nacional Revolucionar), me qendër në Vjenë.<sup>44</sup> Kryetar u zgjodh Fan Noli. Organizata u konceptua si një front politik antizogist me motiv rikthimin e pushtetit të përmbysur. Me fjalë të tjera, ky ishte një front ku ishin mbledhur njerëz me ide të ndryshme, po që i bashkonte vetëm antizogizmi. Po atë muaj, brenda KONARE-së të majtët u grupuan në atë që u quajt *Komiteti i Çlirimit Nacional*. Të njëtin veprim do ta bënë më vonë edhe një grup të djathtësh, të cilët dolën më vete, duke krijuar organizatën *Bashkimi Kombëtar*, në shenjë mospajtimi me politikën e majtë që ndoqi KONARE-ja, veçanërisht me financimet që merrte nga Moska. Si KONARE-ja ashtu edhe fraksionet e saj do të kishin shtypin e tyre.

Për rrymat politike në Shqipëri në vitet 20-30 kemi trashëguar pak studime. Nëse është folur diçka për të majtën, të dhënat janë të deformuara dhe për më tepër gjithçka është kufizuar vetëm me grupet komuniste. Pas rënies së komunizmit ka disa botime me interes dhe midis tyre e vlen të veçohet studimi monografik

41. Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2006, f. 202, 204.

42. Shefqet Vërlaci shihej si përfaqësuesi më tipik i klasës feudale, kur programi i opozitës ishte fund e krye kundër kësaj klase. Për më tepër, ai ishte njeriu më i afërt i Ahmet Zogut, vjehëri i tij. Vërlaci ishte një mbulesë e mirë edhe për grupet mercenare, që njerëzit e Zogut t'i përdornin kur të shfaqej nevoja.

43. Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Botimet Çabej, 1996, f. 77

44. Kristo Frashëri, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH, 1878-1941*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006, f. 32-33.

i prof. Kristo Frashërit, për historinë e lëvizjes së majtë në Shqipëri, deri në krijimin e partisë komuniste. Studimi përmban të dhëna të rëndësishme për zhvillimet brenda së majtës, dallimet midis rrymave, po dhe midis vetë komunistëve. Për shkak persekucioni, në periudhën që flasim e majta në përgjithësi e aq më pak ajo komuniste, nuk mundi të zhvillohej në rrugë legale brenda në Shqipëri. Ajo mundi të krijojë një histori të vetën vetëm në kushte emigracioni, ku u regjistruan komunistët e parë, celulat, organizatat etj. Aty spikatën dhe individët politikë, mjaft prej të cilëve hynë në histori. Sejfulla Malëshova është njëri prej tyre. Deri më 1927 komunistët shqiptarë në emigracion ishin individë që ishin regjistruar në njërin ose në tjetrën parti komuniste, ku ata punonin ose studionin. Por një organizatë komuniste më vete e shqiptarëve për herë të parë u krijua më 28 gusht 1927, që u quajt *Grupi Komunist Shqiptar* në Bashkimin Sovjetik. Në grup bënin pjesë 12 nga 20 studentët që, përmes Kominternit, ishin dërguar në Bashkimin Sovjetik për studime, midis tyre Lazar Fundo, Sejfulla Malëshova, Tajar Zavalani, Ali Kelmendi etj. Ai ishte i organizuar në tri celula, në Moskë, Leningrad, siç thirrej atëherë Shën Petërburgu, dhe në Odesë.<sup>45</sup> Grupi u njoh nga Internacionalja Komuniste dhe Malëshova në emër të tij u thirr në Kongresin VI të Kominternit, më 1928.

Për grupin shqiptar të komunistëve duket se Seksioni Ballkanik i Kominternit ishte veçanërisht i interesuar. Arsyeja është se në Shqipëri nuk kishte një parti komuniste dhe grupi shqiptar mund të merrte përsipër detyrën për ta krijuar atë. Këtë detyrë Gjergj Dimitrovi, në emër të Seksionit Ballkanik të Kominternit, ia komunikoi grupit më 12 shtator 1929. “Një vit më vonë (1930), në bazë të direktivës që lëshoi Kominterni, *Grupi Komunist Shqiptar* në BS u shpërnda.”<sup>46</sup> Prof. Frashëri thotë se pas shpërndarjes së grupit, bërthama komuniste shqiptare në Francë u forcua me militantë komunistë të Grupit të Moskës, S. Malëshova, Ll. Fundo, T. Zavalani, D. Godelli etj.<sup>47</sup> Por ky pohim duhet marrë me rezervë, teksa burime të tjera flasin se Malëshova ka vazhduar të qëndrojë në Moskë, ku dhe jepte leksione filozofie. Frashëri nënvizon edhe faktin se pas shpërndarjes së Grupit të Moskës, “më 1931 detyrën për të formuar Partinë Komuniste Shqiptare e kishin dy organizata të tjera të emigracionit politik shqiptar: *Qendra Komuniste e Vjenës*, e atashuar në *Seksionin Ballkanik të Kominternit*, kryesuar nga Lazar Fundo dhe fraksioni komunist i *Komitetit të Çlirimit Nacional*, kryesuar nga Halim Xhelo.”<sup>48</sup> Që Malëshova pas viti 1930 ka qëndruar për një kohë në Moskë dhe se ai ka qenë i tërhequr në angazhimin ndaj Shqipërisë e pohon vetë ai në biseda private, që janë regjistruar nga ata që ishin ngarkuar ta ndiqnin, kur ai u vu në përpunim nga Sigurimi i Shtetit, më 1951. “Më 1927 u pranua kandidat i Partisë Bolshevike dhe më ’30 u bëra anëtar i saj. Më ’30-’31 erdha në konflikt me shokët shqiptarë për çështjen taktike të punës në Shqipëri dhe Kominterni ia besoi punën Zai Fundos dhe Halimit (Xhelo, A.L.) dhe këta e drejtonin nga Franca. Unë vazhdova të shkruaj artikuj për “Lirinë Kombëtare” dhe vazhdova punën si profesor filozofie në Moskë. Pas tradhëtisë së Fundos, puna i besohet Ali Kelmendit. Në demaskimin e Fundos edhe unë kam pjesën time.”<sup>49</sup> I njëjti pohim është bërë edhe nëntë vite më vonë, më 1961, ndërsa i ankohet mikut të tij të vjetër Demir Godelli se nuk i ishte njohur pensioni për vitet e luftës, si nuk i ishin njohur vitet në Bashkimin Sovjetik, megjithëse atje ai kishte derdhur rregullisht kontributet në sigurimet shoqërore. Në këtë rast sjell këtë të dhënë, kur thotë: “...unë kam punuar 14 vjet rresht në Bashkimin Sovjetik...”<sup>50</sup> Duke ditur se Malëshova ka qenë ndër 20 të rinjtë e parë që shkuan për studime në BS, më 1925, në qoftë se është larguar që andej pas katërmëdhjetë vjetësh, i bie të ketë qenë viti 1939. Nuk ka arsye që pohimet e mësipërme të mos merren të mirëqena, kur ato janë marrë në kohë të ndryshme dhe rasti i dytë madje është regjistruar me teknikë operative. Por këto do të përjashtonin të dhënë tjetër, sjellë nga prof. Frashëri, sipas të cilës në rrethanat kur Grupi i Moskës ishte shpërndarë dhe kur Qendra e Vjenës ishte shpërngulur në Francë, “Kominterni krijoi institucionin e *Përfaqësisë Komuniste Shqiptare*, selinë e së

45. *Po aty*, f. 37

46. *Po aty*, f. 60

47. *Po aty*, f. 59

48. *Po aty*, f. 61

49. *Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)*, Ministria e Punëve të Brendshme, Dosje formulare për Sejfulla Malëshovën, nr. 587-A, Kategoria 2/A, Raport i dhënë më 24.11.1952.

50. *Po aty*, fl. 107. Raport i dhënë më 31.5.1961.

“Duhet hedhur  
pikëpamja e  
mikroborgje  
se tani në Sh  
ka klasë pur



ar poshtë  
politikanëve  
zë që thonë  
qipëri nuk  
nëtoje”

Sejfulla Malëshova

cilës e vendosi në Francë, me pak anëtarë dhe me përgjegjës Sejfulla Malëshovën”.<sup>51</sup> Bëhet fjalë për vitin 1936 dhe nuk është e qartë ku ishte Malëshova, në Moskë apo në Francë? Për t’u saktësuar pasiguri të këtij lloji mendoj se ka nevojë për ekzaminime të mëtejshme, pasi ndonjë prej rasteve mund të konsiderohet thelbësor për veprimtarinë e Malëshovës. Për ta vendosur në balancën e kontributeve reale të viteve në emigracion, për Malëshovën ka nevojë të saktësohet edhe ndonjë e dhënë tjetër, që është sjellë deri në botimin zyrtar të Akademisë së Shkencave, në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar. Në zërin për Malëshovën thuhet se ai “u pranua anëtar i Partisë Komuniste të BS (1930–1932), por u përjashtua si buharinist”.<sup>52</sup> Një tjetër pohim është i një veterani të Luftës që thotë madje se ai është përjashtuar nga partia dhe është dërguar të punonte si punëtor në Kaukaz, por pas verifikimeve ai ishte kthyer në parti.<sup>53</sup> Duke gjurmuar të dhëna si këto, del e paqartë saktësia e tyre, çka e bën të vështirë një identifikim të besueshëm të veprimtarisë së Malëshovës në një hapësirë kohore që zë gati gjithë vitet ’30. Duke marrë në shqyrtim veprimtarinë e komunistëve shqiptarë në emigracion, si në *Grupin e Moskës*, në *Qendrën Komuniste të Vjenës* ashtu edhe si anëtarë të *Komitetit të Çlirimit Nacional*, në raport me detyrën e tyre kryesore – krijimin e një partie komuniste në Shqipëri, na duhet të përcaktojmë kontributin e tyre në grup, ashtu edhe të individëve më përfaqësues, njëri prej të cilëve ishte vetë Malëshova.

Lidhur me këtë detyrë, janë bërë disa përpjekje. Por pati dy vështirësi. Njëra ishte puna në terrenin shqiptar. Kur më 1930 në Tiranë erdhi Ali Kelmendi, të dhënat ishin se në Shqipëri kishte të paktën dy a tri celula komuniste. Kelmendi u vendos në Korçë, ku kishte një a dy celula aktive. Një celulë vepronte edhe në Tiranë. U hodhën disa hapa modestë, çka nxitën që në gusht 1934 në Dëshnicë të Korçës të mbahej një mbledhje ilegale për të diskutuar një platformë veprimesh për krijimin e një partie. Në këtë mbledhje Selim Shpuza përfaqësonte Prefekturën e Shkodrës, Hasan Reçi të Tiranës, Demir Godelli të Elbasanit, Ali Kelmendi, Dhimitër Fallo dhe Ymer Dishnica të Korçës. U pranua që kongresi themelues i partisë të mbahej më 1935, ndërsa për platformën mendimet u ndanë më dysh. Hasan Reçi kërkoi përfshirjen e komunistëve në një kryengritje të fshehtë, që po përgatitej për rrëzimin e Ahmet Zogut, ndërsa Ali Kelmendi e kundërshtoi idenë e implikimit të komunistëve në një grusht shteti, që rrëzonte një klikë dhe ngrinte një tjetër dhe mbrojti idenë bolshevike të një revolucionit popullor.

Ky ishte një diskutim i hershëm në rrethet komuniste të emigracionit, që lidhej me platformat e vetë Kominternit për te organizuar e drejtuar revolucionet bolshevike. Përjashtim do të bënin ato vende ku mungonte një klasë proletare dhe vendet koloniale të cilat duhet të çliroheshin më parë nga kolonializmi. Po Shqipëria ku hynte? Sipas krerëve të Komitetit të Çlirimit Nacional traktatet skllavëruese që Zogu kishte lidhur me Musolinin e kishin kthyer Shqipërinë në provincë të Italisë. Prandaj ata duhej të punonin jo për revolucionin socialist, po për çlirimin nacional dhe përmbysjen e feudalizmit. Këtë tezë e mbronte fort sidomos Halim Xhelo. Të tjerët, më kryesorët Malëshova, Fundo mbronin idenë se Shqipëria nuk ishte një vend kolonial dhe se do të duhej një parti komuniste për të përgatitur revolucionin socialist.<sup>54</sup> Këto teza i zhvilloi Sejfulla Malëshova, të cilat u bënë edhe teza të Grupit Komunist Shqiptar në BS. Sipas një dokumenti të tetorit 1929, ka një vlerësim interesant për atë që Malëshova me Grupin e quajnë faza e tretë e zhvillimeve në Shqipëri, pasi Ahmet Zogu u vetëshpall mbret i shqiptarëve. Kjo fazë ka për veçori reformat në legjislacion dhe reformat sociale, synimi i vërtetë i të cilave “është që superstrukturën e vjetër t’ia përshtatë nevojave të zhvillimit kapitalist dhe depërtimit të kapitalit italian në fushën e prodhimit dhe të tregtisë.”<sup>55</sup> Në këto teza thuhet po ashtu: “Duhet hedhur poshtë pikëpamja e politikanëve mikroborgjezë që thonë se tani në Shqipëri nuk ka një klasë punëtore. Në të vërtetë në Shqipëri jo vetëm që ka një klasë

51. Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së...*, f. 106

52. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 1605. Shih edhe: Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f. 379.

53. Niko Tyto, *Për Sejfulla Malëshovën...*, f. 61

54. Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes...* f. 46.

55. AQSH, F. Grupi Komunist Shqiptar në BRSS, L. 1, V. 1929, D. 30, fl. 10.

punëtore, por tashmë ajo ka filluar të ndërhyjë si një forcë e pavarur në arenën shoqërore, siç e tregojnë grevat në Durrës e në Sarandë.” Dhe më tej: “Në Shqipëri revolucioni borgjezo demokratik do të jetë në mënyrë të pakontestueshme një etapë e pavarur e revolucionit. Shpejtësia e transformimit të këtij revolucionit në një revolucion socialist do të varet nga raporti i forcave që do të zhvillohet brenda vendit dhe nga koniunktura revolucionare ndërkombëtare.”<sup>56</sup>

Por dallimet brenda grupeve të komunistëve u thelluan. Këto dallime vinin më së pari dhe më kryesorja për shkak të vlerësimeve jo të njëjllota të gjendjes në Shqipëri, por ato ishin edhe refleksi i debateve brenda vetë partisë bolshevike. Reshat Këlliçi, njëri nga komunistët e Grupit të Moskës, kujton se në vitet 1927–28 lufta midis trockistëve dhe shumicës së Komitetit Qendror “bëhej në mënyrën më demokratike, ishte një luftë mejdani, ku të dyja palët përdornin mjetet legale: gazetat, mbledhjet, propagandën, agjitacionin; me një fjalë të gjitha mjetet që përdoren në një fushatë elektorale me rëndësi historike.”<sup>57</sup> Duket se Stalinit atë kohë i duhej një fasadë demokracie në parti, deri sa më 1929 vija e tij u shpall fituese. Këlliçi ishte ndër njerëzit e afërt të Malëshovës. Megjithatë ai nuk e përmend asnjëherë në kujtimet e tij. Arsyeja është se ato janë botuar më 1965, kur as që bëhej fjalë t’i përmendej emri, një mënyrë efikase kjo për t’u fshehur jeta e tjetrit. Në këto debate Malëshova bashkë me Ali Kelmendin, Koço Tashkon etj., iu mbajtën deri në fund vijës bolshevike. Ndryshe ndodhi me Lazar Fundon, i cili u zhvendos nga bolshevizmi në pozita socialdemokrate. Ai jo vetëm u tërhoq nga ideja e një revolucionit socialist, por edhe u ndikua mjaft nga vija e Buharinit, me të cilin për një kohë kishte punuar në zyrat e Kominternit. Dihet, Fundos kjo i kushtoi shtrenjtë. Malëshova nuk lëvizi nga e tija, duke iu mbajtur vijës bolshevike. Ajo çfarë u ndodhi vite më pas në veprimet e Malëshovës e vë në dyshim nëse bolshevizmi i mëhershëm ka qenë bindje e tij apo një konformizëm ideologjik në kushte dhune i një anëtarit të Partisë bolshevike. Nëse do të ishte kjo e dyta, mund të thuhet po aq se kjo do të kishte qenë për të një sjellje atipike.

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore Malëshovën e gjeti në Francë. Në Shqipëri grupet komuniste qenë zgjeruar me anëtarë të rinj, por nuk dukej asnjë shans të bashkoheshin në një parti. Për Koço Tashkon, dërguar për këtë qëllim në Shqipëri më 1937, me fillimin e luftës gjithçka ishte bërë më e vështirë. *Përfaqësia Shqiptare*, deri atëherë një lidhëse me Kominternin, ku Malëshova kishte qenë përgjegjës, qe shpërbërë. Vetë Malëshova duket se ka shkëputur çdo lidhje me Shqipërinë. Këtë e thotë në fund të tetorit 1941 edhe Miladin Popoviçi në një letër për PKJ se në Francë flirton me Fundon njëfarë Malëshova. “Ky person, që jeton në Paris, asgjë nuk ka bërë deri më tash për punën revolucionare në Shqipëri. Të paktën ta bënte këtë herë pas here, për të dërguar mesazhe gojore, me anë të punëtorëve që punojnë në Francë dhe kthehen që andej në Shqipëri.”<sup>58</sup> Ndoshta Popoviç deri diku ka të drejtë, pasi nga ato pak dokumente që kemi del se Malëshova duhet të ketë qenë në udhëkryq. Ai, i gjendur bosh, nga Grenoble i shkroi disa letra Fan Nolit, nëse mund të ndërhynte për ndonjë punë në Shtetet e Bashkuara. Duket se Noli nuk e ka inkurajuar, me gjithë këmbënguljen e Malëshovës për t’u larguar së andejmi e për t’u vendosur diku, qoftë dhe në Argjentinë ose Meksikë.<sup>59</sup> Ka ndonjë zë që thotë se pikërisht në atë kohë atij i është ofruar edhe Ahmet Zogu me propozimin për të punuar me shqiptarët e Amerikës, në mbështetje të luftës, sigurisht për interes të oborrit. Thuhet se ky propozim ka përkuar me rënien e Francës nën gjermanët dhe me atë rast Zogu është larguar për në Londër.<sup>60</sup> Nëse është bërë ndonjë ofertë si kjo, nuk është e qartë nëse Zogu është tërhequr, apo Malëshova nuk e ka pranuar ofertën. Nuk dimë nëse Malëshova vetë ta ketë përmendur ndonjëherë këtë fakt, ashtu siç nuk kemi të dhëna për përfshirje të tij në veprime politike, deri kur ai vendosi të kthehej në Shqipëri.

56. *Po aty*.

57. Reshat Këlliçi, Me djemtë e “Bashkimit”, kujtime 1924, Tiranë: Shtëpia Botonjëse, “Naim Frashëri”, 1965, f. 200.

58. Arhiv Jugosllavije, Arhiv za Radniči Pokret Jugosllavije, Izvori za Istoriju SKJ, Dokumenti Centralnih Organa KPJ, NOR i revolucija 1941–1945, Seria A, Knjiga 2, Dokumenti 27, fl. 85–88, Beograd: Izdavački Centar Komunist, 1986, 30.10.1941.

59. Sejfulla Malëshova (Lame Kodra), Vepra 3, Publicistika, letër drejtuar Fan Nolit, 30.11.1940, Tiranë: Botimet Argeta-LMG, 2017, f. 453–454

60. AIDSSH, ... Dosje formulare ..., Raport i Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, 6. 2. 1950.

---

## Në Labinot, në shtabin e luftës (Intermezzo)

---

Malëshova erdhi në Shqipëri në qershor 1943. Ai thotë se kishte ardhur me pasaportë të rregullt, lëshuar nga legata shqiptare në Paris me emrin Sejfulla Tahsin. Ai ishte lidhur me Partinë Komuniste Shqiptare nëpërmjet Hulusi Spahiut, ushtarak dhe vullnetar në Luftën e Spanjës, po që atë kohë ishte në Zvicër. Ata janë takuar në Modena dhe të dy kanë udhëtuar për në Shqipëri.<sup>61</sup> Më 4 korrik ai ka qenë në Labinot, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe po atë ditë është pranuar anëtar i këtij Këshilli. Në atë mbledhje është vendosur krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe është zgjedhur po ashtu anëtar i këtij Shtabi.<sup>62</sup> Malëshova është kooptuar edhe në përbërjen e Komitetit Qendror të PKSH, ashtu siç është zgjedhur edhe në funksione të tjera, në Kongresin e Përmetit dhe në qeverinë e Beratit në fund të luftës.

Në luftë Malëshova mbajti funksione të rëndësishme politike, por jo ushtarake, ndonëse ai kishte studiuar në një akademi ushtarake-politike. U zgjodh anëtar në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, po nuk dimë të jetë marrë me ndonjë plan ose skemë taktike veprimesh luftarake, si dhe të ketë marrë pjesë drejtpërdrejt në luftime. Kam ndeshur diku, nuk di se ku, që ai ishte ndër të vështirësi, kur pas luftës i kishin kërkuar kujtime për ushtrinë, nga që nuk dinte ç'të thoshte. Megjithatë Hoxhës, si drejtues kryesor i shtabit të luftës, i duhej dikush që të shpjegonte luftën që ai drejtonte dhe t'i frymëzonte luftëtarët e saj. Malëshova pa dyshim ishte njeriu i përshtatshëm. Ai kishte përvojë në organizimin e një partie bolshevike, ashtu siç kuptonte nevojën për mbështetje në popull dhe nevojën për aleanca. Ai ishte më i dituri midis atyre që kishte përreth, llogaritur dhe vetë Hoxhën, i qartë në të shprehur, ashtu siç ishte i shkathët në të shkruar. Prandaj Hoxha e përfshiu në të gjitha forumet e luftës, ku ai duhej të hartonte rezoluta, të përgatiste vendime, të nxirrte buletine, të shkruante trakte e deri pjesë për teatrin partizan, si dhe gjithçka tjetër që kërkohej në këto raste.

Megjithatë Hoxha ndjehet i pakënaqur me punën e Malëshovës. Ai i ankohet me letër Ymer Dishnicës se “unë nuk të ndaloj të kesh atë admirim (për Sejfullain, A.L.), por për pjesën teme unë jam mjaft i deziluzionuar prej tij, pse e shoh që s’po bën gjëkafshë dhe këtë gjë ia kam shkruar dhe s’është përgjigjur, as letrës teme dhe as detyrave që i janë ngarkuar”. Dhe më tej: “Mund të jesh komunist me kokë të madhe, mund të kesh punuar dhe në Moskë, mund të kesh punuar dhe në Komintern, si thotë Sejfullahu, po fakti është se nuk po bën gjë.”<sup>63</sup> Opinione si këto Hoxha i ka përdorur edhe më vonë, kur ia ka dashur puna. Nuk kanë munguar madje edhe shpotitë, duke përdorur vargjet e vetë poetit “këmbëkryq përmbi selishte”, për ta paraqitur atë sehirxhi në raport me kontributet e të tjerëve që iu bashkuan luftës.

Mund të thuhet se kjo është rutina e punës, ku pakënaqësitë dhe qortimet shihen si normale në kësi marrëdhëniesh. Por një këqyrje e kujdesshme e këtyre marrëdhëniesh dhe sidomos duke i lidhur ato me praktikën e pasluftës, vjen në përfundimin se kjo është më shumë një taktikë e Hoxhës për ta shfrytëzuar tjetrin aty ku dhe për çfarë ai donte, t’i shfrytëzonte dijet, pa ushqyer konkurrencën. Thënë shkurt, për ta pasur nën kontroll. Ky mendim përforcohet edhe nga një letër e dytë që Hoxha në tetor ia çon Dishnicës, duke i kërkuar edhe njëherë t’u bashkohej kritikave për Sejfullahun, “pse ai jo vetëm nuk jep asnjë rezultat pozitiv, por i ka shtuar kritikën edhe ca më shumë, kritika të një njeriu të sëmure dhe që e quan veten të predestinuar të kontrollojë që lart dhe jo të punojë. Ti e di fare mirë që ato në një parti

---

61. AIDSSH, Dosje formulare nr. 587, fl. 60. Raport i dhënë më 24.11.1952.

62. AQSH, F. 40/APL, D. 3. fl. 1.

63. AQSH, F. 14/APL, V.1943, D. 20, Letër e Enver Hoxhës për Ymer Dishnicën dhe Nako Spirun, 4 tetor 1943.

komuniste nuk shkojnë. Ai kritikon, bile ashpër të gjithë artikujt që shkruhen në Zërin e popullit dhe në Bashkimi kundra Ballit ... Këto të meta ne duhet t'i zhdukim, pse ai do të bëhet një njeri shumë i vlefshëm për Partinë.”<sup>64</sup> Është e qartë, Hoxha me të drejtë ndjehet i shqetësuar jo për “rendimentin” në punë të Malëshovës, po se ai nuk ishte përfshirë ende në strategjinë e re të Hoxhës në raport me Ballin, teksa ai sapo kishte urdhëruar “për shpartallimin e tij”.<sup>65</sup> Ose tek përpiquej ta mbante shtabin të karikuar se nuk duhej humbur kohë, “por zjarr për zjarr t'i vëmë zjarrin Ballit dhe zogistëve”, etj.<sup>66</sup> Duket se taktika e Hoxhës e ka bërë efektin që lufta kundër Ballit të funksiononte si strategji kolektive e komunistëve.

Sa sipër, është thelbësore të shënohet se gjatë gjithë luftës, qëkurse ka mbërritur në shtabin e Hoxhës e deri në fund të saj, kur u krijua qeveria e përkohshme në Berat, më 22 tetor 1944, Sejfulla Malëshova na shfaqet më shumë një rekrut i bindur që merr dhe zbaton urdhra, sesa një individ politik krijues. Kjo vjen edhe për shkakun që debatet në forumet politike dhe ushtarake shqiptare të kohës së luftës, siç është vërejtur, kanë qenë të varfra. Kjo lidhet po ashtu edhe me një rregull të përgjithshëm të çdo lufte, ku urdhrat ushtarakë marrin përparësi në raport me debatet politike dhe debatet e natyrave të tjera. Në këtë frymë, del që edhe Malëshova të ketë qenë pjesë e atyre vendimmarrjeve të cilat, kur u është bërë analiza, janë vlerësuar të gabuara. Mjaft të kujtojmë që njëra prej këtyre vendimmarrjeve solli pasojat që dihen nga prishja e marrëveshjes së Mukjes.

Sa sipër, duke vlerësuar pa mëdyshje rolin e rëndësishëm të Malëshovës në përbërje të shtabit drejtues dhe pjesë e kontributit kolektiv të Luftës, po aq e kemi të vështirë ta shënojmë atë dallueshmëri si individualitet politik. Nuk duhet harruar se ky relativizim aso kohe vlente për të gjithë, përfshirë dhe vetë komandantin e asaj lufte. Për këtë arsye u gjykua që ky segment kohe të shihet si një sheshpushim midis viteve në mërgim dhe viteve në pushtet, në të parat si kohë formësimi të ideve politike të Sejfulla Malëshovës dhe në të dytat si kohë reflektimi dhe verifikimi të këtyre ideve.

---

## Idetë si verifikim

---

Kur luftës po i afrohej fundi, duket se Malëshova i kishte ikur Hoxhës nga shënjestra. Në regjistrimet e ditëve të Kongresit të Përmetit, maj 1944, është shënuar se diskutimi i Malëshovës u prit me ovacione dhe me thirrjet “Rroftë poeti revolucionar! Rroftë poeti i popullit!”. Në pushimet midis seancave ai krijoi atmosferë entuziaste, kur doli në podium dhe recitoi një varg poezish të tij, që stenografisti i ka renditur me tituj.<sup>67</sup> E gjitha kjo do të thoshte se emri i tij tashmë ishte bërë vërtet popullor. Në atë Kongres, Malëshova u zgjodh anëtar i Komitetit të Përgjithshëm të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Në tetor ai u kooptua nga kandidat në anëtar i KQ dhe i Byrosë Politike, ndërsa Hoxha e caktoi ministër për propagandën dhe kulturën popullore në qeverinë e përkohshme. Në tetor po ashtu u mblodh Konferenca e Frontit Nacionalçlirimtar dhe ai u zgjodh sekretar i kësaj organizate. Po nuk është kjo e veçanta. Më kryesorja, Malëshova ishte ai që përgatiti programin dhe statutin e organizatës, një platformë

---

64. AQSH, F.14/APL, V.1943, D.21, fl. 39-40, Enver Hoxha i shkruan Ymer Dishnicës, tetor 1943.

65. “Letër e KQ të PKSH drejtuar Komitetit Qarkor të PKSH për Gjirokastrën,” më 1 tetor 1943, në: *PPSH. Dokumente kryesore (1941-1948)*, Vëllimi I, Botim II, Tiranë, Naim Frashëri 1971, f. 211.

66. AQSH, F.14/APL, V.1943, D.20, Letër e Enver Hoxhës drejtuar Nako Spirut dhe Ymer Dishnicës, më 29 shtator 1943.

67. AQSH, F.40/APL, V.1944, D.13, f. 56. Verbal i Kongresit të Përmetit, 24 – 28 maj 1944.

që kur u mbush viti dhe u mbajtën zgjedhjet e para, ajo do të kthehej në objekt debatesh të mëdha, aq sa platforma dhe gjithë *politika me Frontin* u përdorën si pika e parë dhe më kryesore ndër argumentet që kryqëzuan autorin e tyre.

Do ta rimarrim pak më tej këtë moment shumë të rëndësishëm në politikën e komunistëve për regjimin që ata do ta shisnin si “demokraci popullore”, por edhe qëndrimin e Malëshovës në raport me këtë çështje. Por më parë na duhet të qëndrojmë ende, qoftë dhe për kronologji, në Beratin e çliruar të tetor – nëntorit 1944, aty ku ishte vendosur selia e *Qeverisë Provizore Demokratike*. Berati në ata dy muaj ishte kthyer në qendrën kryesore politike, ushtarake dhe administrative të vendit, qendër ku shkonin e vinin njerëz nga të katër anët, prej nga mbledheshin të dhëna e shpërndaheshin urdhra.

Ato ditë në Berat, nga 23 deri më 27 nëntor, Plenumi II i KQ të Partisë Komuniste do të merrte në analizë punën e deriatëhershme, për të cilën mendoj se mbetet analiza më kritike në gjithë historinë e saj. Për atë mbledhje ca kohë u hesht, derisa u shpërnda një version zyrtar për prapaskenë jugosllave, si presion ndaj Enver Hoxhës. Ky plenum doli nga kasaforta ku qe mbyllur dhe u bë i njohur vetëm më 1996 kur Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave i botoi të plota gjithë materialet e gjetura. Sipas rendit të ditës, referatin e parë për gjendjen politike në vend e mbajti Sejfulla Malëshova, por ky referat nuk është gjetur në arkivin e Partisë së Punës.<sup>68</sup> Dy referate të tjera, njëri për vijën politike të Partisë dhe tjetri për çështjet organizative, janë mbajtur përkatësisht nga Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe. Mungesa në dokumentacion e referatit të Malëshovës nuk ndjehet aq, sa për shkak të dosjes së bollshme, po më shumë për faktin se Malëshova ato ditë e ka marrë disa herë fjalën dhe i ka dhënë tone analizës. Për sa i përket idesë së një prapaskene, versioni mendoj se është i tepruar. Vetë Velimir Stojnić (më pas Stojnić), i dërguari i Partisë Komuniste Jugosllave për ndihmë në Shqipëri, thotë se kudo ndjehej i penguar në detyrën që kishte marrë dhe se asgjë nuk bëhej pa u pyetur Miladini. Për këtë arsye, puna e parë që bëri, ai i kërkoi PKJ të largonte nga Shqipëria Miladin Popović –in (më tej Popović), i cili kishte drejtuar de facto PKS-hë që prej vitit 1941. Stojnić ndërkohë kishte identifikuar mjaft dobësi në funksionimin e Partisë dhe, më shumë se aq, “në kthesat kryesore, si Mukja dhe Labinoti, qëndrime të paqarta dhe sektare”.<sup>69</sup> Për këtë arsye ai kishte biseduar veçmas me anëtarë të KQ dhe kishte kërkuar prej tyre analizë kritike. Kësisoj, ishte ose jo prapaskenë, Stojnić e arriti atë që dëshiroi, e uli në gjunjë Hoxhën me shokë, duke i vënë ata plotësisht nën tutelën jugosllave e duke bërë të qartë se “pa Jugosllavinë ju nuk mund të mbani pushtetin.”<sup>70</sup>

Për Plenumin e Beratit, ndonëse është shkruar herë pas here, nuk kam ndeshur rreth tij ende një analizë të plotë, e cila do të ishte jo vetëm politike, por edhe ideologjike, sociale e deri psikologjike. Dihet se çështja që përshkoi thujtë gjithë diskutimet ishte sektarizmi i luftës. Por kjo çështje u kthye në çast thelbësor të vetëdijës politike për Sejfulla Malëshovën. Jo se ai ishte më kritiku ndaj praktikave sektare të luftës, jo se ishte më kritiku ndaj Enver Hoxhës, njeriut përgjegjës për inkurajimin e këtyre praktikave, po se për të ishte verifikimi i parë në terren i formimit të tij me komunizmin si ideologji, si filozofi dhe si politikë. Këta komponentë ngërtheheshin në jetën e përditshme, me shokët në vijën e zjarrit, me njerëzit e thjeshtë të popullit, me aleatë e me kundërshtarë. U kthye në çast thelbësor edhe për kthesat e vështira që mori jeta e Sejfulla Malëshovës, ku Berati u shënua si referencë e fshehur për peripecitë që do ta ndiqnin.

---

68. *Politikë antikomuniste e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKS-hë*, Berat 23 – 27 nëntor 1944, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përgatitur nga Prof. Ndreçi Plasari dhe Dr. Luan Mallezi. Tiranë 1996, f. 11.

69. *Po aty*, f. 144.

70. *Po aty*, f. 148.



Emri i tij tashmë ishte bërë vërtet popullor. Në Kongres, Malëshova u zgjodh anëtar i Komitetit të Përgjithshëm të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Në tetor ai u kooptua, nga kandidat, në anëtar i KQ dhe i Byrosë Politike, ndërsa Hoxha e caktoi ministër për Propagandën dhe Kulturën Popullore në qeverinë e përkohshme.

Koha kur Malëshova mbërriti në Labinot, korrik 1943, përkoi me marrëveshjen që u bë në Mukje me Ballin Kombëtar dhe që u pasua me prishjen e saj nga komunistët. Sejfullai u pajtua me analizën që iu bë kësaj çështjeje në Plenumin e Beratit. Thelbi i asaj analize ishte se me Ballin që ndjekur një politikë oportuniste deri në mbledhjen e Labinotit në shtator, kur u demaskua publikisht Mukja. Pas asaj mbledhjeje të gjithë pranuan se nga oportunizmi u kalua në sektarizëm. Vetë Hoxha ka pranuar se “nga oportunizmi i parë u hodhëm në një sektarizëm të ekzagjeruar... Ne u hodhëm në luftë me Ballin... Labinoti ishte mbledhja karakteristike që tregonte panikun tonë para situatës së krijuar... Me Labinotin ne ia dhamë përgjigjen popullit dhe Ballit dhe njëkohësisht i dhamë atij armën për të na luftuar, duke na akuzuar si shkaktarë të prishjes së marrëveshjes dhe të vëllavrasjes.”<sup>71</sup> Për hir të vërtetës, Hoxha i bëri këtij rasti analizën më kritike, e cila mbeti për të e vetmja. Por ishte prof. Malëshova ai që e shpjegoi thjesht si kishte ndodhur kalimi nga oportunizmi me Ballin në sektarizëm, për më tepër në kundërvënien me vendimet e strukturave të luftës. “...pas Mukjes, në vend që të shkonim t’i takonim ata të Ballit, bëmë Konferencën e Labinotit, ku e dënuam Mukjen, thotë ai. Ky ishte një gabim. Megjithatë në Labinot u vendos të mos e godisnim Ballin me armë, kurse ne nisëm menjëherë luftën me armë kundër Ballit, në kundërshtim me Rezolucionin e Labinotit. Ky ishte një provokim që bëmë ne dhe që e detyruam Ballin të hidhej në prehrin e reaksionit e të okupatorit. Ne u hodhëm kështu nga oportunizmi në sektarizëm. Eksperienca ka treguar se deviacionet nga e djathta tek e majta, shkojnë bashkë, janë vëllezër.”<sup>72</sup>

71. Po aty, f. 24 – 25.

72. Po aty, f. 128.

“

Unë jam çuditur kur kam dëgjuar të thuhet se, sa më brutal e terrorist të jetë një njeri, aq më komunist është. Ky është kriter i gabuar. Kështu, në Partinë tonë po duken simptomat e degjenerimit, nga një parti politike, në një bandë kriminelësh.

Sejfulla Malëshova

”



Por e keqja shkon edhe më tej. Malëshova shpjegoi atë që po ndodhte jo vetëm me kundërshtarin, por edhe brenda familjes, duke vizatuar atë pamje të frikshme të transformimit të një partie politike në një bandë kriminelësh. “Për herë të parë këtu unë mora vesh si u vra Mustafa Gjinishi dhe nuk e kuptoj përse, – tha Malëshova. Një nga të dyja: ose ai ka qenë tradhtar i Partisë dhe i popullit dhe, si i tillë, ai duhej të dënohej hapur, ose ai ka bërë vetëm gabime dhe për gabime nuk dënohen njerëzit. Përveç kësaj, mënjani ne e vrasim Mustafa Gjinishin, në anën tjetër, ne e paraqesim atë si hero përpara popullit dhe Partisë. Këto metoda jezuite nuk kanë të bëjnë fare me një parti komuniste. Terrorizmi, si në popull, si në ushtri, si në parti, tregon, së pari, dobësinë e vijës sonë politike, së dyti tregon mosbesimin në popull, së treti, tregon se ne nuk kemi lidhje me masat. Terrori si sistem në historinë e lëvizjes revolucionare, gjithnjë ka qenë i lidhur me mosbesimin në popull, ka treguar dobësinë e atyre që e kanë përdorur. Nuk bëhet mobilizimi i masave me terror. Fakti që në parti s’është kuptuar kjo gjë, tregon se në çfarë niveli teorik e politik qëndron Partia jonë. Me terror po i zgjidhim të gjitha punët. Donim të provokonim Muharrem Bajraktarin dhe për këtë ne i binim prapa krahëve. Kjo s’ka të bëjë fare me një politikë komuniste. Unë jam çuditur kur kam dëgjuar të thuhet se sa më brutal e terrorist të jetë një njeri, aq më komunist është, d.m.th i masim shokët nga brutaliteti dhe kriminaliteti. Ky është një kriter i gabuar. Kështu në Partinë tonë po duken simptomat e degjenerimit nga një parti politike në një bandë kriminelësh.”<sup>73</sup>

Nga fjalët e Malëshovës kuptojmë simptomat e një konflikti, ende në embrion, midis doktrinės dhe praktikave për instalimin e pushtetit në Shqipëri. Doktrina është pjesë e formimit politik e kulturor të brezit të komunistëve të Moskës. Ndërsa praktika ishte ajo çfarë po u shihnin sytë në atdhe e që tek Malëshova prodhonte revoltë. Ndjesi që komunistët shqiptarë dhe jo vetëm e kanë provuar në mënyrë masive, që nga më të hershmit dhe deri tek më të rinjtë. Shumë kanë rënë viktima të idealizmit të tyre, të tjerë kanë provuar modifikimet ose revizionimet. Nuk mund të themi aspak se Malëshova u përket këtyre të fundit. Megjithatë është fakt, siç e përmend ai vetë, se kishte vënë alarmin për çështjet që e shqetësonin, por shqetësimet e tij kishin rënë në vesh të shurdhët. Atëherë ai kishte pritur mbledhjen e Plenumit.<sup>74</sup>

Siç është e njohur, kritikën në Plenumin e Beratit Hoxha i priti me qetësi, ndonëse siç e ka pohuar më vonë, personalisht Berati i kishte djegur shumë.<sup>75</sup> Nuk ka të dhëna që ai t’i jetë kundërvënë ndonjërit prej kritikëve, së paku për njëfarë kohe, për shkak të Beratit. Pra, as Malëshovës, edhe pse më i hidhuri. Përkundrazi, faktet thonë se ai u mbështet shumë tek Malëshova, i cili përveç kulturës e propagandës, mori role harmonizuese për politikën ekonomike të pasluftës, si kryetar i Këshillit Ekonomik, një organizëm ndërministror. Në janar 1945 ai u zgjodh kryetar i Këshillit Administrativ të Bankës së Shtetit Shqiptar. Më shumë se aq, në vitin e parë të pasluftës ai u vu në krye të reformave kryesore në vend dhe u mor sidomos me përgatitjen e zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese.

Tani, po rikthehem aty ku e lamë, te zgjedhjet e përgjithshme dhe, lidhur ngushtë me to, politikën me Frontin. Organizata e Frontit Nacionalçlirimtar u krijua më 26 tetor 1944 në Berat, me përfaqësues të Partisë Komuniste, të Rinisë, të Gruas Antifashiste, delegatë të sindikatave punëtore dhe patriotë pa parti.<sup>76</sup> Deri atëherë termi Front Nacionalçlirimtar përdorej rëndom në të folurën e përditshme, në qarkoret, buletinet e Luftës etj., por nuk ka pasur një organizatë të strukturuar me këtë emër. Madje, edhe sot ka prej atyre që Frontin e dinë si kupolë të këshillave nacionalçlirimtarë dhe sikur qenka krijuar në Pezë, më 16 shtator 1942. Jo, në Pezë është krijuar Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar që, në fakt, ishte në krye të Luftës, ashtu siç këshillat nacionalçlirimtarë në qendrat e banuara u ngritën si organe

73. Po aty, f. 128.

74. Po aty, f. 133

75. AQSH, F. 14/AP-OU, L.1, V. 1946, D. 9, fl. 15. Mbledhje e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 9 qershor 1946.

76. AQSH, F. 876, V. 1944, D. 3. Procesverbal mbi krijimin e organizatës së Frontit Nacionalçlirimtar, 26 tetor 1944.

lufte ose organe pushteti në zonat e çliruara. Ndërsa Fronti Nacionalçlirimtar, si organizatë, nga njësitë më të ulëta e deri në Këshillin e Përgjithshëm, është konceptuar, qëkurse u krijua, tetor 1944, e deri në fund, “si organizatë politike e të gjithë popullit”. Sipas statutit të saj, në organizatë bën pjesë “kushdo që gëzon të drejtat civile dhe pranon programin e Frontit Nacionalçlirimtar.”<sup>77</sup> Edhe një herë: *kushdo që gëzon të drejtat civile*. Siç shihet, në anëtarësinë e Frontit është aplikuar një politikë hapjeje. E njëjta politikë u aplikua edhe për organet e zgjedhura, e përcaktuar po ashtu me statut: “Si organizatë politike e gjithë popullit që është, në këshillat e Frontit Nacionalçlirimtar duhet të përfaqësohen të gjitha grupet e tendencat politike, si dhe patriotët pa parti që marrin pjesë në Front.”<sup>78</sup> Në kërkesë të kësaj klauzole, në Këshillin e Përgjithshëm hynë edhe individë kundërshtarë me komunistët gjatë luftës, me kusht që ata “të mos kishin lyer duart me gjak”. Për disa prej tyre në Konferencë ka pasur reagime, për shkak se midis drejtuesve të Luftës kishte hyrë keq politika e ndarjes “o me ne, o kundër nesh”. Malëshovës, po dhe Bedri Spahiut, iu desh të merren gjatë me delegatët që nuk pranonin disa prej emrave të propozuar për në Këshill, duke u përpjekur t’u shpjegonin atyre se ata individë kishin shumë mbështetës në krahinat e tyre dhe ishte me interes që ata mbështesnin programin e Frontit. Për shembull, Riza Kishta i krahinës së Vërçës ishte njëri prej tyre, për të cilët u fol më gjatë dhe që u pranua jo pa vështirësi. Si ai kishte edhe të tjerë. Ndër ta Cen Elezi, emri i të cilit më vonë u bë simptomatik, ku nuk silllej si shembull. Vitin tjetër, në gusht 1945, organizata e Frontit u mblodh në kongresin e saj të parë dhe që prej asaj kohe e deri në vitin 1991 u quajt Organizata e Frontit Demokratik. Në zgjedhje, në krye të organizatës u vu Enver Hoxha, i cili e mbajti këtë detyrë 40 vjet. Sekretar i përgjithshëm u zgjodh Sejfulla Malëshova. Ky i fundit në Kongres mbajti raportin, ku shpjegoi edhe politikën e zgjerimit të Frontit, sipas të cilës “zgjerimi do të bëhej në radhë të parë, në drejtim të masave neutrale dhe të gënhyera nga okupatori dhe shërbëtorët e tyre. Po, përveç kësaj, ne u hapëm dyert e Frontit dhe atyre që kishin bashkëpunuar me okupatorin, ... atyre që kishin luftuar me armë në dorë kundër nesh, ushtarë dhe oficerë, dhe që ishin hedhur pastaj në radhët tona. Këtë e bëmë, pse në Front të gjithë duhet të kenë shesh të lirë të punojnë për Shqipërinë e Re. Punët treguan se ne kishim të drejtë”, përfundoi Malëshova.<sup>79</sup>

Krijimi i organizatës së Frontit dhe hapja e saj si politikë ishte taktikë e zgjuar. Për hapjen si politikë nuk dimë nëse ishte vërtet mendja e Malëshovës, për çka më pas u bë përgjegjës, ashtu siç është e dokumentuar që Hoxha e ka mbështetur. Gjithsesi, të dyja gjetjet ishin në favor të komunistëve. Përpara ishin zgjedhjet e përgjithshme dhe, kuptohet, Hoxha kishte nevojë që Aleatët ta njihnin qeverinë e tij të përkohshme para se të mbaheshin zgjedhjet. Por Perëndimi kishte kushtet e veta, më kryesorja kërkonin zgjedhje të lira, me të drejtë përfaqësimi të individëve dhe grupeve politike. Këtë kërkesë e përmbante edhe “Deklarata për Evropën e Çliruar” e Konferencës së Krimesë, shkurt 1945. Por kjo nuk ishte punë e lehtë. Hoxha e kishte ndarë shqetësimin me anëtarët e Komitetit Qendror, se qeveritë si kjo e tij Perëndimi nuk i donte, pasi sipas tyre, “këto janë qeveri komuniste, prandaj këtu s’ka demokraci, ka diktaturë të një partie, që është ajo komuniste dhe prandaj këto zgjedhje bëhen në kondita jo të lira.”<sup>80</sup> Taktikat me Frontin lidhen pikërisht me këto zgjedhje. Qëkurse u krijua organizata, Partia Komuniste u paraqit si njëra nga organizatat përbërëse të Frontit dhe që u strehua nën kupolën e tij politike. Në zgjedhje ajo nuk u paraqit si subjekt zgjedhor më vete. Kandidatët e saj u shpallën përmes organizatës së Frontit. Por nëpër këshillat e Frontit kishin ardhur edhe ata që njiheshin si kundërshtarë me komunistët. Për t’i dhënë një pamje gjoja pluraliste disa prej tyre u përfshinë në lista. Ky ishte një truk i komunistëve, për të zbutur mungesën e përfaqësuesve nga organizata të tjera politike, çka ligji e përmbante. Të vetëdijshëm se kjo ende ishte e pamjaftueshme, komunistët përmes Malëshovës hynë në

77. AQSH, F. 40/1/Fronti Nacionalçlirimtar Shqiptar, V. 1944, D. 1. Konferenca e Parë e Frontit Nacionalçlirimtar, mbajtur në Beratin e çliruar, më 26.10.1944.

78. Po aty.

79. “Situata politike dhe detyrat e Frontit, raport në Kongresin Parë të Frontit Demokratik të Shqipërisë”, më 5 gusht 1945, në: Sejfulla Malëshova (Lame Kodra) Vepra 3, Tiranë, Argeta – LMG, 2017, f. 347.

80. AQSH, F. 14/AP-OU, L. 1, V. 1945, D. 2, fl. 8. Plenumi IV i KQ të PKSH, 17. 10. 1945.

biseda me Klerin Katolik të Shkodrës për mundësinë e përfaqësimit të tyre, por katolikët e pikasën se oferta nuk ishte tjetër përveçse nevojë e komunistëve për një fasadë antikomuniste.

Si reagim ndaj lojës së komunistëve, Gjergj Kokoshi, anëtar i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, ministër i Arsimit, në mbledhjen e Këshillit, më 27 shtator, kundërshtoi ligjin për zgjedhjet. Ai i kërkoi Këshillit që “në Asamble përbri njerëzve të luftës të shkojnë dhe njerëzit e paqes,” të zotë për sakrificë, me dinjitet njerëzor dhe me ideale të nalta për atdheun. Kësi njerëzish ka edhe jashtë Frontit e duen me mbetë si të tillë, tha ai. Por ata janë të destinuar të dështojnë. Ata nuk janë në listat e Frontit, pasi në listat e Frontit janë njerëzit e shtetit.<sup>81</sup> Ky rast duket e ka shqetësuar Enver Hoxhën, pasi ka kuptuar se Kokoshi nuk ishte vetëm dhe se ai dhe të tjerë rreth tij, të pamundur për konkurrencë elektorale, do të shfrytëzonin Frontin për të hyrë në Asamble dhe aty në Asamble do të krijonin parti ose grup opozite.<sup>82</sup> Në fakt, kështu ndodhi. Atë çka komunistët ia arritën të ndalonin, një opozitë nga jashtë, kundërshtarët e morën nga brenda në Asamble, falë hapësirave që vetë komunistët kishin krijuar. Në këmbim, Perëndimi njohu qeverinë e përkohshme të Hoxhës, ashtu siç njohu edhe zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945.

Kur komunistët ishin ende në euforinë e fitores me mbi 93 për qind të votave, Enver Hoxha njoftoi Byronë Politike se kursi kishte ndryshuar. Ai u tha kolegëve se vija e Partisë, si në politikën me Frontin, si në ekonomi, ashtu edhe në propagandën për Aleatët, ishte dominuar nga oportunizmi dhe se oportunizmit, tonin ia kishte dhënë Sejfulla Malëshova.<sup>83</sup> Diskutimet kanë zgjatur pesë ditë, nga 6 deri më 10 dhjetor. Ne nuk kemi mundur të gjejmë asgjë nga regjistrimet e asaj mbledhjeje, përveçse konkluzioneve telegrafike me tri pika për oportunizmin që kishte kapur Partinë, nën influencën e Malëshovës. Nisur nga kohëzgjatja, diskutimet duhet të kenë qenë të vështira, por Hoxha nuk është tërhequr, derisa i ka sjellë aty ku donte gjashtë anëtarët e tjerë të Byrosë, përjashtuar Malëshovës. Më 11 dhjetor ata kanë hedhur firmat në dokumentin me tri pika dhe kanë vendosur që analiza të vijohej në plenum të Komitetit Qendror. Sa i përket Gjergj Kokoshit, ai kishte dhënë dorëheqjen si ministër dhe bashkë me të tjerët që ishin marrë me krijimin e opozitës, në janar u arrestuan dhe gjykata dha për ta dënime vërtet të rënda.


Po çfarë po ndodhte me Malëshovën? Rasti na ndihmon për të kuptuar një dukuri tipike në partitë komuniste, ashtu siç ndihmon për të kuptuar rolin e njeriut më me autoritet në parti, për aq kohë sa e ushtroi këtë rol. Për shumë kohë emri i Malëshovës, ndëshkimi që ai mori, nuk është lidhur me shkurtin e vitit 46, kur ai u shkarkua nga funksionet në parti e as me vitin 1948, kur u largua për fare nga Partia. Thënë shkurt, emri i Malëshovës nuk lidhet me kinse oportunizmin e tij, po me historinë e mëhershme të Beratit, kur ai qe ngritur kundër sektarizmit në parti dhe në udhëheqjen e luftës. Prandaj në opinion, ndryshimi i kahjes së goditjes, nga sektarizmi kundër oportunizmit, u kuptua si kthim i restos, një fillim gjuetie nga ana e Hoxhës.

Mendoj se ky opinion përmban një pjesë të së vërtetës. Hoxha e kishte marrë Beratin si komplot të të gjithëve kundër tij, orkestruar nga Stojniçi. Tani është Hoxha që i bën bashkë të tërë kundër më kritikut prej tyre, Malëshovës. Ashtu siç do t’ia gjente anën ta kthente dhe vetë Stojniçin nga kishte ardhur. Kjo luftë brrylash është e zakonshme në hierarkitë e pushtetit, jo vetëm në ato komuniste. Në rastin tonë çështja shkon më përtej personales. Regjimet komuniste e kanë provuar se dhuna e frika do të thotë siguri pushteti, ndërsa lëshimet përbëjnë rrezik. Për këto regjime sektarizmi është rregulli, ndërsa oportunizmi është përjashtim nga rregulli. Po e marrim për një çast të mirëqenë se Hoxha bashkë me

81. AQSH, F. 489/Presidiumi i Kuvendit Popullor, V. 1945, D. 83, fl. 71-72. Mbledhja e Tretë, Seanca V e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, më 27 shtator 1945.

82. AQSH, F. 14/AP, L. 1, V. 1945, D. 2, fl. 9. Plenumi IV i KQ të PKSH.

83. AQSH, F. 14/AP – OU, L. 1, V. 1945, D. 4. Mbledhje e Byrosë Politike të KQ të PKSH, 6 – 10 dhjetor 1945.



AIDSSH, Dosje formulare nr. 587-A, kategoria 2/A, për Sejfulla Malëshovën.

të tjerët rrëshqitën në oportunitizëm, duke u hapur rrugë kundërshtarëve të pushtetit të bëheshin pjesë e tij. Me siguri, Hoxha e kishte kuptuar me kohë rrezikun për pushtetin e tij. Megjithatë e ka pranuar për oportunitet politik në raport me koniunkturën e kohës. Kur ranë koniunkturën, ai shpejtoi të rivendosë situatën.

I vetmi që nuk u pajtua me shefin e Partisë ishte Malëshova, i cili vazhdoi të këmbëngulte se 'në vijën tonë jo vetëm që nuk ka dominuar oportunitizmi, por e kundërta'. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me dy qasje. Njëra, e Hoxhës që i pranon lëshimet politike për rrethanat ndërkombëtare dhe shpejton t'i korrigjojë, sapo erdhi rasti. Tjetra, e Malëshovës, që nuk i konsideron lëshime, po të drejta politike të natyrshme dhe për këtë arsye nuk sheh as nevojë për ndreqje. I pari përdor një taktikë politike, ndërsa i dyti veprimet i ndërmerr në pajtim me bindjet e veta.

Po pse kjo diferencë, kur si njëri ashtu edhe tjetri kanë pirë ujë në të njëjtin burim? Doktrina komuniste të ardhmen në barazi dhe me nevoja të përmbushura, të ardhmen pa shtet e pa dhunë e projekton përmes shtrëngesës, e projekton me diktaturën e një klase ndaj një tjetre. Këto mësimë Malëshova i ka marrë, si shumë të tjerë, që në rininë e vet dhe është formuar sipas tyre. Por rrethanat e kanë sjellë të ketë qenë edhe pjesë e evoluimeve taktike të partive komuniste në rrafsh ndërkombëtar. Kur ai përfaqësonte

Grupin Komunist Shqiptar në Kongresin e Kominternit, më 1928, komunizmi evropian ishte në kulmin e bolshevizimit të tij. Por më 1934, kur Malëshova ishte në marrëdhënie aktive me Kominternin, për shkak të detyrave që kishte lidhur me grupet komuniste në Shqipëri, atëherë “filozofia e sektarizmit ishte rrëzuar në favor të një fronti të bashkuar me të gjitha forcat antifashiste”<sup>84</sup> dhe socialdemokratët nuk shiheshin më si socialfashistë dhe krahu i djathtë i borgjezisë. Për të vazhduar më tej, është kjo marrëdhënie koalicionesh gjatë luftës që diktoi qeverisjet me koalicion pas luftës, ku komunistët të dominonin pushtetin, aty ku ishte e mundur, por jo monopol. Pikërisht për këtë arsye hyri termi i *demokracive popullore* dhe ku “Stalini inkurajonte udhëheqësit e demokracive popullore të mendonin për rrugët nacionale, individuale për në socializëm”.<sup>85</sup> Sot opinionet për demokracitë popullore të pasluftës janë më të ftohta, pasi për disa studiues ky ka qenë më shumë “një kamuflazh që Stalini dhe shokët e tij e përdorën për të mashtruar Perëndimin”, dhe se “Demokracia popullore nuk ishte aspak demokraci, sepse ideja dhe realiteti i qeverisë parlamentare ishin tërësisht të papranueshëm për sovjetikët.”<sup>86</sup>

E solla këtë shpjegim jo për të thënë se Malëshova kishte njohje teorike për rrugët e kalimit në socializëm dhe si do të ishte ky socializëm, por se ai më së pari njihnte orientimet e ditës për këtë çështje. Sigurisht, njohja e parimit, njohja e taktikave, e udhëzimeve, njohja edhe e terrenit shqiptar kanë krijuar një bindje të caktuar, e cila jo gjithmonë ka qenë e njësuar me bindjen e të tjerëve. Fundja, kjo ka ndodhur edhe me partitë të cilat për shkak të rrethanave kanë ndryshuar orientimet e jo më për individët. A nuk ishin rrethanat ato që inkurajuan fraksionet komuniste brenda partive socialiste ose socialdemokrate pas Luftës së Parë Botërore dhe që u kthyen në parti? A nuk ishin këto parti fraksione që njëherë u armiqësuan aq keq me partitë mëmë dhe pastaj ato bashkërisht ndërtuan koalicione? Për të ardhur deri në ditët tona, a nuk ishte komunizmi që u shkërmoq ‘sa hap e mbyll sytë’, ndërsa partitë u ‘përshtatën’ po aq shpejt dhe në mënyrë të pabesueshme, duke u kthyer edhe ato brenda ditës, nga komuniste në socialiste? Kësi konvertimesh, më parë se te grupet sociale dhe politike, ndodhin tek individët që pastaj u prijnë ndryshimeve. Mendoj se këto reflektime dhe verifikime kanë ndodhur gjatë dhe pas luftës edhe te komunisti Sejfulla Malëshova. Prandaj kur në Plenumin V të Komitetit Qendror, shkurt 1946, ai shpjegoi se zgjerimin e Frontit dhe të qeverisë e kishin këshilluar ‘edhe sovjetikët, edhe jugosllavët’, që në Shqipëri ‘të mos dukej se qeveria është me komunistë’<sup>87</sup>; e gjitha kjo Malëshovës duhet t’i ketë ardhur për mbarë të mos e merrte thjesht si këshillë për kozmetikë.

Me të njëjtin arsyetim do ta shpjegoja gatishmërinë e Malëshovës për të mbështetur krijimin e partive të tjera, siç ndodhi me partinë socialdemokrate e në tentativë ndoshta edhe një parti republikane. Për këtë çështje ka disa rekorde, kryesisht në vjeshtë 1943, por edhe më 1944. Shpjegimet më të plota si dhe nga kush u krijua Partia Socialdemokrate, më 1943, i ka dhënë Musine Kokalari, përfshirë dhe kontaktet me drejtues në partitë e tjera, por ajo nuk e zë në gojë të ketë pasur kontakte për këtë qëllim me Malëshovën.<sup>88</sup> Të dhëna dokumentare paralele vijnë edhe nga kampi i komunistëve, ku sekretari i Qarkorit të PKSH për Tiranën Gogo Nushi e ka informuar Hoxhën për lëvizjen brenda

84. Donald Sasson, “Social Democracy”, në: *A Dictionary of 20<sup>th</sup> – Century Communism*, Edited by Silvio Pons and Robert Service, Princeton and Oxford: Princeton University Press, 2006, p. 717.

85. Norman M. Naimark, “People’s Democracy”, në *A. Dictionary of...* p. 608.

86. Po aty, p. 610.

87. *AQSH*, F 14/AP-OU, L.1, V. 1946, D. 1/1, fl. 36. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit V të KQ të PKSH, më 21 shkurt – 3 mars 1946.

88. Musine Kokalari, Si lindi Partia Socialdemokrate, në *Vëpra*, vëllimi i dytë, përgatiti Novruz Xh, Shehu, Tiranë: Shtëpia Botuese Geer, 2009, f. 387 – 440. Këtë punim Kokalari e ka shkruar më 1972, në Rrëshen, kur ishte e internuar. Ajo shpjegon se këtë parti e kanë krijuar bashkërisht katër vetë, Musine Kokalari, Skënder Muço, Isuf Luzaj dhe Selman Riza. Ajo ka kërkuar mbështetje nga Mithat Frashëri dhe Hasan Dosti, po nuk e kanë inkurajuar. Të njëjtën gjë ka bërë edhe me Nexhmije Xhunglinin, e cila e ka kundërshtuar. Në nëntor 1945, ajo bashkë me disa nacionalistë u kërkuan misionet të Perëndimit në Shqipëri të ndërhyjnë te qeveria shqiptare për të shtyrë datën e zgjedhjeve, me qëllim që t’u jepej partive më shumë kohë përgatitore për zgjedhje. Më 23 janar Kokalari u arrestua me akuzën e përpjekjeve për të rrëzuar pushtetin popullor.

Ballit Kombëtar, kur anëtarë të kësaj partie Skënder Muço, Mithat Aranitasi, Isuf Luzaj e të tjerë nga Vlora kanë bërë disa takime në Tiranë me moton se “Balli u diskreditua, prandaj duhet të formojmë diçka tjetër.”<sup>89</sup>

Të dhëna për një parti socialdemokrate me Llazar Fundon, Dhimitër Paskon, Selman Rizën dhe Anton Lufin “dhe me të tjerë ish zjarrista” Hoxhës i shkojnë edhe më 1944.<sup>90</sup> Por ndryshe nga vjeshta, këtë herë Hoxha duket se u ka dhënë rëndësi njoftimeve me këtë temë. Kjo shihet në letrat që ai i dërgon Nako Spirut në mars 1944. Në të parën ai i shkruan Nakos se “për çështjen e Partisë Social Demokrate ... mua Sejfullahu s’më ka fjalosur aspak dhe unë s’jam i mendimit që ne të vëmë forcat për ta krijuar dhe të largojmë elementa nga fronti gjoja për t’i afruar.”<sup>91</sup> Në letrën e dytë Hoxha është i prerë, kur shprehet se “nuk është nevoja që këta elementë të formojnë një Parti ose Parti të ndryshme në radhët e Frontit, por kjo është edhe ca më keq kur vetë ne bëhemi shtysa për këtë. Të përpiqemi me të tjera mënyra t’i shtojmë radhët e Frontit dhe ta zgjerojmë Frontin.” Hoxha i kërkon Nakos t’i thuhet Isuf Luzit, person me përgjegjësi në Partinë Socialdemokrate, por edhe në rreshtat e Ballit Kombëtar, se nuk është vendi i tij tek Balli, pasi “bashkëpunëtorët e tij sot janë në tradhti të hapët, ...” dhe se “do t’i vlejë shumë atdheut, në qoftë se shpëputet nga rreshtat e tradhtarëve dhe hidhet në rreshtat e Frontit Nacionalçlirimtar, derisa nuk bëhet tepër vonë.”<sup>92</sup> Hoxha porositi që letrën ta shkruante Nako dhe ta firmoste Sejfullai, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Përgjithshëm NÇL. Duket hapur se Hoxha nuk ka besim që Sejfullai do ta shkruante me përmbajtjen dhe tonet që ai udhëzonte një letër me këtë temë.

Versioni më i besueshëm në këtë histori dhe që e provoi koha, është se Hoxha dhe Malëshova kishin dy qasje të ndryshme për këtë çështje. I pari iu mbajt versionit të hershëm bolshevik, sipas të cilit komunistët do ta merrnin dhe do ta mbanin të vetëm pushtetin. Ndërsa i dyti duket se ishte partizan i idesë se një demokraci popullore do të thoshte demokraci më e gjerë përfaqësuese dhe kështu socialdemokratët do të ishin të favorizuar për të qenë pjesë e pushtetit të udhëhequr nga komunistët. Kjo ide e përpunuar nga Kominterni vazhdonte të ishte ende direktivë për partitë komuniste. Nëse Malëshova nuk pati mundësi të punonte hapur që pikërisht një direktivë si ajo të gjente zbatim në Shqipëri, gjithsesi duket se ai e pëlqente si ide. Kjo duhet të jetë arsyeja që për Malëshovën të ketë zënë vend mendimi që sjellja e tij politike më shumë se e një komunisti ishte ajo e një socialdemokrati. Prandaj dhe Hoxha nuk nguron të thotë se Malëshova “nga ana politike ka qenë një oportunist i fëlliqur në shërbim të borgjezisë e që edhe sot nuk i ka njohur gabimet e tij, se nuk është aspak marksist, megjithëse me fjalë pretendon të jetë i tillë dhe që përdor shpesh parulla marksiste.”<sup>93</sup> Sidoqoftë, është krejt e besueshme që Malëshova të ketë qenë i interesuar që një parti e tipit socialdemokrat të ishte pjesë e demokracisë popullore. Këtë mendim e përforcojnë edhe disa prirje të tij që janë vërejtur në fjalimet politike dhe në rekomandimet për ekonominë.

Malëshova u shënjestrua për oportunitizëm edhe në dy drejtime të tjera, në politikën ekonomike dhe në qëndrimin ndaj anglo-amerikanëve. Akuza për të parën: politikë oportuniste inkurajuese me privatin dhe mungesë politikash për forcimin e sektorit të shtetit. Akuza për të dytën: ka vënë në një plan, si marrëdhëniet me anglo-amerikanët, ashtu edhe me sovjetikët. Me anglo-amerikanët për të krijuar përshtypjen e një demokracie të gjerë liberale, me qëllim njohjen e qeverisë nga ana e tyre. Ndërsa sovjetikët ... , miqtë tanë të vërtetë që na njohën pa kushte ... dhe ... po na ndihmojnë pa rezerva, ...

89. AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 26, fl. 25. Letër e Gogo Nushit për Enver Hoxhën, datë 16.10.1943.

90. Po aty, F. 14/APL, V. 1944, D. 45, fl. 2/1. Shevqet Musaraj i shkruan Enver Hoxhës, 13.5.1944.

91. Po aty, F. 14/APL, L. 1, V. 1944, D. 76, fl. 11/1. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, pa datë, por nënkuptohet muaji mars.

92. Po aty, F. 14/APL, L. 1, V. 1944, D. 76, fl. 12/1. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, 2 mars 1944.

93. AQSH, F. 14/AP, L. 1, V. 1949, D. 2. Fjala e Enver Hoxhës në Plenumin III të KQ të PPSH, më 13. 10. 1949.

u vunë në një plan me anglo-amerikanët.<sup>94</sup> Nga të dyja kritikrat, Malëshova pranoi vetëm të dytën. Edhe për këtë jo se kishte gabuar në qëndrime ose mesazhe politike, po se ai personalisht nuk e kishte menduar që midis Aleatëve “këto çështje do të dilnin kaq shpejt dhe kaq të ashpra”.<sup>95</sup>

Mund të ndalesh gjerë e gjatë në dallimet programore të tezave politike, ekonomike, kulturore e sociale të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe tezave të Malëshovës. Ato për një kohë, së paku gjatë vitit 1945, kanë qenë njësh, që do të thotë se teza e Malëshovës kanë qenë edhe teza të Partisë. Ndryshimi fillon në fund të atij viti, kur u kërkua rishikimi i vijës së deriatëhershme të Partisë dhe kur aty u vërejt se kjo vijë e gabuar mbante autorësinë e Malëshovës.

Në historinë e Partisë Komuniste e më pas të Partisë së Punës, ka shembuj që drejtues të lartë në parti e në qeveri, kanë marrë dënime të ashpra, deri edhe dënime kapitale, jo për mospajtime thelbësore në ndërtimin dhe zbatimin e vijës në një ose në disa fusha të caktuara, por për kundërshtime të dorës së dytë. Ka po ashtu mjaft raste kur ‘besnikë të Partisë’ janë dënuar deri edhe me vdekje me akuzën e ‘armikut të Partisë’.

Rasti i Malëshovës nuk hyn në këto kategori. Në fakt, ai përgatiti dhe zbatoi në fusha të caktuara politika, të cilat Enver Hoxha ndërhyri dhe i ndryshoi. Po pranojmë se Malëshova, kuptohet me miratimin e Hoxhës, kishte bërë lëshime ndaj “reaksionit”. Po kjo ndodhi se ishte pikërisht ai Hoxhë që kontribuoi që grupe shoqërore me një traditë atdhetare të viheshin përkrah pushtuesit. Ata e përgatitën vetë fatin e tyre të palavdi. Ishin pikërisht komunistët ata, të cilët që gjatë Luftës e lanë vendin djallëzisht pa opozitë. Atëherë u gjend një formulë tjetër, ajo e zgjerimit të Frontit në nevojë për pak më shumë hapësirë lirie. Por Hoxha, ndoshta i këshilluar nga jashtë, i ka dhënë fund dilemës, zgjedhjet e 2 dhjetorit do të ishin të parat dhe të fundit, kur brenda të njëjtit subjekt zgjedhor, siç ishte organizata e Frontit Demokratik të Shqipërisë, do të kishte hapësirë për kundërshtarët, apo për ata me mendim ndryshe. Praktika e zgjedhjeve ishte fundamentale dhe për t’u ndryshuar ajo do të duhej të godisje mbështetësit e saj. Sejfulla Malëshova ishte kurban i parë. Masakra do të ndodhte pak më vonë kur, ashtu siç pritej, brenda Kuvendit u tentua për një opozitë nga brenda. 22 persona, pjesa më e madhe deputetë, u dënuan me vdekje me akuzat për krijim grupesh ilegale, për bashkëpunim me kriminelë, me qëllim përmbysjen e pushtetit me dhunë, etj. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për përbërjen e organizatës së Frontit, si e projektoi Malëshova dhe si u kthye pas rënies së tij. Malëshova e shihte organizatën si shtëpinë e të gjithëve, përjashtuar atyre që me vendim gjyqësor kishin humbur të drejtat civile. Thënë ndryshe, organizata që konceptuar si një mjedis i hapur idesh dhe kundërshti opinionesh. Ajo ndryshoi krejtësisht, kur u instalua regjimi i pastër i terrorit. Organizatës së Frontit, Hoxha u kujdes t’i jepte fytyrën e Partisë dhe, më tepër se aq, e ndërseu në fushata demaskimesh publike ndaj cilitdo që nuk u përshtatej rregullave të regjimit. Edhe pasi e nxori partinë nga ilegaliteti, organizatën e mbajti gjithë kohën subjekt të vetëm elektoral.

Më tej. Pak për politikën ekonomike dhe politikën fiskale. “Fronti Demokratik nuk është kundër pronës private, tha Malëshova në një konferencë për zgjedhjet në shtator 1945. Fronti Demokratik në politikën e tij ekonomike e quan një gjë të domosdoshme aktivizimin e industrisë private nacionale, që kemi sot në Shqipëri.” E të tjera. Ndërsa pesë muaj më vonë, në Plenumin V, Hoxha lëshoi thirrjen: “Ky është kursi që duhet të kemi në ekonomi. Çdo gjë për forcimin e sektorit të shtetit, luftë të pamëshirshme kapitalit privat...”<sup>96</sup> Po aty Hoxha e kritikon Malëshovën se në përgjegjësinë e kryetarit të Këshillit Ekonomik jo vetëm e kishte lënë pa kontroll sektorin privat të ekonomisë, por premtonte ndihmë në kredi etj.

94. AQSH, F 14/AP-OU, L.1, V. 1946, D. 1, fl. 8, 10, 19, 20, 21. Referatat dhe konkluzionet e Plenumit V të KQ të PKSH, 21 shkurt 1946.

95. AQSH, F 14/AP-OU, L.1, V. 1946, D. 1/1, fl. 4. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit V të KQ të PKSH, 21 shkurt 1946.

96. Po aty, fl. 13.

Duket se këtu kemi të bëjmë me dy politika të ndryshme që vijnë njëra pas tjetrës. Të parat kanë qenë të Malëshovës, por të pranuar edhe nga të tjerët dhe që iu nënshtruan një analize të gjatë në parti. Nga analiza, ata që folën në shumicë thanë se nuk e kishin kuptuar ku po shkonin me këto politika lëshuese e liberale. Thanë po ashtu se nuk kishin kuptuar se vendi kishte hyrë në një rend të ri të ndërtimit të socializmit dhe që partia të udhëheqë, tha Nako Spiru, duhet të zhvillojë luftën e klasës. Me këtë arsyetim, partia duhej karikuar me vullnetin për luftë, duhej ngarkuar me urrejtje për kundërshtarët. Kjo lloj politike ishte e ndryshme nga ajo e Malëshovës, kur në një mbledhje të Kryesisë së KNÇ ndërsa diskutohej projektligji mbi tatimin e jashtëzakonshëm për fitimet e luftës që propozuar që tatimi të fillonte me dyshemenë 100 mijë franga. Ç’është kjo, tha Malëshova, e ç’janë 100 mijë franga?! Me sa duket episode të këtij lloji janë regjistruar dhe e kanë ngarkuar dosjen për oportunitizëm. Në përfundim të arsyetimit, pranojmë se ka dy konceptime politikash ekonomike, ashtu siç ka një praktikë të njësuar e të pranuar, por që u kërkuar dhe u pranuar të ndryshohet pas një lumi kritikash dhe autokritikash. Në këto kushte të gjithë e hodhën lumin, dhe u shprehën për reflektim. I vetmi që ndenji në pozitë e para ishte Sejfulla Malëshova. Autokritika e tij që për episode krejt periferike. “Unë i pranoj gabimet, tha ai në mbyllje, por jo ato që s’kam bërë dhe ato që nuk mendoj se janë gabime.”<sup>97</sup> Ai nuk mund të ndiqte rrjedhën e të tjerëve, një mënyrë që praktikohesh shpesh në forumet e asaj kohe? Mendoj se kishte mundësi ta bënte. Po nuk e bëri se do t’i vihej kundër vetvetes, kundër bindjeve. Bindjet, vetëdija për atë çfarë je, janë thelbi i njeriut.

Plenumi V i Komitetit Qendror e largoi Malëshovën nga funksionet partiake, por e mbajti për një kohë ministër të arsimit, detyrë që e kishte marrë pas dorëheqjes së Gjergj Kokoshit. Duket se Enver Hoxha ka qenë i vendosur për të nisur serinë e spastrimeve me motive të luftës kundër oportunitizmit në parti dhe në jetën e vendit. Në anën tjetër mund të vërehet njëfarë pasigurie, kur është fjala për ta bërë publik ndëshkimin. Në procesverbalin e mbledhjes shënohet:

“Shulja (Kristo Themelko) pyet nëse do t’u thuhet organizatave për përjashtimin e Sejfullait.

Komandanti: Do t’u thuhet Komitetit Qendror (fjala duhet të jetë për aparatën e KQ) dhe shokëve më të mirë”<sup>98</sup>.

Ky rast hap serialin e praktikave ekstreme, si vijë sjelljeje për regjimin. Malëshova u pasua nga rasti tjetër, ai i Tuk Jakovës, atë kohë numri dy në parti, pas Hoxhës. Edhe ky për oportunitizëm, shpirtbutë me armikun e klasës. Si fillim, të dy ata u cilësuan si udhëheqës që kishin gabuar rëndë. Prandaj ata u zhveshën nga funksionet në parti, duke u mbajtur në postet shtetërore. Pastaj për ta u tha se ishin armiq të egër të partisë dhe të shtetit. I pari e kaloi gjithë jetën në internim. I dyti shkoi në burg, ku dhe vdiq, larg kujdesit mjekësor. Që atëherë u pa se për pushtetin e ri, marrë me ‘grykën e pushkës’, sfidat nuk do të ishin të lehta dhe përplasjet e brendshme të pashmangshme.

Është me vend një pyetje nëse ka pasur reagime nga sovjetikët për ndëshkimin e revolucionarit të hershëm, e bolshevikut të 25-ës? Ka qarkulluar mendimi se është marrë pëlqimi i sovjetikëve, pasi Malëshova ka ndjekur politikën e lidhjeve me Perëndimin. Pas hapjes së arkivave kanë dalë edhe dokumentet, të cilat përmbajnë komente në mbështetje të ndëshkimit, por jo të kenë ndërhyrë drejtpërdrejt. Gjithsesi, dokumentet janë interesante dhe nxisin për komente. Mund të veçohen dy nga dokumentet. Njëri është një njoftim i zakonshëm i M. Suslov për sekretarin e KQ A. Zhdanov, më 13 korrik 1946, që është mbështetur në të dhënat që Koçi Xoxe i ka dërguar Moskës. Në këtë njoftim nënvizohet një fakt domethënës që u është raportuar sovjetikëve. Fjala është se “Gjatë shqyrtimit të çështjes mbi Malëshovën anëtarët e Byrosë Politike që e mbështetën atë, Bedri Spahiu – ministri i

97. *Po aty.*

98. *Po aty.*



Rimëkëmbjes së Ekonomisë dhe Tuk Jakova – udhëheqës i Bashkimeve Profesionale shqiptare, ndonëse pranuan gabimet e tyre, treguan shpirtvogëlsi dhe shprehën dëshirën e tyre për të dalë nga përbërja e Byrosë Politike. Daljen e tyre nga përbërja e Byrosë Politike ata e kanë motivuar me paaftësinë për të përballuar detyrat që u ishin ngarkuar atyre. Sjellja e Bedri Spahiut dhe e Tuk Jakovës që dënuar nga shumica e anëtarëve të Byrosë Politike.”<sup>99</sup> Duket se të dy, si Jakova ashtu edhe Spahi, e kanë parandjerë fatin e tyre të ardhshëm. Nuk do të kishte kohë tjetër më oportune për t’u larguar me qetësi nga postet. Por në sistemet komuniste diktatoriale, dorëheqjet nuk janë të mirëpritura, ato konsiderohen dezertim nga fronti. Një dokument i dytë me burim Moskën është një raport i sektorit të jashtëm në KQ të PK (bolshevike) të BS, i vitit 1947, pa datë, “Mbi Partinë Komuniste Shqiptare”, në të cilin vërehet se kjo parti “kohët e fundit ka bërë një sërë gabimesh serioze” dhe se “Radhët e saj janë të mbushura plot me elementë oportunistë, sektarë, përçarës e karrieristë. Në përbërje të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, ka depërtuar një trockist i betuar dhe ideolog i restaurimit të kapitalizmit në Shqipëri, profesor Sejfulla Malëshova”.<sup>100</sup>

Ky dokument flet shumë për qëndrimin sovjetik. Nuk dihet ende nëse ndëshkimi i Malëshovës erdhi me porosi të tyre, po duket e sigurt që Moskë e ka mirëpritur. Po jugosllavët? Ka një varg dokumentesh që tregojnë se jugosllavët janë ta pakënaqur me Malëshovën, për të njëjtat arsye që përfshihen në kritikën e Hoxhës, duke shtuar se ka munguar orientimi për vëllazërim me popujt e Jugosllavisë. Në një dokument thuhet se qëndrimi i Malëshovës ndaj Jugosllavisë është shumë i ftohtë, se ambasadorin e ri ai e ka pranuar më se ftohtë dhe në mënyrë fyese, gati-gati as që ka dashur të flasë me të.<sup>101</sup> Në një tjetër dokument të ministrit fuqiplotë jugosllav në Tiranë thuhet se, sipas Hoxhës, Malëshova bashkë me Dr. Nishanin ka qenë ithtari më i madh të pranoheshin kushtet amerikane për njohjen e qeverisë më 1945 dhe se ai (Hoxha) falënderon për ndërhyrjen e Legatës sonë po atë ditë në mbremje.<sup>102</sup> Për këtë moment flet edhe deponimi që ka dhënë Koçi Xoxe gjatë marrjes në pyetje në hetuesi. Xoxe ka shpjeguar se kur erdhën notat e qeverisë dhe kur Malëshova ka pranuar kushtet e amerikanëve për marrëveshjet, ambasadori jugosllav Josip Gjergjia kishte shkuar tek Enveri, pastaj te Koçi për t’i thënë se edhe sovjetikët nuk ishin dakord që të pranoheshin kushtet amerikane. Çfarë do të bëni me këtë njeri, kishte thënë Gjergjia, duke shtuar se ai kishte folur dhe me Nako Spirun dhe me Komandantin për çfarë bënte Sejfullai. Atë ditë Gjergjia turfullonte, shpjegon Xoxe: “Nuk bën mirë ai Sejfullai. Çfarë njeriu është! Shikojeni mirë punën e Sejfullait!”<sup>103</sup>

Ky është fundi politik i Sejfulla Malëshovës. Për të eliminuar Malëshovën Enver Hoxha kishte mundur të kompaktësonte Byronë dhe më pas Plenumin e Komitetit Qendror. Në radhë ishte Berati, si mënyra më e mirë për t’u rehabilituar vetë Hoxha. Por që të rrëzoje Beratin, duheshin goditur ata që bënë Beratin dhe që Hoxha i kishte përreth vetes. Më 9 qershor ai mblodhi Byronë dhe u vuri në tavolinë tezat për rishikimin e Plenumit të Beratit. Edhe për këtë mbledhje nuk ka procesverbal, ka vetëm disa shënime të Pandi Kristos. Sipas këtyre shënimeve, mbledhja ka nisur shpotitëse kur Hoxha u ka thënë anëtarëve të Byrosë se tani që do të mbajmë Kongresin do të duhet të analizojmë gjithë punën e Partisë, nga Lufta e deri më sot. Pas kësaj Nako Spiru ka pyetur me njëfarë shpotie nëse do të flisnin për Kongresin apo do

99. T.V.Volokitina et al., eds., Восточная Европа, в документах российских архивов, 1944-1953 гг. Том I, 1944-1948 гг., Москва – Новосибирск: Сибирский хронограф, 1997), Документ № 160. Shënim i drejtorit të OVP të KQ të PK të BS (b) M.A.Suslov, për sekretarin e KQ, A.A. Zhdanov mbi gjendjen në udhëheqjen e PKSH. Moskë, 13 korrik 1946.

100. Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse, 1946 - 1962, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë-Tiranë, përgatitës Hamit Kaba-Ethem Çeku, Prishtinë: 2011, f. 40.

101. AJ, CKSKJ, 507. IX., 1. I – 146, K. 2, fl. 2. Informacion i ambasadorit të RFDJ, Josip Gjergjia, në Shqipëri, për situatën politike në RPSH.

102. Po aty, fl. 1.

103. AMB, Fondi i Dosjeve Penale, V. 1949, D. 1623/4. Procesverbal i papërpunuar për marrjen në pyetje të Koçi Xoxes, deponim për datën 10.11.1945.



Kongresi i Përmetit, maj 1944.

Në foto: Ramadan Çitaku, Liri Gega, Hysni Kapo, Sejfulla Malëshova, Haxhi Lleshi, Myslim Peza.

të bënin historikun e Partisë. Hoxha është përgjigjur se do të analizonin punën e Partisë para dhe pas Beratit. Xoxe e ka çuar edhe më tej kur ka thënë: Atëherë ne duhet të bëjmë analizën e punës që nga koha e grupeve komuniste, ende pa lindur partia jonë.<sup>104</sup>

Hoxha e ka ndjerë tensionin e brendshëm, teksa kërkohej rikthimi në një çështje të nxehtë, ku ishin përfshirë të gjithë. Për këtë arsye e ka çuar analizën në një kohë të dytë. Nako Spiru ka takuar Gjergjian, i ka dhënë tezat, duke kërkuar ndërhyrjen e jugosllavëve.<sup>105</sup> Gjergjia e ka vënë në dijeni Xoxen për spiunimin e Spirit, ndërsa Tito ka thirrur Enverin në Beograd në krye të një delegacioni të madh. Tito e ka mbyllur çështjen me Enverin, duke u shprehur për të dërguarin e tij të mëhershëm, Stojnić se kishte bërë disa veprime partizançe. Ai e kishte tërhequr Stojnićin në Jugosllavi dhe në vend të tij solli Sava Zlatić (më tej Zllatiç).

Përmbledhtas, Sejfulla Malëshova mbetet nga figurat më interesante të historisë së komunizmit në Shqipëri. Më 1928, në Ditën Kombëtare të Pavarësisë, në *Lirinë Kombëtare* ai bënte orakullin se “Shqipërinë do ta shpëtonte vetëm revolucioni, vetëm diktatura e punëtorëve dhe e fshatarëve.”<sup>106</sup>

104. AQSH, F.14/AP-OU, Dosje pa emër, V.1946. Shënime të Pandi Kristos në mbledhjen e Byrosë Politike, më 9.6.1946.

105. AJ, CKSJK, 507/IX, I/IV – 205. Shënim sqarus rreth dokumentit mbi tezat për rishikimin e Plenumit të Beratit paraqitur në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 9.6.1946 dhe përfshirë në Librin e Bardhë për Shqipërinë.

106. 1912 – 1928, Liria Kombëtare, 28 nëntor 1928, në: Sejfulla Malëshova, Vepra..., f. 61. ★ Revolucion nga lart.

Predikoi se kjo diktaturë do të sillte liri, barazi e drejtësi, sikundër jeta e solli të kapte majat e pushtetit si garant i lirisë. Një jetë midis dy skajeve: ëndrrës dhe zhgënjimit. E pamë veprimtarinë politike të Malëshovës në dy kohë, pasi njëra ka sjellë tjetrën. Pamë se disa veçori të sjelljes politike të tij, kur sapo kishte mbaruar lufta, tregojnë për një vizion ndryshe, krahasuar me drejtuesit e tjerë komunistë, në Shqipëri e jashtë saj. Fryma që kërkoi t'u jepte në mënyrë idealistike raporteve sociale në vend, sa ç' ishte largim nga dogma, duket se po aq ishte me ndikim perëndimor, prej nga Malëshova vinte. Sejfulla Malëshova mbrojti si rrugë progresi për vendin e tij, mbështetjen sa tek Bashkimi Sovjetik aq edhe te Perëndimi, edhe pse mund të mos ishte rrugë e sigurt. E sigurt është se ky opinion u bë njëri nga shkaqet që i kushtoi shumë malëshovimit idealist. Sikundër ideja bashkëjetesës dhe ajo e konkurrencës së lirë midis pronës së shtetit dhe pronës private, si mekanizëm zhvillimi, mund të mos ishte jetëgjatë. Edhe kjo ide kundërvënëse me çdo program bolshevist, që ka për thelb asgjësimin e pronës private, i kushtoi profesorit të filozofisë, ministrit të Propagandës dhe të Kulturës Popullore, kryetarit të Komitetit për Ekonominë.

Janë të shumta dhe të mjafta burimet dokumentare, ku janë fiksuar pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës në rrafshë të politikës, të praktikave ekonomike e sociale, po edhe të përpjekjeve për hapësira demokracie në kushte diktature. Vështirë të thuash se këto ide do të provoheshin të efektshme, nëse në terrenin shqiptar do të qe aplikuar një regjim disi më i butë. Vetë Malëshova duhet të ketë pasur përvoja të vështira në fund të viteve '20, kohë e bolshevizimit të përgjithshëm të komunizmit evropian, përfshirë nën moton "Revolution from above". Ashtu sikundër një tjetër përvojë duhet të ketë lënë gjurmë. Mbetet për t'u hetuar dhe arsyetuar kjo përvojë kur Malëshova, si anëtar i partisë bolshevike, e kishte përjetuar nga afër *Purgën* e tmerrshme të mesviteve '30-të në Rusinë Sovjetike. Përmasat e atij tmerrri ndoshta përbëjnë arsye të mjaftueshme pse ai u përpoq me sa mundi të shmangej e ngjashmja në vendin e tij. Sidoqoftë, këto qëndrime politike, si dhe idetë për reforma ekonomike, përbëjnë të veçantat në veprimtarinë politike të Sejfulla Malëshovës. Këtu, mendoj se duhet kërkuar edhe thelbi i malëshovizimit, *një përpjekje për jetë njerëzore në një regjim çnjerëzor, regjim të cilit, megjithatë, ai i besonte.*

Më 12 qershor 1971 Sejfulla Malëshova ndërroi jetë në spitalin e Fierit. Pakkush e vrau mendjen se kishte ikur politikani i njohur, vjershëtori i popullit, përkthyesi anonim që kishte sjellë në shqip Gëten, Pushkinin e Nekrasovin, po dhe Gorkin e Marksit. Në raportin e vdekjes diagnoza është për apendicit akut. Kështu kishte ndodhur edhe me Tuk Jakovën. Të dy ikën me të njëjtën diagnozë. Njëri më 1959, në spitalin e burgut në Tiranë, tjetri në Fier. Për njëzet vjet, që prej vitit 1951 e derisa vdiq, 19 oficerë të Sigurimit u morën me ndjekjen e tij dhe plot agjentë dhanë informacionet e tyre regjistruar në qindra faqe. Një raport i Degës së Punëve të Brendshme të Fierit ka shënuar se dosja ka vlerë historike, prandaj është marrë në ruajtje me kohë të pacaktuar.<sup>107</sup> Për paradoks, puna e errët e diktaturës së djeshme na sjell në dritë përditshmërinë e fshehur të një njeriu të thjeshtë, të ditur e me dinjitet.

---

107. AIDSSH, Ministria e Brendshme, Dosje formulare nr. 587. Vendim për arkivimin e Dosjes formulare 2 – A të Sejfulla Malëshovës, 29.6.1971. 252

# Konstandin Çekrezi



# I treti i munguari

Kostë Çekrezi u lind në Ziçisht, ku kreu studimet e para në shqip dhe greqisht, ndërsa shkollën e mesme e përfundoi në gjimnazin grek të Korçës. Studimet universitare i filloi në qytetin e Selanikut, por i ndërpreu për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore.

**NGA HAMIT KABA**

Konstandin Çekrezi<sup>108</sup> ishte një demokrat liberal me prirje të majta, i cili nuk u pajtua asnjëherë me regjimet autoritare apo totalitare dhe me gjendjen e Shqipërisë së prapambetur, ndryshimit të së cilës i kushtoi gjithë jetën. “Jeta e tij, - shkruan Ilir Ikonomi në parathënien e librit të Andon Andonit për Çekrezin, - ishte një energji e pafund: energji për të shkruar, për të polemizuar dhe për të kundërshtuar autoritetin”.<sup>109</sup>

Çekrezi ishte gazetar, historian, publicist dhe politikan i njohur në emigracion. Veprimtaria e tij nisi që në moshë të re në Amerikë, për të vazhduar në atdhe, pas kthimit në vitin 1925, për të kulmuar me krijimin prej tij të organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ në Boston në vitin 1941 dhe përpjekjeve për njohjen e saj nga qeveria amerikane dhe britanike. Menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore [LDB] Çekrezi dha dorëheqjen nga detyra e tij si kryetar i organizatës ‘Shqipëria e Lirë’, të cilën e krijoi dhe drejtoi për gati 4 vjet, për shkak të afrimit të saj me regjimin komunist që u vendos në Shqipëri. Deri në vdekjen e tij, Çekrezi mbeti partizan i demokracisë perëndimore, i afrimit të Shqipërisë me SHBA, një mediator i papërtuar i pajtimit ndërmjet shqiptarëve me vizione e pikëpamje të ndryshme politike e ideologjike.

---

108. Në Shqipërinë komuniste emri i Konstandin Çekrezit ishte pothuajse i panjohur, ndonëse që në kohën e vet është konsideruar me të drejtë si një nga tre figurat më të shquara të emigracionit shqiptar në SHBA. Emri i tij radhitet përkrah atij të Faik Konicës, të F. S. Nolit e të Kristo Dakos.

109. Andon Andoni, *Kostë Çekrezi I treti, i munguari*, Tiranë: Naimi, 2016, f. 5.

Kostë Çekrezi (1892-1959) u lind në Ziçisht, ku kreu studimet e para në shqip dhe greqisht, ndërsa shkollën e mesme e përfundoi në gjimnazin grek të Korçës. Studimet universitare i filloi në qytetin e Selanikut, por i ndërpreu për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1918 përfundoi studimet e larta për ekonomi dhe administrim publik në Universitetin e Harvardit.

---

## Veprimtaria e hershme politike e K. Çekrezit

---

Menjëherë pas fitores së pavarësisë, Çekrezi shërbeu si sekretar i Gjykatës Civile të Vlorës, si përkthyes pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe Princ Vidit (Wied). Çekrezi mbështeti reformat e marra nga qeveria e Ismail Qemalit, ndër të cilat edhe atë të ndarjes së fesë nga shteti dhe barazinë e besimeve fetare në Shqipëri. Shenjën e parë të qëndrimit të tij si njeri i ndryshimit Çekrezi e dha në moshë të re. Ai ishte vetëm 22 vjeç kur u ngarkua nga gjykata e Vlorës që të kryesonte procesin kundër myftiut të deriatëhershëm të gjithëpushtetshëm, dënimi i të cilit përbënte një fenomen të pazakontë në Shqipërinë e sapodalë nga sundimi osman.<sup>110</sup>


Në vitin 1914, në moshën 23 vjeçare, Çekrezi, si shumë shqiptarë të tjerë emigroi në Amerikë dhe shumë shpejt (në vitin 1915) u emërua kryeredaktor i gazetës ‘Dielli’ të ‘Vatrës’, të cilën e shndërroi në gazetë të përditshme. Në vitin 1916 drejtoi revistën ‘Illyria’, ndërsa në vitin 1919 ‘Adriatic Review’. Bashkëpunoi dhe polemizoi me personalitetet e njohura të botës shqiptare në Amerikë, si Fan Noli, Faik Konica, Kristo Dako, Themistokli Gërmenji, Qerim Panariti etj. I papërtuar për punë, i papërtuar për kritika, një natyrë tipike rebele, Çekrezi nuk pushoi asnjëherë të punonte për çështjen kombëtare. Në kushtet kur Shqipëria ishte zhytur në amullinë e Luftës së Parë Botërore dhe ishin vënë në pikëpyetje, madje edhe ajo çka ishte arritur në Konferencën e Londrës të vitit 1913, djaloshi Konstandin Çekrezi arriti për herë të parë të realizonte një regjistrim të komunitetit shqiptar të Amerikës. Ai kërkoi nga Kuvendi i ‘Vatrës’ që të ndryshonte programin e saj dhe ta shndërronte atë në një shoqëri politike. Kjo ide u diskutua gjerësisht në gazetën ‘Dielli’ gjatë muajve maj-korrik 1915, sidomos nga miku i tij dhe i shqiptarëve, Anthony Arnoux.<sup>111</sup> Sidoqoftë, ai nuk ia arriti plotësisht qëllimit. Nisma e tij, nuk gjeti mbështetjen e duhur në Kuvendin e katërt të ‘Vatrës’, që u mbajt më 4 korrik 1915. Këtë ide e realizoi deri diku patrioti Kristo Dako me krijimin e Partisë Politike të Shqiptarëve të Amerikës, por ajo nuk arriti dot të rivalizonte ‘Vatrën’. Kundërshtari më i madh i idesë së Çekrezit ishte Fan Noli. Idetë e reja të tij u konsideruan nga shumica e vatanëve si mjet për të marrë drejtimin e saj. Ishin pikërisht këto vite kur Çekrezi arriti të matej me figurat madhore të nacionalizmit shqiptar në emigracion e madje në botën shqiptare, siç ishin Noli, Konica, Dako, Gërmenji, etj.

Në vitin 1919 botoi të parin libër në gjuhën angleze *Albania, past and present*. Parathënien e tij e shkroi profesori i njohur i Universitetit Columbia në SHBA, Charles D. Hazen. Historia e shkruar nga Çekrezi, në dallim nga burimet e shumta të jashtme dhe nga shtrembërimet e fqinjëve të Shqipërisë, përpiket të paraqesë dhe shpjegojë historinë e popullit të vet nga këndvështrimi i një shqiptari. “Për vite e vite me radhë, – shkruan Hazen, – bota ka dëgjuar mjaft për punët e Shqipërisë, por ajo ka dëgjuar vetëm ç’thuhet thujtë tërësisht nga burime të jashtme; nga grekët, serbët a malazezët, dhe nga Fuqitë e Mëdha”. “Prandaj, – shkruan ai më tej duke iu referuar librit të Çekrezit, – është kënaqësi e avantazh i

---

110. Kostë Çekrezi, *Shqipëria e shkuara dhe e tashmja*, Tiranë: Naimi, 2012, f. 143.

111. Beqir Meta, *Federata Pan Shqiptare ‘Vatra’*, Tiranë: Globus R, 2002, f. 150.



Çekrezi, si shumë shqiptarë të tjerë emigroi në Amerikë dhe shumë shpejt (në vitin 1915) u emërua kryeredaktor i gazetës 'Dielli' të 'Vatrës', të cilën e shndërroi në gazetë të përditshme. (në foto)

qartë që, më në fund, kemi një interpretim nga vetë shqiptarët, një shpalosje të historisë së Shqipërisë, një paraqitje të kërkesave të shqiptarëve, drejtpërdrejt nga mendja dhe zemra e një vendasi. Sepse, me sa di unë, ky libër është i pari i një shqiptari për Shqipërinë që ka dalë në gjuhën angleze”.<sup>112</sup> Historia e Çekrezit dëshmon për kulturën, për njohuritë e tij të gjera dhe për karakterin realist e progresiv në mbrojtje të çështjes shqiptare. Veçanërisht me interes nga vepra e mësipërme unë do të konsideroja historinë e vështirë e të amullt të Shqipërisë së viteve 1912-1918 dhe disa mendime të tij në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë.

Çekrezi, shkakun kryesor të Kryengritjes së fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme të vitit 1914 e kërkon te mosgjydhja e problemit agrar dhe jo te fundamentalizmi i popullsisë myslimane. “Shkaku më i dukshëm i këtij revolucioni ishte agrar. Në Shqipërinë e Mesme toka u përket më së shumti pasanikëve vendas, bejlerëve e pashallarëve, që kanë çifligje shumë të mëdha”.<sup>113</sup> “Zgjydhja e çështjes së tokës është një punë me të cilën duhet të përballet qeveria e ardhshme e Shqipërisë”.<sup>114</sup> Çekrezi mendonte se Shqipëria mund të bëhej një shtet modern dhe i përparuar në familjen e shteteve evropiane, sepse asaj nuk i mungonin as burimet ekonomike dhe as ato njerëzore. Një vend të posaçëm ai i kushton vendit që zënë gratë në shoqërinë shqiptare. ‘Askund në Ballkan, – përmend Çekrezi, – gruaja nuk respektohet e nderohet kaq shumë’. Vështrimet e tij për gratë shqiptare, për familjen, për gjendjen arsimore e kulturore në vend, janë disi të idealizuara e të gjykuara në frymën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

112. Constantine Çekrezi, *Albania Past and Present*, New York: MacMillan Co, 1919.

113. Kostë Çekrezi, *Shqipëria e shkuara dhe e tashmja*, Tiranë: 2012, f. 183.

114. Kostë Çekrezi, *Shqipëria e shkuara dhe e tashmja*, Tiranë: 2012, f. 209-210.

Kjo tendencë është e kuptueshme po të kemi në konsideratë rrethanat në të cilat gjendej Shqipëria gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, kur problemet e ekzistencës dhe të sigurisë së shtetit shqiptar ishin parësore në krahasim me zhvillimin dhe modernizimin e shoqërisë shqiptare. Idetë liberale e socialdemokrate të Çekrezit vihen re sidomos kur trajton problemin e pakicave e minoriteteve në Shqipëri. Ai nuk do të ishte kundër mbajtjes së një plebishiti të pakicave greke në Shqipëri, por vetëm nëse vendi do të vendosej nën autoritetin e një fuqie të huaj asnjëse dhe nëse do të shmangeshin manipulimet e mundshme të tij.<sup>115</sup> Çekrezi shfaq mendimin e tij se jo vetëm ai, por edhe shtresat e intelektualëve shqiptarë nuk do t'i nëpërkëmbnin të drejtat e pakicave në Shqipëri, për shkak të formimit të tyre dhe mungesës së shovinizmit. 'Gjëra të tilla, - shkruan Çekrezi, - nuk do të ndodhin kurrë në Shqipëri, ku toleranca fetare e politike, është një parim i njohur'.<sup>116</sup>

---

## Veprimtaria politike e K. Çekrezit ndërmjet dy luftërave botërore

---

Kostandin Çekrezi më 5 mars 1920 u emërua nga qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës si Komisionier i Shqipërisë në Uashington. Kandidatura e tij u mbështet nga 'Vatra', personalisht nga Faik Konica dhe vëllai i tij Mehmet Konica, atëkohë ministër i jashtëm i Shqipërisë në qeverinë e kryeministrit Sulejman Delvina.<sup>117</sup> Aq me pasion e kishte marrë ai çështjen e njohjes së Shqipërisë nga qeveria amerikane, sa në një rast, në vitin 1922, i paraqiti Departamentit të Shtetit një tablo tejet të zbukuruar të gjendjes në Shqipëri, duke deklaruar se një gjeolog i huaj kishte zbuluar atje rezerva platini.<sup>118</sup> Me gjithë përpjekjet dhe pasionin e tij për njohjen e qeverisë shqiptare nga ana e SHBA, nuk ia arriti dot qëllimit. Qeveria amerikane vazhdonte ta studionte ende mundësinë e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me qeverinë shqiptare, por për arsye të ndryshme, duke përfshirë edhe ato ekonomike, ajo nuk po nxitohej. Qeveria shqiptare e largoi nga detyra Çekrezin në prill 1922, për shkak të mosvendosjes në kohë të marrëdhënieve diplomatike me SHBA. Me rekomandimin e tij, kjo detyrë iu ngarkua zëvendëskonsullit të ri të Shqipërisë në Nju Jork, Koço Tashkos.

Në vitin 1923 Çekrezi botoi një fjalor anglisht-shqip. Pas përfundimit të studimeve të larta, Kostandin Çekrezi punoi si pedagog në Universitetin e Uashingtonit dhe në Universitetin e Nju Jorkut, ku shpалosi aftësitë e tij profesionale e intelektuale përmes ligjërimeve dhe leksioneve të tij për teoritë politike dhe historinë moderne.

Çekrezi nuk mori pjesë në lëvizjen e qershorit të udhëhequr në Noli, por qëndroi indiferent ndaj saj. Ai vetë, me sa njohim, nuk ka dhënë ndonjë shpjegim për këtë. Është e vështirë të mendosh se kjo ndodhi për shkak të grindjeve e qejfmbetjeve të mëparshme të tyre. Shpjegimi më i mirë duhet të kërkohet në librin e lartpërmendur, kur Çekrezi merret me qeverinë e Ismail Qemalit dhe kritikave që asaj iu bënë nga shqiptarët e Amerikës. "Nacionalistë radikalë, radhët e të cilëve ishin mbushur kryesisht me shqiptarë që po ktheheshin nga Shtetet e Bashkuara, iu kthyen agitacionit kundër qeverisë së Vlorës. Kjo shihej prej tyre si konservatore dhe e pandreqshme; ata donin ta modernizonin brenda natës, edhe qeverinë, edhe vendin. Këta kritizues të rreptë i quanin reformat e kryera si çikërrima dhe dëshironin

---

115. Kostë Çekrezi, *Shqipëria e shkuara dhe e tashmja*, Tiranë: 2012, f. 280.

116. Kostë Çekrezi, *Shqipëria e shkuara dhe e tashmja*, Tiranë: 2012, f. 280-281.

117. The National Archives and Record Administration ( *më tej*: NARA), Roll 4, Microcopy 1211, 875.01 B11/4, April 5, 1922.

118. Andon Andoni, *Kostë Çekrezi I treti, i munguari*, Tiranë: Naimi: 2016, f. 5.



ta shihnin Shqipërinë të reformuar që nga themelet”.<sup>119</sup> Duket se ky gjykim është shtrirë edhe në këtë rast. Në vitin 1925, pasi ardhjes në pushtet të Ahmet Zogut, Konstandin Çekrezi u kthye në vendlindje. Me ndihmën e Zogut ai arriti të siguronte një shtypshkronjë, përmes së cilës botoi gazetën ‘Telegraf’ (sipas modelit të ‘Daily Telegraf’), artikujt e së cilës deri në vjeshtën e vitit 1928 mbështetnin Zogun dhe ‘shugurimin’ e tij mbret i shqiptarëve. Por më 14 shtator 1928 Çekrezi u arrestua dhe u dënua me një vit burg. Burgosja e tij u faturua ish-kryeministrit Koço Kota<sup>120</sup>, por shkaqet duhen kërkuar më thellë. Ai botoi disa artikuj kritik kundër qeverisë së Zogut në gazetën ‘Telegraf’, ndër të cilët shquhej ai me titull ‘Quo Vadis Albania’, me të cilin duket se e ‘mbushi’ kupën. Kritikata e tij ndaj Zogut u fokusuan te marrëdhëniet e tij të ngushta politike e ekonomike me Italinë e Musolinit, te sjellja e tij autoritare dhe te loja pas kuintave e mbretit shqiptar, i cili kishte përqendruar në duart e veta të gjitha fijet e pushtetit, dhe te paaftësia e qeveritarëve të tij. Disa burime përmendin se një ndër shkaqet e pakënaqësive të tij ndaj Zogut lidhej me pamundësinë e Çekrezit për t’u bërë president i Shqipërisë – një ëndërr që u fashit pasi Zogu u shpall mbret i Shqipërisë në vitin 1928.<sup>121</sup>

Pavarësisht nga ambiciet personale të Çekrezit ishte e vështirë që natyra e tij rebele dhe formimi i tij me idetë e demokracisë amerikane të pajtohej me stilin dhe qeverisjen me tharm oriental të mbretit Zog. Këtë gjë ia kishte vënë në dukje Çekrezit edhe ministri amerikan në Tiranë, Charles C. Hart, i cili e kishte paralajmëruar, se nëse do të vazhdonte ta drejtonte gazetën mbi bazën e ideve amerikane, do të përfundonte ose në burg, ose në mes të katër rrugëve.<sup>122</sup> Si shumë intelektualë të tjerë me formim perëndimor, edhe Çekrezi do të zhgënjehej shpejt nga realiteti shqiptar. Shqipëria ishte vend i prapambetur, me mendësi tradicionale ballkanike e cila nuk mund t’i përthithte idetë demokratike perëndimore dhe stilin perëndimor të qeverisjes. Për formimin dhe temperamentin e Çekrezit do të ishte e vështirë, siç edhe ndodhi, që të merrej vesh me mbretin Zog, marrëdhëniet me të cilin do të ishin në shumicën e tyre konfliktuale. Çekrezi bëri vetëm disa javë burg. Më 11 tetor 1928, vetëm pak kohë pasi Zogu u shpall mbret i Shqipërisë ai doli nga burgu.<sup>123</sup>

Pas mbylljes së gazetës ‘Telegraf’ Çekrezi filloi të botonte revistën ‘Ora’. Editor i saj u caktua kushëriri i tij, Vasil Xhaçka, ndërsa një vit ajo u drejtua nga Namik Delvina e pas tij nga Timo Dilo. Në vitin 1929 Konstandin Çekrezi u dekretua anëtar i Këshillit të Shtetit, që kryesohej nga Mehdi Frashëri. Anëtarë të tij ishin edhe Zoi Xoxe, Martin Ivanaj, etj. Por ‘mirëkuptimi’ i Çekrezit me regjimin e Zogut tashmë kishte përfunduar. Më 2 shtator 1932 filloi gjyqi ndaj 49 të akuzuarve për pjesëmarrje në ‘Organizatën e Fshehtë’ të Vlorës. Kryengritja e projektuar nga kjo organizatë dështoi ende pa filluar, sepse u diktua nga policia zogiste. Qëllimi i organizatës, sipas prokurorisë, ishte që të ‘prishte qetësinë e brendshme dhe të ndryshonte formën e regjimit. Në listën e të akuzuarve krahas emrave të Idriz Jaho Kuçit, Nuredin Vlorës, Dhimitër Konomit, Seit Qemalit, Skënder Muços, Hysni Lepenicës, Uran Filipit, Llaqi Mandit etj, ishte edhe ai i Kostë Çekrezit. Ndaj Çekrezit u ngritën dy akuza kryesore: *së pari*, se ai kishte dijeni për këtë organizatë, të cilën e kishte përkrahur përmes revistës ‘Ora’ dhe *së dyti*, se ai kishte qenë i ngarkuar prej saj që të rekrutonte ‘shqiptarët e Amerikës’.<sup>124</sup> Çekrezi u dënua me tre vjet, por qëndroi vetëm dy vjet e gjysmë në burg. Ndërmjet 7 vetëve që u dënuan me vdekje [por vendimi nuk

119. Kostë Çekrezi, *Shqipëria e shkuara dhe e tashmja*, Tiranë: 2012, f. 154.

120. Në librin *Plani i tretë për copëtimin e Shqipërisë*, Çekrezi pretendon se ka shpëtuar nga dënimet e rënda ish kryetari n e ‘Vatrës’ Anastas Pandeli dhe dy patriotë të tjerë si Ismail Deveja dhe Hysen Nikolica të akuzuar nga qeveria e Koço Kotës se do të kryenin atentat kundër Zogut, f. 79–81.

121. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë (më tej: AMPB), Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i Zbulimit Politik, Dosja 29, vitet 1947–1959, 28. 04. 1951, fleta 52. Deponim i Lary Post.; Andon Andoni, *Kostë Çekrezi I treti, i munguari*, Tiranë: Naimi: 2016, f.

122. NARA, M 1211, Roll 2, Telegram i Charles C. Hart për Sekretarin e Shtetit, No. 537, Tiranë, 11 tetor 1928.

123. NARA, M 1211, Roll 2, Telegram i Charles C. Hart për Sekretarin e Shtetit, No. 537, Tiranë, 11 tetor 1928.

124. AMPB, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i Zbulimit Politik, Dosja 29, 16.1.1951.

“

Në përpjekjet e mia për të mbledhur tok dhe për të organizuar gjithë elementët kundërshtarë të regjimit, hyra në kontakt edhe me Grupin Komunist të Shqipërisë

Konstandin Çekrezi

”

u zbatuar] ishin edhe tre anëtarë të KONARE-së, Skënder Muço, Murat Myftari dhe Hysni Alushi.<sup>125</sup> Armiqësia e Çekrezit me mbretin Zog paskëtaj nuk do të ndërpritej.

Çekrezi u lirua nga burgu në shkurt 1935, por ende pa u tharë mirë boja e lirimit, ai do të përfshihej në një tjetër komplot kundër Zogut, - atë që në histori njihet me emrin 'Kryengritja e Fierit'. Anëtarët kryesorë të kësaj organizate kishin pikëpamje e formim të ndryshëm politik. Në Kryengritjen e Fierit kishte njerëz me bindje republikane, nacionaliste, madje edhe komuniste. Aty bashkoheshin borgjezë, tregtarë, nëpunës, pronarët të mëdhenj tokash, oficerë efektivë e të liruar, parësia e Beratit, Vlorës e Shkodrës, të gjithë të pakënaqur nga Zogu. "Vrionasit, - shkruan Çekrezi, - ishin në vijën e parë".<sup>126</sup> Arsyet e pakënaqësive ishin të ndryshme, të tilla ishin edhe kërkesat e tyre. Një pjesë e pjesëmarrësve në kryengritjen e Fierit ishin të prekur nga reformat e ndërmarra nga Zogu. Ata i bashkonte kërkesa për përmbysjen e Zogut, por nuk kishin të njëjtat aspirata për çfarë do të ndërtonin në të ardhmen. Disa kërkonin republikë, të tjerë kërkonin një Shqipëri pluraliste.<sup>127</sup>

Çekrezi ishte i pakënaqur me regjimin zogist që 'bazohej te forca'. Pakënaqësitë ndaj tij kishin sjellë 4 lëvizje kryengritëse brenda një periudhe 10-vjeçare. Për të përballuar presionin e brendshëm, Zogu, sipas Çekrezit, nuk gjeti rrugë tjetër veçse të hynte më thellë në mbrojtjen e Musolinit, deri në atë shkallë sa independenca e Shqipërisë arriti të mbetet vetëm si një fjalë, një teori, një hije dhe jo një realitet.<sup>128</sup> Në politikën e jashtme regjimi i Zogut u bë shtojcë e Italisë. Në Lidhjen e Kombeve ajo votonte sikurse Italia.

Kontaktet e para me këtë organizatë Çekrezi i pati në vitin 1934, kur ishte ende në burg. Ai u lidh me Musa Kranjën, njërin prej drejtuesve kryesorë të saj. "Në përpjekjet e mia për të mbledhur tok dhe për të organizuar gjithë elementët kundërshtarë të regjimit, hyra në kontakt edhe me 'Grupin Komunist' të Shqipërisë".<sup>129</sup> Çekrezi do t'i quante anëtarët e këtij grupi si 'idealistë të shkrehur që pandehnin se çdo problem i Shqipërisë do të zgjidhej automatikisht në minutën që do të vihej në veprim regjimi sovjetik në vendin tonë'.<sup>130</sup> Kostë Çekrezi i veshi vetes rolin e protagonistit në këtë kryengritje,<sup>131</sup> por ishin të tjerë persona që e organizuan atë. Çekrezi, si intelektual i njohur dhe me kulturë, u përzgjedh nga organizatorët e kryengritjes që të ishte pjesë e qeverisë së ardhshme që do të krijohet pas përmbysjes së Zogut. Madje edhe në fjalimin që mbajti para kryengritësve, ai foli në emër të qeverisë së re të krijuar në Tiranë.<sup>132</sup>

125. Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së 1878-1941 (Vështrim historik me një shtojcë dokumentare)*, Tiranë: ILAR, 2006, f. 75

126. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f.33.

127. Andon Andoni, *Kostë Çekrezi I treti, i munguari*, Tiranë: Naimi, 2016, f. 296.

128. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 29.

129. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 31.

130. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 31.

131. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 33.

132. Andon Andoni, *Kostë Çekrezi I treti, i munguari*, Tiranë: Naimi, 2016, f. 296-297.

Dështimi i kryengritjes së Fierit e detyroi Çekrezin të largohej fshehtazi, bashkë me Musa Kranjën në drejtim të Italisë. Gjykata e Zogut e dënoi me vdekje.<sup>133</sup> Pasi qëndroi disa muaj në burg në qytetin e Barit ai u lirua dhe shkoi në Francë, ku vazhdoi aktivitetin e tij kundër Zogut. Në vitin 1939 së bashku me Sejfulla Malëshovën, Dr. Ymer Dishnicën, etj, krijuan ‘Konfederatën e Shqiptarëve në Mërgim’, një shoqatë me pikëpamje relativisht të majta, e udhëhequr prej tij.<sup>134</sup>

Ndaj Çekrezi nuk kanë munguar edhe insinuatat, duke e quajtur komunist. Në mënyrë të veçantë kjo akuzë është përdorur nga Zogu dhe njerëzit e tij. Por Çekrezi nuk ishte i vetmi i akuzuar me këtë cilësim. Edhe të tjerë persona, si kundërshtarë politikë të Zogut u akuzuan e burgosën duke u veshur epitelin ‘komunist’, duke mos qenë të tillë. Çekrezi e ka fajësuar Zogun se e përdori pa vend këtë akuzë, duke i bërë, në njëfarë mënyre, reklamë këtyre pikëpamjeve që në Shqipëri ishin mjaft të kufizuara. Akuzat që i janë bërë Kostë Çekrezi si komunist nuk janë të argumentuara. “Është e vërtetë se ai nuk ishte monarkist, shkruan Dalip Greca, është i vërtetë edhe mendimi se ai anonte majtas, dhe se ai ishte një i majtë liberal i modelit amerikan”.<sup>135</sup> Antikomunizmi i tij duket qartë në shkrimet e tij në gazetën ‘Telegraf’ dhe debatet me disa komunistë të njohur shqiptarë të asaj kohe. Çekrezi e quajti ‘vetëvrasje politike’ pjesëmarrjen e Nolit në festimet e 10 vjetorit të Revolucionit të Tetorit në Moskë në vitin 1927.<sup>136</sup> Disa persona të tjerë si Mustafa Gjinishi, Kolë Berisha e Loni Adami, të cilët qëndronin pranë gazetës ‘Telegraf’, Çekrezi nuk do përtonte t’i quante ‘komunistë sipas berihajt.’

Në fillim të LDB Çekrezi së bashku me disa komunistë antifashistë pjesëmarrës të Luftës së Spanjës [Mehmet Shehu, Skënder Luarasi, Hulusi Spahiu] u gjend në një kamp internimi në Francën Jugore të Vishisë [Vernet de l’Ariege]. ‘Që kur isha në këtë kamp kujton Çekrezi, ‘mendja ime ishte kthyer ndaj Amerikës’, për shkak të shokëve të mi shqiptarë, dhe sidomos ndaj qeverisë amerikane dhe presidentit Woodrow Wilson që e kishin shpëtuar Shqipërinë nga Plani i Dytë i Copëtimit të Shqipërisë.<sup>137</sup> Bashkëjetesa me komunistët shqiptarë në këtë kamp, siç tregon ai vetë në librin *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë* nuk ishte e lehtë për shkak të pikëpamjeve të ndryshme politike, ndonëse ata paraqiteshin si ‘demokratë të thjeshtë’. Veçanërisht të ashpra ishin debatet politike me Mehmet Shehun.<sup>138</sup>

---

133. Jakov Milaj, “Pjesëmarrja dhe kontributi i myzeqarëve në kryengritjen e Fierit”, gazeta *Myzeqeja*, tetor 1995.

134. AMPB, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Zbulimi Politik, Dosja 29, Nga deponimi i Lary Post, Tiranë, 16.1.1951.

135. Dalip Greca, “Kostë Çekrezi, gazetari që e bëri *Diellin* të përditshëm, antizogisti që pati kundër Konicën dhe Nolin”, Boston, 2012.

136. Nasho Jorgaqi, *Jeta dhe Vëpra e Fan S. Nolit*, Volumi 2, Tiranë: Ombra GVG, 2005, f. 70. Cituar nga Andon Andoni, *Kostë Çekrezi, i treti i munguari*. f. 304; shih: Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së 1878-1941, (Vështrim historik me një shtojcë dokumentare)*, Tiranë: Ilar, 2006, f.35.

137. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 10.

138. Çekrezi ka shkruar se që kur ishte në kampin e përqendrimit në Francë ua kishte shfaqur idenë e tij për të krijuar një organizatë në Amerikë ‘shokëve’ të burgut siç ishin Mehmet Shehu, Skënder Luarasi e Hulusi Spahiu, por këta të fundit nuk e kishin pëlqyer. Sipas mendimit të treve ‘Presidenti Roosevelt nuk ishte më i mirë se Musolin e Hitleri’. Shih: *Plani i tretë...*, f. 11.

---

## Lufta e Dytë Botërore: në krye të organizatës “Shqipëria e Lirë”

---

Më 27 tetor 1941 Konstandin Çekrezi mbërriti në Nju Jork me vizën e siguruar nga konsulli amerikan në Marsejë. Largimi i tij nga kampi i përqendrimit u mundësua falë përpjekjeve të gjithanshme të zonjës Thomas<sup>139</sup> – një e njohur e hershme e tij, miqve të saj dhe të vetë Çekrezit në Departamentin e Shtetit e në rrethet universitare, dhe veçanërisht e ish-ambasadorit amerikan pranë Qeverisë së Vishisë, zotin Henry Hey. Mbështetja e DSH për rikthimin e tij në SHBA nuk duket të jetë e rastësishme. Çekrezi ka shkruar se qëkurse ndodhej në kampin e përqendrimit në Francë i kishte lindur ideja, se nëse ‘Vatra’ nuk kthehej në programin e saj origjinal, ai do të krijonte një organizatë të re, e cila do të punonte në favor të Shqipërisë, duke siguruar ndihmën dhe simpatinë e qeverisë amerikane.<sup>140</sup> Rrethanat e krijuara ishin të favorshme, pasi Konica e Noli ndonëse e kishin dënuar pushtimin e Shqipërisë nga Italia, patën një periudhë pasiviteti në veprimtarinë e tyre politike.<sup>141</sup> “Në prill të vitit 1939, – ka shkruar Çekrezi, – kur Musolini i dha këpucët në dorë Zogut, ‘Dielli’ u kthye si pa të keq në favor të mbretit të ri të Shqipërisë, Viktor Emanuelit të Italisë, se ashtu e urdhëroi Beu [Faik Konica]. Me dorën e vetë Faik Konicës, ‘Dielli’ dënoi si tradhtar djaloshin dardhar [nga Piqerasi] Vasil Laçi, sepse qëlloi me revole ‘madhërinë e Tij’ shkurtabiqe, Viktorin e Italisë”.<sup>142</sup> Italianët u munduan që nëpërmjet ‘Vatrës’ dhe gazetës ‘Dielli’ të ndikonin te komuniteti shqiptaro-amerikan për të siguruar mbështetje.<sup>143</sup> Por situata ndryshoi menjëherë pas hyrjes së SHBA në Luftën e Dytë Botërore. Rrethanat e luftës diktonin masa të rrepta ndaj Italisë me të cilën SHBA gjendej zyrtarisht në luftë. Duke pasur në konsideratë natyrën e gjallë dhe ambicioze të Çekrezit, kundërshtitë e tij në të shkuarën me Konicën e Nolin, armiqësitë me Zogun dhe idenë e tij për të krijuar një organizatë të re të shqiptarëve të Amerikës, kthimi i tij besohet se kishte arsye të mjaftueshme politike për t’u mbështetur nga DSH.

Çekrezi e bëri publikisht të njohur planin e tij për shoqatën e re më 16 nëntor 1941, në një takim në Peabody Playhouse në Boston. Në librin e tij *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Çekrezi pretendon se iniciativa e tij nuk u mbështet as nga Noli dhe ca më shumë nga Konica. Lary Post, – kushëriri dhe bashkëpunëtori i tij pretendon se ai nuk i ftoi as njërin dhe as tjetrin.<sup>144</sup> Më 27-28 dhjetor 1941 Çekrezi thirri një kongres të shqiptarëve të Amerikës dhe krijoi organizatën ‘Shqipëria e Lirë’.<sup>145</sup> Ai ishte i pari që nisi një lëvizje në Amerikë dhe kontribuoi që çështja shqiptare të dalë nga pellgu i harresës.<sup>146</sup> I zgjedhur në krye të organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ Çekrezi i adaptoi asaj karakterin e vet rebel, ambicioz, nacionalist dhe demokratik. Programi politik prej 5 pikash i ‘Shqipërisë së Lirë’ kishte si qëllim që të bashkonte rreth saj të gjithë shqiptarët e mërguar; të garantonte të drejtat e

---

139. Zonja Thomas ishte në këtë kohë rreth të 60-ve. Ajo kishte punuar në Operën e Parisit. Ajo e mbështeti edhe financiarisht Çekrezin dhe pas luftës ata jetuan në shtëpinë e saj në Virxhinia.

140. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 11.

141. Ilir Ikononi, *Faik Konica, Jeta dhe vepra në Washington*, Tiranë: Onufri, 2011, f. 297; Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 10-11.

142. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 70.

143. Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: Botime KLEAN, 2015, f. 297-298.

144. AIDSSH, F.AMPB, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i Zbulimit Politik, Dosja 29, 16.1.1951. Nga deponimi i Lary Post në burg.

145. NARA, RG 226, “Përse u ngrah Shqipëria e Lirë? Cili është programi i saj politik e kombëtar?”, Boston, Mass. 27-28 dhjetor 1941.

146. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, përgatitur nga Bejtullah Destani & Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 219-220.



Çekrezi në Ziçisht

1934

kombit shqiptar, duke bashkëpunuar me qeverinë amerikane dhe aleaten e saj kryesore Anglinë; të vendoste lidhje me grupet e rezistencës në Shqipëri dhe, së fundi, të përgatiste plane për rindërtimin e shtetit shqiptar të pasluftës. Objektivi i fundit do të arrihej përmes krijimit të një qeverie që do të dilte nga populli, “duke përjashtuar të gjithë ata që duan të bëhen mbretër, princër, diktatorë e shtypës të popullit”.<sup>147</sup> ‘Shqipëria e Lirë’ e paraqiti veten si qeveri në mërgim, në mbrojtje të drejtave të Shqipërisë, deri në ditën kur populli shqiptar do të kishte mundësi të zgjidhte lirisht qeverinë e vet. Pas përmbushjes së këtij objektivi ‘Shqipëria e Lirë’ do të transformohej në ‘parti politike me program liberal, demokratik e popullor’. Programi i kësaj organizate e përjashtonte ekzistencën e një qeverie nën Zogun. ‘Populli shqiptar thuhet aty e meriton një fat shumë më të mirë nga ay, në të cilin e shpuri regjimi i Zogut’. Në dallim nga ‘Vatra’, ‘Shqipëria e Lirë’ u kushtoi vëmendje zhvillimeve të brendshme në Shqipëri, duke paraparë mundësinë e krijimit të një qeverie të ardhshme brenda vendit, ose përfshirjen e përfaqësuesve nga Shqipëria në një qeveri që mund të krijohet në emigracion. Për ‘Shqipërinë e Lirë’ ky ishte një problem parimor, ndaj të cilit nuk ndryshoi qëndrim gjatë gjithë periudhës së luftës.

Krijimi i ‘Shqipërisë së Lirë’ nuk u prit mirë as nga Zogu dhe as nga ‘Vatra’ e drejtuesit e saj historikë Konica e Noli. Ata hynë në polemika të forta me njëri-tjetrin. ‘Vatra’ me Konicën e Nolin mbështesnin idenë e krijimit të një qeverie të kryesuar nga Zogu në emigracion, ndërsa Çekrezi dhe ‘Shqipëria e Lirë’ e kundërshtonin atë. Polemika ndërmjet tyre i kalonte shpesh kufijtë e etikës, duke prekur jetën intime, me fyerje e insinuata. Konica e akuzonte Çekrezin si njeri me personalitet të ulët, i cili

147. NARA, RG 226, “Përse u ngruh Shqipëria e Lirë? Cili është programi i saj politik e kombëtar?”, Boston, Mass. 27-28 dhjetor 1941.

kishte përvetësuar paratë e qeverisë shqiptare kur shërbente si komisioner i saj në SHBA, në fillim të viteve '30. Çekrezi i akuzonte të dy, Konicën e Nolin, se po e mbështesin Zogun pasi kishin marrë para prej tij, etj. Mosmarrëveshjet e Çekrezit me Vatrën, Zogun, Konicën [deri në vdekjen e tij në dhjetor 1942] dhe Nolin, vazhduan gjatë gjithë periudhës së luftës, ndonëse pati përpjekje për afrim e modifikim qëndrimesh. Shpesh çështjet parimore përziheshin me motivet personale dhe me lojërat e vogla politike, tipike për 'djemtë e këqij' të Shqipërisë në Amerikë. Qëndrimi disi egoist i Çekrezit i cili vinte veten në krye të gjithçkaje është kritikueshëm. Por sipas opinionit tim ai pati dy merita të mëdha: *së pari*, ai ishte i pari lider shqiptar në emigracion i cili hodhi dhe mbështeti idenë e bashkëpunimit të emigracionit jashtë vendit me krerët e rezistencës në Shqipëri, dhe *së dyti*, kritikoi pretendimin e Zogut, për të qenë ai përfaqësues absolut e legjitim i shqiptarëve, duke qenë në koherencë me vendimet e Konferencës së Atlantikut [gusht 1941]. Rezistenca e shqiptarëve dhe e çdo populli tjetër kundër fashizmit e nazizmit nuk mund të zhvillohej me sukses, nëse forcave brenda vendit do t'u mohohesh e drejta për të pretenduar për pushtet pas mbarimit të luftës. Edhe nëse qeveria e Zogut do të kishte mundur që të siguronte njohjen e Aleatëve të Mëdhenj, fati i të ardhmes së Shqipërisë ashtu siç rrodhën ngjarjet do të vendosej brenda vendit nga vetë populli shqiptar. Shembullin e asaj se çfarë do të kishte ndodhur edhe nëse Zogu do të ishte njohur nga Aleatët e gjejmë te Greqia e Jugosllavia. Qeveritë në emigracion të këtyre dy vendeve u njohën nga Aleatët gjatë Luftës, por e ardhmja e tyre u vendos në zgjedhjet e përgjithshme apo plebishitet që u mbajtën pas mbarimit të Luftës.

Çekrezi bashkëpunoi me Departamentin e Shtetit, me Ministrinë e Luftës dhe Zyrën e Shërbimeve Strategjike (OSS-Office of Strategic Services). Në emër të 'Shqipërisë së Lirë' Çekrezi kërkoi aderimin e Shqipërisë në 'Deklaratën e Kombeve të Bashkuara' (1 janar 1942), njohjen e një qeverie shqiptare në emigracion nga Aleatët e Mëdhenj, ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar pas mbarimit të luftës etj. Çekrezi, 'Shqipëria e Lirë' dhe degët e saj të shumta në Amerikë mbajtën qëndrim kritik ndaj deklaratës së qeverisë britanike të dhjetorit 1942 e cila e la të hapur problemin e kufijve. Dyshimet e forta të Çekrezit për qëndrimin e Britanisë së Madhe ndaj pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut përbëjnë boshtin e librit të tij të botuar në vitin 1951 me titull: *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*.<sup>148</sup> Insistimi i përfaqësuesve të organizatës 'Shqipëria e Lirë' në lidhje me deklaratën e z. Anthony Eden në lidhje me kufijtë e Shqipërisë Jugore nuk mori asnjëherë ndonjë përgjigje mohuese apo pohuese në Foreign Office [FO]. Në Departamentin e Shtetit [DSH] përmendet se Çekrezit i thuhej se Amerika nuk ishte pjesëtare e asnjë marrëveshjeje të hapët apo të fshehtë për kufijtë e Shqipërisë. Ndërsa zyrtarët e ambasadës sovjetike në Uashington përgjigjeshin në mënyrë standarde: kjo ambasadë nuk merret me çështjen e Shqipërisë.<sup>149</sup> Frika e Çekrezit ndaj copëtimit të mundshëm të Shqipërisë nga Greqia nuk u shua as pas mbarimit të Luftës, kur Shqipëria u rreshtua përkrah Bllokut të Vendeve Komuniste, të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik. Çekrezi ishte i shqetësuar për trajtimin që po i bënin qeveritë e tre Aleatëve të Mëdhenj Shqipërisë, edhe në mbarim të Luftës. Për të nuk ishte folur fare në Konferencën e Teheranit (nëntor-dhjetor 1943), ndërsa në konferencën e Jaltës, Josif Stalini e trajtoi Shqipërinë dhe kombet e vegjël, si shtete me të drejta jo të barabarta me shtetet e mëdhenj.<sup>150</sup>

Periudha e Luftës së Dytë Botërore shënon kulmin e pjekurisë dhe karrierës politike të Konstandin Çekrezit. Ai parashtroi përpara shqiptarëve të emigracionit një program politik atraktiv, duke i lënë në hije deri diku si 'Vatrën', ashtu edhe dy drejtuesit e saj natyralë- Konicën e Nolin. Çekrezi u tregua një

148. Copëtimi parë i Shqipërisë sipas Çekrezit kishte ndodhur në vitin 1913 me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, i dyti në Konferencën e Paqes të Parisit në vitin 1919-20 dhe i treti pas shpalljes së deklaratës së qeverisë britanike për Shqipërinë më 17 dhjetor 1942.

149. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 44-45.

150. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 45-46

polemist i shkëlqyer. Ai u mat me Nolin e njohur me shumë eksperiencë, mençuri, kulturë e gojëtari. Çekrezi u premtoi shqiptarëve në emigracion se do të siguronte nga Aleatët pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, se do të arrinte ta bënte të njohur ‘Shqipërinë e Lirë’ te qeveria amerikane dhe më e rëndësishmja, se do të garantonte njohjen e një qeverie shqiptare prej tyre. Por asnjëri nga këto objektiva nuk u arrit. Si rezultat, duke filluar nga mesi i vitit 1942 e mbrapa ‘Shqipëria e Lirë’ u gjend në vështirësi. Një numër anëtarësh e braktisën e u bashkuan me ‘Vatrën’ ose qëndruan neutralë. Në Kuvendin e qershorit të vitit 1943 një pjesë e delegatëve propozuan shkarkimin e tij si drejtues i organizatës ‘Shqipëria e Lirë’. Në rrethanat e krijuara, Kostë Çekrezi u detyrua të bënte një tërheqje taktike. Ai pranoi që ‘Shqipëria e Lirë’ dhe ‘Vatra’ të merreshin vesh për të krijuar një Front të Bashkuar Kombëtar apo Komitet Kombëtar me funksionet e një qeverie në emigracion, i cili mund të drejtohej nga Zogu. Propozimi i Çekrezit ishte i kushtëzuar: *Së pari*, Zogu duhej të pranonte që qeveria e tij do të kishte funksione të përkohshme, vetëm për kohën e Luftës, *së dyti*, të njihje të drejtën e popullit shqiptar që sipas Kartës së Atlantikut të vendoste për formën e regjimit dhe qeverinë që ai dëshironte, dhe *së fundi*, që qeveria e re të arrinte të siguronte njohjen e saj nga të dy Aleatët Perëndimorë të Luftës. As Noli dhe as Zogu nuk besonin se Aleatët e Mëdhenj Perëndimorë do ta njihnin qeverinë shqiptare të krijuar në emigracion. Zogu u tregua shumë i rezervuar ndaj propozimeve të Çekrezit, duke këmbëngulur se të vetmen zgjidhje që do të pranonte do të ishte krijimi i një qeverie në emigracion e bazuar në njohjen e tij si sovranitet juridik.<sup>151</sup> Zogu e konsideronte veten si të vetmin person legjitim që mund të përfaqësonte Shqipërinë dhe shqiptarët. Duhet përmendur se edhe Noli nuk mendonte se Zogu duhej njohur pa kushte. Mandati i qeverisë së tij do të kufizohej vetëm për kohën e luftës, ndërsa forma e regjimit do të vendosej pas luftës, duke u bazuar në parimet e Kartës së Atlantikut.<sup>152</sup> Noli ishte më i moderuar dhe më elastik se Çekrezi, i cili ushqente ambicie për të qenë ai në krye të qeverisë shqiptare në mërgim. Noli e gjykonte më të dobishme për shqiptarët që të kishin një qeveri në emigracion nën autoritetin e Zogut, të cilin ai e konsideronte si personin më të përshtatshëm dhe më me autoritet, se sa fare pa qeveri.

Në maj-qershor 1944 në Londër u zhvilluan disa takime sekrete ndërmjet të autorizuarve të Zogut dhe përfaqësuesve të ‘Shqipërisë së Lirë’, Tajar Zavalani, Anton Logareci dhe Dervish Duma.<sup>153</sup> ‘Shqipëria e Lirë’ e pranoi idenë e krijimit të një Komiteti Kombëtar me në krye Zogun, ndonëse pëlqente idenë e krijimit të një Fronti të Bashkuar. Pëlqimi i dhënë nga ‘Shqipëria e Lirë’ shënonte kulmin e lëshimeve të ‘ndaj Zogut, ndërkohë që ky i fundit refuzoi të pranonte dy kushtet e saj. Së pari, që Zogu të pranonte të qëndronte jashtë Shqipërisë deri sa të mbahej plebishiti që do të përcaktonte formën e regjimit [republikë apo monarki], dhe *së dyti*, që të pranonte ardhjen e menjëhershme në Londër të përfaqësuesve nga Shqipëria, të cilët duhet të merrnin pjesë në Komitetin Kombëtar që do të krijohej.<sup>154</sup> Zogu, sipas Tajar Zavalanit, nuk i pranoi këto dy kushte, sepse nuk donte të komprometonte legjitimitetin e tij. Foreign Office nga ana e vet i këshilloi përfaqësuesit e emigracionit shqiptar të mbledhur në Londër, që fillimisht të bashkoheshin kudo ku ndodheshin, dhe pastaj t’i kërkonin qeverisë angleze që të njihje Komitetin Kombëtar.

Ideja për të krijuar një qeveri të përbashkët të ‘Vatrës’ dhe ‘Shqipërisë së Lirë’ u diskutua më 3 korrik 1944 në Boston nga përfaqësuesit e dy organizatave. Çekrezi ishte iniciatori i këtij takimi, vendimet e të cilit ai, Qerim Panariti dhe Theodhori Katelli, më 11 gusht ia prezantuan edhe DSH.<sup>155</sup>

151. NARA, Roll 15, Secret, 504, ALBANIA BASIC HAND BOOK, 1943, gusht 1943.

152. TNA, WO 204/0962, Volume 4(MR), *Handbook of Albanian Personalities*, May 1945.

153. NARA, RG 226, File 80244, “Lack of Agreement between Zogist and Anti-Zogists in London - Mungesa e Marrëveshjes ndërmjet zogistëve dhe antizogistëve në Londër”, 7 July 1944, pp.1-2.

154. NARA, RG 226, File 80244, “Lack of Agreement between Zogist and Anti-Zogists in London - Mungesa e Marrëveshjes ndërmjet zogistëve dhe antizogistëve në Londër”, 7 July 1944, pp. 1-2.

155. NARA, Roll 15, 875.00/8-1144, Memorandum bisede i takimit të Qerim Panaritit, Kostandin Çekrezit dhe Theodhori Katellit me Cavendish Cannon, Hohenthal e Huston në Departamentin e Shtetit, më 11 gusht 1944.



Emërtimi i institucionit DREJT. SIG. SHTETI  
Emërtimi i sektorit 26. POLITIK

Vidi 1049

DOSJA Nr. <sup>29</sup>472

AIDSSH, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i Zbulimit Politik, Dosje nr. 39 për Konstandin Çekrezin

TITULLI I DOSJES

MATERIALI SHPI DERDUR  
MIN AGJENTURIAZ DE KRIMINE LIT  
ROSTA ÇEKREZIT.

AID

Afati i ruajtjes \_\_\_\_\_  
Sasia e fletëve 52

Ka filluar më 1948  
Ka mbaruar më 1959  
Numri rendor \_\_\_\_\_ I Inventarit

Raportime për Konstandin Çekrezin

Kosta Çekrezi

I pa pozite zyrtare, mik i ngushtë i Xhamit. Ka qenë me influencë të madhe një kohë në departamentin e Francës u njëf me një pesëkë amerikanë në shtëpinë e secilës jetonte. Bante alkoolik i madh. Shkruan artikuj të ndryshëm dhe u a chat gazetarëve në klubin e katyres.

Fleko i vëniq dhe in la një përurite madhe hotelësh në New York dhe Washington. Bante i ofertë në departamentin, fyne e del shpesh.

U nxuare nga materjalet e " 66 " date 16.IX.1958 prej M. M. me 8.1.1959

*Kosta Çekrezi ka qenë një përvdiq. Është kate  
Ministria e Punëve të Jashtme të Amerikës  
19/10/1958*

AIDSSH

DEMI E I-re

Tirone me 6 Rendor 1950

JCHOU GENERAL

Shprehënjitur ju dergojme një lister që agjenti amerikan Kosta Çekrezi i ka drejtuar Kuvendit të 5 Shqipërisë së Lire\* ( një nga të dy organizatat e mëdha të kullonise shqiptare në Amerikë), me synim e as cilës i ftan stin që të ndërtojë qendria dhe të afrohen meqëse për politikën e imperializmit amerikan, duke a përparitur ai n'interesa të Shqipërisë.

Me këtë rast ju bëjmë të ditur se Kosta Çekrezi është një nga themeluesit e " Shqipërisë së Lire", por në vitin 1945 në vendim të Kuvendit u dëbua për qendria s'raiqeser karshi Republikës s'one.

Lutem që abasi të kini shëruar punë, letra të na rikthehet për arsye se nuk posedojmë kopjetjeter.

Kryetar i Deger se I-re

N/Kolonel  
( Zoi Tashaj )

Përfaqësuesit e emigracionit shqiptar gjatë takimit në DSH u interesuan që të njihnin opinionin e qeverisë amerikane për dy çështje të rëndësishme. *Së pari*, se a do të ishte praktike që të ngrihej një qeveri shqiptare në mërgim, dhe *së dyti*, a mund ta njihnin ata qeverinë e FNÇ të dalë nga Kongresi i Përmetit? Opinioni paraprak i delegacionit të shqiptarëve shkante në favor të njohjes së qeverisë së dalë nga Kongresi i Përmetit, por ata nuk ishin të vendosur. 'Ata ishin veçanërisht të etur të dinin se cila qeveri do të kishte shansin më të mirë për të siguruar njohjen zyrtare [nga qeveria amerikane], dhe kështu t'i mundësonin Shqipërisë që të bëhej anëtare e Kombeve të Bashkuara'.<sup>156</sup> Dokumenti i mësipërm dëshmon se Kostë Çekrezi dhe shqiptarët e Amerikës kishin dijeni për mbajtjen e Kongresit të Përmetit. Por lidhjet e tyre me FNÇ ishin të dobëta dhe sporadike. Delegacioni ushtarak shqiptar nga Bari, më 10 gusht 1944 u drejtoi thirrje organizatave të 'Shqipërisë së Lirë', 'Vatër' dhe mbështetësve të Zogut që të njihnin qeverinë e Përmetit.<sup>157</sup>

Në vjeshtën e vitit 1944 Çekrezi dhe 'Shqipëria e Lirë', sikurse 'Vatra' dhe Noli si përfaqësues i Kishës Ortodokse të Pavarur të Shqiptarëve të Amerikës morën vendimin për të njohur e mbështetur qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit. Më 6 tetor 1944 Konstandin Çekrezi dhe Qerim Panariti u paraqitën në DSH dhe kërkuan që të njihje qeveria e Përmetit.<sup>158</sup> Vendimi për të njohur qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit ishte marrë që më 17 shtator nga Komiteti Drejtues i organizatës 'Shqipëria e Lirë' që drejtohej nga Kostë Çekrezi. Qerim Panariti dhe Kostë Çekrezi u paraqitën edhe në emër të Komitetit Shqiptaro-Amerikan. Zoti Huston e refuzoi kërkesën e tyre. Ai u bëri të qartë bashkëbiseduesve, se njohja e saj do të thoshte ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë dhe njëkohësisht dhunim i parimeve të vetë kësaj qeverie, si zgjedhje e vetë popullit shqiptar.<sup>159</sup>

Më 2 nëntor 1944, Konstandin Çekrezi i drejtoi Presidentit Roosevelt një telegram me shumë ankesa e fajësime për qëndrimin e mbajtur nga Aleatët e Mëdhenj në përgjithësi dhe në veçanti, nga qeveria amerikane ndaj çështjes shqiptare.<sup>160</sup> Ai ankohej për trajtimin e diferencuar që i ishte bërë Shqipërisë nga Presidenti, i cili nuk e kishte përmendur së fundi emrin e saj, në listën e gjatë të viktimave të agresionit fashist. Lista e kritikave ishte e gjatë. Ai i bënte të ditur Ruzveltit se Shqipëria nuk ishte thirrur në Konferencën e Breton Woods-it, se Departamenti i Shtetit nuk e kishte njohur Komitetin shqiptaro-amerikan, të prezantuar prej tij më 11 gusht 1944, se nuk e kishte njohur qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit, për shkak se ajo dominohej nga një bërthamë komuniste, se nuk kishte pranuar të njihje asnjë qeveri të krijuar në mërgim, se i kishin refuzuar propozimet e ardhura nga 'Shqipëria e Lirë', madje nga mbreti Zog. Por një ditë më pas Çekrezit i erdhi përgjigja nga DSH. Cavendish Cannon, si shef i Divizionit të Çështjeve të Evropës Jugore e njoftoi se ishin njohur me përmbajtjen e telegramit, dhe se shqetësimet e Çekrezit për çështjen shqiptare ishin edhe shqetësime të disa oficerëve të këtij Departamenti.<sup>161</sup> Konstandin Çekrezi më 14 dhjetor 1944 iu drejtua Sekretarit të ri sapoemëruar të Departamentit të Shtetit, Edward R. Stettinius me kërkesën për njohje e qeverisë së Beratit. Ai iu lut gjithashtu zotit Stettinius, që të ndërhynte edhe te qeveritë e Britanisë së Madhe dhe të Ruisë, që edhe këto të bënin të njëjtën gjë. Njohja e shpejtë, sipas Çekrezit do ta shpjegonte zbatimin e programit të UNRRA-s për Shqipërinë. Ai kërkoi gjithashtu që ndërmjet Amerikës dhe Shqipërisë të rivendosej komunikimi postar.<sup>162</sup>

156. Po aty.

157. AQSH, Fondi 41, Dosja 154, viti 1944.

158. NARA, Roll 16, 875.01/10-744, Department of State, Southern European Division, Memorandum for Files-Albania, October 7, 1944.

159. NARA, Roll 16, 875.01/10-744, Department of State, Southern European Division, Memorandum for Files-Albania, October 7, 1944.

160. NARA, Roll 16, 875.01/11-344, Telegram of Chostantine Chekrezy to Hon, Franklin D. Roosevelt, White House, November 2, 1944.

161. NARA, Roll 16, 875.01/11-344, Telegram of Chostantine Chekrezy to Hon, Franklin D. Roosevelt, White House, November 2, 1944.

162. NARA, Roll 16, 875.1/12-144. C A Chekrezy to Hon. Edward Stettinius, December 14, 1944.

Kostë Çekrezi ka disa analiza me interes edhe për forcat politike e ushtarake në Shqipëri gjatë LDB. ‘Balli Kombëtar’, sipas tij, nuk ishte një parti homogjene, por një grup i madh në radhët e të cilëve gjendeshin bejlerë, agallarë, arkondë, klerikë dhe fshatarë. Ai ishte formuar nga mbetjet e organizatës ‘Bashkimi Kombëtar’, të cilët kundërshtonin fashizmin dhe njerëzit e tij si Shefqet Vërlaci e Mustafa Kruja. Balli, sipas tij, bënte sikur bashkëpunonte me italianët, por nga ana tjetër i sabotonte ku të mundej me anë të çetave të armatosura. Por brenda Ballit kishte një tog elementësh të pandershëm, të cilët vodhën, dogjën, vranë e çnderuan emrin e Tij në sytë e popullit shqiptar.<sup>163</sup> Marrëdhëniet e Ballit Kombëtar me Komitetin Nacional të Çlirimit [Lëvizjen Nacionalçlirimtare] ishin bashkëpunuese deri në Konferencën e Teheranit, por pas njohjes së qeverisë së marsallit Tito nga Anglia dhe Amerika, raportet ndërmjet të forcave të lartpërmendura shqiptare ndryshuan. Për Shqipërinë, sipas tij, nuk u fol fare në Konferencën e Teheranit.

Njohuritë e Çekrezit për forcat politike e ushtarake në Shqipëri ishin të pakta dhe shpjegimet e tij jo rrallë të pasakta. Lëvizja Nacionalçlirimtare, të cilën Çekrezi e emërton si Komiteti Nacional i Çlirimit apo Komiteti Nacional i Shqipërisë u ngrit mbi idetë e Komitetit të Çlirimit Nacional të Kominternit. Shumica e madhe e popullit shqiptar, që nuk ia donin shëndetin as Vërlacit, as Mustafa Krujës, që nuk pëlqenin aspak politikën me dy faqe të Ballit dhe që urrenin emrin e Zogut, u tërhoqën dalëngadalë drejt Komitetit Nacional të Çlirimit, i cili premntonte se me ardhjen e tij në fuqi Shqipëria do të bëhej ‘lulja e Ballkanit’, ku do të mbretëronte liria, drejtësia, barazia, vëllazërimi dhe do të sigurohej ‘bukë për të gjithë’, ... ëndrra këto për çdo popull të shtypur’.<sup>164</sup> Shkurt, – shkruan Çekrezi, – Balli e humbi luftën se nuk mundi ose nuk diti ta bëjë popullin shqiptar për vetë’. Shqipëria, ndryshe nga shumë vende e popuj të tjerë, ‘e liroi krejt veten nga okupata armike pa ndonjë ndihmë ose ndërhyrje ushtarake nga jashtë nga ana e Fuqive Aleate’.

---

## Paslufta: Çekrezi socialdemokrat dhe kundërshtar i regjimit komunist

---

Çekrezi nuk u pajtua me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri pas mbarimit të luftës dhe marrëdhëniet që qeveria shqiptare ndërtoi me SHBA dhe me Demokracitë Perëndimore. Ai u nda nga organizata ‘Shqipëria e Lirë’ në maj 1945, duke dhënë dorëheqjen dhe pas kësaj periudhe deri në vdekje, ai mbajti qëndrim kritik ndaj saj, ‘Vatrës’, Nolit dhe kujtdo tjetër që mbështeste qeverinë e Tiranës. Formimi i tij si liberal-demokrat nuk e lejonte Çekrezin të pajtohej me realitetin komunist të Shqipërisë dhe me mbështetjen që iu dha asaj nga ‘Shqipëria e Lirë’, ‘Vatra’ e Noli. Qëndrimi i tij kritik është pasqyruar në librin e fundit, të shkruar në vitin 1951 me titull: *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*. Shkaqet e ndarjes së tij me ‘Shqipërinë e Lirë’-organizatë të cilën ai e ngriti dhe drejtoi për një periudhë gati 4 vjeçare, Çekrezi i ka shpjeguar në një letër që i drejtoi Kuvendit të 9-të të saj, në qershor 1950.<sup>165</sup> *Së pari*, ai përpiket që të largojë përgjegjësinë e tij nga disa vendime që mori Kuvendi i ‘Shqipërisë së Lirë’ në maj 1945, të cilat preknin programin esencial të saj të miratuar në Kuvendin e Parë në dhjetor 1941. ‘Shqipëria e Lirë’ hoqi dorë nga një pikë e rëndësishme e programit që i kushtojë bashkëpunimit me të gjithë Aleatët dhe veçanërisht me SHBA, në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar. *Së dyti*, ai mundohet që të rrëzojë akuzat që iu bënë personalisht Çekrezit, si shkaktari i mosbashkimit të shqiptarëve të Amerikës. *Së treti*, për t’u hapur rrugën dhe t’u krijohej

---

163. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 50–56.

164. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f.52–53.

165. AMPB, Dosja 29, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i Zbulimit Politik, 1 qershor 1950.

Letër Enver Hoxhës për Konstandin Çekrezin

THE NEWSPAPER  
DIELLI  
PRINTED AND PUBLISHED  
BY VATRA-NEWSPAPER

The Yun-Albanian Federation of America  
VATRA  
HEADQUARTERS - 168 HUNTINGTON STREET  
BOSTON, MASS. 02116  
17 Janar, 1947

I dashur Kryeminister:

Ketu brenda po ju abull kjo qe mori imtot Noli nga Zoti Kosta Çekrezin, te cila mund qe te perdor si te duar. Peshkopi nuke fuq...  
Pasi u-mentuash mire kufytava se kjo letre mund...  
Qeverise Shqiptare qe te informohet se qpo sil...  
shka nevojte per koment nga ana ime, vetem desh...  
me kete rast se kjo eshte nje nga aresyet se p...  
po heshtojme qe te lidhim ne organizaten Shq...  
e larte te shqites kane pasur dhe kane lidhje...  
Çekrezi.

Me shume te fala e nderime,  
Enver Hoxha  
Qerim Panariti,  
Editori i Diellit.

Gjeneral-Kol. Enver Hoxha  
Kryeministri i Shqiperise  
Tirane, Shqiperi

45/68

Model N. 7  
TEPER SEKKEK

**KERKESE**

Sekcioni Evidencës Operative  
Pranë Drejtoris Zbulimit Publik M. P. M.

Lutemi kontrolloni si pas evidencave:

Mbiemri Çekrezin  
Emri Kosta  
Atësia Napolitane  
Dat Lindia 1891 Kombësia Shqiptare nënshtrësia Shqiptare  
Vend Lindia Kufytava e Qeverise Shqiptare  
Në cilat shtete ka jetuar më parë dhe ku ndodhet në kohën e tashme Në qytet...  
... 13-Febr 1931:...

INFORMACIONI IBI AGJENCIA E DEPARTAMENTIT TE SHTETIT

Jane intervejuar kës gjeje agjenciat Shqiptare qe qe aserbejne ne...  
Ded. e Shtetit dhe deri tashmi rezultojne qe qe me siguri si tashmi...  
kete elemente.

- 1- Kostadin Çekrezi Washiktón
- 2- Qerim Panariti ne Vatra, Boston
- 3- Stefan Lasko dhe i Velaj " " " "
- 4- Lluji Prifti Kryetar i Kom. te Jergeni.
- 5- Nald Dindari qe te A. Rini

Te larte përmendurit nuk difet se ofane relatare te rregullta due...  
te pa rregullta shajne ne dety. Vete, jane pare vashdimit ne kontakte...  
me elenata te Qeverise Shqiptare, si qe tyre kane zane vend ne per...  
Org. e ndryshme te Shqiptarve te Amerikes dhe qe keteje /pervec punes infór...  
ative qe mund te bejne ne direkt dhe ku indirekt bene propegande e kapin...  
parulla kunder Shqiperise. Si p.sh. fain e shprehjen qe te kqija mndie...  
Shqiperise dhe Amerikes ja hedhin Shqiperise etj.

Per neve me i rrezikshmi tashmi paraqitet Qerim Panariti, abasi ai...  
ka zane qendrite ne Vatra. Dhe bile Qerimi se qe u grind ne delegacionin...  
te, qe per punen e Komitetit te ndiemave, pesh ne nje nga Nr. e fundit te...  
ironizonte rreth punes se "Brigadeve Kulturele" ne Shqiperi, si edhe rreth...  
shvillimit te proçesit ne Shqiptet Bejor.

Per sa i perket Kosta Çekrezi, si qendron gjithean Ketu ne Washiktón...  
tón. Ite po para disa diteve shkoi ne New-York dhe u takua me delegacionin...  
Atij delegacioni i u shfaq baxtasi si i derguar e Dept. te shtetit dhe e...  
ftoi qe te vinte ne Washiktón, per te aser kontakt me ndonje nga zyrtaret...  
e Dept. e per te biseduar rreth shprehjenve diplomatike te Shqiperise...  
me Ameriken. Ite delegacioni i tha te shprehim nga tjetër i shkrori Ministria...  
dhe nuk diq ne se i shkrori ndonje përgjigje rreth kësaj osantje due jé.

Raport i Sigurimit të Shtetit për Konstandin Çekrezin

Kërkesë seksionit të evidencës operative të Sigurimit të Shtetit për Çekrezin

mundësia të gjithë atyre që mendonin se Çekrezi ishte bërë pengesë për pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara dhe për njohjen e saj nga qeveria amerikane. Në maj 1945 Kuvendi i 'Shqipërisë së Lirë' nuk i mori në konsideratë vërejtjet e Çekrezi, por vendosi të përkrahte në masën 100% dhe pa kushte qeverinë e gjeneral Hoxhës, pa marrë në konsideratë rrethanat dhe marrëdhëniet e saj me qeverinë e SHBA.<sup>166</sup> 5 vjet më vonë, asnjë nga objektivat e 'Shqipërisë së Lirë' nuk ishte arritur, përkundrazi, ishte armiqësuar më shumë me qeverinë e SHBA. Përpjekjet për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy vendeve kishin dështuar. 'Shqipëria e Lirë' sipas Çekrezi, ishte tashmë një agjenci e thjeshtë propagandistike e qeverisë së Tiranës.

Çfarë kishte ndodhur me Çekrezi ndërkohë që ai kishte qenë partizan i vendosur i bashkëpunimit me faktorin e brendshëm në Shqipëri gjatë gjithë periudhës së Luftës, dhe e kishte njohur pa hezitim si qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit ashtu edhe atë të Mbledhjes së Beratit? Është e vështirë t'i japësh përgjigje të qartë kësaj pyetjeje. Marrëdhëniet jo të mira të qeverisë komuniste me SHBA dhe Britaninë e Madhe, e ardhmja e vendit të tij të lindjes larg modelit perëndimor, që ai kishte mbrojtur gjatë gjithë jetës së tij dhe sidomos dhuna e përdorur për vendosjen e regjimit të ri, duket se e shpjegojnë metamorfozën e tij. Çekrezi kishte kontakte të vazhdueshme me Departamentin e Shtetit dhe e njihnte më mirë se të tjerët situatën jo të mirë në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Qëndrimin e tij ndaj regjimit komunist të Shqipërisë ai e bën të qartë në kapitullin e VI të librit të tij *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*. Çekrezi e konsideron të shkëlqyer triumfin e forcave çlirimtare, që e kishin çliruar vendin pa ndërhyrjen ushtarake të Aleatëve. 'Vendi ynë vazhdon më tej Çekrezi u lirua nga pushtimi i huaj për të hyrë nën zgjedhjen e një ideologjie të huaj.<sup>167</sup> Ana tjetër e regjimit komunist në Shqipëri, përmend ai, ishte dhuna e ushtruar ndaj kundërshtarëve të regjimit duke përfshirë ballistët, zogistët, liberalët dhe shumë persona të tjerë me kontribute në luftë, por me pikëpamje të ndryshme nga ato të komunistëve shqiptarë. Duke iu referuar ngjarjeve të ndodhura në Tiranë, më 27 nëntor 1944, Çekrezi do të shkruante: "Në atë datë të paharrueshme për popullsinë e kryeqytetit, Tirana jepte pamjen e një kasaphane të tmerrshme, në të cilën gjaku i ushtarëve gjermanë u trazua me gjakun e kundërshtarëve shqiptarë të Komitetit Nacional të Çlirimit, ballistë, zogistë, liberalë, fajtorë ose të pafajshëm. Të ndezur nga lufta dhe të etur për hakmarrje, partizanët u vërsulën nëpër kafene dhe vende të tjera publike dhe private për të vlarë çdo njeri që ishte shënuar që më parë si 'armik i popullit'...për t'u bërë shembull për të gjithë kundërshtarët e regjimit të ri'.<sup>168</sup>

Gabimi tragjik i shumë shqiptarëve kishte të bënte me faktin se 'ata nuk e kishin kuptuar se forcat e Komitetit Nacional ishin organe të një revolucioni përmbysës të gjithë sistemit të vjetër politik, ekonomik, shoqëror për të ngritur në vend të tij një sistem krejt të ri'.<sup>169</sup> Në Shqipëri po ndodhte një revolucion, dhe si të gjithë revolucionet ai do të shoqërohej me dhunë, masakra e ekzekutime. Për të bërë të besueshme këtë tezë, Çekrezi i referohej praktikës së dhunshme të Revolucionit Francez, Revolucionit të Tetorit në Rusi, por edhe traditës dhe ashpërsisë së popujve ballkanikë, të cilën ai e sintetizon me shprehjen 'nuk bëhet dasmë pa therur mish'. Baza e komunizmit është diktatura. "Diktaturat ideologjike, qofshin fashiste, naziste ose komuniste, veshin rrobat e idealizmit për t'ia arritur qëllimit të tyre më me efektivitet".<sup>170</sup>

166. AMPB, Dosja 29, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i Zbulimit Politik, 1 qershor 1950.

167. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 63.

168. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 67-58.

169. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 58.

170. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 62.

Çekrezi ka vlerësuar disa masa të rëndësishme ekonomike e sociale të ndërmarra nga regjimi komunist pas çlirimit të Shqipërisë, të cilat zhdukën edhe gjurmët e fundit të feudalizmit dhe të jetës primitive e patriarkale. Ai përmend reforma të tilla, si: emancipimi i gruas, zhdukja e influencës së klerit mbi ‘shumicën injorante të popullit shqiptar, reformën agrare, etj’. Çekrezi nuk flet për zhdukjen e feudalizmit, por të mbeturinave të tij, sepse Zogu, gjykonte ai kishte ndërmarrë disa reforma të pjesshme, ndërsa regjimi komunist e zgjidhi këtë problem në mënyrë radikale. Kodin Civil ai e quan ‘monument të gjallë të regjimit zogist. Çekrezi vë përballë njëra – tjetrës reformën agrare të kohës së Zogut, në të cilën kishte dhënë kontributin e tij personal, si anëtar i Këshillit të Shtetit, dhe reformën agrare të regjimit komunist. ‘Zogu, shkruan Çekrezi, e zbatoi pjesërisht ligjin për reformën agrare, pasi qëllimi i tij ishte që të godiste disa prej kundërshtarëve të tij. Reforma agrare e ‘Pushtetit Popullor’ e zgjidhi radikalisht problemin, dhe u dha tokën fshatarëve, por këta të fundit, sikurse ish-pronarët e tyre, u shndërruan në bujq të shtetit. Reformat e marra nga regjimi komunist në Shqipëri, shkruante Çekrezi nuk kishin si qëllim kryesor ‘të mirën e popullit’, por konfirmimin pikë për pikë të dogmës socialiste-komuniste, sipas së cilës ‘shteti është zot i gjithë pasurisë së vendit, i cili rregullon çdo veprim dhe sjellje të qytetarëve të vet në pikëpamje politike, shoqërore, ekonomike, fetare e familjare’.<sup>171</sup> Në një regjim të tillë, nuk mund të bëhet fjalë as për liri, as për lumturi, as për vëllazërim, as për barazi’. Populli që i dha mbështetje Komitetit Nacional të Çlirimit, – nënvizonte Çekrezi, – duke iu referuar zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, nuk e kishte as idenë më të vogël se Shqipëria do të futej në kallëpin komunist. Mbi këtë pikë – shton ai, – nuk kishte dijeni as ndofta shumica e pjesëtarëve të qeverisë që u formua në Përmet në maj të 1944’.<sup>172</sup> “Fshirja nga faqja e tokës shqiptare e klasës së bejlerëve, arkondëve dhe bajraktarëve që kishin sunduar vendin prej shekujsh, u krye aq efektivisht saqë, edhe me zhdukjen e regjimit të ri [komunist], të mos mbetet mundësi që ajo klasë të fitojë ndonjë ditë pozitën që kishte gëzuar më parë, së paku jo në shkallën e kohës së kaluar”.<sup>173</sup>

Në vitin 1951 Sigurimi i Shtetit vendosi t’i çelë dosjen Konstandin Çekrezit dhe ta regjistrojë atë në kategorinë II-A me pseudonimin ‘Tomasi’. Dosja përmban këtë motivacion: ‘si agent amerikan që paraqet rrezikshmëri për interesat e vendit tonë’.<sup>174</sup> Duket se ‘kupa u mbush’ në vitin 1949 kur Çekrezi krijoi shoqërinë ‘*Të shpëtojmë Shqipërinë*’ e cila kishte si objektiv kryesor orientimin e Shqipërisë drejt SHBA. Çekrezi u akuzua se bashkëpunonte me Departamentin e Shtetit, se bënte propagandë kundër regjimit komunist në Shqipëri, se mbante kontakte me ish-kriminelët e luftës të kthyer në Amerikë, etj. Nuk ka dyshim që ai nuk e donte regjimin komunist dhe nuk pajtohej me frymën antiamerikane e përçarëse që injektonte ngado regjimi komunist në Shqipëri dhe të dërguarit e tij në Amerikë. Por ai nuk hoqi dorë nga ideja e bashkëpunimit e madje shkrijes së dy organizatave më të mëdha të emigracionit shqiptar në Amerikë. Çekrezi mbajti qëndrim kritik ndaj politikës së jashtme e të brendshme të qeverisë komuniste, por edhe ndaj shqiptaro-amerikanëve që mbështetnin atë, si Noli, Qerim Panariti, etj. Ndonëse gazeta ‘Dielli’ e ‘Liria’ nuk pranonin t’i botonin shkrimet e tij Çekrezi nuk i ndërpreu përpjekjet për të bindur krerët e tyre që të bashkoheshin e të bashkëpunonin me qeverinë amerikane në të mirë të Shqipërisë. Ai vazhdoi gjithashtu të ruante kontaktet me disa figura të njohura të diplomacisë shqiptare, si Mihal Prifti, Kahreman Ylli, deri në vitin 1950. Qeverisë shqiptare nuk i interesonte fryma e kohezionit të këtyre organizatave, ndërsa disa përfaqësues të saj në Kombet e Bashkuara u munduan që t’i mbanin shqiptarët e Amerikës të ndarë e përçarë.<sup>175</sup> Ndër shqetësimet e tij të mëdha ishte edhe nëna e tij plakë në Ziçisht të Devollit, gjendja e së cilës nuk ishte e mirë. Çekrezi e kishte gati të pamundur të komunikonte me të, prandaj iu drejtua

171. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 65.

172. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 66.

173. Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 63-64.

174. AMPB, Drejtoria e Sigurimi të Shtetit, Dosja 29, vitet 1947-1959, 28 prill 1951.

175. AMPB, Drejtoria e Sigurimi të Shtetit, Dosja 29, vitet 1947-1959, 31. 5. 1949.

# C. A. Chekrezi, Albanian Exile

Constantine A. Chekrezi, an Albanian patriot who was successively journalist, statesman, rebel and prisoner in his country's behalf, died of a heart attack Saturday in the Clarendon Trust Co. building, Arlington.

Mr. Chekrezi, who was 66 years old, lived for the past 17 years at 1918 Kirkwood rd., Arlington.



Born in Zicisht, Albania — then under Turkish rule— he studied in Korcha, Albania, and Salonika, Greece, and graduated from Harvard College in 1918.

He began his advocacy of Albanian freedom in 1914 as editor of two Albanian-English publications in Boston After Albanian independence was established at the end of World War I, Mr. Chekrezi became Commissioner to the United States.

AIDSSH, Dosje nr. 39 për  
Konstandin Çekrezin, njoftimi  
i vdekjes në Washington Post

për ndihmë të afërmve e miqve të tij në Amerikë e në Shqipëri, duke përfshirë edhe disa emra të njohur, si Mihal Prifti e Kahreman Ylli.

Si njeri me pikëpamje socialdemokrate ai e kishte gjithashtu të vështirë të pajtohej me kërret e emigracionit të ri politik. Pozicioni prej kritiku dhe pajtimtari ishte e vështirë të kuptohej për bashkatdhetarët e tij në Amerikë. Kritikat e tij u drejtuan ndaj të dy palëve, si ndaj drejtuesve të emigracionit të vjetër, ashtu edhe më emigracionin e ri të ardhur pas LDB. Qëndrimi kritik nuk la jashtë as Komitetin 'Shqipëria e Lirë' dhe as peshkopin spekulant e përçarës të Kishës Ortodokse të Shqiptarëve të Amerikës, Mark Lipen. Çekrezi ndoqi rrugën e mesme, që për fatin e tij të keq nuk u kuptua nga shqiptarët e Amerikës, të cilët pëlqenin ekstremet. Megjithëse 'Vatra'<sup>176</sup> evoluoi gradualisht, duke u larguar nga afeksioni i saj për qeverinë komuniste, prapëseprapë marrëdhëniet e tij me kërret e saj dhe të organizatës 'Shqipëria e Lirë' vazhduan të mbeteshin të ngrira. Duket se e shkuara vazhdonte ende të rëndonte shumë. Sidoqoftë Noli nuk i kurseu disa fjalë të mira të merituar në ceremoninë e varrimit të Çekrezit në vitin 1959. "Vdiq fukara një burrë i madh i Shqipërisë".<sup>177</sup>

176. Përfshirja në gjirin e 'Vatrës' të këtij kontingjenti erdhi pas dy modifikimeve që iu bënë statutit të saj në shtator 1958: *Së pari*, që 'Vatra' nuk duhet të kishte marrëdhënie me ato shtete me të cilat SHBA nuk kishin marrëdhënie diplomatike, d.m.th nuk duhet të kishte lidhje me Shqipërinë. *Së dyti*, në shtator 1958 Kuvendi i 'Vatrës' ndryshoi statutin e saj, duke miratuar një klauzolë, sipas së cilës në të mund të pranoheshin 'të gjithë bijtë e racës shqiptare'. Liberalizimi i statutit përmes këtij neni krijonte mundësinë që në të hynin të gjithë shqiptarët, duke përfshirë edhe emigrantët politikë të mbërritur në këtë Amerikë pas Luftës së Dytë Botërore.

177. Andon Andoni, *Kostë Çekrezi: I treti i munguari*, Tiranë: Naimi, 2016, f. 6.

# Tajar Zavalani





# Komunisti i zhgënjyer nga stalinizmi

Tajar Zavalani u lind më 15 gusht 1903 në qytetin e Korçës. Ai ishte djali i aktivistit dhe nacionalistit shqiptar Fehim Zavalani, me origjinë nga Dangëllia e Përmetit. Ndoqi shkollën katolike franceze ‘Marist Brothers’ në Manastir, për të vazhduar më pas studimet në degën e letërsisë në shkollën franceze të Selanikut.

**NGA HAMIT KABA**

Tajar Zavalani është një nga veprimtarët më aktivë të së majtës shqiptare në periudhën midis dy luftërave botërore dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore [LDB]. Ai ka lënë trashëgimi të pasur politike, historike, publicistike, por edhe në fushën e gazetarisë dhe të përkthimeve. Veprimtaria më produktive e tij u zhvillua jashtë Shqipërisë, në BS kur ishte djalë i ri, dhe në Angli [Londër] që nga viti 1940 e deri në vdekjen e tij në vitin 1966. Zavalani ishte i pakënaqur me gjendjen e prapambetur të Shqipërisë dhe me qeverisjen e Zogut. Modelin tjetër fillimisht ai e kërkoi në Moskë të komunizmi sovjetik, por gradualisht u zhgënjye prej tij dhe përqafoi idetë socialdemokrate të mishëruara të demokracisë perëndimore. Është vështirë të gjendet një person tjetër i ngjashëm me Tajar Zavalanin, që të jetë endur aq gjatë sa ai, në kërkim të modelit më të mirë për të ardhmen e vendit të vet. Gjithashtu është e vështirë të gjendet dikush tjetër si ai që të ketë pësuar një metamorfozë të vërtetë të bindjeve të tij politike. Pas LDB Tajari u shndërrua në një antikomunist të hapur kundër regjimit komunist që u vendos në Shqipëri dhe kundër sistemit komunist në përgjithësi.

Një tjetër veçori e personalitetit të tij ka qenë aftësia për të gjetur mirëkuptim dhe për të bashkëpunuar me persona e njerëz të rëndësishëm, të cilët nuk mendonin si ai. Kjo veti e Zavalanit spikati në veçanti gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, kur u zgjodh nënkryetar i organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ të Bostonit dhe njëkohësisht përfaqësues i seksionit të saj në Londër. Në dallim nga natyra egocentriste dhe jo elastike e drejtuesit të Organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ dhe mikut të tij – Konstandin Çekrezit, Tajar Zavalani ishte i aftë të kontaktonte me të gjitha kahet e emigracionit shqiptar, [me Ahmet



Emigrantë antizogistë në Bashkimin Sovjetik. Poshtë S. Malëshova, S. Shpuza, Ll. Fundo dhe sipër, R. Këlliçi e T. Zavalani

Zogun, Faik Konicën, Fan S. Nolin, Qerim Panaritin, etj.], por edhe diplomatët e Foreign Office dhe britanikët dashamirës të Shqipërisë dhe çështjes shqiptare në Londër. Tajar Zavalani ka folur e ka shkruar edhe për rëndësinë dhe nevojën e lidhjeve e kontakteve të emigracionit shqiptar me forcat e rezistencës në Shqipëri, për mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet tyre deri në krijimin e një qeverie të përbashkët.

Interesante janë edhe analizat e tij në fushën e ekonomisë së centralizuar të modelit sovjetik dhe të ekonomisë së tregut të lirë.<sup>178</sup> Ndryshe nga miku i tij, Konstandin Çekrezi që e shihte Britaninë e Madhe si rrezik për 'copëtimin e tretë të Shqipërisë', Zavalani e konsideronte atë si shtetin më të mundshëm që do të mbështeste Shqipërinë e pasluftës. Bashkëpunoi me disa gazeta e revista shqiptare në vitet '30 dhe përktheu një numër veprash të rëndësishme nga letërsia botërore duke përfshirë dhe romanin 'Nëna' të shkrimtarit sovjetik Maksim Gorki, që u bë frymëzim për rininë shkollore në periudhën midis dy luftërave. Në Angli punoi si gazetar pranë BBC, por botoi disa artikuj në gazetat më në zë në Londër. Pa dyshim libri *History of Albania* zë një vend të veçantë në veprat e tij. Autori e hartoi pjesën e parë në vitet e Luftës së Dytë Botërore, ndërsa pjesa tjetër u shkrua pas vitit 1951. Pjekuria e fituar me kalimin e viteve u mishërua në përmbajtjen e këtij libri. Ndonëse është shkruar me shumë kulturë libri nuk u botua i plotë sa ishte gjallë autori. Interesi i të huajve për Shqipërinë e bunkerizuar e të harruar nga bota duket se mungonte. Libri i parë i Zavalanit në gjuhën angleze '*How Strong is Russia*' u botua në Londër në vitin 1951.

Për hartimin e profilit politik të Tajar Zavalanit është zbatuar parimi metodologjik i vlerësimit dhe ndarjes së burimeve primare e sekondare, duke u dhënë prioritet të parave. Pikëpamjet e Tajar Zavalanit kanë njohur ndryshime të mëdha nga koha në kohë, dhe punimi është përpjekur të nënvizojë evolucionin e tyre. Jeta e Zavalanit u shoqërua me thyerje të mëdha: nisi si i ri me pikëpamje të majta, për t'u bërë komunist në Bashkimin Sovjetik; u kthye në Shqipëri dhe u largua gradualisht nga komunizmi bolshevik pas zhgënjimeve që pësoi prej tij; u transformua në socialdemokrat gjatë Luftës së Dytë Botërore, për

178. Tajar Zavalani, *How Strong is Russia*, London: Hollis & Carter, 1951.

t'u shndërruar në antikomunist pas mbarimit të saj. Edhe në fushën e besimit jeta e T. Zavalanit pati ndryshime të mëdha. Lindi në një familje të besimit mysliman të rritit bektashi, u shndërrua në një komunist ateist, për t'u konvertuar në vitin 1958 në katolik, me emrin e ri Thomas-Henry Zavalani. Pavarësisht nga 'galopet' në jetën e tij, në personalitetin e Tajar Zavalanit spikasin dy veti thelbësore: kultura e gjerë dhe atdhetaria.

---

## 1925 -1939: Tajar Zavalani, mbështetës i ideologjisë komuniste

---

Tajar Zavalani u lind më 15 gusht 1903 në qytetin e Korçës. Ai ishte djali i aktivistit dhe nacionalistit shqiptar Fehim Zavalani, me origjinë nga Dangëllia e Përmetit. Ndoqi shkollën katolike franceze 'Marist Brothers' në Manastir [sot: Bitola-Maqedonia e Veriut], për të vazhduar më pas studimet në degën e letërsisë në shkollën franceze të Selanikut.<sup>179</sup> Në vitin 1922 shkoi në Tiranë dhe filloi punën në Ministrinë e Jashtme si sekretar i Komisionit Shqiptar për Përcaktimin e Kufijve.<sup>180</sup> Tajar Zavalani në vitin 1924 ishte pjesë e shoqatës 'Bashkimi', një shoqatë politike, shoqërore e kulturore me prirje të majta marksiste dhe jomarksiste, së bashku me personalitete të tjera të njohura si Avni Rustemi, Zai Fundo, Reshat Këlliçi, etj.<sup>181</sup> Anëtarët e kësaj shoqate dëshironin daljen e Shqipërisë nga prapambetja feudale dhe ndërtimin e një vendi demokratik e modern dhe me drejtësi shoqërore. Qenia e tij në shoqatën 'Bashkimi' nuk ishte e rastësishme, pavarësisht nga mosha e re. Tajari, sipas tregimeve të një bashkëpunëtori të tij të ngushtë, në moshën 10 vjeçare kishte marrë guximin t'i thoshte babait të vet, Fehim Bej Zavalanit se, nuk ishte e drejtë që pjesa më e madhe e prodhimeve shkonin në hambarin e tij, e jo të atyre që kishin derdhur djersën duke punuar...<sup>182</sup>

Tajar Zavalani mori pjesë në 'kryengritjen e Vlorës' si e cilëson ai në librat e tij<sup>183</sup> lëvizjen e qershorit të vitit 1924 të udhëhequr nga Noli. Në librin e tij *Histori e Shqipnis*, Tajar Zavalani i ka kushtuar vëmendje kësaj ngjarjeje duke theksuar se kishte marrë fund 'bashkimi i shenjtë' për pavarësinë kombëtare dhe Shqipëria kishte hyrë në një fazë tjetër. "Mendimet u ndanë, - ka shkruar ai, - kur erdhi puna me ç'dukë gjurmët e sundimit osman dhe me e kthye Shqipnin në një shtet modern, mbas modelit perëndimor".<sup>184</sup> Zavalani mbështeti grupin e radikalëve të majtë, si e quan ai grupimin e udhëhequr nga Noli, të cilët synonin që të spastronin me themel sistemin administrativ, ekonomik dhe shoqëror të trashëguar nga Perandoria Osmane. Masa më e rëndësishme e këtij grupimi ishte reforma agrare, ndarja e fesë nga shteti, ndërtimi i shkollave të kategorive të ndryshme, mësimet universitare etj. Zavalani është përpjekur që të argumentojë se pse ngjarjet e qershorit të vitit 1924 nuk ishin 'revolucion' por kryengritje e armatosur. Ai ka vënë në dukje faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që çuan në dështimin e saj. Vendosijen e marrëdhënies diplomatike me Bashkimin Sovjetik, Zavalani e konsideron si një hap tërësisht të gabuar,

---

179. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, përgatitur për botim nga Bejtullah Destani & Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 3-4.

180. Komisioni kishte për detyrë që të precizonte vendimet e marra nga Konferenca e Ambasadorëve e Parisit e nëntorit të vitit 1921.

181. Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së 1878-1941 (Vështrim historik me një shtojcë dokumentare)*, Tiranë: ILAR, 2006, f. 24.

182. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f.

183. Shih: Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018; Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë: PLEJAD, 2019.

184. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë: PLEJAD, 2019, f. 386-387.

“Mendimet u  
erdhi puna n  
gjurmët e su  
dhe me e kth  
në një shtet n  
modelit perë

ndanë, kur  
ne ç'dukë  
ndimit osman  
ye Shqipnii  
modern, mbas  
ndimuer”

Tajar Zavalani

që u mor nën influencën e Kostandin Boshnjakut – i kthyer në Shqipëri pas revolucionit bolshevik.<sup>185</sup> Ky hap i Nolit, sipas Zavalanit, pati konsekuenca brenda vendit, por edhe jashtë tij.<sup>186</sup>

Pas dështimit të lëvizjes së qershorit Tajar Zavalani, si shumë mbështetës të tjerë të F Nolit shkoi në mërgim si emigrant politik, fillimisht në Romë dhe pas saj, për gati 8 vjet në Bashkimin Sovjetik [BS]. Në një autobiografi të shkruar prej tij, Tajar Zavalani ka shpjeguar se kishte qenë ambicia e tij e madhe ndjekja e studimeve të larta, ndërsa e kishte pritur me qejf shkuarjen në Bashkimin Sovjetik, ndonëse kishte pasur një ide të zbehtë mbi komunizmin.<sup>187</sup> Tajari shkoi në BS së bashku me 20 intelektualë të moshës së re, anëtarë dhe simpatizantë të majtë të Shoqërisë ‘Bashkimi’, me mbështetjen e Komitetit të Çlirimit Nacional. Pasi mësoi gjuhën ruse, një vit pas shkuarjes në BS ai vazhdoi Shkollën Marksiste-Leniniste në Leningrad, të cilën e përfundoi pas tre vjetësh. Zavalani në këto vite nuk e kishte vënë në dyshim filozofinë bolshevike dhe praktikën staliniste të ndërtimit të shtetit komunist, përkundrazi, si shkruan ai vetë, ‘kënaqësia ime më e madhe intelektuale në atë kohë ka qenë se, gjeta përgjigjen në pyetjen që më kishte munduar prej kohës, e ajo është: Çka e bën shoqërinë njerëzore që të ecë përpara dhe të përparojë?!’<sup>188</sup> Më 28 gusht 1927 Zavalani dhe 11 studentë të tjerë shqiptarë që vazhdonin studimet në BS u pranuan anëtarë të Partisë Komuniste Bolshevike dhe formuan Grupin Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik. Përveç T. Zavalanit [me pseudonimin: Zoniev-Zonati] anëtarë të këtij grupi ishin edhe Lazar Fundo, Sejfulla Malëshova, Ali Kelmendi, Rexhep Çami, Selim Shpuza [Tabaev], Demir Godelli, Riza Dani [Dokini], Naum Prifti, Sali Hidri dhe Riza Hajno. Tajar Zavalani drejtonte celulën komuniste të Leningradit.<sup>189</sup>

Tajar Zavalani dhe shokët e tij të grupit komunist shqiptar në BS në vitin 1928 morën udhëzim nga Gjergj Dimitrovi [kryetar i Seksionit Komunist të Ballkanit], që të përgatiteshin të ktheheshin në vendin e tyre (duke përfutur nga amnistia e Zogut për emigrantët politikë), për të formuar bërthamën e Partisë Komuniste të Shqipërisë.<sup>190</sup> “Kominterni, – kujton Zavalani, – donte që unë të shkoja në Shqipëri dhe të punoja ilegalisht, por unë refuzova”. Tajar Zavalani që drejtonte seksionin e Leningradit krijoi një komision të përkohshëm, i cili do të merrej me punën përgatitore për formimin e një partie komuniste në Shqipëri. Në të merrnin pjesë edhe Halim Xhelo, Sejfulla Malëshova, Selim Shpuza dhe Demir Godelli.

Zavalani përktheu Manifestin Komunist, ndërsa shokë të tjerë të grupit përkthyen të tjera dokumente të rëndësishme programatike për komunizmi. Më 17 dhjetor 1928, Lazar Fundo, Sejfulla Malëshova, Tajar Zavalani e Reshat Këlliçi u pranuan individualisht dhe jo si grup komunist, anëtarë të Komitetit të

---

185. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, Tiranë: PLEJAD, 2019, f. 391. Pjesa e parë e librit *History of Albania* u shkrua gjatë periudhës së LDB, ndërsa pjesa e dytë pas vitit 1951 e deri sa vdiq në vitin 1966. Ripunimi përfshiu edhe pjesën e parë të tij. Ai, siç kujton edhe vetë Zavalani, e ripunoi këtë libër duke u konsultuar me shumë botime në Bibliotekën e Londrës. Autori kishte evoluar shumë në gjykimet e tij në kohën që përfundoi librin. Kjo gjë duket qartazi nëse krahason *Ditarin (1942-1944)* e mbetur si dorëshkrim nga koha e Luftës e të botuar dy vjet më parë në Prishtinë nga Bejtullah Destani e Agim Morina me ngjarjet e LDB të librit *History of Albania*.

186. Pa dashur të merremi me gjykimin e veprës së lartpërmendur, më duhet të them se ky konkluzion është i mbingarkuar. Unë mendoj se *së pari*: Fan Noli u pri drejt Bashkimit Sovjetik jo për motive ideologjike, por kryesisht për arsye pragmatiste: për të siguruar mbështetjen e një shteti të madh, në një kohë që nuk po e gjente atë në vendet e Perëndimit, *së dyti*, njohja e qeverisë sovjetike ishte kusht që i ishte bërë i ditur që më parë Komitetit Kombëtare Mbrojtja e Kosovës. Pa siguruar paraprakisht njohjen e qeverisë shqiptare, BS nuk do ta ndihmonte KMKK, i cili ishte mbështetës dhe element përbërës i qeverisë së Nolit. *Së fundi*, Bashkimin Sovjetik në vitin 1924 e njohën pothuajse të gjitha shtetet e Perëndimit [me përjashtim të SHBA], ndërsa sapo ishte pranuar si vend anëtar i Lidhjes së Kombeve.

187. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 14.

188. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f.14-15.

189. Arkivi Qendror i Shqipërisë (AQSH), Fondi 16/AP (Grupi Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik), Lista 1, Dosja 1, cituar sipas librit të K. Frashërit, *Historia e Lëvizjes së Majtë...*, f. 37.

190. AQSH, F 16/AP (Grupi Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik), Lista 1, Dosja 12, fl. 1-3., Letër e Lazar Fundos drejtuar Tajar Zavalanit më 10 janar 1928.

Çlirimit Nacional (KÇN)<sup>191</sup>. Në vitin 1929 u kthye në Moskë dhe filloi punën si specialist në Institutin e Bujqësisë. Sidoqoftë në vitin 1930 me urdhër të Kominternit, Zavalani iu atashua grupit të komunistëve shqiptarë pranë KONARE-s në Berlin, që drejtohej nga Fan Noli, por vepronin si një celulë e pavarur brenda tij.<sup>192</sup>

Tajar Zavalani dhe shokët e tij komunistë e jokomunistë të KONARE-s në vitet 1928-1931 u përfshinë në divergjencë të forta, për shkak të dy platformave të ndryshme, të dyja të miratuara nga Internacionala Komuniste [Kominterni]. Thelbin e divergjencave ndërmjet ‘çlirimistëve’ dhe ‘bolshevikëve’, siç i cilëson dy grupimet e majta brenda KONARE-së prof. Kristo Frashëri, kishin të bënin me adoptimin e dy platformave të ndryshme për të ardhmen e Shqipërisë. ‘Çlirimistët’ mendonin se në Shqipëri duhej të vendosej një regjim demokratik përparimtar [shih pikëpamjet e Halim Xhelos], ndërsa ‘bolshevikët’ gjykonin se duhej kryer revolucioni socialist, në shembullin e Revolucionit të Tetorit.<sup>193</sup> ‘Bolshevikët’ ku bënte pjesë edhe Tajar Zavalani mbështetnin idenë e përmbysjes së regjimit kapitalist në Shqipëri dhe vendosjen e pushtetit socialist, sipas modelit të Revolucionit të Tetorit. Ndërsa grupi i ‘çlirimistëve’ kishte si objektiv vendosjen e një regjimi demokratik përparimtar në Shqipëri dhe nuk ishte për diktaturën e proletariatit.<sup>194</sup> Organizata e Komunistëve Shqiptarë të BS (Sejfulla Malëshova, Lazar Fundo, Tajar Zavalani e Ali Kelmendi) kishte mbështetur platformën e revolucionit socialist. Por duke filluar nga viti 1931 e më mbrapa Tajar Zavalani, Lazar Fundo dhe disa komunistë të tjerë i ndryshuan pikëpamjet e tyre, duke u larguar nga teoria e revolucionit socialist në Shqipëri.

Divergjencat brenda KONARE-s, të shkaktuara nga pikëpamjet e ndryshme të rrymave brenda saj, pamundësia për të ndjekur e ndikuar mbi zhvillimet politike në Shqipëri, dhe mungesa e mjeteve të nevojshme financiare, për shkak të premtimeve të pambajtura të ‘miqve rusë’, siç shkruante Noli, e detyruan kreun e KONARE-s që të jepte dorëheqjen nga kjo organizatë në vitin 1931 dhe të rikthehej në Amerikë. Situatën e vështirë në të cilën u gjend KONARE pas largimit të Nolit, e ka analizuar Tajar Zavalani, [drejtues i Grupit Komunist Shqiptar në Vjenë], në një raport që i drejtonte Sekretariatit të Vendeve Ballkanike të Kominternit më 4 mars 1931.<sup>195</sup> Ai pranonte se kjo organizatë ishte në gjendje të vështirë, të shkaktuar sidomos nga largimi i Nolit, por edhe i Kostandin Boshnjakut nga grupi i komunistëve bolshevikë. KONARE në vitin 1931 u shpërbë dhe paskëtaj në emigracion do të mbetej vetëm organizata e Komitetit të Çlirimit Nacional [KÇN] me celulat e saj në BS, Francë, Austri dhe Zvicër. Militantët apo komunistët e tjerë shqiptarë në emigracion, ndryshe nga komunistët e BS të cilët kishin organizatën e tyre, ishin të inkuadruar në partitë komuniste të vendeve respektive, ku jetonin e punonin. Anëtarët e Grupit Komunist të Bashkimit Sovjetik ishin superiorë ndaj shokëve të tyre të një ideali, për shkak të kulturës dhe njohjes më të mirë të teorisë marksiste-leniniste dhe praktikës së ndërtimit të socializmit në BS. Sejfulla Malëshova, një ndër komunistët bolshevikë shqiptarë më të qëndrueshëm dhe të pandryshueshëm, ndryshe nga shumë komunistë të tjerë të BS – Sejfulla Malëshova u bë ideologu i komunizmit shqiptar, por edhe ai nuk shkoi aq larg sa do të donte Enver Hoxha.

191. Lazar Fundo dhe Sejfulla Malëshova ishin pranuar anëtarë të Kominternit, shih: Branko Lazitch & Milorad Drachkovitch, *Biographical Dictionary of the Comintern*, California: The Hoover Institution Press, Stanford University, 1973, p. 250.

192. Në KONARE, të cilën profesor Kristo Frashëri e quan Front, miltonin persona me pikëpamje të majta, të cilët përfaqësonin dy filozofi të ndryshme: komunistët çlirimistë ose socialdemokratë dhe komunistët bolshevikë. Të parët nuk mendonin se në Shqipëri duhej të zhvillohej revolucioni socialist, por revolucioni demokratiko-borgjez, sepse Shqipëria gjykonin ata, ishte një vend relativisht i prapambetur e me mbeturina feudale. Këtij grupimi të udhëhequr nga Halim Xhelos do t’i bashkoheshin me kalimin e kohës edhe komunistët Lazar Fundo, Kostandin Boshnjaku dhe Tajar Zavalani. Ndërsa grupimi e komunistëve bolshevikë bënin pjesë komunistët Sejfulla Malëshova, Ali Kelmendi e Koço Tashko. Shih: Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së majtë në Shqipëri ...*, f. 54-58.

193. Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së 1878-1941 (Vështrim historik me një shtojcë dokumentare)*, Tiranë: ILAR, 2006, f. 41-42.

194. Kristo Frashëri, *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së 1878-1941 (Vështrim historik me një shtojcë dokumentare)*, Tiranë: ILAR, 2006, f. 41-42.

195. AQSH, Fondi 15/AP, Lista 1, V. 1931, D. 7, Raport i Zonatit për BLS, 4.03.1931.

Në vitin 1932, me urdhër të Gjergj Dimitrovit u kthyen në atdhe disa nga anëtarët e grupit të komunistëve shqiptarë në BS, si Demir Godelli, Selim Shpuza, Rexhep Çami e Reshat Këlliçi. Në Shqipëri u kthye edhe Halim Xhelo. Tajar Zavalani u kthye në Shqipëri në fillim të vitit 1933, pas qëndrimit për pak kohë tek familja e tij në Selanik, ku u pajis me pasaportë të re nga konsullata shqiptare. Me ndihmën e miqve të familjes dhe veçanërisht të Mehmet Konicës ai filloi punën si drejtor i Zyrës së Statistikës. “Në këtë periudhë – ka shkruar Zavalani në autobiografinë e vet, – fillova t’i kontribuoj shtypit ‘legal’ dhe kjo nxori në sipërfaqe për herë të parë mospajtimin tim me llojin e komunizmit sovjetik. Sidoqoftë, – shton ai më tej, – u jam përmbajtur ideve të mija revolucionare”.<sup>196</sup> Tajar Zavalani ishte në përgjithësi natyrë jokonfliktuale. Ai tregojë i kujdesshëm dhe deri diku i adaptueshëm ndaj situatave e rretheve shoqërore që ai frekuentonte, por jo rrallë idetë e tij priteshin me reagime të ashpra. Mungesa e partive politike, liria e kufizuar në fushën e ideve dhe sidomos, ashpërsia me të cilën përballeshin komunistët dhe idetë e tyre nga regjimi autoritar i mbretit Zog e bënin më të vështirë përhapjen e ideve komuniste në Shqipëri. Polemikati i kalonin kufijtë e etikës, duke u shndërruar jo rrallë në sulme personale e në fyerje. Në këtë periudhë, Zavalani u kushtoi kujdes dhe sjelljes në shqip të përkthimeve nga letërsia botërore. Ndër to përmendim ‘Ana Karenina’ e Tolstoit, ‘Sonata’ e Krojcerit, ‘Nëna’ e Gorkit, ‘Ishulli i Thesarit’ i Stivenzonit, ‘Tartari dhe Taraskoni’ të Dodesës, ‘Gobseku’ i Balzakut dhe ‘Dama me Kamelië’ i Dymasë.

Fundi i viteve ’30 shënon ndarjen përfundimtare të Tajar Zavalanit me idetë komuniste. Braktisja e komunizmit sovjetik erdhi në mënyrë graduale. Në autobiografinë e tij, Zavalani ka përmendur se në fillim të viteve ’30 ai filloi të dyshojë te politika staliniste për kolektivizimin e bujqësisë, si rezultat i së cilës pati miliona fshatarë të vdekur nga zia e bukës, të syrgjynosur në Siberi e të dënuar në gjyqet kundër kulakëve. Spastrimet, vrasjet dhe dënimet e ashpra në Ushtrinë e Kuqe, si rezultat i së cilës u eliminua edhe vëllai i tij Hyseni, dhe sulmi i Bashkimit Sovjetik mbi Finlandën në vitin 1940 i ‘hapën sytë’ dhe e larguan përfundimisht nga komunizmi bolshevik sovjetik.<sup>197</sup>

---

## 1939-1944: Tajar Zavalani si nacionalist antifashist dhe socialdemokrat

---

Në vitin 1939 Tajar Zavalani u internua në Italinë e Veriut për shkak të veprimtarisë së tij kundër regjimit italian të pushtimit. Me ndihmën e Ernest Koliqit dhe mbështetjen e tij financiare u lirua nga internimi dhe, së bashku me bashkëshorten shkoi në Zvicër. Pas një qëndrimi të shkurtër, Zavalani, arriti në Paris, ku për herë të parë, kujton ai, ‘rashë në kontakt me Mbretin Zog’. Pas pushtimit të Francës nga Gjermania, Zavalani u vendos në Londër. Duke filluar nga viti 1940 dhe deri në vdekjen e tij, ai punoi në BBC (The British Broadcasting Corporation) në seksionin e gjuhës shqipe.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore tek profili i Tajar Zavalanit skicohen më qartë karakteristikat e nacionalisti antifashist dhe të një socialdemokrati, aktiv në emigracionin shqiptar në Angli e Amerikë, me vizion të qartë për zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë në rrugën e demokracisë perëndimore. Në veprimtarinë e tij të njohur kryesisht nga burimet arkivore britanike e amerikane spikasin përpjekjet për të njohur e pranuar zyrtarisht Shqipërinë në Kombet e Bashkuara Antifashiste, për të bërë të njohur rezistencën dhe kontributin e popullit shqiptar në favor të kauzës antifashiste, për të krijuar një Komitet Kombëtar, një Front të Bashkuar edhe nën Zogun.

---

196. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 16.

197. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 16.



T. Zavalani bëri përpjekje që të bashkëpunonte me mbretin Zog, si gjatë kohës së qëndrimit të tij në Paris, ashtu edhe në Londër, duke ofruar si rrugëzgjdhje krijimin e një Komiteti Kombëtar apo një Fronti të Përbashkët kundër rrezikut fashist e nazist. Kjo do të ishte një marrëveshje pragmatike e detyrueshme për të fuqizuar rezistencën shqiptare kundër ushtrive të Boshtit. Në të vërtetë, mendimi personal i Zavalanit dhe i organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ ishte që në Shqipërinë e pasluftës nuk duhej të restaurohej sërish regjimi monarkik zogist, të cilin ai e përcaktonte si ‘diktaturë personale të një njeriu me një varg satrapësh rrotull tij’. ‘Zogu, – ka shkruar Zavalani, – nuk mund të jetë ideali për të cilin duhet të luftojnë e të vriten shqiptarët.<sup>198</sup> Modelin e ardhshëm të zhvillimit të Shqipërisë Zavalani e kërkonte te ‘një demokraci e vërtetë, ku sovraniteti i popullit të jetë një realitet e jo një kallëp i gënjeshtër sa për të rrejtur botën’.<sup>199</sup> Lufta e popullit shqiptar, sipas tij, duhej të ishte kombëtare dhe sociale. ‘Duam që populli shqiptar të shpëtojë njëherë e përgjithmonë, jo vetëm nga zgjedha fashiste, por edhe nga ana e bejlerëve dhe arkondëve që sundojnë si vegla të invaduesit’<sup>200</sup>. Por Zogu gjykonte ai, ishte treguar i ngathët dhe donte që gjithçka të vërtitej rreth tij, si personi legjitim i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Mbreti Zog duhej të kishte likuiduar zyrtarisht qeverinë e vjetër të Koço Kotës, dhe gjatë kohës së qëndrimit në Paris të krijonte një Komitet Kombëtar në vend të saj. Një tjetër version do të ishte krijimi i një Fronti të Përbashkët me në krye Zogun, në të cilin do të përfshiheshin figura të shquara të popullit shqiptar në emigracion dhe brenda Shqipërisë. Nëse Zogu do të vinte në Londër [nga Parisi] me një qeveri të tillë, ajo do të kishte shumë gjasa që të njihej nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe nga qeveritë e vendeve të tjera aleate. Pranimi i Zogut në krye të Komitetit Kombëtar do të ishte i kushtëzuar. Ai duhej që pas mbarimit të luftës t’i nënshtrohej vendimit të një Asambleje Kushtetuese të zgjedhur në mënyrë demokratike, e cila do të vendoste mbi formën e regjimit. Zogu nuk e krijoi një qeveri të kësaj natyre dhe nuk pranoi gjithashtu të paraqiste zyrtarisht një deklaratë që do të dëshmonte se e ardhmja e regjimit të Shqipërisë së pasluftës, do të përcaktohej nga ndonjë plebishit apo Asamble Kushtetuese.<sup>201</sup> Mosdhënia e një garancie të tillë, pavarësisht nga manovrat e Zogut, ishte burimi kryesor i mosmarrëveshjeve me Zogun e deri diku, edhe me ‘Vatrën’, e cila nga ana e vet nuk tregonte kaq strikte në këtë pikë sa ‘Shqipëria e Lirë.’ ‘Vatra’ ndonjëse ishte republikane në esencë dhe kundër monarkisë, nën ndikimin e drejtuesve të saj kryesorë, Konicës e Nolit, u tregua e gatshme ta njihte Zogun si mbret legjitim, por vetëm për kohën e Luftës.<sup>202</sup> Megjithëse e nxiti dhe e mbështeti frymën e bashkëpunimit dhe afrimit të korrekteve të ndara e të përçara në emigracion, duke arritur deri në pranimin e Zogut si mbret legal dhe drejtues të mundshëm të një qeverie në emigracion, përpjekjet e Zavalanit nuk patën sukses. Shqiptarët, si jashtë, ashtu edhe brenda vendit, vazhduan të mbeteshin të ndarë.

Tajar Zavalani si asnjë shqiptar tjetër në emigracion bëri përpjekje për të bërë të njohur rezistencën e popullit shqiptar kundër pushtimit italian e gjerman, si në Londër, ashtu edhe në Uashington. Detyra e gazetarit të BBC e ndihmonte në këtë rol. Ai zhvilloi disa takime zyrtare e jozyrtare me diplomatë të FO dhe persona të tjerë të interesuar për Shqipërinë gjatë LDB. Në dhjetor 1943 Zavalani shkroi një pamflet me titull ‘*Albania Under Nazi Oppression*’, i cili u botua nga Zyra e Londrës e Organizatës ‘Shqipëria e Lirë’.<sup>203</sup> Studimi i tij nuk u prit mirë nga mbreti Zog, sepse e gjeti veten jashtë trajtimit. ‘Në këtë pamflet, zoti Zavalani ka dhënë një raport të gjallë dhe me autoritet të luftës së shqiptarëve kundër tiranisë dyshe, të cilën po ia rekomandojmë me ngrohtësi lexuesit anglez’, ka shkruar në parathënien e tij zoti Ivor

198. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f.143.

199. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 148.

200. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 152.

201. Tajar Zavalani, *Ditar (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 178-179.

202. The National Archives and Record Administration [ më tej: NARA], RG 226, Entry 54-16, File 61750, 11 March 1944.

203. TNA, FO 371/43563, Tajar Zavalani, *Albania Under Nazi Oppression*, foreword by Ivor Thomas, M.P., Published by the London Office of the Free Albania Committee, London.

Thomas, ish-deputet në Parlamentin Britanik.<sup>204</sup> Karakteristika kryesore e këtij studimi informues është vështrimi i tij dashamirës, gjithëvlerësues, pa paragjykime e anësi për kontributin e forcave të rezistencës në Shqipëri deri në dhjetorin e vitit 1943. Me interes të veçantë paraqitet ajo pjesë e broshurës që merret me periudhën e pushtimit gjerman. Autori i ka kushtuar vëmendje politikës së veçantë që gjermanët ndoqën në Shqipëri. Gjermanët sipas tij, ndryshe nga italianët u treguan njohës së mirë të mentalitetit shqiptar dhe historisë së shkuar të tyre. Politika e tyre e njohjes së ‘pavarësisë’ së Shqipërisë, ‘neutralitetit’, përkohshmërisë së qëndrimit në Shqipëri dhe frikësimit të shqiptarëve me ‘gogolin’ komunist, mendonte Zavalani, pati efektet e veta në apatinë dhe përçarjen e forcave të rezistencës. ‘Këta njerëz, shkruan Zavalani, që gjatë pushtimit italian ishin organizuar nën Ballin Kombëtar dhe kishin luftuar krah për krah me LNÇ, morën një qëndrim tjetër kur gjermanët zëvendësuan italianët. Ka një betejë për supremaci, e cila ka rezultuar në përlëshje të armatosura ndërmjet Frontit Kombëtar (Ballit Kombëtar) dhe LNÇ’.<sup>205</sup> Tajar Zavalani vlerëson të katër anëtarët e Regjencës, duke filluar me Mehdi Frashërin, Lef Nosin, Patër Anton Harapin dhe Fuad Dibrën për patriotizmin e njohur dhe për ndershmërinë e tyre. Asnjëri prej tyre nuk pranoi fillimisht të merrte përsipër detyrën e regjentit, por ajo u bë e mundur pas ndërhyrjes së fortë të Xhafer Devës.<sup>206</sup>

Si gazetar i BBC për Shqipërinë Tajar Zavalani duhej të përcillte lajme e të raportonte për rezistencën e shqiptarëve dhe për grindjet e tyre, të cilat morën karakterin e një konflikti civil në vitin 1944. Në disa raste u gjend ‘ndërmjet dy zjarreve’. Lëvizja Nacionalçlirimtare e akuzonte për njëanësi në favor të Ballit Kombëtar e të Legalitetit, ndërsa këtë të fundit e akuzonin për të kundërtën.<sup>207</sup>

Në *The National Archives (TNA)* në Londër gjenden disa dokumente që dëshmojnë për projektet politike e ekonomike të Tajar Zavalanit në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë.<sup>208</sup> Modeli i Shqipërisë së ardhshme sipas tij duhej të ishte ai i demokracive perëndimore. Studimet e tij me karakter ekonomik janë mjaft të vlefshme. Në to ka gjetur vend gjendja e rrugëve e mjeteve të transportit dhe sidomos e lëndëve të para, të cilat shiheshin si mundësi për zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë. Por për fat të keq ato mbetën thjesht dokumente të ruajtura në arkiv, pasi askush në qeverinë britanike nuk u kushtoi vëmendje. Zavalani u tregua shumë entuziast kur mori vesh se në tetor 1944 në Shqipëri do të zbarkonin trupat komando britanike, sepse shpresonte se me mbështetjen e tyre Shqipëria do të ndiqte rrugën e demokracive perëndimore. Por Shqipëria, për fatin e tij të keq mori një rrugë tjetër, atë të komunizmit, të cilën Zavalani e njëjto shumë mirë dhe e kishte braktisur.

---

204. TNA, FO 371/43563, Tajar Zavalani, *Albania Under Nazi Oppression*, foreword by Ivor Thomas, M.P., Published by the London Office of the Free Albania Committee, London: 1943, p.28.

205. Tajar Zavalani, *Albania Under Nazi Oppression*, foreword by Ivor Thomas, M.P., London: London Office of the Free Albania Committee, 1943, p. 20.

206. Tajar Zavalani, *Albania Under Nazi Oppression*, foreword by Ivor Thomas, M.P., London: London Office of the Free Albania Committee, 1943, p. 12, Tajar Zavalani ka shkruan se Xhafer Deva pasi pa që asnjëri nga 4 personat e propozuar nuk po e pranonte detyrën e re ndërhyri dhe tha: “Unë propozoj që Mehdi Frashëri duhet të detyrohet që të pranojë dhe kështu edhe të tjerët do të detyrohen të bëjnë të njëjtën gjë...Mehdi Frashëri, shton ai më tej, donte të fliste sërish, por Asambleja nuk e lejoi. Kështu u zgjodhën edhe të tjerët dhe pastaj u ekzekutuan himni kombëtar”.

207. Në një artikull të O.Varashit të botuar në gazetën ‘Bashkimi i Kombit’ në datën 6 janar 1944 shkruhej: “Është e lehtë Tajar Beu të flasësh nga Radio Londra. ... ju hani mirë, ju pini mirë, hyni e dilni e shikoheni në pasqyrë deri në 9:20 A.M., dhe më 7:45 të darkës filloni të lehni nga mikrofonat. Ju vazhdonin ende me guxim brutal që të kritikoni personalitetet më të ndritura të Shqipërisë dhe ta nxisni popullin drejt fundit katastrofik. Nuk ka kuptim të kemi shqiptarë pa Shqipëri ose Shqipëri pa shqiptarë. Por për aq kohë sa ju mbeteni larg nga zjarri dhe kaloni kohën në Londër, ju nuk keni të drejtë të na gjykoni”.

208. TNA, WO 204/8659, Studim i Tajar Zavalanit mbi burimet ekonomike të Shqipërisë, i cili i dërgohet Douglas Howard në FO, më 18 shtator 1944.

---

## 1945-1966: Tajar Zavalani, demokrat liberal dhe antikomunist

---

Pas LDB Tajar Zavalani vazhdoi të punonte në BBC. Ai nuk u pajtua me sistemin komunist dhe me derivatin e tij shqiptar, ndaj të cilëve mbajti qëndrim të ashpër. Për t'i shërbyer qëllimeve antikomuniste Zavalani u anëtarësua në 'Pen Club' (klub i shkrimtarëve antikomunistë të Evropës), në gazetën e të cilit [Arena] shkroi disa artikuj kundër komunizmit real. Pas formimit të ACEN (Komiteti i Kombeve të Robëruara për Evropën), në vitin 1957, T. Zavalani u zgjodh delegat i Komitetit Shqiptar, detyrë të cilën e mbajti deri në fund të jetës.<sup>209</sup> Ai ishte gjithashtu edhe drejtues i degës së ACEN të Londrës.

Në vitin 1951, Tajar Zavalani botoi në Londër librin e tij të parë, *How Strong is Russia*. Arsyeja e shkrimit ai e përcakton me fjalët: "Në mbarim të Luftës na doli murtaja komuniste si një rrezik që kërcënonte gjithë botën e lirë, ndërsa iluzionet në Perëndim përsa i përket qëllimeve të mira të Stalinit me shokë ishin shumë të rrënjosura dhe të rrezikshme. Si një kontribut modest drejt këtij qëllimi shkrova librin mbi Rusinë që u botua në vitin 1951".<sup>210</sup> Periudha 5-vjeçare e qëndrimit të tij në 'Mekën' e komunizmit botëror, njohuritë teorike të fituara në shkollën marksiste-leniniste, eksperiencia në Institutin e Studimeve Agrare në Moskë dhe praktika staliniste e viteve '30, bënë që Tajar Zavalani të botonte një libër të veçantë e të mirëpritur për lexuesin. Qëndrimi i tij në Rusinë Sovjetike koinçidoi me një nga periudhat më të rëndësishme të historisë së Bashkimit Sovjetik, pikërisht në kohën kur po formatohej modeli sovjetik i zhvillimit të këtij shteti të madh. Gjatë viteve '30 në Bashkimin Sovjetik filloi procesi i kolektivizimit të bujqësisë dhe industrializimit të ekonomisë. Pretendimet e Stalinit dhe të udhëheqjes komuniste sovjetike për ta shndërruar BS në një vend të përparuar, me industri dhe bujqësi të zhvilluar e për ta nxjerrë vendin nga prapambetja u shndërruan në makth për fshatarësinë ruse. Me miliona fshatarë u detyruan të bashkonin tokat dhe pasuritë e tjera, për të krijuar ekonomitë kolektive në formën e kolkozeve e sovkozeve [kooperativa e ndërmarrje bujqësore shtetërore]. Shoqërimi i pronave fshatare u krye kryesisht me forcë e dhunë. Ekonomitë më të prekura ishin ato të kulakëve. Gjatë viteve të para të kolektivizimit, dëshmon T. Zavalani, prodhimi bujqësor dhe blegtoral, në krahasim me periudhën e pararevolucionit pësoi rënie. Miliona fshatarë vdiqën nga zia e bukës, nga dënimet me vdekje, apo nga internimet në gulagët famëkëqij të Siberisë Sovjetike. Bashkimi Sovjetik u bë dalëngadalë superfuqi, por me një koston e miliona jetëve njerëzore.

*How Strong is Russia* ishte ndër të paktët libra të botuar në Perëndim, pas Luftës së Dytë Botërore për ekonominë e centralizuar sovjetike dhe zhvillimet e saj sipas pesëvjeçarëve deri në mbarim të vitit 1950. Libri u shkrua nga një autor që kishte kulturën e duhur teorike komuniste dhe njohuritë e nevojshme në fushën e ekonomisë sovjetike. Përmes shifrave dhe burimeve origjinale, ai ka pasqyruar dhe analizuar të gjithë planet pesëvjeçare të shtetit sovjetik deri në vitin 1950, duke krahasuar objektivat dhe arritjet reale të tyre. Tajar Zavalani është përpjekur ta nxjerrë BS nga mjegulla e propagandës, me të cilën e kishte mbuluar veten udhëheqja sovjetike. Ai ishte i rrallë në llojin e vet, sepse u shkrua në një kohë kur imazhi i BS dukej i pasfidueshëm dhe modeli i tij i suksesshëm. Përveç aspekteve ekonomike Tajar Zavalani ka trajtuar edhe fushat e tjera, si financat, ushtria dhe sidomos jetën sociale.

Farën e dështimit të ardhshëm të sistemi komunist Tajar Zavalani e shihte te pamundësia e ekonomisë së centralizuar për të konkurruar me ekonomitë e përparuara të vendeve kapitaliste, e veçanërisht atë të SHBA, pavarësisht nga zhvillimi me prioritet i industrisë së rëndë. Paralajmërimin e kishte dhënë

---

209. "Tajar Zavalani", në: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. III, Tiranë: Akademi e Shkencave të Shqipërisë, 2009, f. 2980.

210. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, Tiranë: PLEJAD, 2019, f. 6.

më herët V. I. Lenini. Zavalani ka nënvizuar: “Shpejt, pasi u bë drejtues i qeverisë bolshevike, Lenini do të shpallte ‘në planin afatgjatë, se produktiviteti i punës do të jetë faktori deciziv në betejën ndërmjet regjimit sovjetik dhe botës kapitaliste”.<sup>211</sup> Lenini theksonte se nëse shteti sovjetik do të donte ta fitonte betejën e tij historike me botën kapitaliste, duhej të fitonte pikërisht në këtë fushë. Sigurisht prapambetja e BS në fushën e teknologjisë, prodhimi i paktë i sendeve të konsumit, disbalanca e buxhetit në favor të ushtrisë, mohimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, mungesa e interesit vetjak, etj, ishin disa nga faktorët që çuan në rënien e sistemit komunist. Tajar Zavalani me këtë libër dha një kontribut të çmuar në Perëndim, duke u përpjekur të çmitizonte sistemin komunist të BS. Libri i lartpërmendur është i vlefshëm edhe për lexuesin e sotëm shqiptar, por edhe për studiuesit, sepse modeli sovjetik u zbatua edhe në Shqipërinë komuniste.

Pa dyshim, vepra më rëndësishme e Tajar Zavalanit mbetet *Historia e Shqipërisë*. Pjesa e parë e këtij studimi u shkrua gjatë LDB, por u rimor nga autori pas vitit 1951 dhe u përfundua në moshë të pjekur, pak kohë para vdekjes së tij. Libri reflekton mendimin final të tij për historinë e Shqipërisë, për komunizmin real dhe për derivatin e tij shqiptar, etj. Tajar Zavalani mund të themi pa hezitim në disa drejtime ka revizionuar vetveten. Pikëpamjet politike të Tajar Zavalanit në periudhën e pasluftës kanë evoluar drejt një demokraci liberal dhe antikomunisti të pakompromis. “Në mbarim të luftës, shkruan ai në parathënie, na doli murtaja komuniste si një rrezik që kërcënonte të gjithë botën e lirë..”. Gjykimet e tij kanë shkuar shumë më larg se më parë. Ai është tejet kritik me regjimin stalinist të Shqipërisë dhe të shkuarën e komunistëve shqiptarë, si gjatë kohës së mbretit Zog, ashtu edhe gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Nëse krahasojmë gjykimet e tij autentike të pasqyruara te *Ditari (1942-1944)* për periudhën e luftës, me ato çka shkruan te *Historia e Shqipërisë*, vihen re, jo thjesht reflektime, por madje përmbysje. Gjykimet e Zavalanit ndaj komunistëve shqiptarë, të kthyer nga emigracioni në vitet ’30-’40 janë nga më të ashprat, ndonëse nuk e përmend veten e tij. Në librin *Historia e Shqipërisë* ai ka shkruar: “Komunistët e stërvitun, qi ishin kthye nga Rusia ose nga Evropë Perëndimore në kohën e mbretit Zog ose mbas 7 prillit, kishin predikue bindjen absolute dhe të verbët ndaj politikës së Bashkimit Sovjetik mbas interpretimit qi jepte Kominterni”.<sup>212</sup> Tajar Zavalani ka reflektuar jo pak nga ç’kishte thënë e shkruar gjatë kohës së LDB [shih sidomos *Ditari (1942-1944)*]. Për të ‘çdo gjë që ishte shkruar gjatë kohës së okupacionit fashist e nazist ishte propagandë’. Gjykimi i tij për ish-mbretin Zog gjithashtu ka ndryshuar, duke përfshirë në disa raste edhe faktet. Tajar Zavalani në librin *Historia e Shqipërisë* ka pohuar se ‘Mbreti Zog kishte pranue qi populli shqiptar të vendoste me shumicë votash të lira mbi formën e regjimit dhe personin e kryetarit të shtetit’<sup>213</sup>, ndërkohë që tek ‘Ditari’ ka shkruar të kundërtën<sup>214</sup>. *Historia e Shqipërisë* është shkruar me kulturë, me sensin e masës dhe mbi të gjitha është mjaft e balancuar. Pjesën më të mirë të saj unë do të konsideroja kapitujt kushtuar periudhës së qeverisjes zogiste, si gjatë kohës së republikës, të monarkisë dhe atë të periudhës së pushtimit të Shqipërisë. Tajar Zavalani nuk e shikon historinë bardhë e zi. Ai i vlerëson ndryshimet që pati Shqipëria gjatë kohës së Zogut, por mban qëndrim kritik ndaj politikës së ndjekur prej tij, sidomos përsa u përket marrëdhënieve me Italinë, pushtimit të Shqipërisë, etj. Tajar Zavalani ka koncepte të qarta për demokracinë parlamentare, republikën autoritare, monarkinë parlamentare, diktaturën fashiste e komuniste.

Një tjetër karakteristikë e mendimit politik të Tajar Zavalanit është të qenët nacionalist shqiptar i pastër. Internacionalizmi i tij i viteve ’30, përqafimi i idesë për krijimin e një Federate Ballkanike ku do të përfshihej edhe Shqipëria është zhdukur në periudhën e pasluftës. Sistemi komunist nuk ishte modeli i kërkuar për popullin shqiptar. Për të, nuk ka ndonjë ndryshim ndërmjet diktaturave fashiste

211. Tajar Zavalani, *How Strong is Russia*, London: Hollis & Carter, 1951, p.7.

212. Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë: PLEJAD, 2019, f. 453.

213. Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë: PLEJAD, 2019, f.451.

214. Tajar Zavalani, *Ditari (1942-1944)*, Përgatiti për botim Bejtullah Destani and Agim Morina, Prishtinë: 2018, f. 178-179, 183.

“

**Paragjykimeve dhe koncepteve të gabuara të së kaluarës po iu shtohet tani edhe efekti i keq i veprave stupide dhe kriminale të komunistëve”**

Tajar Zavalani

e komuniste. Me të drejtë ai mban qëndrim kritik ndaj disa tezave pansllaviste të Enciklopedisë Sovjetike, të cila e shtrembërojnë historinë kombëtare të shqiptarëve, apo mundohen të gjejnë pika takimi edhe atje ku ato nuk ekzistojnë. Tajar Zavalani ishte i shqetësuar për mënyrën se si shkruhej historia e vendit të tij nga historiografia komuniste. “Paragjykimeve dhe koncepteve të gabuara të së kaluarës po ju shtohet tani edhe efekti i keq i veprave stupide dhe kriminale të komunistëve”. Historia e vërtetë e popullit shqiptar, sipas Zavalanit, do të shkruhej nga shqiptarët që jetonin në tokën e lirë. Tajar Zavalani sidoqoftë është i bindur për relativitetin e gjykimeve të veta, në mënyrë të veçantë për pasluftën, për shkak të mbylljes së arkivave shqiptare, mungesës së kontakteve me Shqipërinë dhe vazhdimin të proceseve historike.

Tajar Zavalani nuk mundi të kthehej ndonjëherë në Shqipëri pas luftës. Ai vdiq në mëngjesin e 19 gushtit të vitit 1966 në Londër. Për shkakun e vdekjes së tij ka dy versione. Sipas versionit të parë ai vdiq nga një atak kardiak, si rezultat i një sëmundjeje të gjatë, ndërsa sipas versionit të dytë, vdiq nga një aksident automobilistik. Në Shqipërinë komuniste emri i tij pothuajse nuk u përmend. Gruaja e tij Selma Zavalani vazhdoi të angazhohej në organizatën ‘Shqipëria e Lirë’.

# Musine Kokalari



# Profili i një shkrimtareje socialdemokrate

Musine Kokalari lindi në Adana në Turqinë Jugore, në gjirin e një familjeje gjirokastrite. Kokalarët, ku u lind Musineja, ishin familje intelektualësh të rëndësishëm. Musineja ishte nxënëse e Institutit Femëror në Tiranë, që në mesin e viteve '30 ishte një fidanishte e modernitetit të botës shqiptare.

**NGA DORIAN KOÇI**

Figura e Musine Kokalarit, pavarësisht ndryshimit të sistemeve politike në Shqipëri, nuk është trajtuar ende në dimensionin e saj të plotë intelektual. Përveçse një shkrimtare e talentuar dhe njeri i letrave, ajo ka pasur dhe një angazhim të fuqishëm intelektual dhe politik në shoqërinë shqiptare, gjatë dhe menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Ky angazhim politik nuk do të mund të kuptohet nëse nuk analizojmë mendimin e saj politik të shprehur në programin e Partisë Socialdemokrate të hartuar prej saj si dhe kontekstin historik të ballafaqimit të opozitës antikomuniste me komunistët shqiptarë që kishin ardhur në pushtet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. *Musine Kokalari lindi në Adana në Turqinë Jugore, në gjirin e një familjeje gjirokastrite. Kokalarët, ku u lind Musineja, ishin familje intelektualësh të rëndësishëm. Gjyshi, Hamiti, i mbaroi studimet e larta teologjike në Turqi, ndërsa i biri Reshati (1875-1946), babai i shkrimtares studioi drejtësi në Stamboll ku u vendos me familjen. I martuar me Hanushe Çiçon, Reshati pati tre djem Mumtazin (1896-1944), që studioi dhe ai në Turqi; Vesimin (1898-1944) që mbaroi shkollën turke me një bazë të frëngjishtes, Hamitin (1909-1989), që i kreu studimet universitare në Francë, edhe ai për drejtësi.<sup>215</sup> Më 1921, Musineja u kthye së bashku me familjen në Shqipëri, ku nisi shkollën fillore në Gjirokastrë. Familja e saj u vendos në Tiranë, nëntë vjet pasi u rikthyen në atdhe. Vëllai i saj, Vesimi, kishte një librari në kryeqytet në mesin e viteve '30, që shumë shpejt u bë, për gjithë kryeqytetin shqiptar, një pikë e fortë referimi dhe thellimi kulturor. Në vitin 1937, pas gjimnazit filloi të botonte në gazetën "Shtypi" skica letrare me*

215. Musine Kokalari, *Vëpra e zgjedhur*, vëll. 3, përgatitur nga Persida Asllani, Tiranë: B.K.SH, 2017, f. 232.

frymëzim popullor, prozë dhe poezi. Në qendër të tyre janë plagët shoqërore të Shqipërisë: varfëria, padrejtësia, analfabetizimi dhe sidomos gratë shqiptare që në mjediset prapanike, vazhdonin të trajtoheshin si skllave, të diskriminuara dukshëm krahasuar me burrat.<sup>216</sup> Musine Kokalari ishte nxënëse e Institutit Femëror në Tiranë, që në mesin e viteve '30 ishte një fidanishte e modernitetit të botës shqiptare.

---

## Musine Kokalari përballë rrymave politike shqiptare të viteve '30

---

Një pjesë e rëndësishme e formimit të saj intelektual zë periudha e viteve '30. Nuk mund të përcaktosh qartë se në cilën prej rrymave të viteve '30 Musine Kokalari e gjente më shumë veten, por duket se më tepër i përket grupit që u konturua me emërtimin “Të Rinjtë” pa u atashuar te konceptet e “Diktaturës së Ndritur” të Ismet Totos e Nebil Çikës. Ky përfundim mund të nxirret nga shënimet që ajo ka lënë, të titulluara “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972), ku shënon konfliktin midis brezave në jetën politike të vendit, midis të rinjve dhe të vjetërve, si konflikt për të evoluar shoqërinë shqiptare drejt progresit. Musine Kokalari duket se kishte bërë për vete devizën e një përparimi të shpejtë, aq të nevojshëm në Shqipërinë e asaj kohe ende të paurbanizuar. Ky përparim zakonisht perceptohej si kontradiktë midis elitës së vjetër shqiptare të formuar në kohën e Perandorisë Otomane, me nostalgji të theksuar për privilegjet e trashëguara nga *ancient regime* dhe të rinjve që kërkonin një modernizim sa më të shpejtë, të bazuar në merita dhe përparim kulturor. Musine Kokalari shkruan rreth këtij debati e kontradikte në “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972) *se ...brezi i ri gjithmonë shkonte më larg se brezi i vjetër. E tërhiqte atë. Kulturat e ndryshme çanin errësirën dhe në rrugëdaljen drejt qëllimit, gjithmonë shikonte brenda vendit dhe jashtë në popujt e tjerë ku lëvizjet, luftërat, kultura po zhvillohej. Brezi i ri ishte gjithmonë i gatshëm drejt bashkimit të këtyre forcave lirishtese dhe kulturave për të mirën e vendit.*<sup>217</sup> Fermentimi ideologjik ku Musine Kokalari formoi botëkuptimin e saj pavarësisht se ajo vetë gjatë këtyre viteve nuk atashohet në asnjë nga rrymat e mendimit të kohës që mbizotëronin në jetën publike të Mbretërisë shqiptare, duket se ishin idetë e një amalgame midis atyre të publicistit dhe filozofit Ismet Toto dhe Branko Merxhanit të Neoshqiptarizmit.

Një rol të rëndësishëm në formimin e saj intelektual luajti dhe rrethi familjar. Të dy vëllezërit më të mëdhenj të Musinesë u përfshinë në organizatën e Vlorës të vitit 1932 për të rrëzuar monarkinë dhe mbretin Zog dhe për të vendosur një sistem republikan qeverisjeje. “Organizata e Vlorës”, sipas Musine Kokalarit, ishte organizatë e bashkimit kombëtar me elementë të brendshëm, të lidhur me ata të jashtëm për përmbysjen e Pushtetit dhe vendosjen e Republikës<sup>218</sup>. Organizata e Vlorës u zbulua nga organet policore të regjimit autoritar të mbretit Zog dhe pjesa më e madhe e anëtarëve të saj u arrestua përfshi dhe vëllanë e madh të Musine Kokalarit, Vesim Kokalarin. Musine Kokalari kujton se kur shkonte në burg të takonte të vëllanë takonte dhe disa figura të tjera të shquara intelektuale të kohës, me të cilët më vonë ajo do të bashkëpunonte dhe në formimin e Partisë Socialdemokrate. “Njoha familjarisht Skënder Hajron dhe Topullin e gjithë të tjerët, pastaj Skënder Muçon, Hysni Lepenicën, inxhinier Baçin..., kujton ajo. Të gjithë këta kur veja për takim, na dilnin te hekurat e burgut”<sup>219</sup>. Kontakti me këto figura të njohura të botës intelektuale shqiptare do të përcaktonte dhe

---

216. Musine Kokalari, *Vepra e zgjedhur ...*, f. 233.

217. Musine Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972)*, Vepra II, përgatitur nga N. XH. Shehu, Tiranë: Geer, 2009, f. 393.

218. Po aty, f. 398.

219. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 398.





Më 1921, Musineja u kthye me familjen në Shqipëri, ku nisi shkollën fillore në Gjirokastrë. Familja e saj u vendos në Tiranë, nëntë vjet pasi u rikthyen në atdhe. Musine Kokalari ishte nxënëse e Institutit Femëror në Tiranë, që në mesin e viteve '30 ishte fidanishte e modernitetit të botës shqiptare.

botëkuptimin ideologjik të Musine Kokalari të bazuar në idealet e pasardhëse e ideve të Rilindjes Kombëtare, besnikë të idealeve antifeudale, laike në kulturë e në marrëdhënie shoqërore, për progres shoqëror, për liri politike dhe barazi shoqërore e reformim ekonomik.<sup>220</sup> Një pjesë të rëndësishme të këtyre shqetësimeve sociale zënë edhe skicat dhe poezitë me të cilat ajo kish debutuar në shtypin e kohës. *Muza ose Tacita ishin pseudonimet me të cilat, para se të studionte në Itali, kishte firmosur në gazetat "Shtypi", artikuj me të vërtetë të sigurt në vetvete për një vajzë të atyre kohëve, reportazhe dhe rrëfime që denonconin problemet shoqërore të gruas në vitet '30*<sup>221</sup>.

Janë pikërisht këto ide dhe pikëpamje që tentojnë drejt një modernizmi të shpejtë në jetën publike shqiptare që lënë paksa në heshtje në shënimet e jetës së saj të Universitetit, ngjarje madhore në historinë e Shqipërisë, siç është pushtimi fashist në 7 prill 1939. Ekspansioni kulturor italian influenconte shumë në botën intelektuale të Tiranës, aq sa intelektualë të shquar të kësaj periudhe nuk arrinin të dallonin qartë format e ndryshme të regjimeve politike në Perëndim, që fillonin nga demokracia liberale dhe mbaronin te fashizmi. Më 1937 Musine Kokalari mbaroi Institutin "Nëna Mbretëreshë" dhe më pas vijoi studimet në Universitetin e Romës, në Itali, të cilin e mbaroi shkëlqyeshëm në vitin 1941 me një temë diplome për Naim Frashërin.

220. M. Kokalari, *S'i lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 397.

221. Mauro Geraci, "Muza shqiptare në Sapienza. Jeta dhe vdekja e ëndrrës universitare", në: *Musine Kokalari, Vepra e zgjedhur 3 ...*, f. 25.

---

## Musine Kokalari si themeluese e Partisë Socialdemokrate

---

Katër vitet e saj në Romë janë të mbizotëruara nga kërkimi i vetvetes dhe zbulimi i madhësisë së qytetërimit evropian me të cilin ajo bie në kontakt të drejtpërdrejtë në Itali. Këto vite i përshkroi në librin e vet *Jeta ime Universitare (1940-1942)*, ku gjejmë dhe pasazhin mbi momentet e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. *Vizitat e mia shkruan Musineja u ndërprejnë për disa kohë, nga nisja për në Shqipëri në 5 të prillit. Në mbrëmjen e asaj dite, kur mbrërit në Bari, pashë një grumbullim ushtarësh dhe e mësova arsyen. Më zuri frika duke menduar mbi situatën në të cilën ndodhesha. Ndruhesha vetëm që nuk do më lejonin të nisesha. Përkundrazi, po. Ndodhi vetëm me anijen e fundit dhe arrita të nesërmen në 6 prill, në Tiranë, në çastin kur qielli ishte mbuluar me aeroplanë italianë. Anëmbanë mbretëronte një gjendje shpirtërore që mundet lehtësisht të përfytyrohet. Një qeveri ikte, një italiane e zëvendësonte. Në ato çaste ndjenjat më intime zgjohen dhe shpirti gjendet në një turbullirë të tmerrshme. Ajo mbrëmje ishte thellësisht e qetë, një lloj qetësie që jep një ndjenjë paniku, ndërsa, ngandonjëherë, dëgjoheshin disa gjuetje pushke. Një ditë kishte mbaruar dhe e nesërmenja ishte e panjohur. Në 7 prill, nga mesdita hynë në Tiranë trupat italiane. Shpejt qyteti u mbush. Një gjuhë e re dëgjohet nëpër rrugë; hapa ushtarësh, motoçikletash e autokarrosh. Italianët, që jetojnë nëpër qytete të mëdha, ndeshen në sende të pakuptueshme për ta. Çdo karakteristikë orientalizmi (lindore), u jep atyre përshtypje vafërie dhe mbeten të mrekulluar e të habitur.*<sup>222</sup>

Nga burimet arkivore nuk rezulton që Musine Kokalari të ketë qenë pjesë e ndonjë organizimi fashist të rinisë shqiptare universitare, por si pjesë e borgjezisë së kulturuar që po lindte e së cilës ajo i përkiste, nuk qëndroi pasive kur iu kërkua hartimi i një vepre letrare që do të nxirrte në pah kontrastin midis dy kulturave të dy brigjeve të Adriatikut dhe modernitetin që po përqafohej dita-ditës nga ndikimi i drejtpërdrejtë i kulturës italiane në Shqipëri. Në pranverën e vitit 1940, Pietro Parini, asokohe i dërguari italian në Shqipëri, i jep detyrën autores “*të shkruajë përshtypjet e një gruaje shqiptare në Itali*”, duke iu referuar sidomos studentëve shqiptarë në kryeqytet.<sup>223</sup> Libri që botohet në të përditshmen “*Tomorri*” në katër kapituj titullohet “*Nënua Plakë në Romë*” dhe është vazhdim i novelave të mëparshme të botuar në 1939, “*Siç më thotë nënua plakë*”. Këndvështrimi i saj si shkrimtare e re vazhdon të mbetet origjinal edhe në këtë përmbledhje të vogël rrëfimesh. “*Nënua plakë në Romë*” është një tekst me substrat orientalist i ballafaqimit dhe antonimisë Lindje-Perëndim, ku spikasin temat e feminizmit, urbanizmit, folklorit dhe antropologjisë sociale. Duket se deri në fund të vitit 1941, Musine Kokalari nuk është përfshirë në ndonjë aktivitet politik të drejtpërdrejtë dhe interesat e saj si studente e porsadiplomuar e filologjisë anojnë drejt gjetjes së rrugës së vet si shkrimtare. *Kur kthehet në Tiranë pas studimeve universitare në 1941 ajo i rrëfen Ali Asllanit, mik dhe shkrimtar, bashkëpunëtor i revistës “Gruaja Shqiptare” dhe sikurse dhe ajo, autor i një narrative të frymëzuar nga shoqëria folklorike shqiptare: “Dua të shkruaj, të shkruaj e vetëm të shkruaj letërsi dhe të mos kem fare të bëj me politikë”*<sup>224</sup>. Gjithsesi, kjo periudhë idilike do të ndërpritet shumë shpejt nga flakët e Luftës së Dytë Botërore që përfshiu Europën. *Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe hyrja në të e demokracive perëndimore i vuri shqiptarët para dilemës së orientimit: ose me Boshtin fashist, ose me “plutokracinë”, siç i kishte cilësuar Musolini, Francën dhe Britaninë e Madhe. Një klikë mercenare e kolaboracioniste, me pak segmente të zgjatura të saj, u bashkua me fashizmin. Fytyra e këtij regjimi në publik ishin gazeta “Fashizmi” e më vonë “Tomorri”, emisionet e Radio-Tiranës dhe gjithë propaganda figurative filmike. Kjo ishte “Shqipëria fashiste”*<sup>225</sup>. Kufijtë moralë midis atyre që nisën bashkëpunimin me italianët dhe atyre që ishin neutralë apo filluan paksa më vonë rezistencën nuk ishin kaq të ndarë. Shqipëria ishte një nga

222. Musine Kokalari, *Jeta ime Universitare (1940-1942)*, Vepra I, përgatitur nga N. XH. Shehu, Tiranë: Geer, 2009, f. 368.

223. Simonetta Ceglie, “Një libër në sirtar. Nënës sime”, në: *Musine Kokalari, Vepra e zgjedhur 3 ...*, f. 111.

224. Robert Elsie, “Musine Kokalari”, në: *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë: Dukagjini, 1997, f. 156.

225. Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë: Toena, 2014, f. 176.

viktimat e para të të ashtuquajturit rend i ri fashist dhe i konfigurimit të hartës gjeopolitike që Fuqitë e Boshtit dëshironin t'i jepnin botës. Ky fakt nxiti një reflektim nacionalist të shtrirë në të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare të kohës sidomos pas disfatës italiane në Luftën Italo-Greke dhe gjeti një përkrahje e mbështetje veçanërisht tek të rinjtë e shkollave, një pjesë e mësuesve të tyre, pra tek intelektualë atdhetarë. *Ata ndjenë nevojën e organizimit, të manifestimit e të veprimit antifashist. Në Shqipëri ende në vitin 1939 nuk kishte organizata të mirëfillta politike antifashiste. Kishte vetëm disa grupe të vogla komuniste në Korçë, Shkodër e Tiranë, si dhe individë e bërthama me bindje republikane, monarkiste dhe antifashiste.*<sup>226</sup>

Pikërisht te të rinjtë (një pjesë e shoqeve të saj prej Institutit Femëror) dhe intelektualë atdhetarë, disa prej të cilëve edhe miq familjarë, Musine Kokalari do të gjejë mbështetje për të diskutuar idetë e saj dhe në disa raste, do të përfshihet në aktivitete të përbashkëta politike. Ndërkohë jeta politike në vend filloi polarizimin kur komunistët shqiptarë u organizuan në PKSH, të krijuar me asistencën jugosllave dhe nacionalistët formuan organizatën politike të “Ballit Kombëtar” me pikëpamje republikane e reformatore. Shqipëria, për fat të keq, nuk kishte traditë të përfaqësimit të partive politike, pasi Mbreti Zog nuk kishte lejuar formimin e tyre dhe përvoja politike ishte shumë e varfër në këtë drejtim. Musine Kokalari merr kontakte me të dy krahët e rezistencës dhe vetë ajo, sipas kujtimeve të bashkëkohësve, merr pjesë në aksione të rezistencës antifashiste. *“Musineja ishte tepër e kthjellët dhe kishte bindjen, - kujton shoqja e saj Selfixhe Ciu, - që komunizmi dhe fashizmi s’kanë asnjë ndryshim midis tyre, përderisa dhe vrasin njeriun ... Musineja ishte antifashiste e vendosur. Dhe atë ditë, në korrik 1942, kur erdhi të më takonte, e gjeti oborrin e burgut mbushur me vajza të reja, të arrestuara nga të gjitha anët e Shqipërisë. Vajzat këndonin në oborr. Se mjaft në robëri/O e mjera Shqipëri/ O djem rrëmbeni pushkët/Ja vdekje, ja liri”. Nuk do ta harroj kurrë shprehjen e fytyrës së Musinesë. Mbeti si e hipnotizuar para asaj force dhe asaj dëshire të jashtëzakonshme të vajzave shqiptare për LIRI. Ishte ajo rini e bukur që ia blatoi jetën çlirimit të Shqipërisë. Po ndoshta në sytë e saj ishte dhimbja. Ato vajza ishin gati për dasmë dhe nuk e llogarisnin fare jetën. “Si mundet brishtësia e shpirtit të vajzës shqiptare të jetë një uragan i tillë?” Çdo të vijë pas uraganit?*<sup>227</sup>

Përfshirja e Musine Kokalari në rezistencën shqiptare që kishte filluar, do të sillte risi në përfshirjen e grave të shkolluara në luftë. Ajo do të kërkonte që të përshtaste traditën më të mirë të trashëgimisë politike të Shqipërisë me parimet e demokracisë liberale të Britanisë së Madhe dhe Francës. Në librin e vet të shkruar në vitin 1972 “Si u formua Partia Social-Demokrate” ajo shkruan se *idealet e Rilindjes ishin të gjalla, të shëndosha. Demokratët e shikonin dhe mbështeteshin tek ideja e zhvillimit, e evolucionit hyrë në ndërgjegjen shoqërore si zhvillim gradual.*<sup>228</sup> Në të njëjtën kohë ajo bën dallimin e qartë të ideve tradicionale të zhvillimit të Shqipërisë me idealet e së majtës ekstreme, komunizmit, që kishin hyrë edhe ato në Shqipëri. *“Po krahas këtyre idealeve, - shkruan ajo, - Revolucioni i Tëtorit pruri ideale të tjera revolucionare që hynin në Shqipëri dhe u formuan grupet komuniste jo me shtrirje në shkallë kombëtare, por të kufizuara dhe me parime jo të qarta, as të njëjllota.*<sup>229</sup>

Përsa i përket formimit të saj intelektual, Musine Kokalari dukej se kishte kaluar nëpër shkollën evolucioniste të mendimit politik shqiptar. Kjo shkollë edhe pse jo e afirmuar nga ideologë të mirëfilltë, përfshinte brenda vetes ide republikane e liberale, që nga Rilindja Kombëtare e deri në vitet '40. Si ideolog i respektuar dhe me influencë të madhe në jetën publike shqiptare sidomos të kolonisë shqiptare në Turqi prej nga vinte dhe Musine Kokalari ishte filozofi dhe gjuhëtari Sami Frashëri. Në vitin 1899 ai kishte botuar në Bukuresht traktatin politik “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” që ishte kthyer në një manifest të elitës liberale shqiptare. Përfaqësuesi i kësaj elite që kish lënë gjurmë të pashlyeshme në kulturën shqiptare gjatë viteve '30 ishte Mithat Frashëri (1880-1949), nipi

226. P. Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore ...*, f. 177.

227. Eglantina Mandia, *Sonata e Hënës: rëfim për një jetë*, Tiranë: Globus R., 1995, cituar sipas M. Geraci. Muza shqiptare në Sapienza ..., f. 40.

228. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 403.

229. Po aty, f. 403.

i Sami Frashërit dhe një nga themeluesit e mëvonshëm të organizatës nacionaliste “Balli Kombëtar”. Libraria e Mithat Frashërit në rrugën Mbretërore në Tiranë ishte kthyer prej kohësh në një vend ku diskutoheshin dhe shpërndareshin idetë liberale të kohës. “Unë e kam njohur këtë ambient që në vogëli, – shkruan Musineja kur përshkruan Librarinë e Mithat Frashërit ku kishte kontakte me intelektualë të tjerë shqiptarë të njohur të kohës, si Sotir Kolea, Aleksandër Xhuvani e Mati Logoreci. - Jam rritur me gjithçka që po rritej, zhvillohej, kërkohet, ishte mbështetur në botëkuptimin e thellë iluminist dhe në reformizmin e parlamentarizmin që na e ushqeu Sami Frashëri që në bangat e shkollës.<sup>230</sup> Është pikërisht në këtë ambient ku ajo së bashku me Skënder Muçon, Isuf Luzin dhe Selman Rizën themelon Partinë Socialdemokrate të Shqipërisë si një alternativë evolucioniste dhe rrugë të mesme që të lidhte me të forcat e pakristalizuara, duke u radhitur me të në aleancë me Partinë Komuniste në gjirin e Frontit Nacionalçlirimtar.<sup>231</sup> Musine Kokalari zgjedh me vetëdije të plotë bashkimin e të gjitha forcave antifashiste mbi bazën e një aleance demokratike. Gjatë vitit 1943 bie në kontakt me Nexhmije Xhuglinin (më vonë Hoxha) dhe përfshihet në Organizatën e Gruas Antifashiste për Tiranën, madje duke u zgjedhur edhe në organet drejtuese të saj. Pas dështimit të mbledhjes së Mukjes dhe acarimit të marrëdhënieve mes dy organizatave politike në Shqipëri, Musineja deklaron dorëheqjen nga ky pozicion. Në një letër që Nexhmije Xhuglini i shkruan Enver Hoxhës më 22 shtator 1943, ndër të tjera e njofton se “Edhe Musineja me shoqe kërkon formimin e partisë social-demokrate, megjithëse është ‘apolitike’. Me atë u ndamë, por ka infektuar, ose ma mirë ka fituar simpatinë e njanës që ishte me ne në këshill. Ajo deshi ta mbante Musinenë me pahir dhe na kundërshtoi mjaft, duke thënë se duhet të jemi të bashkuara”<sup>232</sup>. Musineja kujton se i kishte parashtruar Nexhmijes “intensifikimin e luftës kundër okupatorit dhe parashtrimin për të hyrë në gjirin e Frontit Nacionalçlirimtar, jo si individë të veçantë, por si grup demokratik ose më mirë si parti (socialdemokrate)”<sup>233</sup>. Përpjekja e Musine Kokalari për të themeluar rrugën e mesme në Shqipëri, pjesëmarrëse në rezistencën e armatosur, ra në vesh të shurdhër, si nga përfaqësuesit e PKSH-së, ashtu dhe nga udhëheqësit e organizatës politike “Balli Kombëtar”. Rezistenca e armatosur ndaj fashizmit italian ishte opsioni më i pranueshëm e i përshëndetur edhe nga Aleatët e Mëdhenj të Koalicionit të Kombeve të Bashkuara, që në dhjetor të vitit 1942 në deklaratat e tyre përkatëse. Në këtë kuadër, Musine Kokalari shprehet në librin e vet “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972) se *pushtimi italian pra, nxorri në plan të parë luftën. Gjithë ish të emigruarit në kohën e Zogut, të kthyer në vend, kishin dëshirën, që në gjendjen e re të bëhej e mundur dhe vendi me një luftë demokratike dhe të mbështetur në ndihmën e aleatëve, të arrinin në një Shqipëri demokratike konstitucionaliste që ishte dhe opinioni i gjithë demokratëve të vendit.*<sup>234</sup> Edhe pse midis programit të Ballit Kombëtar të quajtur “Dekalogu” kishte një lidhje organike me programin e Partisë Socialdemokrate të përpiluar nga Musine Kokalari dhe Isuf Luzaj, *udhëheqësit e “Ballit Kombëtar” Mit’hat Frashëri dhe Hasan Dosti nuk e pranuan alternativën e krijimit të këtij formacioni të ri politik me arsyen se do të përçahej organizata e tyre politike.*<sup>235</sup> Pavarësisht këtij fakti, të nxitur edhe nga gjendja e brendshme politike e marrëdhëniet midis forcave politike të kohës, Musine Kokalari dhe Isuf Luzaj, duke njohur moralisht Skënder Muçon si udhëheqës, vazhduan me projektin e themelimit të Partisë Socialdemokrate dhe organit periodik të shtypit, të titulluar “Zëri i Lirisë”. Data e saktë e themelimit të Partisë Social-Demokrate nuk dihet, por për të është shkruar në shtypin e kohës së LANÇ, si tetor 1943. *Numri i parë i gazetës “Zëri i Lirisë” është 1 kallnor (janar) 1944. Në faqet e Zërit të Lirisë shpallet dhe popullarizohet, në radhë të parë, programi i Partisë Social-Demokrate, si dhe ndonjë aspekt i statutit të saj (i pabotuar në këtë organ dhe që nuk ka arritur si dokument as në arkivat tona).*<sup>236</sup> Sipas kujtimeve të Musine Kokalari, ajo kish këmbëngulur për të vazhduar botimin

230. Po aty, f. 403.

231. Po aty, fq 406.


232. Nexhmije Hoxha, *Lufta jonë çlirimtare, kujtime, dokumente dhe letra*, Tiranë: Vllamasi, 2011, f. 295.

233. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 406.

234. Po aty, f. 404

235. Po aty, f. 406–407.

236. Luan Zelka, *Shtypi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944*, Tiranë: Globus R., 2003, f. 290.



Koncepti i socialdemokracisë sipas Musine Kokalari

e saj si alternativë e mesme në konfliktin politik që kish filluar në Shqipëri në tetor të vitit 1943. Musine Kokalari ishte e vetëdijshme se gazeta dhe fraksioni politik që ajo përfaqësonte nuk do të ishte i suksesshëm, madje shton se dhe me Skënder Muçon, Isuf Luzajn dhe Skënder Rizën që e themeluan nuk u takuam më bashkë. Mungesa e një kohezioni dhe organizimi sigurisht që do të ndikonte dhe në vazhdimësinë e alternativës socialdemokrate në vitin 1944, por Musine Kokalari dëshmon se qëllimi i saj ishte largpamës dhe do t'i shërbente Shqipërisë në momentin kur ajo do çlirohej nga gjermanët. “Unë i nxora ato gjashtë numra, - shkruan ajo, - vetëm me një qëllim: Që përshkruar një rrugë, një program partie. Pas çlirimit, në qoftë se do të ishte Shqipëria demokratike të mbështeteshim në atë rrugë dhe të vazhdonte”.<sup>237</sup> Për këtë arsye qysh në kryeartikullin e parë të gazetës shënohet se alternativa socialdemokrate rreshtohet përkrah rrymave të tjera politike së bashku me komunistët e vërtetë shqiptarë, zjarristët e patundur, rreth birit të Abdylit (Mithat Frashërit) flamurtarit të '78. Duket se më tepër se një realitet i mundur në vitin 1944, pretendimi i mësipërm ishte një dëshirë për të arritur një nga synimet e Partisë Socialdemokrate, rruga e mesme drejt një bashkimi që kishte dështuar në Mukje. Në të njëjtën kohë, përmendja e përbashkimit rreth figurës së Mithat Frashërit dëshmon edhe afërsinë ideologjike të programit të socialdemokratëve

237. Musine Kokalari. Si lindi Partia Social-Demokrate (1972),Vepra II, pergatitur nga N.XH.Shehu, Geer,Tiranë:2009, fq 410.

me “Dekalogun”, programin e “Ballit Kombëtar”. Afërsia e gazetës “Zëri i Lirisë” dëshmohej edhe nga vetë Musine Kokalari në deponimet e saj në gjyq 17 qershor-2 korrik 1946, ku shprehet se “gazeta gjatë okupacionit botohej prej Partisë Social-Demokrate që ishte në bashkëpunim me Ballin Kombëtar, por si grup i veçantë”.<sup>238</sup> Për më tepër, në deponimet e saj në hetuesi të datës 1 prill 1946 Musine Kokalari shpreh sërish afërsinë e Partisë Socialdemokrate me organizatën e Ballin Kombëtar. “Kam marrë pjesë në Ballin Kombëtar si Social-Demokrate dhe kam qenë përgjegjëse e gazetë “Zëri i Lirisë”, në të cilën kam botuar artikuj ku flitesh nga pikëpamja shoqërore, mbi çështjen e Kosovës në bazë të Kartës s’Atlantikut dhe mbi demokracinë”.<sup>239</sup>

Në numrin e parë të gazetës krahas botimit të programit të Partisë Socialdemokrate bie në sy një tjetër shkrim programor me titullin “Misioni i Partisë Socialdemokrate”. Në artikull zëbërthehet programi i Partisë Socialdemokrate ku bie në sy ndarja në dy etapa i misionit dhe idesë socialdemokrate në Shqipëri. Në etapën e parë sipas artikullshkruesit synohet independenca dhe kufijtë etnikë, instalimi i një qeverie demokratike ...<sup>240</sup>, ndërsa në etapën e dytë parashikohet vendosja e drejtësisë shoqërore shoqëruar me të gjitha referimet për popullin shqiptar.<sup>241</sup> Artikulli nuk ka emër në fund, por duke pasur parasysh pohimin e Musine Kokalarit kur shkruan për botimin e gazetës se ... unë (Musineja) nxirrja material andej këndeje. Ndihte dhe Isuf Luzi dhe e vetne munda të nxjerr gjashtë numra<sup>242</sup> mund të supozohet se artikulli është i Musinesë ose Isuf Luzit që kishin hartuar dhe programin e Partisë Socialdemokrate. Në deponimet e saj në hetuesi në datën 1 prill 1946 Musine Kokalari dëshmon se gazeta botohesh në Shtypshkronjën Gutenberf aty ku dilshin dhe gazetat e Ballit. Gazeta shitesh me çmim 5 lek dhe disa herë jepesh edhe gratis, këtë gazetë e merrte dhe “Balli Kombëtar”. Gazeta mbahesh vetëm me rrogën time dhe disa ndihma që jepte Skënder Muçua<sup>243</sup>. Origjinaliteti i këtij organi krahasuar me organet e tjera shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore është trajtimi relativisht i gjerë i së ardhmes, i problemeve social-politike, kryesisht në prizmin teorik nga një këndvështrim socialdemokrat, i programit të formacionit politik që përfaqësonte.<sup>244</sup> Një aspekt të rëndësishëm në gazetë zinte përgatitja ideologjike dhe pasqyrimi i ideve socialdemokrate që do të duheshin të hidhnin rrënjë në realitetin shqiptar. Nga pasqyra e lëndës del se me këtë problematikë janë botuar në “Zërin e Lirisë” 12 artikuj propagandistikë, studimorë dhe pjesë të përkthyer nga literatura botërore<sup>245</sup>. Me interes të veçantë janë edhe artikujt që lidhen me realitetin shqiptar dhe sfidat e socialdemokracisë në një vend që kish hyrë me vonë në procesin e industrializimit dhe zhvillimit urban. Në gazetë trajtohen, sipas prizmit socialdemokrat, çështje të sindikalizimit në artikujt “Punëtorija e shtypshkronjave” dhe “Klasa dhe kolektivitetet në vendin tonë”. Gazeta kishte si moto të vet në krye të ballinës devizën “Drejtësi shoqërore dhe liri politike”. Këto dy synime që ishin të pasqyruar dhe gjerësisht në programin e Partisë Socialdemokrate, në fakt konkurronin si ide me atë çfarë propagandonte dhe PKS-h si forca më e madhe e rezistencës antifashiste, e organizuar jo vetëm politikisht duke udhëhequr Frontin Nacionalçlirimtar, por edhe ushtarakisht, në formën e batalioneve dhe brigadave partizane. Kjo duhet të ketë qenë një nga arsyet që forma e bashkëpunimit që iu afrua Partisë Socialdemokrate ishte vetëm futja në gjirin e Frontit Nacionalçlirimtar të anëtarëve të kësaj partie, si anëtarë të thjeshtë dhe jo si formacion politik.

238. AIDSSH/AMPB, F. 1/Proceset hetimore-gjyqësore, D. 1081-A, Nga procesverbali i deponimeve të Dosja Musine Kokalari në gjyqin e organizatës Bashkimi Demokratik Shqiptar.

239. AIDSSH/AMPB, F. 1/Proceset hetimore-gjyqësore, D. 1081-A, Nga procesverbali i deponimeve të Dosja Musine Kokalari në gjyqin e organizatës Bashkimi Demokratik Shqiptar.

240. L. Zelka, *Shtypi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore ...*, f. 292.

241. Po aty.

242. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 409.

243. AIDSSH/AMPB, F. 1/Proceset hetimore-gjyqësore, D. 1081-A Nga procesverbali i deponimeve të Musine Kokalari në gjyqin e organizatës Bashkimi Demokratik Shqiptar.

244. L. Zelka, *Shtypi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore ...*, f. 292.

245. Po aty.

Konflikti politik midis PKSH dhe Ballit Kombëtar i nisur në tetor 1943 me ardhjen e gjermanëve në Shqipëri nuk la shumë hapësira për rrugë të mesme dhe bashkim të të gjitha forcave të rezistencës. Partia Socialdemokrate u shpall si alternativë politike në një mbledhje që u mbajt në datën 12 tetor 1943 në Tiranë, në një shtëpi në rrugën e Elbasanit. Kjo mbledhje dëshmohej nga kujtimet e Musine Kokalari në librin e vet “Si u formua Partia Social-Demokrate” (1972) por edhe nga letra që Gogo Nushi, sekretar i qarkorit të Tiranës i dërgon Enver Hoxhës në 17 tetor 1943 për ta informuar mbi mbajtjen e Asamblesë Kombëtare. Në letër Gogo Nushi shkruan se *Balli nuk ka nxjerrë ndonjë gjë të re këto ditët e fundit. Me sa mësojmë, delegatët e Vlorës e kanë thënë vetë që Balli u diskretitua., prandaj duhet të formojmë diçka tjetër. Për këtë punë kishin ardhur Skënder Muçoja, Mitat Aranitasi, Jusuf Luzaj dhe të tjerë nga Vlora. Këta janë takuar shumë herë me Kondin (Sotir), Hariton (Qiriako) etj ., për të formuar Partinë Social-Demokrate. Në mbledhjen e fundit që patën, midis të tjerëve (Kondi, Harito, Sk.Muço, Mitat Aranitasi, zonjusha Musine Kokalari dhe disa të tjerë) mori pjesë dhe një simpatizanti ynë i cili na raportoi për të gjitha bisedimet që patën.*<sup>246</sup> Siç vihet re dhe nga letra, Partia Socialdemokrate trajtohet si një shtojcë apo alternativë e organizatës “Balli Kombëtar” dhe ajo çfarë iu afrua, sipas kujtimeve të Musine Kokalari, ishte rreshtimi brenda FNÇ si anëtarë të thjeshtë. Gjithsesi Musine Kokalari ishte për rrugën e bashkimit pasi siç thekson në kujtimet e veta “*unë nuk doja përçarje dhe as të çënohej Fronti N/Çlirimtar. Duhej të mbetej gjithmonë rruga drejt bashkimit, afrimit e në rast nevojë dhe aprovimi të hynim si Parti S.Demokrate*”<sup>247</sup>. Konflikti politik midis PKSH dhe Ballit Kombëtar i nisur në tetor 1943 me ardhjen e gjermanëve në Shqipëri nuk la shumë hapësira për rrugë të mesme dhe bashkim të të gjitha forcave të rezistencës. “*Për fat të keq, kujton Musine Kokalari, dhe kjo tentativë shkoi kot. Mitat Beu (Frashëri) tregoi pakënaqësinë e vet dhe ndikoi në marrëdhëniet midis Skënderit dhe Isuf Luzit, që ishin në grindje e ambicie. Unë u zëmërova, se pashë edhe një herë se krerët e Ballit nuk frymëzoheshin nga demokracia, por donte të shkonte përpara, duke ruajtur vetëm prestigjin e Lumo Skëndos që mbizotëronte në emrin e babait.*”<sup>248</sup> “*Rruga tragjike, - konkludon Musine Kokalari, - dhe pozita demokratike ishte gjithmonë sa në krahun komunist në shënjestër, po aq dhe nga elementët e Ballit, që donte të mbahej në këmbë me influenca personale*”.<sup>249</sup> Në këtë kontekst politik, pas përfundimit të Operacionit të Dimrit nga forcat gjermane, ku një pjesë e madhe e forcave të Ballit Kombëtar bashkëpunuan për të goditur bazat dhe forcat e armatosura të Frontit Nacionalçlirimtar, alternativa socialdemokrate, edhe pse me mbështetje të mjaftueshme intelektuale në Tiranë e Vlorë, u shpërbë. “*Një grup të rinjsh, - shkruan Musine Kokalari, ikën në Berat dhe forca gjermane intensifikojnë më keq. .... Balli u paralizua. Bëri në Berat Kongresin dhe një pjesë e krerëve të tij, si Kolë Tromara, Bahri Omari, Koço Muka muarnë pjesë në qeveri. Unë (Musine Kokalari) nuk e nxora më gazetën. U mora vetëm me letërsi. Çdo përpjekje që e kotë, nga të dy palët*”<sup>250</sup>. Në gjysmën e dytë të vitit 1944 ajo i rikthehet pasionit të saj, letërsisë, duke botuar dy libra: “Sa u tunt jeta” dhe “Rreth Vatrës”.

Kjo situatë nuk do të vazhdonte shumë. “*Filloi lufta e Tiranës, - kujton Musine Kokalari në librin e vet “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972). 12 nëntor, m’i morën dy vëllezër e shumë veta në lagje (për fat të keq) i tretë ishte i sëmurë me tifto) i vranë “ushtarakët çlirimtarë”. Më 13 nëntor më arrestuan. Më mbajtën në një shtëpi tek lagjia jonë. Ndaj të gdhirë kapërcyem tek rruga e Fortuzit, ndën gadishmërinë e tanksit gjerman. Na shpënë në rrugën Bardhyl. Na përplasën në binsat e një shtëpie ku qenë shumë të burgosur të mbledhur andej këndeje*”.<sup>251</sup>

246. AQSH, F14/APV.1943, D. 26, fl.

247. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972)* ..., f. 408.

248. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972)* ..., f. 409.

249. Po aty.

250. Po aty, f. 410.

251. Po aty, f. 412.

Ky moment është fillimi i kalvarit të vuajtjes së Musine Kokalarit, është dokumentuar edhe në arkivat e shtetit.<sup>252</sup> Një nga akuzat që i bëhen nga dy hetuesit partizanë që e marrin në pyetje, Sylo Kozeli dhe Sotir Polena, është se ajo është socialdemokrate dhe se ka sjellë përçarje gjatë luftës. Është ironik fakti që të njëjtën akuzë për përçarje i kishin bërë dhe krerët ballistë kur ajo i pat lajmëruar për formimin e Partisë Socialdemokrate. Në datën 28 nëntor ajo lirohet, por Musine Kokalari është e ndërjegjeshme se një epokë ka përfunduar për popullin shqiptar dhe ka filluar një epokë e re. “Filloi tragjedia e individit demokrat, - shkruan ajo, - nënë diktaturën e proletariatit. Kështu u mbyll epoka e Rilindjes dhe tendenca demokratike nga pozita humaniste që mbron popullin e thjeshtë, njeriun e punës për të shpëtuar nga skllavëria fizike dhe shpirtërore dhe dinjitetin njerëzor. Hyri dhuna dhe gjakderdhja për të shfarosur demokraten dhe gëzimi mizor për gjakderdhje, me forcë e mospëfillje”.<sup>253</sup>

---

## Musine Kokalari përballë regjimit të “diktaturës së proletariatit” (1945-1982)

---

Në historinë e rezistencës antikomuniste të Europës Lindore, Shqipëria, si vendi që hyri më shpejt se çdo vend tjetër i Europës Lindore në procesin e sovjetizimit, nuk ka shumë histori politike për të rrëfyer, pasi çdo mjet dhe akt i rezistencës u shtyp dhe u përdoq nga regjimi komunist. Periudha kur pushteti komunist në Shqipëri dha iluzionet që mund të pranonte edhe pjesëmarrje të opozitës është shumë e shkurtër. Ajo zgjati nga dhjetori i vitit 1944 deri në dhjetor 1945, periudhë në të cilën ende nuk kishte mbaruar zyrtarisht Lufta e Dytë Botërore dhe ende nuk ishin ndarë zonat e influencës në Evropën Lindore. Zgjedhjet e para për të formuar Asamblenë Kushtetuese që do të vendoste formën e qeverisjes në Shqipëri u mbajtën më 2 dhjetor 1945. Zhvillimi dhe mbarëvajtja e tyre ishte një nga kushtet që duhet të plotësonte qeveria shqiptare, në mënyrë që të fitonte njohjen e plotë dhe të pakushtëzuar. Masat e shpejta të komunistizimit të shtetit dhe të qeverisjes, edhe pse PKSHP vazhdonte të mos deklarohet hapur dhe të fshihej përmes FNC, kishin krijuar një klimë jo shumë të përshtatshme për gjallërimin dhe pjesëmarrjen politike të opozitës shqiptare në jetën publike e sociale të vendit. Në Shqipëri tashmë ishte vendosur një regjim komunist sipas modelit sovjetik, por në ndryshim nga “demokracitë e tjera popullore”, ky proces u zhvillua me asistencën dhe mbështetjen direkte të Jugosllavisë dhe Titos<sup>254</sup>. Shumë shpejt, në vlagën e korrespondencave të Qeverisë së Përkohshme me qeveritë e Aleatëve për të siguruar njohjen, si dhe masave për komunistizimin e Shqipërisë, edhe perëndimorët që operonin në Shqipëri nëpërmjet misioneve të veta ushtarake dhe civile e ndjenë të nevojshme të ndihmonin dhe përkrahnin opozitën e brishtë shqiptare. Për më tepër, brenda vetë FNC, kishte figura dhe personalitete që nuk binin dakord me format e organizimit të ri shtetëror, si gjykatat vendore, këshillat dhe komitetet ekzekutive, forma të huazuara nga sistemi komunist sovjetik. Një pakënaqësi e madhe tjetër ishte dhe e elementëve të shpronësuar apo tregtarëve të mëdhenj, pasuria e të cilëve u ishte nënshtruar ligjit të Tatimit të Jashtëzakonshëm të Luftës.

Kontaktet e para të britanikëve me opozitën u vendosën në qershor të vitit 1945, përmes njerëzve që punonin pranë Misionit Ushtarak Britanik, si: Kiço Xhonga, Ing. Avdulla Muça, Shaban Balla, Niko Beço, Hivzi Golja, Lllazar Apostoli (Larry Post) etj. *Intelektualët e mësipërm, të afërt me Misionin Ushtarak*

---

252. Shih për më tepër: AQSH, F14 d.2/a v.1944

253. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 412-413.

254. Hamit Kaba, Ethem Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, Prishtinë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2011, f. 16.





Musine Kokalari në gjyqin publik, korrik 1945

*Britanik, siguruan komunikimin midis këtij misioni me koordinatoren e grupit të rezistencës Sami Çeribashi, me elementë të përjashtuar nga Fronti, si ish-ministri i arsimit, Gjergj Kokoshi, dhe grupin social-demokrat, të përfaqësuar nga Musine Kokalari. Gjithashtu ata përfshinë në Komitetin inisiator të krijuar në pranverë 1945 edhe Qenan Dibrën, eksponent i njohur i Partisë së Legalitetit<sup>255</sup>. Grupimi Social-Demokrat kryesohej nga Musine Kokalari, intelektuale dhe shkrimtare e njohur për kohën. Një memorandum iu dërgua Aleatëve për shtyrjen e zgjedhjeve dhe pranimin e alternativave të tjera partiake, veç FNÇ. Ky memorandum, sipas dëshmive, u hartua nga Musine Kokalari dhe përfshinte një program politik të organizatës Bashkimi Demokratik Shqiptar. Pikat kryesore të këtij memorandumit ishin: 1) Qeverisje demokratike dhe respektim i të drejtave të njeriut. 2) Miqësi me shtetet demokratike, sidomos me vendet fqinje. 3) Zgjidhja e problemit të Kosovës, me anë të një plebishiti, ose sipas Konferencës së Paqes. 4) Respektimi i të drejtave të pakicave. 5) Zbatimi i gjithë reformave, duke pasur parasysh dhe traditat. 6. Të luftohet çdo element fashist apo profashist dhe kriminelët e luftës. 7) Të njihet neutraliteti i Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha. 8) Të mbahet një fuqi e armatosur sa për sigurimin e qetësisë së brendshme.<sup>256</sup>*

Sic shihet, ky program ishte një reflektim më i gjerë i programit të Partisë Socialdemokrate të botuar në janar 1944 në “Zërin e Lirisë”. Grupimi socialdemokrat në Bashkimin Demokratik Shqiptar (1946) përfaqësonte një rrymë të moderuar të së majtës shqiptare, e cila ishte për një evolucion të shoqërisë shqiptare pa qenë e nevojshme të ndërmerreshin masa ekstreme të kopjuara nga sistemi komunist në Bashkimin Sovjetik. *Në nenin dy të statusit të Partisë Socialdemokrate shkruhej se PSD është evolucioniste përse i përket kolektivizmit ekonomike.*<sup>257</sup> Pra, grupimi socialdemokrat kërkonte evolucion të marrëdhënieve

255. Leka Ndoja, *Zanafilla e Bashkimit Demokratik. Bashkimi Demokratik Shqiptar 1946*, Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, 2015, f. 9.

256. AIDSSH/AMPB, F. 1/Proceset hetimore-gjyqësore, D. 1081-A, Nga procesverbali i deponimeve të Musine Kokalari në gjyqin e organizatës Bashkimi Demokratik Shqiptar.

257. Musine Kokalari. Vepra 2, Programi i Partisë Socialdemokrate pergatitur nga N.XH.Shehu, Geer, Tiranë:2009, fq. 435

ekonomike në Shqipëri dhe jo kolektivizim të dhunshëm që u zbatua nga komunistët shqiptarë. Po kështu, përsa i përket problemit agrar, një nga problemet më të mëdha të shoqërisë shqiptare të asaj kohe, PSD në statutin e vet, neni tre, shënonte se *ka për qëllim kryesor t'i sigurojë bujkut tokën e mjaftueshme për të punuar, të zhdukë shfrytëzimin, spekulimin dhe parazitizmin. Gjithashtu do t'i sigurojë proletariatit bukën, banimin dhe të gjitha ndihmat e tjera për t'ja bërë jetën e këndshme.*<sup>258</sup> Siç shikohet nga frazeologjia e përdorur PSD ishte shumë afër qëndrimeve të së majtës shqiptare që synonte një shndërrim social që t'i përgjigjej nevojave të kohës. Si qëllim të afërt dhe shprehësishëm për të realizuar një balancë ekonomike në jetën e popullit shqiptar, PSD shikonte *realizimin e një reforme agrare që do të ishte etapa e parë e ndarjes së tokës*<sup>259</sup>. Për më tepër në program synohej *në realizimin e një sistemi sigurimi shoqëror për mbrojtjen e të gjitha klasave shoqërore*<sup>260</sup>. Musine Kokalari dhe socialdemokratët shqiptarë ishin të ndërgjegjshëm se në Shqipëri duhet të kishte drejtësi shoqërore, në mënyrë që të kishte më shumë liri politike. Edhe në aspektin e politikës së jashtme, PSD ishte në mbështetje të një ideje për realizimin sa më parë të një konfederate ballkanike, duke qenë një hap më para se edhe vetë komunistët shqiptarë, që nuk guxonin ta shprehin hapur në asnjë program të tyre këtë qëllim. Mirëpo, pavarësisht këtyre qëndrimeve shumë të ngjashme me komunistët shqiptarë, sërish qëndrimet e tyre u quajtën të rrezikshme për monopolin e pushtetit që dëshironin të arrinin komunistët, sepse socialdemokratët ishin për një jetë aktive parlamentare dhe ekzistencën e opozitës në jetën politike të vendit, që përfshinte të tri organizatat.

Për fat të keq të historisë së parlamentarizmit në Shqipëri, zgjedhjet nuk u shtynë dhe u zhvilluan në datën e përcaktuar më parë, më 2 dhjetor 1945. Fronti Demokratik fitoi shumicën e vendeve në Asamblenë Kushtetuese prej 82 vendesh dhe asnjë kandidat jashtë listave të Frontit, nuk fitoi. Misioni Ushtarak Britanik dhe Misioni Civil Amerikan i ndoqën zgjedhjet nga afër. Procesi i zgjedhjeve u konsiderua i pranueshëm prej tyre. Raporti i Misionit Ushtarak Britanik njofton se përfaqësuesit e tij kishin mundur të vëzhgonin qendra votimi në Shkodër, Krujë, Lezhë, Milot, Mamurras, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier dhe Vlorë. Konkluzionet e vëzhgimit ishin se: “pavarësisht çdo lloj presioni që mund të jetë ushtruar para votimeve, në ditën e votimit nuk pati frikësim të dukshëm”. Të njëjtin përfundim jep dhe drejtuesi i Misionit Civil Amerikan, Jacobs në raportin e tij. Ata mendonin se në Shqipëri nuk mund të kërkonin standarde demokratike, si në vendet e tyre. Gjithsesi, fitorja e Frontit Demokratik me rezultat aq të thellë ishte zhgënjyese për Aleatët Perëndimorë<sup>261</sup>. Triumfi në zgjedhjet e 2 dhjetorit nga Fronti Demokratik dhe PKS-h që qëndronte në prapaskenë, u dha komunistëve shqiptarë vetëbesim për të ecur më tej në projektin për instalimin e regjimit të tyre. Modeli mbi të cilin ata bazoheshin ishte modeli sovjetik. *Modeli sovjetik ishte një sistem totalitar i bazuar në një parti të vetme. Si i tillë, në procesin e funksionimit të shtetit, në të mungojnë ata organizma që shërbejnë si kundërpeshë ndaj pushtetit, që e kontrollojnë dhe e kufizojnë atë nga ndërmarrrja e veprimeve arbitrare*<sup>262</sup>. Në këtë kontekst, e vetnja që mund të krijonte probleme në instalimin e regjimit komunist në Shqipëri ishte opozita e Bashkimit Demokrat, ndaj për këtë arsye menjëherë pas zgjedhjeve, qeveria e Enver Hoxhës vendosi të marrë masa represive ndaj tyre. *Mjet kryesor në ushtrimin e pushtetit të regjimeve totalitare është tiranizimi. Ai është në vetë përmbajtjen e totalitarizmit, të sundimit total nga një parti e vetme e udhëheqësi i saj, të nënshtrimit të individit në kuadrin e komb-shtetit.*<sup>263</sup> Një numër i madh i eksponentëve të opozitës shqiptare kishin mbajtur kontakte shumë të ngushta me oficerë të Misionit Ushtarak Britanik, si Nënkolonelin Palmer, Kapitenin Smith dhe Togerin Arnot. Të arrestuarit ishin pothuajse të gjithë eksponentët e Bashkimit Demokrat duke filluar nga Gjergj Kokoshi, Musine Kokalari, Sami Çeribashi, Ali Kavaja, Qenan Dibra, etj. Rezultoi që pjesa më

258. Musine Kokalari. Vepra 2, Programi i Partisë Socialdemokrate pergatitur nga N.XH.Shehu, Geer, Tiranë:2009, fq 435.

259. Musine Kokalari. Vepra 2, Programi i Partisë Socialdemokrate pergatitur nga N.XH.Shehu, Geer, Tiranë:2009, fq 436.

260. Musine Kokalari. Vepra 2, Programi i Partisë Socialdemokrate pergatitur nga N.XH.Shehu, Geer, Tiranë:2009, fq. 436.

261. Për më tepër shih: Sonila Boçi, “Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945”, në: *Studime Historike*, nr. 1-2, 2008, Tiranë: 2008.

262. Llambro Filo, *Sistemet politike bashkëkohore*. Tiranë: Botimet Ideart, f. 358.

263. Ll. Filo, *Sistemet politike bashkëkohore ...*, f. 358-359.

-2-  
N-1081-A

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËSË  
MINISTRIA E PUNË MBRENDËSHME

Titulli i Dosjes

**DOSJE (E PËRFUNDJAR)**

Nr. *17*

Dokument i Detyrës Ligjore dhe Repartit  
Përshkrimi i Subjektit

**TITULLI I DOSJES**  
*Prokurorosi i Tiranës  
4. Musine Kokalari dhe bashkëpunëtorët  
5. Heli  
6. Heli  
7. Heli  
8. Heli  
9. Heli  
10. Heli  
11. Heli  
12. Heli  
13. Heli  
14. Heli  
15. Heli  
16. Heli  
17. Heli  
18. Heli  
19. Heli  
20. Heli  
21. Heli  
22. Heli  
23. Heli  
24. Heli  
25. Heli  
26. Heli  
27. Heli  
28. Heli  
29. Heli  
30. Heli  
31. Heli  
32. Heli  
33. Heli  
34. Heli  
35. Heli  
36. Heli  
37. Heli  
38. Heli  
39. Heli  
40. Heli  
41. Heli  
42. Heli  
43. Heli  
44. Heli  
45. Heli  
46. Heli  
47. Heli  
48. Heli  
49. Heli  
50. Heli  
51. Heli  
52. Heli  
53. Heli  
54. Heli  
55. Heli  
56. Heli  
57. Heli  
58. Heli  
59. Heli  
60. Heli  
61. Heli  
62. Heli  
63. Heli  
64. Heli  
65. Heli  
66. Heli  
67. Heli  
68. Heli  
69. Heli  
70. Heli  
71. Heli  
72. Heli  
73. Heli  
74. Heli  
75. Heli  
76. Heli  
77. Heli  
78. Heli  
79. Heli  
80. Heli  
81. Heli  
82. Heli  
83. Heli  
84. Heli  
85. Heli  
86. Heli  
87. Heli  
88. Heli  
89. Heli  
90. Heli  
91. Heli  
92. Heli  
93. Heli  
94. Heli  
95. Heli  
96. Heli  
97. Heli  
98. Heli  
99. Heli  
100. Heli*

Te mos harrim dhe të ruajmë s'arrestuar =  
Nëse ka rrethana

Nr. *2654-1081*

Emri i Aktit  
Kombi  
Forma  
Dite

Dosje gjyqësore nr. 1081-A për Musine Kokalarin

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËSË  
PROKURORIA E  
GJYKATËS USHTRAKË E HAJDËT

Nr. *17* E. P.

**Letër-rreshtim**  
Kundra:

Musine Kokalari e bija *K* e Roshatit dhe e Anushës  
vjet. *28* nga Turqi - Tiranë me profesion *libra shitëse*  
*ELXXX*

**Akuzohet**  
**Sabotatore e Paqetësisë dhe Armike e Pëpopullit**

Me qenë se (saj) *184* i detyrohet prej N. rrethit të Ligjit Nr. 21 date 15.XII.1944 dhe 15. parag. II të Ligjit Nr. 41 date 14.I.1945 N. Prokuror i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20. parag. III të Ligjit Nr. 41. -

**Urdhërojmë:**

Rreshtimin e tij për një kohë të përcaktuar në burgun e Tiranës. ....  
Organet e M. P. Policisë dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e kësaj letere-rreshtimi.

PROKURORI  
(Kuj. I. H. Hoxha)  
*Musine Kokalari*  
KRYETARI  
(Maj. F. Hoxha)

Tiranë, më 10.V.1946.

Fletë arresti për Musine Kokalarin.

“

Filloi tragjedia e individit demokrat, nënë diktaturën e proletariatit. Kështu u mbyll epoka e Rilindjes dhe tendenca demokratike nga pozita humaniste që mbron popullin e thjeshtë, njeriun e punës, për të shpëtuar nga skllavëria fizike e shpirtërore, dhe dinjitetin njerëzor.

Musine Kokalari

”

e madhe e tyre kishte qenë prej kohësh në survejimin e agjentëve të Mbrojtjes së Popullit dhe ndaj tyre u ushtrua një proces hetimor i dhunshëm dhe i egër. Akuzat kryesore drejtoheshin ndaj bashkëpunimeve të tyre me të ashtuquajturit kriminelët e luftës ose të arratisurit në male dhe përpjekje për të rrezuar me dhunë pushtetin në fuqi. Në këtë proces u përfshinë 75 persona, prej të cilëve 9 morën dënime kapitale dhe të tjerët u dënuan me burgime të gjata. Procesi hetimor edhe më vonë ai gjyqësor hodhën bazat e sistemit të eliminimit të elitave jokomuniste dhe të kundërshtarëve politikë që do të vazhdonte për pothuajse gjithë periudhën e sundimit komunist në Shqipëri. Ky gjyq i parë ndaj opozitës shqiptare nuk ishte i rastësishëm. I veçantë për njetin e eliminimit komunist nuk ishte vetëm numri i madh i të eliminuarve, por mënyra e përzgjedhjes së atyre që ekzekutoheshin. *Iu dha fund gjyqimit në bazë të fajësisë vetiake apo përgjegjësisë vetiake. Dënimi nuk bëhej mbi bazën e akuzës për krime vetiake, por mbi bazën e prejardhjes sociale të të dënuarit dhe të thashethemeve për të.*<sup>264</sup> Musine Kokalari u arrestua më 23 janar 1946 dhe e mbajtën 17 ditë në burg.

Mbi Musine Kokalari u zbatua e njëjta strategji për ta denigruar dhe burgosur. Qëndrimi i saj në gjyq ishte një shuplakë ndaj regjimit komunist dhe dëshmi e forcës morale që intelijenca shqiptare po tregonte përkundëjt totalitarizmit. Musine Kokalari nuk pranoi të merrte avokat mbrojtës në gjyq dhe e shkroi vetë mbrojtjen e saj. Në gjyq ajo do të shprehej me një guxim të pashoq intelektual e njerëzor se *“Unë nuk kam nevojë të jem komuniste të dua vendin tim. E dua vendin tim edhe pse nuk jam komuniste. Unë e dua përparimin e tij. Ju mburreni se keni fituar luftën, dhe tani ju jeni fituesi që doni të shuani ata që ju i quani kundërshtarë politikë. Unë mendoj ndryshe nga ju, por unë e dua vendin tim. Ju jeni duke më ndëshkuar për idealet e mia!”*<sup>265</sup> Po kështu ajo do të shprehej edhe për alternativën socialdemokrate duke qartësuar se *aktiviteti i grupit të vogël socialdemokrat nuk është gjë tjetër veçse një notë e drejtuar aleatëve të perëndimit për shtymjen e votave ku qeveria u njoh me të drejtë opozite.*<sup>266</sup> Më 2 korrik të vitit 1946, Musine Kokalari u dënua me 20 vjet burgim nga Gjykata Ushtarake e Tiranës si sabotatore dhe armike e popullit. Me arrestimin dhe dënimin e Musine Kokalari u shuan shpresat se regjimi komunist në Shqipëri do të ndiqte një rrugë të moderuar drejt konsolidimit të pushtetit të tij e me veprimet arbitrare po shuante rezistencën dhe mendimin ndryshe. Për të filloi kalvari i vërtetë i burgjeve dhe internimeve komuniste, që do ta degdisnin nga Tirana, në Burrel, Shkodër e Rrëshen (Mirditë) deri në fund të jetës së saj.

Në ecejaket e degdisjes së saj nga njëri burg në tjetrin nuk mungonin stigmatizimet përsa i përket kredos së saj socialdemokrate. Në vitin 1957, gjatë një inspektimi në burgun e Shkodrës, Beqir Balluku, funksionar i lartë i hierarkisë komuniste që edhe e kishte arrestuar në nëntor të vitit 1944, do ta pyeste: *Si vete, socialdemokrate?*<sup>267</sup> Më 8 tetor të vitit 1961, u lirua nga burgu dhe u internua në Rrëshen. Aty iu nënshtrua ndjekjes së përhershme nga Sigurimi i Shtetit, siç dëshmohej nga dosja e saj në arkivat e AIDSSH. *“Jeta në Rrëshen është një kapitull tragjik më vete, vuajtjesh e shëmtimesh, - do të shkruante Musine Kokalari, - në shënimet e veta. Ata pandehnin se unë nuk e dija. Sa vjet vuajtje e padrejtësi? Nuk kam mbajtur të mbaj një ditë të hollësishëm që do ishte shumë interesant. S’ka gjë më të keqe kur njerëzit janë të paformuar ideologjikisht dhe çudi, ardhur nga bangat e Universitetit. S’kishin marrë vesh asgjë”*<sup>268</sup> Musineja punoi fshesare dhe 11 vjet në ndërmarrjen e Ndërtimit në Rrëshen, mes tullave, llaçit dhe betonit. Kur i mbaroi internimi më 1979 i thanë të shkonte në Gjirokastër, por pasi nuk e lejuan të shkonte në Tiranë, nuk pranoi të lëvizte nga Rrësheni. Ndërroi jetë më 13 gusht 1983. Më 1991 familjarët e saj e zhvendosën në Shish-Tufinë, në Tiranë. Rezistenca e saj morale dhe intelektuale ka lënë gjurmë të pashlyeshme në mendimin intelektual shqiptar.

264. Ll. Filo, *Sistemet politike bashkëkohore ...*, f. 358.

265. AIDSSH/AMPB, F 1/Proceset hetimore-gjyqësore, D. 1081-A, Nga procesverbali i deponimeve të Musine Kokalari në gjyqin e organizatës Bashkimi Demokratik Shqiptar.

266. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 423.

267. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 430.

268. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 431.

---

## Trashëgimia politike dhe ideologjike e Musine Kokalarit

---

Në vitet e mëpasme pas dënimit të Musine Kokalarit dhe përqasjes së PKSH drejt një komunizmi sa më ortodoks të lidhur ngushtë ideologjikisht me variantin stalinist sovjetik është vështirë të gjurmohen ndikimet e mendimit të saj në të majtën shqiptare. Realizimi i Reformës Agrare më 1946 ishte shumë i ashpër dhe i tejkalonte përmasat e një reforme që jepte frymë për ekonominë. Konfederata Ballkanike u mbështet fuqishëm nga udhëheqja komuniste shqiptare deri në denoncimin e saj si koncept nga Stalini, por qartazi, Musine Kokalari dhe PSD-ja shqiptare mendonte për një variant tjetër që përfshinte dhe vetëvendosjen e popujve, siç dëshmohet dhe nga memorandumimi dërguar ambasadës britanike në prag të zgjedhjeve të 2 dhjetorit në 1945.

Në vitin 1948 pas Plenumit VIII të PKSH, Musine Kokalari kujton në librin e vet “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972) se *i kërkuan të mbronte shkurtimisht tezat të Socialdemokracisë*<sup>269</sup>. Nuk është e qartë se cili ka qenë qëllimi i kësaj kërkesë, por fakti që i janë referuar si mendimtare socialdemokrate dëshmon për autoritetin që ajo kish fituar si përfaqësuese e kësaj rryme në Shqipëri. Në shënimet e veta në kapitullin e fundit Përshtypje nga libri “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972), ajo kritikon variantin e socializmit të ushtruar në Shqipëri, jo vetëm përse i përket dhunës së ushtruar dhe mungesës së të drejtave dhe lirive të njeriut, por edhe për konceptet teorike që ilustronin marksizmin në Shqipëri. *Puna e krahut është e rëndë në socializëm, që thonë që është klasa punëtore në fuqi, punëtori mbetet gjithmonë në fund: qoftë në dituri, aqë më pak në pagesë dhe aq më shumë në mbylljen e tij brenda katër mureve të ndërmarrjes.*<sup>270</sup>

PSD-ja e themeluar në shkurt të vitit 1991 nga një grup intelektualësh shqiptarë në kuadër të pluralizmit, nuk arriti ta përfshinte figurën e Musine Kokalarit si një themeluese të mendimit socialdemokrat në Shqipëri dhe figura e saj iu bashkëngjiti opozitës së djathtë shqiptare, edhe pse ideologjikisht, ajo i përkiste spektrit të majtë. Trashëgimia politike e mendimit të saj teorik nuk u mor parasysh as në formimin e sindikatave të pavarura nga politika dhe as për dinjitetin human, për të cilin kishte shkruar aq shumë. Në memorandumimin dërguar ambasadës britanike në pjesën “Politika sociale” që dukej se ishte reflektim i programit të Partisë Socialdemokrate, nënvizohej *si kërkesë lënia e lirë e organizatave të punëtorëve dhe pjesëmarrja e tyre në vendosjen e kushteve të punës.*<sup>271</sup> Revokimi i mendimeve të saj teorike rreth socialdemokracisë mund të jenë një përpjekje e mirë për të ridimensionuar rrugën e tretë të së majtës shqiptare.

---

269. M. Kokalari, *Si lindi Partia Social-Demokrate (1972) ...*, f. 429.

270. Po aty, f. 433.

271. Alina Vagner, *Musine Kokalari dhe socialdemokracia*, Fridrih Ecbrecht Stiftung: 2016, f. 28.

## Bibliografia

AQSH,F14, dos.26

AQSH, F14 d.2/a v.1944

Dosja Musine Kokalari, Arkivi i AIDSSH.

Alina Vagner. Musine Kokalari dhe socialdemokracia. Fridrih Ecbreht Stiftung:2016

Eglantina Mandia. Sonata e Hënës:rrëfim për një jetë-Tiranë:1995, Globus R.

Hamit Kaba, Ethem Çeku. Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962. Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti I Historisë. Tiranë:2011.

Leka Ndoja. Zanafilla e Bashkimit Demokratik. Bashkimi Demokratik Shqiptare 1946. Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë:2015.

Luan Zelka. Shtypi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944. Tiranë:2003, Globus R.

Llambro Filo. Sistemet politike bashkëkohore. Botimet Ideart, Tiranë.

Mauro Geraci. Muza shqiptare në Sapienza .Jeta dhe vdekja e ëndrrës universitare. Musine Kokalari. Vepra e zgjedhur 3, përgatitur nga Persida Asllani, Tiranë: 2017, B.K.SH

Musine Kokalari. Jeta ime Universitare (1940-1942), Vepra I, përgatitur nga N.XH.Shehu, Geer, Tiranë:2009.

Musine Kokalari. Si lindi Partia Social-Demokrate (1972), Vepra II, përgatitur nga N.XH.Shehu, Geer, Tiranë:2009.

Musine Kokalari. Vepra 2, Programi i Partisë Socialdemokrate përgatitur nga N.XH.Shehu ,Geer, 2009.

Musine Kokalari. Vepra e zgjedhur 3, përgatitur nga Persida Asllani, Tiranë: 2017, B.K.SH.

Paskal Milo. Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore. Tiranë:2014, Toena.

Robert Elsie. Musine Kokalari në Histori e letërsisë shqiptare. Tiranë-Pejë: Dukagjini, 1997.

Simonetta Ceglie. Një liber në sirtar.Nënës sime. MusineKokalari. Vepra e zgjedhur 3, përgatitur nga Persida Asllani, Tiranë: 2017, B.K.SH,

Isuf

Luzaj





# Profili i një nacionalisti socialdemokrat

Isuf Luzaj është një prej themeluesve të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë. Ai ka lindur në 1913 në Kaninë të Vlorës. Është diplomuar në letërsi dhe filozofi në Universitetin e Sorbonës në Francë. Për merita akademike ka marrë titullin honorifik “Profesor i Amerikës”, i cili i është dorëzuar nga Presidenti i SHBA-ve, Ronald Regan.

**NGA ILIR KALEMAJ**

Isuf Luzaj është një prej themeluesve të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë. Ai ka lindur në 1913 në Kaninë të Vlorës. Është diplomuar në letërsi dhe filozofi në Universitetin e Sorbonës në Francë. Në vitet 1936 kthehet në Shqipëri pas studimeve dhe emërohet profesor, fillimisht në Normalen e Elbasanit, dhe më pas në Liceun e Korçës. Më 1938 emërohet pedagog në Shkollën Teknike të Vlorës. Pas Luftës së Dytë Botërore pati një karrierë të spikatur akademike, që nisi nga Universiteti i Buenos Airesit në Argjentinë, e vijoi me universitetet në New Hampshire, Barat College-Lake Forest, Illinois, Colombia, Harvard, St. Joseph College, Indiana në SHBA. Në Universitetin e Indianës shërbeu për disa vite si shef i katedrës së filozofisë<sup>272</sup>. Për merita akademike ka marrë edhe titullin honorifik “Profesor i Amerikës”, i cili i është dorëzuar nga Presidenti i SHBA-ve, Ronald Regan. Isuf Luzaj ka pasur gjithashtu aktivitet të rëndësishëm politik gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai u evidentua si një prej intelektualëve antifashistë, e më pas si një prej drejtuesve të Ballit Kombëtar të qarkut të Vlorës. Një tipar i spikatur i jetës dhe veprimtarisë së Luzajt gjatë LIIB ka qenë themelimi, më 12 tetor 1943, i Partisë Socialdemokrate në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, së bashku me Musine Kokalarin, Skënder Muçon e 60 intelektualë të tjerë. Në emigracionin e detyruar politik pas Luftës së Dytë Botërore, Isuf Luzaj u shqua për përpjekjet e pareshtura për luftën kundër komunizmit në Shqipëri dhe Kosovë. Ashtu si gjatë Luftës, edhe në emigracion, Isuf Luzaj u angazhua për çështjen kombëtare shqiptare. Ai u njoh për kontaktet e shpeshta në diasporë me emigracionin e shqiptarëve të Kosovës dhe territoreve të tjera në ish-Jugosllavi për të materializuar konceptin e një Kosove të pavarur, por edhe duke pasur destinacion final bashkimin Shqipëri-Kosovë.

272. Isuf Luzaj - *Biografia*. Marrë nga: <https://www.luzaylibrary.com/biografia/>

---

## Isuf Luzaj: antizogisti, antifashisti dhe themeluesi i Ballit Kombëtar

---

Në fund të viteve '30, profesor i ri, i sapokthyer nga studimet e larta në Francë, Isuf Luzaj filloi të shfaqej në rrethet intelektuale shqiptare si njeriu rebel me prije revolucionare. Më 1937 zuri fill karriera e tij letrare, e cila do ta vinte përballë regjimit autoritar të mbretit Zog. Përmbledhja poetike “Rrëfime” u konfiskua nga censura e regjimit zogist, pa shitur as 100 kopje. Jo vetëm kaq, poetin e ri e ndaluan dhe e dërguan në Ministrinë e Brendshme. Ajo çfarë i kishte shqetësuar krerët e kësaj Ministrie ishte poezia “Neroni”, e cila rrekej ta krahasonte mbretin Zog me perandorin famëkeq romak Neroni. Në një intervistë të vitit 1991, të botuar fillimisht në gazetën “Illyria” të Nju Jorkut, prof. Luzaj kujton takimin me ministrin e Brendshëm: “Me Neronin, perandorin romak që dogji Romën, ke aluduar për mbretin Zog. Madje juve ju njohim edhe si antizogist. Ki mendjen or djalë!- m’u kërcënua ai”<sup>273</sup>. Pas 49 ditësh i ndaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, profesori e ri u lirua dhe u detyrua të largohej nga Korça, e cila ishte bërë në atë kohë qendër e lëvizjes majtiste dhe sindikaliste. Më pas u emërua mësues në Shkollën Tregtare të Vlorës. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia e Musolinit e gjeti antifashistin nacionalist, Isuf Luzaj pranë vendlindjes, Vlorës. Në fakt, qëndrimi i tij ndaj pushtimit të Shqipërisë nga Italia, kishte karakter të fortë antifashist dhe, si një nga profesorët e Shkollës Tregtare të Vlorës, Luzaj i nixti nxënësit për të reaguar ndaj pushtimit të Shqipërisë. Ai kujton se ishte përpjekur së bashku me 120 studentët e tij të reagonin me armë kundër pushtimit të vendit, por mungesa e organizimit të rezistencës dhe e armatimeve e kishin bërë të pamundur<sup>274</sup>. Për organizimin e një proteste kundër pushtimit, ai mori edhe kosto personale, pasi u internua nga pushtuesit italianë.

Aneksimi i Shqipërisë nga Italia e Musolinit kishte karakter, sa politik e strategjik, aq edhe ideologjik. Në përpjekjet e tyre për t’u diktuar shqiptarëve, përveç të tjerave, edhe ideologjinë fashiste, pushtuesit strukturuan shoqërinë shqiptare sipas modelit fashist italian. Ata konsideruan si rrezik për regjimin e tyre individët e shkolluar në vende të demokracisë liberale, si Francë, SHBA, Britani e Madhe, etj. Të gjithë mësuesve iu kërkua të bënin betimin e besnikërisë ndaj regjimit të ri dhe pas qershorit 1939, të aderonin në Partinë Fashiste Shqiptare. Është e vërtetë se zyrtarisht aderimi nuk ishte detyrim, por kundërshtimi ishte i mjaftueshëm për ta vënë individin në vëzhgim. Gjatë viteve 1939–1940, Mëkëmbësi i Përgjithshëm, Francesco Jacomoni në raportet e tij periodike i ankohet vazhdimisht ministrit të Jashtëm italian, Galeazzo Ciano, për sjelljet e pjesës më të madhe të intelektualëve shqiptarë, të cilët, të shkolluar në shtete të demokracive liberale kërkonin të drejta dhe liri individuale e kombëtare, dhe kundërshtonin ideologjinë fashiste. Pas demonstratave të 28 nëntorit 1939, Jakomoni shkon edhe më tej. Në një telegram që ai i dërgon Cianos vë në dukje se “qendra e propagandës nacionaliste dhe antiitaliane janë institutet/shkollat e mesme” duke shtuar se ka ardhur koha që “të dëshmohet energji represive kundrejt klasës së intelektualëve shqiptarë”<sup>275</sup>.

Më 28 nëntor 1939, në qytetet kryesore të vendit në Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, etj., profesorët dhe studentët e shkollave të mesme devijuan festimet e organizuara nga pushtuesit fashistë me rastin e përvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe protestuan me flamurin shqiptar pa shenjat e Liktorit, për një

---

273. “Isuf Luzaj: Kosova, arsyeja e dështimit të mbledhjes së Mukjes” intervistë e Vehbi Bajramit, në: *Panorama*, 11 shtator 2013, <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-kosova-arsyeja-e-deshtimit-te-mbledhjes-se-mukjes/>.

274. “Isuf Luzaj: Kosova, arsyeja e dështimit të mbledhjes së Mukjes” intervistë e Vehbi Bajramit, në: *Panorama*, 11 shtator 2013, <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-kosova-arsyeja-e-deshtimit-te-mbledhjes-se-mukjes/>.

275. Sonila Boçi, “Tiparet e rezistencës shqiptare kundër pushtuesit italian” referat i pabotuar mbajtur në tryezat shkencore *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore*, organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) 5-7 nëntor 2019. Autorja i referohet: AQSH, F. 161/Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1939, D. 5, fl. 2, Telegram i Jacomonit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, pa datë.



Karriera akademike e Isuf Luzajt në SHBA shënoi vetëm rritje, por ajo nuk e pengoi armiqësinë e regjimit totalitar në Shqipëri ndaj tij dhe familjes.

Shqipëri të lirë dhe të pavarur. Në Vlorë, prof. Luzaj ishte së bashku me studentët në këtë protestë. Ai kujton se ishin rreth “një mijë studentë dhe një mijë qytetarë brodhëm rrugëve të Vlorës, duke kënduar himnin e flamurit”<sup>276</sup>. Reagimi i pushtuesve fashistë ishte i ashpër. Një fushatë e gjerë arrestimesh e internimesh filloi në të gjithë vendin. Në një listë të titulluar *Eppurazione della classe intellettuale albanese* (Pastrimi i klasës intelektuale shqiptare), Jakomoni shenjon internimin e një numri jo të vogël profesorësh të shkollave të mesme, duke përfshirë Selman Rizën, Kristaq Cepon, Abaz Ermenjin, Safet Butkën, Isuf Luzajn, etj. si dhe pushimin nga puna të shumë e shumë të tjerëve<sup>277</sup>.

Në kujtimet e tij, Luzaj shprehet se shkak për arrestimin ishte bërë vrasja e një polici italian nga një student i Shkollës Tregtare. “Lindi dyshimi se e kisha bërë unë një vepër të tillë dhe më arrestuan. Së pari më çuan në burgun e Vlorës e pastaj në atë të Durrësit, prej nga, pas disa muajsh, më transferuan së bashku me 12 studentë në Brindisi të Italisë. Ky ishte burgu më i keq që kam parë në jetë. Prej burgut të Brindisit na transferuan në Gaeta e prej atje në Ventotene”<sup>278</sup>. Në kampin e Ventotenes ra në kontakt me shqiptarë të tjerë të internuar, si: Abaz Ermenjin e Llazar Fundon, por edhe me antifashistë italianë, si me komunistët Altiero Spinelli e Umberto Terracini dhe socialistin Sandro Pertini. Prej tyre mori kontakt me literaturën marksiste. Për shkak të poezive që Luzaj kishte shkruar për Luftën e Vlorës

276. “Isuf Luzaj: Kosova, arsyeja e dështimit të mbledhjes së Mukjes” intervistë e Vehbi Bajramit, në: *Panorama*, 11 shtator 2013, <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-kosova-arsyeja-e-deshtimit-te-mbledhjes-se-mukjes/>.

277. Sonila Boçi, “Tiparet e rezistencës shqiptare kundër pushtesit italian” referat i pabotuar mbajtur në tryezat shkencore *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore*, organizuar nga Instituti i Historisë (ASA) 5-7 nëntor 2019. Autorja i referohet: AQSH, F. 161/Mëkëmbësia e Përgjithshme, V. 1939, D. 5, fl. 12-14, Lista e arsimitarëve shqiptarë të internuar, apo të pushuar nga puna më 1940.

278. “Isuf Luzaj: Kosova, arsyeja e dështimit të mbledhjes së Mukjes” intervistë e Vehbi Bajramit, në: *Panorama*, 11 shtator 2013, <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-kosova-arsyeja-e-deshtimit-te-mbledhjes-se-mukjes/>.

(1920), komandanti i kampit e izoloi në kështjellën e Ventotenes, ku u takua me Ali Këlcyrën. Këtu filloi rrugëtimi i tij si një prej anëtarëve më aktivë të Ballit Kombëtar. Ali Këlcyra i kishte treguar të riut antifashist se, para se ta internonin, ai së bashku me Mit'hat Frashërin, Fuat Bej Dibrën e Lef Nosin kishin krijuar Ballin Kombëtar, po nuk kishin statut të organizatës. “Në varrezat e kështjellës, – kujton Luzaj, – të dielave, populli shkonte për të vendosur lule. Edhe ne, një ditë, blemë ca lule për të nderuar të vdekurit, vetëm që karabinierët italianë të mos na hetonin se po bashkëpunonim. Në atë vend, disa të diela rresht, shkruam Dekalogun e Ballit Kombëtar. Ali Këlcyra fliste, unë shkruaja. Unë propozova që në Dekalog të hynte pika e shtatë: “Organizata e Ballit Kombëtar do të zbulojë vlerat e vërteta, do t’i edukojë njerëzit, pa marrë parasysh besimin, krahinën ose partinë politike”<sup>279</sup>.

Kontributi i Isuf Luzajt në organizatën politike Balli Kombëtar që i shumëfishtë. *Së pari*, si një prej organizatorët më të hershëm të rezistencës kundër pushtuesit fashist italian dhe nxitës i ndjenjave antifashiste në rininë shkollore. *Së dyti*, Luzaj spikati si ideolog dhe inspirues i parimeve të socialdemokracisë në programin prej 10 pikash të Ballit Kombëtar, Dekalogu; dhe *së treti*, si një prej themeluesve dhe komandantëve aktivë të çetave të Ballit në zonën e Vlorës. Përmendim se Luzaj, ndër të tjera, ishte iniciatori që në Dekalogun e Ballit Kombëtar, më saktësisht i pikës shtatë, të shkruhej: “Organizata e Ballit Kombëtar do të zbulojë vlerat e vërteta, do t’i edukojë njerëzit pa marrë parasysh besimin, krahinën ose partinë politike”.<sup>280</sup> Në njëfarë mënyre, Luzaj ishte ngjizës i idesë pankombëtare të Ballit Kombëtar (ndonëse jo i vetmi) dhe e vazhdoi këtë aktivitet bindshëm edhe në diasporë, ku zhvilloi pjesën më të madhe të aktivitetit të tij politik, si dhe krijimtarinë e tij intelektuale, ku fanar ndriçues ka qenë në mënyrë konsistente ideja e bashkimit kombëtar.

Mund të themi pa hezitim që Luzaj që një nga pionerët e “shartimit” të idesë nacionaliste të bashkimit kombëtar, me idetë socialdemokrate dhe të arritjes së barazisë klasore përmes metodave demokratike, çka e bënte njëherazi të ndryshëm me komunistët që predikonin rrugën revolucionare dhe luftën e klasave, por edhe sinkretik e origjinal në idetë e tij. Aq i spikatur që aktiviteti i Prof. Luzajt në ngjizjen e ideve socio-ekonomike dhe filozofisë politike nacionaliste të Ballit Kombëtar, sa kjo organizatë në diasporë, në vitin 1965 e thirri dhe mandej e zgjodhi kryetar në kongresin e mbajtur në Nju Jork, dy vjet pasi kishte ndërruar jetë miku i tij i kahershëm, Ali Këlcyra. Pra, në rastin e Isuf Luzajt kemi një fakt që e bën atë disi unik edhe mes bashkëveprimtarëve të tjerë, për shkakun se ka qenë në dy kohë të ndryshme, edhe themelues i Partisë Socialdemokrate, krahas Musine Kokalarit e të tjerëve, edhe themelues e më pas kryetar i Ballit Kombëtar, pra një nacionalist konsistent, me kredenciale të forta në luftën e tij të pareshtur për bashkimin kombëtar. Në tetor 1941, me ndërhyrjen e Ali Këlcyrës pranë ministrit të Arsimit të kohës, Ernest Koliqi, Isuf Luzaj lirohet nga internimi dhe kthehet në Shqipëri, e cila kishte një situatë mjaft të ndryshme nga sa e kishte lënë. Rezistenca antifashiste dhe antiitaliane kishte filluar të zgjerohej e të forcohej. Të majtët komunistë ishin organizuar në Partinë Komuniste të Shqipërisë, madje në Konferencën e Pezës kishin krijuar bazat për një front popullor antifashist të drejtuar prej tyre.

Një muaj më vonë, organizata Balli Kombëtar shpalli publikisht ekzistencën dhe krahu më revolucionar i saj filloi organizimin e çetave për rezistencën e armatosur kundër pushtuesve fashistë italianë. Në zonën e Vlorës, të majtët komunistë të grupit të Zjarrit si: Hysni Lepenica dhe socialdemokratët Isuf Luzaj dhe Skënder Muço, krijuan disa çeta të armatosura dhe ndërmorën disa aksione kundër pushtuesit italian. Ndër aksionet më të spikatura të çetës së Ballit Kombëtar të drejtuar nga Isuf Luzaj ishte ai i Selenicës, i prillit të vitit 1943. Sipas një trakti të Ballit Kombëtar, një kompani e karabinierisë italiane kishte vrarë pa asnjë arsye katër fshatarë të Lubonjës dhe kishte filluar të terrorizonte zonën përreth. “Nji prej katundarëve, – shkruhet më tej në këtë trakt, – mundi të shpëtonte dhe lajmëroi shpejt çetën

279. “Isuf Luzaj: Kosova, arsyeja e dështimit të mbledhjes së Mukjes” intervistë e Vehbi Bajramit, në: *Panorama*, 11 shtator 2013, <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-kosova-arsyeja-e-deshhtimit-te-mbledhjes-se-mukjes/>.

280. Isuf Luzaj. 2010. “Mjeku japonez që mjekonte Enver Hoxhën”, intervistuar nga Vehbi Bajrami, *Albania-* Nr. 15, 4 mars, ff. 18-19.

nacionaliste të Prof. Isuf Luzaj që rastësisht ndodhesh afër vendit të ngjarjes. Luzaj, i prekun nga një xhest i tillë provokator dhe barbar në dam të katundarëve të pafajshëm, me gjithë se ishte me një pakicë prej 36 vetash, vendosi të zinte vend me shokët e tij në katundin Armen kundra fuqisë Italiane që vinte tue mbjellë tmerrin rrugës me anë krimesh. Nga ora një e mbas ditës filloi lufta e furishme, e cila në tre orë përfundoi në shkatërrimin e armikut. Fuqija Italiane u shpartallue prej çetës së Luzajt tue lanë shumë të vrarë, të plagosur, të mbytur në lum dhe dhjetë robër, të cilët u çarmatosën dhe u lanë të lirë. Nga ana e jonë plagoset vetëm Hasan Lepenica. Fuqija italiane në ikje ra në një përpjekje të dytë me një çetë partizane që e shkatërruen krejtësisht fuqinë Italiane”.<sup>281</sup>

---

## Kontributi i Isuf Luzajt në themelimin e Partisë Socialdemokrate

---

Mbledhja e Mukjes dhe denoncimi i vendimeve të marra në të nga ana e drejtuesve të lartë të PKSH-së prishi ekuilibrat, jo vetëm ndërmjet grupeve shqiptare të rezistencës, por edhe vetë brenda Ballit Kombëtar. Isuf Luzaj ishte një nga përfaqësuesit e Ballit Kombëtar në këtë mbledhje. Ai kujton se kishte mbrojtur përfshirjen në vendimet përfundimtare të takimit për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Ajo që u ra në sy kundërshtarëve të tij politikë në këtë mbledhje ishte antikomunizmi i profesorit të filozofisë. Në një letër konfidenciale të Ymer Dishnicës drejtuar Enver Hoxhës, ku i raportonte këtij të fundit mbi mbledhjen e Mukjes, Dishnica shkruan ndër të tjera, se: “Tenorët e diskutimeve qenë Skënderi me Isufin, i pari konsiliator dhe i dyti akuzator (me helm në bark karshi nesh – gjoja antizogist e demokrat”.<sup>282</sup> Sikundër thuhet në të njëjtin dokument, çetat balliste të Vlorës ku bënte pjesë edhe Luzaj, dhe të Mallakastrës, ishin ato ku dominonin diskutimet dhe përfaqësonin kryesisht vijën e organizatës së Ballit Kombëtar përgjatë diskutimeve të Mukjes, të cilat bëheshin për të gjetur pika të përbashkëta takimi dhe unifikim të luftës kundër pushtuesit nazi-fashist, por që, siç del nga korrespondenca e Dishnicës që përfaqësonte komunistët, ata ishin të pasinqertë në përpjekjen e tyre për bashkim.

Vjeshta e vitit 1943, krahas pushtuesit të ri, solli për Shqipërinë tensionim të skajshëm të marrëdhënieve ndërmjet grupeve të rezistencës, që shpejt degradoi në luftë civile. Me sa duket, pasiviteti i Ballit Kombëtar ndaj pushtuesve të rinj nuk i pëlqeu shpirtit rebel dhe revolucionar të Isuf Luzajt. Më vonë, Prof. Luzaj do të shprehte zhgënjim sepse, sipas tij, drejtimin e Ballit Kombëtar e kishin marrë në dorë feudalët. Madje edhe për Mit’hat Frashërin, personalitetin e të cilit e vlerëson në kujtimet e tij, shprehet: “Mit’hati ishte njeri shumë i ndershëm. Atdhetar qind për qind e i sinqertë. Demokrat në teori, aristokrat në praktikë. Në teori e donte demokracinë, po në praktikë ishte me bejlerët e Toptanit, sepse i kishte farefis dhe me ata të Elbasanit, të Korçës e të Shkodrës. Ata bejlerë, siç thashë, ishin armiku i popullit, sepse ata e mbajtën në hu e litar 500 vjet popullin shqiptar nën sundimin turk. Një shqiptari që i shërbente sulltanit, i jepej titulli bej<sup>283</sup>”.

---

281. AQSH, F. 270/APL, V. 1943, D. 11, fl. 14. Trakt i Ballit Kombëtar me titull “Të burgosurit në fushën e hapët të Durrsit, lufta e Selenicës: një tjetër faqe nderi e historis kombëtare”, pa datë.

282. AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 14-16. Letër e Ymer Dishnicës për Enver Hoxhën mbi zhvillimin e mbledhjes së Mukajt, 3 gusht 1943.

283. “Isuf Luzaj: Kosova, arsyeja e dështimit të mbledhjes së Mukjes” intervistë e Vehbi Bajramit, në: *Panorama*, 11 shtator 2013, <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-kosova-arsyeja-e-deshtimit-te-mbledhjes-se-mukjes/>.

Ndoshta ishte edhe për shkak të këtyre pakënaqësive ndaj drejtuesve të Ballit Kombëtar që në tetor 1943, Isuf Luzaj, së bashku me Musine Kokalarin, Skënder Muçon dhe një grup tjetër intelektualësh shqiptarë takohen në një shtëpi në Tiranë dhe vendosin krijimin e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë. “Më 1 janar të vitit 1944, Musine Kokalari bashkë me Prof. Isuf Luzi publikojnë numrin e parë të gazetës “Zëri i Lirisë” që shërbente si gazetë zyrtare e Partisë së sapothemeluar Socialdemokrate”.<sup>284</sup> Kjo parti kishte për qëllim kryesor “të sigurojë drejtësi shoqërore dhe liri politike”,<sup>285</sup> sikundër nënvizohej në nenin e parë të programit të saj, si dhe të ishte “parti evolucioniste përsa i përket kolektivizmit shoqëror”,<sup>286</sup> pra, ndryshe nga koncepti bolshevik i revolucionit që kishin komunistët. Gjithashtu, kishte ndër pikat kryesore të programit të saj: “të luftojë kundër çdo okupatori për independencën e një Shqipërie të ujnitur brenda kufijve të saj etnikë”.<sup>287</sup> Por nga ana tjetër vinte po ashtu theksin te liritë themelore të njeriut, ku përfshihej pikësëpari “liria politike”, iniciativa private dhe vota, si dhe shprehimisht përmendte opozitën parlamentare.<sup>288</sup>

Pra kemi të bëjmë me një parti evolucioniste, duke ndjekur kësajsoj filozofinë volteriane dhe jo atë rusoiane apo marksiste, e cila shprehej hapur për lejimin e opozitës parlamentare, zgjedhjeve të lira, votës së fshehtë dhe zgjedhjeve periodike, duke qenë kësajsoj pararendëse e liberalizmit politik. Njëkohësisht duke dhënë një kontribut jo të vogël për historikun e së majtës politike dhe ideologjike në realitetin shqiptar. Shpallja e statutit të Partisë Socialdemokrate shkaktoi reagimin e drejtuesve të lartë të PKSH-së. Në një letër, Y. Dishnica i raportonte Enverit se “Partija social demokrate e qiti statutin të cilin ja u dërguam. Nuk dimë mirë a do të përmbledhi shumë elemente që tue inkludue dhe Mehdiun me gjith rrethin e tij apo do jet veç nga ajo Partija demokrate qi ka në mund të baj Mehdiu dhe atëhere do jet e vogël – Isuf Luzaj do jet edhe për këtë punë këtu.”<sup>289</sup> Pra, duket se ka shqetësim nga formimi i Partisë Socialdemokrate, por neglizhohet duke u bazuar në premisën që do ketë pak anëtarësi e për rrjedhojë, do të jetë pak aktive. Gjithsesi, nënvizohet roli i I. Luzajt dhe efektit që mund të ketë ai në ngjizjen e këtij formacioni të ri politik.

Në fushatën për defaktorizimin e kundërshtarëve politikë, drejtuesit e PKSH-së kërkuan ndërmarrjen e një sulmi fillimisht propagandistik, e më pas edhe me armë kundër tyre. Në një letër që Enver Hoxha i dërgonte Nako Spiros më 14 tetor 1943, i kërkonte që gazeta zyrtare e Partisë, “Zëri i Popullit”, të shkruante një artikull ku të denoncoheshin disa nga figurat kryesore të Ballit Kombëtar. “Të thuhet, – udhëzonte E. Hoxha, – se sigurisht shpejt do të vijë dita që Balli Kombëtar, fole e poshtërsive dhe e tradhtisë do të dezertohet prej të gjithëve dhe më parë prej atyre që bëjnë këto manovra të poshtra, pse do të shohin se ju dolli boja me këtë maskë, por emrat e atyre që bëjnë këto poshtërsira i kemi shënim, që nga Lumo Skëndua deri te Ramazan Jarani me shokë, dyke kaluar prej Skënder Muços e Isuf Luzajt”<sup>290</sup>.

Përgjatë zhvillimit të ngjarjeve gjatë viteve 1943–1944, prof. Luzaj është akuzuar disa herë publikisht nga kundërshtarët e tij politikë, si bashkëpunëtor i pushtuesve gjermanë. Po në korrespondencën e brendshme të PKSH, ka edhe një panoramë tjetër. Më 2 mars 1944, menjëherë pas operacionit ndëshkimor të Ushtrisë pushtuese Gjermane ndaj forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Enver Hoxha i shkruante

284. Shih për më tepër Musine Kokalari: Biografi. Marrë nga: <https://musinekokalari.org/sq/biografi/>

285. Novruz Xh. Shehu. 2009. *Musine Kokalari. Vepra: Vëllimi i dytë*. Tiranë: Geer. Neni VI. Programi është marrë nga gazeta Zëri i Lirisë, organ i Partisë Social-Demokrate.

286. Po aty, neni II

287. Po aty, neni VI.

288. *Po aty*, neni IV.

289. AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 4–7. Letër e Nako Spirit për Enver Hoxhën, 8 tetor 1943.

290. AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 11–12. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spiritin, 14 tetor 1943.

Nako Spiros një letër ku i kërkonte të zgjeronte me të gjitha mënyrat radhët e Frontit Nacionalçlirimtar. “Aty, – i kujton Hoxha Spiros, – sigurisht ndodhet Isuf Luzi, i cili ka një përgjegjësi dhe me rëndësi në Partinë Socialdemokrate, ka qënë dhe është me përgjegjësi nën reshtat e Ballit Kombëtar, por ka qëndruar gjithmonë larg komprometimit, nuk është goditur me ne, ka mundësi që të sjellë një ndarje në radhët e Socialdemokrates. Duhet t’i shkruhet një letër e mirë, nga ana e Sejfullahut dhe të vihet posht: antar i këshillit të përgjithshëm. T’i shkruhet se aty ku bën pjesë ay nuk është vëndi i tij, bashkëpunëtorët e tij sot janë në trathëti të hapët, se nuk mbulohet dielli me shoshë duke dashur t’i ndrojnë emrat e të vënë maska partish të ndryshme; ay i cili sot ka një përgjegjësi në Partinë Socialdemokrate do t’i vlejë shumë Atdheut në qoftë se çkëputet nga reshtat e trathëtarëve dhe hidhet në reshtat e Frontit Nacionalçlirimtar, deri sa nuk bëhet tepër vonë. Këtë e shkruani ju dhe e firmoni nga ana e Sejfullahut”<sup>291</sup>. Me kërkimet e deritanishme nuk jemi në gjendje të pohojmë nëse Sejfulla Malëshova e ka dërguar këtë letër dhe, as përgjigjen eventuale të Luzajt. Ajo që dihet me siguri është se Luzaj vijoi të ishte anëtar i Partisë Socialdemokrate, e cila gjatë Luftës vepronte si pjesë e Ballit Kombëtar. Armiqësia e drejtuesve të lartë komunistë ndaj Prof. Luzajt ndoqi një kurbë rritëse, veçanërisht në verën dhe vjeshtën e vitit 1944, kur ai mori komandën e operacioneve të Ballit Kombëtar në rajonin e Vlorës, duke pasuar Skënder Muçon, i cili ishte vrarë pak kohë më parë nga pushtuesit gjermanë. Akuzat që qarkullonin për të brenda Shqipërisë shkuan edhe në veshin e oficerëve aleatë të misioneve britanike e amerikane.<sup>292</sup>

---

## Isuf Luzaj dhe marrëdhëniet e tij me regjimin totalitar shqiptar

---

Më 28 nëntor 1944, Isuf Luzaj së bashku me shumë prej drejtuesve të Ballit Kombëtar largohet nga Shqipëria, duke lënë në Kaninë gruan me 5 fëmijë të mitur. Jeta e tij në emigracionin e gjatë nuk do të ishte e lehtë. Në Itali, e cila ishte stacioni i parë i Luzajt, u arrestua me akuzën se ishte atentatori i gjeneral Zaninit, i cili kishte vrarë Qazim Koculin, heroin e Luftës së Vlorës dhe një nga figurat më me influencë në Vlorë. Gjykata italiane e dënoi me burgim të përjetshëm, i cili u amnistua pas pak kohësh. Me rekomandim të Sandro Pertinit, punoi më tepër se 2 vjet në Bibliotekën e Vatikanit dhe më pas u vendos në Breshia, ku dha mësim latinisht në një seminar pranë qytetit. Më 1948, largohet drejt Argjentinës, ku fillon karrierën në fillim si përkthyes pranë Ministrisë së Arsimit e më pas si pedagog në Universitetin e Buenos Airesit dhe këshilltar në Ministrinë e Arsimit. Pas vdekjes së Ali Këlcyrës (1963), përfaqësues të Ballit Kombëtar në SHBA e thërrasin për të marrë drejtimin e organizatës. Në kongresin e mbajtur në Nju Jork, Prof. Luzaj zgjidhet kryetar i Ballit Kombëtar në emigracion.

---

291. AQSH, F. 14/APL, V. 1944, D. 76, fl. 12-13. Letër e Komitetit Qendror të PKSH=së për Nako Spirun, 2 mars 1944.

292. Office of Strategic Services. American Embassy London. Nov. 5, 1945. Most Secret. Declassified and released by Central Intelligence Agency Sources Methods Exemption. Nazi War Crimes Disclosure Acts. Date 2004, 2006. Në këtë pasazh gjithashtu shtohet se ai [Luzaj] raportohet se i ka mbushur xhepat me flori gjerman”. Pasazhi në anglisht: “Luzaj took over the military command of BK in the Valona area, succeeding Skënder Muço. He is described as having his pockets filled with German gold.” Një tjetër dokument i CIAs shkon edhe më tej ku e klasifikon Luzajn një agjent gjerman përgjatë luftës. Më saktësisht “Isuf Luzi, 38, professor, German agent occupation; head of civilian unit helping German operations. Accused by Albanians of massacre of 300 men of Valona. Dishonest; opportunist. Does not belong to any party in Italy; now in Rome.” FIELD HQ. FILE NO JRX-3897, 26 Korrik 1946. Por edhe Ernest Koliqi i Bllokut Independent raportohet në një dokument ta ketë klasifikuar Luzaj si “anti-komunist dhe të dënuar me vdekje nga komunistët”. Por gjithashtu shtonte se “Luzaj bashkëpunoi me gjermanët kundër komunistëve”. 3 dhjetor 1958. Kjo e dhënë gjendet edhe më dokumentin sekret ku zëvendës drejtori për planifikimin në Departamentin e Shtetit i dërgon eprorit të tij që është Zëvendës-Asistent Sekretari për Sigurinë në Departamentin e Shtetit ku raporton ndër të tjera se “subjekti bashkëpunoi me gjermanët kundër komunistëve”. 25 Maj 1965. Declassified and released by Central Intelligence Agency Sources Methods Exemption. Nazi War Crimes Disclosure Acts. Date 2004, 2006.

“Komunizmi,  
leninizmi janë  
si një utopi në  
heronjtë e m  
shekujve XIX



marksizmi,  
e të dënuar  
ga të gjithë  
endimmit të  
K dhe XX”

Isuf Luzaj

Karriera e tij akademike në SHBA shënoi vetëm rritje, por ajo nuk e pengoi armiqtë e regjimit totalitar, të vendosur në Shqipëri, ndaj tij dhe familjes. Qysh në fillimet e tij, regjimi i ri i diktaturës së proletarietit, i instaluar fill pas çlirimit të vendit nga forcat naziste, ka qenë armiqtë me ata që i quante kundërshtarë të vijës së parë dhe një nga këta, për shkak të veprimtarisë politike-ideologjike, ishte edhe intelektual i majtë Isuf Luzaj. Për shembull, Komisioni për Krimet dhe Kriminelët e Luftës i mbledhur në 1945 e quan “tradhëtar me damkë dhe kriminel të mirënjohur” Isuf Luzajn.<sup>293</sup> Familja e Prof. Luzajt, e mbetur në Shqipëri, u persekutua ashpër nga regjimi. Të gjithë u internuan, madje vajza e vogël 1-vjeçare vdiq në kampin e përqendrimit në Fushë-Krujë, për mungesë të ilaçeve kundër tuberkulozit. Po ashtu, është interesante një e dhënë e hershme mbi veprimtarinë e Isuf Luzajt që mban datën e 30 tetor të vitit 1957, ku punëtori operativ A. L. i Drejtorisë së Zbulimit Politik raporton për Luzajn, se “në fillim ka simpatizuar Lëvizjen N.Ç. Me daljen në skenë të Ballit Kombëtar, ay lidhet ngushtë me Mitat Frashërin dhe bëhet ndër kryesorët në këtë organizatë. Në vitin 1943, Isufi është shkruar komandant i forcave balliste të Vlorës. Pak para çlirimit është arratisur së bashku me kriminelë të tjerë luftime”.<sup>294</sup> Nga këqyrja e dosjeve të Sigurimit ka shumë pak informacion për veprimtarinë e Luzajt në emigracion. Një e dhënë që vlen të përmendet është në një raportim biografik për Luzajn, ku citohet (sipas operativit, pas bisedave të bëra me Hetem Cakon) se: “Isufi, si njeri intelektual që dinte shumë gjuhë të ndryshme, futej në çdo sferë të emigracionit politik që ndodhej në Itali, si me Polak, Rumun, Çek, Hungarez, Jugosllav dhe si personalitet njëjef direkt me Ministrin e Brendshëm Italjan Shelbe, paguhej mirë, nuk qëndronte fare në kamp, por bridhte gjithë Italin. Isufi kishte miqësi me gjithë komandantët e kampeve Rexhio Emilie..., gjithashtu, edhe vëllai i tij, Ifrahim Luzi, bënjte një jetë lluksoze në atë kohë.”<sup>295</sup> Pra shihet që qysh herët Isuf Luzaj ka qenë më tepër se thjesht element i padëshiruar për regjimin e ri monokratik dhe ishte shpallur hapur armik i klasës e paradoksalisht, edhe bashkëpunor i nazi-fashizmit, pa asnjë provë apo indicie, ndërkohë që vetë Luzaj ka qenë i burgosur politik nga fashistët italianë në ishullin Ventotene, së bashku me Safet Butkën, Zai Fundon, Stavro Skëndin, etj.

---

## Mendimi politik i Isuf Luzajt

---

Jo më pak i rëndësishëm ka qenë mendimi i tij intelektual për të majtën ku si filozof, Prof. Luzaj shkruan në mënyrë kritike për komunizmin: “Komunizmi është një filozofi jete antinatyrale, kundër ligjeve të natyrës, e dënuar të falimentojë, sepse është false me premisat logjike, e gabuar dhe pa themel në arkitekturën e ideve dhe fision imagjinatë të sëmurë”.<sup>296</sup> Ai gjithashtu shkruan se “komunizmi, marksizmi, leninizmi janë të dënuar si një utopi nga të gjithë heronjtë e mendimit të shekujve XIX dhe XX”,<sup>297</sup> siç thekson në librin e tij “Rindërtimi i Fuqive Shpirtërore”, ndërkohë që mbron dhe avokon social-demokracinë si formën më adekuate të evoluimit të së majtës natyrore që garanton shtetin social dhe rishpërndarjen ekonomike.

---

293. Raport i Komisionit për Krimet dhe Kriminelët e Luftës. Vlorë. 5.2.1945. Cituar nga fashikulli i dosjes për Isuf Luzaj, marrë nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit miratuar me vendim Nr. 810, dt. 19.12.2019.

294. Vendim i Drejtorisë së Zbulimit Politik. Tepër Sekret. Përpiluar nga Kapiteni i Gradës së Parë, Angji Lubonja. Raportuar 30 Tetor 1957. Miratuar 31 dhjetor 1957. Cituar nga fashikulli i dosjes për Isuf Luzaj, marrë nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, miratuar me vendim Nr. 810, dt. 19.12.2019.

295. Isuf Luzaj. Biografi. Kartoteke 503 A. f. 28

296. Isuf Luzaj. 2005. *Rindërtimi Fuqive Shpirtërore*: Refleksione Filozofike. OMBRA GVG.

297. Ibid

Gjithashtu, në librin me dy vëllime “Kujdeset e Bletës”, ndonëse në pjesën më të madhe të tij kemi përsiatje të natyrës metafizike apo që kanë të bëjnë me filozofinë morale, te fillimi i volumit të dytë, gjejmë ndër të tjera dhe arsytetime të filozofisë politike. Për shembull kur Luzaj shkruan ndër të tjera: “Vetëm në Rusi e cila qëndroi Mesjetare deri në Revolucion, pati mbijetuar ndonjë ndërlidhje e Filozofisë me Politikën Bolshevike janë materialistë, kurse TË BARDHËT janë idealistë”.<sup>298</sup> Pra, thekson pikëpamjet e dialektikës hegeliane dhe materializmit dialektik të Marksit, si formësues të ideve komuniste dhe nxitës të Revolucionit Bolshevik, ndërsa “të bardhët” i referohej ushtrisë së bardhë që iu kundërvu Ushtrisë së Kuqe të Trockit dhe që u mundën në fund, duke humbur çdo lloj shprese për rifitim të pushtetit politik.

Isuf Luzaj mund të konsiderohet pa frikë si një nga eksponentët më të shquar të demokracisë sociale apo socialdemokracisë shqiptare. Kjo për disa arsye. *Së pari*, vetë Balli si formacion politik bashkonte nacionalizmin me një agjendë sociale të mirëfilltë, sikundër pasqyrohet fare qartë te Dekalogu i Ballit Kombëtar, që parashikonte krijimin e një shteti social, garantimin e mirëqenies bazë për shtetasit shqiptarë dhe elementë të tjerë të rishpërndarjes, që janë pranë filozofisë së një të majte politike, pavarësisht pozicionimit antagonist me Partinë Komuniste përgjatë luftës dhe pas saj. *Së dyti*, vetë Isuf Luzaj, jeta, edukimi dhe sidomos vepra e tij, flasin qartë për një qëndrim ideologjik qartësisht të majtë, për drejtësi shoqërore dhe barazi sociale. Duke vijuar kësaj në një traditë të së majtës shqiptare që ka lindur qysh me Sami Frashërin, i cili, në ditët e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në 1878, gjeti kohë të botonte një nga artikujt pionerë të së majtës historike shqiptare, të titulluar: “Socializmi dhe prona e përbashkët” ku, siç shprehet historiani K. Frashëri, shprehte ndër të tjera “një konsideratë të madhe për idetë socialiste, veçse jo për socializmin marksist, por për socializmin demokrat, ose siç quhet sot, për socialdemokracinë”.<sup>299</sup> Në vitet e mbrame të jetës, Isuf Luzaj iu përkushtua specifikisht profesionit të profesorit dhe udhëheqësit të katedrave universitare. Në vitin 1979 ishte emëruar titullar katedre i 87 profesorëve në Universitetin e Illinoisit.<sup>300</sup> Kjo karrierë u kurorëzua me marrjen e titullit “Profesor Emeritus” si dhe dekoratës së lartë “Profesor i Amerikës”. Kjo e fundit iu dorëzua nga Presidenti amerikan Ronald Regan, për hir të karrierës së gjatë dhe të spikatur në universitetet më prestigjioze të SHBA-së, në Harvard, Columbia, Indiana, Illinois, etj.<sup>301</sup>

Botimet letrare të Isuf Luzajt nisën qysh herët, ku vlen të përmendet botimi i parë “Rrëfimet”, publikuar në Korçë më 1937. Vite më pas, përgjatë emigracionit në Argjentinë, botoi në Buenos Aires romanin “Los rios bajan rojos”, 1954 (“Lumenjtë rrjedhin të kuq”), me temë nga lufta antifashiste në Shqipëri. Nga viti 1995 filluan të botohen në Tiranë një numër veprash të tij: poetike, si “Gloria e çmendur” (1995), “Lamtumira e yjeve” (1995), “Topografi labçe” (2001), etj. Në fakt, duhet theksuar që kontributi letrar i Luzajt është nënvlerësuar dhe përmendur fare pak. Një përjashtim është Robet Elsie, i cili përmend shkarazi te “Historia e Letërsisë Shqiptare” në nënkapitullin “Poetë të tjerë të kohës para marrjes së pushtetit nga komunistët”, kontributin e Luzajt ku shkruan *inter alia* “... Jusuf Luzaj (l.1913), autor i përmbledhjes sentimentale me 293 faqe “Rrëfimet”, Korçë, 1937”.<sup>302</sup> Ndërkohë, Luzaj ka botuar libra me kontribut të spikatur në antologjinë e filozofisë shqiptare, duke qenë kështu një nga pionerët në këtë lëmë. Veçojmë këtu “Ekzistenca dhe boshësia” (1996), “Sëmundjet e shekullit tonë” (ese filozofike, 1999), “Përtej së mirës dhe së ligës” (2003), “Rindërtimi i fuqive shpirtërore” (2005), “Filozofia e

298. Isuf Luzaj. 2017. *Kujdeset e Bletës: Essais ekzistencialistë*. Vëllimi II. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pashajave të Komunistit.

299. Kristo Frashëri. 2006. *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së (1878-1941)*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, f. 11.

300. Isuf Luzaj për Enver Hoxhën: E vërteta e diplomimit në Francë. Shkarkuar nga: <http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-per-enver-hoxhen-e-verteta-e-diplomimit-ne-france/>

301. Isuf Luzaj- Biografia. Marrë nga: <https://www.luzaylibrary.com/biografia/>

302. Robert Elsie. 1997. *Histori e Letërsisë Shqiptare*. f.327. Shih gjithashtu: Robert Elsie. 2006. *Albanian Literature: a Short History*. I.B.Tauris.

bukurisë” (2009). Ka lënë në dorëshkrim edhe një varg veprash të tjera. Isuf Luzaj pati letërkëmbim me personalitet të shquara letrare, si Pablo Neruda, Jorge Luis Borges, Fan Noli, dhe politikë, si Sharl dë Gol, Alçide de Gasperi, Palmiro Toliati, Sandro Pertini, etj.<sup>303</sup>.

Së fundmi, figura e Isuf Luzajt po merr vëmendjen e munguar dhe mëse të merituar. Veçojmë këtu librarinë e tij online krijuar nga Redon Veliu<sup>304</sup> apo botimin e veprës së tij filozofike nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pashajve të Komunistit (ISKK) që lajmëron botimin për së afërmi të 6 librave filozofikë të Luzajt, brenda 2 vëllimeve me mbi 400 faqe secili, nën titullin “Kujdesjet e Bletës”.<sup>305</sup> Siç ka theksuar Agron Tufa në cilësinë e (ish)-Drejtorit të ISKK-së, “i anatemuar gjatë diktaturës dhe i mërguar, Luzaj qëndroi dhe shkroi veprën e vet kryesisht në Argjentinë. Hartues i Dekalogut të Ballit Kombëtar, Isuf Luzaj ishte ndër intelektualët e majtë antikomunistë, që dëshironte të realizonte idealin kombëtar të rilindësve për një Shqipëri të bashkuar e demokratike”.<sup>306</sup>

---

## Konkluzione

---

Profesor Isuf Luzaj ka qenë veprimtar i spikatur i së majtës shqiptare. Ai është figurë poliedrike me kontribute mjaft të vlefshme, si në Shqipëri, ashtu dhe në diasporë, sikurse mund të kategorizohet edhe si intelektual, edhe politikan, por edhe ideolog. Dualizmi vihet re edhe te tipologjitë e së majtës, të renditura në krye të kësaj përmbledhjeje, ku Isuf Luzaj mund të kategorizohet lehtësisht tek e majta socialdemokrate, përkrah Musine Kokalarit e të tjerëve, por edhe tek e majta nacionaliste, përkrah Tajar Zavalanit, Kostë Çekrezit e të tjerëve, me kontribut sa brenda, aq edhe jashtë vendit, për të majtën, por edhe për bashkimin e kombit, çka nuk ka qenë tërësisht ekskluzivitet i së djathtës konservatore shqiptare. Gjithashtu, nuk mund as të nënvlefësohet e as të relativizohet fakti që ka qenë një nga themeluesit e Ballit Kombëtar, kontribues i spikatur i këtij formacioni politik përgjatë luftës, duke arritur madje ta drejtonte pas luftës, në emigracion.

Edhe vetë formacioni politik i Ballit Kombëtar, ndryshe nga Legaliteti i Abaz Kupit që përfaqësonte qartësisht të djathtën konservatore, apo Partinë Komuniste, që përfaqësonte linjën bolshevike apo grupet e tjera komuniste dhe socialiste, që përfaqësonin rryma të tjera të së majtës, kishte brenda gjirit të vet edhe ata me mendime qartësisht të majta, si ideologji politike, të tillë si Isuf Luzaj, Skënder Muço, Hysni Lepenica apo Ali Këlcyra, ashtu sikundër edhe ata me mendime të qarta konservatore, si Mit’hat Frashëri, Hasan Dosti, Abaz Ermenji e ndonjë tjetër. Parë në këtë prizëm, duke gërshetuar figurën poliedrike të Isuf Luzajt dhe veprimtarinë e tij të spikatur politike e ideologjike, arrijmë të kuptojmë më mirë, si kontributin e tij personal, ashtu dhe linjat kryesore të programit të Ballit, i cili kishte një platformë sociale dhe ekonomike të majtë, por qëndronte në të djathtë të spektrit politik, kur vinte puna tek aksi nacionalist. Gjithashtu, në të njëjtën linjë ne shohim një konsistencë në mendimin e tij filozofiko-politik, ku gërshetohet antikomunizmi sistemik me një qasje barazie sociale, nëpërmjet një shteti ndërhyrës, por pa hequr dorë nga prona private. Ndërkohë që qëndronte i palëkundur, si një patriot që yllin polar të aktivitetit të tij politik shihte bashkimin e Shqipërisë me Kosovën dhe viset e tjera amtare.

---

303. Shih *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (FESH), Vëll. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, f. 3037

304. <https://www.luzajlibrary.com/biografia/>

305. Fatmira Nikolli. “Isuf Luzaj, filozofi shqiptar, miqësia e korrespondenca me Sartrin. Gazeta Shqiptare.” 19.01.2018 Shih: <http://www.gsh.al/2018/01/19/isuf-luzaj-filozofi-shqiptar-miqesia-e-korrespondenca-sartrin/>

306. Ibid

## Referencat

AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 14-16. Letër e Ymer Dishnicës për Enver Hoxhën mbi zhvillimin e mbledhjes së Mukajt, 3 gusht 1943.

Elsie, Robert. 1997. *Histori e Letërsisë Shqiptare*.

Elsie, Robert. 2006. *Albanian Literature: a Short History*. I.B.Tauris.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar (FESH), Vëll. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009.

Frashëri, Kristo. 2006. *Historia e Lëvizjes së Majtë në Shqipëri dhe e Themelimit të PKSH-së (1878-1941)*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, 14 tetor 43. AQSH, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 11-12.

Luzaj, Isuf - *Biografia*. Marrë nga: <https://www.luzajlibrary.com/biografia/>

Luzaj, Isuf. 2017. *Kujdeset e Bletës: Essais ekzistencialistë*. Vëllimi II. Tiranë : Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunitetit.

Luzaj, Isuf. 2005. *Rindërtimi Fuqive Shpirtërore: Refleksione Filozofike*. OMBRA GVG.

Luzaj, Isuf për Enver Hoxhën: E vërteta e diplomimit në Francë. Shkarkuar nga:

<http://www.panorama.com.al/isuf-luzaj-per-enver-hoxhen-e-verteta-e-diplomimit-ne-france/>

Luzaj, Isuf. 2010. "Mjeku japonez që mjekonte Enver Hoxhën", intervistuar nga Vehbi Bajrami, *Albania*- Nr. 15, 4 mars, ff. 18-19.

Luzaj, Isuf. Biografi. Kartoteke 503 A. f. 28

Nikolli, Fatmira. 2018. "Isuf Luzaj, filozofi shqiptar, miqësia e korrespondenca me Sartrin." *Gazeta Shqiptare*. 19 Janar. Shih: <http://www.gsh.al/2018/01/19/isuf-luzaj-filozofi-shqiptar-miqesia-e-korrespondenca-sartrin/>

Office of Strategic Services. American Embassy London. Nov. 5, 1945. Most Secret. Declassified and released by Central Intelligence Agency Sources Methods Exemption. Nazi War Crimes Disclosure Acts. Date 2004, 2006.

Raport i Komisionit për Krimet dhe Kriminelët e Luftës. Vlorë. 5.2.1945. Cituar nga fashikulli i dosjes për Isuf Luzaj, marrë nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit miratuar me vendim Nr. 810, dt. 19.12.2019.

Shehu, Novruz Xh.. 2009. *Musine Kokalari. Vëpra: Vëllimi i dytë*. Tiranë: Geer. Programi është marrë nga gazeta Zëri i Lirisë, organ i Partisë Social-Demokrate.

Vendim i Drejtorisë së Zbulimit Politik. Tepër Sekret. Përpiluar nga Kapiteni i Gradës së Parë, Angji Lubonja. Raportuar 30 Tetor 1957. Miratuar 31 dhjetor 1957. Cituar nga fashikulli i dosjes për Isuf Luzaj, marrë nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit miratuar me vendim Nr. 810, dt. 19.12.2019.

Skënder  
Luarasi



# Patrioti, demokrati dhe opozitari i përherëshëm

Skënder Luarasi është një personazh poliedrik me kontribut të spikatur në letrat dhe historinë e Shqipërisë. Në kapërcyell të viteve '20-'30, Skënder Luarasi njihej nga brezi përparimtar si arsimtari, publicisti, gazetari, përkthyesi, dramaturgu dhe si drejtuesi e bashkëpunëtori i disa organeve të shtypit përparimtar të kohës.

**NGA SONILA BOÇI**

*“Duke qenë pra ai që jam, them se i kam bërë për dy arsye: Së pari, e kam ndjerë veten të lidhur me atdhenë gjatë gjithë jetës time. E them kështu që të mos përdor fjalën patriotizëm, me të cilën janë bërë aq shumë spekulime. Së dyti, kam dashur që në këtë atdhe populli të bënte një jetë të njerëzishme, me drejtësi dhe me barazi shoqërore, që secili të gëzonte frytet e punës së vet, të nderohej si qytetar i plotë, e të mos rronte njëri në kurriç të tjetrit. E them kështu për të mos përdorur fjalën socializëm, për të cilën nuk janë bërë më pak spekulime”<sup>307</sup>.*

Skënder Luarasi është një personazh poliedrik me kontribut të spikatur në letrat dhe historinë e Shqipërisë. Në kapërcyell të viteve '20-'30, Skënder Luarasi njihej nga brezi përparimtar si arsimtari, publicisti, gazetari, përkthyesi, dramaturgu dhe si drejtuesi e bashkëpunëtori i disa organeve të shtypit përparimtar të kohës. Nga regjimi autoritar i mbretit Zog ishte konsideruar si antizogist dhe “bolshevik”, arsye për të cilat u arrestua tre herë gjatë viteve 1920-1930. Regjimi totalitar i Enver Hoxhës në heshtje e përdoqi dhe eurvejoi, madje edhe e goditi herë pas here në mënyra të ndryshme, pasi në sytë e kreut të “diktaturës së proletariatit”, ai ishte intelektual i sëmure nga ideologjia borgjeze, madje dhe agjent i mundshëm i agjencive të huaja inteligjente.

307. Skënder Luarasi, *Në brigadat internacionale në Spanjë*, Tiranë: Toena, 1996, f. 9.

Është folur dhe shkruar shumë për patriotin, njeriun e letrave, përkthyesin, publicistin dhe pedagogun Skënder Petro Luarasi. Shpesh ai përmendet si një prej vullnetarëve të parë shqiptarë në Luftën Civile të Spanjës, por pak apo aspak është folur për kontributin që dha në formësimin e mendimit politik të së majtës shqiptare, duke propaganduar në disa breza studentësh parimet e së majtës për drejtësi dhe barazi shoqërore. Në këtë punim, Skënder Luarasi do të analizohet në lidhje me qëndrimet e tij politike dhe afinitetin që pati me mendimin politik të së majtës. Në diskursin publik e politik shqiptar, e majta lidhet, jo pa të drejtë, me internacionalizmin, dhe idhtarët e mendimit politik majtist shpesh, edhe për shkak të lidhjeve të hershme të PKSH/PPSH-së me komunistët jugosllavë, kanë marrë vulën e internacionalistëve, të cilët nuk kanë pasur në zemër çështjen kombëtare. Përgjithësime të tilla simpliste, nuk iu përgjigjen fakteve dhe dokumenteve historike, pasi një numër i madh aktivistësh të nacionalizmit të hershëm shqiptar përqafuan mendimin politik të së majtës. Skënder Luarasi është pikërisht rasti i intelektualit tek i cili pati një simbiozë interesante të patriotit të interesuar për çështjen kombëtare me parimet e së majtës për barazi, zhvillim, përparim dhe solidaritet. Ai ishte individi intelektual i cili angazhimin politik e quante detyrë. Ai ishte patrioti dhe idhtari i ideve marksiste, që iu imponua shoqërisë me shembullin e tij duke frymëzuar kështu breza të tërë studentësh të përqafonin kulturën, si mjetin që do të krijonte një shoqëri të përparuar, të drejtë dhe të barabartë.

---

## Formësimi i hershëm politik i Skënder Luarasit

---

Dy faktorë kanë ndikuar më së shumti këtë identitet politik të Skënder Luarasit: trashëgimia familjare dhe shkollimi i tij në Turqi, SHBA dhe Austri. Ai u lind në Kolonjë, më 19 janar 1900 në një ambient i cili lëvrinte nga idetë patriotike të Rilindjes Kombëtare. I ati, Petro Nini Luarasi, një nga veprimtarët më të njohur të nacionalizmit shqiptar, i cili që më 1882 luftoi “si kundër tiranisë turke dhe feudalëve të vendit, ashtu edhe kundër obskurantizmit dhe Fanarit dhe klerit ortodoks ignorant e fanatik të atëhershëm”<sup>308</sup>. E ëma, Lina rridhte nga familja e njohur Sevo, anëtarë të së cilës ishin prej themeluesve të organizatës “Vatra” në SHBA. Edukimi i tij i hershëm me idealet e nacionalizmit shqiptar dhe vrasja e pabesë e të atit nga shovinistët grekë do të kishin ndikim në mburrjen e djaloshit Luarasi me ndjenjën e detyrës dhe sakrificës sublime për atdheun. Ai tregon në kujtimet e veta se e kishte bërë të vetën moton e gjithëherëshme të të atit, sipas së cilës nëse atdheu ka nevojë, detyra e një patrioti është t’i përgjigjet thirrjes deri në sakrificat më sublime.

Identiteti politik i Skënder Luarasit u formësua në një masë të madhe nga ambienti që frekuentoi gjatë viteve të shkollimit. Pas vdekjes së të atit, në moshën 11 vjeçare nisët me ndihmën e një filantropi amerikan për të studiuar në Stamboll në shkollën amerikane Robert College. Një vit më vonë, udhëton drejt SHBA për të vijuar studimet fillimisht në Easton Academy (Easton Penna, më 1916) dhe, më pas, në American Internation College (Springfield Mass., më 1918). Në vitin 1920, kthehet për pak kohë në Shqipëri dhe shërben pranë Kryqit të Kuq në zonën e Elbasanit. Studimet e mesme dhe të larta i vijon me ndërprerje në Vjenë, përkatësisht në Gjymnazin Klasik, Fraishtadt (1922–1926) dhe Fakultetin e Filologjisë, të cilin e përfundoi më 1930.

Të dy shtetet ku studioi dhe jetoi për disa vjet, ndikuan në identitetin e tij politik. Modeli i demokracisë amerikane, me parimin “nga populli, për popullin, me popullin” e formuan Skënderin si qytetarin e

---

308. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 1. Kërkesa e Skënder Luarasit për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.



përfshirë dhe reagues. Më vonë, gjatë viteve '30 nxënësve të tij do t'u mësonte se “skllavi më i keq është ai që dëshiron të jetë skllav” dhe se “një njeri është i lirë kur ai formon dhe shpreh lirshëm opinionet e veta”<sup>309</sup> dhe në të vërtetë, gjatë gjithë jetës së tij, ai nuk hezitoi të shprehte hapur mendimet e veta. Që në moshë shumë të re, djaloshi Luarasi i mbryjtur me ndjenjat kombëtare nuk mund të rrinte indiferent kur fatet e Shqipërisë ishin ende të paqarta. Ai kujton se “Gjatë qëndrimit tim katër vjetësh në SHBA si student kam marrë pjesë aktive në lëvizjen kombëtare, dhe me konferenca dhe me artikuj të botuar në shtypin e vendit kam mbrojtur tezën e Shqipërisë së jugut kundër agjentëve të imperializmit grek. Me qëllim që të bashkoheshin studentët shqiptarë që të ndihmonin për të fituar përsëri independencën pas Luftës së Madhe u përpoqa të themelohej Lidhja e Studentëve Shqiptarë, ku u zgjodha sekretar i parë dhe më 1920 editor i organit të Lidhjes “Studenti”<sup>310</sup>. Vlen të veçohet nga këto shkrime një letër të 21 marsit 1919, botuar nga “The Adriatic Review”, në të cilën djaloshi Luarasi i përgjigjej një shkrimi në po këtë gazetë të avokatit grek, Janitis, i cili “i mohon Epirit racën, gjuhën, zakonet dhe ndjenjat shqiptare”, madje shprehet me fjalë fyese për shqiptarët duke i quajtur “hajdutë, laspangerë dhe katilë”<sup>311</sup>.

Luarasi shprehet natyrshëm i indinjuar ndaj këtyre akuzave dhe gjuhës së përdorur nga artikullshkruesi. Ai flet “si shqiptar dhe banor i Epirit” dhe i kujton avokatit grek, të gjitha shkrimet e të huajve nga Lord Bajroni tek Edith Durham, të cilët kanë nxjerrë në pah vlerat dhe cilësitë e jashtëzakonshme të shqiptarëve, duke iu kundërvënë atyre politikën e qeverisë dhe kishës greke për të helenizuar ortodoksët shqiptarë dhe goditur të gjithë patriotët të cilët punonin për të promovuar e zhvilluar kulturën dhe shkrimin e gjuhës shqipe<sup>312</sup>. Ndjenjat patriotike të Luarasis shprehen qartazi edhe në shkrimet e mëvonshme, në të cilat ai flet për ngjarje dhe figura të rëndësishme të kombit shqiptar dhe sakrificat e patriotëve shqiptarë për pavarësinë e vendit, duke veçuar rolin e gruas shqiptare në mbryjtjen e këtyre ndjenjave.

Në fundvitet '20, krahas shkrimeve me karakter kombëtar, Luarasi fillon të shpallë gjithmonë e më qartë edhe mendimin, edhe qëndrimet e tij politike. Shqipëria e pavarur është larg aspiratave të idealistit Luarasi, i cili ëndërronte për një shtet modern dhe të përparuar në frymën “okcidentale”. Në shkrimet e tij fillojnë të kristalizohen disa qëndrime politike që qartazi anojnë nga idealet e së majtës për barazi shoqërore, për një shoqëri ku të mbizotërojë drejtësia dhe aristokratët apo “feudalët”, siç i quan ai, të mos mbajnë peng të ardhmen e vendit. Vetë Luarasi, atëherë por edhe më vonë, e konsideronte veten revolucionar<sup>313</sup>, pa vendosur etiketa se në cilin krah të spektrit të së majtës e vendoste veten, ndërsa shumë prej ish-studentëve të tij e quanin marksist.

Idetë politike të Luarasis pasqyrojnë atmosferën e zhvillimit të mendimit politik në Shqipërinë e atyre viteve, kur ideologjitë e mëdha botërore, përktheheshin dhe merrnin formë në arealin e varfër shqiptar, ku lëvrinte një elitë intelektuale në formim e sipër. Komunizmi marksist kishte bërë për vete si “çlirimtaristët”, djemtë e “Bashkimit” dhe komunistët, ndërsa shembulli i Qemal Atatürkut do të frymëzonte idhtarët e “diktaturës së ndritur”. Luarasi vetë na e shpjegon mjaft mirë pse përqafoi marksizmin. Sipas një shkrimi të tij të botuar në revistën “Nëntori” në prill të vitit 1960, ai kujton se gjatë qëndrimit të tij në SHBA,

309. Myslim Islami, “Prof. Skënder Petro Luarasi, personifikim i problemit shqiptar”, në: *Histori e tjetërsuar*, Tiranë: Progresi, 2005, f. 105.

310. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 1. Kërkesa e Skënder Luarasis për t'u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

311. Skënder Luarasi “Kundër shpifjeje greke”, në: Skënder Luarasi, *Fjala Shqipe*, Tiranë: Naim Frashëri, 1961, f. 24.

312. Skënder Luarasi boton të plotë letrën e mitropolitit të Kosturit, i cili vendos shkishërimin e Petro Nini Luarasis dhe të gjithë ata që e ndihmojnë atë pasi, sipas kësaj letrë, “i mallkuari dhe i zvetnuari [Petro] Luarasi, duke u marrë vesh me propagandën protestane dhe masone, erdhi rrethepërçark në katundet e ndryshme të ngastrës së Kolonjës, duke u zotuar të emërojë mësonjë shqiptarë gjoja për të mësuar gjuhën shqipe, e cila nuk ekziston, por që me të vërtetë ai erdhi që të përdredhë ndërgjegjen e orthodhoksëve dhe të bënjë prosselitë në masoni dhe në protestantizëm”.

313. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 1. Kërkesa e Skënder Luarasis për t'u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

“

Më 12 janar, më  
burgosën për tre  
muaj në lidhje me  
letrat anonime  
në Tiranë dhe me  
ngritjen e afishave në  
Korçë. Ditën e 1 majit  
e festova tok me  
klasat e mija, duke  
dalë jashtë me këngë  
përmes qytetit.

Skënder Luarasi

”

anëtari i “Vatrës” dhe i afërmi i tij nga ana e nënës, Jorgji Sevo, i kishte rrëfyer se Lenini duke denoncuar Traktatin e Fshehtë të Londrës (prill 1915)<sup>314</sup>, “na ndihmoi ne shqiptarëve të kuptojmë ç’rrezik u ndodhëm. Lenini na bashkoi që të shpëtojmë Shqipërinë nga fqinjët lakmonjës”<sup>315</sup>. Ky akt duhet të ketë nxitur interesin e Luarasit për revolucionin bolshevik të tetorit 1917 dhe shtetin e madh sovjetik të krijuar si rezultat i tij. Në atë periudhë, shumë patriotë të tjerë shqiptarë, duke përfshirë Kristo Kirkën, Mihal Gramenon e shumë të tjerë filluan t’i vendosin vetes epitete, si “socialistë” apo “bolshevikë”, por siç pohon me të drejtë prof. Frashëri, të gjithë ata i përkisnin rrymës së majtë jomarksiste<sup>316</sup>. Mendoj se ky pohim vlen edhe për Skënder Luarasin. Ideali i Skënder Luarasit ishte modernizimi dhe përparimi i Shqipërisë me anë të dijes, arsimit dhe ndryshimeve të thella politike, ekonomike dhe sociale. Ai vetë do të shkruajë në kujtimet e tij se “edhe unë, si amerikanët kërkoja reforma. Këtë dëshirën time për reforma e liri ma kanë quajtur ‘të keqe’, ‘herezi’, ‘anarkizëm’ e deri ‘komunizëm’”<sup>317</sup>.

Gjatë viteve '20, si aktiviteti i tij, ashtu dhe shkrimet e tij flasin qartë për idetë e majta të Luarasit. Si student në Vjenë me bursë të Ministrisë së Arsimit, ai, sipas thëniesve të tij “veprimin tim përparimtar e vazhdova me fjalë e me shkrime ... si kryetar i shoqëris “Albania” dhe si editor i revistës së saj “Djalëria”<sup>318</sup>. Gjatë vitit 1924, mbështeti Lëvizjen e Qershorit dhe qeverinë e drejtuar nga Fan S. Noli, të cilin e konsideronte si patriotin dhe intelektualin më të madh të kombit shqiptar<sup>319</sup>. Në dhjetor 1924 “kur Ahmet Zogolli përgatiste goditjen tradhëtare dhe Fan Noli thirri popullin në ndihmë, lashë mësimet dhe u bashkova me togun e tim vëllai Dhimitri dhe me forcat e tjera vullnetare të Kolonjës që do të niseshim kundër Zogollit”<sup>320</sup>. Mbështetja ndaj Nolit dhe idetë e tij përparimtare të shprehura në gazetën “Djalëria” do t’i kushtonin studentit Luarasi bursën, por jo vetëm kaq. Ai shkruan në biografinë e tij se kur ishte kthyer në Shqipëri “në janar 1928 (në dasmën e sime motre) më burgosën. Pas tre muajve më lanë të kthehem në Austri. Atje me gjithë intrigat e konsulatës të policia e vendit, e cila disa herë më lajmëroi të linja Vjenën, munda të vazhdoj mësimet me përkrahjen e vëllait tim, Dhimitri”<sup>321</sup>.

Për shkak të karakterit të tij të fortë, inteligjencës, moshezitimit për të shprehur gjithmonë mendimin e tij, Skënder Luarasi kishte fituar simpatinë e bashkëstudentëve në Vjenë, madje edhe kishte ndikuar në formësimin e mendimit politik të disa prej tyre. Prof. Aleks Buda, si një nga bashkëstudentët e Luarasit në Vjenë, kujton se konsulli shqiptar që merrte informacione mbi shqiptarët e atjeshëm, i konsideronte atë dhe vëllanë e tij, Mihalin si të dyshimtë, pikërisht sepse shoqëroheshin me Skënder Luarasin<sup>322</sup>.

314. Në dekadat e para të shek. XX, në disa raste e majta komuniste ose socialiste u shpreh në mbështetje të çështjes kombëtare shqiptare. Më 1918, rreth një vit pas fitores së Revolucionit të Tetorit, V. I. Lenini jo vetëm e bëri publik Traktatin e Fshehtë të nënshkruar në Londër më 26 prill 1915 nga katër shtetet e Antantës, por gjithashtu deklaroi se Rusia bolshevike do të ndiqte një politike në favor të kombësive të vogla. Një vit më vonë, socialistët italianë do të protestonin në mënyrë energjike kundër këmbëgjuljes së qeverisë së tyre për të mbajtur të pushtuar Vlorën, duke cenuar kështu sovranitetin dhe tërësinë territoriale të shtetit të pavarur shqiptar. Gjatë viteve '20 të shek. XX, Internacionala III Komuniste njohu krijimin e një Komiteti për Çlirimin e Kosovës, i cili ishte i shkëputur nga Partia Komuniste Jugosllave. Të gjitha këto qëndrime dhe deklarata të grupeve të ndryshme të së majtës ndërkombëtare pro çështjes kombëtare shqiptare në fillim të shek. XX, si dhe trajtimi në shtypin majtist evropian të problemeve të ndjeshme për shqiptarët si zhdukja e pronës së madhe latifondiste, për ngritje mëditjesh, kundër shfrytëzimit të njeriut etj. ngjallën simpati të një pjesë e intelektualëve dhe të rinjve shqiptarë për këtë ideologji. Për më tepër shih: Kristo Frashëri, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe themelimit të PKSH-së (1878-1941)*, Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2006, f. 18-23.

315. Skënder Luarasi, “Lenini”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 132.

316. K. Frashëri, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së ...*, f. 24.

317. M. Islami, “Prof. Skënder Petro Luarasi, personifikim i problemit shqiptar” ..., f. 107.

318. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 1. Kërkesa e Skënder Luarasit për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

319. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi.

320. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 1. Kërkesa e Skënder Luarasit për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

321. Po aty.

322. Andi Pinari, “Aleks Buda: Mes politikës dhe shkencës”, në: *Kur Sigurimi merrej me shkencë*, botim i AIDSSH dhe Perform, [https://issuu.com/aidssh/docs/kur\\_sigurimi\\_merrej\\_me\\_shkence](https://issuu.com/aidssh/docs/kur_sigurimi_merrej_me_shkence), vizituar më 3 maj 2020.

Më vonë, Buda do ta quante me krenari Luarasin si “mësuesi im” dhe do ta konsideronte të qenët bashkëstudent me të, si një nga momentet vendimtare për formimin e tij si marksist. Aq i fortë ishte ndikimi i Luarasit në rrethin e studentëve shqiptarë, sa një pjesë e tyre nuk ngurrojnë të nënshkruajnë një peticion për Ministrinë e Arsimit në vitin 1930, duke i kërkuar autoriteteve që t’i rikthejnë bursën e studimit Skënder Luarasit<sup>323</sup>.

---

## Luarasi si mësues në Shqipërinë e gjysmës së parë të viteve ‘30

---

Viti 1930 e rikthen Skënder Luarasin në Shqipëri tanimë si profesor i gjuhës shqipe, i anglishtes dhe i gjermanishtes në Shkollën Teknike në Tiranë, por antizogizmi i tij i shprehur do t’ia vështirësonte karrierën edhe jetën. Shprehja e hapur e mendimeve dhe veprimtaria e tij politike shumë shpejt do të shkaktonte reagimin e strukturave policore të regjimit. “Më 12 janar, – shkruan Luarasi, – më burgosën për tre muaj në lidhje me letrat anonime në Tiranë dhe me ngritjen e afishave në Korçë. Ditën e 1 majit e festova tok me klasat e mija duke dalë jashtë me këngë përmes qytetit”<sup>324</sup>. Viti i ardhshëm mësimor e gjen të transferuar në Vlorë në Institutin Tregtar. Është viti kur ministri i Arsimit, Hil Mosi, ndërmori reformën e kombëtarizimit të shkollës shqiptare, e cila nuk mund të mos kishte mbështetjen e patriotit Luarasi, por edhe këtu veprimtaria e tij do të ngjallte pakënaqësinë e regjimit, i cili vendosi sërish ta transferojë profesorin “problematik”. Me insistimin e mikut të vjetër të familjes, tanimë ministër i arsimit Mirash Ivanaj, kthehet sërish në gjimnazin e Tiranës<sup>325</sup>. Por idealizmi dhe antikonformizmi i tij sërish e bënë të vështirë qëndrimin në kryeqytet. Edhe në Tiranë, Luarasi vijoi të mbante lidhje me elementë revolucionarë. Në shkollë, ai kujton se punoi për të ngritur lart moralin e studentëve të shtypur dhe “për të goditur mësuesit dallkawkë që thërrisnin për nipërit e Zogollit me titullin Naltësi. E rrëzoja në klasë nxënësit e dobët Sherefedin Zogun dhe nuk pranova t’i jap mësim private. Për të sjellë rregull në internat, përzura djem feudalësh si bie fjala të birin e adjutantit të Zogut, Xhafer Sul Kurtin. Ndihmova për demokratizimin e shkollës, duke rekomanduar për bursistë vetëm djem të varfër dhe revolucionarë nga shpirti”<sup>326</sup>.

Në vitet 1934–1935, ishte sërish Mirash Ivanaj, i cili i kërkoj të transferohej në gjimnazin e Shkodrës, për të ndihmuar ministrin reformator të Arsimit në implementimin e reformës arsimore të vitit 1932. Në Shkodrën e ndarë mes besimesh fetare, Luarasi merr edhe drejtimin e konviktit. Në kontakt me elementë komunistë si Selim Shpuza, i cili sapo ishte kthyer nga Moska, veprimtaria politike e Luarasit bëhet më e dukshme. Ai vetë pohon se “Në internat solla vëllazërimin midis elementëve dhe frymën revolucionare”. Në Shkodër, Luarasi punoi për të kapërcyer ndasitë fetare në sistemin arsimor. Ai nuk pranoi që klasat e gjimnazit të ndaheshin në bazë të përkatësisë fetare të nxënësve dhe shkroi në ballë të klasave fjalët lapidare të poetit rilindas, Pashko Vasa “feja e shqiptarit është shqiptaria”<sup>327</sup>. Luarasi organizoi shoqëri studentësh, me anën e të cilave “shpërndava në Shkodër dhe Malësi broshurat “Shpëtimi i fshatarit”

---

323. Po aty.

324. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 1. Kërkesa e Skënder Luarasit për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

325. M. Islami, “Prof. Skënder Petro Luarasi, personifikim i problemit shqiptar” ..., f. 105.

326. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasit për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

327. M. Islami, “Prof. Skënder Petro Luarasi, personifikim i problemit shqiptar” ..., f. 111.

dhe “Legaliteti” dhe literatura të tjera revolucionare”<sup>328</sup>. Në programet mësimore të letërsisë, futi edhe romanin “Nëna” të shkrimtarit sovjetik Maksim Gorki të përkthyer në shqip nga Tajar Zavalani, një akt shumë i guximshëm për kohën. Nxënësit e tij Lazër Radi<sup>329</sup>, Arshi Pipa<sup>330</sup>, Ramiz Xhabija, Andrea Varfi e shumë të tjerë kujtojnë me respekt mësuesin e letërsisë, Skënder Luarasi që u fliste për të majtën dhe nevojën për ndryshime rrënjësore në organizimin shoqëror e politik të Shqipërisë dhe edukonte me shembullin e tij për t’i shërbyer shoqërisë. Më 19 qershor 1935, prof. Luarasi sfidoi mendjet e reja të nxënësve të tij me një temë hartimi të bazuar në vargjet “E vjetra shembet, kohët po ndryshojnë, një jetë e re po lulëzon gjëmadhash”, të shkëputura nga drama “Vilhem Tel” e Friedrich Schillerit, të cilët ai vetë e kishte shqipëruar disa kohë më parë. Hartimet e nxënësve tregojnë qartë idetë të cilat mësuesi i letërsisë kishte dashur t’u edukonte. Shumë prej hartimeve, të cilat më vonë Luarasi ua dhuroi muzeve të arsimit në Tiranë, Shkodër e Vlorë, flasin për ndjenjat republikane, lirinë e përparimin, për një sistem shoqëror të drejtë e të barabartë, për zgjidhjen e çështjes shqiptare, etj. Nxënësi Elez Braha trajtonte çështjen e përplasjes së mentaliteteve të vjetra me djelmërinë, e cila është “shpresa e të ardhmes”, e cila do të mund t’i rrëzojë “mentalitetet e kalbura”. “Njeriu ka lindë i lirë e gjithkund asht ndër pranga, – shkruan Braha. Këto na i thotë Rusoi, i përmenduri dijetar e edukator frëng. E mbasi njeriu asht lindun i lirë, duhet ta gëzojë këtë liri e jo sikur deri tash. Ndryshimin e kohës dhe të shemburit e së vjetrës na i dëftejnë fletët e historisë ... Po na a thue të rrimë në terr si deri tash e të shohim rreth e rrotulltue ka le një jetë e re e të heshtim? Ah! jo! Djalëria e jonë nuk do të rrijë ende në gjumin e randë të fantazmës”<sup>331</sup>. Një tjetër nxënës i klasës, Xhemal Broja shkruante: “Për ditë po shofim se prej gjëmadhash të kombeve të vjetra, po lulëzojnë jetë të reja. Shembëllën e kemi në Rusinë, e cila u sundonte prej Carëve të fëlliqët, qi kishin shtyp popullin, e nuk ia nepshin të drejtën e qi i bajshin sa e sa kobe të tjera të ndyta e se nën pushtetin e tyre po shkonte Rusija dita me ditë në rrënim, sot, banë qi prej atyne gjëmadhash, të lulëzojnë një jetë e re, plotë gjallni. Gjithashtu kemi edhe në Turqinë, e cila përpara, në kohën e sulltanëve, nuk ishte në këtë gjendje qi asht sot ... Aty një mendje e trashë e sulltanit, e influencueme prej baballarëve të tij ma të liq sa ai, kishte fatin e të gjith popullit në dorë. Sot po prej atyne rrënimesh po lulëzon një jetë e kandshme, nën një atmosferë mendimesh të lira ...”<sup>332</sup>.

Fakti që nga të gjitha këto hartime, profesor Luarasi zgjodhi të lexonte para klasës atë të nxënësit Qemal Stafa, i cili ishte një lloj manifesti i të majtës komuniste, flet qartë për një lloj evoluimi të qëndrimit të tij politik. Për Qemalin 15 vjeçar “E vjetër është çdo gja që kohët e kalueme na kanë lanë. Sistemi shoqruer, arti i dikuershëm, feja, dasija mes popujvet, janë të tilla”<sup>333</sup>. Ai fliste për padrejtësinë e ndarjes së pasurisë në Shqipëri, ku dikush kishte miliona e të tjera as bukë për t’u ushqyer. Varfëria konsiderohej nga revolucionari i ri si burim i të gjitha të këqijave me të cilat përballej shoqëria, “Prej këndeje shofim se asht gja e domosdoshme ta ndryshojmë ndamjen e sotshme të pasunis (gja e vjetër) e ta zëvendsojmë me një ndamje të drejtë, e të njëjshme (gja e re). Rusët e kanë ba me kohë: shembull ky se e vjetra shembet. Edhe na do ta bajmë ... Edhe na shqiptarët do ta rrënojmë të vjetrën. Mbi të do ngrehim madhnisht flamurin e kuq të vllaznimit, të kulturës e të pasunis. Kemi besim në vetvete,

328. AQSH, F 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasis për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

329. Lazër Radi, “Në gjurmët e një ditari të djegur, kujtime libri i dytë (1928-1939)”, në: <https://www.radiandradi.com/profesor-skender-luarasi-ne-kujtimet-e-lazer-radi-libri-i-dyte-i-kujtimeve/>, vizituar më 18 mars 2020.

330. Intervistë e Arshi Pipës dhënë për një dokumentar mbi të, prodhim i Radiotelevizionin Shqiptar, viti 1990, në: <https://www.youtube.com/watch?v=mmBn3XnRcTA>, vizituar më 17 mars 2020.

331. “Hartimi i famshëm i Qemal Stafës: ‘E vjetra shembet, kohët po ndryshojnë. Nji jetë e re po lulëzon gjëmadhash’. Punimet ndër vite të nxënësve të Skënder Luarasis dhe hartimi i famshëm i Qemal Stafës për Leninin. Ja si u dënua Qemali për idetë revlucionare”, në: Gazeta Telegraf, 19 maj 2019, <https://telegraf.al/dosier/ekskluzive-hartimi-i-famshem-i-qemal-stafes-e-vjetra-shembet-kohet-po-ndryshojne-nji-jete-e-re-po-lulezon-gjemadhash-punimet-nder-vite-te-nxenesve-te-skender-luarasis-dhe-hartimi-i-famshem-i/>, vizituar më 28 prill 2020.

332. Po aty.

333. Po aty.

prandaj guxojmë”<sup>334</sup>. Leximi i një hartimi të tillë me përmbajtje “bolshevike”, nuk kaloi pa rënë në sy të drejtuesve të shkollës, por edhe të parisë të qytetit. Në biografinë e shkruar në vitin 1946, tregoi se klerikët e lartë të qytetit, qoftë ata katolikë, qoftë ata myslimanë “u bashkuan dhe më luftuan. Por studentët më përkrahën dhe më mbrojtën”<sup>335</sup>.

---

## Mendimi politik i Skënder Luarasit në vitet '20-'30

---

Në mendimin politik të Skënder Luarasit gjatë periudhës që u parashtrua më lart, spikat nevoja për ndryshime radikale në organizimin shoqëror dhe politik të vendit. Majtizmi i tij gjithnjë e më shumë shfaqet si opozitë e sistemit politik dhe social në Shqipëri, të përfaqësuar nga monarkia e mbreti Zog. Për të, rikthimi i Ahmet Zogut në krye të shtetit shqiptar shihet si triumf të asaj çka ishte e vjetër, e prapambetur dhe e mbante Shqipërinë të lidhur me trashëgiminë osmane. Kur Ahmet Zogu u shpall mbret më 1928, Luarasi nuk ngurroi të shkruante në gazetë mendimin kritik ndaj tij. Ashtu si një pjesë e madhe e njerëzve të shkolluar të brezit të tij, Luarasi e konsideronte regjimin autoritar të drejtuar nga mbreti Zog, si burim i mungesës së zhvillimit dhe modernizimit të vendit. Për të, Zogu ishte mishërimi i feudalizmit dhe trashëgimisë osmane, gjë që e mbante Shqipërinë në të shkuarën dhe pengonte modernizimin dhe lëvizjen e vendit kah Perëndimit. Këto ide Luarasi i shpreh në dy artikuj të botuar gjatë viteve '20-'30, të cilët krahas pasqyrimin të ideve të tij, shpalosin edhe evolucionin që ka pësuar mendimi politik i Luarasit.

Artikulli i parë është botuar në gazetën “Zëri i Korçës” më 10 gusht 1929. Ai vë në dukje atë që autori e quan degjenerim moral dhe kulturor të klasës feudale shqiptare. Artikulli merr shkas nga një gjyq që po zhvillohej në Korçën e asaj kohe, në të cilin gjykohej Ethem Maliq Bej Vila për vrasje për motive të dobëta. Luarasi nuk e sheh këtë ngjarje si një krim të rëndomtë. “Këtë radhë çështja qëndron pak ndryshe, – shkruan Luarasi. Kjo vrasje e pashembullt në ashpërsinë dhe ndërlihdjet e saj pasqyron gjendjen e kalbur të strukturës sonë shoqërore. Është shfryrje e shpirtit të sëmurë. Ky soj krimi është më i rrezikshëm se hakmarrja, sepse nuk dëmton vetëm një njeri. Mikrobet e tij hematojnë një gjeneratë të tërë, sikundër kanë filluar të pëgejnë një shtresë të djalërisë të shtresave të larta të këtij qyteti”<sup>336</sup>. Me gjuhën e tij therëse, Luarasi e vizaton shumë të shëmtuar figurën e beut të ri dhe shëmtimi shkon përtej pamjes së tij fizike, por lidhet me atë çfarë përfaqëson beu për shoqërinë shqiptare. “Përgjithësisht përshtypja e parë që të bën i pandehuri, – shkruan Luarasi, – është ajo e një njeriu të rrëzuar trupërisht, mëndërisht, shpirtërisht. Ethem Beu nuk ka parë ndonjë dobi prej arsimit. Forcat e rrethanave e kanë ndërtuar shtrembër. Ky bir babai është shkurt prodhimi më i thjeshtë i aristokracisë së degjeneruar që na la pas regjimi turk, është feudal”<sup>337</sup>. Dhe e mbyll artikullin me urimin që, në të vërtetë është një thirrje për të gjithë shoqërinë. “Vepra e 21 marsit qoftë e fundit. Nuk dëshirojmë në asnjë mënyrë të kthehemi në barbarizmat e kohëve të vjetra. Kemi nevojë për një rrojtje të denjë për njerëz me shpirt, ndjenja dhe gjykim. Kemi nevojë për një rrojtje njerëzore”<sup>338</sup>.

---

334. Po aty.

335. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasit për t'u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

336. S. Luarasi, “Një gjyq me rëndësi”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 41-42.

337. S. Luarasi, “Një gjyq me rëndësi” ..., f. 41.

338. Po aty.

Artikulli i dytë që na shpalos edhe më drejtpërdrejt antizogizmin dhe antifashizmin e Luarasis. Artikulli është shkruar në Madrid më 1937, me titull “Ahmet Zogu varr shokët e vet”. Ai merr shkas nga ekzekutimi i Ismet Totos pas kryengritjes së dështuar të Delvinës të drejtuar nga vëllai i tij, ish-ministri i Punëve të Brendshme, Ethem Toto. Luarasi i drejtohet një kundërshtari të tij politik, i cili “si monarkist i shpallur, na ka luftuar, ne dhe demokratët, në mënyrë fort të rreptë; dëndur na ka goditur edhe në ndjenjat tonë thjesht kombëtare. Ne kemi pasur mëri për qëndrimin e tij në favor të regjimit shkatërronjës të sotëm”. Ndryshe nga komunistët stalinistë shqiptarë, të cilët nxitën kulturën e konsiderimit të kundërshtarit politik si armik të betuar, Luarasi nuk e denigron kundërshtarin politik, përkundrazi nuk e fsheh simpatinë që ka për intelektin dhe aktivitetin e Totos së ri, atë “bir Progonati”, i cili “binte në sy sidomos për inteligjencën” dhe që zotëronte “plot vetija të malësorit”<sup>339</sup>. Luarasi, konceptet politike që përbënin “diktaturën e ndritur” dhe “neoshqiptarizmin”, propagandues i të cilave ishte edhe Toto, i barazonte me zogizmin dhe fashizmin. Gabimi më i madh i Ismet Totos, sipas Luarasis ishte konsiderimi i A. Zogut si përfaqësues i grupit “të të rinjve”, dhe “si djalë i popullit” që do të mendohej për të mirën e tij, “por harroi se i biri i Xhemal Pashës qe produkt i sundimit të vjetër turk, dhe se ky malësor matjan kish më tepër krushqi shpirtërore me Sulltan Hamidin sesa me patriotët idealistë shqiptarë”<sup>340</sup>. Ajo çka e ndante revolucionarin Luarasi nga neoshqiptari Toto ishte qasja që kishin për të ardhmen e vendit dhe rolin e mbretit Zog në të. “Ismeti, - shkruante Luarasi, - shihte te Zogu, Mbretin e Shqipërisë; ne shihnim armikun e popullit shqiptar; ai “Shpëtimtarin e Kombit”; ne tradhëtarin e atdheut; ai modernizonjësën e vendit tonë, ne mesitin e EIAA-s dhe SVEA-s, të Bankës “Kombëtare”, të huavet dhe të gjithë traktateve të turpshme që ka lidhur me të huajt. Ismeti shpresonte se Zogu do të bëhej edhe çlironjësi i Kosovës dhe i Çamërisë, kurse ne qemë të bindur që triumfonjësi ilegal nuk ishte veçse shërbëtori më i përunjur i imperializmit fashist, të cilin e shiti më së pari vendin e lindjes. Ismeti ëndërrimtar përfytyronte mbi krye të Zogut kurorën e Skënderbeut, kurse ne me syt e ballit tonë që në fillim ja kishim parë në dorën e fshehur thikën tradhtare, e të cilën goditi drejt në zemër sovranitetin e popullit shqiptar”<sup>341</sup>. Për Luarasin, mendimit politik të Totos i mungonte ideologjia, gjë që e çonte atë në disa qëndrime “paradoksale”, “dëshirën për “oksidantalizim” të Shqipërisë nga një mbret që është më oriental se anadollakët vetë; pajtimin e popullit përmes vrasësve të patriotëve veteranë; pasurimin e kombit përmes hajdutëve më të tmerrshëm që ka parë bota; organizimin e djalmërisë dhe zhvillimin e kulturës përmes katilëvet e ministravet analfabetë”<sup>342</sup>.

Qëndrimi në Spanjë dhe kontakti i atjeshëm me komunistë marksistë, duket se ka radikalizuar qëndrimet politike të Luarasis. Duke bërë diferencën midis ideologjisë së “diktaturës së ndritur”, Luarasi në këtë artikull veçon njëkohësisht edhe veten, edhe nga ata që ai i quan demokratë, duke u afliuar tani me njerëzit “me tendenca të përparuara revolucionare”, e cila nënkuptonte të majtën marksiste. “Ismeti si zogist dhe fashist në prirjet e tija, ne, shqiptarët me tendenca të përparuara revolucionare dhe të gjithë demokratët antifashistë, na kish armiq ideje. Me gjithë këtë neve na vjen keq që humbëm kryengritësin e Delvinës, që triumfi i tyre nuk do ta kishte fashistizuar aspak Shqipërinë, të cilën nuk ka mundur ta fashistizojnë as Zogu më i kërrusuri shërbëtor i Musolinit, pasi populli shqiptar qëndron aq fort në kundërshtim me qëllimet e fashizmit, sa që do ta kishte kapur rastin që të shpëtonte njëherë e mirë prej zotërimit italian dhe do të arrinte në çlirimin e të gjithë Shqipërisë. Kështu kryengritja e fituar e Ethem Totos dashur pa dashur do të përfundonte në themelimin e demokracisë shqiptare”<sup>343</sup>.

339. S. Luarasi, “Zogu varr shokët e vet”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 49-53.

340. Po aty.

341. Po aty.

342. Po aty.

343. Po aty.

---

## Si luftëtar në Brigadat Internacionale në Spanjë

---

Mesi i viteve '30, ndryshoi shumëçka në jetën e Skënder Luarasi. Më 12 dhjetor 1936, ai u nis si vullnetar në Luftën Civile që po zhvillohej në Spanjë midis forcave republikane të mbështetura nga Bashkimi Sovjetik dhe shumë antifashistë kudo në botë dhe monarkistëve, të cilët mbështeteshin nga Gjermania naziste e Hitlerit dhe Italia fashiste e Musolinit. Arsytet përse Skënder Luarasi ishte nga të parët vullnetarë shqiptarë që u nis nga Shqipëria për në Spanjë, duhen kërkuar te ndjenjat e tij antifashiste, por edhe te situata e tij personale. Më 20 gusht 1935, ai u arrestua sërish padrejtësisht me akuzën si pjesëmarrës në kryengritjen e Fierit. Pavarësisht se u gjet i pafajshëm nga gjyqi, ministri i Punëve të Brendshme, Musa Juka “telegrafikisht kërkoi prej gjyqit që të më dënonte medoemos”<sup>344</sup>.

Në një bisedë që zhvillon Luarasi më 16 dhjetor 1952 me agjentin “Dhëlpëria” tregon sa e vështirë dhe i rrezikshëm ishte bërë për të qëndrimi në Shqipëri. “Nga fundi i 1936, - tregon Luarasi, - unë isha e dëshpëruar nga transferimi që më bënin për në Teknike (Vlorë), nga artikulli i Ismet Totos në ‘Arbëria’ që më tallte, nga zënia me Zallarën dhe goditja që më bëri Adem Karapici në ‘Kursal’ kur më akuzoi si ‘bolshhevik’ dhe nga masat që mund të merrte Musa Juka për refuzimin që i bëra për të mos redaktuar botimin që po përgatishnin për 25-vjetorin e Indipendencës. Në atë kohë, ndiqja radion e republikanëve spanjollë dhe mora vesh se nga të gjitha anët e botës shkojnë vullnetarë për të shpëtuar Madridin<sup>345</sup>. Idenë për t’u larguar në Spanjë e kishte diskutuar një ditë në kafën ‘Kursal’ me kunatin e tij Mina Uçin dhe Selim Shpuzën dhe, pasi ishte inkurajuar edhe nga këta të dy dhe kishte siguruar nënën në kujdesin e familjes së motrës, kërkoi dy muaj leje nga Faik Shatku, ministri i atëhershëm i Arsimit, me pretekstin për të shkuar në Vjenë për të përfunduar doktoratën<sup>346</sup>.

Në ditët e ftohta të dhjetorit 1936, Luarasi udhëton fillimisht për në Follorinë (Greqi) e më pas në Lyon të Francës, ku Ymer Dishnica i krijon lidhje me një anëtar të KQ të PKF që merrej me vullnetarët e Brigadave Ndërkombëtare. Në Paris takon edhe të tjerë përfaqësues të së majtës shqiptare në emigracion si Kolë Tromarën, Kostë Çekrezin, Zai Fundon, etj. Madje, për këtë të fundit, kujton se ishte përpjekur ta dekurajonte për të shkuar në Spanjë, pasi “për të luftuar Zogun ishte më mirë të shkoja të qëndroja në Shqipëri ose në Francë”<sup>347</sup>. Skënder Luarasi ishte i vetmi intelektual i paangazhuar në asnjë prej grupeve të majta si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë vendit që vendosi me iniciativën e tij për të shkuar vullnetar në Spanjë.

Në ditët e para të janarit 1937, Luarasi nis një tjetër udhëtim shumë më të vështirë dhe që kërkonte shumë sakrificë, tanimë nga Parisi në Perpinjan. Pas peripecive të shumta dhe në klandestinitet të plotë, luftëtarët antifashistë nga shumë vende të botës mbërritën në Figueras, ku u çlodhën pak në kështjellën mesjetare dhe zgjodhën drejtuesit ushtarakë dhe politikë, vijuan rrugëtimin për në Barcelonë dhe së fundi në Albacetë, një qytet midis Valencës dhe Madrit, i cili ishte caktuar si bazë e brigadave ndërkombëtare<sup>348</sup>. Për shkak të përgatitjes së tij intelektuale, Skënder Luarasi u caktua për të përfaqësuar

---

344. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasi për t’u pranuar anëtar i PKSH-së, 25 prill 1946.

345. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 49. Raport informativ i agjentit “Dhëlpëria” i datës 16.12.1952, flitet mbi luftën e Spanjës.

346. Po aty.

347. Po aty.

348. S. Luarasi, *Në brigadat internacionale në Spanjë, ...* f. 18-19.





Petro Marko e Skënder Luarasi në Luftën e Spanjës (1938).

Nga e majta në të djathtë sipër Petro Marko, Skënder Luarasi, Iljaz Pashaj.

vullnetarët shqiptarë<sup>349</sup> në Komitetin Ballkanik, i cili drejtohej nga profesori i Universitetit të Lubjanës, Dragotin Gustiniç<sup>350</sup>. Brigadat Internacionale të Spanjës mbledhën së bashku komunistë bolshevikë, anarkistë, socialdemokratë, socialistë e demokratë liberalë, të cilët i bashkonte solidariteti njerëzor dhe një ideologji e përbashkët: antifashizmi. Për komunistët shqiptarë të lidhur me Kominternin, Spanja ishte një mundësi e mirë “për të mësuar artin e luftës teorikisht dhe praktikisht”<sup>351</sup>, pra për të stërvitur ushtarët e ardhshëm të revolucionit. Por Luarasi nuk ishte pjesë e këtyre kombinimeve politike, pasi ai nuk ishte pjesë e asnjërës prej skemave organizative të së majtës shqiptare. Ai, deri në fund të jetës dëshmonte krenarinë që ndjente si pjesëmarrës i këtyre brigadave dhe në çdo rast nuk mungonte të përmendte se misioni i tij ishte, sa antifashist e revolucionar, aq edhe patriotik. Më 4 shtator 1946, tanimë si deputet i Kuvendit Popullor, ishte i vetmi që propozoi që në projektligjin për dëshmorë të atdheut të shtohesh edhe një nen për “ata që ranë në Luftën e Spanjës, duke lëftuar nga ana e republikanëve, të

349. Në bisedat që Skënder Luarasi ka zhvilluar mbi këtë çështje me agjentin “Dhëlpëria” shprehet se në komitetin ballkanik ishte i ngarkuar me punën e shqiptarëve dhe të grekëve, pasi për grekët nuk kishte akoma ndonji njeri të përshtatshëm. Shih: AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 49. Raport informativ i agjentit “Dhëlpëria” i datës 16.12.1952, fletet mbi luftën e Spanjës.

350. S. Luarasi, *Në brigadat internacionale në Spanjë*, ... f. 18-19.

351. AQSH. F. 15/AP, L. 1, D. 21, fl. 8. Letër e Aziz Çamit mbi punën e Fundos, 17 janar 1938.

cilësohen si dëshmorë të lëvizjes”<sup>352</sup>. Sipas tij, në Spanjë vullnetarët shqiptarë shkuan si përfaqësues të Shqipërisë nga të gjitha shtresat përparimtare të shoqërisë. “Erdhën mësuesit që t’u tregonin nxënësve të tyre se ç’u kishin thënë në klasë për vlerën e vërtetë të lirisë e të pavarësisë, të bashkimit kombëtar dhe bashkimit të popujve – këto vlera dhe parime ishin gati t’i mbronin edhe me kokën e tyre: 2. Qenë fshatarë e punëtorë, që t’i tregonin familjeve të tyre frutin e djersës dhe një jetë më të denjë në atdheun e tyre që Zogu dhe feudalët ia kishin shitur fashizmit italian: 3. Qenë ushtarakë, që do t’u tregonin shokëve të tyre në ushtrinë e mbretit faqezi se cili qe armiku i vërtetë i Shqipërisë dhe kundër kujt do të drejtonin armët kur të vinte momenti vendimtar për liri a vdekje. Në Brigadat Internacionale u përfaqësua edhe gruaja shqiptare (është fjala për infermieren Justina Shkurti – S.B.) që u shërbeu me devocion të plagosurve, të sëmurëve duke u bërë edhe vetë donatore (dhuruese gjaku)”<sup>353</sup>.

Simbioza e dy ideologjive, nacionalistit me majtistin antifashist, del qartazi në prononcimet publike në mediet e ndryshme spanjolle. Në një intervistë të dhënë në radio mbi arsyet që e kishin shtyrë për të luftuar për Republikën Spanjolle, Luarasi shprehet se “Në Tiranë patëm dëgjuar me interes të madh të flitej për luftën që u bë një mot më parë në Etiopi dhe me interes të dyfishuar dëgjuam edhe për ngjarjet në Spanjë. Nuk ka në Shqipëri, – thashë në atë emision, një qytetar me pesë para mend në kokë që të mos kuptojë se pas atij të Abisinisë dhe Spanjës do të jetë populli shqiptar viktimë e tretë e lakmisë fashiste... Dhe shpjegova se shqiptarët që ishin vullnetarët shqiptarë mbushnin një detyrë patriotike, se kështu do të kishte sy e faqe kombi ynë të kërkonte ndihmën e popujve të tjerë lirisdashës në rast të një agresioni fashist ndaj vendit tonë”.

Në vjeshtën e vitit 1937, Luarasi së bashku me vullnetarin tjetër shqiptar në Spanjë, Petro Markon morën leje për të botuar në gjuhën shqipe gazetën “Vullnetari i Lirisë” si organ i shqiptarëve në Brigadat Internacionale. Gazeta e cila u përgatit vetëm në dy numra, ishte e ndikuar plotësisht nga majtizmi marksist dhe, për këtë arsye censura e regjimit monarkist bënte thirrje për “kontroll të rreptë” gazetës<sup>354</sup>. Për Luarasin “Vullnetari i Lirisë” kishte mundur “të përhapej zëri i lirisë në gjuhën tonë amtare, që t’u tregohej atdhetarëve tanë e vërteta për Spanjën dhe për Shqipërinë. Në radiot e Barcelonës e të Valencias dhe në “Vullnetarin e Lirisë”, të botuar në Madrid, ne shprehëm mendimet tona nga Fronti i Spanjës; përshkruam hijen e ligë të fashizmit që po shtrihej drejt bregdetit lindor të Adriatikut dhe thamë se një e premtë e zezë do t’i vinte Shqipërisë domosdo, po të mos ia shtypnin kokën fashizmit në llogoren e lirisë<sup>355</sup>. Me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë, ai gjente rastin të paralajmëronte bashkëkombasit e vet se Shqipëria po shkonte drejt humbjes së pavarësisë kombëtare. Ai e shihte fitoren e republikanëve në Spanjë si mënyra e vetme për të penguar avancimin e fashizmit në Evropë, pra dhe në Shqipëri. Nga Spanja në frymën e vendimeve të Kongresit VII të Internacionales Komuniste (1935), Skënder Luarasi i bënte thirrje popullit shqiptar të bashkohej, të krijonte frontin dhe të “çlirohej nga tirania fashiste qoftë kjo e jashtme apo e brendshme”. “Ky bashkim kombëtar – shkruante S. Luarasi te ‘Vullnetari i Lirisë’, – do të na ndihmojë të zëvendësojmë ‘triumfin e Legalitetit’ e të mizerjes me të revolucionit popullor të punës dhe të bukës, të përparimit dhe të lumturisë”<sup>356</sup>. Majtisti i paangazhuar në Shqipëri do të largohet nga Spanja si komunist. Më 1939, para se trupat internacionaliste të largoheshin nga Spanja e Frankos, Skënder Luarasi u bë anëtar i Partisë Komuniste Spanjolle.

352. AQSH, F. 489, V. 1946, D. 80, fl. 20. Nga procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Popullor, datë 4 shtator 1946.

353. S. Luarasi, *Në brigadat internacionale në Spanjë*, ... f. 40

354. Myslim Islami, “Prof. Skënder Petro Luarasi, personifikim i problemit shqiptar ...”, f. 115.

355. S. Luarasi, *Në brigadat internacionale në Spanjë*, Tiranë: Toena, 1996, f. 40.

356. Po aty.

---

## Në kampet e përqendrimit në Francë

---

Vitet e Luftës së Dytë Botërore janë ato për të cilat kemi më pak të dhëna mbi veprimtarinë politike dhe intelektuale të Skënder Luarasis. Informacionin mbi këtë periudhë të jetës së tij e përftojmë nga ato pak gjëra që ai ka shkruar në biografinë e vet dhe bisedave që ka zhvilluar me njerëz të besuar, të cilët Sigurimi i Shtetit i kishte ngarkuar për të raportuar mbi Skënder Luarasin. Në biografinë e tij të shkruar më 1946, ai bën thjesht një ekspozitë të asaj çfarë ka ndodhur në 5 vitet e jetës së tij kur qëndroi në Francë. Pas marrjes së urdhrin nga qeveria spanjolle për tërheqje më 12 shkurt 1939, Brigadat Internacionale lanë Spanjën dhe u drejtuan në Francë, ku u izoluan në një kamp në St. Syprien. “E premtja e zezë”, që profesori e kishte paralajmëruar në shumë prej shkrimeve të tij të mëparshme, e gjeti në këtë kamp. Ai kujton se “bëri çmos të nisej për në Shqipëri për të luftuar kundër armikut që na sulmonte mëmëdheun”<sup>357</sup>, por komandanti i kampit nuk i kishte lejuar duke i thënë “Mon dieu! Ju s’e ditkeni q’atje po bëhet luftë. Jini mirë këtu.”<sup>358</sup>

Deri në qershor 1944, Luarasi udhëtoi nga një kamp përqendrimi në tjetrin në Francën para dhe gjatë pushtimit. Në maj 1939, luftëtarët shqiptarë të Spanjës, Skënder Luarasi, Hulusi Spahiu, Mehmet Shehu, Zef Prela, Mane Nishova, etj., u transportuan në Gurs. Atje Luarasi pohon se ishte i angazhuar me “brenda grupeve internacionale, duke themeluar kurse gjuhe, biblioteke, dhe duke mbajtur konferenca”. Jetën politike e vijoi edhe në këtë kamp përqendrimi, ku ai pohon se ishte “anëtar i celulës në grupin italian deri më 1942, kur u disolvuam lidhjet. Në Gurs shokët shqiptarë të partisë më kishin zgjedhur përgjegjës. Tok me Mehmet Shehun kemi mbajtur lidhjet me botën jashtë kampit”<sup>359</sup>. Në maj 1940 u transportuan për në kampin e internimit në Vernet, nga i cili, më vonë kur Franca ishte nën kontrollin e qeverisë kolaboracioniste të Petain-it, një pjesë e të internuarve shqiptarë mundën të riatdhesohen, por Skënderit nuk iu dha kjo e drejtë nga komisioni militar italian për riatdhesim, për arsye ende të paqarta. Ai kujton se në kampin e përqendrimit, Kostë Çekrezi i kishte propozuar për të shkuar në SHBA, por Luarasi nuk kishte pranuar. I mbetur tanimë i vetmi shqiptar në kamp, nga fillimi i vitit 1943 tentoi të arratiset nga kampi. Ishte kjo arsyeja që u burgos dhe u dënua nga gjyqi i komunës së Pamierit. Nga fundi i atij viti, së bashku me një grup të dënuarish u dërguan në një kamp pune në Bordeaux, “ku togun tonë e mbajtën të izoluar nga të tjerët për një dy muaj”<sup>360</sup>. Pas zbarkimit të trupave ushtarake aleate në Normandi dhe çlirimit të Francës nga pushtuesit gjermane, Luarasi lirohet nga kampi i Bordeaux –së dhe gjeti strehim në “shtëpinë e punëtorit francez Georges Beanchues”. Për gati një vit, Luarasi qëndroi në Marseilles dhe siguroi jetesën, sipas biografisë së tij, duke dhënë mësimë private, sidomos djalit të një tregtari grek derisa ishte bërë e mundur riatdhesimi i tij në Shqipëri. Në biografinë e përpiluar nga Sigurimi i Shtetit thuhet se, në qytetin francez, Luarasi kishte punuar me Aleatët Perëndimorë. Ndërsa Skënder Luarasi qëndronte i izoluar në kampet e përqendrimit në Francë, emri i tij përmendet si një nga drejtuesit e mundshëm të shtetit shqiptar të pasluftës. Sipas një memorandumit tepër konfidencial të hartuar nga gazetari britanik dhe njohësi shumë i mirë i Ballkanit, Patrick Maitlandt shprehet se prestigji i mbretit Zog kishte rënë shumë në Shqipëri, për një pjesë të madhe të elitës politike shqiptare, e ardhmja e vendit nuk duhet të ishte në dorë të atyre “që mbështetën rënien e Shqipërisë së Lirë”<sup>361</sup>. Gazetari shprehet i çuditur që edhe ish-kryeministri majtist Fan S. Noli nuk ishte nga emrat e preferuar të intelektualëve shqiptarë për të

---

357. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasis për t’u pranuar anëtar i PKS-së, 25 prill 1946.

358. S. Luarasi, “Në fushë të përqendrimit në Francë”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 63.

359. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasis për t’u pranuar anëtar i PKS-së, 25 prill 1946.

360. AQSH, F. 14/AP/str., V. 1947, D. 360, f. 2. Kërkesa e Skënder Luarasis për t’u pranuar anëtar i PKS-së, 25 prill 1946.

361. *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (në arkivat kombëtare britanike)*, përgatitur për botim nga Hamit Kaba dhe Sabit Sylja, dok. 11, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2018, f. 49.



Tradhëtari del  
ndonjëherë edhe prej  
familjeve q'i i kanë dhënë  
atdheut heronj. Pupu,  
sa keq do t'i ketë ardhur  
Skënderbeut, atë ditë kur  
mori vesh tradhëtinë e  
nipit Hamzë. Naimi, dhe  
Samiu nuk gjejnë prehje  
në varr për tradhëtinë që i  
bëri nipi i tyre atdheut, që  
ata dy vëllezër e deshën  
me mall aqë të zjarrtë!

Skënder Luarasi



marrë në dorë fatet e Shqipërisë së pasluftës. Në vend të tyre, ata përmendnin si drejtues të mundshëm të shtetit shqiptar emrat e ish-ministrit të arsimit, Mirash Ivanaj, arkitektit Qemal Butka dhe të profesorit Skënder Luarasi, duke theksuar se i pari do të ishte më i përshtatshëm pasi do të ishte “i aftë për një qeverisje të fortë në rast se kthehej”<sup>362</sup>. Burimi i sipërpërmendur ndonëse është thjesht opiniononi i një gazetari, është dëshmi për gjurmën që Skënder Luarasi kishte lënë në elitën intelektuale të Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave Botërore.

---

## Medalja me dy anë: Skënder Luarasi gjatë regjimit komunist

---

Në 13 qershor 1945, Skënder Luarasi kthehet në atdhe tanimë me entuziazmin e një njeriu që ka realizuar ëndrrën e tij politike: fitoren kundër fashizmit, por edhe atë çka e konsideronte një mundësi reale për të zhvillimin, modernizimin dhe përparimin e vendit. Përfshirjen popullore në Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe sakrificat e bëra gjatë pesë viteve të pushtimit nazifashist nga djelmëria shqiptare, Luarasi e shihte si ogur të mirë për të ardhmen e vendit, pasi siç thoshte ai në artikullin “Në gjurmë të patriotëve”, të botuar në gazetën “Bashkimi” më 28 nëntor 1945, “ku patrioti bie dëshmor, mbin liri”<sup>363</sup>. Për Luarasin nëntori i vitit 1944 ishte po aq i rëndësishëm në historinë e Shqipërisë, sa ata të viteve 1443 dhe 1912 dhe bënte thirrje që të mos lejonin që këtë nëntor të prishej nga tradhëtarët, ashtu siç ishin shkatërruar ai i Skënderbeut nga pushtimi osman dhe ai i Ismail Qemalit “nga Ahmet bej Zogolli dhe nga patroni i tij Musolini”<sup>364</sup>. Në këtë përplasje midis heronjve dhe tradhtarëve, Luarasi i konsideron tradhtarë të gjithë ata që bashkëpunuan me pushtuesin, pavarësisht të kaluarës së tyre personale apo familjare patriotike. “Tradhëtari del ndonjëherë edhe prej familjeve që i kanë dhënë atdheut heronj. Pupu sa keq do t’i ketë ardhur Skënderbeut, atë ditë kur mori vesh tradhëtinë e nipit Hamzë. Naimi, dhe Samiu nuk gjejnë prehje në varr për tradhëtinë që i bëri nipi i tyre atdheut, që ata dy vëllezër e deshën me mall aqë të zjarhtë!”<sup>365</sup>.

Si gjithmonë qytetar aktiv, Skënder Luarasi pranoi propozimin për të kandiduar si përfaqësues i popullit të Kolonjës në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 për Asamblenë Kushtetuese. Po atë vit, Luarasi ishte një prej iniciatorëve të krijimit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, madje zgjidhet edhe në kryesinë e saj. Në fjalimet e tij publike dhe në shkrimet e botuara gjatë vitit 1945, shihet qartë se ëndrrat e tij për të ardhmen e vendit, nuk janë në të njëjtën gjatësi vale me politikën e PKSH-së, e cila kishte kontrollin e plotë të Frontit Demokratik. Ndërsa Luarasi i konsideronte miq të gjithë ato shtete që kishin njohur Shqipërinë në nëntor 1945<sup>366</sup>, pra edhe Aleatët Perëndimorë, në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, të mbajtur menjëherë pas zgjedhjeve përcaktohet aleanca e ngushtë e shtetit shqiptar me

---

362. *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (në arkivat kombëtare britanike)*, përgatitur për botim nga Hamit Kaba dhe Sabit Sylva, dok. 11, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2018, f. 49.

363. S. Luarasi, “Në gjurmë të patriotëve”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 54.

364. S. Luarasi, “Në gjurmat e patriotëve”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 59.

365. S. Luarasi, “Në gjurmat e patriotëve”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 56.

366. Në artikullin “2 dhjetor 1945”, botuar në gazetën “Bota e Re”, Luarasi e konsideron fitoren e Frontit Demokratik në këto zgjedhje si ngjarjen më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë, e cila kishte gëzuar si shqiptarët, ashtu edhe “ata të huaj të cilët interesoheshin për situatën politike të Shqipërisë dhe kishin kuptuar ndryshimet rrënjësore që ndodhën në vendin tonë gjatë luftës për liri. Njohja e qeverisë sonë prej popujve miq para zgjedhjeve, e vërtetoi këtë”. Shih: S. Luarasi, “2 dhjetor 1945”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 58. Luarasi i referohet njohjes zyrtare të qeverisë shqiptare më 10 nëntor 1945 nga BRSS dhe, njohjen e kushtëzuar me zgjedhjet e lira dhe demokratike të Aleatëve Perëndimorë (SHBA dhe Britania e Madhe).

Bashkimin Sovjetik dhe Jugosllavinë e Titos<sup>367</sup> dhe menjëherë pas saj fillon propaganda shtetërore kundër SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe. Ndërsa Luarasi flet për unitetin politik të Shqipërisë, por të një Shqipërie që ishte atdheu i përbashkët si i luftëtarit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, ashtu dhe e familjes së ballistit të dikurshëm<sup>368</sup>, PKSH-ja në shkurt 1946 sanksionoi luftën e klasave si forcën lëvizëse të shoqërisë shqiptare<sup>369</sup>.

Entuziazmi i vitit 1945 nuk duket të ketë pasur jetë të gjatë për prof. Luarasin. Viti 1946 nxori në pah natyrën e vërtetë të totalitarizmit stalinist që po aplikohet në Shqipëri. Fushata e spastrimeve që deri atëherë ishte bërë në emër të dënimit të kolaboracionistëve, tanimë po prekte edhe ata intelektualë me prirje të majta, si: Gjergj Kokoshi, Suad Asllani, etj., të cilët ishin kontributorë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, por kundërshtonin regjimin diktatorial të Hoxhës. Për mendimin politik të Luarasit në këtë periudhë është e vështirë të gjykojmë. Burimet arkivore nuk janë të plota dhe publikimet e tij me karakter politik fillojnë të bëhen gjithnjë dhe më të pakta. Ndryshe nga karakteri i tij zakonisht ekspresiv në seancat e Kuvendit Popullor, ai ka mbajtur qëndrim të përmbytur dhe ishte disi i tërhequr në diskutimet për miratimet e ligjeve të ndryshme. Ndërhyrja më e gjatë e deputetit Skënder Luarasi në Kuvendin Popullor është ajo e seancës së jashtëzakonshme të zhvilluar më 30 korrik 1946 për të miratuar rezolutën mbi pranimin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris. Ashtu si shumica e folësve, Luarasi hodhi idenë se Lëvizja Nacionalçlirimtare i ka dhënë të drejtën Shqipërisë të ulet në tryezën e bisedimeve të paqes. Ai u kërkon “njerëzve që kanë në duar fatet e shteteve, veçse të jenë të nderçëm kundrejt së drejtës t’onë”. “Shqipëria e vogël në hartën gjeografike, – u shpreh Luarasi, – po bëhet një shtet i madh në të drejtën e saj ndërkombëtare. Janë disa virtute që e dallojnë popullin tonë nga të gjithë popujt e tjerë. Populli shqiptar nëse është i varfër në pasuritë lëndore, nuk e ka lënë veten të varfërohet në virtutet e tij. Populli shqiptar kurdoherë është gati të bëjë çdo sakrificë për lirinë dhe pavarësinë e tij ... . Është kjo dashuri që ka populli tonë për veten e tij që e bëri të hidhet pa u kursyer në zjarrin e luftës, kurse popujt e tjerë shihnin vetëm të ruanin kokën e tyre dhe të bënin tregti në kurriz të popujve të vegjël. Ne shqiptarët gëzohemi që kemi kuptuar rrugën e drejtë që na shpje në rradhët e përbashkëta kundra armikut fashist. Ne ishin të parët që ngritëm grushtin kundra invazorit fashist. Me këtë i shërbyem jo vetëm vendit tonë, por gjithë popujve; edhe na i çmojmë të gjithë ata që e quajnë veten antifashistë”<sup>370</sup>.

Gjatë vitit 1946, disa qëndrime të tij janë shumë kontradiktore, gjë që të bën të dyshosh nëse tërheqja është një moment reflektimi, apo një përpjekje për t’u përshtatur me situatën e re politike në vend. Në seancën e datës 27 nëntor 1946, kur deputeti i Vlorës Hasan Pulo propozoi që Enver Hoxhës t’i jepej titulli “Heroi i Popullit”, për kontributin e tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe për sakrificat që po bënin për mirëqenien e popullit dhe për ruajtjen e independencës së atdheut. Duke qenë se vetë Hoxha nuk asistonte në atë seancë të Kuvendit, Skënder Luarasi propozoi që të “zgjidhej një delegacion prej një deputeti nga çdo prefekturë për të shpënë homazhet e thella të Kuvendit dhe të popullit shqiptar, komandantit tonë”<sup>371</sup>. Në diskutimin mbi heqjen e mandatit të deputetit të Shkodrës dhe njëkohësisht ish-nxënësit të tij, Kolë Prelës, Skënder Luarasi diskuton në favor të heqjes së mandatit<sup>372</sup>.

Çfarëdo ta ketë shkaktuar tërheqjen e prof. Luarasit gjatë vitit 1946, ajo nuk zgjati shumë. Sërisht shpirti rebel dhe antikonformizmi i tij dolën shumë shpejt në pah. Në prill 1948, gjatë një mbledhjeje që u zhvillua nga Ministria e Arsimit me arsimtarët e shkollave të mesme, Luarasi u shpreh shumë kritik

367. AQSH, F. 14/AP,V. 1945, D. 4, fl. 1-2. Procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 11 dhjetor 1945.

368. Shih: S. Luarasi, “2 dhjetor 1945”, në: *Fjala Shqipe ...*, f. 61.

369. AQSH, F. 14/AP,V. 1945, D. 1/1. Procesverbali i Plenumit V të KQ të PKSH-së, 21 shkurt 1946.

370. AQSH, F. 489,V. 1946, D. 28, fl. 5-6. Nga procesverbali i seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Popullor, datë 30 korrik 1946.

371. AQSH, F. 489,V. 1946, D. 97, fl. 76. Nga procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Popullor, datë 27 nëntor 1946.

372. AQSH, F. 489,V. 1946, D. 122, fl. 220. Nga procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Popullor, datë 23 dhjetor 1946.

ndaj politikave arsimore të këtij dikasteri e veçanërisht ndaj trajtimit diskriminues ndaj profesorëve. “Drejtuesat tanë, – thuhet të jetë shprehur prof. Luarasi, – na kritikojnë ne profesorët se kemi të meta dhe nuk bëjmë detyrën. Për profesorët s’ka asnjë kritikë, këtyre s’mund t’u bëhen kritika, këta e kanë kryer gjithnjë detyrën e tyre, këta janë të paprekshëm. Është ministria ajo që nuk e ka bërë detyrën e saj, dhe ne nuk na ka dhënë praktikisht asnjë ndihmë, drejtuesat tanë rrinë në kolltuqet e buta të ministrisë dhe na diktojnë urdhëra, ata kanë guxuar dhe të goditin në kokë dhe profesorët. Nuk na kanë dhënë asgjë, jemi pa tekste, kam kërkuar tekste për të zhvilluar mësimin ...., më kanë thënë s’kemi, kam kërkuar kaq herë gjene s’kemi, vallë kur do të ketë, do të ketë ndonjëherë? Kam kërkuar që të zhvilloj mësimin mbi Faik Konicën, sipas programit, më kanë thënë nuk ta japim. E kam gjetur Faik Konicën në bakalli në frytierët e Tiranës të shitur me kuintal për të mbështjellë. Pse? Se e quajnë feudal”<sup>373</sup>.

Një vit më vonë, “rebelizmi” i Luarasis do të shfaqet sërish tanimë në mbrojtje të Sejfulla Malëshovës, me të cilin ishte përplasur kur ky i fundit drejtonte Ministrinë e Arsimit. Në tetor 1949, në Konferencën III të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë<sup>374</sup>, Sejfulla Malëshova doli kundër tezave të hedhura në referatin kryesor të Konferencës. Ai nuk është dakord me vijën politike mbi letërsinë dhe artet të paraqitur në referatin kryesor. Malëshova kundërshtonte të vendosej kufi ndarës ndërmjet shkrimtarëve të rrymës përparimtare dhe atyre të rrymës reaksionare në letërsinë shqipe; kundërshton që Fishta dhe Mjeda apo Noli dhe Konica të vendosen në dy kampe të kundërta<sup>375</sup>. Për të, Fishta, Noli dhe Konica ishin shtyllat ku mbështetej letërsia shqiptare e Rilindjes. Në mbështetje të Malëshovës dolën vetëm Ymer Dishnica dhe Skënder Luarasi. Luarasi kritikoi referatin si “shumë të gjatë dhe shumë të cekët”. Ai kundërshtoi imponimin politik që e drejtonte letërsinë vetëm në temat e aktualitetit, ose në temat historike që lidheshin me Luftën Nacionalçlirimtare. Ai i kërkoi Dhimitër Shuteriqit të njëjhej edhe “lufta e madhe që kanë bërë prindërit t’anë për të krijuar lëvizjen t’onë kombëtare”. “Kisha shumë për të thënë – u shpreh Luarasi, – po pasi S. Malëshova i tha të gjitha, unë u lehtësova”<sup>376</sup>. Për shkak të këtij qëndrimi Luarasi u përjashtua nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe u largua nga puna si profesor për t’u emëruar si leksikograf në Institutin e Shkencave. Për më tepër, reagimet e profesorit, si dhe miqësia e tij me disa prej deputetëve të dënuar me atë që njihet si Gjyqi i Deputetëve, tërhoqën vëmendjen e Sigurimit të Shtetit ndaj tij. Në vitin 1951, Luarasi filloi të survejohej me qëllim që “të zbulojë të gjithë aktivitetin aktual të Skënder Luarasis kundër partisë dhe shtetit”, si dhe “t’organizohet më së mirë përpunimi i Skënder Luarasis duke patur parasysh se kemi të bëjmë me një objekt të rafinuar që dyshohet si spiun i huaj, prandaj edhe masat tona që do të merren për përpunimin e tij të jenë të studiuara mirë dhe të synojnë në zbulimin e tij si agjent i huaj”<sup>377</sup>.

Tanimë në kushte të diktaturës dhe mungesës tërësore të lirisë, është e vështirë të gjykosh si apo nëse ka ndonjë evoluim në mendimin politik të Skënder Luarasis. Ai vetë në bashkëbisedimet me bashkëpunëtorët e shumtë të Sigurimit të Shtetit që japin raporte për të, i referohej bindjeve të tij komuniste, por më së shumti në të shkuarën “Unë një gjë s’kuptoj në këta, – i tha një ditë bashkëpunëtorit me pseudonimin Dhëlpëria, – në vend që ta kenë për nder të kenë afër njerëz të ndershëm dhe me karakter nga ata që kanë lëftuar për komunizmë dhe për çlirim të popullit që atëherë kur nuk ish e sigurt se do të

373. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 15. Raport i Komisionit të Kontrollit të Shtetit për Ministrinë e Arsimit, pa datë, sjellë në MPB më 16 tetor 1952.

374. Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve u përgatit me shumë kujdes nga drejtuesit e lartë të PPSH-së. Tezat në të cilat do të mbështeteshin referatet kryesore u dhanë dhe u kontrolluar nga drejtoria e Arsimit dhe e Propagandës pranë KQ të PPSH. Drejtuesit komunistë ishin shumë të shqetësuar se letërsia dhe artet nuk po arrinin të luanin si duhet rolin që u kishte caktuar regjimi si përcuese të politikës së partisë dhe edukuese të masave, prandaj në këtë Konferencë kërkuan që të nxitej letërsia në këtë drejtim. Për më tepër shih: AQSH, F. 14/AP/Str., V. 1949, D. 548.

375. Eldon Gjika, *Realizmi socialist në sistemin letrar shqiptar (fillimi dhe stabilizimi 1944-1961)*, Tiranë: Albas, 2019, f. 82.

376. Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë (9-12 tetor 1949), Tiranë: Mihal Duri, 1950, f. 81.

377. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 68. Plani i masave operative të përpunimit të Skënder Luarasis, 1 nëntor 1953.

triumfante komunizmi kaqë shpejt këtyre u pëlqen të afrojnë njerëz të të gjithë bajraqeve, njerëz oportunistë dhe arrivistë”<sup>378</sup>. Ajo çka kuptohet qartë nga dokumentet e dosjes së tij formulare është zhgënjimi dhe pakënaqësia ndaj atyre që po qeverisnin Shqipërinë, gjë që mund të ketë shkaktuar një ndryshim të qasjeve të tij ndaj të majtës. Sa i takon patriotizmit i tij, ai vijon të shfaqet gjithnjë e më qartë. Madje mund të thuhet se krisja e madhe me regjimin ishte pikërisht për mënyrën sesi ai trajtonte të shkuarën historike dhe patriotët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. “Pse na flasin për tradita ç’u duhen traditat dhe patriotët? Këtyre u mjaftojnë ato të Luftës Nç (nacionalçlirimtare). Në vend që të paktën një shkollë në Ersekë t’i vinin emërin e tim eti, që ka qenë i pari që ka hapur shkollat shqipe në Kolonjë, i kanë vënë emrin e një Dumeje që është vranë gjatë Luftës Nç”<sup>379</sup> ose “shkrimtarët dhe patriotët e Rilindjes nuk festohen me qëllim që të vihen në vend vlerat e tyre, por për qëllime propagandistike të kohës”<sup>380</sup>.

Pakënaqësia e tij ndaj gjendjes së përgjithshme të vendit dhe qeverisjes së njerëzve mediokër e pa vizion është një nga tematikat më të shpeshta që regjistrohet nga bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit. Ndonjëherë ajo merr karakterin e inateve dhe ambicieve personale, por jo rrallë drejtohet edhe ndaj politikave ekonomike e sociale të regjimit. Ai fajëson sjelljen e regjimit ndaj intelektualëve, duke shprehur mendimin se linçimin ndaj tyre ishte dora e jugosllavëve që kërkonin të eliminonin elitën intelektuale të Shqipërisë; shpreh pakënaqësi për disnivelin e jetesës midis punëtorit dhe nëpunësit me drejtuesit e lartë të shtetit; kritikon nepotizmin dhe padrejtësitë që ndodhin në të gjithë strukturën qeverisëse, etj. Si njeri i letrave pakënaqësia e tij më e madhe lidhet me imponimin nga ana e regjimit të modelit letrar. Ai mendonte se shkrimtari duhet të jetë i lirë të zgjedhë, si tematikat që do të trajtojë në veprat e tij, ashtu edhe qasjen filozofike dhe metodën. Imponimi i metodës së realizmit socialist, sipas Luarasis, kishte dështuar të prodhojë letërsi të arrirë. Ai kritikon linçimet që u bëhen shkrimtarëve, siç ishte p.sh. rasti i dënimit të Kasem Trebeshinës, kur Luarasi nuk heziton të shprehet se “kjo nuk është letërsi e realizmit socialist, por e hipokrizisë socialiste”<sup>381</sup>. Të njëjtën qasje kishte Luarasi edhe për luftën e klasave. Ai i vlerësonte njerëzit në bazë të asaj që mund të ofronin me profesionalizmin e tyre, jo çfarë bindjeje politike kishin. Më 1956, kur Arshi Pipa i sapoliruar nga burgu, trokiti në derën e ndërmarrjes së botimeve në Tiranë, Skënder Luarasi ndërhyri për ish-nxënësin e tij, të cilin e vlerësonte si përkthyes për të filluar punë në këtë ndërmarrje. “Njerëz të tillë me vlera si Arshiu, – citohet të ketë thënë në një raport të Sigurimit të Shtetit, – nuk duhen flakur, por përkundrazi duken afruar, se humbasin kot”<sup>382</sup>.

Ndonëse shumë më i rezervuar sesa në komunikimet miqësore me kolegët që ai u beson, Luarasi nuk mungon të shprehë edhe publikisht mendimet e tij. Më 1957, kur me shkrimtarët dhe artistët e Tiranës po punohej vendimi i Plenumit të KQ të PK të BS mbi veprimtarinë antiparti të Malenkovit, Kaganoviçit dhe Molotovit, Luarasi nuk hezitoi të bënte një paralelizëm mes Enverit dhe Stalinit duke u shprehur “Tani dhe neve duhet t’i themi shokut Enver se edhe ay duhet të jetë më i lidhur e masat, të mos jetë i mbyllur dhe i izoluar, por të dali në popull të marrë kontakt me popullin të mari vesh kërkesat dhe nevojat e popullit”<sup>383</sup>. Po kështu gjatë diskutimit të maketit të historisë së Shqipërisë, e cila paraqiste në mënyrë të deformuar disa nga momentet e rëndësishme të historisë sonë kombëtare, veçanërisht atë të Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme, Luarasi mbrojti tezën e

378. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 28. Raport informativ i datës 24 korrik 1950.

379. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 19. Raport i agjentit Dhëlpëria për një bisedë të tij me Skënder Luarasin, dt. 2 maj 1950.

380. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 20. Raport i Dhëlpërisë, 9 maj 1950.

381. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 67.

382. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 89, Raport i datës 2 gusht 1956

383. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 104. Informacion i shefit të sektorit të propagandës, pa datë.



A p r o v o b e t  
Shefi Seksionit te Vegante  
M a j o r  
( Ferbat Matohiti )

" Taper sekret "

Tirane, me 25. 11. 1953

V e n d i m  
(mbi transferimin e dosjes formulare 2/A.)  
te Skender Luarasi.

Jos Puntori Operativ Majo Qirisko Frokopi, efektiv  
i Drejtorise II-te, mbase pasqin mbi  
sjes formulare 2/A te Skender Luarasi

Q e s t i a  
se Skender Petro Luarasi, per aktivitet  
perqendruar ne agitacion e propagand  
nism cysh ne vitin 1931.

Me qene se sektori Intellig  
ti) i kalon si objekt Drejtorise P.I  
bequr nga instruksioni mbi mbajtjen

V e n d o s a  
transferimin e dosjes formulare ne 2/  
Drejtorise P.I brendeshme Tirane per  
ninin e tij.-

Punt  
u-shtyp I kop. Major ( )  
kon-dsk-Q.P.

Sek. 3/10  
M. Thaci

Set 5 (178)

Karre P.Op. R. Numan  
Dhene h.p. "Kosmografi"  
Ne bazen "Mikrofoni"

R A P O R T E

1) Ne daten 1.6.1970 nd u takua me Andrea Matrini ne Ur.  
Korçë e Pezës. Ne dy tek shkruan ne qyre e komunales mbase ad kishite ne-  
voja per te lyster guazhena, por nenpuesi i komitetit mangonte. Andrea  
dake mare shkas nga mangesa e nenpuesit, shka

"Ja nak ku rregull, nak ka ne drejtes, kam takuar disa dite  
me zere Skender Luarasin. Skenderi me tha se keta eshte diktatura e  
te pa punave, kater-pose keta rrashe nje njeri, p-sh vitim tek une ofice-  
ra te sigurimit, civiline qe te marrin vesh se qfare them une per kete  
ose ate qeshtje. Pese qe keta nak liden guazhet dhe lajmet e lotes ne  
jeshite, radioje jone nak ep sto dhe keshtu nji njeri po te komentoje  
nante nteri ne keta lajme, vinen njeron praps. Ne qofte se do ti laje-

do ti thosh ato, shchare edhe po ti  
voja qe te ndiqeshtin. Skenderi tha  
por te te lene edhe lajmet e shtypin

Nr. Prot.

Korçë 22 / III / 1965.

Linda:

Drejtorisi M.B.

Tirane.

Ne lishje me shifra 27.05-174 57.37/XI/45 na postete Ju  
pershkrimet biografiat e Skender Luarasi:

Lindur ne katundin Guras te Kolonjes ne 13 Janar 1901. Mbase  
e para shqip i mori nga i tati Petro Luarasi (Drejtor i shkollave shqipe  
n Korçe ne 1909; hequr ne 1911) shken patriotike te tet Skenderit e ka ndjekur  
hemerke Sht. Hallak e shqiptarit Gjonat Skenderi e ka vjeter ne familja  
e tija qe prej rrethimit e mbase ne 1914 per u shqep kolonja prej ande  
zere shka dhe vellej si mbase ne Vlore. Ne 1915 i vellej e shqepi ne  
Amerike ka qene meket "Easton Academy (Easton, Pa) dhe ne amerikan  
College (Springfield, Mass) ne 1920 u kthye mbase ka shqepu nga dy vje  
si nen puna dhe mbase ne Vjeter e ka qene pun, mbase mbase von  
shqep per ne vjeter meket mbase. Ne 1921 velle mbase ne Gjimnazin  
e Prishtines, dhe ne 1923 shqepu me "Revista Filozofike" n Universite  
tin e Tiranës. Per vjeter shkollon ne 1923-24 mbase mbase profesor i shqep  
shqipe, shqepu me gjimnazin e shqepu "Teknike Tirane". Ne 1931 -  
33 u transferua ne Inst. Drejtor te Vlores, ne 1934 u thir ne Gjimn. Tirane  
ne 1935 u transferua ne Gjimnazin e shqepu, mbase mbase mbase mbase  
tit. Ne 1935-36 u transferua ne Gjimnazin e Tiranës. Ne 1936 ne Dsheto  
ne prshkollin se do te shqep me Vjeter mbase ka shkollon Teknike dhe shka  
vullnetarisht ne Spanja ne Brigadat Internacionale. Pervec detyren qe i  
kishin opakuar ne qendren politike te Brigadave, u kujdes dhe per orga-  
nizimin e vullnetarve shqiptare dhe per krijimin e organit te tyre "Vull-  
netari i Lirisë" dhe transmetimet shqip nga radiot e Valencës dhe Barcel-  
lonës. Ne shqepu e ushtrës republikane dhe brigadave Internacionale na  
Spanja ne 11 shkurt 1939 u imberua ne France ne kampet e perqendrimt.  
Ne St. Cyrion e gjimn. shten e zeze te 7 Prillit. Ne Fushen e Perqendrimt  
ne France u mbajt gjer sa u qalirua prej ushtrive aleate ne 1944. Ne Shqip-  
peri mundi te ketebet ne 13 Qershor te ketij viti. (1945). Ne 1918 ka  
qene i shqepu i themelimit ne "Mshjes Studentave Shqiptare ne Amerike  
une sekretar i pare i saj. Qellimi lishjes qe te bashkonte shqiptaret, u  
e udhimitin per fitimin e independences shqiptare pas luftes mbase. Qe  
kur qe i mbase Skenderi ka mbase ofitur thezen e Shqipris se Jugut kunder agjea  
utave te imperialismit Grek (shin Gazetat "Springfield Republican" e  
Revisten Adriatiku.) 1920 Janar u botua "Studenti" dhe u ngjodh editor u  
revistes. Vepimin ne fjalë dhe me shkrim e ka vashkuar dhe ne Austri kur  
qe student ne Wiene si kryetar shqep "Albania" dhe ditor i Revistes Djalor  
ria. 1924 ka qene per qeverine e Kur Reizit, kur Zepo kapeteve shqepu me  
qerres e mbase dhe qeverije e Pan Nollit thiri popullin ne ndihme, Skenderi  
ne 1924 e te vellejsh Dhimitri u das kua me forcat vullnetare te Kolonjes  
qe te mbase kunder Zogut. 1927 Janar u arrestua per aktivitet anti zog.  
1931 Janar u arrestua permbri per agitacion anti-zogist. 1935 Shkurt u

AIDSSH, Dosje formulare nr.  
2823-A për Skënder Luarasin



Nuk ka dyshim që komunizmi e zhgënjeu revolucionarin përparimtar Skënder Luarasi, por ai nuk reshti kurrë së ngrituri zërin, ndonjëherë edhe me tone të larta, për të kërkuar të drejtën e tij.

karakterit antikombëtar të saj, e cila ishte në kundërshtim me tezën zyrtare që e paraqiste këtë ngjarje si një lëvizje me karakter social dhe, si të tillë, përparimtar. Një prej bashkëpunëtorëve të Sigurimit me pseudonimin Dragoi kishte dëgjuar Luarasin t'i pohonte Nasho Jorgaqit se “desha të mos diskutoja, por kur mendova se historia është tempulli i një kombi shkova dhe fola, pata kundërshtuar dhe ata më ndërprejnë fjalën disa herë dhe deshën të mos më linin të flisja. Në qoftë se nuk do të më linin të flisja do të shkoja drejt tek Enver Hoxha dhe do të kërkoja të drejtën time, por për fat ata më lanë dhe nuk u bë skandal. E pashë që të rinjtë ishin me mua dhe kur dolëm në pushim erdhën dhe më rrethuan dhe më thanë fjalë të mira”<sup>384</sup>. Në fakt ishte pikërisht Enver Hoxha ai që reagoi më ashpër ndaj ndërhyrjes së Luarasit. Ndonëse për karakterin antikombëtar të Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme ishin shprehur mjaft historianë dhe intelektualë të tjerë, ishte pikërisht emri i Skënder Luarasit dhe ai i Qamil Çelës që u përmend nga kreu i PPSH-së, si historianë borgjezë me arsytim “antishkencor dhe antishqiptar”, të cilët nuk e njohin fare “karakterin e popullit” dhe nuk kanë “asnjë fije respekti për ndjenjat e tij lirisdashëse, për të cilat është shquar shekuj me radhë”<sup>385</sup>.

Në mes të viteve '50, mesa duket si reflektim i procesit të destalinizimit që Nikita Hrushovi ua imponoi vendeve të Bllokut Socialist, vihet re një zbutje e qëndrimit të regjimit ndaj prof. Luarasit. Ai pranohet sërish si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve. Në një bisedë me agjentin Dhëlpëria, Luarasi shprehet se “ky muaj ka qenë muaji i gëzimeve të mia. Si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve u pranova,

384. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 108. Raportim i 10 qershorit 1958

385. Enver Hoxha “Disa pikëpamje mbi kryengritjen e Shqipërisë së Mesme (1914-1915), të udhëhequr nga Haxhi Qamili”, në: *Për shkencën*, Tiranë: 8 Nëntori, 1985, f. 109.

përthimi i pjesës së Bajronit m'u botua në Nëntori; dëshira ime që të vinin eshtrat e Migjenit m'u plotësua. Tani nuk kam ç'të them. A beson se tashti kam filluar të ndjej një farë ndryshimi në vetvete. Tashti sikur edhe njerëzit më duken më të mirë, sikur më duan më tepër, sikur i kam miq"<sup>386</sup>. Në vitet 1960-1961, prof. Luarasi arriti të hapë katedrën e anglishtes në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës.

Ndonëse në jetën e tij personale pati momente të vështira për shkak të humbjes së gruas së tij, Ollgës, në jetën profesionale kjo ishte një nga periudhat më të qeta në jetën e profesorit, e cila reflektohet edhe në reagimet e tij më të kontrolluara. Si rezultat, në shkurt 1964, Sigurimi mori vendimin që ta ulte nivelin e survejimit në kategorinë 2B. Qetësia ishte jetëshkurtër. Më 26 tetor 1964, në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve po diskutohej romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" i Ismail Kadaresë, i cili ishte konsideruar me probleme të rënda ideologjike dhe mori kritikën e anëtarëve të Lidhjes, por jo të Luarasis. Ai do të kishte vlerësime superlative për veprën, do ta krahasonte Kadarenë me Heminguejin, madje në ditët në vijim do të konfrontohej ashpër me të dërguarin e KQ të PPSH<sup>387</sup>. Kjo ngjarje riktheu masat ndëshkimore ndaj profesor Luarasis. Ai u përjashtua sërish nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Shtohet gjithashtu edhe masa e survejimit të tij, tanimë edhe për faktin se ishte martuar me profesoreshën sovjetike, Maja Poljakova.

Skënder Luarasi e jetoi totalitarizmin stalinist shqiptar duke u strehuar në studimet e tij për patriotët e shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare; duke i dhënë zë në shqip Shakespear-it, Goethe-s, Byron-it, Longfellow-s, Witman-it, etj.; duke u përpjekur të prodhojë letërsi të mirë; si dhe duke ushqyer mendjet e studentëve të katedrës së anglishtes. Nuk ka dyshim që komunizmi e zhgënjeu revolucionarin përparimtar, por ai nuk reshti kurrë së ngritur zërin, ndonjëherë edhe me tone të larta, për të kërkuar të drejtën e tij. Për oficerët e Sigurimit të Shtetit ai ishte njeriu "që pikëpamjet armiqësore i kishte shfaqur vazhdimisht ... ai ishte i pakënaqur dhe kurrë nuk kishte për të ndryshuar"<sup>388</sup>. Kurse ai vetë kërkonte të ndryshonte mendësinë e studentëve të tij, duke shpresuar "të krijonte" njeriun e lirë në vend të "njeriut të ri". Ai përpiqej që "nëpërmjet gjuhës angleze t'i edukojë studentët që mësimet dhe parimet të mos i gëlltisnin kallëp, por t'i kthejnë në bindje dhe atyre bindjeve t'i qëndrojnë besnikë". Skënder Luarasi ishte karakter i fortë, me opinione të forta, të cilat jo gjithmonë i shprehte me qetësi. Në kushtet e një jetese pa asnjë hapësirë lirie, edhe atij i është dashur ndoshta të bëjë herë pas here ndonjë kompromis me veten, por gjatë gjithë jetës së vet besoi se kultura është rruga e vetme drejt përparimit, prandaj urrente mediokritetin dhe servilizmin. Në jetën e tij aspak e lehtë besoi fort te liria dhe, pavarësisht se jetoi në frustrimin e survejimit deri sa vdiq më 27 prill 1982, ai mbeti, ashtu siç Lasgush Pogradeci e cilësonte "mik i shtrenjtë, patriot i madh, demokrat i madh, "sherrxhi" i madh"<sup>389</sup>.

386. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 85. Raportim i 20 shkurt 1955.

387. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 128-129. Informacion i kryetarit të Degës II, Raqi Zavalanit, 28 tetor 1964.

388. AIDSSH, Dosje formulare 2823-A, Skënder Luarasi, fl. 154. Raporti i punëtorit operativ, 5 dhjetor 1965.

389. Myslim Islami, "Prof. Skënder Petro Luarasi, personifikim i problemit shqiptar", ... f. 104.

# Petro Marko



# Një vullnetar jashtë radhëve

Përfshirja e Petro Markos në hapësirën e një polemike të përgjithshme politike rastis që të ketë një datë nisjeje – të paktën nëse i përmbahemi rrëfimit autobiografik që shkrimtari hedh në letër, siç deklaroi, në muzg të viteve 1970. Duke folur pikërisht për këtë farësoj zanafille, studiuesi i letërsisë Aurel Plasari rreket t’i japë zhvillimit të këtij të fundit një frymëmarrje më të gjerë se rrethanat shqiptare të asaj kohe.

**NGA EDON QESARI**

*Futuni për një çast në shpirtin e një njeriu që mbeti vetëm, pa ndjenja, i mbuluar në dhe, në një natë thëllimi, me trup të dërrmuar... Dhe shokët e tij janë vvarë të gjithë ose dhe ata të pakë që mbetën të gjallë të jenë tërhequr dhe armiku i tërbuar të ketë shkelur edhe tokën e Katalonjës! Kështu mbeta unë...*

*Petro Marko, "Hasta la vista"*

Përfshirja e Petro Markos në hapësirën e një polemike të përgjithshme politike rastis që të ketë një datë nisjeje – të paktën nëse i përmbahemi rrëfimit autobiografik që shkrimtari hedh në letër, siç deklaroi, në muzg të viteve 1970 (Marko, fq. 76-77). Duke folur pikërisht për këtë farësoj zanafille, studiuesi i letërsisë Aurel Plasari rreket t’i japë zhvillimit të këtij të fundit një frymëmarrje më të gjerë se rrethanat shqiptare të asaj kohe:

Debati në fjalë lidhej me një situatë jo vetëm shqiptare: edhe në Europë ishte ndërkoha e “ankesave” të mëdha të artistëve. Të artistëve të bindur se shoqëria – ose më gjerë qytetërimi – u bënte padrejtësi, se borgjezia që kishte zëvendësuar aristokracinë kërkonte prej artit të lajkatonte dhe madje kurtizonte shijen e saj mediokre, se artistit i duhej të flijonte personalitetin e vet, temperamentin, deri edhe stilin nëse nuk donte të vdiste – heroikisht – urie. (...) Në Europën e modernizuar kjo pakënaqësi i ndau opinionet e njerëzve të letrave dysh. Nga njëra anë, një opinion romantik, që e refuzonte të tanishmen në emër të nostalgjisë për të kaluarën, duke shkualifikuar borgjezinë dhe duke rivendikuar aristokracinë. Nga ana tjetër, një

opinion që nuk e kërkonte zgjidhjen te kthimi në të kaluarën, por te një e ardhme më e mirë, me liri dhe të drejta më të mëdha sociale. (...) Në Shqipëri kjo pririje e dytë mund të kishte jetë të vërtetë. Prireja e parë, ajo e imazhit të një aristokracie bujare e të ndriçuar, as që mund të ekzistonte në një vend si Shqipëria me të një të kaluar “anormale” në krahasim me Europën, të një feudalizmi anakronik krejt të palakmueshëm. (Plasari, *Petro Marko mes zilisë dhe lavdisë*)

Lypet të theksojmë, megjithëkëtë, se një pjesëmarrje e këtij lloji shfrytëzon dukshëm kushtet shoqërore – mënjane atyre kulturore, të vëna në lëvizje qysh në fillim të viteve 1920 – që erdhën duke u krijuar në nisje të asaj dekade, atëherë kur monarkia (e në përgjithësi struktura shtetërore) e drejtuar nga Zogu I duket se gëzon qëndrueshmëri politike të mjaftueshme. Nuk bëhet fjalë për një ecuri të pandërprerë, siç dëshmon historia jolineare e shumë prej organeve të shtypit në gjirin e të cilit zhvillohen shumë nga polemikat e përmendura më sipër. Vetë fati i dy organeve si “ABC” dhe “Bota e Re”, të cilat bartin dorën themeluese të Petro Markos – asokohe ende në të njëzetat – e që më bindshëm shfaqin një ngjyresë ideologjike të identifikueshme me krahun e majtë të botëkuptimit politik, është tregues domethënës që nuk shkëputet nga një kontekst më i gjerë (ku organet alternative, siç komentonte “Bota e Re” «vdisin si foshnjat e parritura mirë», nga një «sëmundje e përhapur që quhej mungesë e lirisë së shtypit»<sup>390</sup>). Siç do të shohim, revista “ABC” pati jetë fare të shkurtër, teksa vetëm një numër i saj, në mars të vitit 1936, pa dritën e botimit në Tiranë; ndërsa “Bota e Re”, me qendër në Korçë dhe që hamendësohet të ketë shërbyer si tribunë për lëvrimin e ideve të celulës së atëhershme komuniste të atij qyteti, nuk do të zgjasë më shumë se disa muaj, nga prilli i po 1936-s deri në shkurt të vitit pasardhës. (Cornis Pope; Neubauer, fq. 93)

Sidoqoftë, mund të pohojmë se deri në përmbyllje të asaj që gjykohet si përvoja më liberale përgjatë qeverisjes mbretërore – periudha kur në krye të ekzekutivit qëndron figura e Mehdi Frashërit (tetor 1935 – nëntor 1936) – gjallëria e publicistikës shqiptare dhe moria e pozicionimeve ideore-politike të shprehura përmes saj, nuk do të kenë të krahasuar me asnjë nga etapat pararendëse (Puto, fq. 541)<sup>391</sup>. Filloi “liria e shtypit”, pra gazetat e reja tani shkruanin më lirisht. Pena e Tajar Zavalanit dhe e Branko Merxhanit, ajo e Vangjel Koçës dhe e Ismet Totos, ajo e Nebil Çikës dhe e Gjergj Bubanit nisën të shkruajnë artikuj që zbulonin gjendjen e keqe të vendit dhe polemizonin me kontradiktat e thella historike (Marko, fq. 141).

E tillë është fryma që Marko gjen në tetor të vitit 1935, kur kthehet në Tiranë i thirrur nga Vangjel Koça dhe Branko Merxhani. Kanë kaluar vetëm pak muaj qysh kur ishte larguar për në Korfuz, në mesin e rrokopujës që ndoqi kryengritjen e dështuar të Fierit, një pjesë të krerëve të së cilës Marko i kishte parasysh mirë. Njihej me disa syresh që në kapërcyell të viteve 1932-1933, si pati hequr dorë nga vazhdimi i shkollës së lartë për shkaqe të lidhura me pamundësinë për të gjetur bursë. Ai i mesit të viteve '30 ishte një opozitarizëm që nuk vinte si pasojë e një formimi të caktuar intelektual. Përkundrazi, «[t]ë gjithë ne e deshëm komunizmin pa e njohur se ç'ishte komunizmi» dëshmon vetë Marko (Marko, fq. 162). Në këtë mënyrë, kalimi i tij nga qëndrime kryesisht mospërfillëse ndaj zhvillimeve të përgjithshme politike, në një angazhim më organik, vjen më së shumti në vazhden e përjetimit të marrëdhënieve shumë të ndera që Marko – i ri dhe i papunë – vendos me administratën shtetërore dhe shërbimet ndaj qytetarit (*po aty*, fq. 82-83).

390. Citimi është marrë nga një artikull i shfaqur në numrin 2 të “Bota e Re”, dalë më 30 prill 1936 (Koka, fq. 250).

391. Puto sqaron dhe se si një atmosferë e atillë për shtypin u krijua në rrjedhën e disa ndryshimeve ligjore, të propozuara që në prill 1933, mbi nenin 197 të Statutit Themeltar të monarkisë, duke siguruar kështu se « [l]iria e shtypit dhe e fjalës është e garantuar », pa varësisht se një raport paraprak justifikues nga ana e një komisioni të posaçëm parlamentar saktësonte se roli i këtij sektori vlerësohej si « bashkëpunëtor i shtetit ». Çka, njëkohësisht me sanksionimin e lirisë në ushtrimin e shtypit, përkufizonte dhe rrafin brenda të cilin ky duhet të vepronte, « duke njohur të drejtën e censurës preventive me ligj jo vetëm në raste të jashtëzakonshme, por edhe atëherë kur shihet e arsyeshme dhe e dobishme ». (*po aty*).



Në prill të vitit 1936, ndërsa atmosfera intelektuale e Tiranës vazhdonte të ishte nën ndikimin e rrezatimeve “liberale”, Petro Marko bashkëthemelon revistën jetëshkurtër “ABC”, në një kohë kur rrethanat politike të krijuara po nxisnin hapjen e disa organeve të karakterit demokratik.

Rrethanat, paskëtaj, janë të tilla që vetëm e çojnë në skaj një prije të tillë opozitare që Marko nuk vonon ta ndajë me të tjera grupe në Tiranë. Përftimi i Zogut në përfytyrimin e përgjithshëm si aleat i Musolinit, e ashpërsia e këtij të fundit ndaj çfarëdolloj veprimtarie antifashiste (e konsideruar *tout court* komuniste)<sup>392</sup> veç thëllonte kahjen e opozitës së heshtur brenda vendit (Puto, fq. 535). Tonet me frymëzim nolian, ku nacionalizmi përzihet me një *discursus* të përgjithshëm majtist, janë të gjithëgjendshme, ndërkaq që figura e monarkut shihet si përdhosje, *in primis*, e një tradite patriotike që zinte fill nga periudha e lëvizjeve antiosmane. Përkundër, përpjekja propagandistike e Tiranës, për ta paraqitur kryengritjen e zbuluar të Fierit si një përbatim bolshevik<sup>393</sup> dha ndihmesën e vet duke e trajtësuar antizogizmin si të majtë, paçka përbërjes së shumëllojshme, e shpesh kontradiktore, në organikën e kësaj të fundit<sup>394</sup>. Nuk ishte assesi një risi, pasi që në krye të herës regjimi i ishte përshtatur një *modus operandi* gjerësisht ballkanik të ushtrimit të autoritetit politik kundrejt formave të ndryshme të opozitarizmit, duke përcaktuar si “bolshevizëm” apo “komunizëm” çfarëdolloj identiteti kundërshtar (Frashëri, fq. 31). E pavarësisht se ata që akuzoheshin si “agjentë të Moskës” jo gjithmonë kishin lidhje organike me Kominternin, është e pamohueshme se përpunimi ligjërimit antagonist në panoramën politike evropiane të viteve 1920–1930, gjen pikënisje pikërisht te Bashkimi Sovjetik (Pons, fq. 41).

392. Mbi vitet e komunistëve italianë (ashtu si dhe të tjera formacionesh politike antifashiste) në klandestinitet, shih: Spriano, *passim*.

393. Pësia e përbërjes komuniste – apo më saktë, me frymëzim komunist – në grupin tejet heterogjen që ndërmori organizim e kryengritjes së Fierit, është gjykuar si mjaft anësore edhe nga historiografia e periudhës së RPSSH. Për më gjerë mbi ngjarjet, shih: Belegu, *passim*. Përpos, Puto vë theksin tek pjesëmarrja e rëndësishme në kryengritje e Riza Cerovës, i njohur i Markos dhe i sapokthyer nga Bashkimi Sovjetik. (Puto, fq. 535–536) Mbi jehonën ndërkombëtare të kryengritjes: Smirnova, fq. 186–190.

394. «[K]ryengritja ishte për shpëtimin e popullit nga tirania dhe nga rreziku i pushtimit italian» dëshmon Marko (Marko, fq. 136).

Nga ana tjetër, më shumë se brenda një suaze marksiste, Marko lë përshtypjen se po i qaset një rryme të mbështetur mbi baza mjaft klasike republikanizmi radikal<sup>395</sup>. Njësimi i kundërshtisë së tij ndaj regjimit në Shqipëri me njëfarë majtizmi militant kishte nisur të kryhej me arratisjen e parë drejt Greqisë<sup>396</sup>, vend prej të cilit autoritetet shqiptare dyshonin se e kishin prejardhjen disa prej prurjeve radikale që i druheshin më tepër<sup>397</sup>. Përfshirja në valën e diasporës së atjeshme, ku strehoheshin emra si Spiro Koleka dhe Omer Nishani, na jep një pasqyrë plotësuese të mendimit politik mbi të cilin themelohej ajo botë e larmishme veprimtarësh opozitarë. Në këtë kuptim, termi “revolucionar” (apo më shpesh “nacional-revolucionar”), i përdorur asokohe për të karakterizuar botëkuptimin e shumë prej emrave që do të shquhen si personalitete të lidhur, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, me qëndrime të majta, shpreh një veprimtari politike të vagullt. *Casus*-i përbashkues kishte të bënte me kundërshtinë ndaj figurës së Ahmet Zogut në krye të shtetit shqiptar dhe më gjerë ndaj trajtës monarkiste të këtij të fundit – çka përputhej, gjithsesi, me taktikën gjithëpërfshirëse të fronteve popullore të shpallur më 1935 nga ana e Kominternit<sup>398</sup>.

Megjithatë, historia e hershme e organizatës mërgimtare KONARE, e dalluar për larmishmërinë politike të rangjeve të saj, nuk kishte qenë dëshmi e ndonjë vullneti uniformizues (Frashëri, fq. 33). E vagullt mbetej ngjyresa shoqërore – e përzier pashmangshmërisht me shprehi nacionaliste – në leksikon e përdorur edhe nga të tjera formacione më homogjene dhe shprehimisht të majta<sup>399</sup>. Nuk duket se gjërat shkojnë drejt një kthjelltësie programore, as kur KONARE-ja, në vitin 1927, pasohet nga Komiteti i Çlirimit Nacional – rrjedhje pikërisht e pamundësisë për të ndarë të njëjtën strehë politike mes të pranishmëve në të parën (Koka, fq. 162-163). Në organin e kësaj organizate të dytë, “Liria Kombëtare”, ishte më e dallueshme prania e një semantike marksiste-leniniste – për herë të parë flitet për federatë mes popujve të Ballkanit, siç vë re Dervishi (fq. 50-51); por ikja përfundimtare në Amerikë e Nolit, kryetar i KÇN-së dhe figura më qendrore e krejt antizogizmit, ia shenjojnë fundin andej nga mesi i viteve 1930 (Jorgaqi, fq. 76; Tako, fq. 218; Koka, fq. 216). Bashkë me KÇK-në, e cila bie në batak të thellë financiar<sup>400</sup>, tkurret plotësisht dhe gjallëria e formave të tjera opozitare të mërgatës, përfshirë ato që i kishin ndenjur larg hegjemonisë organizuese të Kominternit. Kur vetë Markoja takohet, në fund të viteve '30, me një pjesë të mirë personalitetesh antizogiste që strehoheshin në kryeqytetin francez (Ali Këlcyra, Beqir Valteri, Rexhep Mitrovica), ai shprehet se « [k]ëta politikanë ëndërronin që Zogun ta hiqnin Fuqitë e Mëdha, ashtu siç e sollën në fuqi, dhe pastaj këta të ktheheshin në Shqipëri e të ishin në krye të qeverisë, të pushtetit (në dispozicion të Fuqive të Mëdha që kishin interesa në Shqipëri) » (Marko, fq. 263).

395. Çka duket qartë kur Marko tregon një episod nga jeta e tij e mëvonshme si mësues në një fshat të krahinës grekofone të Dropullit: « U flisja (banorëve të fshatit) dhe për padrejtësitë. Madje, kur bëheshin zgjedhjet për kryeplakun, u thosha “Çdo vit bëhen zgjedhje për kryeplakun e fshatit, kurse për monarkët nuk ka kurrë zgjedhje. Ai që është në fron, dhe që fronin e ka marrë me gjak, qëndron aty gjersa të vdesë, qoftë i mirë, qoftë i lig...” Ata më dëgjonin. Ndonjëherë u lexoja edhe ndonjë shkrim greqisht të organit të rinisë komuniste greke *I protopori*. » (Marko, fq. 105). Sidoqoftë, në Dropull Marko ka mundësi të bjerë në kontakt me organe shtypi të majtë që vijnë, në formë të jashtëligjshme, nga Greqia.

396. Është e paqartë nëse Marko ikën në Greqi pasi Asim Vokshi, asokohe ende i përfshirë në rangjet e ushtrisë shqiptare, e paralajmëron për rrezikun që i kanoset pasi ka rënë në sy tek autoritetet shtetërore si propagandues komunist, apo, siç tregon më vonë, me qëllim për të vazhduar studimet universitare në Athinë (Marko, fq. 116 e 125).

397. Në maj të vitit 1936, Ministria e Punëve të Brendshme lëshonte një qarkore në të cilën udhëzonte masa për t'u marrë në drejtim të parandalimit të propagandës së Radio Moskës, valët e së cilës lundronin në jugun e Shqipërisë përmes gjuhës greke (*Dokumente e materiale historike...* fq. 363).

398. « Sipas urdhrat të Kominternit, ne, si komunistë, duhet të kemi në ballë të çdo lëvizjeje popullore kundërfeudale. Në këtë organizatë ka edhe elementë heterogjenë, po ne duhet të jemi në krye për të forcuar lëvizjen tonë revolucionare » – i bën të qartë Asim Vokshi Markos (Marko, fq. 135). Për më shumë rreth taktikës bolshevike të fronteve popullore, shih: Haslam, fq. 673-691; Pons fq. 98-111.

399. AQSH/AP, Fondi nr. 16 i Grupit Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik, Lista nr. 1, Dosja 15, fq. 14.

400. Fan Noli, ende në fund të viteve '30, u dërgonte të holla Ali Kelmendit, siç dëshmon ky I fundit nga Parisi: AQSH, Fondi Fan Noli (nr. 14), Dosja 103, *Letër e Ali Kelmendit për Fan Nolin*, më 03.04.1938, fq. 37.



Më e koklavitur qe trashëgimia politike e atyre që kishin kalëruar komunizmin në selinë e tij qendrore, në Moskë, e prej të cilëve pritej themelimi i një partie të mirëfilltë. Njerëz si L Lazar Fundo, Tajar Zavalani, Sejfulla Malëshova, Selim Shpuza, Ali Kelmendi do të ndikojnë drejtpërdrejtë në pjekurinë politike të Markos (veçanërisht Zavalani, të cilin Marko e konsideronte si veprimtarin më energjik ndër komunistët vendas – *po aty*, fq. 200). Kthimi i tyre në Shqipëri në fund të viteve '20, me porosi të vetë Dimitrovit (Dervishi, fq. 88–89), sidoqoftë, nuk do t'i japë hov njëtrajtësimit të lëvizjes<sup>401</sup>. E pavarësisht se qëndrimi i tyre në Bashkimin Sovjetik do t'i pajiste ata, në sytë e të tjerëve, me breroren e shenjtë të komunizmit, Marko dëshmon për një tension mes militantës politike dhe përshtypjeve që ata djem të rinj kishin përreth Bashkimit Sovjetik.

[K]ëta shokë shqiptarë, që më parë kishin qenë të KONARE-së dhe që shkuan në Bashkimin Sovjetik, qëlluan që të ishin aty kur ende BS ishte shumë i varfër, ishte koha kur ende kishte korrente të ndryshme, kur aty ishte ende Trocki. Stalini ende nuk e kishte konsoliduar mirë pushtetin dhe trazirat ishin të shumta. [...] Por ata shikonin varfërinë e masës. Kjo zgjati gjer në fillim të viteve '30, kohë kur shumica e shqiptarëve aty u larguan dhe erdhën këtu me përshtypjet e atmosferës që lanë atje. Nuk ishin entuziastë, ishin të lumtur që kishin lënë atë vend dhe kishin ardhur këtu, ku e ndienin veten më të gëzuar dhe të sigurt. Ishin këto arsye që shumica e shokëve tanë që u kthyen nga Bashkimi Sovjetik dështuan, me gjithë përkrahjen e besimin e madh që kishim ne ndaj tyre. Ata, duke na parë ne plot entuziazëm dhe besim ndaj komunizmit, nuk mund të shpreheshin kundër, se do të quheshin tradhtarë dhe renegatë (Marko, fq. 165–166)<sup>402</sup>.

Një përshkrim emblematic i këtyllë, pavarësisht se nuk bart emërtesë, duket se i adresohet pikërisht figurës së Tajar Zavalanit, një kujtim i dashur për Markon, e që në fund të asaj dekade, pas ekzekutimit të të vëllait në Bashkimin Sovjetik, do të braktisë vullnetarisht aspiratat politike të rinisë së tij.

Në prill të vitit 1936, ndërsa atmosfera intelektuale e Tiranës vazhdonte të ishte në ndikimin e rrezatimeve “liberale”, Petro Marko bashkëthemelon revistën jetëshkurtër “ABC”<sup>403</sup>, në një kohë kur rrethanat politike të krijuara po nxisnin hapjen e disa organeve të karakterit demokratik<sup>404</sup>. Në të do të përfshiheshin emra të rëndësishëm të politikave kulturore të periudhës socialiste, si Dhimitër Shuteriqi dhe Shevqet Musaraj. Paraprakisht, qysh prej kthimit nga Greqia në vjeshtë të vitit pararendës, kishte kryer një përvojë si artikullshkrues në revistën “Illyria”, me pseudonimin DEMO-KOTI (Demokrat Komunisti). E pavarësisht se me atë rast, vullsi politik i kritikës sociale të shprehur përmes skicave të tij nuk kishte kaluar pa marrë qortime, me hapjen e “ABC”-së, si Marko, ashtu edhe të tjerët nuk u

---

401. Më herët ishte dalluar se mjetet e parapërgatitjes teorike dhe propogandistike ishin të mangëta, çka vononte krijimin e kuadrove të mirëfillta partiake. Siç vëren Sejfulla Malëshova në një letër drejtuar Nolit: AQSH, AP, F. 16, D. 16. / Ap. V, dok. 25, I vitit 1929. fq. 6; por edhe Ali Kelmendi tek i raporton Kominternit: AQSH/AP, Fondi nr. 15 i dokumenteve të Kominternit për Shqipërinë, L. 1, D.19, Ali Kelmendi, *Raport mbi aktivitetin e tij dhe të grupeve komuniste në Shqipëri*, 5 dhe 7 mars 1936.

402. Për një qasje përmbledhëse në trajtimin e marrëdhënieve mes pushtetit sovjetik të konsoliduar në duart e Stalinit dhe militantës ndërkombëtare komuniste, si dhe intelektualëve të majtë të strehuar në Bashkimin Sovjetik, *shih* Service, fq. 190–212, si dhe David-Fox, fq. 526–550. Për një vështrim interpretues më të majtë, *shih* Hobsbawm, fq. 28–35. Në fund të viteve 1980, një gazetar amerikan i quajtur Stephen Suleyman Schawrtz hodhi në faqet e “New York Times”-it (të datës 24 janar 1988) tezën se në vitet 1930 qarkullonte nëpër Evropë një njësi vrasësisht të cilët, të porositur nga Kremli, eliminonin gjithë intelektualët e majtë që kishin shfaqur, haptazi ose jo, qëndrime kundërshtuese ndaj liderit stalinist në Bashkimin Sovjetik. Vite më vonë, Schawrtz do t'i kurorëzojë hulumtimet e tij në vëllimin *Intellectuals and Assassins: Writings at the End of Soviet Communism* (Anthem Press, New York 2001), ku do të pohojë se edhe intelektual i mirënjohur gjerman Walter Benjamin nuk kishte vrarë veten, sikundër mendohet gjerësisht ende sot, por është eliminuar nga një *killer* filsovjetik.

403. «Ne ishim për zhurmën, alarmin, paçka se revista mund të mbyllej – tregon Markoja, teksa pohon se në redaksi mbërrinin kërkesa për të botuar artikuj përshkrues mbi gjendjen e punëtorëve të naftës në Kuçovë – Na kishin thënë disa herë shokët se duhej të shfrytëzonim këtë rast të “shtypit të lirë” që la përkohësisht qeveria liberale e Mehdi Frashërit» (*po aty*, 151).

404. Epiqendra e një prirjeje të tillë duket se ishte Korça, ku përgjatë dyvjeçarit “liberal” do të hapen edhe dy revista të tjera me orientim kah boshit të majtë, “Rilindja” dhe “Bota e Re” (Koka, fq. 250).

tutën. Toni i artikujve mbetej i ngjashëm me atë të një deklamimi nga maja e një tribune popullore<sup>405</sup> e ku qasja klasore parashihte «kryengritje të shpirtit dhe të barkut»<sup>406</sup>. Teprimi i një qasjeje editoriale të atillë, në të cilën kritikohej ashpër gjendja sociale në vend, ku Ferri i Dantes qe hiçgjë në krahasim<sup>407</sup>, apo politikat tregtare mes Shqipërisë dhe Italisë, i bëri përshtypje edhe Branko Merxhanit, i pranishëm në bordin redaksional të revistës; por edhe Migjenit, si ish-bashkëpunëtor tek “Illyria” apo tek “Bota e Re”<sup>408</sup> dhe vëzhgues e njohës i realitetit politik në zhvillim në Tiranë. Pa mbushur ende muajin, ndërsa ende përgatitej botimi i numrit të dytë, “ABC”-ja u mbyll. Materiali i përgatitur për një organ të tillë “bolshhevik” – siç e pati gjykuar Ethem Totoja, ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë Frashëri – qarkulloi ilegalisht. Arsyetimi që u përdor nga strukturat shtetërore që Marko thotë se i takoi deri në nivelin më të lartë – deri vetë kryeministrin në prani të Këshillit të Ministrave (Marko, fq. 153-155) – ishte se botuesit kishin kërkuar leje për një revistë artistike-kulturore, ndërkaq që karakteri i numrit të parë të saj ishte haptazi politik. Çka e shpuri Petro Markon për herë të parë para gjykatësve, në kushtet e veprimtarit si redaktor politik i “ABC”-së – në prani edhe të Asim Vokshit, në karrigen e të akuzuarve – duke e dënuar me gjashtë muaj internim.

Tërheqja e Markos nga polemikat e kryeqytetit nuk do të zgjasë shumë, ngase zbatimi i urdhrat për internim nuk do të ndiqet me përpikëri nga autoritetet e rendit të kohës. Në fund të verës ai gjendet sërish në Tiranë, në rolin formal të administratorit të revistës “Përpjekja shqiptare” të themeluar nga Branko Merxhani (Cornis Pope; Neubauer, fq. 93). Këto zhvillime ndodhin ndërkaq që jeta politike e vendit haset me disa risi jo krejt të papritura. Në nëntor të vitit 1936, kreu i shtetit i tërheq mbështetjen ekzekutiv të Mehdi Frashërit, duke risjellë një frymë konservatore në qeverisjen e Shqipërisë. Gjë që duket edhe në dikasterin që udhëheq censurën mbi organet e shtypit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, që gjën në krye të saj sërish figurën e Musa Jukës. Pasojat janë të menjëhershme, pasi, shprehet Marko, i kërkohet “Përpjekjes shqiptare” që të deklarohet publikisht si revistë jokomuniste (Marko, fq. 168), ndonëse vetë prirjet politike të Merxhanit, si themelues dhe ideues i saj, vështirë se puqeshin me botëkuptimin e së majtës kritike (Kulla, fq. 29). Sidoqoftë, kaq mjafton që Merxhani të vendosë t’i përshtatet udhëzimit të autoriteteve, duke e pagëzuar numrin e parë të revistës me një artikull me frymë programatike të titulluar “Pse nuk jam marksist”<sup>409</sup> – e që hedh dritë mbi arsyet e largimit të Markos nga bordi i “Përpjekjes shqiptare”, duke e shtyrë t’i bashkohej të tjera organeve, si “Vatra”, “Arbëria” dhe “Shtypi” – të mbështetura me fonde publike – më të heshtura për sa i përket vëmendjes ndaj zhvillimeve socio-politike. Për njëfarë kohe shkëputet nga kryeqyteti dhe zhvendoset në Korçë, ku merr pjesë me një artikull të karakterit studimor mbi letërsinë që po lëvrohej asokohe në Shqipëri, në faqet e revistës “Bota e Re” – për botimin e së cilës kishte ndihmuar në prill të vitit 1936, fill pas ndalimit të “ABC”-së (Marko, fq. 170 dhe 173). Siç sqaron Plasari, [a]rtikulli u kundërvihet nënkuptueshëm një vargu artikujsh të “Illyria”-s, me mëtime gjithashtu programore, të Ernest Koliqit dhe të Vangjo Nirvanës. Përkundër debatit të tyre lidhur me marrëdhëniet e shkrimtarit me popullin, Marko fut konceptin e “turmës”, duke ngulmuar për një letërsi që “të pasqyrojë dëshirat, ëndrrat, idealet, jetën e turmës”. (...) Denoncimi politik-futurist i “shkrimtarëve demagogë”, siç i quan, nga ana e Petro Markos me artikullin e përmendur: “Sot ne kemi shkrimtarë demagogë, kemi shkrimtarë që shkruajnë ose për kolltuk ose për para ose për... , prandaj jo, nuk meritojnë kurrë të mburren me emrin e shkrimtarit. Janë tradhëtorët e letërsisë së palerë, asaj letërsije që bashkë me jetën tonë përpigjet të dalë nga errësira në dritë. Dhe këtë nuk mund ta nxjerrin kurrë pseudo-intelektualët dhe pseudo-shkrimtarët që me penën e tyre lajkatore nxijnë më tepër sheshin e turbullt e kaotik literar [...] Dhe një njeri i tillë, që mundohet duke nxirë kartëra për

405. «Sytë do t’i drejtojmë nga ana e popullit që të shohim nga se vuan dhe ç’janë nevojat e tij» “ABC”, 1 mars 1936.

406. *Po aty*.

407. *Po aty*.

408. Tek “Illyria”, 7 mars 1936, Migjeni kishte botuar “Recitalin e malësorit”, ndërsa tek “Bota e Re”, më 15 tetor, do të hedhë për shtyp “Legjendën e misrit”.

409. “Përpjekja shqiptare”, nr. 4, 5, 6, botuar në revistën Mapo, nr. 192, 19 shkurt, 2011, fq. 23.

qëllime vehtjake, le ta dijë se dielli nuk mbulohet me shoshë, le ta dijë fare mirë që dëmi që përpiqet t'i sjellë turmës vetëm e vetëm për të kënaqur dëshirat e tij do të kthehet ndonjë herë mbi vehte. Patjatër do të marrë shpërblimin e merituar [...] Se duhet ta dimë që disa të paguar, që hiqen flamurtarët e rinisë që shkruan dhe që, me vizat e tyre t'importuara ose të blera, mundohen ta ndryshojnë fare rrugën që shpie për në brigjet e një shqiptarizme të kulluar, për në drejtime që ata vetë s'i dinë. Ata duhen dënuar. Dhe dënimi më i mirë i tyre është lufta e përbuzjes dhe e djegies së paçavurevet të tyre...” (Plasari, *cit.*).

Rreshta që paralajmërojnë një politizim të mëtejshëm të penës së Markos, deri në pjesëmarrjen e tij, pak më vonë, në Konferencën e Shkrimtarëve Antifashistë që mbahet në Valencia të Spanjës, gjatë luftës së atjeshme civile (Marko, fq. 225). Për momentin, gjithsesi, ndarja me Merxhanin mbërrin kështu në pikën e vet kulmore, pasi përfshirja në veprimtarinë editoriale të “Botës së Re” – revistë jo fshehtas kritike ndaj “neoshqiptarizmit”<sup>410</sup> – do të shënojë kësisoj dhe pozicionin politik përfundimtar të Markos në një rrafsh antagonizmi social të shënjestruar nga qeveria e Zogut (*Dokumente e materiale historike...*, fq. 394-395).

Prania në kryeqendrën e Shqipërisë juglindore i dha mundësinë Markos të kishte marrëdhënie më të drejtpërdrejta me elementin e majtë vendas, të organizuar përreth grupit “Puna”<sup>411</sup> – pararendës i celulës komuniste të Korçës<sup>412</sup> – që do të shpërndahet në shkurt 1937 në vazhden e masave të zbatuara nga autoritetet shtetërore kundër atyre që shiheshin si mjete propagande kundërqeveritare (Koka, fq. 247)<sup>413</sup>. Revista dyjavore “Bota e Re” ishte shprehi e drejtpërdrejtë e këtyre rrethanave socio-politike, duke shërbyer si mbistrukturë e tyre, deri sa ndjek dhe vetë fatin e “Punës”, duke u mbyllur në të njëjtën kohë. Si e tillë, revista mund të konsiderohet si grahma e fundit e lëvizjes së vënë në veprim nga ndikimi i qeverisë “liberale” mbi shoqëri; siç duket dhe qartë nga fryma republikane e deri-diku radikale që shfaqet në kolonat e saj<sup>414</sup>.

Në këtë kuptim, më shumë se brendia e artikujve të shfaqur në numrat e “Botës së Re”, te të cilët është e rrokshme një frymë e përgjithshme progresiste dhe polemike ndaj klerit<sup>415</sup>, e cila bënte thirrje për pjesëmarrje më të gjerë popullore në vendimmarrje politike – e ku leximi klasor i marrëdhënieve shoqërore<sup>416</sup> mbetet përgjithësisht i mbështjellë nga një përdorim i vazhdueshëm i kryefjalës “përparim”, bash si antonim i gjendjes sociale ekzistuese<sup>417</sup> – është rrethi në të cilin revista zhvillohet e lexohet, që bart një rëndësi të veçantë. Kështu që pavarësisht se kontributi intelektual i Markos në faqet e saj ngelet modest, ajo çka ka rëndësi në këtë seli është të theksohet ndikimi që atmosfera tërësore pati

410. Për më shumë, *shih* kritikën e shfaqur ndaj rrymave të mendimit në nr. 14 të “Bota e Re”, 30 tetor 1936, fq. 16-18.

411. Për t'u dalluar nga shoqëria sindikaliste “Puna”, e organizuar përreth punëtorëve të sektorit të naftës në Kuçovë (Frashëri, fq. 121), me qendër në atë qytet, aktiviteti i të cilës mbyllet andej nga fillimi i vitit 1936, me shtypjen e njëres prej grevave të organizuar nga anëtarësia e saj. *Shih: Historia e Parisë së Punës së Shqipërisë*, botim II, 8 Nëntori, Tiranë, 1981, fq. 32-33.

412. Lypet të sqarohet se, për historiografinë zyrtare të RPS të Shqipërisë, grupi komunist i Korçës pati luajtur një rol parësor jo vetëm në themelimin e mëvonshëm të Partisë Komuniste (1941), por dhe më të dallueshëm, për shkak të besnikërisë së tij ndaj politikave të Kominternit, në dallim nga grupi komunist i Shkodrës, në gjirin e të cilit shumë anëtarë – e mes tyre kreu, Zef Mala – do të akuzohen, edhe *post-mortem*, si sektaristë apo trockistë. Për më gjerë, *shih*: Enver Hoxha, *Kur lindi Partia (Kujtime)*, 8 Nëntori, Tiranë, 1982, fq. 18-19; *Historia e Parisë së Punës*, *cit.* fq. 35.

413. Për frymën e majtë që ndihej në Korçë, për materialet me qasje komuniste që qarkullonin atje, si dhe shqetësimin e vazhdueshëm që shfaqte Ministria e Punëve të Brendshme për të atilla fenomene, *shih*: *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri dhe demokraci 1917-1941*, botim i Drejtorisë së Arkivave të Shtetit të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1959, fq. 366-414.

414. Numri i parë i revistës, dalë më 15 prill 1936, bart qartësisht një orientim kritik ndaj elementëve feudalë që konsiderohet se ende sundojnë jetën politiko-shoqërore të vendit (fq. 10-11). Prije kjo e cila vazhdon të thellohet me nxitjet kulturore për «fitimin e të drejtave qytetare» (nr. 10, 30 gusht 1936, fq. 22).

415. *Shih* “Bota e Re”, nr. 1, 15 prill 1936, fq. 12.

416. «Të gjitha klasat duhet të sakrifikojnë për t'i dhënë pak shpirt bujkut tonë », trumbetonte numri i parë i revistës (15 prill 1936), përmes penës së Tajar Zavalanit.

417. “Bota e Re”, nr. 8, 30 korrik 1936, fq. 1-2.

në formimin e tij si militant i një të majte e cila, siç u argumentua më sipër, nuk shkëlqente në lëmin e përpunimit teorik. Nëse vëzhgojmë kontekstin në gjithë përmasat e veta kohore, trajtësimi i një të majte në Shqipërinë e viteve 1930 nuk duket se shkëputet nga shembuj të tjerë europianë. Në të gjitha përvojat kontinentale, siç sqaron Pons, karakteri politik i lëvizjeve të ndryshme antisistem, pavarësisht veçantive lokale, ishte i mbryjtur me kategorizime të huazuara nga Bashkimi Sovjetik, fryt i lidhjeve që shumë individë me peshë në këto lëvizje kishin me Moskën (Pons, fq. 40–41).

E pavarësisht se në Korçë marrëdhëniet përbrenda vetë grupit komunist nuk ishin dhe aq të paqta – edhe përkundrejt orientimeve të Moskës, deri sa hasim edhe forma inkuizicioni ndaj të dyshuarish si trockistë (Frashëri, fq. 116–117) – është e pamohueshme se gëlonin ndjenja të fuqishme radikalizmi politik. Qëndrimi i Markos në Korçë, me gjasa, ka qenë jo pa fryte për konvertimin e tij përfundimtar, pasi, siç dëshmohet, moria e materialeve bibliografike që qarkullonin<sup>418</sup> dhe në përgjithësi vullneti veprimtar i grupeve të individëve me referenca politike të caktuara ishin në kulmin e zhvillimit të tyre pikërisht në kapërcyell të viteve 1936–1937 (*Dokumente e materiale historike...*, fq. 396–397). E qartë mbetet, mbi të gjitha, se do të jetë po ky *habitat* i cili do ta shtyjë Markon drejt angazhimit në Spanjë, në luftën civile në të cilën ishte pjesë e një interesimi gjithmonë e më të gjerë, në sajë të jehonës ndërkombëtare që ajo kishte përfutur. Për më tepër, grupi komunist i Korçës mbante lidhje organike me Përfaqësinë Komuniste Shqiptare në Paris, e cila vepronte si zyrë *plénipotentielle* e Kominternit për rekrutimin e vullnetarëve shqiptarë në luftën e Spanjës (Frashëri, fq. 128).

Në verën e vitit 1937, Petro Marko ndjek të tjerë veprimtarë të rinj që ishin nisur *déjà* për në Spanjë (mes tyre, Asim Vokshi, Skënder Luarasi), duke u përfshirë në radhët e brigadave ndërkombëtare të angazhuara në krahun republikan të luftës civile. Dalja nga Shqipëria nuk kishte qenë një ndërmarrje e lehtë, edhe sepse Tirana, zyrtarisht, kishte shpallur asnjëherë përballë një konflikti të brendshëm që po merrte përmasa ndërkombëtare të paprecedenta (*Dokumente e materiale historike...*, fq. 261). Përpara nisjes, siç dëshmon vetë, Marko porositet që t'i dorëzojë Llazar Fundos në Paris një raport ilustrues mbi gjendjen e në Shqipëri, të përgatitur nga Omer Nishani, të cilin Marko e takon në Korfuz (Marko, fq. 183). Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që kishte një militant dhe intelektual i angazhuar si Fundo<sup>419</sup>, asokohe ende i inkuadruar në gjirin e Kominternit (ose më saktë të seksionit ballkanik të Kominternit, me seli pikërisht në Paris – Spinelli, fq. 264–265), arrijmë të kemi një pasqyrë të qartë të shkallës së përfshirjes së Markos, së paku si element ndërlidhës, në ato dinamika politike, qëllimi fundor i të cilave ishte bashkimi mes elementëve të konsoliduar antizogistë dhe komunistëve nën suazën e Moskës. Organizimi i vajtjes së tij në Spanjë, ashtu si dhe për shqiptarë të tjerë, merret përsipër nga vetë Fundoja që luan rolin e ndërlidhësit në një kuadër më të gjerë angazhimi pro-republikan, të udhëhequr nga Kominterni (Bevor, fq. 177). Rreshtimi i Markos është kësaj tregues i rëndësishëm dhe kuptimplotë për të kuptuar, përtej tij, se në ç'degëzim të lëvizjes komuniste botërore kishte hyrë qeliza kryesore që për pak vite do të marrë barrën e themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare. Në një kohë kur tensioni brenda së majtës së përfshirë në luftën civile spanjolle, mes vullnetarëve të angazhuar në radhët e Partisë Komuniste Spanjolle (filo-sovjetike) dhe atyre të POUM-it (*Partido Obrero de Unificación Marxista*, subjekt politik i anëtarësuar në Internacionalen IV (trockiste)<sup>420</sup> do të rritet deri në përplasje fatale, me fare pak përjashtime – siç do të ishte rasti ndriçues i Fundos – majtëzimi shqiptar do të orientohet rreptësisht kah Moska. Në këtë vazhdë, Petro Marko do të jetë vetëm një ushtar, pavarësisht se vullnetar, duke përfutur kësaj dhe anëtarësinë në Partinë Komuniste për herë të parë (Marko, fq. 223).

418. Tekstet kryesore të dogmës marksiste-leniniste kishin nisur të përktheheshin që në gjysmën e dytë të viteve '20. Fan Noli ishte marrë posaçërisht me dokumentet udhëzuese të Kominternit (Dervishi, fq. 88).

419. Mbi rolin vendimtar të Fundos në themelimin e grupit komunist të Korçës, *shih*: Alexander, fq. 32. Në autobiografinë e tij, Marko shprehet bujarisht mbi cilësitë intelektuale dhe organizative të Fundos, duke e konsideruar mandej atë si frymëzuesin e statutit themelues të Ballit Kombëtar (Marko, fq. 197–200).

420. *Shih*: Alba – Schwarz, *passim*.

REPUBLICA POPULLORE E SHQIPËRISE  
 Mod. GJ. 57  
**6094**  
 VJETI 195

**GJYKATA E**

Nr. i Regj. Them \_\_\_\_\_  
 Data e ardhjes \_\_\_\_\_

Nr. i Vondimit \_\_\_\_\_  
 Data \_\_\_\_\_

**ANKUES**

*p. IV*

**PADEHUR**

*62-1949*

*Petro Marko*

**AKUZA**

*54 Flek*

*804 776*  
*Nr: 906*

**AKUZA**

*54 Flek*

**AKUZA**

*804 776*  
*Nr: 906*

AIDSSH, Dosje hetimore-gjyqësore nr. 6094 për Petro Markon

REPUBLICA POPULLORE E SHQIPËRISE  
 MINISTRIJA E P. MBRËNDESHME  
 Drejtorija e Punëve të Brendshme  
 QARKU *Shkup*  
 Nr. Regj. **4863 3415** Kategorija *1/B*

**DEKLASIFIKUAR**


**Dosja Formulare**

Kartë mbetëmeri **PETRO MARKO**

**AIDSSH**

AIDSSH, Dosje formulare nr. 3415 për Petro Markon

**PIETIA E PASËSHTRIMIT**



- 1) Emri i plotë, i shtesa MARKU PETRO MARKO
- 2) Vendi i lindjes Shkup Shkup dat-lin. 1918
- 3) Vendi i banimit Tetov
- 4) Vendi i punës shkup shkup shkup
- 5) Specialiteti \_\_\_\_\_ Profesionit shkup
- 6) Embejti shkup Shkollës shkup
- 8) Partimiteti \_\_\_\_\_
- 9) Driçgjirja shqiptore shkup
- 10) Shtetësi \_\_\_\_\_
- 11) ka qone i regjistruar ne parti ne vitin \_\_\_\_\_ ka qone i regjistruar ne parti ne vitin \_\_\_\_\_ (ne qofte se ne prej kuje ne perse) shkup shkup shkup
- 12) ne se ne pare ka qone i regjistruar ne parti te tjer
- 13) Përmbledhja e shkurtër e materialit të tij komprometues: shkup shkup shkup
- 14) E vendosja që ka qone: shkup
- 15) Porositimi i përcaktimit \_\_\_\_\_ (ose omnit periodhele)

PERSONI OPERATIV: shkup  
 (shkup)

SHEFI SEKSIONIT: shkup  
 (shkup)

Fletë regjistrimi për Petro Markon nga dosja formulare për të

Ashtu si pothuajse të gjithë shqiptarët e tjerë të pranishëm në frontin republikan – mes të cilëve Asim Vokshi, Skënder Luarasi, Veli Dedi dhe së shpejti Mehmet Shehu, – edhe Marko bëhet pjesë e brigadës “Garibaldi”, e përbërë më së shumti nga vullnetarë italianë, e të komanduar nga figura të njohura, asokohe dhe më vonë, të krahut socialist dhe komunist, mes të cilëve Randolfo Pacciardi dhe Luigi Longo (Pacciardi, fq. 41–42)<sup>421</sup>. Do të jetë pikërisht ky i fundit që do të japë lejen, siç dhe mbështetjen, për botimin në gjuhën shqipe të revistës informative të brigadave ndërkombëtare me titull “Vullnetari i lirisë”, numri i parë dhe i vetëm i së cilës del në nëntor të vitit 1937, në rreshtat e të cilës shfaqet dhe emri i Petro Markos (Montobio, fq. 118–160).

Pikërisht ky organ shtypi, qartazi himnizues ndaj Bashkimit Sovjetik, si dhe puna përgatitore e Markos në të bëhen shkas i një episodi emblemantik, në lidhje me një shkresë që Komiteti i Çlirimit Nacional me seli në Paris (i cili varej, përmes rendi arkitekturor shpesh të improvizuar, nga Përfaqësia Komuniste shqiptare që vetë vepronte nën suazën e Kominternit – Dervishi, fq. 128) dërgon në adresë të Longo-s. Pak a shumë shkresa kishte këtë përmbajtje: *Ne nuk e kemi dërguar aty Petro Markon të merret me vjersha, po e kemi dërguar për në front*. Nënshkruante Ali Kelmendi. U habita dhe më erdhi për të qarë. Ç’ ishte kjo shkresë kështu? Longoja më kërkoi t’i thosha se kush ishte ky Ali Kelmendi dhe ç’ mendoja unë. Unë e mblodha veten dhe thashë: – Unë kam ardhur këtu me vullnetin tim dhe nuk më ka dërguar Ali Kelmendi. Ali Kelmendi me shokët e tjerë të Parisit më përcollën. Besoj se Aliu do të jetë zemëruar pse nuk e dërguam revistën atje, po gjetkë. Nuk e kuptoj këtë qëndrim. Ç’ të them? Kemi marrë vesh se shokët e Komitetit tonë në Paris janë përçarë, janë cilësuar si tradhëtarë, prandaj nuk e dërguam atje revistën (Marko, fq. 223–224).

Nëse mbështetemi në rrëfimin e vetë autorit, episodi u mbyll me një përgjigje refuzuese që Longo-ja i dërgon mbrapsht kritikës të firmosur nga Kelmendi, duke pohuar autoritetin vetjak që Kominterni kishte mbi militantët e vet, çka përlligjte dhe detyrën që i ishte caktuar Markos. Përtej kësaj, çka shfaqet qartë është se në gjirin e mërgatës komuniste të strehuar në Paris tashmë janë thelluar ato kundërshti që do të çojnë në shpalljen përfundimtare të Fundos si heretik nga ana e Kominternit dhe *entourage*-it filo-stalinist në gjirin e komunistëve shqiptarë (Hamm, fq. 84)<sup>422</sup>. Kelmendi, pas një sërë dështimesh në përpjekjen përbashkuese të galaksisë komuniste të shpërndarë në Shqipëri, nuk gëzonte më mbështetjen e kolegëve të vet të Përfaqësisë Komuniste Shqiptare në Paris. Për çka madje ai ankohet në derë të Kominternit, duke e akuzuar Fundon si trockist<sup>423</sup>, që gjithsesi ishte tashmë në proces përfundimi të përvojës së tij komuniste, i zhgënjyer siç dukej nga spastrimet staliniste të kulmuara më 1938 me dënimin e Buharinit (Pano, fq. 190)<sup>424</sup>. Anatemimin e Kelmendit e ndjekin të tjerë<sup>425</sup>, duke shënuar kështu përfundimin e Fundos, ashtu si dhe të ndonjë të lëkunduri tjetër, si Zavalani.

421. Për t’u shënuar mbetet fakti se në krahasim me të tjera formacione luftarake të angazhuara në krahun republikan, brigada Garibaldi, pavarësisht se e përbërë në masë dërrmuese nga komunistë të linjës zyrtare sovjetike (rreth 67% e totalit) shquhej për heterogjenitetin në radhët e saj. Prania e anarkistëve dhe trockistëve, tok me atë të pjesëmarrësve të tjerë antifashistë (socialistë, republikanë, radikalë etj.) i jepte një frymë të theksuar tolerance bashkëjetesës mes militantëve të ardhur nga shumë anë të Evropës në rangjet e saj. Për më shumë, shih Pietro Ramella, *I “diversi” e la guerra di Spagna*, në “L’impegno”, (XXVIII), nr. 2, 2008, si dhe *Il coraggio della memoria*, Associazione italiana combattenti volontari antifascisti di Spagna, 2000.

422. Marko nuk përmend emra konkretë në lidhje me ngjarjen, pavarësisht se shqyrtime të mëvonshme dokumentare (Dervishi, fq. 78, 130), kanë nxjerrë përfundimin se grindjet në kupolën komuniste të Parisit kishin shpërthyer si pasojë e kundërvënies mes dy figurave kryesore të KÇN-së së atëshmje, Ali Kelmendit dhe Llazar Fundos, e në përgjithësi të mosmarrëveshjeve të pasosura mes pesë figurave kryesore të Kominternit në lëvizjen shqiptare (veç Fundos dhe Kelmendit, ishin dhe Sejfulla Maleshova, Koço Tashko dhe Halim Xhelo). *Shih* dhe letrën që Kelmendi i dërgon Nolit, ku shprehet në kundërshti të plotë me gjithë rrugëtimin politik të Fundos: AQSH, Fondi Fan Noli (nr. 14), Dosja 103, Letër e Ali Kelmendit për Fan Nolin, më 18.03.1938, fq. 36.

423. AQSH, F. 15/AP, L. 1, D. 19. *Ali Kelmendi, Mbi situatën e punës përgjithsisht dhe mbi gjendjen e emigracionit*, 15 janar 1938.

424. Kelmendi do të zëvendësojë Fundon, në rolin qendror të ndërlidhësit mes Moskës dhe komunistëve shqiptarë të çoroditur (Elsie, fq. 236).

425. AQSH, F. 15/AP, L. 1, D. 20, Koço Tashko, *Letër drejtuar nga Parisi shokëve*, 8 qershor 1938.

Rrethanat apo ndonjë fije konsiderate vetjake bënë që Marko të mbajë qëndrim të tërhequr kundrejt sherrnajave që kishin shpërthyer, duke zgjedhur paskëtaj që të mos shprehej. Është një heshtje që me kalimin e kohës duket se merr përmasat e një zgjedhjeje politike, pa e ditur paraprakisht se kush kishte ngadhënjyer mbi kë. Ai i mbetet besnik linjës zyrtare të Kominternit. Gjë që duket edhe në muajt e fundit të konfliktit spanjoll, atëherë kur antagonizmi mes Partisë Komuniste Spanjolle dhe formacioneve të tjera heterodokse kthehet në *casus belli* për një luftë të brendshme mes republikanëve. Marko, tashmë komisar batalioni, nuk tutet të shpallë përkatësinë e vet staliniste, ndonëse episodi i mësipërm do të shkaktonte një ftohje përfundimtare mes tij dhe Kelmendit (Marko, fq. 247, 259–260).

Fati i Markos si vullnetar ndërkombëtarist në luftën civile spanjolle ndjek atë të brigadave antifashiste në përfundim të konfliktit, e që u kthye vetvetiu në një parardhomë tragjike të skenarit luftarak që shpejt do të përfshinte gjithë kontinentin. Tërheqja e tij dhe e bashkëluftëtarëve që e shoqëronin në drejtim të kufirit franko-spanjoll, në muajin maj të vitit 1938, na jep dhe elemente të çmuara për të rrokur frymën e gjithë asaj asaj epoke: që nga akuza që i mvishet qeverisë franceze (e së njëjtës ngjyrë politike me republikanët spanjollë), deri në dështimin historik që pëson taktika e ashtuquajtur e “Fronteve të bashkuara”, vënë në zbatim pikërisht në Francë dhe Spanjë, nga ana e Kominternit (Marko, fq. 251).

Paskëtaj, Marko përfundon në qytezën universitare franceze të Grenoblit, ku, si anëtar në Partinë Komuniste Franceze, regjistrohet në universitet. Ndërkaq që marrëdhëniet me qendrën shqiptare të bashkëlidhur me Kominternin do të jenë veçanërisht të ndera – pikërisht për arsye të lidhura me çarjen me Kelmendin, i cili do ta konsiderojë Markon një “aventurier”, – rasti do ta shpjerë ish-brigadistin e kthyer në student që ta vlerësojë rolin e komitetit në Paris si dëmtues, për sa i përket ndihmave që ky i fundit hamendësohej se duhet t’u jepte vullnetarëve shqiptarë.

Tanët, që rrinin në Paris, jo vetëm nuk treguan asnjë interesim, por përkundrazi na shihnin si armiq! (...) Vetëm nacionalistët si Rexhep Mitrovica, Qazim Koculi, Aziz Çami e të tjerë u dhanë dorën, kurse shokët tanë u dhanë këmbët. Asnjë për be, asnjë nga ata që quheshin komunistë në Francë nuk denjoi të shkonte në kamp përqendrimi (ku strehoheshin, mes vullnetarëve nga gjithë vendet, edhe ata shqiptarë – shën. im E.Q.) për të takuar vullnetarët e lirisë, por të dërgonte një letër, pale ndonjë ndihmë. As Ali Kelmendi, as Loro Brahim, as të tjerë nuk treguan ndonjë pikë interesimi. Ishte kjo një provë e madhe për të parë se kush ishte antifashist, kush ishte shqiptar. E vërteta është se shumica e nacionalistëve dhanë ndihma dhe u interesuan për shokët që evaduan nga kampi dhe mbetën rrugëve pa asnjë përkrahje (Marko, fq. 273–274).

Çka del më qartë është edhe gjykimi historik që Marko ngarkon mbi përkatësinë ideologjike të shumë prej këtyre veprimtarëve, « që u përkrahën vetëm nga nacionalistët dhe u ndihmuan të ktheheshin në atdhe të zhgënjyer » (*po aty*), duke shprehur njëkohësisht një kritikë të prerë për rangjet, asokohe zyrtare, të komunistëve shqiptarë. Është një dëshmi kjo që vjen vite pas ngjarjeve reale, e që është e ngarkuar nga pesha e kujtimeve; çka lyp të merret me gjithë kujdesin e duhur. E megjithatë, ajo shpreh më së miri një ndasi që, në prag të Luftës së Dytë Botërore – siç dhe të themelimit të një subjekti politik unitar të komunistëve shqiptarë – kishte marrë trajtë të qenësishme, mes veprimtarësh të lidhur krejtësisht pas vullnetit të Kominternit dhe të tjerëve që, në kushte të shturura organizative, vërtiteshin pa një vendndodhje të saktë politike. Duket se Petro Marko, që nuk kishte qenë kurrë pjesëtar i ndonjërit prej atyre pak grupeve gjysmë të organizuara të së majtës shqiptare (nëse përjashtojmë lidhjet e tij me persona të veçantë gjatë qëndrimit në Korçë), i përket kësaj galaksie militantësh që nuk renditeshin pas një qendre.

Rrjedha e jetës politike të Petro Markos, gjithsesi, do të ndjekë ecurinë e ngjarjeve të kohës, e pavarësisht mendimit të shprehur më sipër mbi nacionalistët shqiptarë të strehuar në Francë, mes tij dhe tyre do të ndërhyjnë zhvillimet ndërkombëtare të atyre viteve, duke ua ndarë fatet. Ndërsa Petro Markoja do të largohet nga Franca me nisjen e luftës dhe katrahurën në të cilën ndodhet Partia Komuniste franceze

fill pas bërjes publike të paktit Ribbetrop-Molotov<sup>426</sup>, përfaqësuesit kryesorë të krahut jo-komunist të mërgatës antizogiste do të afrohen me Italinë, e cila tashmë kishte përfshirë brenda kufijve të vet territoriale Shqipërinë. I pamundur të vazhdojë veprimtarinë e vet politike në Francë, Marko i bindet udhëzimit që Kominterni lëshon për të gjithë ish-pjesëmarrësit ndërkombëtarë në Luftën e Spanjës për t'u kthyer (legalisht ose jo) në vendet e tyre të prejardhjes (Marko, fq. 285-286).

Petro Marko kthehet në Shqipëri, pas disa ndalesash përgjatë gadishullit italik (do të qëndrojë në Torinë e mandej në Napoli) dhe gjithmonë i shoqëruar nga autoritetet, në prill të vitit 1940. Me të zbritur në Vlorë, ai nuk vonon të kthehet në fshatin e tij të lindjes, në Dhërmi, ku tregon se investohet për sheshimin e mosmarrëveshjeve klanore mes bashkëfshatarëve të tij dhe fshatit të Dukatit, me qëllim organizimin e qëndresës së përbashkët kundrejt autoriteteve italiane (Marko, fq. 312-313). Është e qartë se prania e tij në Shqipëri, pavarësisht “njollave” politike në veprimtarinë e tij e mëparshme, nuk përbënte ndonjë shqetësim të qenësishëm për autoritetet pushtuese, përderisa as një muaj më pas Marko gjendej në kryeqytet. Pavarësisht se atij nuk do t'i mungojë vrojtimi i autoriteteve, një mospërfillje e tillë duket se lidhet me ndikimin e paktit gjermano-sovjetik, që, duke shuar mosmarrëveshjet mes komunistëve stalinistë dhe Gjermanisë naziste, ishte interpretuar nga filo-fashistët shqiptarë si mundësi për një bashkëpunim mes dy fronteve njëherë kundërshtarë<sup>427</sup>.

Pothuajse menjëherë, emri i Markos do të përfshihet në listën e të akuzuarve për veprimtari agjitacioni kundër autoriteteve – me rastin e zbulimit të një trakti që u bënte thirrje shqiptarëve për mospjesëmarrje në radhët e ushtrisë italiane. Nga maji i vitit 1940 e deri në mars 1942, kalvari i burgosjes së Markos, që ndërkaq ende nuk kishte pësuar një gjykim formal në instancat përkatëse, kaloi krahas disa ngjarjeve që patën jo pak jehonë. Shpërthimi i luftës mes Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë i dha hov riaktivizimit të grupeve antifashiste, ndërkaq që në Shqipëri themelohej një parti komuniste. Përvoja pararendëse në terren antifashist dhe anëtarësia e Markos në Partinë Komuniste Franceze i jepnin atij kredencialet e duhura për të rënë në sy tek gjithë faktori politik kundërshtar ndaj regjimit italian në Shqipëri, e sidomos tek komunistët. Një përfshirje më cilësore e tij në rrjedhën politike të ngjarjeve nuk do të ishte gjithsesi e mundur, pasi Marko, me t'u liruar, kallëzohet sërish për shkak të disa trazirave në Himarë. E kështu, pa arritur kurrsesi të ketë marrëdhënie më të zgjeruara me faktorin e sapobashkuar komunist – veç një takimi të shkurtër që ai thotë se ka pasur me Koço Tashkon dhe Koçi Xoxen (Marko, fq. 338) – Markoja dërgohet për internim në Itali, ku do të qëndrojë deri në kapitullimin e Romës, në shtator 1943.

Do të nisë atëherë një tjetër angazhim i tij në luftë, kësaj radhe në territor italian, saktësisht në krahinën e Lacios, ku Marko iu bashkua formacioneve partizane të Partisë Komuniste Italiane<sup>428</sup>, ndërkaq që kjo e fundit ishte bërë pjesë e qeverisë antifashiste të gjeneralit Badoglio, me qendër në Brindisi dhe me autoritet të kufizuar vetëm në zonat jugore të pushtuara nga anglo-amerikanët. Sërish Marko do të bjerë në duart e autoriteteve fashiste, por në Romën e mbërthyer nga trupat gjermane tashmë. I burgosur në kryeqytetin italian, ai shkruan se jeta i shpëtohet falë ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Ernest Koliqit (Marko, fq. 406). Në vijim, pas çlirimit të Romës nga aleatët, më qershor 1944, Marko nuk do ta rreshtë bashkëpunimin e tij me figurat e antifashizmit italian të njohura që në Spanjë (Longo-n mbi të gjithë), duke u angazhuar edhe në organet e shtypit të dy partive kryesore të majta që drejtonin qëndresën në Itali – asaj komuniste dhe asaj socialiste. Vetëm në tetor të atij viti, pasi Shtabi i Përgjithshëm

---

426. Pakti mes Gjermanisë hitleriane dhe Bashkimit Sovjetik stalinist shkakton një stuhitë të vërtetë në radhët e komunistëve francezë, e cila gjen shfaqje sidomos në ditët e para pas sulmit gjerman mbi Poloni (1 shtator 1939). E parë tashmë si satelit i një vendi bashkëpunëtor me Berlinin, ndaj të cilit Franca kishte shpallur luftë, Partia Komuniste franceze do të gjendet, pa vullnetin e saj, në një gjendje jashtëzakonisht të sikletshme para opinionit publik vendas dhe sidomos masave të anëtarësisë. Për më tepër, *shih*: Pike, fq. 465-471.

427. « Bëre mirë që u ktheve – dëshmon Marko t'i ketë pohuar Mustafa Kruja – se tani ne, si fashistë, edhe ju, si komunistë, kemi lidhje dhe afim të madh, si Stalini me Hitlerin, që u bashkuan kundër plutokracisë perëndimore. » (Marko, fq. 315).

428. Mbi praninë e formacioneve të huaja në gjirin e brigadave partizane italiane, *shih*: Bocca, fq. 332.



Nacionalçlirimtar dërgon nga Shqipëria emisarët e vet, pikërisht për t'u interesuar për fatin e shqiptarëve të mbetur në Itali, Markos do t'i bëhet i mundur riadhesimi, rreth një muaj para se vetë Shqipëria të deklarohet e çliruar<sup>429</sup>.

Që Petro Marko ishte një militant i cili vështirë se mund të renditej brenda rrymave dhe zhvillimeve përkatëse të së majtës komuniste shqiptare, kishte qenë e qartë që përpara lufte, kur profili i tij politik dhe intelektual nuk u lidh kurrë përfundimisht me asnjë nga grupimet e kalcifikuara para themelimit të PKSH-së. Nga viti 1939 e tutje, ai do të kalonte përmes disa përvojash partiake, të cilat, edhe pse me kushtet politike shqiptare do të kishin po të njëjtën referencë ideologjike, Kominternin, prapë dallonin shumë për sa i përket rrethanave dhe prapaskenave.

Me gjasa, një e shkuar e tillë ishte e mjaftueshme për ta tëhuajtur edhe më shumë Markon kur, pas çlirimit të Shqipërisë nga ushtria gjermane, ai gjendet në marrëdhënie jo pak të ngushtë me njerëz të cilët tashmë ishin të ngarkuar me përgjegjësi të lartë në drejtim të PKSH-së dhe shtetit. Domethënës, në vazhden e këtij arsyetimi, është pohimi që i bën Sejfulla Malëshova, i cili, nëse do ta marrim à la lettre<sup>430</sup>, dëshmon shumë për mospërputhjet ideore, siç dhe mendësitë, që mbretëronin në gjirin e drejtuesve të lartë komunistë.

Dëgjoni mirë! Ti ke milituar në partinë spanjolle, në partinë franceze, në partinë italiane... Kjo parti këtu nuk është si ato. Kjo është një parti e krijuar nga dy serbë dhe është parti terroristësh. Ndaj më dëgjo mirë: nuk duhet të hapësh gojën të paktën për një vit për ato që sheh dhe dëgjon. Përndryshe, do ta pësosh... (Marko, fq. 440)

Akoma më i rëndësishëm është një episod i tillë – në lidhje me të cilin kemi pak mundësi të verifikojmë vërtetësinë, por mundet veç ta hamendësojmë – për të gjykuar ecurinë e mëtejshme të marrëdhënies mes Petro Markos dhe regjimit të sapo instaluar. *A posteriori* duket se veçanërisht lidhjet e ngushta të krijuara mes kreut të Tiranës komuniste dhe *entourage*-it titist janë në thelb të ngjyresave kritike me të cilat Marko përshkruan Shqipërinë e viteve 1945–1948. Veprimtaria e tij në një faqe shumë të rëndësishme të shtypit zyrtar – Marko ndërkohë ishte caktuar në drejtim të gazetës “Bashkimi” – kryhej në përpikëri me udhëzimet formale dhe e paraqiste idilike praninë e jugosllavëve në Tiranë. Përkundër, vetë afria e tij me Sejfulla Malëshovën, që nuk do të kalojë shumë dhe do të gjendet në krah kundërshtar me *camarilla*-n hoxhaiste, si dhe notat e theksuara nacionaliste që karakterizonin botëkuptimin ideologjik dhe përvojën militante të Petro Markos, do të paralajmëronin përkeqësimin e marrëdhënieve të tij me regjimin.

Në pranverën e vonë të vitit 1947 emri i Petro Markos përfshihet në një listë arrestimesh të përgatitura nga autoritetet shqiptare. Kallëzohet për “faje penale kundër popullit dhe shtetit” përmes një letërndalimi të përhershëm të firmosur nga prokurori i prefekturës së Tiranës, por pa asnjë hollësi tjetër sqaruese<sup>431</sup>. Vetë i akuzuari, në kujtimet e tij, mendon se preteksti për ta arrestuar bart autorësinë e atyre që mbronin interesat jugosllave në Tiranë, mes të cilëve ministri i Ekonomisë, Nako Spiru (Marko, fq. 467)<sup>432</sup>. Vetëm disa muaj më vonë, rreth vjeshtës, do të bëhen të ditura një grusht akuzash sipas të cilave, në të shkuarën e afërt, Markoja kishte pasur raporte të ngushta me një nënshtetas amerikan, me emrin Anton Stivens, që kishte qenë në Shqipëri. Sipas deklaratave, të nënshkruara pas muajsh

429. AIDSSH, Dosje Hetimore Gjyqësore nr. 6094, *Promemorie mbi Petro Markon*, 27.01.1948, fq. 45.

430. Marko, në rrëfimin e tij autobiografik, shprehet se pjesën e librit që flet për vitet pas luftës e ka hedhur në letër vetëm më 1991, pasi më parë « ishte e pamundur ta shkruaja, se, edhe ta mendoja, ishte me rrezik jete » (Marko, fq. 435).

431. AIDSSH, Dosje Hetimore Gjyqësore nr. 6094, Petro Marko, *Letërndalim i përhershëm*, 21.05.1947 dhe *Urdhënesë paraburgimi*, 19.05.1947, fq. 33–34.

432. Rreth një vit më vonë, në prani të hetuesit, Marko shpreh pakënaqësinë e tij ndaj Nako Spirit, pasi, ishte ai që shtyu për ta pushuar nga puna, « pa asnjë arsye » Po aty, *Proces-verbal*, 03.09.1948, fq. 20.

“Ne nuk e ke  
aty Petro Ma  
merret me v  
po e kemi d  
në front”

Ali Kelmendi

mi dërguar

arkon të

vjersha,

dërguar për

dhune të ushtruar në ambientet e parburgimit, i akuzuari pranonte se i kishte servirur amerikanit, në cilësinë e kryeredaktorit të gazetës “Bashkimi”, « informata mbi biografin e personave të ndryshëm të Pushtetit dhe në se ishin në Partinë Komuniste, gjë që ka qenë kryesorja për Amerikanët, p. sh. Për Komandantin, Sejfulla Malëshovën, Ymer Dishnicën, Ymer Nishanin, Nako Spiron, Spiro Kolekën » duke marrë përsipër, në po të njëjtën deklaratë, të zbrërthetë « aktivitetin t’im në shërbim t’Amerikanvet »<sup>433</sup>. Në një tjetër deklaratë, me gjasë të fundvitit 1947, Marko rrëfen për të tjera takime që, në kuadrin e veprimtarisë së tij gazetareske ka pasur me nënshtetas amerikanë dhe anglezë, të cilët, sipas nënshkrimit, shpreheshin kritikë ndaj politikave të jashtme dhe të brendshme të qeverisë Hoxha – e që në fakt, na jep më tepër themelet e narrativës që regjimi sapo kishte nisur të ndërtonte mbi antagonizmin mes tij dhe vendeve perëndimore.

Aleancën e Popullit Shqiptar me Popullin e Jugosllavisë e kritikonte. Pse anoni nga jugosllavët, kurse ata s’kanë mjetet e duhura për vehten e tyre. [...] Kjo demokracia juaj nuk është demokraci dhe neve nuk na pëlqen as pakë, demokraci të vërtetë ka vetëm n’Amerikë. Politika t’uaj është e gabuar, unilaterale dhe do të ketë konsekuenca të këqija. Amerika nuk do t’u konsiderojë si një shtet mik, nuk do t’u ndihmojë dhe nuk do t’u njohë. [...] Gjith këto gabime, gjith kjo politikë e gabuar e Qeverisë t’uaj shkaktohet me qënë se ajo ka tendenca të majta, sepse shumë nga pjestarët e Qeverisë janë Komunistë. Drejtusat e Qeverisë i shante duke i quajtur të pa zotë për të qënë n’ato vënde drejtuse. Mburrtë vetëm Sejfulla Malëshovën dhe Ymer Dishnicën, dhe i quante njerëz me kulturë dhe burra shteti. Qeverija t’uaj si Komuniste persekuton fenë dhe kjo nuk është një politikë e mirë. Ky kërkonte të nën-vleftësonte Gjyqin Special që u zhvillua kundra armiqëve dhe kriminelave të luftës. Dënimin me vdekje të disave nga krerët e tradhëtisë e quante të pa drejtë dhe më zuri si shembull Kolë Tromarën dhe Bahri Omarin. Me këtë mënyrë bënte axhitasion dhe kërkonte që të bënte opinionin e tij, opinion të masës popullit Shqipëtar në favor t’imperializmit Amerikan. Fjalët e treguara më sipër, deri diku zunë vënd dhe në mua, gjë e cila vërtetohet prej botimeve me karakter të tillë që ndodhën në gazetën “Bashkimi p.sh. dokumentarët fotografikë të botuar në gazetën “Bashkimi” tregojnë qartë popullarizimin e Amerikës<sup>434</sup>.

Mbi të tilla deklaratat, si dhe mbi përputhjen e tyre me faktet reale apo arbitraritetin në formulimin e tyre nga ana e hetuesve, mund të ngrihen hamendje të shumta. E sigurt është ndërkaq se përpunimi i tyre u hapi rrugë formulimit të qartë të akuzës ndaj Petro Markos, i cili, në janar 1948 deklaroihej «një nga agjentët aktivë të spiunazhit amerikan në Shqipëri» dhe si informator i pajtuar nga Harry Fultz-i me qëllim për t’i pajisur amerikanët me informata të llojllojshme (që nga përbërja e emigracionit shqiptar në Romë, përgjatë luftës, deri te propaganda pro-amerikane përmes shtypit shqiptar)<sup>435</sup>. Këtyre, u shtohet gjithashtu akuza për « kontakte me grupin e deputetëve dhe merr pjesë në biseda të ndryshme politike qoftë në Dajti, qoftë në shtëpit e tyre »<sup>436</sup>. Interesante mbetet që askund, qoftë në aktet e nënshkruara nga autoritetet e hetuesisë, qoftë në ato të vetë të akuzuarit (sido që të ketë qenë modaliteti i firmosjes nga ky i fundit) nuk përpilohet ndonjë akuzë si (anti)jugosllav në drejtim të tij<sup>437</sup>.

433. Po aty, *Deklaratë*, 27, 11, 1947, fq. 36 dhe 47-48.

434. Po aty, *Deklaratë*, fq. 43.

435. Po aty, *Promemorie mbi Petro Markon*, 27.01.1948, fq. 45 dhe 50. Takimi me Fultz-in ndodh në Bari, në prag të kthimit të Markos në Shqipëri nga Italia, siç tregon dhe vetë në kujtimet e tij (fq. 429). Në procedimin ndaj të akuzuarit, më datë 05.09.1948 përpara hetuesit, Marko e pranon pjesërisht akuzën e parashtruar nga hetuesia, duke deklaruar se « [m]ua Fultz-i nuk më ka propozuarë kur erdha aty që të hynja në shërbim të tij, as që të bëhesha informator i tyre. Nuk kam mare nga ay as një udhëzim. Gjatë bisedimeve që pata me të ky kërkoi të bënte një listë të gjithë shqiptarëve që ishin në Romë. Unë i dhashë listën e shqiptarëve që ishin në Romë dhe pastaj u largova » (nënvizimi është në dokument). – Po aty, *Proces-verbal*, 03.09.1948, fq. 12.

436. Po aty, fq. 46.

437. Përkundrazi, me rastin e formulimit të akuzës si bashkëpunëtor i faktorit anti-komunist shqiptar në Itali, shkak për të cilin u bë takimi me Koliqin në Romë, Marko shprejete kështu: « Unë kam punuarë si mbas urdhërave që na jepnin Jugosllavët. Këtu ka dhe shokë të tjerë që kanë marrë letra njoftimi të cillët sot janë në Shqipëri. Neve donim të shfrytëzonim Ernest Koliqin, aji at-her nuk na lëftonte pse po binde Gjermania. » Po aty, *Proces-verbal*, 03/(data e paqartë e muajit)/1949, fq. 2.

Në maj të vitit 1949, Petro Marko, mbi të cilin rëndonin edhe akuza e bashkëpunimit me faktorin kuisling gjatë qëndrimit të tij në Itali në vitet 1943-1944<sup>438</sup>, shpallet fajtor dhe dënohet me tre vjet burgim nga Gjykata e Lartë Ushtarake<sup>439</sup>. Në atë rast, duke mos pranuar asnjë prej akuzave, mes të tjerash Marko pohoi dhe lidhjen e tij të hershme me lëvizjen komuniste në Shqipëri si kundërprovë ndaj fjalës së prokurorit:

Unë kam shkruar në revista po me frymë leniniste dhe Revista A.B.C. përmbante frymë revolucionare. Revista SHQIPËRIA E RE ka qenë nacionaliste, unë kam shkruarë vjersha dhe poezi. Unë kam heq dorë prej shokëve që shkruanin në Gazeta me frymë antikomuniste, unë shkruaja artikuj kontrabandë në gazetë dhe në shkrime që qenë në favor të Popullit, dhe unë nga këto shkrime jam persekutuarë nga Qeverit e mëparshme. Unë kam shkruarë dhe në revistën KOHA E RE dhe këtu bënja siç më thoshin pse at-herë ishja 20 vjeç. Unë kam lexuar libra marksistë, si Manifesti Komunist e të tjerë<sup>440</sup>.

Pothuajse menjëherë më pas ai do të paraqesë rekurs, por e njëjta seli ia mohon atë « me qenë se gjyqi në përgjithësi ka rjedhur rregullisht dhe nuk konstatohet ndonjë e metë në aplikimin e ligjës »<sup>441</sup>. Ai do të lirohet në 15 maj të vitit 1950, duke qenë se për gjykatën ai e kishte kryer periudhën 3-vjeçare të dënimit formalisht në paraburgim. Jashtë qelisë gjente një vend ku kushtet politike në të cilat e kishte lënë para se të prangosej kishin ndryshuar rrënjësisht. Jugosllavia i kishte lënë vendin Bashkimit Sovjetik, si aleat më i ngushtë i Tiranës, ndërsa njerëzit e gjykuar si pranë Titos, me në krye Koçi Xoxen (që sipas Markos e shpëtoi nga dënimi më vdekje – Marko, fq. 484) qenë zbritur nga maja e pushtetit dhe zhdukur nga faqja e dheut.

10. Jeta në burg nuk duket se tronditi dhe aq bindjet ideologjike të Markos, më shumë se ta bënte të ndërgjegjshëm për realitetin e pushtetit të instaluar prej pesë vitesh në Shqipëri. Nis kështu rrugëtimi politik i tij i fundit (dhe më i gjatë, nëse e shtrijmë në hark kohor). Është njëkohësisht dhe udhëtimi më apolitik i tij, krahasuar me jetën intelektuale dhe publike para vitit 1950. Në kuptimin që veprimtaria e vetme tashmë e tij, ballë regjimit që, paradoksalisht ai i kishte përshëndetur themelimin, do të jetë kryekëput e paangazhuar nga ana funksionale. Një marrëdhënie e cila, në tërësi do të karakterizohet nga tërheqja, heshtja dhe marrëdhëniet personale me disa eksponentë të caktuar me të cilët Marko kishte ndarë përvoja njerëzore para vitit 1945. Ndër këta spikat emri i Hysni Kapos, por sidomos i Mehmet Shehut, të cilin Marko, siç kishte bërë paraprakisht me Xoxen, e quan shpëtimtarin e vet; pavarësisht se, siç shkruan, « [n]uk ishte më ai Mehmet që njihja unë dhe shokët e tij, por një Mehmet tjetër » (Marko, fq. 503, 506, 517).

Të paktën nëse bazohemi në ato çka Marko hedh si kujtime në epilog të andrrallave të tij jetësore, të qenët një *protégé* i njeriut të dytë më të fortë të Republikës Popullore të Shqipërisë, e ka lejuar që për një kohë të gjatë të mund të ushtronte zanatin e shkrimtarit dhe të botohej. Pavarësisht se kjo veprimtari nuk do të kishte ecuri të pasqyruar nga ngurtësitë e politikave kulturore të regjimit, së paku në një rast, vullneti artistik i Markos nuk do të hasë në pengesa të asnjë lloji.

Fjala është për botimin e romanit “Qyteti i fundit”, (1960) i cili, ndryshe nga pararendësi “Hasta la vista” – e pavarësisht se ky, përmban edhe më tepër “të meta” për t’u sulmuar nga autoritetet – del me sukses dhe pa cunime censure. Do të jetë diçka e përkohshme, pasi romani në fjalë, fill pas botimit të parë, do

438. Po aty, fq. 21.

439. Po aty, *Akt-gjykim*, 05.05.1949, fq. 6.

440. Po aty, *Proces-verbal*, cit. fq. 1.

441. Po aty, *Vendim*, 05.05.1949, fq. 8.

të ketë një fat të zymtë editorial<sup>442</sup>. Gjë që nis menjëherë pas botimit, kur vepra nis të sulmohet ashpër. Ndër zërat më kritikë është ai i Misto Treskës, njëri prej atyre “komunistëve ortodoksë” – siç lakoheshin në Perëndim – që gjendej i lidhur ngushtë me politikën kulturore të regjimit. Shkruan Treska, duke vlerësuar përputhjen e romanit me normat e përpikta të realizmit socialist si të paarrirë:

E vërteta historike nuk është paraqitur drejt. E para e punës, pushteti ynë popullor, sado i zënë të ketë qenë me punë dhe probleme të tjera më të mëdha duket sikur diskretitohet kur lë ashtu në mëshirë të fatit, të grumbulluar brenda portit, pa as kujdesin e rregullin më të vogël, një grup italianësh që duan të riatdhesohen. Këtu duket sikur shteti ynë ka hequr dorë nga fati i këtyre njerëzve (...) Por edhe sikur të ishte ashtu siç shkruan autori, kjo gjë nuk duhej të pasqyrohej e të përgjithësohej në një vepër letrare, sepse kjo nuk bën e nuk të bëjë thelbin e karakterit të pushtetit tonë popullor.

Kritika vazhdon mandej të prekë atë që quan strukturë të dobët të romanit, duke pasur shqetësim kryesor botimin e këtij të fundit në Itali. Çka zbulon pastaj dhe marrëdhëniet tashmë të përkeqësuar mes regjimit shqiptar dhe Partisë Komuniste Italiane. Qartazi, prej shkrimtarit Marko pritet që të mos ngacmojë disa ekuilibra të tendosur prej pak kohësh, kur PPSH-ja dhe PKI-ja kishin zgjedhur dy rrugë të ndryshme për t’u raportuar me Moskën e Hrushovit (Devlin, fq. 3-4).

Po të marrim edhe shtypin e kritikën letrare të drejtuar nga Partia Komuniste Italiane, për gjendjen e marrëdhënieve tona me këtë Parti, të udhëhequr nga grupi oportunist e revizionist i Togliatit, këto nuk do të flisnin aspak në favor të librit. Më të mirën punë që mund të bënim do të ishte ajo që të heshtnim. S’do shumë mend se çfarë qëndrimi do të mbante kritika letrare borgjeze. Kështu, ky libër, edhe sikur të kishte merita në vet-vehte, do të ndodhej me kritikën armiqësore të vendit dhe këtej do të hapej hallka për të diskredituar të gjithë letërsinë tonë, pa folur këtu që “Qyteti i fundit” nuk mund të përfaqësojë letërsinë tonë të ditëve të sotme<sup>443</sup>.

Ecure jo shumë të mirë do të ketë dhe vetë miqësia mes Markos dhe Shehut, kur i pari përjashtohet nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve në vitin 1974. Arsyja, për Markon, lidhet ngushtë me një ngatërresë të shkaktuar nga botimi i një poezie të hershme të tij, e vitit 1935, në të cilën përshkruhet me nota pesimiste gjendja politike dhe shoqërore e vendit. Me qëllim ose jo, vargëzimi ishte përfshirë në një botim që pasqyronte prodhimet më të fundit letrare të shkrimtarëve shqiptarë; çka la përshtypjen se poezia ishte një krijim i cili i referohej situatës aktuale të Shqipërisë. Rasti ngriti një stuhitë të tillë sa dhe vetë kryeministri i vendit, pikërisht Mehmet Shehu, reagoi negativisht ndaj autorit (Marko, fq. 510). Sidoqoftë, nuk përjashtohet që krejt ngjarja të jetë e ndërthurur me një tjetër “skandal” letrar që shkaktonte krijimtaria e Markos: atë të botimit të romanit “Një emër në katër rrugë”, po atë vit, e që shkaktoi një valë spastrimesh të rënda pikërisht të atyre që e kishin lejuar qarkullimin ndër lexues të një libri të tillë<sup>444</sup>.

---

442. Në vitin 1977, libri i poetit Drago Siliqi hiqet nga qarkullimi – ose “kalohet për karton”, siç thuhej asokohe në zhargon – pasi, krahas Ricosit, përdortë “disa superlativa” ndaj romanit “Qyteti i fundit”, madje, siç shprehen autoritetet të skandalizuara, duke quajtur veprën e Markos me frymë edhe më revolucionare se ajo e Migjenit. AQSh, F 511, V. 1977, D. 153, f. 81-82. Po të njëjtin fat ka dhe një libër i Koço Bihikut, vetëm pasi në të, për dhjetë herë rresht, përmendet emri i Petro Markos. *Po aty*, fq. 83-84.

443. Burimi...

444. « Faj i rëndë ishte botimi i romanit të Petro Markos “Një emër në katër rrugë” me gabime të theksuara ideologjike, që nuk u kapën edhe gjatë procesit të rishqyrtimit të veprave, ndërsa drejtorja e aprovoi pa e shtypur fare » – i shkruante Komitetit Qendror ministri i Kulturës Thoma Deliana një vit më vonë (11.4.1974), në një raport mbi risitë në botime dhe kinematografi. Po ai, më 12 dhjetor njofton për shkarkimin nga detyra të drejtorit të shtëpisë botuese “Naim Frashëri” pikërisht për shkak të daljes së librit për botim. AQSh, F 511, V. 1974, D. 131, *Raport mbi veprimtarinë e shtëpisë botuese “Naim Frashëri dhe kinostudios “Shqipëria e re” për zbatimin e detyrave të Plenumit të 4-t të KQ të Partisë*, f. 3; po aty, D. 145, *Informacion*, fq. 3.

Të gjitha këto ndodhi do ta shtyjnë Markon, që në krye të herës, që t'ia përshtasë krijimet e tij letrare nevojës për një jetë më të qetë e pa përballje me regjimin. «Atherë e gjeta çelësin dhe zgjedha temat e dashura për mua – shkruan ai – luftërat e trimave, të popullit tim për liri, pavarësi dhe çlirim» (Marko, fq. 508). Në këtë format, hynin romane si “Halimi”, “Stina e armëve”, “Ultimatumi”, “Ara në mal” – që ishte dhe roman i cili, për përpikërinë e zbatimit të skemave dogmatike në letërsi dhe arte, mori çmimin e Republikës. Në të tjera raste, shkrimtari bënte udhëtime prapa në kohë, në ngjarje të cilat i pati jetuar vetë; porse edhe në të tilla raste vazhdon të tërheqë kritika pikërisht për mënyrën – të gjykuar të papërputhshme me normat doktrimore të realizmit socialist (Juraga; Booker, fq. 68) – se si shtjellon prirjet e tij autobiografike në letërsi<sup>445</sup>.

Në këtë vazhdë, do të jenë romane si “Beteja për foletë e bardha” dhe “Çuka e shtegtarit”, që nuk do të shohin dritën e botimit, si dhe “Nata e Ustikës” që do të dalë, në formë të shkurtuar, vetëm në vitin 1988.

Unë shkrova si poet, si gazetar e si shkrimtar, duke iu nënshtruar mundësisht sa më pak kërkesave dhe rregullave të krijimtarisë së kohës, por u kritikova ashpër, u dënova me heqjen e së drejtës së botimit dhe disa nga veprat m'u bënë karton, pa dalë në qarkullim, duke më mohuar kështu gëzimin e krijimit. Për një artist kjo është e barabartë me vdekjen. Ky është një lloj tjetër burgimi dhe izolimi: heshtja. Emri im u hoq nga të gjitha antologjitë, tekstet shkollore, në plenumet e Lidhjes nuk përmendesha kurrë më dhe asnjë organ shtypi nuk mund të fliste për mua, pra më keq se të kisha vdekur: unë vërtet isha gjallë, merrja frymë, shikoja, mendoja, dëgjoja, gjykoja, por në këtë lloj heshtjeje e ndjeva se isha eliminuar si krijues (Marko, fq. 509).

Petro Marko ndahet nga jeta fill pas rënies *de facto* të regjimit socialist, më 23 dhjetor 1991, pasi kishte kaluar arrestimin dhe burgosjen e të birit, Jamarbër Markos, me akuzën e agjitacionit dhe propagandës më 1975, pasi ishte “internuar” vetë nga veprimtaria botuese dhe kishte kaluar, mes viteve 1988–1989 një sëmundje shumë të rëndë. Deri në fund të shënimeve të tij autobiografike nuk bën kthesë nga ato që ai i identifikon si ideale rinore e që i lidh pashmangshmërisht me komunizmin, duke vënë një fill ndarës mes përjetimit të hershëm të ideologjisë dhe kalvarit që kaloi përgjatë regjimit. Duke ngulur këmbë te papërputhshmëria që ai thekson se pati dalluar që në krye të herës mes komunizmit dhe *condominium*-it shqiptaro-jugosllav të viteve 1944–1948, deri në fund Marko do të shohë një vazhdimësi të pacenuar mes militantizmit të tij majtist dhe një lloj romantizmi patriotik që e pati karakterizuar si veprimtar dhe shkrimtar.

---

445. Për më shumë në lidhje me autobiografizmin në letërsinë shqiptare gjatë regjimit diktatorial dhe politikave kulturore në këtë drejtim, shih: GRAÇI Virion, *Autobiografizmi dhe romani*, Botimet albanologjike, Tiranë, 2015, *passim*.

## Bibliografia

### *Burime arkivore:*

AQSH / AP - Arkivi Qendror Shtetëror / Arkivi i Komitetit Qendror të PPSH-së  
AIDSSH – Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

### *Të tjera:*

ALEXANDER Robert J. *International Trotskysim, 1929-1985: A Documented Anlysis of the Movement*, Duke University Press, Durham and London, 1991.

BELEGU Mentor, *Kryengritja antizogiste e Fierit*, Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha”, Tiranë, 1987.

BEVOR Anthony, *The Battle for Spain. The Spanish Civil War 1936-1939*, Phoenix, London, 2006.

BOCCA Giorgio, *Storia dell’Italia partigiana*, Mondadori, Milano, 1995

CORNIS-POPE, Marcel; NEUBAUER, John, *History of the Literary Cultures of East-Central Europe: Junctures and Disjunctures in the 19th and 20th Centuries*, Vol. III, John Benjamins Publishing, 2004.

DAVID-FOX Michael, *Communism and Intellectuals*, në *The Cambridge History of Communism*, Vol. I *World Revolution and Socialism in One Country, 1917-1941*, Cambridge University Press, 2017.

DERVISHI Kastriot, *Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2016.

DEVLIN Kevin, *Moskow and the Italian CP*, në “Problems of Communism”, Vol XIV, Taylor & Francis, sept-oct. 1965

*Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri dhe demokraci 1917-1941*, botim i Drejtorisë së Arkivave të Shtetit të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1959.

FRASHËRI Kristo, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2006.

GRAÇI Virion, *Autobiografizmi dhe romani*, Botimet albanologjike, Tiranë, 2015.

HAMM Harry, *Albania: China’s Beachhead in Europe*, Frederick A. Praeger, New York, Inc., 1963

HASLAM Jonathan, *The Comintern and the Origins of the Popular Front 1934–1935*, “Historical Journal” 22, 3 (1979).

*Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*, botim II, 8 Nëntori, Tiranë, 1981.

HOXHA Enver, *Kur lindi Partia (Kujtime)*, 8 Nëntori, Tiranë, 1982

JORGAQI Nasho, *Jeta e Fan. S. Nolit*, Ombra GVG, Tiranë, 2005.

JURAGA Dubravka – BOOKER Keith M., *Socialist Cultures East and West*. Praeger, 2002.

KOKAViron, *Rrymat e mendimit politiko-shoqëror në Shqipëri në vitet 30 të shekullit XX*, Instituti i Historisë, Tiranë, 1985.

KULLA Ndrëçim, *Antologji e mendimit shqiptar, 1870-1945*, Plejad, Tiranë, 2003.

MARKO, Petro, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, OMSCA, Tiranë, 2000.


MONTOBIO Manuel, MARKO Anita, SPAHIU Xhevahir, *Voluntarios de la libertad. “Hasta la Vista” y los Brigadistas albaneses en la Guerra Civil Espanola - Vullnetarët e lirisë. “Hasta la Vista” dhe brigadistët*



- shqiptarë në Luftën Civile Spanjolle*, Agencia Espanola de Cooperacion Internacional para el Desarrollo, Madrid, 2009.
- PACCIARDI Rondolfo, *Il Battaglione Garibaldi. Volontari italiani nella Spagna Repubblicana*, La Lanterna, Roma, 1945.
- PANO Nicholas, *Albania: the Last Bastion of Stalinism*, në *East Central Europe* (ed. Milorad M. Drachkovitch), Hoover Institution Press, Stanford, 1982.
- PIKE David Wingeate, *Between the Junes: The French Communists from the Collapse of France to the Invasion of Russia*, *Journal of Contemporary History*. Vol. 28, No. 3 (Jul., 1993), pp. 465-485.
- PLASARI Aurel, *Petro Marko mes zilisë dhe lavdisë*, botuar në gazetën *Panorama*, më 27 nëntor 2013.
- PONS Silvio, *La rivoluzione globale. Storia del comunismo internazionale, 1917-1991*, Einaudi, Torino, 2012.
- PUTO Arben, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Toena, Tiranë, 2009.
- SERVICE Robert, *Comrades. Communism: a World History*, Macmillan, 2007.
- SMIRNOVA Nina, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Ideart, Tiranë, 2004.
- SPINELLI Altiero, *Come ho tentato di diventare saggio*, Il Mulino, Bologna 1999
- SPRIANO Paolo, *Storia del Partito Comunista Italiano, vëllimi II, Gli anni della clandestinità*, Einaudi, Torino, 1969.
- TAKO Pirro, *Fan Noli në fushën politike dhe publicistike*, Tiranë, 1975.

Zef

Mala



# I penduari që nuk diti të heshtë

Në vitin 1937, Zef Mala, asokohe 22-vjeçar, gjendej mes një grushti themeluesish vërsnikë të një organizate politike të majtë në qytetin e lindjes. Pavarësisht se një pjesëmarrje e tillë do të shënojë një *spartiaque* në jetën e tij politike, veprimtaria e mirëfilltë publike e Malës kishte nisur pak vite më herët, pasi kishte përmbyllur shkollimin e mesëm në Kolegjin Saverian të Shkodrës.

**NGA EDON QESARI**

*Më 1929 ose 1930 kishin ardhë në Shkodër dhe kishin marrë në sipërmarrje për rindërtim dhe për meremetim komunal një grup puntorësh që bajshin pjesë në një sindikatë. (...) Mbas luftës kishin marrë pjesë në grevat dhe në pushtimin e fabrikave dhe lidhen me Partin Komuniste. Unë pata punë me ta në meremetimin e gazeremave dhe me qënë se dijshtëm mirë Italishten, kishë lidhë me mikësi me ta. Nga kjo mikësi, lindën biseda të shumta midis meje dhe dy prej puntorve me ne ndër 'ta, prej të cilëve unë mësova pse shtypja e jetesës ishte vetëm një nga trajtat e shtypjes shoqërore dhe se përveç kësaj, ekzistonte një ma e madhe, shtypja e klasave. Prej këtyre mora së pari dhe lexova librat dhe broshurat mbi socializmin, mbi komunizmin, mbi lëvizjen sindikale t'Italisë dhe mbi revolucionin Rus. (...) Dhe faktorët e sipër përmendun caktuan udhën time e më shtynë në rrugën e Komunizmit, por akoma nuk njëfishim asgjë mbi Marksizmin e vërtetë.*

Zef Mala, Promemorie shkruar në burg (1948)<sup>446</sup>

Në vitin 1937, Zef Mala, asokohe 22-vjeçar, gjendej mes një grushti themeluesish vërsnikë të një organizate politike të majtë në qytetin e lindjes, e cila do të njihet më vonë si Grupi Komunist i Shkodrës. Pavarësisht se një pjesëmarrje e tillë do të shënojë një *spartiaque* në jetën e tij politike, veprimtaria e mirëfilltë publike e Malës kishte nisur pak vite më herët, pasi kishte përmbyllur shkollimin e mesëm në Kolegjin Saverian të Shkodrës – i shquar për drejtimin klasik të *curriculum*-it të vet mësimor – dhe ishte zhvendosur në Tiranë, më 1934.

446. AIDSSH, Dosje formulare nr. 2505 Zef Mala, 09.02.1948, fl. 13.

Njëkohësisht me përfitim e një burse studimesh, të financuar nga qeveria shqiptare dhe që e lejon të regjistrohet në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Vjenës, Mala nis të jetë i pranishëm në faqet e shtypit të kryeqytetit, me artikuj të kushtuar kryesisht kronikës rinore dhe përshtypjeve mbi zhvillimet letrare në bashkohësi. Përgjatë gjithë dyvjeçarit 1934–1936 të qëndrimit në Vjenë, angazhimi i tij do të jetë gjithmonë e më i ngjeshur, i ndarë mes qytetit të tij të lindjes dhe Tiranës. Pavarësisht se prania e penës së tij në gazetën e kryeqytetit e lejon të bjerë në kontakt me një ambient në të cilin prijet radikale, sidomos në mesin e njëfarë rinie, nuk ishin të panjohura, ka studiues që mendojnë se afrimi i Malës me idetë e majta do të ndodhë gjatë qëndrimit të tij në Vjenë<sup>447</sup>. Çka përputhet edhe me zhvillimet politike që prej një dekade e gjysmë kishin përfshirë kryeqytetin austriak, i cili, qysh në vitin 1919 e deri më 1934, do të qeverisej në mënyrë të pandërprerë nga socialdemokratët (me frymëzim marksist) vendas<sup>448</sup>.

Në vijim, Malës do t'i ndërpritej bursa e shtetit – qëllimisht, sipas tij, për shkak të ideve marksiste që kishte shfaqur në ambientet universitare vjeneze, e të cilat duket se kishin vënë në alert autoritetet shqiptare që u druheshin më së pari të rinjve «që kanë kryer mësim jashtë shtetit» (*Dokumente e materiale historike...*, fq. 383)<sup>449</sup>. I detyruar të lërë në mes studimet dhe të vendoset sërish në Tiranë, më 1937 Mala afrohet me anëtarët e një celule ndjekësish të ideve të majta të lidhur me qytetin e tij të lindjes. Mes tyre, gjendeshin emra të një rëndësie të veçantë për zhvillimet e mëvonshme politike, si: Tuk Jakova, Vasil Shanto dhe Qemal Stafa (Frashëri, fq. 128), të cilët, në mesvitet '30 ishin bërë të njohur mes shkollarëve të Shkodrës për propagandimin e librave radikalë. Zef Mala, që në atë kohë bënte pjesë në redaksinë e gazetës “Arbënia” të Tiranës, nis atëherë rrugëtimin e vet politik, i cili, brenda një viti, do të kurorëzohet me drejtimin e grupit komunist të përqendruar në Shkodër dhe me shtrirje deri në Elbasan e Gjirokastër. Siç shkruan më vonë, ai do të bëhet edhe nismëtar i disa përkthimeve – kryesisht broshura nga autorë tashmë të renditur si klasikë në literaturën marksiste (Marksi vetë, Lenini, Stalini, Dimitrovi) – që dëshmojnë dhe gjenezën leniniste të formimit të tij fillestar<sup>450</sup>.

Ngjitja e Malës në pozitën drejtuese të një grupi komunistësh që rrekej të sendërtonte një veprimtari organike – ashtu si dhe të shtrinte rrjetin e marrëdhënieve jashtë vendit, me të tjera lëvizje të së njëjtës partishmëri – ndodh në një periudhë ndryshimesh të rëndësishme strukturore. Në Shqipëri vepronin disa grupe të singjashme, ndonëse me dallime të theksuara mes tyre, të cilave historiografia zyrtare e periudhës 1945–1990 u njeh njëfarë autorësie në zanafillat e asaj që më vonë do të pagëzohej si Partia Komuniste e Shqipërisë (*Historia e Partisë së Punës...*, fq. 35)<sup>451</sup>. Kjo do të thotë se që nga gjysma e dytë e viteve '30, kur ishte bërë tashmë e qartë se në Shqipëri ekzistonin premiset për organizimin e një partie komuniste, kishte një vullnet të caktuar ndër instancat drejtuese të Internacionales III (Kominternit) për të shtyrë në drejtim të bashkimit grupet ekzistuese. Për këtë qëllim, që në korrik të vitit 1937, njëri ndër pak shqiptarët e lidhur drejtpërsëdrejti me Moskën, Koço Tashko, kthehet në Shqipëri me qëllim që të ngrinte urat e komunikimit mes grupeve jo pak të çoroditura të komunistëve vendas (Dervishi,

447. Po aty, fl. 16.

448. Gjatë gjithë atyre viteve, Vjena – e cila nis të bëhet e njohur si *Rotes Wien* (Vjena e kuqe) – duke përbërë një veçanti brenda vetë kontekstit austriak të sunduar politikisht nga prijet e djathta dhe nacionaliste – do të shquhet për thellimin e reformave sociale dhe infrastrukturale që do të ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e jetës së shtresave punëtore, duke përbërë njëkohësisht një frymëzim epokal për valëvitjen politike dhe kulturore të ideve të majta anembanë kontinentit (Polanyi, fq. 298–299). Për një trajtesë të përgjithshme në lidhje me marksizmin në Austrinë e periudhës mes dy lufrave botërore, *shih*: Bottomore – Goode, 1978, *passim*.

449. Çka do të pohohet, në njëfarë mënyre, edhe nga vetë militantët. Siç shkruante, disa kohë më vonë, edhe nr. 1 i Buletinit jeshil të Grupit Komunist të Shkodrës, «[i]detë komuniste kanë ardhur nga jashtë, nga puntorët dhe intelektualët që kanë punuar në vende të përparuar». *Shih*: AQSH, F. 11/AP, D. 1, , fl. 1. Buletin i Organizatës Komuniste të Shqipnis, nr. 1, *Për një Parti Komuniste*, dhjetor 1938.

450. AIDSSH, po aty, fl. 17–18. *Promemorie*.

451. *Ibidem.*, aparati dogmatik i asaj historiografie bën një dallim thelbësor mes grupit komunist me qendër në Korçë dhe atij në Shkodër, duke e gjykuar këtë të fundit si me prije jo plotësisht në linjë me orientimet staliniste, si për shkak të formimit intelektual të Zef Malës, ashtu dhe si pasojë e literaturës trockiste apo anarkiste që qarkullonte mes anëtarëve të grupit. Është e qartë se një gjykim i tillë bazohet kryesisht në formulime interpretuese të ngurta dhe pa pasje dokumentare.



Në vitin 1937, Zef Mala, asokohe 22-vjeçar, gjendej mes një grushti themeluesish vërsnikë të një organizatë politike të majtë në qytetin e tij të lindjes, e cila do të njihet më vonë si Grupi Komunist i Shkodrës.

fq. 130, 133). Aq më tepër që nevoja për një formacion partiak të mirëfilltë, të atashuar zyrtarisht pas Kominternit – ndryshe nga lukunia e grupimeve që me vështirësi mund të kontrolloheshin – lidhej dhe me taktikën e përruar pak vite më parë të “fronteve popullore”. Veçanërisht në atë moment, kur dukej se lufta civile e ndërkombëtarizuar e Spanjës po kthehej në një arenë përplasjesh mes fashizmit dhe komunizmit, Moska e shihte të arsyeshme që partitë dhe lëvizjet komuniste të hynin në bashkëpunime taktike me gjithë forcat antifashiste vullnetmira, jo vetëm të majta (socialdemokrate) por dhe të qendrës (McKenzie, fq. 159)<sup>452</sup>. Përmbysja e kushteve social-ekonomike ekzistuese – revolucioni, me një fjalë – mund të priste, ndërkaq që gjendja politike paraqiste nevojën e përballimit të valës fashiste. Një acarim i mundshëm në marrëdhëniet mes regjimit musolinian dhe Zogut pra dukej më se i mirëpritur, çka donte të thoshte se Kominterni nuk e gjykonte negativisht një mundësi të përkohshme paqeje mes mbështetësve të vet në Shqipëri dhe faktorit nacionalist vendas<sup>453</sup>.

Kjo risi politike, e prurë në fillim të vitit 1938, nuk duket se gjeti përkrahje ndër anëtarët e grupit të Shkodrës. Aq më tepër që zbatimin e saj e mori përsipër një emisar, si Koço Tashko, i cili qe ngarkuar me hedhjen e themeleve të unifikimit të grupeve drejt ngritjes së një strukture të qëndrueshme partiake. Ndërhyrja e tij, në këtë vazhdë, u konsiderua si e diktuar nga interesat e grupit komunist të Korçës

452. Për Hobsbawm-in, taktika e “fronteve popullore” ishte veç një hap në strategjinë e përgjithshme të Kominternit, i cili, pas gjasave, mund të zhvillohej edhe drejt “fronteve kombëtare”, duke hapur për komunistët mundësinë e një bashkëpunimi më organik dhe pragmatik madje dhe me parti të djathta (monarkiste apo konservatore) veç në funksion antifashist (Hobsbawm, fq. 148).

453. «Sot nacionalistët në Shqipëri anojnë nga ana e mëngjër, nga ana e puntorisë. Nacionalistët janë kundër monopoleve, kundër fashizmit italianë prandaj edhe janë gati të bashkëpunojnë me puntorinë.» – do të shkruante nr. 1 i buletinit “Përpara” i grupit të Korçës, botuar në shtator 1938, duke adaptuar plotësisht pra udhëzimet e linjës së Kominternit. AQSH, F. 9/AP, D. 1, fl. 15. *Lëvizja nacionale dhe lëvizja sociale*.

- pjesë e të cilit Koço Tashko kishte qenë fillimisht – asfara nga Kominterni. Linja e re taktike, e cila ngjante se i hapte derën një qëndrimi më të butë ndaj kundërshtarëve të dikurshëm, duke ftuar për një veprimtari njëkohësisht më legale nga ana e komunistëve<sup>454</sup>, u refuzua dhe nga Mala vetë (Dervishi, fq. 102, 133). Mospranimi i hasur lidhej më së shumti me dy arsye të natyrës strukturore: *in primis*, në një atmosferë përgjithësisht të pëshqjelluar mes komunistëve shqiptarë, grupi i Shkodrës kishte krijuar lidhje tashmë me elemente (të përfaqësuara nga militantë si Niko Xoxi) të cilët gjendeshin në përplasje me organigramën zyrtare të grupit të Korçës<sup>455</sup>; *së dyti*, Zef Mala kishte bërë të qartë se lidhja e komunistëve shkodranë me Kominternin nuk do të kalonte përmes “korçarëve”, por përmes Partisë Komuniste Jugosllave, urë lidhëse me të cilën ishin Fadil Hoxha dhe Emin Duraku, dy shqiptarë të Kosovës të anëtarësuar në Grupin e Shkodrës (Frashëri, fq. 137, 196).

Qëndrimi kundërshtues i Malës merr trajtën e një *leitmotif*-i në faqet e buletinit (“Buletini jeshil” siç nis të njihet, për t’u dalluar nga i “bardhi” i Korçës) që Grupi shkodran nis të botojë në fund të vitit 1938. E pavarësisht se organi pajtohet me nevojën që komunistët në gjithë vendin kanë për një strukturë të organizuar partiake, duke iu referuar gjithmonë udhëheqjes së shembullit sovjetik, në faqet e tij mund të shohim edhe një kundërpërgjigje të hapur ndaj akuzave të prejardhura nga grupimi korçar (e kominternistëve që rrinin pas tyre)<sup>456</sup>. Në pak rreshta, pretendimi për pastërti doktrinale dhe metodë leniniste shtjellohet me zell:

Brenda lëvizjes komuniste kanë depërtue elementë të pakontrolluar, bile shkatërrues nga ndonjë herë (...) Në bashkëveprim me partitë politike të shqiptarëve të jashtëm e oportunistat e brendshëm, kjo lëvizje shkatërrimtare po spekulon emnin komunizëm dhe besimin e shokëve të pastërvitun mirë në punë marksiste, tue i shtye këta në një rrugë të gabueme. (...) Vetëm nën këto kondita me quadro shokësh të stërvitun e të sprovuem mirë, na do mundemi të fillojmë agitacionin e gjanë në turmat shqiptare për një demokraci revolucionare, që do të na japi në dorë drejtimin e gjithë lëvizjes popullore shqiptare kundër reacionarëve të brendshëm dhe imperialistave të huej e do nisim ta tërheqim turmën drejt vendosjes definitive të socializmit. E shkuemja duhet të na vlejë si mësim që të mos përsërisim në t’ardhëshmen gabimet e maparshme. Nën shtytjen e frymëzimeve nacionale demokrate, shokët që do të mund të baheshin të vlefshëm për punën, kanë bamë një front të përbashkët me feudalë e reacionarë për përmbysjen e regjimit dhe kanë përfunduem në një *bluff* të madh. Janë sakrifikue ata vetë tue mbartë mbi shpinë edhe dënimin e bashkëvepronësve tjerë agallarë ose demokratë. Shokët komuniste nuk duhet të prestohen ma për *putsche* të papjekuna. (Qëllimi i fundit: revolucioni botnor).<sup>457</sup>

Nëse do ta marrim për të mirëqenë se Zef Mala, si kreu i Grupit Komunist të Shkodrës, ka një peshë në autorësinë e dokumentit<sup>458</sup>, ashtu si dhe në çdo element ideologjik që rrezaton nga një formulim i tillë, kemi paraprakisht disa të dhëna të qenësishme për të hedhur dritë mbi botëkuptimin e tij politik.

---

454. *Ibidem*. Në këtë vazhdë, grupi i Korçës fronte për pjesëmarrje në zgjedhje, çka tërthorazi do të legjitimonte, në sytë e përkrahësve komunistë, terrenin ligjor mbi të cilin bazohej monarkia.

455. AIDSSH, po aty, fl. 17–18. *Promemorie*.

456. Në numrin e parë të buletinit “Përpara” lexojmë: «Mirëpo ka disa shokë që nuk duan të bashkëpunojnë me nacionalistat. S’duan të martohen me ta mbasi kanë frikë se mos bëhen nacionalistë, prandaj duan të mbeten kallogjerë. Ku është sektarizëm. Këta nuk e kuptojnë se në Shqipëri ka pak puntorë dhe se Shqipëria është një vend gjysëm kolonial dhe gjysëm feudal, ku problemi nacional del me doemos në plan të parë » AQSH, F. 9/AP, D. 1, *cit.* fq. 20.

457. AQSH, F. 11/AP, D. 1, *cit.* fl. 1–4.

458. Siç shihet dhe nga dokumentet e gjyqit që u zhvillua ndaj anëtarëve të Grupit të Shkodrës mes janarit dhe shkurtit të vitit pasardhës (ruajtur në AQSH, F. 157, V. 1939, D. 6) dëshmitë dhe pohimet e ndryshme i japin Malës autorësinë e krejt linjës politike, ashtu si dhe formulimeve në buletine, të grupit.

Pikë së pari, kundërvënia retorike midis dy grupeve është qartësisht tregues i dy shkollave të ndryshme mendimi. Që të dyja kanë të bëjnë me mënyrën sesi duhet të vepronte Internacionalja III në mesin e viteve '30. Nëse Grupi i Korçës kishte adaptuar tërësisht linjën e shpallur nga Dimitrovi, shefi i Kominternit, për një bashkëpunim me parti të tjera socialdemokrate, liberale e deri nacionaliste (Dimitrov, fq. 86–119), pasuesit e Malës përdorin një retorikë tjetër: leksiku i kësaj të fundit, vetë nocioni i “diktaturës së proletariatit” – i papërshtatshëm për kushtet shqiptare, sipas Grupit të Korçës<sup>459</sup> – thërret në vëmendje, deri diku, teorinë e ashtuquajtur të “social-fashizmit”<sup>460</sup>. Duket se Grupi i Shkodrës i kishte mbetur besnik kësaj të fundit, që kishte qenë politika zyrtare e Kominternit deri në prononcimin e Dimitrovit, e që e shpallte të barazvlefshme me fashizmin çfarëdolloj socialdemokracie. Fort të dallueshme janë gjithashtu dozat e një puritanizmi leninist që bën thirrje për përpjekje në drejtim të ndërgjegjësimit klasor për shtresat e ulta të shoqërisë dhe disiplinës partiake, ashtu si dhe të një bashkërendimi ndërkomëtarist. Teza këto të fundit që japin përshtypjen e një simbioze mes Grupit Shkodran dhe Grupit të Zjarrit, drejtuar nga Andrea Zisi, i cili gjykonte se në Shqipëri mungonin kushtet objektive për një shtysë në drejtim të revolucionit socialist për shkak të prapambetjes shoqërore (Frashëri, fq. 126–127)<sup>461</sup>.

Tue mos pasë klasa të diferencueme, tue mos pasë proletariat dhe borgjezi në kuptimin e fjalës, na sot nuk kemi luftë klase të vërtetë dhe prandaj nuk jemi në kondita të marrim në dorë flamurin e revolucionit. Neve jemi një shtet gjysëm-kolonial. S’kemi klasa të diferencueme, s’kemi proletariat, s’kemi fashizëm, s’kemi parti komuniste, s’kemi partira të tjera politike (e as të djathta qofshin) rrojmë nën diktaturën e Ahmet Zogut dhe të një klike të vogël feudalësh e agjentësh të huaj (...) Nën këto kondita e veçanërisht pa një P.K., me punue për një front popullor në gjasim të atij të Francës ose të Spanjës, me rrokë programin e tyre e me luftue krah për krah për një demokraci revolucionare ose moderate, domethanë me shtypë ujë në havan.<sup>462</sup>

[N]ë Shqipni asht krijue një farë lande komuniste edhe se kjo landë ka nevojë për seleksionim, për organizim dhe të shkrihet në një Parti Komuniste, me të vërtetë revolucionare, me të vërtetë e zoja me përmbushë rolin historik të sajë si pararojë e klasës punëtore në luftën kundër imperializmit të huej, kundër grabitjeve të klikës zogolliane, kundër borgjezisë shqiptare e të huej (...) Neve kemi nevojë të shkojmë përpara dhe të heqim krah për krah me Partitë e tjera Komuniste të shteteve të Ballkanit në udhën e kryengritjes e të vendosjes së Federatës Socialiste Ballkanike<sup>463</sup>.

Nga ana tjetër, vetë pohimi i Malës, sipas të cilit komunistët e Shkodrës kishin zgjedhur të lidheshin me Partinë Komuniste Jugosllave, është problematik. Në gjysmën e dytë të viteve 1930, komunistët në Jugosllavi, përveç ilegalitetit, vuanin edhe nga përçarjet e brendshme – ndër të cilat, përplasjet midis kupolës që rrinte në mërgatë dhe krerëve të brendshëm ishin, në sytë e Kremlinit, veçanërisht

459. «Duhet t’i flasim popullit me gjuhën që na kupton. Populli s’mund të na kuptojë po t’i flasim për diktaturën e proletariatit ose për republikën ndërkombëtare borgjeze.» – AQSH, F. 9/AP, D. 1, *Ibidem*.

460. Kongresi VI i Kominternit, i mbajtur mes korrikut dhe shtatorit 1928, kishte ndaluar çfarëdolloj bashkëpunimi mes partive komuniste të antarësuar në gjirin e vet dhe formacioneve të tjera jo-komuniste. Kjo linjë, që vinte theksin mbi pashmangshmërinë e përplasjes përfundimtare mes botës kapitaliste dhe asaj socialiste, e kishte origjinën tek nocioni i hershëm leninist i luftës ndaj prirjeve reformiste brenda komunizmit. Teoria e social-fashizmit e çonte një antagonizëm të tillë edhe më në skaj (Pons, fq. 82–85). ons, fq. 82–85. , m klasik të majtë mbi çështjen, krahaso: dhe më në skaj. Për më shumë, shih: e përplasjes përfundimtare mes.

461. Edhe boshti ideor që karakterizonte Grupin e Zjarrit është gjykuar nga historiografia e periudhës hoxxaiste si me tipare trockiste, njësoj siç është shprehur për botëkuptimin politik të Zef Malës (*Historia e Partisë së Punës...*, fq. 36); pavarësisht se këta të fundit ishin rreshtuar kundër taktikës bashkëpunuese me socialdemokracinë, ndërkaq që L. D. Trocki vetë e kishte gjykuar një mundësi të tillë si të udhës dhe realiste (Trotsky, f. 1, 4). Është e qartë se për atë historiograf, si në këtë rast ashtu edhe në cilindo tjetër, akuza për trockizëm nuk ngrihet dhe aq mbi ndonjë shqyrtim doktrinor sa mbi një formulim anatemues drejtuar cilëso figurë që shpallej kundërshtar ndaj dogmës zyrtare.

462. AQSH, F. 11/AP, D. 1, fl. 1–4, *cit*.

463. AQSH, F. 11/AP, D. 1, fl. 1–3, Buletin i Organizatës Komuniste të Shqipnis, nr. 2, *Rishtazi për një Parti Komuniste*, Kallnuer, 1939.

“

Qëndrimi i jem para  
policis dhe para  
pohimeve të shokëve nuk  
kthe Komunist e burrnor  
sepse unë kujtova se tue  
pranue pjesërisht akuzat  
mund të shpëtojë një  
pjesë e organizatës tonë  
dhe organizatat e tjera që  
kishin lidhje me ne. (...)

Zef Mala

”



shqetësuese (Swain, fq. 205–224). Pavarësisht se edhe PKJ-ja i ishte përshtatur zyrtarisht të njëjtës linjë të Kominternit që Tashko kishte përcjellë në Shqipëri, çoroditja ishte e plotë. Andaj, kur Mala i referohej asaj partie, duke shprehur njëkohësisht një qëndrim kundërshtar ndaj taktikës së fronteve popullore, me gjasë e kishte fjalën për ndonjë fraksion të brendshëm, që i bënte qëndresë diktatit të Moskës dhe që shpejt do të humbiste peshë. Pasi vetëm pak muaj më vonë, falë ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të masave asgjësuese kundrejt një pjese të *entourage*-it komunist jugosllav, që në vitin 1939 të ngadhënjente lidershipi i Josip Brozit, pikërisht me bekimin e sovjetikëve. Afërmendsh, të atilla zhvillime e linin grupin e Malës jo vetëm të izoluar brenda dhe jashtë vendit, por edhe të pambuluar kundrejt masave shtypëse që po merrte ndërkohë qeveria e Zogut.

4. Buletini “jeshil” nuk do të ketë jetë të gjatë – numri i dytë, dalë në janar 1939, ishte dhe i fundit – pasi, pothuajse menjëherë pas botimit, të gjithë krerët e Grupit të Shkodrës do të arrestohen, përfshirë Zef Malën<sup>464</sup>. Midis janarit dhe shkurtit u zhvillua një gjyq i posaçëm, në përfundim të të cilit veprimtaria e Malës dhe e shokëve të tij u asgjësua plotësisht. Në lidhje me këtë dalin në pah disa të dhëna interesante që, sipas hulumtimeve të Dervishit, na bëjnë të mendojmë se qëllimi fundor i gjyqit ishte thelbësisht politik. Është vënë re, në fakt, se hetimet e mandej arrestimet nuk përfshinin veç anëtarët e Grupit shkodran, porse edhe ata të atij korçar. Megjithatë, duket se procesi u përqendrua te të parët, duke anashkaluar autorët moralë dhe materialë të Buletinit “të bardhë” korçar, siç dhe emrat më në zë të majtimit shqiptar (Tajar Zavalani apo Koço Tashko). Sipas Dervishit, një diferencim i tillë – siç u pa dhe në dënimet e dhëna<sup>465</sup> – e kishte zanafillën te prirjet më të moderuara të Grupit të Korçës, të hapur siç kemi thënë për bashkëpunim me instanca të tjera, edhe pranë monarkisë, në funksion të bashkëpunimit kundër atij që po perceptohej gjithmonë e më tepër si agresivitet imperialist i Italisë musoliniane. (Dervishi, fq. 133, 158–159). Vija puritane e ndjekur nga Grupi i Shkodrës, prirja e tij për të mos e përfshirë dinamikën politike të marrëdhënieve ndërkombëtare në leximin e përgjithshëm të realitetit shoqëror, sipas këtij interpretimi ia vështirësoi pozitën.

Gjithsesi, në shënimet e veta Mala thotë se e gjithë akuza u mor përsipër nga ai vetë. Çka lejoi që të tjerë emra të mos dilnin. Qëndrimi i jem para policis dhe para pohimeve të shokëve nuk kje Komunist e burrnor sepse unë kujtova se tue pranue pjesërisht akuzat, mund të shpëtoja një pjesë të organizatës tonë dhe organizatat e tjera që kishin lidhje me ne. (...) Mora përsipër se të gjitha përkthimet i kisha ba unë, bile edhe buletinin e bardhë që botonte grupi i Korçës. Mbas këtij procesi që banë natën e parë, së bashku me Vasilin na munduen gati një muaj e gjysmë me radhë por qëndruem e shpëtuam grupin e Korçës, të Rinisë, grupet e oficeret, grupet e vajzave këtu në Tiranë tuj mohue njoftjen me të dhe tuj rrëzue thëniet e Nikos (Xoxit, i cili, sipas Malës, u kthye gjatë gjyqit në kallzuesin kryesor të veprimtarisë së grupeve komuniste)<sup>466</sup>.

Ndërkaq që marrëdhëniet mes Tiranës dhe Italisë fashiste kishin hyrë përfundimisht në fazën e tendosjes që do të shpërthente në fillim të prillit (Milo, fq. 848, 891–892), monarkia shqiptare përpiqej të tregojë gjithashtu e hapur ndaj çdo dore të shtrirë, qoftë dhe e majtë. Italia fashiste – pas ndërhyrjeve të jashtëligjshme në Etiopi dhe Spanjë (1936–1939), si dhe përfshirjes në të njëjtin pakt anti-Komintern me Berlinin (1937) – nuk jepte shenja ndaljeje. Rrjedhimisht, monarku shqiptar kishte nevojë të ndihej i qetë në frontin e brendshëm, e pse jo, të rrokte mundësinë e një konsensusi më të gjerë; çka me siguri nuk mund t’i vinte nga qasje radikale si ajo e pasuesve të Malës, apo nga të tjera grupe, si ai i Zjarrit, që madje e përshëndesnin një pushtim hipotetik italian si përshpejtues të atyre kushteve socio-ekonomike

464. AIDSSH, po aty, fl. 18. *Promemorie*.

465. Miha Lako, kreu i Grupit Komunist të Korçës, në fund të procesit, u lirua. Vetëm njëri ndër të dënuarit maksimalisht (10 vjet heqje lirie) i përkiste “korçarëve”, Petro Dume, ndërsa ishte e dukshme se Grupi Komunist i Shkodrës, bashkë me grupet më të vogla (si ai i Rinjve apo i Zjarrit) dalin shumë më të goditur se kolegët e tyre të Korçës. *Shih*, AQSH, F. 157, D. 6, *cit*.

466. AIDSSH, po aty, fl. 18–19. *Promemorie*.

(industrializimi përmes injektimit të kapitalit të huaj dhe lindja, për rrjedhojë e proletariatit vendas) që gjykoheshin të volitshme për shpërthimin e një revolucioni socialist. Arsye të vlefshme këto që Zogu të dëshmonte vullnet bashkëpunues me “komunistët” korçarë; duke ua kursyer atyre dënimet, por duke ua spastruar edhe terrenin politik prej “sivëllezërish” të pabindur dhe “sektarë”. Në atë rast, Zef Mala do të dënohet me 12 vjet heqje lirie, të cilat do t’i vuajë, së bashku me të tjerët (Qemal Stafa dhe Vasil Shanto mes tyre) në një kamp pune në fshatin Mbreshtan, pranë Berat. Do të jenë zhvillimet politike të pranverë-verës 1939, me rënien e monarkisë zogiste dhe pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, që do të shkaktojnë ndërprerjen e dënimit me hapjen e burgjeve më 6 prill. I shoqëruar nga Vasil Shanto, Zef Mala do të arratiset drejt Jugosllavisë, rrugëtim nga i cili u kthyen sërish mbarsht pasi autoritetet jugosllave i dëbuan. Me të hyrë prapë në Shqipëri, mes kaosit institucional në cilin ndodhej vendi pas hyrjes së trupave italiane në Tiranë, dy komunistët shqiptarë do të njoftohen për amnistimin e tyre<sup>467</sup>.

Fati politik i Zef Malës, duke nisur ky çast, do të nisë të distancohet nga ai i Grupit Komunist të Shkodrës, megjithëse duke vazhduar të jetë pikë reference në veprimtarinë e anëtarësisë. Në të njëjtën kohë, për sa i përket ardhmërisë së një partie komuniste të organizuar, ndikimi i tij do të shkojë sidoqoftë drejt rënies – njësoj, fundja, si për vetë ish-grupin e drejtuar prej tij, që me rastin e themelimit të PKS-h-së (1941) nuk do të përftojë më shumë se rolin e një *backbencher*-i. Pavarësisht se “shkodranët” do të jenë një ndër pak grupet e të majtës që do të mbeten relativisht aktivë pas prillit 1939, ishte e pashmangshme të mos ishin pjesë e topitjes së përgjithshme që kishte pësuar ndërkohë gjithë lëvizja komuniste anembanë Evropës, në vazhdën e paktit Ribbentrop-Molotov (Pons, fq. 122-123). Ndonëse Grupi Komunist i Shkodrës luajti rol thelbësor në përpjekjen e parë për të vendosur një tryezë dialogu midis tyre dhe lojtarëve të tjerë komunistë, duke ngritur madje edhe një Komitet të përbashkët në përpjekje për të koordinuar veprimtarinë anti-italiane në nëntor, Mala vetë pëson një dalje të përkohshme nga skena. Pothuajse menjëherë pas protestave që pasuan marrëveshjen trekëndore mes grupeve të Korçës, Shkodrës dhe të ashtuquajturit të të Rinjve, ai do të arrestohet sërish me akuzën si antifashist<sup>468</sup> – pasi qe arratisur prej burgu – nga autoritetet e reja të rendit publik në Shqipëri, duke u dënuar me internim në Ventotene (Itali)<sup>469</sup>. Do të jetë në këtë lokalitet ishullor që do të ketë mundësi jo vetëm të njihet me personalitete të shquara të antifashizmit italian (nga komunisti Pietro Secchia, te federalisti Altiero Spinelli), si dhe të takohet e miqësohet me emra jo të panjohur të qëndrësës antifashiste shqiptare, si vëllezërit Kryeziu, por dhe të një antistalinisti të deklaruar tashmë si Llazar Fundo (Secchia, fq. 46).

5. Deri në kthimin e tij në Shqipëri, në verën e vitit 1943, veprimtaria politike e Zef Malës mbeti pezull. Pavarësisht orvatjeve të vazhdueshme për t’i shërbyer lëvizjes edhe në kushtet e internimit, ai mbetet krejtësisht i izoluar kundrejt zhvillimeve politike në Shqipëri. Kur autoritetet italiane urdhërojnë rikthimin e tij pas, me qëllim përfshirjen në një gjyq të posaçëm ndaj më shumë se 200 komunistëve ku ai akuzohet si hedhës i farës komuniste në vend (Dervishi, fq. 242), lëvizja zotëronte tashmë një ngrehinë partiake. Pas kapitullimit italian, në shtator të po të njëjtit vit, ndërsa Mala arrin të arratiset, ai gjen një Parti Komuniste me hierarki të hekurt dhe dukshëm të strukturuar në rangjet e veta, fort të lidhur me homologen e saj jugosllave që është kthyer tashmë në urë ndërlidhëse zyrtare mes komunistëve shqiptarë dhe Moskës. Ç’është më e rëndësishmja, Mala ndodhet përballë një formacioni që ishte shprehi e drejtpërdrejtë e vullnetit stalinist për të përjashtuar çfarëdolloj shtyse opozitare brenda saj. Kushtet ndërkombëtare kishin ndryshuar; tashmë Bashkimi Sovjetik ishte në luftë me Gjermaninë naziste dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare i ishte rikthyer parullës së luftës ndaj fashizmit, duke synuar njëkohësisht edhe një pozitë mbizotëruese të elementëve të vet lokalë (partive të ndryshme komuniste) në gjithë territoret evropiane ku po luftohej. Çka nënkuptonte se çfarëdolloj elementi i dyshuar si jo-ndjekës i vijës ortodokse të Kremlinit – e që shpesh dëftohej si trockist – vështirë se do

467. Po aty, fl. 19.

468. AQSH, F. 53, D. 31/8, V. 1940, faqe 215.

469. AQSH, F. M.P.B. Drejtorja Politike, D. 93, V. 1940, bobina 5.

të mund të gjente vend brenda strukturave partiake. I pamundur të ishte pjesë, për arsye rrethore, i mbledhjes së parë të Partisë Komuniste, në të cilën tre grupet themeluese (i Korçës, Shkodrës dhe të Rinjve) mundën të sheshonin mosmarrëveshjet edhe falë ndërmjetësimit jugosllav, Mala mbeti tërësisht jashtë loje (Pipa, fq. 80). Emri i tij, në atë rast, por dhe i të tjerë veprimtarëve mbi të cilët rëndonte një e shkuar plot mosmarrëveshje me Grupin Komunist të Korçës, u përmend me përçmim, në vazhden e gjithë një narrative të re që kishte nisur të zyrtarizohej, e cila e përkufizonte në mënyrë mjaft kritike përvojën e grupeve parapartiake komuniste në Shqipëri (Dervishi, fq. 195–196). Do të jetë kjo periudhë e cila, pas çlirimit do ta stigmatizojë Malën si «me tendenca anti-parti, edhe pas formimit të Partisë»<sup>470</sup>.

I vënë patjetër në dijeni të këtyre zhvillimeve, nga burgu Mala përpiqet të bjerë në kontakt me krerët e saj, duke i dërguar Komitetit Qendror një letër në të cilën shpreh autokritikë ndaj qëndrimeve të tij të shkuara politike «se gjatë kohës së shkueme kisha ba punë, por edhe gabime, kishem krijue shumë miq, por dhe armiq, kushtet fizike të mijat e sidomos pamja më ishin dobsue shumë dhe nuk më lejojshin më me zhvillue veprimtari intensive se kishnja frikë mos bijsha rishtazi në gabime ose me individualitetin t’im të bahesha pengim për Partinë, dhe se prandaj dojsa t’isha afër Partisë por t’i kushtohesha studimeve të mija porsa të mbaronte lufta»<sup>471</sup>.

Përgjigjia i vjen nga Enver Hoxha personalisht, e cila, edhe pse vonon, bart një frymë deri diku pajtuese kundrejt të akuzuarit; pavarësisht se i bëhet atij të ditur, tërthorazi, se « [g]jak i ri dhe i pastër lëvrin në radhët e » PKSH-së dhe se koha e *entourage*-it të grupimeve kishte perënduar. Për Hoxhën: Gabimet e bamuna prej ish grupevet të ndryshme komuniste, i kanë bamë dëm të madh lëvizjes s’onë; ato kanë penguar formimin e Partis, ata kanë sëmumur mjaft shokë dhe konsekuencat e punës së vjetër grupashe, për fatin e keq të Partis s’onë ndihen dhe shikohen herë pas here gjatë luftës dhe përpjekjeve Megjithatë, siç thamë, qëndrimi i kreut të ri rreket të duket vullnetmirë.


“Vendimi i marrun nga Komiteti Qendror karshi teje ka qënë i drejtë dhe dënimi i peshuar mirë. Por sikundër që e di çdo dënim që jep Partija ka një karakter edukativ dhe ajo ndihmon të ngrihen, të gjejnë rrugën e drejtë, të gjithë ata që kanë gabuar dhe që i njohin gabimet e tyre dhe që ia rifillojnë punës së re me gjithë vullnet dhe bindje. (...) Përsa i përket tezave të tua të shkrojtura mbi çështjen Shqiptare që prej ‘38-‘41 nuk i kemi të gjitha dhe do të jetë mirë që të na i çoni që të mundim t’i shqyrtojmë me imtësi; por sikundër që e thua vet n’autokritikën për skjarime dhe kritikën e tyre duhet t’a lëmë kur të vijë momenti që të jesh jashtë, pse vetëm duke e diskutuar gjërë e gjatë së toku besojmë se do të të skjarojmë dhe të të bindim mbi sa mund të kesh gabuar”<sup>472</sup>.

---

470. AIDSSH, Dosje Formulare nr. 2505 Zef Malaj, fl. 9. Raport propozimi në II A për përpunimin e Zef Malës, 19.02.1955.

471. AIDSSH, po aty, fl. 20–21. Promemorie.

472. AQSH, F. 14/APL, L. 1, D. 33, fl. 1. Letër e Komitetit Qendror të Partisë drejtuar Zef Malës në lidhje me autokritikën e tij që i ka drejtuar Komitetit Qendror të PKSh, datë 01.08.1943.



Autokritikë e Zef Malës drejtuar  
PKSH-së më 1943

6. Zef Mala nuk do të qëndrojë shumë kohë në burg. Pas kapitullimit të Italisë, më shtator 1943, ai do të përfitojë nga gjendja kaotike e autoriteteve dhe do të arratiset. I gjithë përjetimi i pjesës së mbetur të luftës, nga ana e tij, do të jetë mjaft i heshtur<sup>473</sup>. Për shkak të sëmundjes së syve, e cila do ta shoqërojë gjithë jetën, veprimtaria politike e Malës do të ndërpritet, pavarësisht se për pak kohë ai do të strehohet në Pezë, pranë kryeqytetit, vend në të cilin do të mbulojë detyrën e sekretarit të Shtabit për zonën. Në vijim, për shkak të pamundësisë së ushtrimit të rolit që i ngarkohet, pikërisht si pasojë e sëmundjes, Mala do të dërgohet në Tiranë, prej ku, në ilegalitet, do të rrijë në pritje të çlirimit të vendit dhe marrjes së pushtetit nga ana e komunistëve të Hoxhës<sup>474</sup>.

Duket se rrjedha e ngjarjeve e kishte bindur tashmë Malajn për fatin e tij politik. I ndërgjegjshëm se që mënjanoar, përpjekja e tij e vetme do të shkonte në drejtim të një përfshirjeje në sferat kulturore, a të ngjashme, të r'egjimit të ri; ndonëse pa u anëtarësuar ndonjëherë në PKSH dhe pa bërë kërkesë në këtë drejtim (çka do të shihet me dyshim)<sup>475</sup>, e madje duke u përpjekur shprehimisht t'i qëndrojë

473. AIDSSH, Dosje Formulare nr. 2505, fl. 40. Zef Malaj, *Proces-verbal*, 04.08.1948.

474. Po aty, fl. 8. *Raport propozim përpunimi për Zef Malën*, 04.08.1952.

475. Do ta përligji këtë vendim të tij në këtë mënyrë, më 1947: «Edukimi dhe formimi im i vjetër me frymën e grupeve kisha frikë se mos më shtynte të binja në gabime. Unë i kisha kuptuar gabimet e vjetra, mirpo dyke dyshuar se mund të bëjta ndonjë gabim në punë e sipër kisha frikë se do të keqkuptohej. Nga ana tjetër dyke qenë fizikisht jo mirë nuk isha në gjendje të jepnja sa duhej» - AIDSSH, po aty, fl. 34. *Deklaratë*, 09.01.1947.

larg çfarëdolloj angazhimi të kulluar politik<sup>476</sup>. Përkundër, ai do të jetë ndër të parët viktime të asaj propagande akuzuese ndaj grupeve para-PKSH, për bashkëpunim me Llazar Fundon dhe veprimtarë trockistë, që kishte nisur pa mbaruar ende lufta; e që letra e Enver Hoxhës parashikonte më së miri<sup>477</sup>.

Ndërkaq që dërgohet për t'u mjekuar në Itali, për njëfarë periudhe ai do të vendoset në një pozicion krejt të mënjanuar pranë Misionit Civil shqiptar në Romë, nga ku do të kthehet në prill 1945. Do të jetë kjo periudha kur Mala, falë dhe prestigjit intelektual që gëzonte te disa prej personaliteteve më të larta komuniste – por, me ç'duket, nuk ishte kështu për Enver Hoxhën<sup>478</sup> – e mbase dhe të ndonjë mbështetjeje miqësore që ende kishte pranë jugosllavëve, emërohet shef seksioni në Bibliotekën Kombëtare të sapokrijuar. Nga raporti që do t'i bëhet pak vite më vonë, nga zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të rezultojë se puna e tij në krye të institucionit nuk pati qenë fort e qetë. Biblioteka ngrihej në bazë të “kontributeve” që vinin nga një sërë selish private, të cilat shpesh i përkisnin personaliteteve të cilët ishin shquar gjatë Luftës si kundërshtarë të komunistëve (Lef Nosi, Mit'hat Frashëri, Terenc Toçi). Njëkohësisht ajo kërkonte ndërhyrje të gjithanshme për shkak të kushteve të ndera materiale në të cilat gjendej godina që i ishte akorduar institucionit. Ndërhyrjet e Malës në këtë drejtim nuk munguan, pavarësisht se është e qartë, nga dokumentacioni i përpiluar më vonë, se ndaj tij ekzistonte një frymë e përhershme dyshimi<sup>479</sup>. E në fakt, pak muaj para arrestimit, në maj 1947<sup>480</sup>, ndërkaq që nuk ishte më në krye të Bibliotekës Kombëtare, ai u akuzua – duke u përjashtuar edhe nga sindikata e punonjësve përkatës – «për shkak se nuk kishte bërë pastrimin e librave fashistë që ndodheshin aty, për shtytjen e Nën-punsave që të mos nënshkruanin një Komunkim të Drejtorit»<sup>481</sup>.

Pasi arrestohet nga organet e Sigurimit të Shtetit, Mala do të qëndrojë në burg deri në vitin 1949. Diku, te raporti i një informatori, del se shkak për lirimin e tij ka qenë ndërhyrja e Tuk Jakovës<sup>482</sup>. Gjithsesi, pavarësisht kësaj përvoje, atij do t'i lejohet puna në Institutin e Shkencave, ku, me urdhrin për themelimin e Arkivit të Shtetit, më 8 qershor 1949, do të emërohet drejtori i parë i tij. Sidoqoftë, duke nisur nga viti 1952<sup>483</sup>, Mala do të vrojtohet me më vëmendje se më parë (duke kaluar në nivel më të lartë përgjimi<sup>484</sup>) nga funksionarët e policisë politike të regjimit, të cilët përgatisin dhe një dokumentacion të imët për ato sjellje që shfaqen shqetësuese në sytë e tyre. Si p.sh.:

“Është në opozitë me vijën e Partisë dhe të Pushtetit, interpreton evenimente të ndryshme politike në kundërshtim me realitetin duke propaganduar se Pushteti jonë nuk i ka pozitë e shëndosha dhe se kapitalizmi është në ofensivë, ku kampi imperialist është më mirë, bota kapitaliste e kapërxeu krizën e parashikuar të mbas luftës. Zefi gjithashtu thotë se mos pëlcase lufta me ndonjë vënd në Evropë,

476. AIDSSH, po aty, fl. 21. *Promemorie*.

477. Disa vite më vonë, tashmë në qeli dhe i akuzuar si anti-parti, sipas një dëshmie të pafirmosur, Mala do të pohojë se emri jo i mirë që gëzonte në gjirin themelues të PKSH-së vinte për shkak se «shokët e mij të vjetër, Qemal Stafa, Tuk Jakova, Vasil Shanto, (dhe më duket) Kristo Themelko duke përfutur nga mungesa ime këtu kur u formua Partija, të gjitha fajet e grupit t'onë që ishin edhe fajet e tyre mi ngarkuan mua, kështu që unë mbeta fajtor në sy të Partisë, duke mos pasur mundësi të s'qarohem kam mbetur gjer më sot si fajtori kryesor si përgjegjësi me fajet e grupit Shkodrës». – AIDSSH, po aty, fl. 38. *Deklaratë*, 25.01.1948. Po ashtu, Mala do të mohojë çfarëdolloj bashkëpunimi përgjatë luftës me Fundon apo trockistët. – Po aty, fl. 51. *Raport*, 18.11.1952.

478. «Unë e një pjesë e mirë e shokëve e njohim dhe e dënojmë Zef Malën, por ka dhe nga ata që akoma kanë iluzione për të. Ka bile ndonjë që e quan konfuzin antimarksisht Zef Mala si “teoricien të madh”». (Hoxha, fq. 160).

479. AQSH, F. 511, D. 45, *Promemorie mbi nevojat, punën e prespektivat e Bibliotekës dhe Muzeumit Kombëtar*, 02.04.1946.

480. AIDSSH, po aty, fl. 12.

481. AIDSSH, po aty, fl. 8, 42.

482. AIDSSH, po aty, fl. 69.

483. AIDSSH, po aty, fl. 10. *Plani i masave operative agjenturale të përpunimit të Zef Malës i kategorizuar në II. B*, Tepër sekret, 05. 11. 1953.

484. AIDSSH, po aty, fl. 63. *Plan nr. 2 i masave operative agjenturale për dosjen II-B të quajturit Zef Mala*, Tepër sekret, 05.10.1954.

ndoshta edhe kundra nesh, nuk ma pret mëndja që B.S. dhe Bullgarija e vënde të tjera të Demokracisë Popullore të hyjnë në luftë për një copë Shqipëri të izolime etj. etj<sup>485</sup>”.

Në një bisedë me Andrea Varfin<sup>486</sup> është shprehur në këtë mënyrë: “Lufta është e pa evitueshme”, shkaku i luftës do të jetë Gjermanija, Zefi thotë se Polonia që në pjesën më të madhe është katolike nuk është e lidhur kaq ngushtë me Bashkimin Sovjetik pra këtu ka një pikë të dobët, Zefi ç’faq dyshime për plasjen e Bombës Atomike nga ana e Bashkimit Sovjetik. Tue folë për borgjezinë Amerikane dhe atë Engleze, Zefi thotë se borgjezija Engleze është më e aftë. Tue krahasue se cili është armiku ma i rrezikshëm nga t’arratisurit jashtë Shtetit për vëndin t’onë, Zefi Mala thotë se ma i rrezikshëm është Mustafa Kruja sepse ay ka një vijë politike të caktuar që konsiston me pasë marrëdhënie të mira me Italinë, por jo me u ba koloni e tyre. (...) Gjithnji tue bisedue për një luftë që është e mundshme, Zefi Mala thotë se udhëheqja e Partisë nuk ban burrëni me u largue por duhet të qëndrojë deri në fund tue luftue. Siç shihet pra Zefi Mala vazhdon të qëndrojë në pozitat anti-parti, ay nuk ka besim në forcën e kampit Demokratik dhe anti-imperjalist, nuk ka besim n’udhëheqjen e Partisë S’onë.<sup>487</sup>

Si duket kërkojnë të shkëputin lëvizjen komuniste prej çdo tradite. Sipas tyre komunizmi ka ardhë në Shqipëri vetëm kur këta formuan Partinë. Por historia është e gjallë: në kohën kur Enver Hoxhës i pritej bursa nga regjimi satrap i Zogut dhe i jipej nëpunësi në Konsullatën shqiptare në Bruksel, ndofta për të luftuar më mirë regjimin e Zogut (këto fjalë i tha më ironi), të tjerë punonin me komunizmin<sup>488</sup>.

Në të gjitha raportet e këtij lloji, del në pah lirshmëria me të cilën Zefi Mala shprehet, sidomos në lidhje me çështje ndërkombëtare<sup>489</sup>, apo mbi figurën letrare të Fishtës<sup>490</sup>. Njëkohësisht, të qenët kritikues përtej atyre caqeve politike të konsideruara tashmë si dogmatike – e që mund të shfrytëzohet lirisht nga çfarëdolloj dashakeqësie intepretuese – por dhe shoqërimi i tij me persona ndaj të cilëve rri gjithashtu pezull dyshimi i veprimtarisë “anti-parti” (si rasti i Shyrete Turkeshit, apo i Kasëm Trebeshinës<sup>491</sup>), kanë kontribuar shumë në mbushjen e dosjes akuzuese<sup>492</sup>. Sidoqoftë, mbetet e pamundur të dimë më siguri se sa këto pohime të deklaruara nga përgjuesit (agjenti “Dhelpëria” dhe informatori “Dinamo”) përputhen me ato çka Mala mund të ketë thënë në realitet. Përkundër, procesverbalet e pyetjeve që i bëheshin në organet përkatëse dëshmojnë për një njeri fort të kujdesshëm në përgjigjet që jepte.

Deri kur merret në pyetje në qershor të vitit 1955, ku sipas proceverbalit, ai pranon se «nuk kam qënë në gjëndje ti përmbahem detyrimit qi i kisha bërë vehtës që të mos interesohesha për asnjë çështje tjetër përveç antyre që kishin të bëjnë me punën e përditshme. (...) ndofta i lodhur nga braktisja në

485. AIDSSH, po aty, , fl. 9. *Raport propozimi në II A për përpunimin e Zefi Malës*, Tepër sekret, 19.02.1955.

486. I cili, në një tjetër raport, tregohet se është shprehur i keqardhur nga shkarkimi i Zefi Malës prej Bibliotekës Kombëtare. «Çuditem, tha Andrea, nuk ma merrte mendja se do të arrinin deri këtu me Zefin ». AIDSSH, po aty, fl. 32.

487. AIDSSH, po aty, fl. 33. *Informatë*.


488. AIDSSH, po aty, fl. 64. *Raport*, 24.11.1954. Aluzionin për pajtimin e Enver Hoxhës si informator nga regjimi i Zogut në vitet 1930, raportohet se Mala e bën sërish në vitin 1974. – Shih: Po aty, fl. 280. *Shënim operativ*, 10.11.1974.

489. Shih: AIDSSH, po aty, fl. 48. *Raport*, 23.12.1950.



490. E njëjta vëmendje i kushtohet edhe pohimeve të Malës në lidhje më gjuhën shqipe «Kam qenë i mendimit se për sa i takon shkollave fillore dhe unike të jepeshin mësim në dy tekste, gëgërisht për shkollat e veriut dhe tekste toskërisht për shkollat e Jugut. Për shkollat e nalta të përdorëshin dy tekstet (dy dialektet), p.sh. një tekst i gjeografisë mund të jetë gegënisht ai i historisë toskënisht etj. si mbas auktorit të librit. Jam i mendimit se tendenca e zhvillimit gjuhës Shqiptare shkon drejt gegënishtes ». Po aty, fl. 85. *Procesverbal*, 06.07.1955.

491. AIDSSH, po aty, fq. 70. *Raport*, 20.06.1955.


492. Si për shembull: AIDSSH, po aty, fl. 31–32, 42–45, 50–62. Pothuajse kudo, spikat një respekt i veçantë për figurën e Mehmet Shehut, teksa Mala, sipas informatorëve, shprehet më mospërfillës ndaj fjalimeve të Enver Hoxhës.



AIDSSH, Dosje formulare nr. 2505 për Zef Malën



AIDSSH, Fletë regjistrimi për Zef Malën, nga dosja formulare për të



AIDSSH, Plan masash nga dosja e Zef Malës

të cilat gjëndesha, pësova një çthurje shpirtërore dhe fillova të kem dhe manifestoj mendime që më përpara as i kisha manifestuar. Këto konsistojnë në komentimin e ngjarjeve të mëdhaja dhe problemeve të përditëshme të Pushtetit»<sup>493</sup>. Po në këtë periudhë, Mala dëshmon se një delegacion i Partisë Komuniste Italiane, kryesuar nga Luigi Longo, pati ardhur në Tiranë plot dy herë duke i kërkuar autoriteteve shqiptare që ta linin marksistin shkodran të shkonte të mjekohej në Itali. Kërkesë e cila rregullisht refuzohet<sup>494</sup>.

Si pasojë, organet e Hetuesisë bëjnë gati një raport sipas të cilit « [r]rezikshmëria e Zef Malës qëndron në faktin se ay mbjell panik për pasigurin e vëndit t'onë, duke e lidhur me rrethimin gjeografik dhe në mos respektimin e traktateve të ndryshme që ka lidhur vendi jonë. »<sup>495</sup>. Pasi Zef Mala pranon se është fajtor sipas akuzës së formuluar – porse «në kohën që kam zhvilluar këtë aktivitet kundërshtar në agitacion dhe propagandë nuk kam mendue se ka qënë e tillë»<sup>496</sup> – ai dënohet me 5 vjet heqje lirie më tetor 1955, për t'u shlyer në burgun e Burrelit.<sup>497</sup>

7. Jeta e Zef Malës në burg do të karakterizohet nga vëzhgimi i vazhdueshëm i gjithë pohimeve që bën gjatë qëndrimit atje, si dhe shoqërimit që ai ka me të tjerë të burgosur politikë. Ka të dhëna se gjatë qëndrimit në burg ai ka zhvilluar orë mësimore të kushtuara historisë së grupeve komuniste në Shqipëri para themelimit të PKSH-së<sup>498</sup>. Shkruan, në këtë vazhdë, një raportues nga burgu: «Zefi tani në burgun e Burrelit jo vetëm që nuk është penduarë, por zhvillon veprimtari kundërshtar e si mbas të dhënave këtë e zhvillon në favor të ideve Socialiste duke përkrahur Socialistat e perëndimit dhe ja ka qejfi që edhe këtu në Shqipëri një rregjim i tillë si kur të vendosej nuk do të ishte keq.»<sup>499</sup> Kësisoj, megjithëse do të lirohet në nëntor të vitit 1959, në sajë të raportimeve negative që vijnë mbi pohimet e tij përgjatë kohës së vuajtjes së dënimit, Zef Mala do të vazhdojë të jetë nën mbikëqyrje të lartë nga ana e organeve të Sigurimit të Shtetit<sup>500</sup>.

Raportimet e kësaj kohe, të cilat lypen vëzhguar me lupë kritike për sa i përket vërtetësisë së tyre, na japin gjithashtu një ide mbi evolucionin e mendimit marksist të Malës. E ky, afërmendsh, e shpreh atë nën prizmin ndikues të realitetit politik shqiptar. Kësisoj, raportet rreth tij dëshmojnë një reflektim ideologjik që Malën e çon drejt një qasjeje më të afërt me socialdemokracinë klasike.

“Ne social demokratët kemi pasqyrën e vërtetë të drejtësisë dhe të një demokracije reale Marksiste. Komunizmi i Leninit është i shtrembëruarë dhe mbahet në fuqi me diktaturën e proletarjatit pse po të mos e kishin këtë kurë nuk do të qëndronin në fuqi dhe të kishin kaqë jetë të gjatë. Masa duhet të ngrihet me evolucion dhe të jepet e drejta e plotë e lirisë, të mos ketë frikën e automatikut siç veprohet sot”<sup>501</sup>.

---

493. AIDSSH, po aty, fl. 77. *Procesverbal*, 29.06.1955. Kjo linjë rrëfimi para autoriteteve, ku Mala do të pranojë vetëm ato që i quan manifestime me « mejtime në opozicion me vijën e partisë dhe Pushtetit » do të jetë e tillë dhe në vijim. Po aty, fl. 80, 82, 83.

494. Po aty, *Informacion*, 29.10.1964, fl. 208. Shih dhe, po aty, *Raport*, 15.02.1971, fl. 270. Gjithçka konfirmohet dhe nga një tjetër burim, ish-kreu i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës (1950–1951) në vitin 1966, teksa ishte vetë nën vrojtim, i cili pohon se vetë Enver Hoxha ishte shpenzuar pranë dërgatës italiane për të bërë të pamundur vajtjen e Malës në Itali, duke penguar shprehimisht takimin mes tyre. – po aty, fl. 258.

495. AIDSSH, po aty, *Relacion përmbledhës për materialet që kemi për të kategorizuarin në II, A Zef Mala*, tepër sekret, 22.06.1955, fl. 76.

496. AIDSSH, po aty, *Mbi njoftimin e Akuzës*, 11.07.1955, fl. 94.

497. AIDSSH, po aty, *Vëndim mbi transferimin e dosjes formulare II-A*, Tepër sekret, 13.02.1956, fl. 148.

498. Po aty, *Proces-verbal*, 20.10.1970, fl. 272.

499. AIDSSH, po aty, *Biografia e të burgosurit Zef Cjon Mala*, 24.09.1959, fl. 158. Shih dhe fl. 159–160.

500. Po aty, *Raport propozimi për kategorizimin në II-A për të quajturin Zef Mala*, 04.02.1960, fl. 163, 166, 188.

501. Po aty, *Raport*, 21.03.1960, fl. 164. Shih dhe: fl. 174.



Marksizmin e shtrembërojnë simbas rrethanave ekonomike, politike e simbas diktatit të Moskës. Unë – tha Zefi, e di se kam falimentue, se të gjithë rrethin tim e kanë zhdukë ose burgosur. Unë tha kam pasur frikë internimin por shpëtova. Këto të gjithë kanë devijue dhe kanë zhdukur Marksistat ma të mirë. Si Sejfulla Malëshova, Tukur e të tjerë. (...) Ne, tha na quajnë me njëmij emra si trockista, social-demokratë e tjerë, por në të vërtetë ne jemi Komunistat e vërtetë. Nënë këtë regjim puntori i cili luftoj për çlirimin e tij, vuan përsëri, pse shteti është shndërrue në një punëdhënës që i shfrytëzon deri në palcë puntorët. (...) Jam plotësisht i bindun se Komunizmi ndërkombëtar e ka humbur davanë për arsye se e kanë paraqitur shtrembët pse është praktikue shtrembët (...) Ky nuk asht as Komunizmi i Marksit, as i Leninit<sup>502</sup>.

Ndërkaq që gjendja e tij ekonomike, ashtu si dhe ajo e shëndetit, vështirësoheshin tej mase<sup>503</sup>, Mala u lejua të qëndronte në Tiranë, porse marrëdhëniet e tij shoqërore gjykoheshin, në bazë dhe të pohimeve të tij, si inekzistente. Fillimisht ai çohet në Shkodër, pastaj internohet në Zvërnec të rrethit të Vlorës, e mandej, duke gjykuar edhe shëndetin e tij të brishtë, lejohet ta përfundojë periudhën e dënimit në Tiranë<sup>504</sup>. Një veçim i tillë nga kontaktet nuk i pengonte autoritetet që të denonconin ato pohime kritike ndaj regjimit, aq karakterizuese të Malës, të cilat do të ktheheshin dhe në mallkim për të deri në fund të jetës. Kritika, ato të Malës, që drejtoheshin kah “aplikimi” i përgjithshëm i teorisë socialiste në rastin shqiptar («kjo udhëheqja jonë nuk udhëheq, por shtyp»), tashmë që thyerja e aleancës me Moskën ishte thjesht çështje kohe. Madje, nuk janë të rralla rastet kur orientimi “evolucionist” i regjimit hrushovian, që sipas Malës «don me shembë rendin e fanatikve, mendje mëdhenjve, injorantëve, që shtypin pa mëshirë për interesa vetjake» përkrahet shprehimisht<sup>505</sup>. Në fjalët e raportuara nuk mungon dhe një frymë pendese që Mala shpreh, sipas përgjuesëve, kundrejt veprimtarisë politike të ushtruar nga vetë ai në kohën e monarkisë zogiste.

Ky sistem është totalitar, policor, që terrorin e ka për parim, por unë nuk duhet të ankoem se vetë e desha këtë sistem. Zogu na jepte nga 15 napolona flori për studime kur ishim studentë dhe neve qaheshim nga ai, donim të çlironim popullin. Ja si e çliruam<sup>506</sup>.

Mendohet se në mesin e viteve 1960, pikëpamjet e tij të rishta dhe kritike drejtuar filozofisë marksiste, ashtu edhe në tërësi për marrëdhëniet globale gjatë Luftës së Ftohtë, Mala i ka përpiluar në një sërë shënimesh të cilat, në mendjen e autorit, do të duhet të përbënin një libër voluminoz; por që do t'i humbasin gjurmët e nuk do të dihet më fati i tij<sup>507</sup>. Çka del qartë, përpos arsyetimit tërësor teorik, është një zhgënjim i mirëfilltë nga ana e tij në lidhje me krejt zhvillimin sistematik të socializmit real, duke gjykuar përfundimisht se kasta qeverisëse shqiptare,

---

502. Po aty, *Raport*, 21.02.1960, fl. 178-180.

503. Po aty, *Raport*, 08.09.1961, fl. 189.

504. Po aty, *Plan masash*, Tepër sekret, 31.07.1964, fl. 199. Në një dëshmi të Isuf Keçit, pohohet se Enver Hoxha pati takuar Zef Malën sapo ky qe kthyer nga internimi, duke i kërkuar « një autokritik sa me qenë në arshiv dhe të ju emnoj Minister të Arsimit. Po Zefi nuk pranoj, ay i tha Enverit nuk dua me futur duarët në gjakun e popullit qe e kemi derdhur kot na si koti, ju jeni fajtor dhe do përgjigjeni për të gjitha këto që keni bamun » - po aty, fl. 258.

505. Po aty, *Raport*, 29.09.1961, fl. 190.

506. Po aty, *Relacion mbi aktivitetin armiqësor të Zef Malës*, Tepër sekret, 30.04.1964, fl. 194.

507. « Unë tha Zefi, marksizmin e njof mirë dhe ky ka gabimet e veta që unë në studimin tim jam mundue me i ndreq e me I pa në një prizëm më të favorshëm për masat, se sot marksizmi ka gabime sa të duash dhe këto gabime kanë fillue që në 1905 kur u ndanë menshevikë e bollshëvikë dhe kanë vazhdue deri në kohën e Hrushovit, por tu i ngatërrue më keq se ishte. Zefi pastaj tha se me këtë rugë që ndjek kampi socialist nuk ka kurgjë në dorë se do të ketë gjithmonë nevojë për perëndimin dhe ky këta popuj që vuajnë për munges aftësjie në administrimin ekonmik e politik nuk ka interes t'i zhdukë me luftë por I len kështu mundësinë vetes e zhvillimit të tregjeve në fushën e industrisë shteteve të perëndimit. » – AIDSSH, po aty, *Raport*, 20.10.1964, fl. 219.



Në vitin 1968, Zef Mala u martua me një vajzë himariote, Eftihia Likoka, prej një familjeje të persekutuar nga regjimi.

kryesisht janë njerëz që udhëhiqen nga inadi, jo nga arsyeja, dhe në vend që të ngrejnë popullin në nivelin e aristokracisë, kanë ul dhe aristokracinë në mjerimin e popullit fukara dhe këtë e quajnë barazi e zhdukje klasash. (...) Komunizmi, po nuk u pa në një prizëm tjetër më idealist, nuk ka gjë në dorë. Edhe komunizmi është një grumbull morish që veç një mendje e pa pjekur mund t'i besojë dhe ndonjë gjysmë intelektual, por njerëz që udhëhiqen nga një kulturë e shëndoshë nuk i besojnë. Prandaj këta kanë interes me lanë rininë në errësirë dhe me e zhvillue në një anë<sup>508</sup>.

8. Në vitin 1968 Zef Mala martohet me një vajzë himariote që quhet Eftihia Likoka, e cila vjen nga një familje e persekutuar nga regjimi<sup>509</sup>. Megjithatë, deri në fillim të viteve 1970 duket se jeta e tij njuh njëfarë qetësie, pavarësisht se përgjimet nuk i ndahen – siç dhe nxitjet për ta pyetur e rrjedhimisht për t'i hetuar pohimet antikonformiste që ai mund të bënte. Si ai, si të tjerë persona me të cilët shpesh shoqërohet, siç është rasti konkret i Kasëm Trebeshinës, përbëjnë në këtë kuptim material të vazhdueshëm vrojtimi<sup>510</sup>. Mund të thuhet kështu se Mala nuk heq dorë nga çiltërsia me të cilën, siç raportohet, ai vazhdon të shprehë mendimin e tij në lidhje me politikat e regjimit dhe gjithë traditën ideologjike mbi të cilin ai mbështetet («për mua ky nuk është socializëm gjersa nuk respekton lirinë

508. Po aty, fl. 220. Shih dhe: *Relacion mbi aktivitetin armiqësor të Zef malës në ishullin e Zvërmecit*, 26.10.1964, fl. 227. « Kam hequr dorë nga marksizmi. Socializmi ka dështuar, s'ka as një gram socializme e komunizme, ka vetëm llafe bosh, kamb zbatuar e bark bosh. »

509. Po aty, *Shënim operativ për Eftihia Zaho Likoka*, 29.08.1968, fl. 262.

510. «Gjatë bisedës (Mala dhe Trebeshina) qëndruan shumë afër njëri me tjetrin, flisnin me zë të ulët dhe kontrollonin çdo lëvizje njerëzish që kalonin aty afër» – Po aty, *Informacion*, 01.02.1972, fl. 277.

e fjalës, të ndërgjegjes, të ideve, qoftë filozofike, qoftë fetare»<sup>511</sup>). Çiltërsi e cila nuk resht së shkuari ndesh me shtyllat zyrtare të dogmës shtetërore.

Sidoqoftë, organet e policisë politike gjykonin, në vitin 1971, se Mala «nuk ka ndonjë aktivitet të theksuar armiqësor», pasi, izolimi, sëmundja e syve dhe, në përgjithësi, braktisja e gjithanshme e shtynin të pohonte se «[u]në nuk i duhem më gjë as dreqit, kam arritur në një shkallë që duhet ta shoh njeriun fare nga afër për ta njohur». Arsye për të cilën, pas gati 20 vitesh vëzhgim të lartë, autoritetet përkatëse e ulin ndjeshëm nivelin e vëmendjes mbi jetën e tij private<sup>512</sup>.

Ndërkaq, zhvendosja ideore e Malës, përmes kritikës së zhvillimeve politike në vendet e socializmit real, drejt një qasjeje paradigmatiske – tejet të vagullt për sa eklektike – më të afërt me idetë klasike liberale dhe traditën kulturore demokratike, duket e përfunduar. Shprehet ai në këtë kohë:

“Nuk shkruaj asgjë, lexoj pak dhe rrij mendoj; kam arritur në konkluzion se njerëzimi do të zhvillohet nëpërmjet ideve të mëdha: 1) të filozofisë greke, 2) Të moralit të krishterë, 3) të ideve mbi shtetin dhe të drejtat e Anglo-saksonëve. Revolucion ishte ai francez që dha gjithë këto vlera njerëzimit, ndërsa ai i tetorit në Rusi ishte një grusht shteti që tregoj se ishte i aftë për të shkatërruar çdo gjë, por jo për të çelur rrugë të reja, gjysmë shekulli eksperiencë tregon rezultatet e hidhura dhe negative të asaj eksperience, sidomos për vendet e Europës”<sup>513</sup>.

Një ecuri e tillë, më 1977, do të çojë që niveli i vrojtimit mbi Zef Malën, nga ana e Sigurimit të Shtetit, të rritet sërish, pikërisht si pasojë e lirisë me të cilën konsiderohet se ai shprehej mbi tematika të cilat prekin bazat doktrimore të regjimit shqiptar<sup>514</sup>. E njëjta gjë, mund të thuhet edhe për mendimin e tij në lidhje me ato modele socializmi – si ai jugosllav, ose kinez – të cilët Mala i konsideron plotësisht si përvijim i politikës së fuqisë nga ana e shteteve përkatëse.

Situata tërësore e jetës së vet, gjithsesi, e bën atë tërësisht të ndërgjegjshëm se një arrestim i mundshëm, apo një internim i radhës mund të jenë shumë të shpejtë, pavarësisht mënyrës sesi mund të përligjej një akt i tillë nga ana e organeve shtetërore<sup>515</sup>. Çka ndodh në verë të vitit 1978, kur merret vendimi që Zef Mala të internohet familjarisht në Labovë të Madhe të Gjirokastrës; prej nga do të arrestohet – me motivacionin e një letre «me përmbajtje të mprehtë armiqësore» dërguar udhëheqjes së vendit – duke u dënuar me 10 vjet heqje lirie<sup>516</sup>. Pak muaj më vonë, në 26 dhjetor, Zef Mala do të ndahet nga jeta.

---

511. Po aty, *Raport*, 22.12.1970, fl. 266.

512. Po aty, *Vendim për ulje nga 2/A në 2/B të Zef Malaj si element anti-parti*, Tepër sekret, 16.06.1971, fl. 274.

513. Po aty, *Raport*, 05.08.1971, fl. 276. Po në këtë vazhde, shih: Po aty, *Raport*, 29.10.1976, fl. 288; si dhe fl. 302

514. Po aty, *Vendim mbi ngritjen nga kontroll operativ 2.B në përpunim aktiv 2.A të objektit Zef Mala*, Sekret, 22.01.1977, fl. 294.

515. Po aty, *Raport*, 22.09.1977, fl. 306.

516. Po aty, *Ekstrakt*, Sekret, 27.06.1978, fl. 315; *Relacion mbi përfundimin e hetimit të çështjes penale në ngarkim të Zef Malës*, 05.02.1979, fl. 320.

Isuf  
Keçi



# Jeta e një ish-anëtari të Grupit Komunist të Rinjve nën regjimin totalitar

Sipas dosjes së tij hetimore dhe dëshmive të regjistruara në procesverbalin e marrjes në pyetje në hetuesi, Isuf Keçi deklaroi se është i datëlindjes së vitit 1917. Gjimnazi i Tiranës, ku Isuf Keçi mbaroi studimet e mesme, ishte një qendër e rëndësishme intelektuale dhe fidanishte e mendimit politik. Mes ideve progresiste të modernitetit, prej kohësh ishin atashuar dhe idetë komuniste që, edhe pse ishin në fillimet e tyre, u përfaqëuan nga rinia e kryeqytetit.

## NGA DORIAN KOÇI

Figura e veprimtarit komunist Isuf Keçi, pavarësisht ndryshimit të sistemeve politike nuk është trajtuar ende në dimensionin e tij të plotë, përse i përket zhvillimeve të lëvizjes komuniste shqiptare nga vitet 1941-1951. Përveçse një kuadër komunist i orëve të para, ai ka pasur dhe një angazhim të fuqishëm politik në organizimin e lëvizjes komuniste shqiptare në gjithë vendin. Ky angazhim politik i tij nuk do të mund të kuptohet nëse nuk analizojmë mendimin e tij politik të shprehur fillimisht brenda strukturës organizative të Grupit Komunist të “Të Rinjve”, si dhe kontekstin historik të ballafaqimit të pikëpamjeve të këtij grupimi me dogmën zyrtare që ndiqte PKSH, e certifikuar nga emisarët jugosllavë dhe Komiterni.

Isuf Keçi lindi në Tiranë më 1917 në një familje qytetare dhe patriote tiranase. Ai ishte djali i dytë i Ibrahimit dhe Hafasë, pas vëllait të tij Hamit Keçi që lindi në 20 mars 1915. Të parët e familjes Keçi u vendosën në territorin që sot mban emrin Tiranë rreth vitit 1600, duke kontribuar në themelimin e qytetit (siç njihet edhe në veprën “Patriotizma në Tiranë” të Ibrahim Hysen Dalliut). Familja Keçi klasifikohet në familjet e pasura tiranase. Aktiviteti kryesor ekonomik i familjes ishte tregtia, e cila nëpërmjet gjyshit të Hamitit (Hysen Keçi) dhe sidomos nëpërmjet babait (Ibrahim Keçi) u zhvillua shumë. Në Tiranë dhe fshatrat rreth saj, familja Keçi, si një nga familjet e mëdha

të Tiranës, ka qenë e mirënjohur jo vetëm për aktivitetin tregtar ekonomik, por për mikpritjen dhe bujarinë.<sup>517</sup> Sipas dosjes së tij hetimore dhe dëshmi të regjistruara në procesverbalin e marrjes në pyetje në hetuesi, Isuf Keçi deklaroi se është i datëlindjes së vitit 1917 dhe se në vitin 1939 mbaroi Gjimnazin e Tiranës dhe po atë vit shkoi për studime në Torino në Fakultetin Politeknik.<sup>518</sup> Gjimnazi i Tiranës ku Isuf Keçi mbaroi studimet e mesme ishte një qendër e rëndësishme intelektuale dhe fidanishte e mendimit politik. Mes ideve progresiste të modernitetit, prej kohësh ishin atashuar dhe idetë komuniste që edhe pse ishin në fillimet e tyre, ishin përqaftuar nga rinia e kryeqytetit.

---

## Lëvizja komuniste e viteve '30 dhe ndikimi i saj në formimin ideologjik të Isuf Keçit

---

Nga leximi i dokumentacionit të viteve '30 vihet re se ideologjia komuniste në Shqipëri synonte depërtimin në shkollat e mesme dhe në organizimet sindikaliste. Kjo lidhje midis modernitetit dhe komunizmit kishte rënë në sy dhe në raportet sekrete të xhandarmërisë zogiste që ndiqte nga afër situatën në shkollat e mesme të Shqipërisë. Në raportin mbi tendencat komuniste në shoqëri që Komandanti i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, Shefki Shatku i drejtonte Mbretit Zog në datën 5 korrik 1936 shkruhej se djalëria komuniste ndahet në tri kategori: 1-Komunistët e vërtetë, 2-Djemtë që thonë që janë komunistë vetëm për modernizim dhe për t'u dukur intelektualë (reklamistë). 3. Të rinjtë që spekulojnë duke u hequr komunistë për interesa materiale.<sup>519</sup> Sigurisht që Isuf Keçi si bir i një familjeje tregtare e me gjendje shumë të mirë ekonomike bënte pjesë në kategorinë e dytë që përshkruhet në raport.

Një rol të madh në përhapjen e ideve të majta në Shqipëri luante edhe rrjeti i mirëndërtuar i shpërndarjes së literaturës me pikëpamje të majta e komuniste. Në dosjen hetimore, Isuf Keçi pohon në hetuesi, se “qëkur isha nxënë në gjimnaz më kanë rënë në duar dhe kam lexuar studime me përmbajtje socialiste. Këto m'i kanë dhënë Faik Miraku, disa herë Xhemi Aliu dhe rrallë Qemal Stafa.”<sup>520</sup>

Përveçse arsyes së tendencës së modernitetit, një arsye tjetër e përqaftimit të ideve komuniste nga rinia shqiptare ishte e lidhur ngushtë edhe me zgjidhjen e çështjes kombëtare. Që nga viti 1920, pas Kongresit të Lushnjës, kur kishte filluar rithemelimi i shtetit kombëtar, dalëngadalë nëpërmjet rrjetit arsimor, ushtrisë dhe administratës shtetërore ishte injektuar nacionalizmi në shoqërinë shqiptare si një rrymë shtetformuese që e kish origjinën që në Rilindjen Kombëtare (1878–1912). Në qarkore të ndryshme të Ministrisë së Brendshme të mbretërisë në vitet '30 drejtuar Ministrisë së Arsimit i tërhiqej vëmendja kësaj të fundit për rrezikun nga idetë socialiste, pasi dëmtonte ndjenjën e pastër të nacionalizmit që po ngjallej mes popullit. Për këtë arsye, MPB kërkonte të gjendeshin prej Ministrisë së Arsimit, profesorë të besueshëm dhe ndjenja “nacionaliste të kulluara”<sup>521</sup>. Mirëpo duke qenë një vend i prapambetur agrar që tentonte të kapërcente shpejt etapat e modernizimit të shoqërisë si dhe duke u nisur nga fakti që Lenini më 1917 kishte denoncuar

---


517. Rahman Parllaku, “Jeta e luftëtarit patriot Hamit Keçi, nga lufta për çlirim tek burgosja pas përplasjes me Enver Hoxhën”, në: *Gazeta Sot*, 20 mars 2015. DOSSIER në: <https://sot.com.al/dossier/jeta-e-luft%C3%ABtarit-patriot-hamit-ke%C3%A7i-nga-lufta-p%C3%ABr-%C3%A7lirim-tek-burgosja-pas-p%C3%ABrplasjes-me>

518. AIDSSH/AMPB, F.1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 2. Procesverbalin e marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

519. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së*, Tiranë: Shëpia Botuese 55, 2016, f. 117.

520. AIDSSH/AMPB, F.1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 2. Procesverbalin e marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

521. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste ...*, f. 115.



Isuf Keçi lindi në Tiranë më 1917 në një familje qytetare dhe patriote tiranase. Ai ishte djali i dytë i Ibrahimit dhe Hafsasë. Të parët e familjes Keçi u vendosën në territorin që sot mban emrin Tiranë rreth vitit 1600

(Arkivi Marubi)

“Traktatin e fshehtë të Londrës” midis një pjese të elitës patriotike shqiptare kishte zënë rrënjë mendimi se problemi i modernizimit të shpejtë të shtetit kombëtar shqiptar dhe çështja kombëtare shqiptare mund të zgjidhej përmes një lëvizjeje revolucionare të tipit bolshevik. Në analizën e revolucionit rus që bënte një nga komunistët të parë shqiptarë Koço Tashko e quante me karakter kombëtar, por edhe kthesë në historinë e njerëzimit, sepse shembi ato që ai i quante mure të imperializmit. Si veprime pozitive që kishin ndikuar në Shqipëri përmendeshin prej Tashkos denoncimi i Traktatit të fshehtë të Londrës të vitit 1915 nga Lenini, vrasja e “kryeagjentit të imperializmit” Esat Toptani, roli i Bajram Currit, shoqëria “Bashkimi” dhe kryengritja e qershorit e vitit 1924.<sup>522</sup> Në vitin 1935, Kongresi VII i Internacionales Komuniste miratoi udhëzimet e reja të Kominternit që e vinin theksin mbi organizimin e luftës popullore kundër rrezikut fashist dhe krijimin e fronteve popullore. Këto udhëzime i solli në Shqipëri, Koço Tashko në vitin 1937 dhe filluan të propagandoheshin nga Grupi Komunist i Korçës. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia Fashiste në 7 prill 1939 dhe rezistenca e dobët e forcave monarkiste të paorganizuara dhe të braktisura nga Zogu që mori arratinë duket se rrëzuan iluzionet për krijimin e një fronti të përbashkët fashist për kundërshtimin e pushtimit fashist dhe tulatën në mënyrë të konsiderueshme lëvizjen komuniste shqiptare. Aq më tepër që vetëm dy muaj më parë pushtimit ishte zhvilluar arrestimi dhe dënimi i 73 komunistëve, ku pjesa më e madhe i përkiste Grupit Komunist të Shkodrës, të cilët morën dënime që varionin nga 10 vjet burg deri në disa muaj.

Gjyqi zgjati nga data 28 janar deri më 10 shkurt 1939 dhe pati efekt frenues në radhët e militantëve të rinj. Në procesverbalin e marrjes në pyetje në hetuesi, Isuf Keçi deklaroi se pas arrestimit të komunistëve ai frikësohet dhe nuk lexon dhe as shpërndan më literaturë komuniste.<sup>523</sup> Kjo literaturë konsistonte në broshura për shpjegimin e komunizmit, fundin e klasës borgjeze, proletariatin, gjyqet e Moskës, sukseset sovjetike në jetë e shoqëri, shkaqet e luftës së klasave, etj.

522. AQSH, F.14/AP/Kujtimet, D. 24, fl. 1. Kujtimet e Koço Tashkos, shkruar më 1.12.1953.

523. AIDSSH/AMPB, F.1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl.3 . Procesverbalin e marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

“

Ne i paraqitëm shokut italian udhëzimet që unë kisha për t'u lidhur me Partinë Komuniste Italiane, por shokët italianë, pasi u konsultuan midis tyre, na thanë se nuk është nevoja. Kështu, mbasi qëndrova gjashtë ditë, u ktheva në Shqipëri.

Isuf Keçi

”



---

## Ç'do të thoshte anëtarësia e Grupit Komunist të të Rinjve gjatë viteve të Rezistencës Antifashiste (1939-1944)

---

Në shtator të vitit 1939 Isuf Keçi shkon për të studiuar në Fakultetin Politeknik të Torinos. Ai qëndron një vit atje dhe sipas dëshmimeve që jep në procesverbalin në hetuesi, lë shkollën në fund të vitit 1940, pasi nuk i pëlqente të shkonte më në Itali<sup>524</sup>. Torinoja në atë kohë ishte një qytet ku studionin disa shqiptarë, mes të cilëve edhe Qemal Stafa, por nuk ka të dhëna nëse Isuf Keçi ka zhvilluar aktivitet komunist në këtë qytet. Jeta dhe veprimtaria e tij është e lidhur ngushtë me aktivitetin e vëllait të tij Hamit Keçi (1915–2002). Hamit Keçi, pasi mbaroi shkëlqyeshëm gjimnazin e Tiranës, më 11 janar 1935 filloi studimet në shkollën ushtarake të Napolit, Itali, nga ku, në vitin 1937 vazhdoi studimet ushtarake në një nivel më të lartë, në Akademinë e Artileri- Xhenios në Torino. Dy muaj para përfundimit të plotë të studimeve, në prill 1939, refuzoi diplomën, shërbimin në një ushtri të huaj dhe pagesën, duke i këmbyer me burgun dhe internimin, sepse nuk pranoi t'i shërbente Mbretit të Italisë, Viktor Emanuelit III. Hamit Keçi organizoi dhe udhëhoqi lëvizjen që përfundoi me dështimin e ceremonisë të betimit për besnikëri e përkushtim të oficerëve shqiptarë ndaj mbretit të Italisë. Aktiviteti i tij në Itali në vitin 1939 u konsiderua i “rrezikshmërisë së lartë” siç rezulton nga dokumentet e arkivit të shtetit shqiptar, për këtë arsye u ndëshkua me “4 vjet heqje lirie dhe internim në ishullin e Tremetit në Itali”. Në këtë mënyrë, ai dhe studentët e tjerë shqiptarë shprehën revoltën kundër pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste.<sup>525</sup> Ky reagim i Hamit Keçit ishte një nga format e protestës së hapur të rinisë shqiptare që kundërshtonte fashizmin. Në vitin 1939 të majtën në Shqipëri e përfaqësonte forma e saj më radikale, grupet komuniste, ku më kryesorët ishin ato të Korçës, të Shkodrës, të Rinjtë e Zjarri. Ato ishin në kundërshti dhe në grindje me njëri-tjetrin me nivel të ulët teorik dhe organizativ, me orientime dhe bindje në një skeptër të gjerë të ideologjisë komuniste që nga ajo staliniste e deri tek ajo trockiste.<sup>526</sup>

Isuf dhe Hamit Keçi ishin të dy anëtarë të hershëm të Grupit Komunist të të Rinjve. Grupi Komunist i të Rinjve fillimisht përbëhej në dy pjesë, njëra që udhëhiqej nga Sadik Premte e tjetra nga Anastas Lula dhe Sadik Stavileci. Para se të formonin këtë grup, anëtarët kishin pasur një veprimtari aktive si degë e Grupit të Korçës. Fillesat e këtij grupi ishin pikësëpari pas dështimit të kryengritjes së Fierit të 1935. Bisedat rreth kësaj kryengritjeje bënin që të tuboheshin shumë studentë republikanë prej Institutit Teknik, ku Premte ishte nxënës, dhe Gjimnazit të Shtetit. Shkëputja e Anastas Lulës nga Grupi i Korçës dhe bisedat me Sadik Premten çuan në formimin e grupit të tyre. Gjer më 1939 nuk kishin lidhje organike dhe as veprimtari mirëfilli të përbashkëta me grupimet e tjera komuniste. Përkthenin në shqip dhe lexonin Marks, Engels, Lenin, madje edhe Trocki, sepse nuk kishin dijeni se ishte i ndaluar nga Internacionalja Komuniste. Në këtë grup kishte prani të rëndësishme elementi kosovar që kishin shkuar në Shqipëri për t'u shkolluar. Kjo vinte prej shijes që u kishte lënë denoncimi i Traktatit të Londrës nga ana e Leninit si dhe iluzioni se Bashkimi Sovjetik do të ishte zgjidhja e çështjes kombëtare.<sup>527</sup>

Platforma ideologjike e këtij grupi doli në pah gjatë mbledhjes themeluese të PKSH-së, Konsultës së

---

524. AIDSSH/AMPB, F 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 2 . Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

525. Rahman Parllaku, “Jeta e luftëtarit patriot Hamit Keçi, nga lufta për çlirim tek burgosja pas përplasjes me Enver Hoxhën”, në: *Gazeta Sot*, 20 mars 2015. DOSSIER në: <https://sot.com.al/dossier/jeta-e-luft%C3%ABtarit-patriot-hamit-ke%C3%A7i-nga-lufta-p%C3%ABr-%C3%A7lirim-tek-burgosja-pas-p%C3%ABrplasjes-me>

526. Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore*, Tiranë: Toena, 2014, f. 227.

527. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste ...*, f. 171.

Parë të PKS-së në prill 1942 dhe vitet 1948-1951 në bisedat midis Hamit Keçit, Naizi Islamit, Abedin Shehut dhe Isuf Keçit. Sipas Grupit Komunist të të Rinjve, komunizmi ishte një doktrinë e importuar në Shqipëri, e nuk kishte zhvillim të kushteve ekonomike e sociale të shoqërisë. Lëvizja komuniste kryhej nga intelektualët dhe veçanërisht nga studentët. Shqipëria ishte një vend i prapambetur agrar pa industri, nuk kishte proletariatin industrial dhe rrjedhimisht, as organizata proletare, ose të paktën asnjë si këto me qëllime ekonomike. Ata nuk pranonin tezën leniniste se në radhët e fshatarësisë kishte forca revolucionare. Platforma e tyre mbështetej në përkthimin e librave dhe në qëllimin për të ngritur sa më shumë grupe studimi për të depërtuar në masat.<sup>528</sup>

Gjithsesi, duke zhvilluar një skemë organizimi shumë konspirative në bazë të celulave të krijuara mbi bazën “e treshes” që nuk njihnin njëri-tjetrin, Grupi Komunist i të Rinjve kishte arritur të krijonte mbështetje të gjerë në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Gjirokastrë e Vlorë. Disa nga elementët më të spikatur të këtij grupi komunist ku militonte Isuf Keçi, ishin Anastas Lula e Sadik Premte, Sadik Stavaleci, Kristo Frashëri, Jusuf Kambo, Agron Çorati, Hysni Kapo, Ramadan Çitaku.

Në pranverën e vitit 1940 në Tiranë u bë përpjekja e parë për të krijuar një organizëm të përbashkët midis grupeve kryesore komuniste, që u quajt “Komiteti Qendror i Përkohshëm” i përbërë prej katër vetash: Miha Lako e Koço Tashko nga Grupi i Korçës dhe Zef Mala e Vasil Shanto nga Grupi i Shkodrës. Nuk është shumë e qartë nëse u krijua vetëm midis dy grupeve, atij të Korçës me atë të Shkodrës apo mori pjesë dhe grupi i Të Rinjve.<sup>529</sup> Mirëpo pavarësisht faktit se nëse bënte pjesë apo jo në këtë organizim, Grupi Komunist i të Rinjve ishte treguar shumë aktiv në gjetjen e rrugëve për t’u ndihmuar nga parti të tjera komuniste të vendeve fqinje për të themeluar Partinë Komuniste Shqiptare. Një përpjekje të tillë ku vëllezërit Keçi janë protagonistë gjendet në dosjen hetimore të Isuf Keçit.

Në deponimet e tij në hetuesi Isuf Keçi dëshmon se në nëntor të vitit 1940 ka shkuar sërish në Itali për të bërë regjistrimet dhe takuar të vëllanë, Hamit Keçin, që ishte në internim.<sup>530</sup> Qëllimi i kësaj vizite nuk ishte vetëm takimi me të vëllanë, por edhe një porosi e veçantë që i kishte dhënë Anastas Lula, njëri nga krerët e Grupit Komunist të të Rinjve. Isuf Keçi deponon se qe porositur nga Grupi i të Rinjve dhe posaçërisht Anastas Lula që, me anën e Hamiti Keçit të merrej kontakt me Partinë Komuniste Italiane. “Unë bisedova me Hamitin porosinë që ma dha Anastas Lulua për t’u takuar me ndonjë shok të Partisë Komuniste Italiane. Hamiti më vuri në kontakt me një shok italian që ishte në internim së bashku. Ne i paraqitëm shokut italian udhëzimet që unë kisha për t’u lidhur me Partinë Komuniste Italiane, por shokët italianë pasi u konsultuan midis tyre na thanë se nuk është nevoja. Kështu mbasi qëndrova gjashtë ditë u ktheva në Shqipëri”.<sup>531</sup> Dështimi i kësaj përpjekjeje, por edhe disa të tjerave më parë për t’u lidhur me Partinë Komuniste Italiane do t’i hapte udhë komunikimit tjetër të vazhdueshëm me një parti komuniste anëtare të Kominternit, Partinë Komuniste Jugosllave.

Në raportin e Koço Tashkos mbi formimin e grupeve komuniste në Shqipëri theksohet se marrëveshja e pranverës të vitit 1940 nuk parashikonte shkrijen e grupeve të cilat do të ruanin autonominë e tyre në çështjet organizative dhe politike, por krijimin, përveç komitetit qendror, edhe të komiteteve analoge në qarqe, si edhe aktiviteteve dhe aksioneve të përbashkëta midis tyre. Pikërisht në aksionet e përbashkëta, gjithmonë sipas Koço Tashkos, Grupi i Të Rinjve ka marrë pjesë dhe ishte përpjekur të fitonte supremacinë”.<sup>532</sup>

528. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste ...*, f. 171.

529. Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën ...*, f. 228.

530. AIDSSH/AMPB, F 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 3. Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

531. AIDSSH/AMPB, F 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 3. Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

532. AQSH, F 14/APL, V. 1942, D. 5. Raport i Koço Tashkos mbi formimin e grupeve komuniste në Shqipëri. AQSH.Fondi 14/APL, V. 1941, D. 1. Procesverbali I Mbledhjes Themeluese të PKS-së 11 nëntor 1941, marrë nga raporti i Drejtorisë Qendrore të Policisë,

Një nga aksionet e përbashkëta të grupeve komuniste ishte dhe lirimi i komunistit jugosllav, Miladin Popoviç, nga kampi i internimit në Peqin, më 11 tetor 1941. Sipas kujtimeve të Sadik Premtes, ky aksion u realizua nga Anastas Lula e Mustafa Gjinishi, Ramadan Çitaku e Kristo Themelko. Këtë karakteristike të Grupit të të Rinjve si njerëz të aksionit do ta nënvizojnë edhe të dërguarit jugosllavë Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha në raportet e letrat e tyre dërguar Titos. Dushan Mugosha shkruan në kujtimet e tij se gjatë bisedës arrita në konkluzionin se anëtarët e këtij grupi kanë një disiplinë fanatike dhe janë të gatshëm edhe për aksione të rrezikshme.<sup>533</sup>

Sulmi italian ndaj Greqisë, operacionet e suksesshme gjermane në Ballkan që çuan në rikonfigurimin e tij, si dhe sulmi hitlerian ndaj Bashkimit Sovjetik i bindën komunistët shqiptarë se duhet të linin mënjanë dasitë dhe përçarjet ideologjike dhe të bashkoheshin për të krijuar Partinë Komuniste Shqiptare. Pas disa përpjekjeve të dështuara me Partinë Komuniste Italiane dhe atë Jugosllave, pas një udhëtimi në Kosovë të Koço Tashkos e Xhevdet Dodës si përfaqësues të Grupit të Korçës, i shoqëruar nga Fadil Hoxha dhe Elhami Nimani, i pari përfaqësues i Grupit të Shkodrës dhe i dyti i grupit të të Rinjve u takuan me Boro Vukmiroviçin, Pavël Joviçeviçin, Dushan Mugoshën e Ali Shukriun, përfaqësues të Komitetit Krahinor të PKJ-së në Vitimiricë të Pejës. Në këtë takim Boro Vukmiroviç theksoi se Kominterni kishte autorizuar PKJ-në për t'i ndihmuar grupet komuniste dhe së shpejti atje do të dërgohej përfaqësuesi i saj.<sup>534</sup> Ky takim i hapi udhën formimit të Partisë Komuniste Shqiptare. Grupet Komuniste shqiptare u këshilluan që të gjenin gjuhën e përbashkët, të dorëzonin listat e celulave dhe të krijohej një komitet i përbashkët. Nën këshillimet e Miladin Popoviçit të liruuar nga kampi i Peqinit e Dushan Mugoshës të dërguar në Shqipëri si përfaqësues i PKJ-së, përfaqësuesit e grupeve komuniste shqiptare do të binin dakord të themelonin PKSHT-në më 8 nëntor 1941.

Vëllezërit Keçi, edhe pse anëtarë të hershëm të Grupit të të Rinjve nuk do të marrin pjesë në mbledhjen themeluese, por do t'i japin mbështetje të pakursyer organizimit të PKSHT-së dhe luftës guerile në Tiranë. Në shtëpinë e familjes Keçi, PKSHT organizonte mbledhje e planifikonte demonstrata e aksione. Familja Keçi vuri në dispozicion të lëvizjes shtëpinë, pasurinë dhe lidhjet e kontaktet si familje e pasur. Katër nga pesë fëmijët e familjes Keçi, kanë qenë ilegalë gjatë luftës, nga të cilët Hamit dhe Isuf Keçi kishin pozicione drejtuese në njësitet guerile.

Mirëpo pavarësisht angazhimit të tyre pa rezerva, ata si pjesa më e madhe e anëtarëve të Grupit Komunist të të Rinjve vazhduan të shiheshin me dyshim, si elementë që nuk e kishin dashur me gjithë zemër bashkimin dhe nuk zbatonin disiplinën e partisë së re të porsakrijuar. Ky opinion ishte krijuar kryesisht nga përshtypjet e dy të dërguarve jugosllavë që nuk i simpatizuan udhëheqësit e këtij grupi që në fillim. Në kujtimet e tij Dushan Mugosha shkruan se Anastasi dhe Sadiku më lanë një përshtypje të errët. Që të dy, megjithëse të rinj e mbivlerësonin shumë veten. Flisnin me parulla, në mënyrë libeske, me vetëkënaqësi. Dukej se atyre nuk u interesonte asgjë, përveç sa kishin në kokën e tyre. Me bindje anarkiste, ata biles dhe kuotat e anëtarësisë i mblidhnin vetë, i dispononin dhe i harxhonin sipas mendimit të tyre për shpirtin e tyre.<sup>535</sup> Konsulta e parë e PKSHT-së që u mbajt më 12-14 prill 1942 mori vendim për organizimin e kryengritjes së armatosur dhe zgjedhjen për kreun e partisë. Në të njëjtën kohë ajo i kushtoi rëndësi disiplinës së hekurit bolshevike dhe pajisjes me teorinë leniniste-staliniste<sup>536</sup> për celulat e reja të partisë, por edhe luftës ndaj fraksioneve të tjera të marksizmit që konsideroheshin trockistë, me përfaqësues si Zai Fundon, Niko Xoxin e Aristidh Qendron. Në të njëjtën kohë bie në sy që së bashku me figurat e mësipërme të quajtur që herët

---

Tiranë, 15 qershor 1942. Cituar sipas: Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën ...*, f.

533. Enver Lepenica, *Eliminimi i Grupit Komunist të "Të Rinjve", dokumente, dëshmi, studime*, Tiranë: Intituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, 2016, f. 277.

534. Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën ...*, f. 232.

535. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste ...*, f. 173-174.

536. Dokumente e qarkore të PKSHT Tiranë shkurt 1948, fq 66-67.

nga Kominterni si trockistë në letërën që Miladin Popoviçi i dërgon Titos në 21.5.1942, konsideron si trockist edhe Grupin Komunist të të Rinjve. Ai shkruan se ne tashmë kemi filluar spastrimin e elementëve që pengojnë punën dhe na vënë “shkopinj nën rrota”. Puna jonë kryesore është përqendruar tek Grupi i “Të Rinjve”, të cilin po e spastrojmë me themel nga elementët e padëshirueshëm.<sup>537</sup>

Dy muaj më vonë, më 28-29 qershor 1942 u mbajt në Tiranë Konferenca e Jashtëzakonshme e PKSH-së ku dolën në dritë kontradiktat midis udhëheqjes së PKSH-së dhe dy drejtuesve të Grupit të “Të Rinjve”. Grupi Komunist i të Rinjve, i vënë në shënjestër që herët, sipas metodave të spastrimeve staliniste u anatemia si grup me pikëpamje fraksioniste që nuk respektonte disiplinën e hekurt të Partisë Komuniste dhe kësisoj, kishte penguar punën organizative të Partisë. Vendimet e Konferencës u publikuan në një qarkore në korrik të vitit 1942, ku mes të tjerash thuhej se shokët me përgjegjësi që ishin infektuar me këtë frymë grupi nuk pranuan asnjë kritikë për punën e tyre. Ata refuzuan çdo gjë. Në fund të konferencës dolën me një autokritikë të përciptë, duke mos pranuar kritikën e shokëve, por vetëm të disave dhe të referatit<sup>538</sup>. Vendimet dhe spastrimet që u ndërmorën ishin të ashpra dhe konsiderohen si shfaqja e parë e stalinizmit në lëvizjen komuniste e majtiste shqiptare. Konferenca dëboi për një afat të pacaktuar nga radhët e Partisë Komuniste Shqiptare: Anastas Lulën, Sadik Premten, Halit Petrelën, Sandër Jorgonin, Mërkur Çelën dhe Shaban Jegenin. U dëbuan për tre muaj Isuf Keçi me pseudonimin Biveriku, Shyrete Turkeshi dhe Kristo Frashëri, historiani i ardhshëm shqiptar. Prania e Isuf Keçit në këtë listë dëbimesh dhe spastrimesh dëshmon se në konfliktin që kishte nisur mes së majtës shqiptare ai kishte vazhduar të përçonte platformën ideologjike të Grupit Komunist të të Rinjve. Një nga tezat që kishte sjellë kundërshti mes palëve ishte roli i të ashtuquajturit grupazh nga ana e anëtarëve të Grupit të të Rinjve, që pengonte disiplinën e Partisë dhe organizimin strukturor të saj. Për emisarët jugosllavë përçues të drejtpërdrejtë të stalinizmit, organizimi dhe bindja e verbër ndaj hierarkisë së Partisë ishte thelbësore në organizimin e Partisë Komuniste. Të dy kërret e mëparshëm të Grupit Komunist të të Rinjve kishin pranuar në parim krijimin e një organizate të vetme, por nuk kishin pëlqyer zhdukjen e gjurmëve të organizatave të mëparshme. Sipas Anastas Lulës dhe Sadik Premtes, ky ishte një kthim mbrapa. Ishte një lloj sikuri të bashkoje miellin me krundet-domethënë kuadrot e kualifikuar të Grupit të të Rinjve, me anëtarët e thjeshtë të Grupit Komunist të Korçës që nuk dinin se çfarë ishte marksizëm-leninizmi.<sup>539</sup> Kundërshtia në fakt ishte sa ideologjike, po aq dhe praktike sidomos nga ana e dërguarve jugosllavë që dëshironin fillimin e një kryengritjeje të përgjithshme në Shqipëri në fillim të vitit 1942 për t'i ardhur në ndihmë dhe kryengritjes që kishin filluar në Mal të Zi. Miladin Popoviçi i raportonte PKJ-së më 30 tetor 1941 mbi gjendjen që gjeti në Tiranë. Gjatë kësaj kohe, të dy emisarët jugosllavë punuan për krijimin e një “baze të mirë guerile”, në të cilën ishin afruar edhe ushtarakë shqiptarë që refuzonin të luftonin kundër grekëve në Luftën Italo-Greke. Në kampin e dezertorëve, sipas Miladinit, ndodheshin 1200 ish-ushtarakë shqiptarë me të cilët po zhvillohej një agjitacion i madh. Për grupet e armatosura thoshte se deri atë çast ishte një çetë e fshatarit të pasur Myslym Peza.<sup>540</sup> Ata ishin të interesuar për luftë të menjëhershme ndaj pushtimit italian dhe pretendimet e Grupit Komunist të të Rinjve konsideroheshin intelektualizëm i tepruar. Në Konsultën e parë të PKSH-së, në prill 1942, u mor vendimi për kryengritjen e përgjithshme, por kjo nuk u arrit, pasi numri i komunistëve dhe atyre që simpatizonin kryengritjen ishte i vogël. Për këtë arsye u mendua shtimi i punës në terren me fshatarësinë dhe krijimin e një fronti të përbashkët me nacionalistët.

Grupazhi dhe fraksionizmi u konsideruan si rreziqe të mëdha që shkatërronin organizimin e Partisë Komuniste e për këtë arsye u ndërmorën mbledhje nëpër celula me të dërguar nga qendra. Në një nga këto mbledhje ku ka qenë i pranishëm Dushan Mugosha, merrnin pjesë dhe vëllezërit Hamit e Isuf Keçi. “Ata përpiqeshin, - shkruan Dushan Mugosha, - të shkatërronin mbledhjen dhe rezolutën e Konferencës

537. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste ...*, f. 209.

538. Dokumente kryesore të PPSH 1941-1944, Vëllimi i II, Tiranë:1971, fq 112-113.

539. “Kristo Frashëri” në: Enver Lepenica, *Eliminimi i Grupit Komunist të “Të Rinjve” ...*, f. 300.

540. Kastriot Dervishi, *Lëvizja komuniste ...*, f. 192,



së Partisë. Mbledhja vazhdoi gjatë. Më kokëfortë ishte Jusufi [Isufi]. Pasi mungonin argumentet, duke mos ditur ç'të bënte pyeti: D.m.th Partia është për luftë, për vrasjen e spiunëve...A më lejon kjo Parti për të cilën bëhet fjalë këtu, të vras Mustafa Krujën, kryeministrin e qeverisë kuislinge? Unë iu përgjigja menjëherë: Ky do të ishte një aksion i rëndësishëm... Pas disa ditësh më informuan se u krye atentati kundër Mustafa Krujës. Ai u fsheh, ndërsa roja e tij, kapiteni, u plagos ...<sup>541</sup>. Në këtë fragment të kujtimeve të Mugoshës duket se format e dhunshme të stalinizmit dhe terrorit të kuq iu dhanë si receta të gatshme lëvizjes së majtë komuniste shqiptare. Praktika të tilla duket se jo gjithmonë ishin të suksesshme.

Personaliteti i Isuf Keçit vazhdoi të konsiderohej i padëshirueshëm nga drejtuesit e PKSSh-së pavarësisht përfshirjes së tij në aksione të guximshme. Demonstrata e 7 prillit të vitit 1942, e cila u organizua nga Enver Hoxha, u caktua për ta udhëhequr Isuf Keçi.<sup>542</sup> Kristo Frashëri kujton se në një takim organizate ku qe i deleguar Enver Hoxha, në fund të mbledhjes ky i fundit e pyet nëse mbante kontakte me anëtarë të Grupit Komunist të të Rinjve. Kristo Frashëri kujton: “Nuk kam punë me ta. Po me Jusuf Keçin, – më tha, – si i ke marrëdhëniet? –Shumë mirë, i thashë. –Po mirë, nuk e ke parasysh porosinë që të kanë dhënë për të mos u takuar me shokët e Grupit të të Rinjve? Po i thashë, ma kanë shpjeguar, por Jusufi është shoku im i rinisë. Nuk shoh arsye për të mos u takuar me të. Porosinë e kam kuptuar vetëm për të mos folur me të për çështjet e Partisë, por jo për të mos shëtitur me të. – Je kokëfortë më tha. Unë e mbylla bisedën duke i thënë: Ju siguroj se unë me të nuk bisedoj asgjë nga jeta e Partisë”<sup>543</sup>. Në shtator të vitit 1942, Isuf Keçi u përjashtua nga Partia për shkak se së bashku me Fiqiret Sanxhaktarin, të fejuarën e Agron Çoratit kishin dashur të rrëmbenin vajzën e Man Kukaleshit, komandantit të përgjithshëm të xhandarmërisë për ta shkëmbyer me Shyqyri Ishmin, militant komunist i arrestuar. Çështja u shtrua në forumet e PKSSh dhe Fiqiretja<sup>544</sup> dhe Isuf Keçi u përjashtuan nga Partia më 30 shtator 1942. Më shumë se dënimi i një akti terrorist, siç u pretendua, ka shumë të ngjarë që vendimi për t'i përjashtuar është ndërmarrë sepse po shprehej solidaritet me ish-anëtarin e Grupit Komunist të të Rinjve, Shyqyri Ishmi. Duket se dyshimi e të organizuarit grupazh brenda PKSSh-së me shokët e vet që vinin nga Grupi i të Rinjve vazhdonte të rëndonte ende mbi të. Në një letër që Enver Hoxha dhe Miladin Popoviçi i dërgojnë Nako Spiros në mars 1944 Isuf Keçit i lakohet sërish emri për punën e grupazheve. Për punën e grupazheve shkruan Enver Hoxha dhe Miladin Popoviçi, duhet të keni mendjen. Shumë herë i kemi shkruar Gogos: “Delegates (Nexhmije Xhuglini (Hoxha) i kam shkruar kur isha në Martanesh dhe që pashë atje Kristo Frashërin që po drejtohej në Tiranë. Isuf Keçi kish qenë atje dhe Kristo Frashëri i kishte thënë të piquej me Xhaxha Nezin dhe sigurisht me Xhepin (Sadik Premten). Unë kam bindje se është pjekur, janë pjekur dhe gjithë plehrat që s'janë në Parti dhe që janë në Parti, e që shoku Gogo s'mund t'i heqë nga detyra si përgjegjës celule ose t'iu bëjë vërejtje se gjoja janë aktivë, “shumë aktivë” ... Grupazhet janë struktur në qytete, pse në çeta s'mund të punojnë lirisht, atje organizojnë, atje kombinonë, prandaj shokët të jenë zgjuar, t'i vëzhgojnë, t'i luftojnë dhe të mos ketë Gogoja me shokë për ta një zemër murgeshe”<sup>545</sup>. Gjithsesi, pavarësisht këtyre konsideratave sipas deponimeve në hetuesi të Isuf Keçit më 8 prill 1944 ai ripranohet sërish në Partinë Komuniste Shqiptare dhe i ngarkohen detyra të larta deri në komandant brigade dhe komisar divizioni.<sup>546</sup> Në fund të vitit 1944, më 28 nëntor ai emërohet komandant i Brigadës XI sulmuese. Në mars 1945 emërohet komandant i Zonës III të prapavijës së Shkodrës. Në prill të po atij viti emërohet komisar i Divizionit VI i cili qëndronte në Vuçiternë.<sup>547</sup>

541. Enver Lepenica, *Eliminimi i Grupit Komunist të “Të Rinjve”...*, f. 279.

542. Enver Lepenica, *Eliminimi i Grupit Komunist të “Të Rinjve”...*, f. 307.

543. Kristo Frashëri, *Jeta e një historiani*, Kristalin KH, Tiranë:2014, fq 130.

544. Fiqiret Sanxhaktari pas kësaj ngjarjeje u shkarkua nga detyra e sekretares organizave të qarkorit të PKSSh për Tiranën, u përjashtua si anëtare e PKSSh-së dhe u largua për në Korçë në mbikqyrjen e Pandi Kristos. Për më tepër shih: AQSH, F 20/APL, V. 1942, D. 1, fl. 1. Letër e Bardhos (Ymer Dishnicës) për Dunavecjin (Pandi Kristo), pa datë.

545. AQSH, F.14/APL, D. 76, fl. 27 -28, Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, Mars 1944.

546. AIDSSH/AMPB, F 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 4. Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

547. AIDSSH/AMPB, F 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 4. Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit

---

## Isuf Keçi dhe fantazma e “fraksionistëve”

---

Pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj, marrëdhëniet e tensionuara mes Isuf Keçit dhe drejtuesve të lartë të PKS-së nuk njohën ndonjë përmirësim të dukshëm. Anëtarësia e tij në Grupin Komunist të Rinjve ishte një barrë që ai, ashtu si shumica e anëtarëve të këtij grupi u desh ta mbanin gjatë gjithë jetës. Në vitin 1946, Isuf Keçi u lirua nga radhët e Ushtrisë Kombëtare dhe u ngarkua me detyrën e drejtorit të grumbullimit në Ministrinë e Tregtisë<sup>548</sup>. Gjatë afrimit shqiptaro-jugosllav të viteve 1944-1948, Isuf Keçi, sipas letrës që i dërgoi nga burgu prokurorit Josif Pashko, u persekutua dhe u përndoq për t'u arrestuar nga Sigurimi i Shtetit që në atë kohë drejtohej nga ministri i Brendshëm, Koçi Xoxe. Ka të ngjarë se arsye e kësaj përndjekjeje të ishte demonstrimi i përçmimi ndaj Grupit Komunist të Korçës dhe emërimit në pozicione drejtuese të njerëzve me origjinë nga klasa punëtore, siç ishte Koçi Xoxe, Pandi Kristo e Pilo Peristeri dhe të mos ishte i dëshirueshëm për jugosllavët që ushtronin influencë shumë të madhe në Shqipëri. Menjëherë pas çlirimit, institucionet kryesore u vendosën në diktatin dhe këshillimin e drejtpërdrejtë të këshilltarëve jugosllavë, që ishin atashuar pranë çdo dikasteri të rëndësishëm. Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit sipas dokumentacionit përkatës korrespondojnë dhe raportojnë në Beograd, duke vazhduar një traditë që kishte filluar që gjatë luftës. Të gjitha vendimet kryesore të politikës së jashtme dhe të brendshme të qeverisë shqiptare merreshin me dijeni dhe në bashkëpunim të plotë me autoritetet jugosllave në Beograd, duke krijuar de facto tiparet e një shteti nën protektorat. Pas letrës së Stalinit dërguar Titos dhe Rezolucioneve të Infobyrosë, e cila dënonte vijën politike të Partisë Komuniste Jugosllave, Enver Hoxha përfitoi nga rasti për të ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Jugosllavinë e Titos, duke anuluar të gjitha marrëveshjet që rrezikonin sovranitetin e shtetit shqiptar<sup>549</sup>. Ashtu si në gjithë Europën Lindore, edhe në Shqipëri filluan operacionet e spastrimit nga të ashtuquajturit trockistë dhe mbështetës të Titos. Enver Hoxha shfrytëzoi rastin për të hequr qafe kontrollin e vazhdueshëm bezdisës të udhëheqësve që vinin nga klasa punëtore si Koçi Xoxe, Pandi Kristo, Kristo Themelko, etj., dhe që ishin mbështetur që nga viti 1945 prej jugosllavëve<sup>550</sup>. Të gjitha sjelljet e ashpra ndaj individëve, burgosjet, internimet, torturat në burgje dhe kampe internimi iu faturuan Koçi Xoxes dhe drejtuesve të tjerë të Ministrisë së Brendshme. Gjithë procesi u shoqërua me rehabilitim të të gjithë anëtarëve të PKS-së që ishin përndjekur nga Sigurimi i Shtetit.

Isuf dhe Hamit Keçi janë pikërisht kuadro të Partisë Komuniste që mbështetën kursin e ri prosovjetik të

---

548. AIDSSH/AMPB, F.1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 2. Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit

549. Epilogu i marrëdhënieve të ngushta shqiptaro-jugosllave do të përmbyllet në letrën, që Enver Hoxha i dërgoi Titos më 23 maj 1948, si përgjigje e dy letrave të tij të 22 prillit 1948. Në atë letër, pasi përsëriti sërish konkluzionet e mbledhjes së Byrosë Politike dhe jep siguri për vazhdimin e marrëdhënieve të ngushta jugosllave-shqiptare, ai i tejkalon ato përmes filtrit të ideologjisë marksiste-leniniste. Nën këtë filtër ai synon që të rivendosë barazinë në marrëdhëniet midis dy partive dhe shteteve duke guxuar për herë të parë të kritikojë PKJ. Ne duhet t'i kërkojmë me kujdes arsyet e mëdha të mosmarrëveshjeve tona. Ndershmërisht dhe në mënyrë komuniste duhet që të dy palët t'i analizojmë çështjet të gjitha dhe të bëjmë kritikën dhe autokritikën e vërtetë të gabimeve që janë konstatuar në punën tonë të përbashkët dhe gabime ka nga të dyja palët...Ne i pranojmë me plot sinqeritet kritikën që mund t'i bëhen Partisë sonë nga partitë e tjera motra dhe veçanërisht nga Partia Jugosllave, por nuk pranojmë që një e drejtë e tillë e padiskutueshme t'i mohohet Partisë sonë. Për më tepër shih: AQSH. F.14/AP (MPKJ), V.1948, D. 4.

550. Në qershor 1948, Enver Hoxha, për t'i shpëtuar ndëshkimit si titist, pasi edhe ai vetë pati qenë një udhëheqës që pati ndjekur me besnikëri rrugën jugosllave, u atashua politikisht, së bashku me Mehmet Shehun, Bedri Spahiun, Liri Belishovën etj. në anën e sovjetikëve. Nga viti 1948 “Jugosllavia titiste” u kthye në armikun kryesor të komunistëve shqiptarë, ndërsa marrëdhëniet e shqiptarëve në të dyja anët e kufirit thuajse u ndërprejnë nga një luftë realiste e ftohtë mes dy vendeve dhe nga përdorimi në shkallë të gjerë i rrjetit agjenturor nga të dyja palët. Më 29 qershor 1948, K.Q. i PKS-h publikoi komunikatën, me të cilën solidarizohet me rezolutën e Byrosë Informative “Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave”, ku dënohej rruga e PKJ dhe e udhëheqjes së saj brenda kampit socialist.

PKSH-së. Më 13 dhjetor 1948 Isuf Keçi emërohet kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës.<sup>551</sup> Në vitin 1950, marrëdhëniet e Isuf Keçit me drejtuesit e regjimit totalitar u përkeqësuan sërish. Shkak për këtë u bë i afërmi i tij, Hamit Keçi. Siç është përmendur më herët në këtë punim, Isuf dhe Hamit Keçi kishin mbështetur njëri-tjetrin gjatë veprimtarisë së tyre politike. Ndryshe nga Isufi, Hamit Keçi bëri karrierë në ushtri. Menjëherë pas çlirimit, Hamiti u emërua shef i Shtabit të Korparmatës III të Ushtrisë Kombëtare e, për disa muaj, komandant i Korparmatës I. Gjatë viteve 1945-1948 u dërgua në Moskë për të studiuar në Akademinë e Lartë Ushtarake “Voroshilov”, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. U kthye në atdhe me gradën “Nënkolonel”. U emërua drejtor i Drejtorisë Politike të Zbulimit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe u gradua “Kolonel”. Më 2 gusht të vitit 1949 Hamit Keçi arrestohet. Shkak i arrestimit ishte grindja që pati më 1 gusht 1949 me këshilltarin sovjetik kolonelin Lebedjev, disa oficerë të tjerë sovjetikë që punonin pranë ushtrisë shqiptare, Beqir Ballukun, shefin e Shtabit të Ushtrisë Shqiptare dhe Hysni Kapon, shef i Drejtorisë Politike të Ushtrisë Shqiptare (të dy anëtarë të Byrosë Politike) për planet e stërvitjes së Ushtrisë Popullore.<sup>552</sup> Sipas Hamit Keçit, planet ishin hartuar nga tradhtarë të popullit shqiptar dhe ishin të dëmshme. Nuk është fort e qartë se përse kishte lindur ky konflikt, por ai mund të jetë ilustrues i rivalitetit mes Beqir Ballukut, ish-zëvendësministër i Mbrojtjes gjatë kohës së dominimit jugosllav dhe Hamit Keçit, të porsaardhur nga Moska. Mjaftoi kjo grindje që drejtuesit e lartë të PPSH-së të fillonin të kërkonin për grupe armiqësore që punonin kundër interesave të Partisë dhe të shtetit. Fantazma e Grupit Komunist të të Rinjve u rrizgjua sërish, 8 vjet pas themelimit të PKSH-së. Në bisedën e Enver Hoxhës me ambasadorin sovjetik Dimitri Çuhavin, udhëheqësi komunist shqiptar i kujtoi diplomatit sovjetik se Hamit Keçi i përkiste të ashtuquajturit Grup Komunist të të Rinjve dhe se ky grup, “në periudhën e pasçlirimit u përpoq dhe përpiqet të futet në udhëheqjen e partisë dhe për këtë qëllim, përpiqet gjithmonë ta tregojë veten në popull. Tani për tani, është e vështirë të thuhet se ai është udhëheqës i këtij grupi, por një gjë është e qartë, se në këtë grup bëjnë pjesë Hamit Keçi, Isuf Keçi, Njazi Islami (kandidat për anëtar i KQ), Abedin Shehu (anëtar i KQ – ministër i Punëve Publike), Shukri Këllezi (zëvendësministër i Komunikacioneve deri kohët e fundit dhe tani drejtor i Kombinativit të Naftës në Kuçovë) dhe të tjerë”<sup>553</sup>. Hamit Keçi konsiderohet i çmendur nga disa punonjës ushtarakë, por Hoxha është dyshues dhe shton se ai kishte folur me kushëririn e tij të parë, Isuf Keçin (kryetar i këshillit të qytetit të Tiranës), (në fakt vëllai i tij-shënimi im) dhe me disa shokë të tjerë të grupit mbi veprimet e veta<sup>554</sup>. Gjithsesi në vërejtjen e radiogramit ambasadori sovjetik shënon se “Koloneli Lebedjev është i bindur se Hamit Keçi ka lojtur nga mendja. Shqiptarët po marrin masa për të përcaktuar gjendjen reale të shëndetit të Hamit Keçit”<sup>555</sup>.

Dokumenti i marrë nga arkivat e Moskës mban datën 2 gusht 1949, por Sigurimit të Shtetit iu deshën gatë 6 muaj për të ndërtuar zbulimin e këtij grupi antiparti dhe për të përmbushur porosinë e Enver Hoxhës. Në komunikatën e Komitetit Qendror të PPSH-së lidhur me një mbledhje të Plenumit V të PPSH-së, të mbajtur më 20-22 shkurt dhe 6 mars të vitit 1950, ku u mor në analizë dhe u dënua “veprimtaria e grupit antiparti të kryesuar prej: Abedin Shehut, Njazi Islamit, Shyqyri Këllezit, Isuf dhe Hamit Keçit”, etj., opinioni publik u vu në dijeni për ekzistencën e një grupazhi të përbërë nga kadro të lartë të PPSH-së. Ndërkohë Isuf Keçi, sipas dosjes së tij hetimore ishte arrestuar më 29 shkurt dhe vuante paraburgimin në hetuesinë e Tiranës.

Komunikata e KQ të PPSH-së përmbushte dyshimet që kishin filluar që nga arrestimi i Hamit Keçit në datën 2 gusht 1949 dhe pas 8 vjetësh shikonte sërish një rrezik që i kanosej PPSH-së nga elementë të ashtuquajtur grupazhe. Kjo akuzë të kujtonte akuzat e bërë në vitet e luftës kundër Grupit Komunist të të

551. AIDSSH/AMPB, F.1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 2. Procesverbal i marrjes në pyetje të Isuf Keçit

552. Hamit Kaba, Ethem Çeku (përgatitës për botim), *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, Akademia e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet Flamuri, 2017, f. 100.

553. Hamit Kaba, Ethem Çeku (përgatitës për botim), *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse ...*, f. 100.

554. Hamit Kaba, Ethem Çeku (përgatitës për botim), *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse ...*, f. 100.

555. Hamit Kaba, Ethem Çeku (përgatitës për botim), *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse ...*, f. 101.



Rinjve dhe jo më kot në komunikatën e KQ të PPSH-së përmendej sërish e kaluara komuniste e Hamit e Isuf Keçit, Abedin Shehut, Shyqyri Këllezit e Niazi Islamit. Krerët e grupit të «Të Rinjve», tradhtarët Sadik Premte dhe Anastas Lula, ishin kundër formimit të Partisë dhe vijës së saj politike dhe organizative. Këta krerë trockistë kishin krijuar një grup me koncepte antiparti dhe antimarksiste-leniniste ... Trockistët Anastas Lula dhe Sadik Premte e edukonin grupin me një konspiracion të kalbur dhe me një formë organizimi antiparti duke përdorur rrethe të ngushta të njohurish, miqsh e farefisi, që janë rezultat direkt i mosbesimit ndaj masave ... Një pjesë tjetër e këtij grupi, që ishte më shumë nën influencën e krerëve, të ideologjisë dhe të konceptimeve antiparti të grupit, i ruajti dhe i zhvilloi konceptimet morale, shoqërore, organizative dhe ideopolitike të grupit. Kjo pjesë jo e shëndoshë e këtij grupi ka qenë vazhdimisht në kundërshtim me Partinë dhe me vijën e saj, ka bërë zigzage të rëndësishme në punë, por nuk ka mundur të dalë hapur në luftë kundër Partisë, për arsye të sukseseve dhe të vrullit revolucionar të Partisë. Kjo pjesë e grupit të «Të Rinjve», në të cilën bënin pjesë Abedin Shehu, Shyqyri Këllezi, Isuf Keçi dhe Hamit Keçi dhe me të cilën u bashkua edhe Niazi Islami, që kishte të njëjtat koncepte antiparti, ishte gjithmonë në pritje të evenimenteve dhe të krizave në Parti për të përfutur nga situatat.<sup>556</sup>

Po kështu në mënyrë të tërthortë pranohet në komunikatën e KQ të PPSH përndjekja që Isuf Keçi dhe anëtarët e Grupit Komunist të të Rinjve kishin kaluar gjatë muajit të mjaltit të miqësisë shqiptaro-jugosllave. Gjithsesi, në komunikatë sërish nuk harrohet të kritikohet i ashtuquajtimi grupazh dhe të shprehet frika e krijimit të një organizimi paralel të anëtarësisë së Partisë. Në pragun e këtyre evenimenteve, thuhet në komunikatë, dhe në Kongresin I të Partisë, dhe gjatë kongresit, ata i vunë vetes si objektiv të zënë pozita në Parti duke përfutur nga situata. Për këtë ata u përgatitën dhe bënë plan: në organizatat bazë, në konferencat për zgjedhjen e delegatëve për në kongres dhe në kongres, ata kanë fshehur jo vetëm pikëpamjet e tyre antiparti dhe gabimet e tyre, por edhe ato të njëri-tjetrit, duke u hequr si të persektuar largonin çdo dyshim kundrejt tyre; reklamonin njëri-tjetrin, kritikonin ata që sipas pikëpamjes së tyre nuk duhej të ishin në udhëheqjen e re dhe, në kundërshtim flagrant me rregulloren e aprovuar nga kongresi, bënin lista të kandidatëve për udhëheqje, jashtë komisionit të zgjedhjeve të caktuar nga kongresi. Abedin Shehu, i cili ishte anëtar i këtij komisioni, dekonspironte në shokët e tij të grupit diskutimet e komisionit të zgjedhjeve. Kongresi u bë për këta shokë një kthesë në drejtim dhe me qëllim të kundërt me atë të Partisë. Ata zunë pozita në Parti dhe në shtet dhe filluan të rigrupohen e të zhvillojnë një punë konkrete grupazhi dhe të kalojnë nga lidhjet «e lira shoqërore» në lidhje organizative grupi. Kështu nga lidhjet «miqësore» të ruajtura nga grupi i «Të Rinjve», ata përfunduan në krijimin e një grupi antiparti në radhët e Partisë me tipare organizative, politike dhe morale të grupit të vjetër të «Të Rinjve». Në këtë mënyrë, duke pasur pikëpamje grupazhi mbi Partinë, duke mos pasur besim te Partia dhe duke qenë në kundërshtim me të dhe me vijën e saj, ata kaluan në një fazë më të organizuar të luftës së tyre kundër Partisë dhe pikërisht në një kohë kur forcuan pozitat e tyre në udhëheqje të Partisë dhe të shtetit.<sup>557</sup> Në komunikatë kritikohen dhe pikëpamjet për ekonominë, ushtrinë, zhvillimin industrial e politikat e kuadrit që Isuf e Hamit Keçi, Abedin Shehu, Shyqyri Këllezi e Niazi Islami diskutonin gjatë drekave dhe takimeve të tyre.

Sipas dosjes hetimore të Isuf Keçit rezulton se kishte pasur disa takime të cilat kishin nisur në fillim si dreka qejfi për t'u kthyer dalëngadalë në një grup, të cilit iu shtua dhe Hamit Keçi, Naizi Islami e disa të tjerë.<sup>558</sup> Bërthama e parë e grupit duket se kanë qenë Isuf Keçi, Shyqyri Këllezi e Abedin Shehu e mandej u ishin bashkëngjitur Hamit Keçi e Niazi Islami (kunar i Isuf e Hamit Keçit). Pyetjes se çfarë diskutohej në grupin e tyre Isuf Keçi i përgjigjet se “e mbaj mend fare mirë se iniciatori i hapjes

556. Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH. Komunikatë e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950. Marrë nga: *Memorie.al*.

557. Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH. Komunikatë e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950. Marrë nga: *Memorie.al*.

558. AIDSSH/AMPB, F. 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 4. Procesverbal i marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

“

Ju e vidhni, e

fshatarësinë.

fshatari të m

ekonominë, j

nxirrni ligje e

dhe ia rrëmb

e grabisni

Me të filluar

ëkëmbë

ju menjëherë

e urdhëresa

eni”

Drejtuesit e rinj  
sovjetikë pas Stalinit

së bisedimeve ka qenë Abedin Shehu. Ay e kishte zakon t'i ngrinte problemet gjithmonë në formë pyetjesh dhe pastaj fillonte diskutonte vetë, shpeshherë duke qeshur ose duke luajtur syrin njëri-tjetrit. Mua më kujtohen këto bisedime: Kur do të jemi në gjendje ta sigurojmë bukën vetë? Cili duhet të jetë orientimi ynë, bujqësia apo minierat? A janë më të nevojshëm transportet hekurudhore apo transportet me kamiona? Për këtë Abedini konkludonte se transporti me kamiona është më i nevojshëm dhe më i përshtatshëm për vendin tonë. Është ngritur pyetja, po nga Abedini, se pse është ulur Mareshalli Zhukov nga Komanda? A mund t'a fshij me një herë Ushtria e Kuqe Evropën? A mund ta mbrojmë vendin kundra monarko-fashistave Grek? A e përdorin sovjetikët energjinë bërthamore në industri? Është diskutuar në lidhje me urdhresat e grumbullimit, rezistencën në fshat, cili është kulak. Është diskutuar në lidhje me kuadro të ndryshëm për të metat se cili bën dhe cili nuk bën që nga Ministrat e deri në kuadrot më të ulta. Është folur nga Naizi Islami se nuk është dakort me Komisionin e Planit. Të provokuar nga Abedini aty dekonspironim çdo gjë që kishim”<sup>559</sup>.

Mendimet e bisedat e shkëmbyera, pavarësisht faktit se në komunikatën e KQ të PPSH-së u etiketuan si propagandë trockiste dhe antiparti, shprehnin shqetësimet dhe idetë e ndryshme nga çfarë propagandohej për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë, për fat të keq, po ndiqte rrugën dhe modelin sovjetik stalinist të ndërtimit të bazave të industrisë dhe të një kolektivizimi të dhunshëm, që po shkatërronte bazat e ekonomisë së fshatit. Si anëtare e KNER-it që nga shkurti i vitit 1949, Shqipëria përfitonte ndihma nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të Europës Lindore, por nuk ishin të mjaftueshme për të përmirësuar nivelin e jetesës. Modeli ekonomik shqiptar që një model që karakterizohej nga masat shtrënguese ndaj fshatarësisë dhe sforcimit për të ndërtuar baza industriale të papërballueshme nga buxheti i shtetit. Drejtuesit e rinj sovjetikë që erdhën pas Stalinit, ia thanë hapur Enver Hoxhës: “Ju e vidhni, e grabisni fshatarësinë. Me të filluar fshatari të mëkëmbë ekonominë, ju menjëherë nxirrni ligje e urdhëresa dhe ia rrëmbeni. Në 200.000 tonë prodhim, t'i marrësh 50.000 tonë fshatarësisë si taksë në natyrë, kjo është vjedhje<sup>560</sup>”. Po kështu, zbatimi i modelit stalinist në ekonomi duke i dhënë përparësi ndërtimit të industrisë së rëndë ishte i papërshtatshëm për ekonominë e brishtë shqiptare të porsadalë nga lufta. Në hartimin e Planit I Pesëvjeçar ishte parashikuar ndërtimi i një fabrike për shkrirjen e çelikut, një fabrike letre, fabrike qelqi, ndërtimi i hidrocentralit mbi lumin e Matit dhe i një rafinerie naftë. Ishte pikërisht ky planifikim që i tejkalonte mundësitë ekonomike të Shqipërisë që kritikohesh në mbledhjet e grupit të ashtuquajtur antiparti dhe që kanalizonte gjithë ndihmën ekonomike të përfituar nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të Europës Lindore drejt investimeve të mëdha të papërballueshme.

Një aspekt tjetër i pranishëm në diskutimet e Isuf dhe Hamit Keçit, Abedin Shehut, Shyqyri Këllezit dhe Niazi Islamit ishte edhe ai profesionalizmit të kuadrove që promovoheshin. Shqipëria zinte vendin e fundit nga vendet e Europës Lindore që kishin instaluar ndërtimin e socializmit për numrin e intelektualëve në drejtim. Që gjatë Luftës, Grupi Komunist i të Rinjve ishte kritikuar për intelektualizëm dhe Enver Hoxha e ndoqi si parim deri në fund të jetës së tij promovimin e bashkëlufëtarëve gjysmë të shkolluar, por që kishin si virtut besnikërinë ndaj tij. Niveli i ulët intelektual i Byrosë së fundit Politike të PPSH që udhëhiqte Shqipërinë edhe 20 vjet pasi ishte hapur Universiteti Shtetëror është dëshmi që deri në fund, regjimi komunist mbeti konsekuent në dogmën e tij.

Në Plenumin V të K. Q. të PPSH u morën vendime drastike dhe të ashpra ndaj të ashtuquajturit grupazh antiparti. Në pikën një thuhej: “Të përjashtohen nga radhët e Komitetit Qendror anëtarët e Komitetit Qendror, Abedin Shehu, Niazi Islami dhe kandidati i KQ Shyqyri Këllezi, të cilët në kundërshtim me rregullat më elementare të Partisë kanë zhvilluar një aktivitet grupazhi antiparti me të cilin kanë dëmtuar Partinë, nuk kanë ruajtur vijën e Partisë dhe interesat e saj dhe kanë punuar

559. AIDSSH/AMPB, F. 1/Dosjet hetimore-gjyqësore, D. 656, fl. 4. Procesverbali i marrjes në pyetje të Isuf Keçit.

560. Ana Lalaj, *Pranverë e rrejtshme e '56*, Tiranë: Infobotues, 2015, f. 32.

në kundërshtim me vijën e Partisë, nuk kanë bërë autokritikë përpara Komitetit Qendror. Duke marrë parasysh se pas përjashtimit nga Komiteti Qendror, Niazi Islami vrau veten, akt ky që është në vetvete i dënueshëm nga Partia, duke marrë parasysh që Niazi Islami i ka fshehur Partisë aktivitetin e tij armiqësor, duke marrë parasysh se vetëvrasja e tij është një tjetër akt armiqësor kundrejt Partisë për të mbuluar tradhtinë që i ka bërë Partisë dhe shtetit, Komiteti Qendror vendosi përjashtimin e tij nga Partia pas vdekjes.”<sup>561</sup> Po kështu, pika dy përcaktonte fatin politik të vëllezërve Keçi. Aty shkruhej: Komiteti Qendror përjashtoi nga radhët e Partisë, Hamit Keçin dhe Isuf Keçin dhe aprovoi arrestimin e tyre për faje kundër popullit dhe shtetit.<sup>562</sup>

---

## Trashëgimia politike dhe ideologjike e Isuf Keçit

---

Vendimet që u morën në Plenumin V të KQ të PPSH-së më 20–22 shkurt mbytnë që në vezë një përpjekje tjetër të evoluimit të së majtës shqiptare, nga një e majtë me tipare të theksuara staliniste, drejt një të majte më të moderuar e pragmatike ndaj situatës së atëhershme në Shqipëri. Trashëgimia politike e përkatësisë në Grupin Komunist të të Rinjve kishte lënë gjurmët e veta në trajtimin e problematikës së zhvillimeve të vendit. Edhe pse vendi kishte tashmë një bërthamë më të madhe të klasës punëtore, sfidat e menaxhimit të pushtetit që kishte fituar një nomenklaturë që po shpëritej çdo ditë e më tepër kërkonin një interpretim më të thellë të marksizmit dhe përshtatjes së tij në realitetet e reja. Në realitetin e Perdes së Hekurt ku Shqipëria ishte vetizoluar, përpjekja intelektuale dhe e çiltër e këtyre komunistëve të hershëm është një dukuri e disidencës së brendshme brenda PPSH-së, që la gjurmët e veta në kohë. Pas dënimit me burg si element antiparti në vitin 1951, Isuf Keçi nuk pati më mundësi të rehabilitohej e për më tepër, të ishte aktiv në jetën e majtës komuniste shqiptare. Komunizmi ortodoks shqiptar, edhe pas shkrirjes së akujve në 1953 apo në periudhën 1956–1959, kur ishte nën presionin sovjetik për t’u liberalizuar, arriti të mbijetonte falë përplasjes ideologjike që realizoi në vitin 1960 dhe aleancës së ngushtë me Kinën komuniste. Fjalët e profesor Kristo Frashërit, një prej anëtarëve aktivë të Grupit Komunist të të Rinjve se shpëtoi pa u goditur sërish vetëm me 25 lekë, sa kushtonte një çelës tutius duke nënkuptuar mbajtjen mbyllur të gojës, karakterizuan të gjithë anëtarët e mbetur gjallë të Grupit Komunist të të Rinjve. Isuf Keçi vdiq në vitin 1984 dhe mendimi e aktiviteti i tij politik gjetën vëmendje në aktivitetin e pas viteve ’90, të vëllait të tij, Hamit Keçi. Ai ishte një nga themeluesit e OBLV-së të përbërë nga veteranë të luftës jodogmatikë që dëshirojnë rishikimin e historisë së LANÇ dhe të së majtës shqiptare.

---

561. Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH. Komunikatë e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 20–22 shkurt dhe 6 mars 1950. Marrë nga: *Memorie.al*.

562. Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH. Komunikatë e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, Tiranë, 20–22 shkurt dhe 6 mars 1950. Marrë nga: *Memorie.al*.

## Bibliografi

### *Dokumente:*

Dokumente e qarkore të PKSH Tiranë shkurt 1948  
Dokumente kryesore të PPSH 1941–1944, Vëllimi i II, Tiranë:1971  
Dosja hetimore Isuf Keçi. Procesverbali i marrjes në pyetje. Arkivi i AIDSSH.  
AQSH, F.14, dos.76  
AQSH.F.14/MPJ), dos.4, v.1948.

### *Libra:*

Ana Lalaj, Pranverë e rrejshme e 56', Tiranë: Infobotues, 2015.  
Dosja hetimore Isuf Keçi. Procesverbali i marrjes në pyetje. AIDSSH  
Hamit Kaba, Ethem ÇEKU. Shqipëria dhe Kosva në arkivat ruse 1946–1962. Akademia e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë. Tiranë:2017, Botimet Flamuri.  
Enver Lepenica. Eliminimi i Grupit Komunist të “Të Rinjve”, dokumente, dëshmi, studime. Tiranë:2016, Intituti I Sudimit të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit.  
Kastriot Dervishi. Lëvizja komuniste në vitet 1924–1944 dhe formimi I PKSH-së. Tiranë:2016, Shëpia Botuese 55  
Kristo Frashëri. Jeta e një historiani, Kristalina KH, Tiranë:2014.  
Kujtimet e Koço Tashkos, shkruar më 1.12.1953, AQSH.  
Paskal Milo. Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore. Tiranë:2014, Toena  
Raport i Koço Tashkos mbi formimin e grupeve komuniste në Shqipëri. AQSH.Fondi 14/APL.;  
Procesverbali i Mbledhjes Themeluese të PKSH-SË 11 nëntor 1941.

### *Internet:*

Rahman Parllaku. Jeta e luftëtarit patriot Hamit Keçi, nga lufta për çlirim tek burgosja pas përplasjes me Enver Hoxhën. 20 mars 2015 në Gazeta Sot. DOSSIER  
PLENUMI V I KOMITETIT QENDROR TË PPSH. KOMUNIKATË E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TE PPSH Tiranë, 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950. Memorie.al

### *Burime arkivore:*

AQSH / AP – Arkivi Qendror Shtetëror / Arkivi i Komitetit Qendror të PPSH-së  
AIDSSH – Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

*Të tjera:*

- BOTTOMORE Tom – GOODE Patrick (eds.), *Austro-Marxism*, Clarendon Press, Oxford, 1978.
- DERVISHI Kastriot, *Lëvizja komuniste në vitet 1924-1944 dhe formimi i PKSH-së*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2016.
- DIMITROV, Georgi *Selected Works*, vëllimi II, Sofia Press, 1972.
- Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri dhe demokraci 1917-1941, botim i Drejtorisë së Arkivave të Shtetit të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1959.
- FIERZA Gjon, Zef Mala, mes lavdisë dhe persekutimit, artikull në gazetën “Tirana Observer”, botuar më 16 prill 2015.
- FRASHËRI Kristo, *Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2006.
- Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*, botim II, 8 Nëntori, Tiranë, 1981.
- SWAIN Geoffrey, *Tito and the twilight of the Comintern*, në *International communism and the Communist International 1919* (eds. Tim Rees, Andrew Thorpe), Manchester University Press, Manchester and New York, 1998.
- HOBSBAWM, Eric J., *Age of Extremes*, Little Brown and Company, 1995,
- HOXHA Enver, *Për shokët e mi pionierë: pjesë të zgjedhura nga Veprat*, 8 Nëntori, 1985.
- MCKENZIE Kermit E., *Comintern and World Revolution, 1928-1943: The Shaping of a Doctrine*. Columbia University Press, London and New York, 1964.
- MILO Paskal, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëllimi I, Toena, Tiranë, 2013.
- PIPA Arshi, *Albanian Stalinism: Ideo-Political Aspects*, Eastern European Monographs, Michigan, 1990.
- POLANYI Karl, *The Great Transformation*, Beacon Press, Boston, 2001.
- PONS Silvio, *La rivoluzione globale. Storia del comunismo internazionale, 1917-1991*, Einaudi, Torino, 2012.
- SECCHIA Pietro, *Il Partito comunista italiano e la guerra di Liberazione, 1943-1945 – ricordi, documenti inediti, testimonianze*, Feltrinelli, Milano, 1973.
- TROTSKY Leon, *The Impending Danger of Fascism in Germany – A Letter to a German Communist Worker on the United Front Against Hitler*, në organin “The Militant”, vëllimi V, nr. 2, New York, NY, botuar më 9 janar 1932.

*Xhavid*

*Qesja*

10



# Ky sfidant tragjik

Xhavid Qesja: një personazh krejt i veçantë në historinë e persekucionit komunist shqiptar. Ithtar i pashoq i doktrinës së Marksit e njëherësh antikomunist i pakompromis. Çfarë ndodhi me djaloshin 19 - vjeçar nga Kruja, i cili më 1941 braktisi origjinën prej nga vinte, me familje e farefis, pronarë tokash e dyqanesh, dhe iu bashkua komunistëve? Pastaj qenë komunistët ata që jo vetëm e braktisën Qesen, por dhe e përplasën tridhjetë vjet në burgje dhe internime. Ky sfidant i rrallë e tragjik që e çoi jetën çuditshëm midis dy skajesh, ekzaltimit për doktrinën dhe urrejtjes për pushtetin, për atë pushtet që u ngrit mbi dhe sipas vetë doktrinës.

**NGA ANA LALAJ**

*Unë jam kundër jush e, për pasojë, në luftë me ju!*

*Xhavid Qesja*

Në një jetëshkrim të shkurtër, më 1950, Xhavid Qesja shkruan për veten se u lind në Krujë më 25 maj 1922, në një familje të pasur dhe se, siç e thotë ai vetë, “reformat e pushtetit i kanë marrë tokë, gjë të gjallë, para – me anë të tatimeve të jashtëzakonshme për fitimet e luftës, si dhe dyqane”.<sup>563</sup> Mësimet e para i mori në Krujë dhe më pas kreu shkollën tregtare në Durrës. Gjimnazin e filloi një vit në Shkodër dhe e përfundoi në Tiranë. Në Durrës ka jetuar te një dajo i tij, ndërsa në Tiranë, te xhaxhai. Për të dy thotë se nuk e deshën pushtetin e komunistëve dhe se ai i kishte shkëputur marrëdhëniet me ta.

Po si u lidh Qesja me komunizmin? Ai thotë se për një lëvizje komuniste për herë të parë kishte dëgjuar në Shkodër, më 1938, në vitin e parë të gjimnazit. Por ai vetë nuk ishte përzier dhe askush nuk ishte përpjekur të ndikonte tek ai. Po ashtu, kur erdhi në Tiranë, askush nuk i foli për komunizmin. Gjërat ndryshuan vetëm pasi vendi u pushtua nga Italia fashiste. Të rinjtë e shkollave, kuptohet, me nxitjen e mësuesve, ishin të parët që reagueshan ndaj pushtimit. Xhavid Qesja ishte njëri prej tyre. Që atëherë, në dy-tri raste demonstratash, ai u ndalua e u arrestua nga policia. Më 1940, për një kohë shkolla u

563. AQSH, F 14/AP-Str.V. 1956-1957, Dosje në përpunim, Biografi e anëtarit të PPSH, Xhavid Qesja, 23 shtator 1950.



Xhavid Qesja u lind në Krujë më 25 maj 1922, në një familje të pasur. Mësimet e para i mori në Krujë dhe më pas kreu shkollën tregtare në Durrës. Gjimnazin e filloi një vit në Shkodër dhe e përfundoi në Tiranë.  
(foto nga arkivi i familjes)

mbyll dhe atëherë Qesja u dha pas leximeve. Duket se lexoi jo vetëm libra artistikë, por edhe politikë e sidomos libra me përmbajtje komuniste. “Bleva në Itali – me anë të korrespondencës – mjaft libra të tillë, mbi jetën e shokut Stalin, një përmbledhje të ‘Kapitalit’, etj., – shkruan Qesja. Nga ky i fundit nuk mora vesh ndonjë gjë të madhe, pse më mungonin edhe njohuritë fillestare të marksizmit, por duke lexuar këtë libër m’u krijua bindja se bota do të shkonte në komunizëm.”<sup>564</sup> Një pohim si ky e kam hasur edhe në një raport bisede që Qesja ka pasur me Kiço Ngjelën tridhjetë vjet më vonë, kohë kur të dy vuanin dënimin në burgun e Burrelit. “Ta kam thënë edhe njëherë, – vazhdoi Xhaviti, – unë nuk jam bërë komunist, duke lexuar Nënën e Gorkit, por Kapitalin e Marksit, qysh kur isha student në gjimnaz.”<sup>565</sup> Pra, mund të thuhet se rrugën për në komunizëm Qesja e nisi me librat. Ndërsa takimin e parë me komunistët ai e pati vetëm në verë 1941, kur ai sapo kishte mbaruar gjimnazin. Gjithçka nisi me një ftesë që mori nga një celulë komuniste në Tiranë, pastaj prania në dy a tri mbledhje, në njërën prej të cilave, ku merrte pjesë edhe Tuk Jakova, Qesja u regjistrua anëtar në Partinë Komuniste Shqiptare të sapoformuar.

564. *Po aty.*

565. Autoriteti për Informim mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), Arkivi i Ministrisë Brendshme (AMB), Dosje përpunimi 2-A, nr. 1820 për Xhavid Qesen, Raport i datës 20.8.1981, dhënë nga “I penduari”, f. 234.

Që prej kësaj kohe, Qesja u mor ilegalisht me propagandë komuniste në terren, fillimisht në Tiranë dhe më vonë në Krujë. Në këtë qytet ai krijoi një celulë partie, vuri në punë këshillin nacionalçlirimtar, si dhe mbledhi rreth vetes të rinj antifashistë, etj., një skemë që komunistët e përdorën gjithnjë e më mirë. Në maj 1943 ai u bë pjesë e një njësi partizanësh nga Kruja, të cilët në qershor u bashkuan me një tjetër njësi, atë të Ishmit dhe kështu formuan Batalionin Krujë-Ishëm. Qesja u bë komisar i këtij batalioni, ndërsa Beqir Balluku ishte komandanti. Kështu filloi karriera e luftës për komunistin Xhavid Qesja, që ishte njëherësh edhe fillësë e karrierës së tij politike. Më 1944 ai ishte komisar brigade, anëtar i qarkorit të Partisë në Tiranë, komisar për Zonën e Parë të Prapavijës. Më 1945 punoi në aparatet e Komitetit Qendror të Partisë, deri më 1951. Që prej këtij viti e deri më 1954, ai ishte në krye të organizatës së Partisë së Punës në Shkodër e më pas në Berat, deputet në Kuvendin Popullor, etj.

Deri këtu, një jetëshkrim skeletik si ky, pak a shumë është i ngjashëm me jetëshkrimet e mjaft prej të zbriturve nga mali dhe që zunë karriget e pushtetit. Ajo që është regjistruar si e veçantë të Xhavid Qesja është se një ditë erdhi përplasja me partinë e tij. Edhe pse ai nuk ishte as i pari e as i fundit. Megjithatë, më kryesorja, për nga përmbajtja dhe motivet, kjo përplasje ishte e pangjashme në llojin e vet.

---

## Zanafilla, 1956

---

Blloku komunist, ende pa mbushur dhjetë vjet si i tillë, kaloi dy çaste të vështira, madje dy kriza. Kriza e parë pati si shkak shtrëngesën, diktatin, çka solli thyerjen sovjeto-jugosllave. Ndërsa kriza e dytë pati për shtysë hapjen, liberalizimin. Të dyja herët burimi ishte Moska. Hera e parë ishin vitet 1948 – ‘49 kur, nën kupolën e Kominformit, Stalini i bëri bashkë të gjithë kundër Titos. Hera e dytë, kur pasardhësi i Stalinit punoi shumë ta kthente Titon në “kamp”, por që më parë duhej gjetur një mënyrë për t’i kërkuar ndjesë atij.<sup>566</sup> Më 1956, në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ra miti i Stalinit dhe, me atë rast, u duk se Blloku mori frymë i lehtësuar. Në shoqëritë eurolindore qenë akumuluar mjaft pakënaqësi, më kryesoret për shkak të mungesave në ekonomi dhe të kufizimit të lirive. Kongresi u bë nxitje për lëvizje të brendshme në këto vende. Sinjalet e para u dhanë në Tiranë, kur komunistët e kryeqytetit në prill të atij viti, shfrytëzuan konferencën e tyre të shfrynyin dufin ndaj udhëheqjes së vendit, por që Enver Hoxha ia doli t’i frenonte. Po atë vit, në Poloni e Hungari gjendja u bë shpërthyesë, aq sa Hrushovi iu frik shpërbërjes së Bllokut. I gatshëm për lëshime, ai shpejtoi të qetësonte polakët, ndërsa në Budapest dërgoi tanket. Kjo ishte tronditja e dytë, më seriozja deri atëherë, çka tregoi se modeli sovjetik i shoqërisë komuniste po shfaqej me mjaft probleme.

Sidoqoftë, me gjithë zhgënjimet, viti 1956 ishte përpjekja e parë për një komunizëm më të mirë. Ky motiv vuri në lëvizje shumë njerëz në Lindje, komunistë e jokomunistë, njerëz të thjeshtë dhe intelektualë të përmendur. Xhavid Qesja ishte njëri prej tyre. Atë kohë ai ishte në Moskë, në Shkollën

---

566. \* Pjesë e ndjesës është edhe letra që Nikita Hrushovi ua dërgoi partive komuniste, anëtare të Kominformit, më 23 maj 1955, me të cilën u kërkonte atyre të tërhiqeshin nga Rezoluta e Mbledhjes së tretë të Kominformit “*Partia Komuniste Jugosllave në duart e vrasësve dhe të spiunëve*”, e nëntorit 1949, me arsyetimin se ajo rezolutë ishte miratuar në rrethanat kur partitë komuniste kishin prerë marrëdhëniet me PKJ dhe palët gjendeshin në pozita armiçësore. Këtë abrogim të vendimit të vitit 1949 Hrushovi do ta përdorte si kartë të re politike në marrëdhëniet me Beogradin.

e Lartë të Partisë. Në këtë shkollë studentët nga Shqipëria ishin thuajse të gjithë kuadro që vinin nga lufta dhe kishin poste drejtuese në parti ose në administratën e pushtetit. Më 1957, bashkë me shkollat e tjera në Bashkimin Sovjetik, shkolla të larta dhe kurse të niveleve më të ulëta, studentët dhe kursantët shqiptarë bëheshin disa qindra. Prej tyre vetëm anëtarë dhe kandidatë partie ishin më se 600 vetë, shpërndarë në 15 qytete, më të shumtët në Moskë. Atë vit atje kishte 57 organizata partie, të cilat kishin formuar një komitet të Partisë së Punës, me qendër në Moskë, prej nga vareshin në pikëpamje organizative ose merrnin udhëzime.<sup>567</sup> Studentë shqiptarë kishte edhe gjetkë, në vendet e “demokracive popullore”, një term i sajuar për vendet me qeverisje komuniste. Duket se pikërisht më 1956 e në vijim, për Tiranën u kthye në shqetësim qëndrimi i studentëve shqiptarë në raport me zhvillimet politike në këto vende dhe sidomos me ngjarjet në Poloni dhe në Hungari. Për këtë arsye, studentët shqiptarë në të dy këto vende morën urdhër nga Tirana të ktheheshin në atdhe. Por shqetësimi mbetej edhe për ata që studionin në Bashkimin Sovjetik, pasi edhe në raport me Kursin e ri sovjetik (ose thënë ndryshe Kursi i destalinizimit), Enver Hoxha ishte i dyzuar. Shkak ishin sidomos dy pika të këtij kursi, kritikant ndaj Stalinit dhe afrimi me jugosllavët. Për këtë arsye, drejt Moskës, për studentët e atjeshëm shkonin vazhdimisht udhëzime nga Tirana dhe po ashtu lektorë për konferenca, përzgjedhur midis drejtuesve kryesorë në parti. Siç doli më vonë, Xhavid Qesja nuk kishte qenë në asnjërën nga këto konferenca.

Udhëheqja komuniste e Tiranës kishte të drejtë të ishte në merak ç'mendonin studentët shqiptarë në këto vende dhe sidomos në Bashkimin Sovjetik. Ajo ishte kohë për reflektime. Dhe shumëkush kishte reflektuar. Dhjetë vjet më vonë, duke përmendur Kongresin XX të PK të BS, si dhe revoltat në Poloni dhe në Hungari, në njërën prej letrave që ia drejtonte Byrosë Politike, Xhavid Qesja ka shkruar: “Këtyne tri ngjarjeve unë do t’u jem mirënjohës përjetë, sepse më zgjuan nga letargjia e naivitetit dhe më banë të mendoj si komunist seriozisht dhe në mënyrë kritike. Këto ngjarje kanë bërë që shumëkush të nxjerrë konkluzione. Edhe unë kam nxjerrë dhe si pasojë u shkëputa prej jush. E për këtë e ndjej veten të qetë dhe të lumtun.”<sup>568</sup>

Megjithatë shkëputja e Xhavid Qesës nga udhëheqja e partisë së tij, nuk ishte që në krye të herës as e hapur e as e befte. Qesja thotë se ato ngjarje e zgjuan nga letargjia. Ajo çka mbetet e paqartë është se kur ka ndodhur ky “zgjim”, në një kohë me ngjarjet apo pas tyre. Siç është po ashtu e dyshimtë, nëse shkëputja nga partia e tij, pra Qesja tjetër, është produkt i zhvillimeve politike brenda “kampit”, apo pasojë e ndëshkimit. Gjithsesi, mendoj se këto të dyja është e vështirë t’i ndash. Për këtë arsye jam e prirë të mendoj se, si në të gjitha rastet e ngjashme, edhe kjo histori ka një fillesë pak a shumë të zakonshme, thjesht biseda të lira midis studentësh për çështje që atë kohë zinin vend qendror në të gjitha agjencitë e lajmeve dhe mbushnin faqet e gazetave. Edhe Qesja, si plot të tjerë, ka bërë komente, si për marrëdhëniet me jugosllavët, ashtu edhe për revoltat në Poloni e Hungari. Por komentet e tij kohë pas kohe janë mbajtur shënim, derisa një ditë ato janë zbrazur në organizatën e Partisë. Organizata është mbledhur dy herë dhe në të dyja mbledhjet Qesja ka qenë i kryqëzuar. Unë nuk i kam gjetur protokollet e atyre mbledhjeve, por raportet që i kanë shkruar Komitetit Qendror të Partisë nga organizata, si dhe nga komunistë të veçantë, bashkë me protokollet që janë mbajtur kur Qesja është thirrur në Komitetin Qendror, e japin qartë gjithë çfarë ka ndodhur.

Burimet thonë se njëri prej studentëve, Sul Baholli, anëtar i Komitetit Qendror, i ka kërkuar me këmbëngulje sekretarit të organizatës së Partisë të mblidhte organizatën, pasi ai kishte disa probleme të rëndësishme për të shtruar dhe konkretisht “disa bisedime jo në rrugë partie” të Xhavid Qesës dhe që kishin të bënin sidomos me qëndrimin ndaj Jugosllavisë, por edhe për çështje të tjera. Koha kur është kërkuar të diskutohej në organizatën e Partisë ishte janar 1957, ndërsa ‘bisedimet jo në rrugë partie’ për të cilat bëhej fjalë, u përkisnin muajve më parë, kur ende nuk dihej si do të shkonin punët me jugosllavët e kur Varshava e

567. AQSH, F. 14/AP—OU, V. 1957, D. 24, Udhëzime mbi konferencën për zgjedhjen e Komitetit të Partisë të Studentëve, Nëpunësve dhe Kursantëve në Moskë, 28. 2. 1957.

568. AQSH, F. 14/AP – Str. V. 1957, Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qesës për Byronë Politike të KQ të PPSH, 21 dhjetor 1966.

Budapesti ishin në prag të revoltave. Në ato kohë, duke marrë shkas nga bisedimet jugosllavo-bullgare, Qesja ka thënë se në çështjet kryesore na del se jugosllavët paskan qenë në rregull. Ka thënë po ashtu pas një leksioni për decentralizimin në ndërmarrjet e prodhimit në Jugosllavi, se atje këshillat kishin shumë kompetenca. Të njëjtën gjë i ka pohuar edhe një shoku të kursit se “këta (dmth, sovjetikët) le t’i bien rrangallës për decentralizimin, pasi jugosllavët e kanë zgjidhur me kohë.”<sup>569</sup> Veç këtyre, u tha se Qesja na kishte plasur edhe broçkullën tjetër, sikur përgjegjës për marrëdhëniet e këqija të Hungarisë me jugosllavët paska qenë Rakoshi dhe me ikjen e tij këto marrëdhënie do të rregulloheshin. Organizata kërkoi shpjegime mos me këtë ai aludonte për Shqipërinë?<sup>570</sup> Ashtu siç i kërkuan shpjegime për anekdotën me Mikojanin, se gjoja në partinë bolshevike nuk kishte liri mendimi, njësoj si në kohën e Stalinit.<sup>571</sup>

Rreth këtyre episodeve u vërtit dy ditë organizata e Partisë. Në fakt, pati prej atyre që reagojnë në mbrojtje të Qeses me arsyetimin se disa biseda të lira, edhe nëse mund të ishin të qortueshme, ato nuk duheshin klasifikuar si në kundërshtim me vijën e Partisë. Thanë po ashtu se kritikrat po ngriheshin me pasion dhe nga pozita personale. Këtij mendimi iu mbajtën Ymer Veshi, Agim Bejtja, Koço Lako, Ymer Minxhozi, Kristo Sharra dhe Liri Aranitasi.<sup>572</sup> Por edhe kundërshtarët ishin këmbëngulës pasi, sipas tyre, bisedat e Qeses nuk ishin në rrugën e Partisë dhe kësisoj e dëmtonin atë. Nga të paktët që në dy ditë diskutime nuk thanë asnjë fjalë qenë Petro Lalaj dhe Sotir Manushi. Ata duhet të jenë ndërë ligisht tek ndiqnin si pleksej banalja me seriozen dhe prandaj e kanë pasur të vështirë t’i bashkoheshin korit të kritikëve. Por, falë përvojës, dhe ta mbronin Qesen nuk e kishin të lehtë. Organizata e Partisë u nda më dysh në qëndrime. Me shumicë votash, për Qesen u propozua “vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit.” Komiteti i Partisë e miratoi këtë masë, edhe pse, sipas tij, nuk kishte gjëra në kundërshtim me vijën e Partisë dhe se çështjet ishin ngritur me pasion. Sidoqoftë, komiteti i kërkoi Xhavidit të ishte më i kujdesshëm në biseda të tilla, për të mos lënë keqkuptime.<sup>573</sup>

Udhëheqja e Tiranës u shqetësua për çfarë po ndodhte me organizatën e Partisë, ku bënin pjesë funksionarë të rëndësishëm të partisë dhe të shtetit, të cilët ishin dërguar në Moskë të merrnin mësim për marksizëm-leninizmin dhe përvojën e partisë bolshevike. Dikush edhe mund të lëkundej, siç ndodhi me Qesen, por të ndahej më dysh një organizatë partie, kjo për udhëheqjen ishte alarmuese. Kjo sa ndodhi ka mjaftuar që çështja të trajtohej në Sekretariatën e Komitetit Qendror. Rita Marko, sekretar i KQ, kërkoi të dhëna nga Moska. Thirri edhe studentët që kishin ardhur me pushime, për të marrë informacion, po edhe për t’i testuar ata. Sekretariati u mbledh më 11 shkurt dhe u la të thirrej vetë Qesja për të dhënë shpjegime. Ai u soll nga Moska dhe në fillim u takua me sekretarët Rita Marko dhe Haki Toska. Biseda nuk shkoi mirë. Ata iu mbajtën informacioneve që kishin, ndërsa Qesja nuk pranoi asgjë çfarë thuhej atje. Megjithatë sekretarët e këshilluan t’i shihte me qetësi kritikrat, të reflektonte për gabimet, si mënyrë e vetme për t’u shëruar prej tyre.<sup>574</sup> Më 23 mars ai u thirr në Sekretariatën e Komitetit Qendror. Mbledhjen e drejtonte Hysni Kapo. I thanë edhe njëherë se situatat e vitit 1956 kishin qenë delikate, qoftë marrëdhëniet me Jugosllavinë, ashtu edhe ngjarjet në Poloni e Hungari. Për të tria këto ti ke shfaqur lëkundje. Ne duam të ndihmojmë ty, por që të ndihmojmë, duhet të gjejmë tek ti arsyet e

569. *Po aty*, Informacion i Sulë Bahollit për KQ të PPSH, 31 janar 1957, f. 5. Shih edhe: *AQSH*, F14/AP-OU, V. 1957, D. 23, Relacion mbi disa pikëpamje jo në rrugë partie të shfaqura nga shoku Xhavid Qesja, përgatitur për mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, më 23 mars 1957, f. 112.

570. *Po aty*, Informacion i Shyqyri Kaçurit për Mihal Priftin, f. 6.

571. *Po aty*. Anekdota thotë se kur Mikojeni ka shkuar në mbledhje partie në një uzinë në Moskë, dikush kishte pyetur me letër se ku kishin qenë ata kur gaboi Stalini. Mikojeni ka kërkuar të dinte kush e kishte bërë pyetjen. Askush nuk ishte ndier. Ja, pra, kishte thënë Mikojeni, tjetri bën një pyetje dhe nuk del hapur e pastaj na e kërkoni neve të ndalnim Stalinin!

572. *AQSH*, F14/AP-OU, V. 1957, D. 23, Relacion mbi disa pikëpamje jo në rrugë partie të shfaqura nga shoku Xhavid Qesja, përgatitur për mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, më 23 mars 1957, f. 111

573. *Po aty*, f. 21.

574. *Po aty*, Procesverbal i mbajtur në takimin e shokëve Rita Marko e Haki Toska me shokun Xhavid Qesja, më 9 mars 1957, f. 118/11.

lëkundjes. Përsëri asgjë. Atëherë i lanë Qeses një javë kohë t'i bënte me shkrim gjithë çfarë kishte për të thënë.<sup>575</sup> Më 27 mars Qesja i shkroi Komitetit Qendror se lidhur me çështjen e tij, ai kishte menduar dhe rimenduar dhe se përveçse sa kishte thënë deri atëherë, nuk kishte asgjë tjetër për të shtuar.<sup>576</sup> Sekretariati i KQ të Partisë, me vendim i dha Xhavid Qeses vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit, si dhe i ndërpreu studimet, duke e kthyer në Shqipëri. Sekretariati po ashtu u tërhoqi vëmendjen atyre që e kishin mbështetur Qesen. U tërhoqi vëmendjen edhe Petro Lalajt e Sotir Manushit që kishin heshtur. Për këta dy të fundit nuk e miratoi edhe vazhdimin e mëtejshëm të studimeve për gradë shkencore.<sup>577</sup> I tërhoqi vëmendjen për oportunitizëm edhe Iljaz Spahiut, sekretar i Komitetit të Partisë, si dhe vendosi ta riorganizonte komitetin me zgjedhje në shtator. Në emër të Komitetit Qendror, Enver Hoxha i dërgoi letër organizatës së Partisë të studentëve shqiptarë, me të cilën konfirmoi qëndrimet në kundërshtim me vijën e Partisë të Xhavid Qeses, bëri me dije se ai u thirr në Sekretariatit e Komitetit Qendror për t'u ndihmuar dhe se atje ai mbajti "qëndrim të papërshtatshëm", se Sekretariati e ndëshkoi Qesen, si dhe u tërhoqi vëmendjen të tjerëve, të cilët me fjalën ose me heshtjen e tyre i dolën në krah atij. Hoxha i këshilloi organizatës jetë të rregullt partie, frymë kritike dhe autokritike të komunistëve, si dhe vigjilencë në mbrojtje të vijës së Partisë.<sup>578</sup>

---

## Më mirë zvarrë në pluhur, se zvarrë rreth fronit

---

Vendimi për ndërprerjen e studimeve duket se Xhavid Qesen e vrau më shumë se gjithçka tjetër. Ai u lut ku munda që autoritetet ta shihnin edhe një herë këtë vendim, por përgjigja ishte refuzuese. Nuk dimë nëse e kishte për herë të parë t'i lutej pushtetit, ashtu siç ai u lut për shkollën, por dimë se ishte hera e fundit.

Pasi u kthye nga Moska, mars 1957, po atë muaj Qesja u emërua nënkryetar në Komitetin Ekzekutiv të Qarkut të Elbasanit. Nuk vonoi që në Degën e Punëve të Brendshme të mbërrinin të dhënat e para si e kishte pritur ai detyrën, për çfarë ai fliste, me kë takohej, çfarë lexonte dhe cilët stacione radioshe të huaja ndiqte. Në nëntor Sigurimi e mori në përpunim aktiv 2-A, pasi kishte të dhëna për "veprimtari armiqësor", megjithëse ishte anëtar partie dhe deputet në Kuvendin Popullor.<sup>579</sup> Aty zuri fill dosja e famshme prej qindra faqesh, me numër 1820 dhe që e ndoqi pas më shumë se tridhjetë vjet. Ai e kishte kuptuar se vëzhgohej ngado që shkonte, gjë që ia kishte pohuar njërit prej agjentëve.<sup>580</sup> Por kjo u bë më e dukshme sidomos kur ai u hoq nga detyra e nënkryetarit të komitetit dhe u dërgua përgjegjës në ndërmarrjen komunale të qytetit.

---

575. *AQSH*, F.14/AP-OU,V. 1957, D. 24, Protokoll nr. 5 i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, më 23 mars 1957, f. 422.

576. *AQSH*, F. 14/AP – Str.V. 1957, Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qeses për Sekretariatit e KQ të PPSH, më 27 mars 1957, f. 29.

577. *AQSH*, F.14/AP-OU,V. 1957, D. 24, Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH "Mbi refuzimin e kërkesës së shokëve Petro Lalaj dhe Sotir Manushi për të shtuar afatin e studimit", 23 mars 1957, f. 223.

578. *AQSH*, F. 14/AP-Str. V. 1957, D. 690, Letër e Enver Hoxhës dërguar organizatës-bazë të studentëve shqiptarë, që vazhdojnë Shkollën e Lartë të Partisë pranë KQ të PK të BS, më 3 prill 1957, f. 1-4.

579. *AIDSSH, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje përpunimi, nr. 1820, Xhavid Hajdar Qesja, kategoria II – A, Vendim për hapjen e Dosjes II-A për Xhavid Qesen, 15.11.1957, f. 27.

580. *Po aty*, ... Raport i datës 16.4.1958, dhënë nga "Parashtruesi", f. 37. Sipas këtij raporti, del që agjenti e kishte pyetur Qesen, nëse e kishte takuar Hysni Kapon kur ishte në aktivin e Partisë. Qesja i kishte thënë se nuk e kishte takuar. Po ta kishte takuar, çfarë do t'i thoje, kishte pyetur agjenti. Qeses nuk i ishte duruar pa ia kthyer: "E çfarë do t'i thoja tjetër, përveçse ta falenderoja që më ka vënë nën survejimin e Shim Kollit." Kolli ishte kolonel, person i njohur në Sigurimin e Shtetit, atë kohë punëtor operativ në Degën e Punëve të Brendshme të Elbasanit, ndërsa agjenti ishte njëri nga ata që Kolli e kishte vënë të ndiqte Qesen.

Megjithatë Xhavid ishte i njëjti, sa i përmbajtur, po aq i shpenguar në mendimet e veta. Duket e kishte kuptuar se jeta e tij kishte marrë rrokopujë. I vetmi shqetësim i tij ishte të shpëtonte familjen, por duke ruajtur dinjitetin. Këtë ua këshillonte edhe të tjerëve, deri edhe njërit prej agentëve më aktivë, për sa kohë ishte në Elbasan. “Ti e sheh se tek ne fshihet e vërteta, iu shpreh atij që e vëzhgonte. Gjithçka është pankart... Me siguri, edhe ty ka plot gjëra që nuk të duken të drejta, por ti nuk flet. Po pse nuk flet? Nuk flet se ke frikë, e pëson si Tuk Jakova e Bedri Spahiu. Njeriu duhet të flasë, të jetë principlial, të ketë guxim.”<sup>581</sup>

Më 1 korrik 1958, me vendim të Komisionit të dëbim-internimeve Xhavid Qesja u dërgua në Vlorë, në Zvërnec.<sup>582</sup> Sapo mbërriti, ai i dërgoi telegram familjes: “Jam në rrethin e Vlorës”. Asnjë fjalë më shumë. Të internuarit e tjerë që e kanë parë tekstin, e kanë komentuar si telegram të koduar, sipas të cilit duke mos dhënë adresën, ai “ka dhënë të kuptojë se e shoqja nuk duhej të interesohej për të, por të shikonte fëmijët dhe veten.”<sup>583</sup> Tridhjetë vjet gruaja preu çdo lidhje me të shoqin. Për tridhjetë vjet fëmijët duhej të harronin se kishin një baba. Për më tepër, më 1975, kur fëmijët ishin në moshë madhore, ata lanë llogopin e deriatëhershëm dhe morën atë të nënës: Najdeni.<sup>584</sup> Thonë se për të shpëtuar familjen nga persekucioni, vetë Qesja e ka pranuar, a ndoshta e ka kërkuar, këtë divorc ekstrem. Kur e hodhën në Zvërnec, Xhavid Qesja sa i kishte mbushur 36 vjet. Që prej asaj dite, do të bëheshin edhe 36 vite të tjerë. Në atë ishull, tek ai manastir, Qesja do të varroste gjysmën e vetvetes, për të jetuar terrin e gjysmës tjetër.

Për gjysmëjetën e mbetur na shërbejnë dy burime. Njëri janë bisedat midis bashkëvuajtësve, të ruajtura përmes regjistrimeve dhe me teknika përgjimesh, një praktikë e njohur në kampet e burgjet politike. Burimi tjetër është prodhimtaria intelektuale, tipike për të burgosurit e ndërgjegjes. Midis tyre ka pasur në çdo kohë kapacitete të spikatura të politikës, të kulturës dhe të shkencës. Mjaft të përmendim se në burgjet shqiptare janë përkthyer kryevepra të letërsisë botërore, si dhe është shkruar letërsi në kushte ekstremisht të vështira, që sot është bërë pjesë e kulturës së vendit. Të tjerë kanë luftuar me mjete politike, me protesta të shkruara, ose me akte të tjera rezistence. Midis tyre, pa mëdyshje, Qesja është më përfaqësuesi. Lidhur me rastin Qesja, këto të dhëna burimore na çojnë po ashtu në dy cilësi ose veçori personaliteti, të cilat vërehen lehtë. Njëra është veçori karakteri, cilësi morale, që ka të bëjë me mënyrën si Qesja ka zgjedhur të përballej me privimin e lirisë. Tjetra është veçori formimi. Fjala është për formim të qëndrueshëm kulturor, politik, përgjithësisht formim intelektual. Duket se te Qesja, të dyja këto cilësi kanë dhënë e marrë aq shumë me njëra-tjetrën, sa vështirë t’i ndash e aq më pak ta kuptosh njërin pa tjetrën.

Për veçorinë e parë, anën morale, nisur nga burimet, kryesisht raportet e bashkëpunëtorëve dhe sidomos protestat e Qeses, kupton se rezistenca përkundër depersonalizimit ka qenë për të një luftë e gjatë dhe sfidë e ashpër me pushtetin. Kur Qesja vajti në ishull, atje gjeti edhe të tjerë persona që deri atëherë kishin mbajtur funksione shtetërore ose partie, por që kishin përfunduar atje si kundërshtarë të pushtetit. Të tillë ishin Pëllumb Dishnica, Gjovalin Luka, Peço Fidhi, Xhafer Vokshi, Nuri Huta, etj. Në vijim, për nëntë vite rresht Qeses iu desh të priste e përcillte plot të tjerë. Midis tyre, Tahir Kadareja, Peço Kagjini, Qamil Disha, Iliaz Ahmeti, Kadri Hoxha, Maqo Çomo, etj. Në këtë ishull të mistershëm, dikujt i takoi të qëndronte më pak e dikujt më shumë, dikujt muaj dhe të tjerëve vite. Por për më të shumtit, ai ishte një stacion i përkohshëm dhe pikërisht për këtë ai mbetej i mistershëm. Kështu, kur pas Qeses kishin mbërritur tre të rinj, të sapoardhurit u mbyllën në një dhomë dhe pas një ore njëri prej tyre, Gjovalin Luka u komunikoi të tjerëve: “Dëgjoni, more shokë! Ne nuk dimë pse na kanë prurë këtu ku jemi e as dimë çfarë do të bëhet me ne. Ne kemi në dorë vetëm të mos bëjmë biseda politike dhe të rrimë në

581. *Po aty*, ... Raport i datës 6.12.1957, dhënë nga “Skendi”, f. 22.

582. *Po aty*, Vendim për transferim të dosjes formulare 2-A të Xhavid Qeses, më 15.7.1958, f. 44.

583. *Po aty*, ... Raport i datës 18.2.1959, dhënë nga “Vigjilenti”, f. 97.

584. *Po aty*, ... Shënim i Shkëlzen Bajraktarit, kryetar i Degës VIII në Ministrinë e Punëve të Brendshme drejtuar Ministrin, më 8.1.1987, f. 331.

hallin tonë.”<sup>585</sup> Për ca kohë pakti u ruajt.

Por për Qesen pak rëndësi kishte çfarë merrte e përcillte dikush i rekrutuar nga njerëzit e Sigurimit. Duket se ai e kishte përshtatur programin e vet për kushtet e izolimit, deri atje sa informatorët nuk kanë mundur të njoftojnë gjë tjetër, përveçse:

Nga një raport i tetorit: “Xhavid Qesja qëndron gjakftohtë dhe i matur, por shumë i rezervuar dhe rrallë merr pjesë në biseda.”<sup>586</sup>

Përsëri në tetor: “Xhavid Qesja nuk flet, rri e më tepër dëgjon. Por i asht ba merak (mos)ardhja e nanës së tij ... Thotë se mos ajo mendon t’ia kenë mbytyë djalin.”<sup>587</sup>

Nga një raport i dhjetorit: “Peço Fidhi është mbajtur në Vlorë, me sa duket për hetime. Të gjithë janë me frikë se mos i merr në qafë. I vetmi që nuk ndjehet i shqetësuar është Xhavid Qesja.”<sup>588</sup>

Prapë në dhjetor: “Një ditë Xhavid po hapte sytë për një fije tel. E për çfarë të duhet? I tha njëri nga shokët. Për të qepur buzët, ia ktheu.”<sup>589</sup>

Një raport i shkurtit: “Për ndarjen me gruan Qesja është tronditur pak, por nuk e jep veten. Rri pa folë, pi shumë duhan dhe ka pagjumësi.”<sup>590</sup>

Po kështu në prill: “Rri vetëm të shumtën e kohës. Lexon romane në frëngjisht po nuk i shfaqet kurrkujt... Xhavidit sot iu dha vendimi i gjyqit për ndarjen, të cilit nuk i bani ndonjë përshtypje.”<sup>591</sup>

Administratori i kampit, kapiten Maliq Mersini, nuk ishte i kënaqur me programin e Qeses, për të cilin kishte marrë veçanërisht porosi ta kishte nën vëzhgim. Personi që i kishin sjellë kishte zgjedhur të gdhiehet e ngrysej mbi libra dhe thjesht të shihte hallet e veta. Por Zvërneci nuk ishte qendër për të kaluar pushimet e as qendër shkencore. Ky vend ishte zgjedhur si i përshtatshëm për të mbajtur të izoluar kundërshtarë të regjimit, armiq të pushtetit. Për zyrtarin e punëve të brendshme mbajtja në kontroll e këtyre njerëzve ishte më e pakta që mund të bëhej. Më kryesorja, ata duheshin mbajtur në çdo çast të provokuar, se vetëm atëherë do të shfaqeshin ata të vërtetit, ashtu siç ishin, “armiq të betuar”. Në anën tjetër, për ata që ishin përballë “armikut”, kjo ishte mënyra më e sigurt të demonstronin besnikëri e devotshmëri.

Teknikat e provokimit, siç ndodhte rëndom, funksionuan edhe me Qesen. Ajo që nuk funksionoi ishte strategjia e provokimit. Ai u provokua, që të reagoi. Dhe reagoi, si rrallëkush, fort dhe pandërprerë. U provokua, që të thyhej. Kjo nuk ndodhi.

Provokimet që iu bënë Xhavid Qeses, sidomos kur ai ishte i internuar në ishull, por dhe më tej në 21 vite burgim, mund të konsiderohen si pjesë e një “protokolli” standard që ndërtohej mbi bazën e të dhënave për “rrezikshmërinë” e personit, duke zgjedhur pikat e “dobëta” të tij. E veçanta është se kundërpërgjigja e Qeses është aq e pasur në episode, sa përbën një manual të vërtetë qëndrese. Ajo është e mirëmenduar

---

585. *Po aty*, ... Raport i datës 15.10.1958, dhënë nga Vëzhguesi, f. 55.

586. *Po aty*, ... f. 59.

587. *Po aty*, ... Raport i datës 24.10.1958, dhënë nga “Vigilenti”, f. 62.

588. *Po aty*, ... Raport për datat 12 deri 18 dhjetor 1958, dhënë nga “Vigilenti”, f. 70.

589. *Po aty*, ... Raport i datës 25.12.1958, dhënë nga “Vëzhguesi”, f. 73.

590. *Po aty*, ... Raport i datës 18.2.1959, dhënë nga “Vigilenti”, f. 97.

591. *Po aty*, ... Raport i datës 14.4.1959, dhënë nga “Vigilenti”, f. 107.



në përmbajtje dhe interesante si taktikë. Ai iu mbajt gjithnjë arsytimit se me partinë e tij, që prej vitit 1956 e në vijim kishte mospajtime mendimesh. Duke qenë çështje mendimesh, kjo sipas tij, ishte edhe çështje ku askush tjetër, organ ose individ qoftë, nuk mund të hynte midis tij dhe Partisë. Prandaj ai të gjitha letrat, ankesat, protestat ia drejtoi Byrosë Politike. Dhe kur pikërisht mbi këto letra dhe mbi asgjë tjetër, u ngritën edhe akuzat kundër tij, ai në asnjë rast nuk pranoi t'i jepte shpjegime, asnjë hetuesi, prokurori apo gjyqtari. Prandaj ai i ka quajtur të pambështetura në ligj të gjitha vendimet penale kundër tij, dy vendime me internim me nga pesë vjet dhe tre vendime me burgim me nga dhjetë vjet secili. Këto vendime ai i denoncoi politikisht, por jo me rrugë gjyqësore, pasi ai nuk e njohu të drejtën e gjykatës për t'u marrë me debate të brendshme të Partisë dhe që i përkisnin vetëm asaj. Kjo duhet të jetë arsyeja që ai nuk kërkoi asnjëherë rishikim të vendimeve gjyqësore ose zbutje të masave penale.

Le të kthehemi te jeta në ishull dhe më këtej. Siç është e kuptueshme, në kushte izolimi marrëdhënia midis të izoluarit dhe gardianit, në këtë rast komandantit të ishullit, është gjithçka. Ashtu si të tjerët, Qesja ka parë çdo mundësi që ai të merrej me çfarë i interesonte, në rastin e tij, me lexime. Po ashtu komandanti ka studiuar pikat e dobëta të çdonjërit. Që pastaj t'i përdorte ashtu si t'ia lypte nevoja. Të parën gjë që kërkoi Qesja ishte Rregullorja e kampit. Mori përgjigje se nuk i duhej rregullorja, mjaft të zbatonte ato që urdhëroheshin. Kërkesa për rregulloren u përsërit pafund, por ajo nuk doli kurrë. Kuptohet, një të izoluari si Qesja rregullorja i duhej të gjente hapësira në interes të tij. Ashtu siç edhe kujdestarit të ishullit mungesa e rregullores i jepte dorë të lirë në arbitraritete. Aq sa një ditë ky komandant ua tha copë atij dhe të tjerëve se “sa më keq të sillej ai me ne, aq më shumë ngrihej ai.”<sup>592</sup>

Nuk ishte vetëm përpikëria karakteristike dhe një jetë e normuar me rregulla, e vetmja pikë e ndjeshme e Qeses. Ai kishte edhe dy “dobësi” të tjera. Njëra ishte nëna, Sabrija. Kur Xhavid i bashkua Luftës, familja dhe farefisi ishin kundër. E vetmja që e mbështeti dhe u kujdes për të birin ishte nanë Bija. Ajo ishte edhe e vetmja që do ta ndiqte pas në vitet e internimit dhe të burgut. Por nanë Bijen e penguan sistematikisht të shihte të birin. E po ashtu i biri protestoi ku mundi. Pika tjetër ekstremisht e ndjeshme për Xhavidin ishin librat. Aq e ndjeshme sa për shkak të pengesave që i sollën me librat, ai hyri dy herë në grevë urie. Në të tria këto pika “të dobëta” Xhavid i provokua rregullisht. Dhe vetëm atëherë ai shpërtheu kundër autoriteteve, duke denoncuar shkeljen e të drejtave. Dhe vetëm atëherë, u gjet casus-i për ta marrë Qesen të pandehur, me akuzën për veprimtari armiqësore.

Meqë jemi te librat, po shpjegoj rastin më pikant e që shkon në përmasat e groteskut. Ka ndodhur kështu. Sa herë vinte tek i biri, nanë Bija ngarkohej me libra dhe ushqime. Pasi mbaronte punë me to, Xhavid i postonte librat dhe porosiste të tjerë. Kështu bëri edhe më 30 mars 1966, kur vuri në postë vëllimin e 36 të veprave të plota të Marksit dhe Engelsit, bashkë me katër libra artistikë me autorë Tit Livi, Jul Qezar, Zhorzh Sand dhe Valter Skot. Shkoi prilli dhe librat nuk kishin mbërritur. Atëherë Xhavid i dërgoi letër Komitetit Qendror, ndërsa e ëma shkoi në Degën e Punëve të Brendshme të Vlorës, të cilën e përcollën me premtime. Më 13 prill dërgoi në adresën e së ëmës pakon e dytë me libra. Këtë herë pakoja kishte vëllimin e 37 të veprave të Marks – Engelsit, bashkë me Dostojevskin dhe një dy autorë të tjerë. Pas dy muajsh pakoja mbërriti në destinacion, por pa vëllimin e 37. Më 22 qershor Xhavid njoftoi me letër Byronë Politike, duke kërkuar sqarime në bazë të ligjit, bashkë me kërkesën që librat të shkonin për ku ishin nisur ose t'i ktheheshin atij mbrapsht.<sup>593</sup> Përsëri kurrfarë përgjigje. Prapë letër më 28 korrik: “Kërkoj të më dorëzohen vëllimet 36 dhe 37 të veprave të plota të Marks – Engels, Tit Livi ... Kini parasysh se për mue, librat e mi janë të lidhun me vetë jetën time.”<sup>594</sup> Si dhe më parë, heshtje. Atëherë Qesja njoftoi për grevë urie dhe hyri dy herë në grevë, më 16 deri më 22 gusht dhe më 26 – 27 shtator. Pas kësaj autoritetet i premtuan zyrtarisht Qeses se do të zgjidheshin kërkesat e tij dhe ai ndërpreu grevën.

592. AQSH, F.14/AP–Str., Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 7 shkurt 1962, f. 51.

593. AQSH, F.14/AP–Str., Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 22 qershor 1966, f. 67.

594. *Po aty*, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 28 korrik 1966, f. 71.

“

Po të pyes ty, se s'kam  
cilin të pyes tjetër.  
Kush asht ai që hala  
nuk asht ngijë me  
Xhavid Qesen ... Dhe  
këtë pyetje ta vejë  
ty, jo tue u nisë si ai  
që e ka pësue, por si  
komunist

Xhavid Qesja

”

Por sipas një letre të dhjetorit, del se disa kërkesa janë zgjidhur, por librat nuk janë kthyer.

E gjitha çfarë kishte ndodhur është se kur në Degën e Punëve të Brendshme të Vlorës janë kontrolluar librat, është gjetur se në vëllimin e 36 kishte plot nënvizime në faqet e librit. Po kështu në dy faqet e fundit kishte shënime ku përmenden fjalë të veçanta, p.sh. Angli, ushtarake, drejtësi, fshati, tregu botëror, etj., dhe pas fjalëve janë grupuar numra, që janë numra faqesh. Vlora ia dërgoi librin ministrisë për ekspertizë, nëse “ka shënime sekrete të natyrës së kodit”. Eksperti kriminalist ka marrë një rubrikë të veçantë, rubrikën ‘njeriu’ dhe ka dhënë për përkthim pjesët e nënvizuara të kësaj rubrike. Në përgjigje pasi rendit pjesët e nënvizuara, eksperti vjen në përfundimin se: “... i internuari Xhavid Qesja, nëpërmjet nënvizimeve të fjalëve dhe frazave që ka bërë në faqet e vëllimit të 36 të veprave K. Marks dhe F. Engels, të cilën ia adreson familjes së tij në Durrës, shpreh pikëpamjet e tij politike dhe ideologjike dhe i përdor ato si mjet për t’u ndërlidhur në mënyrë sekrete me persona të ndryshëm jashtë vendit të tij të izolimit.”<sup>595</sup> E dhimbshme, ku të çon padija! Një tregues i thjeshtë tematik, që sot është gjerësisht i aplikueshëm, veçanërisht për botimet shkencore, merret si kod i fshehtë komunikimesh.(!)

Pas këtij rasti, pa ditur se nënvizimet në libër do të shkonin për ekspertizë të thelluar, Qesja ka bërë denoncimin politik të radhës, duke paralajmëruar grevën e tretë. “Unë do të plotësoj ditë më ditë dhjetë vjetet e dënimit, - ka shkruar Qesja. Më 1 korrik 1968 do t’ju paraqes kërkesën për të më dhanë pasaportën për me u largue nga atdheu im. Ju jeni shkaktarët që të them atë që tha Çadajev<sup>596</sup>, se unë Atdheun tim si qorr, si memec e si shurdh nuk e due.”<sup>597</sup>

Disa muaj më vonë, më 12 shtator 1967, një hetues i Ministrisë së Punëve të Brendshme i komunikoi Qeses akuzën për veprimtari armiqësore kundër pushtetit dhe Partisë në formën e agjitacionit dhe të propagandës, sipas nenit 73/1 të Kodit Penal të asaj kohe. Qesja ka firmosur se ka marrë dijëni për akuzën, por nuk ka pranuar të bënte asnjë koment, madje as të hynte në proces. Të nesërmen i kanë vënë përpara një tufë letrash që ia kishte dërguar Byrosë Politike, për të cilat nuk pranoi të komentonte. Më 29 shtator, kur ishte në arrest Qesja i shkroi Byrosë Politike se ishte në ditën e 18 të grevës së urisë, se shtatë ditët e para kishte qenë në grevë të plotë, pa ushqim, ndërsa në njëmbëdhjetë ditët e tjera po torturohej me sonda dhe serume. Arsyeja pse ai hyri në grevë dhe pse i shkroi Byrosë Politike është ajo që ai e kishte bërë të njohur dhe më parë, pikërisht se: “Unë si komunist kam të baj vetëm e vetëm me ju, se çështjet e mija janë vetëm çështje partie. Asht ma se e vërtetë se unë kam pikëpamje që në një seri çështjesh bijnë në kundërshtim me atë vijë që ndiqni ju sot. Por me ia thanë Partisë këto asht një gja shumë leale. Nga mendimet e mija, përderisa unë kam këtë bindje, unë nuk tërhiqem.”<sup>598</sup> Më 23 tetor 1967 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e dënoi Qesen me dhjetë vjet heqje lirie.<sup>599</sup>

Pas disa muajve në Tiranë, më të shumtën e kohës në spital, Qesja u dërgua në Burrel. Autoritetet e burgut kanë marrë porosi që ai jo vetëm të mbahej nën vëzhgim, por “me që ai shkruan vazhdimisht të ecet drejt kapjes së ndonjë dorëshkrimi me përmbajtje armiqësore, për ta rigjykuar përsëri.”<sup>600</sup> Kërkesa për të mbledhur të dhëna “në rrugë legale dhe ilegale” për rigjykim të Qeses u bë aq këmbëngulëse, sa gjendet e përsëritur në disa programe operative. Këta janë sadista, i kishte thënë dikujt Qesja, kur ishte

595. AIDSSH, AMB, Sektori i Sigurimit, Dosje përpunimi, nr. 1820, nr. 2-A. Akt nr. 76/1, datë 15.5.1966, i ekspertit të Laboratorit Qendror Kriminalistik, Farudin Poçari, f. 144-1948.

596. \* Petr Chadaiev (1794 – 1856), filozof dhe mendimtar politik rus.

597. AQSH, F. 14/AP–Str., V. 1966, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 2.12.1966, f. 86.

598. AQSH, F. 14/AP–Str., Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike, më 29.9.1968, f. 100.

599. AMB, F. 1/Hetimor–Gjyqësor, Gjykata e Lartë, V. 1967-70, D. nr. 2407-A, Dosja e hetuesisë, nr. regi. 571, Vendim nr.183, dt. 23.10.1967 i Kolegjit Penal për shpalljen fajtor të Xhavid Qeses, f. 21.

600. AIDSSH, AMB, Sektori i Sigurimit, Dosje përpunimi nr 2-A, nr. 1820, Detyra operative në drejtim të përpunimit të Xhavid Qeses, Burrel, më 17.5.1968, f. 147.

në Elbasan. Kishte të drejtë. Një turrë provokatorësh, si hienat, iu sulën gjahut të tyre, si e si ta zgjonin aty ku e mbanin mbyllur. Sa kishte filluar dhjetëvjetëshin e parë të vuajtjes së dënimit dhe ata donin një fije shkas, qoftë dhe me “rrugë ilegale”, për një dhjetëvjetësh tjetër. E, si gjithmonë, që gjahu të reagonte, ai duhej provokuar. Qesja i ka ndërjerë provokimet, ashtu siç ka kuptuar qëllimet. Puna shkoi deri atje sa ai u kërkoi autoriteteve diçka, të cilës do t’i ikte gjithkush, kërkoi të mbyllej i vetëm në qeli. Pas kësaj kërkese, zyrtarë të Ministrisë së Brendshme nxitimthi morën në pyetje Qesen për arsyen pse ai kishte kërkuar të ikte nga Treshi ose dhoma nr. 3, ku ishin më të njohurit e politikës.

Kaq u desh të arrihej qëllimi. Gracka funksionoi. Më 7 prill 1970, Qesja i shkroi Hoxhës: “Po të pyes ty, se s’kam cilin të pyes tjetër. Kush asht ai që hala nuk asht ngijë me Xhavid Qesen ... Dhe këtë pyetje ta vejë ty, jo tue u nisë si ai që e ka pësue, por si komunist.”<sup>601</sup> Nuk pati përgjigje. Letra tjetër, më 7 maj: “Due me t’i thanë dy fjalë: Ti nuk ke fare të drejtë që e ban veshin e shurdhët. Këtu nuk asht fjala për Xhavid Qesen si person privat, se po të ishte puna kështu, të siguroj se nuk do t’u drejtosha ty e askujt. Këtu asht fjala për Xhavid Qesen si qytetar i RPSH, asht fjala direkt për Kushtetutën e RPSH. Pra, tue ba veshin e shurdhët, nuk e ban kundrejt meje si person privat, por direkt kundër qytetarit, kundrejt kushtetutës.”<sup>602</sup> Këtë herë përgjigjia nuk vonoi, por jo përmes zyrës së ankesave. Më 16 qershor Qesja u mor nën hetim bazuar në këto dy letra, si provë materiale. Më 23 qershor 1970 atij iu shtuan edhe dhjetë vite të tjera, ose duke bashkuar dy dënimet, siç shkruhet në vendim, “përfundimisht dënohet me 17 vjet, dy muaj e 19 ditë heqje të lirisë”.<sup>603</sup> I bëri ditë më ditë.

Kjo është kronologjia e qëndresës së Xhavid Qeses. Për motivet e qëndresës ka vend për të folur shumë. Tridhjetë vjet e disa muaj mbyllur brenda muresh, ndarë nga të gjithë, i provokuar gjithandej. Tridhjetë vjet i mbyllur, vetëm se mendoi ndryshe, mendoi si “armik”. Mund të kishte zgjedhur jetë tjetër, fundja të kishte kërkuar falje, siç e thotë ai vetë, “duke u tërheqë zvarrë si kërmilli rreth karrigeve tuaja”. Nuk e bëri, sepse, siç përsëri ai shkruante, “mendimet e mija janë jeta ime”. Nuk e bëri, se atëherë do të ishte fundi i tij moral. “Edhe unë, shprehej Qesja në njërin nga letrat, si gjithë të tjerët, Shilerin e kam mësue në gjimnaz. Dhe ky Shiler na mësonte ne atëherë: “Asht ma mirë të hiqesh zvarrë në pluhun, se të hiqesh zvarrë rreth fronit’.”<sup>604</sup>

---

## Doktrina dhe indoktrinimi

---

Kur në shtator 1967 Xhavid Qesja u vu në arrest, midis atyre pak sendeve për përdorim vetjak në kushte izolimi, grupi hetimor shënoi se mori në dorëzim edhe 74 fletore, mbushur me shënime nga veprat e Marksit dhe të Engelsit, leksione për fakultetin e drejtësisë, si dhe gjashtë blloqe të tjera, edhe ato me shënime, nxjerrë nga “Kapitali”.<sup>605</sup> Kjo e dhënë është mjaft për të kuptuar se, më e pakta, bëhet

---

601. AMB, F 1/Hetimor-Gjyqësor, Gjykata e Lartë, V. 1970, D. 2407-A, pjesë nga letra e Xhavid Qeses drejtuar udhëheqjes së Partisë, 7 prill 1970, f. 12.

602. *Po aty*, f. 13.

603. *Po aty*, Vendim nr.2, datë 23.6.1970 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, f. 39.

604. *Po aty*, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 16 shtator 1964, e administruar në dosjen penale si provë materiale për gjykimin e Xh. Qeses, f. 31.

605. AMB, F 1/Hetimor-Gjyqësor, Gjykata e Lartë, V. 1967-1970, D. 2407-A, nr. regj. 571, Proces verbal për kontrollin e banesës së Xhavid Qeses, në Vlorë, më 12.9.1967, f. 27.

fjalë për një lexues të vëmendshëm të letërsisë marksiste. Por ky mendim shkon më tej, kur nga një letër e tij për udhëheqjen e Partisë së Punës, mësojmë se ky person në tetë vite e gjysmë izolimi, (aq kishte kryer deri në dhjetor 1966, kur ka shkruar letrën) kishte studiuar me vëmendje të gjitha veprat e plota të Marksit dhe të Engelsit, si dhe korrespondencën e tyre. “I kam studiue njiherit, – thotë ai, – tue pa me sy kritik gjithë zhvillimin e ngjarjeve që kam jetue.”<sup>606</sup> Me fjalë të tjera, ai e ka studiuar Marksit, duke u përpjekur të gjente atje veten, të krahasonte sistemin që Marksit e ndërtoi në libra, me sistemin për të cilin marksistët përsërisnin pa u lodhur se po e ndërtonin, siç ai vetë e kishte projektuar.

Duket se për Qesen e gjithë kjo ka qenë një përjasje e mundimshme. Madje e thotë hapur: “Gjatë studimit, ndërgjegjja ime ka qenë nën presion të vazhdueshëm. Dhe çfarë presioni!” Siç është përmendur në këtë shkrim, diku tjetër ai është shprehur se Kongresi XX, revoltat në Poloni e Hungari atij i kishin hapur sytë. Por tani jemi dhjetë vjet më vonë. Në këta dhjetë vjet, pa mëdyshje, ai ka evoluar në formimin e tij filozofik e politik marksist, ashtu siç edhe ka verifikuar veten. Lidhur me këtë, ai shkruan: “Kur mbarova të 39 volumet, thashë me vete: oh, sa i qetë jam, sa mirë kam veprue, që u shkëputa prej jush! Dhe sikur dhjetëra herë të më merresh jeta, e përsëri të vjshje në jetë, unë përsëri e përsëri, pa ma të voglin hezitim, do të ndjekshje po këtë rrugë që ndoqa.”<sup>607</sup>

Dukshëm, pra, Xhavid Qesja është një studiues i zellshëm i Marksit. Në këtë rast, me termin “studiuues” nuk e kam fjalën për punë të mirëfilltë studimore apo për publikime të tij me këtë temë. Punë të kësaj natyre Qesja nuk dimë të ketë lënë. Megjithatë, edhe ato pak pasazhe, aq sa janë, që përmbajnë letrat drejtuar udhëheqjes partiake të kohës, si dhe disa regjistrime bisedash, ndihmojnë për të krijuar një mendim rreth bindjeve të tij për komunizmin si teori dhe njëherësh për abuzimet, sipas tij, me doktrinën.

Midis abuzimeve ai veçon mënyrën si u aplikuan gjithandej regjimet komuniste, regjime që Qesja i quan antikomuniste. Janë interesante opinionet e tij për këtë dukuri. Ai flet me bindje kur thotë se “këtë komunizëm që ekziston sot në botë, në të gjitha vendet pa përjashtim, do ta urrente edhe Marksit, Engelsi e Lenini. Ky komunizëm është më i keq se fashizmi dhe nazizmi, se ata edhe në kohë lufte nuk i kanë terrorizuar popujt e tyre si këta.”<sup>608</sup> Edhe studiues të tjerë që janë marrë me Marksit dhe marksizmin kanë vërejtur se modeli sovjetik i komunizmit iu largua shumë mendimit marksist, aq sa, sipas tyre, pak gjëra mbetën nga Marksit. Kjo është një tezë e debatueshme, sepse, në fund të fundit, edhe komunizmi sovjetik ruan një bërthamë marksiste, ashtu siç është fakt që ai devijoi me Leninin, për të vazhduar me Stalinin. Megjithatë Qesja nuk është kritik me Leninin. Nuk e kam ndeshur as ta marrë për referencë kur ai flet për komunizmin. Nuk di, nëse kjo vjen nga se Qesja e ka njohur më pak Leninin dhe prandaj është i rezervuar, apo se ai e pranon teorinë e tij. Të mos harrojmë, është koha kur në vitet ’70 teoritë për komunizmin po u nënshtroheshin revizionimeve dhe ku ishin përfshirë politologë e studiues brenda dhe jashtë partive komuniste, të cilët janë mbështetur te Marksit, por që ende në një farë mase kanë qenë të rezervuar ta godisnin drejtpërdrejt Leninin. Me sa duket, për shumë politologë partiakë mënyra më e mirë për ta shkurorëzuar Leninin e leninizmin ishte përmes Stalinit dhe stalinizmit.

Për Xhavid Qesen Stalini ishte gjëmë. Ishte gjëmë për popullin e vet, por edhe për shqiptarët që qeveriseshin me metodat e Stalinit. Burimin e të keqes ai e gjen edhe te niveli i përgjithshëm arsimor

606. *AQSH*, F. 14/AP–Str. Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 2 dhjetor 1966, f. 85; shih edhe: *AMB*, F. 1/Hetimor Gjyqësor, Gjykata e Lartë, V. 1967–1970, D. 2407–A, Letër e Xhavid Qeses drejtuar Byrosë Politike, 2 dhjetor 1966, administruar në dosjen gjyqësore si provë materiale, f. 44.

607. *Po aty*.

608. *AIDSSH, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje përpunimi, nr. 1820, Xhavid Hajdar Qesja, kategoria II – A, Raport i datës 23.5.1972, dhënë nga “Pëllumbi”, f. 177.

e kulturor i atyre që ishin në krye (nënkuptuar edhe Stalinin), pasi, sipas tij, nuk mjafton të udhëhiqesh nga një teori shkencore marksiste-leniniste kur nuk e ke mundësinë ta kuptosh këtë teori, për shkak të formimit të mangët kulturor. “Pse Stalini kreu gjithë ato gabime, që i kushtuan miliona njerëz të vdekur, jo vetëm popujve të BS, por edhe shumë popujve të tjerë të botës? Sepse ai, duke qenë me arsim katërvjeçar jo vetëm nuk kishte mundësi ta zhvillonte marksizmin, por as që e kuptonte dhe as mund ta aplikonte atë. Po të shohësh edhe tendencat vetjake despotike, na del figura e Timurlengut<sup>609</sup> të shekullit XX, veshur me petkun e kryekomunistit Stalin, që mbeti në histori si njeriu më barbar. E njëjta gjë, – thotë Xhavid, – ndodh edhe tek ne me udhëheqësit tanë, të cilët, të pazotët për të aplikuar marksizmin në kushtet tona, e kopjuan rrugën e stalinizmit datë më datë identikisht dhe bënë gjëmën e madhe ndaj popullit tonë, këtë tragjedi të tmerrshme ku shqiptari u ngop me fjalë në letër e në radio për liri dhe bollëk, por që vuan më shumë se çdo popull tjetër në Evropë ...”<sup>610</sup>

Është e njohur teza e Marksit se socializmi nuk mund të ndërtohej as në një vend të vetëm dhe as në vendet e pazhvilluara. Ndoshta këtë ka parasysh Qesja, i cili i përmbahet në çdo rast idesë se ky nuk është socializmi shkencor i Marksit, por një sistem tjetër i cili, siç është aplikuar, “tërheq popujt e varfër, ... sepse ata nuk kanë asgjë për të jetuar dhe socializmi u siguron një qese oriz, një palë brekë”. Marksia mendonte se socializmi do të vinte natyrshëm dhe si nevojë historike në vende të zhvilluara të Evropës, sidomos në Angli, Francë, etj. Po çfarë po ndodh me këto vatra të lëvizjeve përparimtare? – pyet Qesja. Po ndodh ajo që “ata popuj, ata punëtorë të kulturuar, të edukuar me shkollë dhe me ndërgjegje klasore, e urrejnë socializmin e komunizmin, sepse ky komunizëm që aplikuan rusët me Stalinin në krye, është antishkencor e antipopullor, antisocialist e antikomunist”.<sup>611</sup>

U ndala pak në bindjet marksiste të Xhavid Qeses, jo për të bërë komente rreth tyre, po thjesht për t'i identifikuar ato. Ajo çfarë bie në sy, është se Qesja shfaq interes për praktikat komuniste në pajtim me veçoritë e vendeve që e aplikojnë. Ai merr shembull Jugosllavinë, çka tregon se socializmi “specifik” jugosllav i ka tërhequr vëmendjen, pa e shqetësuar shumë trumbetat për revizionizëm. Fundja, a nuk ishte Lenini ai që revizionoi tezën e Marksit për revolucionin jo në një vend të vetëm dhe jo në vendet e pazhvilluara? Megjithatë Leninin nuk i thotë askush revizionist, – shprehet ai.

Që Xhavid Qesja u bë komunist, duke lexuar Marks, kjo është një e dhënë interesante që e ka pohuar vetë. Që Qesja iu bashkua komunistëve në një kohë që ata sakrifkuan të parët në një luftë botërore antifashiste, ky ishte një trend kudo në Evropë. Që Qesja thirri në ndihmë doktrinën, kur ai kishte nevojë, këtë e kanë bërë mijëra të tjerë, para tij, për të mos thënë se kjo ndodh edhe sot në situata të paqarta të një polarizimi social të shtuar, me pushtete të korruptuara dhe me autoritarizmat shtetërorë në rritje. Dhe deri në fund Qesja nuk e humbi besimin në komunizëm.

Për zyrtarët e kohës, Qesja ishte “antikomunist i tërbuar”, ndërsa ai vetë ka përsëritur pa u lodhur se ishte “komunist i bindur”. Nuk është vështirë të kuptohet përmbajtja që i jepet termit në interes të atyre që e përdorin. Të parët e identifikojnë me kuptimin “antiparti”, ndërsa për të dytin termi duhet kuptuar jo për raportet me partinë, por me doktrinën. Sidoqoftë gjithë jeta e Qeses, në dy kohë, na sugjeron se ai ishte jo pak i indoktrinuar. Indoktrinimi u përket dy fazave. Faza e parë shkon nga Lufta e deri në vitet ‘56–‘57, ndërsa faza e dytë shkon, me aq sa thonë burimet, së paku deri në fillim të viteve ‘90.

609. \* Timur Lane ose Timur Leng, (1336 – 1405), pushtues turko-mongol dhe takticien i përmendur ushtarak. Me ëndrën për të ringritur Perandorinë Xhinghis ndërtoi Perandorinë Timurid që shtrihej nga Uzbekistani i sotëm në Avganistan, Iran, bashkë me pjesë të Indisë, Sirisë dhe Turqisë, duke caktuar për kryeqytet Samarkandin në Uzbekistan. Ka hyrë në histori ndër pushtuesit më mizorë, për shkak se nga pushtimet e tij vlerësohet të kenë humbur jetën rreth 17 milionë njerëz.

610. AIDSSH, AMB, Sektori i Sigurimit, Dosje përpunimi, nr. 1820, Xhavid Hajdar Qesja, kategoria II – A, Raport i datës 12.6.1971, dhënë nga informatori “Pëllumbi”, f. 168.

611. AIDSSH, AMB, Sektori i Sigurimit, Dosje përpunimi, nr. 1820, Xhavid Hajdar Qesja, kategoria II – A, Raport i datës 20.2.1972, dhënë nga informatori “Pëllumbi”, f. 176-176/1.



Në fazën e parë Qesja nuk është i indoktrinuar nga doktrina. Ai është i indoktrinuar nga partia, së cilës iu bashkua. Ai dha kontribute në luftë dhe po aq u përfshi fort pas Luftës në reformat komunistizuese në vend. Mbajti funksione dhe detyra të rëndësishme. Partia tregoi besim tek ai, ndërsa ai garantoj besnikëri, një marrëdhënie normale në kësi rastesh. Ka një çast që e tregon indoktrinimin e kësaj periudhe. Fjala është për marrëdhëniet me prindërit, me të afërmit. Ajo ishte kohë e egër dhe Xhavid Qesja atëherë pranoi t'i bindej kohës. Familja e tij ishte shtresë e pasur. Për familjen kishte dy rrugë, ose të dorëzonte pronat dhe t'i bashkohej Luftës, ose t'u nënshtrohej sanksioneve të pasluftës. Zgjodhi të dytën. E njëjta dilemë për djaloshin e ri Qesja: Partia dhe familja. Zgjodhi të parën. Ai i ndërpreu marrëdhëniet me të afërmit. E vetnja me të cilën mbajti lidhje mbeti nëna. Diku është shënuar një rast i dhimbshëm. E ka treguar Amali Dishnica pas një bisede të sajën me Xhavidin, në Zvërnec. Kur Xhavid studioje në Moskë, ndodhi të ishte i shtruar në spital për zemrën. Në njërin nga ditët mori njoftim me telegram për vdekjen e të atit. Infermierja ia kishte dhënë telegramin gjithë frikë. Xhavid e lexoi dhe e vuri mënjanë pa reagu. Për infermierën kjo ishte e panatyrshme dhe prandaj u shqetësua. Por pacienti e kishte qetësuar. "Kështu jam bërë unë, - i kishte thënë ai. I pandjeshëm."<sup>612</sup> Nga të gjitha pengjet që i bien njeriut, ndoshta ky ka qenë pengja e vetëm.

Faza e dytë e indoktrinimit filloi më 1956. "Deri më 1956 kam qenë sinqerisht me ju, - shkruan Qesja në njërin nga letrat. Ndonëse sot shumë gjana të para 56-ës i shikoj ndryshe, atëherë nuk i kam pa, prandaj them se kam qenë sinqerisht me ju."<sup>613</sup> Këto dy faza dallojnë thelbësisht nga njëra-tjetra. E para është pjesë e një indoktrinimi masiv që u zbatua frontalisht nga Partia Komuniste dhe më këtë Partia e Punës. Ky është indoktrinimi i tërthortë. Në këtë rast doktrina vjen përmes një dore të tretë. Ashtu e deformuar, e manipuluar. Sa nga padija, aq edhe për shkak të kopjimeve mekanike, fillimisht nga jugosllavët, pastaj nga rusët, etj. Indoktrimi i drejtpërdrejtë vjen nga kontaktet me burimin. Mësimet e Marksit në këtë fazë të dytë Qesja nuk i mori përmes lektorëve të Komitetit Qendror. Nuk i mori as në Moskë, kur ishte në shkollën e Partisë. I mori kur i studioi vetë. Dhe u mrekullua. "Kam besim të plotë te komunizmi, ai është dhe mbetet për mua ideali më përparimtar, humanitar dhe masiv, dhe jam i vendosur të jap për të edhe jetën ... Unë me këtë botëkuptim rroj e do të rroj."<sup>614</sup>

Ky është Xhavid Qesja. Rruga që zgjodhi, në vështrimin e sotëm mund të mos jetë ajo më e duhura, por nuk na mbetet neve ta diskutojmë. E rëndësishme është të vërejmë se ai ishte pjesë e një partie komuniste dhe ai kërkoi gjatë dhe pa u lodhur për gjithçka lidhej me ideologjinë e filozofinë e saj, u kap fort pas pjesës idealistike, ku gjeti edhe vetveten. Në këto rragime ai gjeti pa vështirësi se bindjet e tij ishin të ndryshme, shpesh të kundërta me çfarë kishte kërkuar prej tij partia, së cilës i kishte shërbyer. Kjo ishte e mjaftë që ai të deklarohet kundër, në opozitë me udhëheqjen: "Pra, unë jam kundër jush e për pasojë në luftë me ju, në emër të mësimave të Marksit, të Engelsit dhe të Leninit."<sup>615</sup>

Kështu, pra, Xhavid Qesja ishte nga disidentët e pakët, që kundërshtoi partinë e tij, duke operuar me teza, të cilat në një mënyrë ose një tjetër i përmbajnë letrat e tij për Byronë Politike. Kjo disidencë është e mjaftë për t'u vlerësuar në thelbin e vet, edhe pse ajo nuk u shfaq me ndonjë formë tjetër të organizuar, apo me platforma publike. Ai jetoi me ëndrrën të kishte një gazetë, ku të shprehte lirisht pikëpamjet e veta. Por kjo ishte e pamundur dhe pikërisht për këtë arsye, ai zgjodhi me vetëdije sakrificën ekstreme për t'i shpallur dhe mbrojtur këto ide. Kësisoj, në gjithë këtë histori të trishtë, disidenca e Qesës vjen dukshëm e pastër, jo si kundërshti e ftohtë ex cathedra tezash politike, por si revoltë për prapësitë e pushtetit dhe të partisë në komandë të vendit, që i çoi shqiptarët të vuanin "më shumë se çdo popull tjetër në Evropë". Në këtë përplasje, edhe pse e mbajtur larg publikut, na vjen profili epik i Xhavid

612. *Po aty*, ... Raport i datës 15.7.1959, dhënë nga "Morena", f. 116.

613. *AQSH*, F 14/AP-Str., Dosje në përpunim, Letër e ... më 2 dhjetor 1966, f. 85.

614. *Po aty*, Letër e Xhavid Qesës drejtuar Byrosë Politike të KQ të Partisë, më 19 gusht 1963, f. 38.

615. *AQSH*, F 14/AP-Str., Dosje në përpunim, Letër e Xhavid Qesës drejtuar Byrosë Politike të KQ të PPSH, Tiranë, më 20 maj 1966, f. 55.



Qeses, i këtij sfidanti të pashoq kundër regjimit. Megjithatë, kjo sfidë qëndrese përmban edhe tragjizmin e vet. I papajtueshëm me aplikimin e komunizmit në vendin e tij, kritik me regjimet gjithkund ku partitë komuniste kishin ardhur në pushtet e, në të njëjtën kohë, ihtar me bindje në komunizëm. Sot nuk është vështirë të biem dakord që regjimet komuniste nuk bëhen më të mira e aq më pak të rrëzohen ato, duke u luftuar nga llogore komuniste. Madje, sa herë ka pasur përpjekje për një komunizëm më të mirë, të gjitha herët regjimet veçse janë egërsuar. Këtu do parë edhe tragjizmi i të gjithë atyre që iu kundërvunë regjimeve nga pozita doktrinare. Në partitë komuniste janë regjistruar plot shembuj të tillë. Për të mos shkuar larg, Malëshova mund të konsiderohet njëri prej tyre.

Më 20 janar 1987, edhe tetë muaj pa plotësuar dënimin me 20 vjet burgim, Xhavid Qesja la repartin 321, ose burgun e Burrelit, dhe po atë ditë ka mbërritur në Shijak, me një vendim të ri internimi edhe për pesë vjet. Autoritetet lokale i kishin caktuar një dhomë për banim, ndërsa njerëzit e Sigurimit kishin vendosur teknikën operative, si dhe kishin gjetur një rezidencë në afërsi të banesës, ku një punëtor operativ do të duhej të merrte regjistrime gjithë kohës. Një njësit vëzhgimi ishte vënë në kryqëzim të rrugës për të ndjekur objektin me emrin e koduar “Gorilla”, midis orëve 7 e mëngjesit deri në 21 të darkës.<sup>616</sup> Duket se Qesja mbetej ende i rrezikshëm. Sipas raporteve, Qesen e vizitonin kohë pas kohe njerëz të afërm, me të cilët ai nuk ishte parë prej tridhjetë vjetësh. Për një kohë nuk ka të dhëna, por në shtator ai dërgoi një letër tjetër e cila u cilësua armiqësore dhe fyese për udhëheqjen.

Më 9 tetor 1987, për shkak të asaj letre, Xhavid Qesja u arrestua përsëri dhe për të tretën herë u dënua me tetë vjet heqje lirie. Këtë herë u dërgua në Spaç, por nuk qëndroi shumë. Në fund të nëntorit 1988 me një dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, ai u la i lirë, duke iu falur dënimi i mbetur.<sup>617</sup>

Tanimë, pas tridhjetë vjetësh e pesë muaj burgje dhe internime, Xhavid Qesja është lodhur shumë. Tridhjetë vjet përplasje me pushtetin. Megjithatë, falë luftës dhe ndryshe nga mjaft të tjerë, ai e pati një “privilegj”. Lëvizjet e rinisë studentore i priti jashtë mureve. Vite më parë ai pati bërë një profeci. Më 1973, kur u dhanë goditjet kundër të ashtuquajturave shfaqje të huaja në letërsi e arte, si dhe në jetën e rinisë, për Qesen shënohet të ketë thënë: “Këto masa do të bëjnë të rritet rezistenca në radhët e rinisë dhe të inteligjencës dhe kjo do të shpejtojë ditën kur rinia do të reagojë në mënyrë aktive kundër diktaturës së proletariatis.”<sup>618</sup> Në shënimin që është bërë në raport thuhet se kjo frazë është konsideruar e rëndësishme dhe prandaj i është përcjellë Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit. Ndërsa për informatorin u propozua një shpërblim prej dyqind lekësh, afërsisht sa gjysma e një page mujore të nivelit mesatar.<sup>619</sup> Rasti tjetër është i vitit 1981, kur midis të burgosurve politikë janë shuar shpresat për ndryshime në vend, përfshirë edhe ndërhyrjet nga jashtë. “Po ky Xhavid Qesja nuk ka humbur çdo shpresë, – raporton bashkëpunëtori duke cituar: ‘Të ardhmen e shoh në përparimin e vendit, në Universitetin, Akademinë, në shkencën e teknikën. Përvetësimi i dijeve shkencore nga rinia, kjo është ëndrra ime, këtu i kam shpresat.’ Qofsha i gabuar, po ky shpreson se rinia do të bëjë edhe përmbysjen.”<sup>620</sup> e mbyll raportin e vet informatori.

Profecia ndodhi. Rinia e bëri përmbysjen. Xhavid Qesja kishte luftuar si askush për këtë dhe e arriti.

616. *AIDSSH, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje Përpunimi 2-A, nr. 1820.1, Raport mbi vëzhgimin e objektit Xhavid Qesja, i cili do të njihet “Gorilla”, për datat 21 deri 25.1.1987, f. 317-319.

617. *Po aty, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje Përpunimi 2-A, nr. 1820.1, Relacion për transferimin e dosjes së objektit aktiv 2-A Xhavid Hajdar Qesja, më 28.12.1988, f. 346.

618. *Po aty, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje Përpunimi 2-A, nr. 1820, Raport dhënë nga informatori “Beni”, Burrel, datë 10.4.1973, f. 181/1.

619. *Po aty, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje Përpunimi 2-A, nr. 1820, Shënim i Shefit të Seksionit R. Hoxha, datë 11.4.1973, f. 182.

620. *Po aty, AMB*, Sektori i Sigurimit, Dosje Përpunimi 2-A, nr. 1820. Raport i dhënë nga informatori “Butrinti”, Burrel, datë 9.12.1981, f. 247.





Lufta e Dytë Botërore ridimensionoi pozicionin e së majtës në Shqipëri. Krijimi i PKSH-së, adaptimi prej saj i modelit stalinist, diktimi i modelit jugosllav, energjia e saj për të drejtuar dhe dominuar lëvizjen e rezistencës antifashiste, i dha legjitimitetin për të kërkuar pushtetin e pasluftës, por edhe i hapi rrugën eliminimit të grupimeve të tjera të së majtës.

Rivalët brenda së majtës komuniste si: Niko Xoxi, Anastas Lula, Llazar Fundo, Mustafa Gjinishi, u eliminuan fizikisht që gjatë Luftës së Dytë Botërore. Komunistë të tjerë, si ata të grupit Zjarri, iu bashkëngjitën në shumicë Ballit Kombëtar. Disa u vranë gjatë Luftës, në përpjekje me armikun, ose në luftë kundër forcave partizane. Të tjerët u konsideruan “armiqtë e popullit” dhe iu nënshtruan ndjekjeve e persekutimeve që iu rezervuan kësaj kategorie. Lufta e mendimeve të ndryshme brenda së majtës komuniste nuk u mbyll në vitet e luftës. Komunistë jostalinistë, si Sejfulla Malëshova, Isuf Keçi, Skënder Luarasi, Petro Marko e shumë të tjerë, me kalimin e kohës vuajtën në mënyra të ndryshme faktin se nuk arritën t’i përshtateshin vijës politike të PKSH/PPSH-së.

E majta socialdemokrate ishte ajo që u godit më shumë dhe në vazhdimësi gjatë regjimit komunist. Pjesa më e madhe e socialdemokratëve shqiptarë: Gjergj Kokoshi, Selaudin Toto, Shefqet Beja, Salim Kokalari, Skënder Muço, etj., iu bashkuan lëvizjes së rezistencës antifashiste.